REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al
web:www.bashkiafier.gov.al

DOKUMENTI

I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T
Z. EDI RAMA

MINISTRJA E ZHVILLIMIT URBAN
ZNJ. EGLANTINA GJERMENI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
ZNJ. EVIS SEMA

KRYETARI I BASHKISË
Z. ARMANDO SUBASHI

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 100 Datë 06.12.2016
Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5 Datë 29.12.2016

Hartuar nga:	Bashkia FIER
Mbështetur nga:	Projekt i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Përmbajtja

Hyrje **12**

1. Analiza e thelluar për Planin e Përgjithshëm Vendor **14**
1.1 Analiza e përgjithshme e territorit **14**
1.1.1 Analiza topografike dhe klimatike 15
1.1.2 Analiza gjeologo - inxhinierike, e burimeve natyrore dhe pasurive minerale 17
1.1.3 Analiza hidrogjeologjike dhe hidrografike 18
1.1.4 Analiza e Gjeorreziqeve 21
1.1.5 Analiza e Bonitetit të tokave 24
1.1.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura natyrore 25
1.1.7 Analiza e zonave me vlerë historike 26
1.2 Dokumentet e planifikimit të hartuara më parë **32**
1.3 Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor **42**
1.4 Analiza e mjedisit dhe e problemeve mjedisore **49**
1.4.1 Metabolizmi i territorit 49
1.4.2 Mjedisi 62
1.4.3 Peizazhi, Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti 146
1.5 Analiza demografike dhe e mirëqenies social-ekonomike **176**
1.5.1 Demografia 176
1.5.2 Zhvillimi dhe përfshirja sociale 182
1.6 Zhvillimi ekonomik urban dhe rural **209**
1.6.1 Zhvillimi ekonomik 209
1.6.2 Analiza e sektorit të Bujqësisë 222
1.6.3 Pronësia mbi token dhe pronat publike 240
1.7 Analiza e infrastrukturave publike **245**
1.7.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik 245
1.7.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura 263
1.7.3 Ndriçimi i mjediseve publike 274
1.7.4 Mbetjet e ngurta 279
1.7.5 Sistemi i kullimit dhe ujitjes 293
1.8 Strehimi **297**
1.9 Përdorimi i tokës, sistemet dhe strukturimi i territorit **299**
1.9.1 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës 299
1.9.2 Cilësia e hapësirave publike, strukturave, dhe territoreve 319
1.10 Rëndësia kombëtare në territor **323**
1.11 Analiza e periferialitetit **329**
1.12 Konkluzione dhe rekomandime për planin **340**

2. Plani i Zhvillimit të Territorit **353**
2.1 Plani i Propozimeve Territoriale **353**
2.1.1 Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit 353
2.1.2 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës 393
2.1.3 Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike 403
2.1.4 Njësitë strukturore të territorit 410
2.1.5 Parashikimi demografik dhe strehimi 415
2.1.6 Instrumentet e drejtimit të zhvillimit 420
2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike **421**
2.2.1 Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale 421
2.2.2 Lëvizja në territor 424
2.2.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura 432
2.2.4 Ndriçimi i mjediseve publike 439
2.2.5 Mbetjet e ngurta 440
2.2.6 Infrastrukturat sociale 444
2.2.7 Infrastruktura të tjera publike 446

2.3 Plani për mbrojtjen e mjedisit 450
2.3.1 Mbrojtja e tokës 450
2.3.2 Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe hapësira e gjelbër 452
2.3.3 Mbrojtja e sistemit ujor 468
2.3.4 Cilësia e ajrit 481
2.3.5 Rekomandime mbi zonat e nxehta mjedisore 483
2.3.6 Rekomandime mbi zonat historike dhe monumentet e kulturës 484
2.4 Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së 485
2.4.1 Fazat e zbatimit të planit 485
2.4.2 Plani i investimeve kapitale 491
2.4.3 Monitorimi i zbatimit të planit dhe çështje institucionale-ligjore 491

3. Shtojcat 497
3.1 Studime mbështetëse 497
3.2 Tabela përmbledhëse e PPV-së 498
3.3 Tabela e Sistemeve dhe Zonave 502
3.4 Korrespondenca institucionale 508
3.5 Procesverbalet/ materialet nga dëgjesa publike 511

Figura 1. Ndarja administrative e Bashkisë Fier 14
Figura 2. Harta e Pjerrësisë në përqindje 16
Figura 3. Harta e klimës 16
Figura 4. Analiza e mbivendosjes së gjeologjisë, dhe pasurive minerale. 18
Figura 5. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë. 20
Figura 6. Analiza e mbivendosjes së rreziqeve në Bashkinë Fier. 24
Figura 7. Skemë e themelimit të qytetit të Fierit në shek. XVIII 27
Figura 8 Themelimi i Apolonisë si koloni greke 27
Figura 9 Apolonia në periudhën romake, si pjesë e Epirus Nova 28
Figura 10 Bashkia e Fierit nën sundimin Osman, Vijaleti i Janinës, Sanxhaku i Beratit 29
Figura 11. Monumentet dhe zonat të mbrojtura. 31
Figura 12. Skenari Strategjik i Zhvillimit të Territorit, 2013 33
Figura 13. Zonimi i hapësirës së mbrojtur të Parkut Arkeologjik të Apollonisë 34
Figura 14. Zonimi i hapësirës përreth Parkut të Apollonisë 35
Figura 15. Zonimi funksional 36
Figura 16. Koncepti i rrjetit rrugor të propozuar 37
Figura 17. Linja TAP dhe Fasha e saj e mbrojtjes 38
Figura 18. PINS Bregdeti, Harta e detajuar e segmentit 2 40
Figura 19. Rajonet ekonomike 41
Figura 20. Pozicionimi i Bashkisë Fier në kontekst rajonal 42
Figura 21. Kufijtë territorialë, Bashkia Fier 2015. 43
Figura 22. Shtimi i sipërfaqeve të ndërtuara 1990 – 2013. 44
Figura 23. Harta e shtrirjes së sipërfaqeve të ndërtuara 45
Figura 24. Elementet e forta në territor, nivel qyteti 47
Figura 25. Elementet e forta në territor 48
Figura 26. Fluksi i energjisë në rajon. 50
Figura 27. Fluksi i ujit (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) në rajon. 51
Figura 28. Konsumi i energjisë elektrike, Bashkia Fier. 53
Figura 29. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale. 54
Figura 30. Harta e konsumit të ujit të pijshëm në territorin e Fierit 55
Figura 31. Fluksi i ushqimit për produktet blegtorale (në kton), Bashkia Fier, 2014 dhe krahasuar me bashkitë e tjera të rajonit 58

Figura 32. Fluksi i ushqimit për produktet bujqësore(kton), Bashkia Fier 2014 dhe krahasuar me bashkitë e tjera të rajonit 58
Figura 33. Fluksi i ushqimit (kton), Qarku i Fierit (2012-2014) 58
Figura 34. Fluksi i ushqimit (kton), krahasimi me qarqe të tjera 59
Figura 35. Fluksi i ushqimit (kton) Qarku Fier, 2014. 59
Figura 36. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Fier 60
Figura 37. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Fier. 61
Figura 38. Relievi në Bashkinë Fier 63
Figura 39. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë 64
Figura 40. Rrëshqitjet në Bashkinë Fier 65
Figura 41. Erozioni në Bashkinë Fier 66
Figura 42. Vëllimi i rezervuarëve/digave mbushur me erozion (%) 68
Figura 43. Burimet ujore në Bashkinë Fier 69
Figura 44. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në Basenin e L. Seman 71
Figura 45. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor 71
Figura 46. Erozioni fundor në shtratin e lumit Vjosë (ndryshimi total në cm) 73
Figura 47. HEC-et në Pellgun e lumit Seman. 76
Figura 48. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Seman, brenda territorit të Bashkisë Fier 81
Figura 49. pH i ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës. 82
Figura 50. Tejdukshmëria e ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës 82
Figura 51. Përçueshmëria elektrike e ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës. 83
Figura 52. Vlerat e NBO5 dhe oksigjenit të tretur në basenet e Semanit dhe Vjosës. 83
Figura 53. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në basenet e Semanit dhe Vjosës. 84
Figura 54. Nitratet, nitritet dhe amoniaku në Basenin e Semanit. 85
Figura 55. Nitratet, nitritet dhe amonium në Basenin e Vjosës. 85
Figura 56. Metalet e rënda në basenet e Semanit. 86
Figura 57. Metalet e rënda në Basenin e Vjosës. 87
Figura 58. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi 2005-2015. 90
Figura 59. Gropë ekologjike për mbetjet e naftës në Pyllin e Levanit. 90
Figura 60. Akuiferëve në Qarkun e Fierit. 92
Figura 61. Qarku Fier: Sipërfaqja e Akuiferëve sipas llojit (në %). 93
Figura 62. Harta e puseve të naftës dhe akuiferëve në Qytetin e Fierit. 102
Figura 63. Plazhi i Divjakës 107
Figura 64. Grykëderdhja e Kanalit të Myzeqesë 108
Figura 65. Segmenti bregor nga Ujëmbledhësi i Myzeqese në Grykëderdhjen e lumit Seman. 108
Figura 66. Fenomeni i grumbullimit në plazhin e Divjakës e Semanit ndër vite. 109
Figura 67. Pamje satelitore e evolucionit gjeomorfologjik të bregdetit nga grykëderdhja e lumit Vjosa deri ne grykëderdhjen e lumit Shkumbin në litoralin shqiptar, për periudhën e verës (Gusht 1981, Korrik 1989 dhe tetor 2001) dhe thyerjet aktive të përmbysura e të mbihedhura 110
Figura 68. Zonat ku ndodh fenomeni i lëngëzimit të rërave 111
Figura 69. Segmenti më i lartë (mbi 4m) i Dunave përgjatë vijës bregdetare të Bashkisë Fier. 112
Figura 70. Rrezikshmëria e përmbytjeve në vend për periudhë rikthimi 100 vjet 116
Figura 71. Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me rikthim 100 vjet 117
Figura 72. Vlera mesatare e treguesve të monitoruar 2002-2014. 120
Figura 73. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë. 121
Figura 74. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite 121
Figura 75. Numri i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave që transportohen me tren në Shqipëri. 122
Figura 76. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara. 122
Figura 77. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %). 123

Figura 78. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit. 124
Figura 79. Shpërndarja e sipërfaqeve pyjor e kullosore sipas NJA-ve në Bashkinë Fier (në %) 128
Figura 80. Harta e fondit pyjor. 130
Figura 81. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës. 134
Figura 82. Rafineria e Naftës në zonën e ish-TEC-it 141
Figura 83. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi në harkun kohor 2005-2015. 143
Figura 84. Depozitë dekantimi me ndarje të lirë (majtas), me dy faza (djathtas) 146
Figura 85. Depozita dekantimi larëse (majtas), Depozitë dekantimi me tre faza (djathtas) 146
Figura 86. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat). 149
Figura 87. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor. 150
Figura 88. Harta Peizazhistike dhe Rrugët. 151
Figura 89. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë. Rezervuari i Levanit. 152
Figura 90. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës. 153
Figura 91. Harta e Elementeve Peizazhistike 153
Figura 92. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike 155
Figura 93. Pishë Poro 158
Figura 94. Parku Levan 159
Figura 95. Dunat e Semanit 160
Figura 96. Kurora e lumit të vjetër Fier 160
Figura 97. Rrapi i pazarit të Cakranit 161
Figura 98. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi. 165
Figura 99. Popullsia e Bashkisë Fier sipas NJA 177
Figura 100. Struktura moshore, 2015 179
Figura 101. Shkollimi i përfunduar në % për secilën NjA, në nivel bashkie, qarku, kombëtar. 184
Figura 102. Numri mesatar i viteve të shkollimit, sipas NjA. 184
Figura 103. Niveli i analfabetizmit sipas NJA 185
Figura 104. Numri i kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme (publike) për NJA, në nivel qarku 186
Figura 105. Mbulimi me kopshte 188
Figura 106. Mbulimi me shkolla 9-vjeçare 188
Figura 107. Mbulimi me shkolla të mesme 189
Figura 108. Mbulimi me objekte arsimore në nivel qyteti (Fier) 190
Figura 109. Kapaciteti akademik për kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme, nivel objekti arsimor, për Bashkinë Fier. 191
Figura 110. Kapaciteti akademik për kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme, për NjA në nivel Qarku. 192
Figura 111. Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar sipas NJA; grafiku i llojeve të aftësive të kufizuara 195
Figura 112. Distanca mesatare në minuta nga qendra shëndetësore më e afërt, nivel qarku. 196
Figura 113. Shpërndarja e ambulancave konsultatore sipas NjA-së, në nivel qarku 197
Figura 114. Niveli i papunësisë i femrave, meshkujve, dhe diferenca e papunësisë femra-meshkuj sipas bashkive, në nivel qarku. 199
Figura 115. Niveli i papunësisë i femrave dhe meshkujve, sipas NjA-ve 200
Figura 116. Punësimi sipas sektorëve, nivel NJA. 202
Figura 117. Statusi i punësimit dhe punësimi sipas nivelit arsimor, për NJA. 202
Figura 118. Punësimi sipas sektorëve në periudhën 2010-2014, si dhe punëkërkuesit e papunë, në nivel qarku. 203
Figura 119. Burimi i të ardhurave të familjeve, nivel qarku. 205
Figura 120. Shpërndarja e bizneseve sipas llojit, në NJA rurale të Bashkisë Fier 214

Figura 121. Shtrirja e veprimtarive ekonomike në bashkinë Fier 215
Figura 122. Harta e Ndërveprimit Ekonomik në Bashkinë e Fierit. 216
Figura 123. Diversifikimi ekonomik i bashkisë 217
Figura 124. Gjurma e gazsjellësit TAP në territorin e Bashkisë Fier. 219
Figura 125. Atraksionet kulturore të vizituara, 2013 220
Figura 126. Harta e territoreve të ullishtave ekzistuese në qarkun Fier 227
Figura 127. Harta e tokave të kripura në Bashkinë e Fierit. 232
Figura 128. Pikat e grumbullimit në bashkinë e Fierit. 235
Figura 129. Vendndodhja e Pronave Publike: Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës 243
Figura 130. Vendndodhja e pronave me funksion Arsim; Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës 243
Figura 131. Vendndodhja e pronave publike me konflikt 244
Figura 132. Shembull konflikti në pronën publike me funkion arsim 245
Figura 133. Fieri në raport me infrastrukturën rajonale. 246
Figura 134. Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor 248
Figura 135. Prerja tip e Autostradës 249
Figura 136. Prerja tip e rruges interurbane kryesore 250
Figura 137. Prerja tip e rrugës interurbane kryesore 250
Figura 138. Prerja tip e rrugës urbane kryesore. 251
Figura 139. Prerja tip e rrugës urbane dytësore. 251
Figura 140. Prerja tip e rrugës lokale. 252
Figura 141. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit. 253
Figura 142. Gjendja e infrastrukturës rrugore 254
Figura 143. Kryqëzimet e rrugëve lokale me rrugët interurbane kryesore dhe dytësore. 255
Figura 144. Aksidentet e regjistruara në territorin e Bashkisë Fier për periudhën 2088-2015. 256
Figura 145. Transporti ndërqytetës, Bashkia Fier 258
Figura 146. Lista e automjeteve sipas regjistrimit 259
Figura 147. Transporti ndërqytetës, Bashkia Fier. 260
Figura 148. Stacionet e Transportit publik dhe vendqëndrimet e taksive, Bashkia Fier. 261
Figura 149. Profil i hekurudhës 262
Figura 150. Skema e furnizmit me ujë nga U.K.-ja Fier. 264
Figura 151. Puset e ujit në Kafaraj pranë lumit Vjosë dhe zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare 269
Figura 152. Zonat e shërbyera nga U.K.-ja Fier. 270
Figura 153. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Bashkinë Fier 271
Figura 154. Rrjeti rrugor i ndriçuar, Bashkia Fier. 276
Figura 155. Grafiku i ofrimit të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Fier 280
Figura 156. Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Fier. 281
Figura 157. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi në harkun kohor 2005-2015 282
Figura 158. Foto nga vend-depozitimi i mbetjeve Fier 283
Figura 159. Grafiku i gjenerimit të mbetjeve inerte në vite, Bashkia Fier krahasuar me mesataren në Republikën e Shqipërisë 284
Figura 160. Infrastruktura bujqësore sipas llojit të kanaleve. 295
Figura 161. Sistemet e territorit 301
Figura 162. Përdorimi i tokës i shprehur në sipërfaqe 301
Figura 163 Përdorimi ekzistues i tokës sipas Kategorive bazë 303
Figura 164. Përdorimi ekzistues i tokës, sipas kategorive kryesore, nivel qyteti 304
Figura 165. Shembuj të mbivendosjes të përdorimeve të tokës 305
Figura 166. Shtëpia e Kulturës, Pojan 320
Figura 167. Zona industriale e Azotikut. 321
Figura 168. Stacioni i trenit, bashkia Fier 322

Figura 169. Objekte banimi në Darezezë. 322
Figura 170 Zonat e mbrojtjes së Gazsjellësit TAP 327
Figura 171. Zonat e rëndësisë kombëtare dhe kufizimet ligjore të territorit në Bashkinë Fier. 329
Figura 172. Harta e analizës së periferialitetit. 332
Figura 173. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Cakran. 333
Figura 174. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Frakull. 334
Figura 175. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Levan. 334
Figura 176. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Portëz. 335
Figura 177. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Dërmenas. 335
Figura 178. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Topojë. 336
Figura 179. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Libofshë. 336
Figura 180. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Qendër. 337
Figura 181. Grafiku i periferialitetit për Fierin. 337
Figura 182. Grafiku i periferialitetit për Mbrostarin. 338
Figura 183. Grafiku i periferialitetit për sipërfaqen e Fierit. 339
Figura 184. Grafiku për popullsinë sipas kategorive përkatëse të periferialitetit. 339
Figura 185. Vizioni i bashkisë dhe polet kryesore të zhvillimit. 354
Figura 186. Harta e specializimit ekonomik të njësive administrative. 356
Figura 187. Fashat, zonat dhe qendërsitë, Bashkia Fier. 360
Figura 188. Projektet transformuese të Bashkisë Fier. 361
Figura 189. Kufijtë e qendrës së vjetër dhe propozimi për kufinjtë e rinj të Qendrës së Fierit. 362
Figura 190. Variante të pozicionit të stacionit multimodal, Fier. 363
Figura 191. Skemë ilustruese konceptuale e zhvillimit të Aksit Ekonomik të Grecallisë. 366
Figura 192. Imazhe transformuese ilustruese të Azotikut. 368
Figura 193. Rrjeti i propozuar i biçikletave në bashki dhe lidhja me potencialet kulturore e natyrore. 370
Figura 194. Prerje tip e Unazës 3. 372
Figura 195. Skemë e strukturës dhe funksionit të zonës ripariane. 374
Figura 196. Skemë e mënyrës së zhvillimit inkremental të zonës së resorteve, Pishë-Poro. 376
Figura 197. Imazh i plazhit të lirë të Semanit. 377
Figura 198 . Imazh ilustrues i zonës së resorteve në Pishë-Poro 377
Figura 199. Koncept zhvillimi i zonës së bregdetit të Fierit. 378
Figura 200. Imazh ilustrues i zonës së shërbimit të marinës, Darzezë. 379
Figura 201. Platformat e ndërhyrjeve në qytetin e Fierit. 382
Figura 202. Ndarja e fshatrave sipas llojit të ndërhyrjeve dhe karakterit kryesor të tyre. 383
Figura 203. Përdorimi i propozuar i tokës, sipas kategorive bazë 400
Figura 204 Sistemet e propozuara territoriale 403
Figura 205. Sistemi i gjelbërimit, nivel qyteti. 405
Figura 206. Sistemi i propozuar i gjelbërimit publik në nivel bashkie. 409
Figura 207. Ndarja e njësive strukturore në nivel qyteti 415
Figura 208. Piramida e popullsisë për vitin 2015 417
Figura 209. Shpërndarja e popullsisë sipas Njësive Administrative, 2031. 419
Figura 210. Rritja e popullsisë së Bashkisë Fier, 2010-2031. 419
Figura 211. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Fier. 422
Figura 212. Linjat e propozuara të transportit publik ndërqytetës. 423
Figura 213. Rrugët e propozuara sipas funksionit 425
Figura 214. Integrimi aksial në Bashkinë Fier, para dhe pas ndërhyrjeve madhore të propozuara në rrjetin rrugor 426
Figura 215. Rrjeti i propozuar i transportit publik në nivel Bashkie. 429
Figura 216. Prerje e Unazës 2, ku kalon transporti publik i propozuar 430
Figura 217. Skema e propozuar e transportit publik dhe parkimeve në qytetin e Fierit 430

Figura 218. Kategorizimi i rrugëve sipas kodit rrugor.....431
Figura 219. Harta e sistemit aktual të furnizimit me ujë dhe propozimeve të reja, Bashkia Fier. 434
Figura 220. Harta e sistemit të shërbimit me kanalizime dhe propozimeve të reja, Bashkia Fier. 438
Figura 221. Ndriçimi i propozuar 439
Figura 222. Vendndodhja e Pikës së Transferimit propozuar për t'i shërbyer Nj.A-së Dermenas, Topojë dhe Levan. 442
Figura 223. Vendndodhja e Pikës së Transferimit propozuar për t'i shërbyer NjA-së Cakran. 443
Figura 224. Rrjeti elekrik në qytetin e Fierit.....446
Figura 225. Linjat e tensionit të lartë dhe nënstacionet elektrike, Bashkia Fier 447
Figura 226. Rrjeti i telefonisë, nivel qyteti 448
Figura 227. Shpërndarja e ngadaltë e ujit në territor kundrejt largimit të shpejtë.....456
Figura 228. Struktura e Kopshtit të Shiut. 456
Figura 229. Zona ripariane përgjatë Semanit.....459
Figura 230. Struktura e Zonës ripariane.....460

Tabela 1. Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2011 52
Tabela 2. Bilanci i energjisë elektrike, 2011.....53
Tabela 3. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale 54
Tabela 4. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Fier 56
Tabela 5. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për qarkun e Fierit.....57
Tabela 6. Vlerësim teorik i nivelit të erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë 67
Tabela 7. Vendndodhja e profileve të monitorimit 70
Tabela 8. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman 71
Tabela 9. Vendndodhja e profileve të monitorimit në Basenin e L. Vjosë. 72
Tabela 10. Erozioni fundor ndër vite në lumin Vjosë. 72
Tabela 11. HEC-et në Basenin e lumit Seman. 73
Tabela 12. Karrierat lumore në Bashkinë e re Fier. 79
Tabela 13. Pikat e monitorimit të Basenit Seman. 80
Tabela 14. Fshatrat pa sistem furnizimi me ujë të pijshëm. 95
Tabela 15. Akuiferi i Vjosës: parametrat problematikë në tre pus-shpimet e ti: Novoselë, Kafaraj dhe Pish-Poro. 96
Tabela 16. Vendndodhja e pus-shpimeve në Bashkinë e re të Fierit sipas ujësjellësve.....97
Tabela 17. Karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë në Bashkinë Fier. 101
Tabela 18. Zonat e përmbytura në dimrin e viteve 1962-1963 114
Tabela 19. Karakteristikat kryesore hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve më të mëdhenj në vend 114
Tabela 20. Lumenjtë/përrenjtë e vegjël me prirje për përmbytje në basenet Shkumbin, Seman e Vjosë 115
Tabela 21. Zonimi i rrezikut të përmbytjeve në Shqipëri për periudhë rikthimi 100 vjet.....116
Tabela 22. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore për periudhë rikthimi 100-vjet dhe nevojat e fatkeqësisë sipas pellgjeve ujëmbledhëse në Rrethin e Fierit 117
Tabela 23. Vlerat mesatare të treguesve të monitoruar nga 2002-2014 ne Bashkinë Fier dhe normat e lejuara të BE-së dhe Shqipërisë 118
Tabela 24. Bilanci i gjelbërimit publik në Bashkinë Fier 119
Tabela 25. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri. 123
Tabela 26. Kategoritë e përdorimit të territorit në përqindje 127
Tabela 27. Shpërndarja e ekonomive pyjore në Bashkinë Fier.....128
Tabela 28. Ekonomitë pyjore/kullosore në zonat e mbrojtura,Bashkia Fier.....130
Tabela 29. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990). 134

Tabela 30. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend. 135
Tabela 31. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime. 135
Tabela 32. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje më vitin 1990. 136
Tabela 33. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave 156
Tabela 34. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Fier 157
Tabela 35. Numri i individëve të shpendëve në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta 163
Tabela 36. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri. 165
Tabela 37. Flora dhe fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Fier. 166
Tabela 38. Speciet floristike në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Fier. 168
Tabela 39. Fauna në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Fier . 169
Tabela 40. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015 176
Tabela 41. Popullsia sipas gjinisë Bashkia Fier, për vitet 2011-2015 177
Tabela 42. Raporti gjinor për bashkinë Fier, 2011-2015. 178
Tabela 43. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave. 178
Tabela 44. Koefiçientët e varësisë 180
Tabela 45. Popullsia e bashkisë Fier, 2011-2031 181
Tabela 46. Niveli arsimor i bashkisë Fier, në raport me bashki të ngjashme 183
Tabela 47. Shkalla e analfabetizmit, niveli maksimal i shkollimit dhe vitet mesatare të shkollimit, në nivel bashkie dhe njësish administrative 183
Tabela 48. Numri i objekteve arsimore, Bashkia Fier. 185
Tabela 49. Treguesit e kapacitetit mbajtës të objekteve arsimore në nivel bashkie. 189
Tabela 50. Lista e objekteve arsimore në nevojë për ndërhyrje rikonstruktuese. 193
Tabela 51. Numri dhe përqindja e personave me aftësi të kufizuar, sipas gjinisë e llojit të paaftësisë, në nivel NjA-je. 194
Tabela 52. Treguesit e infrastrukturës shëndetësore në nivel qarku. 196
Tabela 53. Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe ambulancave, në raport me standardin e planifikimit 197
Tabela 54. Shkalla e papunësisë në Bashkinë Fier, krahasuar me bashkitë e ngjashme. 198
Tabela 55. Punëkërkuesit aktivë sipas qarqeve, për vitin 2014. 199
Tabela 56. Shkalla e papunësisë në Bashkinë Fier, sipas gjinisë dhe njësisë administrative. 200
Tabela 57. Sektori i punësimit në nivel bashkie, krahasuar me bashkit të ngjashme dhe bashkitë e tjera të qarkut. 201
Tabela 58. Sektori i punësimit, statusi i punësimit dhe punësimi sipas nivelit arsimor, nivel NJA. 201
Tabela 59. Punësimi sipas sektorëve në periudhën 2010-2014, si dhe punëkërkuesit e papunë, në nivel qarku. 203
Tabela 60. Burimet e të ardhurave mujore, në nivel qarku. 204
Tabela 61. Shpenzimet e familjeve, nivel Qarku. 205
Tabela 62. Niveli i varfërisë sipas plotësimit të nevojave bazë, nivel qarku. 206
Tabela 63. Nevoja bazë të paplotësuara, në nivel qarku. 206
Tabela 64. Institucione sociale në nivel qarku. 206
Tabela 65. Shërbimet Sociale në Qarkun Fier 207
Tabela 66. Prodhimi i brendshëm bruto, viti 2012 209
Tabela 67. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas viteve. 210
Tabela 68. Numri i ndërmarjeve sipas Qarqeve deri në vitin 2013 210
Tabela 69. Vlera e shtuar Bruto 210
Tabela 70. Vlera e Shtuar Bruto 211
Tabela 71. GVA – Industria dhe Shërbimet, 2012 211
Tabela 72. Diferenca midis emigrantëve dhe emigratëve per 1000 persona, për Qarkun Fier dhe qarqe të krahasueshme 212

Tabela 73. Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve/qark. 212
Tabela 74. Të punësuarit sipas sektorëve në Qarkun Fier. 212
Tabela 75. Biznesi i madh dhe i vogël në Bashkinë Fier. 213
Tabela 76. Prodhimi mujor i naftës bruto në Shqipëri (janar – qershor, 2015) 218
Tabela 77. Ndërrmarjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, 2012. 221
Tabela 78. Rajonalizimi i kulturave bujqësore dhe blegtorale 226
Tabela 79. Prodhimtaria bujqësore në periudhën 2013-2015, Bashkia Fier 229
Tabela 80. Produktet e agropërpunimit në periudhën 2013-2015 230
Tabela 81. Potenciali prodhues blegtorial 230
Tabela 82. Numri i pronarëve të serrave bujqësore në bashkinë Fier. 234
Tabela 83. Aftësia ujitëse e tokave bujqësore 2013 -2014 236
Tabela 84. Kategoritë e pronave sipas Inventarit të Pronave Publike 241
Tabela 85. Pronat publike për shërbimin parësor shëndetësor nga përdorimi i tokës 242
Tabela 86. Klasifikimi i infrastrukturës rrugore sipas Kodit Rrugor. 248
Tabela 87. Infrastruktura rrugore sipas funksionit. 252
Tabela 88. Prurja mesatare e burimeve të ujit në Bashkinë Fier. 264
Tabela 89. Volumi i depozitimit dhe furnizimi e popullatës me ujë të pijshëm: NJA Fier 265
Tabela 90. Të dhëna magjistrale mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm –Fier. 265
Tabela 91. Shërbimi furnizimit me ujë të pijshëm për NjA dhe fshatrat në Bashkinë Fier. 266
Tabela 92. Pus-shpimet në Bashkinë Fier. 267
Tabela 93. Gjendja e tubacione të rrjetit shpërndarës. 272
Tabela 94. Kostot energjisë elekrike në raport me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik. 278
Tabela 95. Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Bashkinë Fier dhe në rang vendi 281
Tabela 96. Prodhuesit e mbetjeve spitalore 285
Tabela 97. Aktivitete gjeneruese të mbetjeve në Bashkinë Fier, sipas lejeve që posedojnë 286
Tabela 98. Vëllimi dhe gjendja e teknike e rezervuarëve në Bashkinë Fier. 294
Tabela 99. Infrastruktura bujqësore sipas llojit, kategorisë dhe gjendjes në Bashkinë Fier në km linearë 296
Tabela 100. Sipërfaqet e ndërtimit për qëllime banimi sipas Njësive Admninistrative të Bashkisë Fier. 298
Tabela 101. Përfituesit e programeve të strehimit social, 2010-2013 299
Tabela 102. Sistemet Urbane 300
Tabela 103. Zonat buferike dhe karakteristikat e zonave të ndryshme të mbrojtjes 323
Tabela 104. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore. 331
Tabela 105. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore. 331
Tabela 106. Kategoritë e periferialitetit sipas sipërfaqes dhe popullsisë. 338
Tabela 107. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë sipas kategorive të periferialitetit në secilën njësi administrative të Fierit 339
Tabela 108. Reflektimi i propozimeve të planeve kombëtare në PPV-në e Bashkisë Fier. 390
Tabela 109. Nevoja për sipërfaqe shërbimesh bazë, sipas Rregullores së Planifikimit. 395
Tabela 110. Llogaritja e nevojës për shtim sipërfaqe banimi, për njësitë administrative. 396
Tabela 111. Sistemet e territorit dhe treguesit përkatës 400
Tabela 112. Bilanci i gjelbërimit publik, qyteti i Fierit 404
Tabela 113. Treguesit e gjelbërimit të veçantë, në nivel bashkie. 407
Tabela 114. Treguesit për zonat makrofunksionale 413
Tabela 115. Popullsia e bashkisë Fier, 2011-2031 416
Tabela 116. Popullsia e bashkisë Fier në periudhën 2010-2015 416
Tabela 117. Projeksioni demografik për Njësitë Administrative, sipas Gjendjes Civile. 418
Tabela 118. Projeksioni demografik për Bashkinë, në periudha 5-vjeçare 418
Tabela 119. Kategoritë e rrugëve të propozuara, sipas klasifikimit të kodit rrugor 425

Tabela 120. Numri i banorëvë që priten të kenë akses në transportin publik në harkun kohor 2011-2031 427
Tabela 121. Kapaciteti i burimeve të furnizmit me ujë krahasuar me kërkesën e parashikuar. 432
Tabela 122. Kërkesa për rezervuarë shtesë sipas zonave të furnizimit me ujë. 433
Tabela 123. Përmbledhje e investimeve të nevojshme për Bashkinë Fier (2021-2040) 435
Tabela 124. Investimet e parashikuara për ITUNU, Bashkinë Fier (2016-2040) 438
Tabela 125. Koordinata referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e Pikës së Transferimit. 442
Tabela 126. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal..... 442
Tabela 127. Nevoja për objekte arsimore. 445
Tabela 128. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ujit..... 470
Tabela 129. Fazimi i projekteve prioritare..... 485
Tabela 130. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit mjedisor 491
Tabela 131. Indikatorët për monitorimin e PPV-së dhe çështjet institucionale e ligjore përkatëse në nivel vendor 494

Hyrje

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Fier me mbështetjen teknike të Co-PLAN, Institutit për zhvillimin e habitatit, në kuadër të Projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Fier, ***Z. Armando Subashi.***

Përmbajtja e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier mbështetet në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Megjithatë për shkak të natyrës mjaft komplekse dhe shumë dimensionale që ka ky dokument, duke mbuluar nevoja të territorit urban dhe rural, gjatë hartimit të tij janë referuar dhe akte të tjera ligjore e nënligjore si dhe dokumente udhëzuese. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ligji nr. 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"
- Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr.8518, datë 30.7.1999 " Për kullimin dhe vaditjen"
- Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar";
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"
- Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë"
- Vendimet e KKT-së në 3 vitet e fundit, në lidhje me përcaktimin e çështjeve, zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare;
- Manuali teknik " Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri", etj

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të këtij dokumenti është mbështetur mbi përcaktimet ligjore për sa i përket strukturës së instrumenteve (dokumenteve të planifikimit) dhe proçedurave të konsultimit publik. Në këtë kuadër Bashkia Fier ka realizuar shtatë Dëgjesa Publike, gjatë fazave të ndryshme të hartimit të Strategjisë Territoriale, PPV-së dhe dokmentit të VSM-së. Gjatë këtyre dëgjesave kanë marrë pjesë, dhe kanë dhënë kontributin e tyre të paçmueshëm, qytetarë dhe profesionistë të Bashkisë Fier, grupet e biznesit dhe interesit, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Bordit të Kullimit, Drejtorisë së Pyjeve e Kullotave, Qendrave të kujdesit social, Komisionit Këshillimor Qytetar (CAP), institucioneve arsimore e shëndetësore të bashkisë, të Njësive Administrative, etj.

Së fundmi një falenderim i veçantë i detyrohet të gjitha institucioneve të cilat janë treguar bashkëpunuese gjatë këtij proçesi, veçanërisht Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Ministrisë së Zhvillimit Urban, ministrive të linjës, fqinje të Bashkisë Fier, si dhe të gjithë aktorëve të përfshirë gjatë proceseve të konsultimeve publike. Gjithashtu falenderojmë: Borana Disha, Klelia Haxhihyseni, Mikel Tepelena, Ledio Capo, Ina Brata, Besjana Qaja, Aldo Sula, Erisa Poleshi dhe Dea Rogova për mbështetjen gjatë proceseve të përpunimeve të ndryshme grafike.

Grupi i punës: Kejt Dhrami, Rudina Toto, Renilda Hyseni, Florian Muçaj, Edmond Leka, Enkelejda Peshkëpia, Dritan Shutina, Anila Gjika, Merita Toska, Elton Stafa, Sotir Dhamo, Besnik Aliaj, Renisa Muka, Iris Hyka, Ada Lushi, Sherif Lushaj, Arta Alla, Silvi Jano, Rodion Gjoka, Kristi Bashmilli, Xhesika Hoxha, Imeldi Sokoli, Gerti Delli, Ani Shtylla, Antonino di Raimo, Loris Rossi, Elona Karafili, Ledian Bregasi, Elvan Dajko, Malvina Disha,

Eneida Çela, Fiona Imami, Zenel Bajrami, Ols Lafe, Godiva Rrëmbeci, Laureta Memo, Aida Ciro, Ingrid Xhafa, Erialda Zekthi, Mariana Proko, Enkelejda Gjinali, Fjordi Bisha, Michiel Van Driessche.

1. Analiza e thelluar për Planin e Përgjithshëm Vendor

1.1 Analiza e përgjithshme e territorit

Bashkia Fier shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të Fushës së Myzeqesë, dhe laget nga Deti Adratik në perimetrin e saj perëndimor, në një gjatësi prej rreth 32 km. Pozita gjeografike e Fierit është mjaft e favorshme, për shkak se në territorin e bashkisë kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme rrugore të vendit: Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane). Me një sipërfaqe prej 66150 Ha, Bashkia Fier ka në përbërjen e saj 10 Njësi Administrative, respektivisht Fier, Cakran, Dërmenas, Frakull, Levan, Libofshë, Mbrostar, Portëz, Qëndër, Topojë. [1]

Bashkia e Fierit karakterizohet nga një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metrash mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë.

Figura 1. Ndarja administrative e Bashkisë Fier



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo kufizohet nga dy lumenj kryesorë, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron Parkun Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë; trashëgon zona industriale dhe naftëmbajtëse si

dhe gëzon pozicion strategjik avantazhues për sa i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të Gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Reforma Administrative-Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndikoi në Bashkinë e Fierit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë, duke i shtuar në përbërje të saj edhe njësi të reja administrative. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 17 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 ha[2] dhe një popullsi prej 82,262 banorë. Pas reformës, Bashkia e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km2 si dhe një popullsi prej 122,475 banorësh[3]. Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit, ndërsa qarku vetë ka në përbërje të tij bashkitë e reja të Mallakastrës, Patosit, Fierit, Lushnjes, Roskovecit dhe Divjakës.

1.1.1 Analiza topografike dhe klimatike

Ky seksion bën një përshkrim të përgjithshëm të aspekteve topografike e klimaterike që ndikojnë në territorin e Bashkisë Fier. Një analizë më e thelluar e këtyre komponentëve, veçanërisht në aspektin mjedisor, mund të gjendet në Seksionin 1.4.2. dhe masat respektive e parashikuara në Plan, në seksionin 2.3.1.

- **Analiza Topografike**

Terreni i Bashkisë Fier është kryesisht fushor, por ka dhe kodra në pjesën Lindore dhe pak në atë Veriore. Terreni fushor vazhdon që nga bregdeti i Adriatikut ku është përqëndruar dhe pjesa më e madhe e vendbanimeve. Lartësitë në këtë zonë variojnë nga 0 deri në 100 m mbi nivelin e detit. Pjerrësia e terrenit në zonën fushore është e ulët dhe varion nga 0-6%. Në pjesën ku terreni fillon të ngrihet hasen gjithashtu vendbanime të shumta, si në njësitë Levan dhe Frakull. Shtrirja e kësaj zone arrin lartësinë 110-220 m mbi nivelin e detit dhe pjerrësia varion nga 6.1-15.6%. Në kufirin e Bashkisë Fier me Bashkinë Mallakastër zona kodrinore më e lartë e bashkisë, në lartësi nga 220 në 550 m. Në këtë pjesë, pjerrësia e terrenit shkon nga 15.7 – 43 %.

- **Analiza Klimaterike**

Klima në këtë bashki sipas klasifikimit të Köppen-Geiger[4] i përket Csa[5] dhe njihet në përgjithësi me termin klimë Mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Prania e trupave ujorë në këtë bashki sjell zbutje të klimës gjatë verës, kur lagështia e ajrit mund të jetë më e lartë. Ky efekt është edhe më i dallueshëm në zonat urbane, ku prezenca e një trupi ujor (lumë, liqen etj.) mundëson krijimin e një mikroklime me temperaturë më të ulët në krahasim me pjesën tjetër urbane.

Bashkia Fier ndahet në dy zona përsa i përket orëve me diell[6]. Në zonën bregdetare kemi më shumë se 2,700 orë në vit me diell ndërsa në pjesën tjeter kemi 2,500 - 2,700 orë me diell në vit. Reshjet mesatare[7] në këtë bashki janë rreth 750 - 1,250 mm/vit dhe ndodhin kryesisht gjatë stinës së dimrit dhe vjeshtës. Përsa i përket shpejtësisë së erës, në territorin e bashkisë dallohen 3 zona. Zona perëndimore ka erëra me shpejtësi 3.1 - 3.5 m/s dhe vetëm në kufirin me bashkinë Divjakë ka erëra me shpejtësi 2.6 - 3 m/s[8]. Pjesa tjetër e Bashkisë Fier ka erëra më të shpejta që variojnë nga 3.6 - 4 m/s. Kurifi ndarës i shpejtësisë sipas një diagonaleje Verilindje – Jugperëndim kalon në perëndim të qyteti të Fierit.

Figura 2. Harta e Pjerrësisë në përqindje



Burimi: ASIG, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Figura 3. Harta e klimës



Burimi: ASIG, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

1.1.2 Analiza gjeologo - inxhinierike, e burimeve natyrore dhe pasurive minerale

Ky seksion bën një përshkrim të përgjithshëm të aspekteve gjeomorfologjike që ndikojnë në territorin e Bashkisë Fier. Një analizë më e thelluar e këtyre komponentëve, veçanërisht në aspektin mjedisor, mund të gjendet në Seksionin 1.4.2. dhe masat respektive e parashikuara në Plan, në seksionin 2.3.1.

- **Analiza gjeologo – inxhinerike**

Bashkia Fier bën pjesë në Albanidet[9] e Jashtme, në zonën e Sazanit (Baseni i Adriatikut Jugor[10]).

Kjo bashki ka larmi të shkëmbinjve, kryesisht atyre mesatarë dhe të dobët. Prania e lumenjve të Semanit e Vjosës, respektivisht në pjesën veriore dhe jugore të bashkisë, bën të mundur formimin e dherave që janë rezultat i mbledhjes së lumenjve. Përgjatë rrjedhjes së tyre kemi suargjile të vendosur mbi zhavorr (dhera me kohezion).

Në zona bregdetare hasen rëra detare me trashësi të qëndrueshme homogjene (dhera pa kohezion). Në pjesën perëndimore të bashkisë hasim formime me veti speciale, ku ka llumra argjilore, argjila të kripura dhe torfa, suargjila torfike. Këto të fundit hasen edhe në zonën Mbrostar dhe Sheqishtë. Në zonën kodrinore dallohet prania e shkëmbinjve të dobët dhe mesatarë. Ndër shkëmbinjtë e dobët mund të përmenden depozitimet e vjetra kuaternare të padiogjenizuara plotësisht, të cilat ndodhen në zonën kodrinore ku shtrihen dhe pjesa më e madhe e vendbanimeve të njësive Levan, Frakull, Portëz, Dërmenas etj. Shkëmbinjtë mesatarë janë më të larmishëm dhe i kemi të tre klasifikimeve:

- flishe ritmike shtresë hollë argjilo-alevrolito-ranore;
- mollasa argjilore;
- mollasa ranoro-konglomeratike

- **Analiza e pasurive minerale**

Në bashkinë Fier ka sasi të konsiderueshme mineralesh jometalore, si:

- shkrifërime - gjenden në zonën pranë bregdetit;
- gurë dekorativë - gjenden në zonën e Peshtan - Zhupanit;
- argjilë - gjenden në zonën e Krapsit, Mbrostarit, dhe në afërsi të bregdetit;
- inerte - gjenden në zonën e Mbrostarit, përgjatë rrjedhjes së lumit Seman;
- rëra kuarcore - gjenden në afërsi të zonës kodrinore

Bashkia Fier gjithashtu ka edhe pasuri në lëndët e para energjetike si gaz, naftë dhe ranor bituminoz. Këto të fundit gjenden në zonën e Kreshpanit. Nafta gjendet në Cakran dhe në Kallmin e Madh, ndërsa rezervat e gazit natyror gjenden në afersi të Levanit dhe në Povelçë.

Figura 4. Analiza e mbivendosjes së gjeologjisë, dhe pasurive minerale.



Burimi: SHGJSH, Përgatiti: Co-PLAN, 2016

1.1.3 Analiza hidrogjeologjike dhe hidrografike

Ky seksion bën një përshkrim të përgjithshëm të rrjetit hidrografik dhe aspekteve hidrogjeologjike që ndikojnë në territorin e Bashkisë Fier. Një analizë më e thelluar e këtyre komponentëve, veçanërisht në aspektin mjedisor, mund të gjendet në Seksionin 1.4.2. dhe masat respektive e parashikuara në Plan, në seksionin 2.3.3.

- **Analiza hidrogjeologjike**

Sipas Hartës Hidrogjeologjike të Qarkut FierBashkia e Fierit ka disa lloje akuiferesh[11], si me porozitet ndërkokrrizor, ashtu edhe me porozitet poro-çarje[12]. Gjithashtu në këtë bashki ka edhe zona jo akuifere të cilat nuk kanë porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh. Jo akuiferët ndodhen në përgjithësi në zonën veriore dhe pjesërisht qendrore të bashkisë, duke përfshirë vendbanimet e njësive administrative Topojë, Dërmenas, Libofshë, Fier, Qendër dhe Mbostar. Shkëmbinjtë në këtë zonë variojnë nga të shkrifët argjila, avrolite, rëra, në shkëmbinj kompaktë avrolite dhe argjilë të rrallë ranore, si dhe flish. Këto dy të fundit gjenden në përgjithësi në pjesën lindore të Bashkisë Fier.

Në zonën bregdetare dhe jugperëndimore si dhe përgjatë rrjedhjes së lumit Vjosa kemi akuiferë me porozitet ndërkokrrizor me ujë-përcjellshmëri shumë të lartë. Litologjia në këtë zonë përbëhet nga shkëmbinj të shkrifët të llojit sediment – rëra, zhavorre dhe argjila. Në afërsi të zonës së ushqimit akuiferët janë me sipërfaqe të lirë, ndërsa në drejtim të rrjedhës ato kalojnë me presion. Akuiferët janë të pasur me burime ujore nëntokësore dhe shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësore shfrytëzohen për shpime dhe prurjet e tyre variojnë nga 5 në 50 l/s. Vetitë fiziko-kimike të ujërave nëntokësore në përgjithësi janë të mira. Ato janë të ëmbla e me fortësi të ulët në zonat ku shfrytëzohen. Shpimet në këtë zonë janë të shumta dhe janë në përgjithësi në akuiferë me presion.

Përgjatë rrjedhjes së Semanit hasim edhe akuiferë me porozitet ndërkokrrizor me ujë-përcjellshmëri mesatare – të ulët dhe shkëmbinjtë përbëhen nga argjila, avrolite dhe rëra. Të tillë akuiferë hasim edhe në zonën e Cakranit, Frakullit, e Portëzës, por në trajtë argjile rëre dhe zhavorresh. Këto zona janë edhe të pasura me burime ujore.

Në zonën kodrinore të Bashkisë Fier hasim në përgjithësi akuiferë me porozitet poro- çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare të ulët që ka shkëmbinj kompakt sedimentarë ranorë dhe konglomerate. Resurset ujore shfrytëzohen kryesisht nëpërmjet shpimeve. Akuiferët janë me presion dhe në disa zona kanë karakter artezian. Përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të komuniteteve të vogla. Shfrytëzimi i rezervave të këtij akuiferi është në masën 60 %. Deri në thellësi 300 m, ujërat nëntokësore janë të ëmbla e kanë fortësi mesatare deri të madhe. Më në thellësi ato kalojnë në të kripura.

- **Analiza hidrografike**

Bashkia Fier ka pasuri të shumta ujore[13] pasi në territorin e saj kalojnë dy lumenj kryesorë, Semani e Vjosa, me basenet e tyre respektive. Përveç tyre, territorin e përshkon edhe lumi Gjanica, i cili kalon përgjatë qytetit të Fierit.

Lumi Seman: Përshkon me dredhime për 61 km Fierin dhe fushën e Myzeqesë. Në veri të qytetit të Fierit pranë fshatit Mbrostar ai merr me vete edhe Gjanicën dhe derdhet në det duke formuar një deltë të madhe. Gjanica është një nga afluentët e Semanit. Pasi përshkon 42 km përgjatë Mallakastrës, ajo futet në qytetin e Fierit dhe më pas bashkohet me Semanin. Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës të lumit Seman prej 863 m mbi nivelin e detit tregon se ky lum grumbullon ujërat e një territori të theksuar malor. Vlerat e larta dhe pothuajse të përafërta të lartësive mesatare të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve Osum (825 m) dhe Devoll (950 m), tregojnë se jo vetëm Semani në përgjithësi, por edhe dy afluentët e tij në veçanti, karakterizohen nga e njëjta natyrë malore e konfiguracionit të pellgut ujëmbledhës. Në përgjithësi sipërfaqja e pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve afluentë Osum e Devoll,

përfshihet në zonën malore dhe kodrinore të pellgut ujëmbledhës (Seman), ndërsa pjesa fushore fillon rreth zonës së bashkimit të këtyre dy lumenjve afluentë e deri në derdhjen e Semanit në detin Adriatik. Lumi Seman dhe dy afluentët e tij kryesor: lumenjtë Osum dhe Devoll, përshkojnë të gjitha zonat tektonike të Shqipërisë, të cilat karakterizohen nga një strukturë e ndërlikuar me toka të përshkueshme prej 21 % të sipërfaqes së përgjithshme të pellgut ujëmbledhës, gjysëm të përshkueshme prej 51 % dhe të papërshkueshme prej 28 %.

Figura 5. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë.



Burimi: SHGJSH, Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Lumi Vjosë është lumi më i madh i Shqipërisë së Jugut dhe një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë. Gjatësia e lumit Vjosa është 272 km, nga të cilat 86 km ndodhen jashtë territorit të vendit tonë. Sipërfaqja ujëmbledhëse e pellgut të Vjosës është 6710 km2. 75 km të rrjedhës së poshtme të Lumi të Vjosës shërben si kufi midis rretheve Fier dhe Vlorë. Në qarkun e Fierit përfshihet vetëm rrjedhja e poshtme e Vjosës, nga afërsitë e Hekalit, deri në derdhjen në det. Lugina e lumit Vjosë në këtë sektor paraqitet e gjerë dhe nga të dy anët kufizohet nga kodra të ulëta me shpate të buta që nuk i kalojnë të 300 metrat. Vetë lugina relievin e ka të sheshtë me tendencë drejt perëndimit. Vjosa në luginën e saj dredhon sa andej-këndej duke krijuar meandrime të shumta. Gjatë jetës së tij lumi Vjosa, në perëndim të Mifolit, ka ndryshuar disa herë shtratin e tij. Vjosa deri në afërsi të fshatrave Çerven e Mifol rrjedh mbi zhavoret e shtratit, ndërsa më në perëndim rrjedh mbi subargjila. Në shumicën e kohës së vitit, lumi Vjosa sjell një sasi të madhe suspensionesh dhe uji i tij rrallë është i kulluar. Shiu më i vogël e turbullon atë. Në varësi të faktorëve klimatikë ndryshon dhe prurja e Vjosës midis muajve dhe stinëve. Prurjet më të vogla ndeshen gjatë muajve korrik – tetor dhe në Mifol arrin në 20 – 40 m³/sek, ndërsa prurjet më të mëdha janë gjatë stinës së dimrit dhe arrin në 200 – 300 - 400 m³/sek. Prurja maksimale e vrojtuar në Mifol është 2,620 m³/sek, ndërsa ajo minimale 18 m³/sek. Ujrat e lumit Vjosë nga pikëpamja e përbërjes janë pothuajse të njëjta gjatë gjithë rrjedhjes së tij. Ato janë HCO3 – Ca dhe më rrallë HCO3 - SO4 – Ca, HCO3 – Ca – Mg dhe HCO3 - SO4 – Ca – Mg. Mineralizimi i përgjithshëm i tyre lëkundet nga 242 mg/l në 484 mg/l, ndërsa fortësia e përgjithshme nga 7.92 në 15.32 gradë fortësi gjermane.

1.1.4 Analiza e Gjeorreziqeve

Ky seksion bën një përshkrim të përgjithshëm të aspekteve të lidhura me gjeorreziqet në territor, si rrëshqitjet, erozionin, sizmicitetin, etj. Një vështrim më gjithëpërfshirës ndodhet në Seksionin 1.4.2, mbi Mbrojtjen e Mjedisit.

- **Analiza e gjeorreziqeve**

Gjeorreziqet janë rreziqe me karakter natyror që mund t'i kanosen një zone. Origjina e këtyre rreziqeve është:

- gjeologjike - tërmete, rënie shkëmbinjsh, rrëshqitje tokash;
- atmosferike - stuhi bore, stuhi ere, thatësira;
- hidrologjike – përmbytje;
- biofizike -zjarrje në pyje, epidemi.

- **Rrëshqitjet**

Si rrëshqitje janë vlerësuar lëvizjet e masave shkëmbore (kryesisht dherave) që përfshijnë sipërfaqe të kufizuara. Ato janë një fenomen shumë i përhapur. Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, paraqiten rreth 384 rrëshqitje të njohura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera. Gjithashtu duhet theksuar se territore të ngjashme me ato ku kemi konturuar rrëshqitjet e njohura, janë po aq të rrezikshme sa ato në të cilat ende nuk ka ndodhur rrëshqitje, por me krijimin e kushteve edhe ato shpate rrezikohen nga i njëjti fenomen. Nga analiza e bërë këtij fenomeni gjeo-dinamik, rezulton se rrëshqitjet ndodhin kryesisht në ato zona ku shkëmbinjtë e bazamentit të truallit janë kryesisht argjila dhe pjerrësia e shpatit është e dukshme. Rrëshqitjet kanë prekur si

shkëmbinjtë e bazamentit ashtu edhe mbulesën e dherave të Kuaternarit. Faktorët kryesorë të ndodhjes së tyre jane pasivë (ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura, tektonika etj.) dhe aktivë (erozioni, përmbajtja e lartë e ujërave nentokësore, reshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme etj.)

- **Vatrat e erozionit**.

Erozioni është fenomen mjaft i përhapur në territorin e qarkut Fier. Ky fenomen është i përhapur, si në zonën tokësore (erozioni tokësor), ashtu dhe në zonën bregdetare (erozioni detar).

- Erozioni tokësor

Zona të tëra, kryesisht të përbërjes litologjike argjilore e flishore, janë të prekura nga ky fenomen, i cili nga ana e tij është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve ’80 – ’90 të shekullit të kaluar, si dhe gjatë këtyre viteve të fundit. Erozioni shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor.

Erozioni sipërfaqësor është shfaqur kryesisht në zonat kodrinore, aty ku kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike flishore e argjilore. Ekspozimi ndaj faktorëve ekzogjene të alterimit, si rezultat i mungesës së pyjeve natyrale, bën që sipërfaqe shumë të gjera të denudohen me shpejtësi të madhe. Si rezultat i rënies së shirave me intensitet të lartë, bëhet largimi i menjëhershëm i materialit të shkatërruar dhe krijimi i kushteve për avancimin në thellësi të proceseve alteruese të shkëmbinjve rrënjësorë. Mekanizmi i erozionit fundor ndodh kur pakot litologjike me fortësi të lartë (gëlqerorë e ranorë) janë të vendosura në kuota hipsometrike më të larta se ato më të buta (argjilat). Për këtë shkak, në rast reshjesh të bollshme coprat e shkëmbinjve të fortë lëvizin nëpër shpate dhe sidomos në shtretërit e përrenjve e përroskave që kalojnë në shkëmbinjtë argjilo - alevrolitore, duke punuar mbi ta sikurse gurët zmerile. Në këtë mënyrë ata bëjnë thellim të shtretërve të tyre me shpejtësi të madhe dhe i bëjnë të paqëndrueshëm shpatet anësore të tyre. Në këtë rast krijohet një proces zinxhir midis errozionit dhe fenomeneve të rrëshqitjeve duke u kombinuar me njeri – tjetrin dhe duke qënë shkaktarë të njeri – tjetrit.

Erozioni detar është një fenomen mjaft i përhapur në qarkun e Fierit, i cili ka një vijë bregore të konsiderueshme. Ai është i lidhur me faktorë gjeologjikë (neotektonika) dhe faktorë humanë (shfrytëzimi i pastudiuar i inerteve në shtratin e lumit Seman dhe degët e tij, gjë e cila ka çuar në zvogëlimin e prurjeve të sedimenteve në det, duke rritur shkallën e erozionit në brigjet e detit). Ndryshimi i vazhdueshëm i grykëderdhjes së lumit Seman, në gjatësi të konsiderueshme, ka ndryshuar ndjeshëm depozitimet e ngurta në hapësirën e deltës së vjetër shumë të zhvilluar të tij e për pasojë vihet re një erozion shumë i fuqishëm i dallgëve të detit në segmente të caktuara si në plazhin e Semanit, në grykëderdhjen e kanalit të Hoxharës e në liqenin e Grykës së Gjemisë të cilat tregohen me shigjeta në hartë[14].

Gjithashtu në këtë bashki kemi edhe rrezik të përmbytjeve sidomos në lumenjtë kryesorë Vjosë dhe Seman, por edhe në lumin Gjanica. Kështu vitet e fundit kanë ndodhur shumë përmbytje në qytetin e Fierit që vijnë si pasojë e reshjeve të shumta dhe mbindërtimit përgjatë brigjeve.

- **Analiza e rrezikut sizmik**

Tërmetet janë dukuri natyrore ose artificiale të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha në njerëz dhe në materiale. Ato shkaktohen nga disa faktorë si: përplasja e pllakave të Tokës, shpërthimet nëntokësore etj. Dukë qenë se janë të paparashikueshëm, ato shkaktojnë akoma më shumë dëme pasi parandalimi i tyre është i paarritshëm. Megjithatë njohja e efekteve, dhe zonave më të prirura për aktivitet të lartë sizmik pakëson pasojat negative të tërmeteve. Shqipëria bën pjesë në Zonën Sizmike Alpine, ku gjenerohet rreth 15% e energjisë sizmike të globit tokësor[15]. Përveç pllakave sizmike, kemi edhe mikropllaka, njësi më të vogla ndarëse, dhe për vendin tonë paraqet rëndësi mikropllaka Adria, që shtrihet ndërmjet pllakës Afrikane dhe Euro-Aziatike. Përplasja e pllakës Adria me Albanidet është shkaku kryesor i tërmeteve në vend, dhe si pasojë kemi një aktivitet të theksuar sizmik. Shqipëria karakterizohet nga zona me aktivitet zismik të ndryshëm:

- mikro aktivitet sizmik intensiv: 1.0<M<3.0;
- tërmete të vegjël: 3.0<M<5.0 (të cilët janë më të shpeshtë);
- tërmete të rrallë me madhësi mesatarë: 5.0<M<7;
- tërmete më të rrallë të fortë: M>7.

Bashkia Fier bën pjesë në zonën me intensitet 8 ballë për sa i përket makrozonimit sizmik. Tërmetet janë rreziqe permanente ndaj veprave inxhinierike, për faktin se janë goditje dhe lëvizje të menjëhershme dhe me energji të lartë të tokës mbi themelet e objekteve inxhinierike[16].

Nga tërmetet më katastrofikë përmendim:

- tërmetin e 17 janarit 1929, me magnitudë M=5.1 me intensitet në qendër VII ballë, me epiqendër në Cakran të Fierit;

- tërmetin e 23 gushtit 1940, me magnitudë M=5.5 e intensitet VII ballë, me epiqendër në Cakran të Fierit;

- tërmetin e 1 shtatorit 1959, me magnitudë M=6.2 e intensitet VIII-IX ballë, i cili goditi fshatrat në afërsi të Urës së Kuçit (Lushnjë) si dhe Lushnjën, Fierin, Rrogozhinën. Ky tërmet pati paragoditje të fuqishme deri M=5.8 e cila gjithashtu shkaktoi dëme. Gjatë këtij tërmeti pati çarje në depozitimet e buta shoqëruar shpeshherë me shatërvane uji e rëre. Në Seman pati rrëshqitje të brigjeve. Në Lushnjë u shembën plotesisht 51 shtëpi dhe u dëmtuan rëndë 407 të tjera. Dëme pati edhe në qytetin e Fierit e Beratit;

- tërmetin e 18 marsit 1962, me magnitudë M=6.0 ballë dhe intensitet VIII ballë, i cili dëmtoi qytetin e Fierit, Lushnjës, Ballshit dhe fshatrat përreth. Pati 5 veta të vrarë, 77 të plagosur, u dëmtuan rreth 2,700 shtëpi nga të cilat 1,000 mbetën të pabanueshme, u dëmtuan objekte social-kulturore, si dhe ujësjellësi dhe rrjeti elektrik i Fierit. Në fshatrat Mbrostar e Vërri u vunë re çarje në depozitimet e shkrifta, të cilat u shoqëruan me burime uji të përzier me baltë, rërë dhe gaz. Fshati i Rërësit, u shkatërrua thuajse tërësisht. Çarjet shkuan deri në 100 m gjatësi dhe 40 cm gjërësi. Tërmeti pati dukuri të shumta trojesh, pseudovullkane rëre e balte, rrëzime të brigjeve të lumenjve Gjanicë, Seman e Vjosë;

- tërmetin e 17 nëntorit 1982, me magnitudë M=5.6 dhe intensitet në epiqendër 7 ballë, i cili preku rëndë zonat Fier, Lushnjë e Berat. Dëmet e tij ishin shumë të mëdha për shkak të zonës tepër të populluar dhe ndërtimeve shumë të dobta. Pati nje të vrarë, u dëmtuan 16,534 godina banimi dhe 405 objekte social-kulturore. Epiqendra e tij u lokalizua në Roskovec, por u ndie në të gjithë vendin e deri në Itali;

- tërmetin e 21 nëntorit 2013, me magnitudë M=5.2 dhe intensitet IV-V ballë, në lindje të Lushnjës, i cili është ndier edhe në Roskovec, Patos e Marinzë të Fierit.

Parandalimi i tërmeteve nuk mund të arrihet, por njohja mirë e intensitet sizmik dhe e historikut mundëson krijimin e kritereve dhe standardeve që duhen patur parasysh për ndërtimin dhe zhvillimin e aktivitetit njerëzor në zonë.

Figura 6. Analiza e mbivendosjes së rreziqeve në Bashkinë Fier.



Burimi: SHGJSH, Përgatiti: Co-PLAN, 2016

1.1.5 Analiza e Bonitetit të tokave

Aktualisht nuk disponohen të dhëna zyrtare mbi bonitetin e tokave në Fier. Gjithsesi zona e Fierit njihet si një ndër rajonet më produktive, ku mbi 70% e sipërfaqes së tokës bujqësore është e bonitetit të lartë, 1-4. Në pjesën perëndimore të bashkisë është mjaft e pranishme

dukuria e kripëzimit, duke i bërë tokat a papërdorshme për kultura bujqësore masive, si drithëra, por mundëson mbjelljen e kallamishteve dhe përdorimet e tjera të ngjashme.

1.1.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura natyrore

- **Monumentet dhe zonat e mbrojtura natyrore**

Në këtë seksion përshkruhen shkurtimisht disa nga zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore, që ndodhen në territorin e Bashkisë Fier, ose e prekin atë në kufi të tij. Një detajim i tyre gjendet në Seksionin 1.10, sa i takon zonave të rëndësisë kombëtare dhe kushtëzimeve ligjore respektive, si dhe në Seksionin 1.4.3, në lidhje me vlerat natyrore që mbartin.

Gjeomonumentet

Gjeomumentet janë zona natyrore që paraqesin interes të veçantë përsa i përket mënyrës se si janë krijuar, rrallësisë, vlerave historiko-kulturore, ose funksionit të tyre si pika interesi. Për nga rëndësia, gjeomonumentet klasifikohen në[17]:

- gjeomonument me vlera ndërkombëtare;
- gjeomonument me vlera kombëtare;
- gjeomonument me vlera rajonale.

- Gjeomonumente me vlera rajonale:

Zonat e mbrojtura, edhe pse disa prej tyre gjenden në kufi me Bashkinë e Fierit dhe nuk administrohen nga kjo bashki, kanë një zonë buferike prej 50m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin.

- Monumentet natyrore (Zonë e Mbrojtur, kategoria III) janë:

- Dunat e Semanit;
- Pishat e zeza në bregdetin e Poros;
- Kurora e lumit të vjetër të Semanit (Libofshë Adriatik);
- Rrapet e rrugës Fier-Vlorë dhe rrapi i pazarit të Cakranit (Çaireve).

Dunat e Semanit ndodhen në bregdet, në veriperëndim të fshatit Povelçë. Ato përfaqësojnë grupe dunash të krijuara nga veprimtaria akumuluese e erës në rërën e plazheve. Ato janë rreth 1km të gjata, 15m të gjera dhe 6m të larta. Veçori e tyre është vendosja në një brez gati linear me drejtim veri-jug. Aty pranë ndodhet edhe Plazhi i Semanit që është një prej plazheve më piktoreske në Shqipëri. Ai është rreth 3.5km i gjatë dhe rreth 2km i gjerë. Dy prej veçorive unike të këtij plazhi janë rëra e imët dhe pyjet e bukura me pisha. Deti është i cekët dhe shumë i përshtatshëm për pushime familjare e me fëmijë. Dunat kanë vlera shkencore (biologjike), ekologjike, kulturore dhe turistike.

Kurora e lumit të vjetër Seman e ka marrë emrin prej formës që ka. Kjo kurorë ndodhet në rrjedhjen e poshtme të Lumit Seman, pranë fshatit Adriatik, në afërsi të Libofshës, rreth 10m mbi nivelin e detit. Ajo përbën një shtrat të dikurshëm të lumit Seman, të braktisur prej tij, si pasojë e karakterit tepër endacak në këtë sektor të rrjedhjes së tij. Ajo ka një pyll me sipërfaqe 44ha. Pylli i Kurorës është një muze i gjallë, me drurë karakteristikë e biodiversitet të lartë. Bimët barishtore të tipit të limaneve, që ngjiten në plepat e lartë, bashkëshoqërimi

dhe dendësia e shumë llojeve bimore, dihatjet e faunës së egër e sidomos bretkosave dhe gjinkallave, të japin ndjesinë e një "xhungle" të vogël mesdhetare[18].

- Zona të mbrojtura

Laguna e Karavastasë gjendet në kufirin verior në Divjakë. Kjo lagunë është shpallur park kombëtar (Kategoria II).

Sistemi ligatinor i Nartës dhe Vjosës në pjesën jugore është shpallur peizazh i mbrojtur (Kategoria V).

Pylli i Levanit (199 ha) si dhe pylli i Pishë-Poros (1575 ha) janë shpallur rezervate natyrore të manaxhuar/park natyror (Zonë e mbrojtur, kategoria III e IV).

1.1.7 Analiza e zonave me vlerë historike

Ky seksion sjell një përshkrim të shkurtër të aspekteve kryesore historike, të cilat kanë ndikuar në formimin e vendbanimeve në zonën e Fierit, si dhe evidenton objektet apo zonat kryesore me vlerë historike e kulturore, nën mbrojtje sipas legjislacionit përkatës.

- **Vështrim historik**

Themelimi i qytetit të Fierit lidhet me rënien e Voskopojës si qendër urbane. Kjo mbështetet në dokumente që tregojnë se nga viti 1769 e më tej, nga Voskopoja do të vinin blegtorë të joshur nga klima e butë dhe kullotat e shumta. Si fillim këta banorë i ngritën shtëpitë e tyre më kallama me baltë. Këto ishin shtëpi përdhese pa oxhak, pasi familja aristokrate qe sundonte në këtë zonë, Vriona, nuk lejonte ngritjen e oxhakeve në shtëpi që nuk ishin të familjes. Shtëpi të tilla përdhese u ndërtuan rreth 24, derisa banorët kuptuan që ky ishte një vend më i përshtatshëm për të jetuar. Kjo ide u përforcua me ndërtimin e Urës mbi Gjanicë, nga e bija e Kurt Pashë Ngurëzë, Rapusheja, që më 1764 bashkoi fshatrat Fier i Madh dhe Shkozë, përkatësisht në perëndim dhe në lindje të lumit. Pas ndërtimit të urës u ngritën vepra të tjera, dukë listuar këtu Kishën e Shën Gjergjit në 1786 dhe një han. Një moment tjetër me rëndësi në historinë e zhvillimit urban të Fierit ishte blerja e tij nga Kahreman Pasha, në kohën kur ishte akoma çiflig shtetëror rreth viteve 1858-1862. Në këtë kohë u krijua edhe tregu i Vrionasve, buzë lumit Gjanica, duke organizuar rreth 122 dyqane[19].

Mbi emrin e Fierit janë hedhur disa hipoteza se nga ku mund të ketë prejardhjen, por dy janë më kryesoret. E para mbështetet në përdorimin e emrit të bimës fier për qytetin, ndërsa e dyta, më e besueshmja, mbështetet në përkthimin e fjalës italiane fiera- panair, pazar. Kjo fjalë mendohet të jetë përdorur nga tregtarët venedikas për të treguar vendin ku organizoheshin panairet e mëdha të produkteve bujqësore e blegtorale në shek. XV- XV[20].

Figura 7. Skemë e themelimit të qytetit të Fierit në shek. XVIII



Përgatiti: Co-PLAN, 2015, bazuar në literaturë

Në territorin e bashkisë Fier ndodhet qyteti antik i Apolonisë. Themelimi i kësaj qendre urbane antike mendohet të jetë rreth vitit 600 para Krishtit dhe është, sipas Skymnit (439-440) dhe Strabonit (VII, 5, 8c 316), vepër e korkyrasve dhe e metropolit të tyre Korintit. Mendohet se kolonët e parë që mbërriten dhe themeluan qytetin ishin vetëm meshkuj, duke rezultuar në një popullsi mikse mes asaj vendase dhe të ardhurve, për të siguruar vazhdimësinë e kolonisë. Fiset ilire që gjendeshin në afërsi të Apolonisë ishin Bylinët, Desaretët dhe Taulantët. Apolonia njihej si një port lumor dhe të ardhurat më të mëdha i kishte nga marrëdhëniet tregtare. Pas Luftrave Romako-Maqedonase, ajo u pushtua nga romakët, dhe vazhdoi të ishte një zotërim me vlerë i tyre.

Figura 8 Themelimi i Apolonisë si koloni greke

Përgatiti: Co-PLAN, 2015, bazuar në literaturë

Në Apoloni mendohet të ketë studiuar edhe Augusti, i cili ndodhej pikerisht në këtë vend kur mori vesh për vrasjen e Cesarit. Nga vlerësimi që kishte për Apoloninë, ky vendbanim mori statusin e Pax Romana dhe kishte shumë lirime nga taksat. Megjithatë, një tërmet i fuqishëm që zhvendosi rrjedhjen e lumit Vjosa dhe shtoi distancën e Apolonisë me detin Adriatik, u bë shkak që të fillonte rënia. Shkaqet ekonomike të bashkuara më forcimin e vendbanimeve të tjera antike bëri që Apolonia të humbistë vlerën e saj. Gjatë periudhave të mëvonshmë ajo nuk u shtrytëzua më si vendbanim, por shpesh gurët u mbartën nga Apolonia për të ndërtuar vepra të tjera më në fushë. Apolonia njihej edhe si pika e nisjes së pjesës jugore të rrugës Egnantia, që lidhte perandorinë romake me trevat më në thellësi të Ballkanit.

Figura 9 Apolonia në periudhën romake, si pjesë e Epirus Nova

Përgatiti: Co-PLAN, 2015, bazuar në literaturë

Gjatë pushtimit otoman, ashtu si në pjesën tjeter të Shqipërisë kemi ndarje të reja administrative. Kemi dy periudha duke u dalluar në mënyrën e ndarjes për përdorim të tokave. Periudha e parë përfshintë vitet 1362- 1864 dhe njihet si periudha e Ejaleteve. Ejaletet ndaheshin në sanxhakë, dhe ishin gjatë gjithë kohës në ndryshim të kufinjve dhe në territorin shqiptar ishin rreth 10 sanxhakë, duke realizuar një ndarjë shumë të copëzuar të territorit. Për më tepër territori ndahej në dy zona, në atë të timarit dhe atë të haraçit. Bashkia e Fierit bënte pjesë në zonën e timarit, që do të thoshte se toka ishte shtetërore dhe mund të jepej vetëm nga sulltani personave qe shkonin në luftë për të. Kjo zonë njihej ndryshe edhe si zona e dhjetës sipas taksës që paguhej.

Periudha e dytë përfshin vitet 1864-1912 dhe njihet si periudha e Vijaleteve, që më tej ndaheshin në sanxhakë. Në këtë periudhë kemi përdorimin e tokës me çifligje. Bashkia e Fierit bënte pjesë në Vijaletin e Janinës, në Sanxhakun e Beratit. Gjithashtu vlen të permendet se kleri mysliman kishtë numrin më të madh të çifligjeve në zonën ndërmjet Lushnjes dhe Fierit (Figura 10).

Figura 10 Bashkia e Fierit nën sundimin Osman, Vijaleti i Janinës, Sanxhaku i Beratit



Përgatiti: Co-PLAN, 2015, bazuar në literaturë

- *Monumentet e kulturës dhe zonat arkeologjike*

Bashkia Fier është në një kryqëzim sa antik dhe modern rrugësh. Dikur në territorin e saj shtrihej një nga kolonitë më të hershme të bregdetit Adriatik, e njohur si Apollonia e Ilirisë, ndërsa sot është parku arkeologjik më i madh i ultësirës perëndimore shqiptare e një prej më të vizituarve.

Apollonia është një park arkeologjik me potencial të lartë zhvillimi në funksion të vizitave turistike dhe të edukimit por prej vitesh, mungesa e një plani menaxhimi e ka penalizuar parkun me zhvillime projektesh që jo përherë kanë qenë në unison me njëri-tjetrin apo jo pak herë edhe me mbivendosje me njëri-tjetrin.

Aktualisht parku arkeologjik ka një gjendje të mirë të ruajtjes e konservimit por njëkohësisht nevoja emergjente të ndërhyrjeve specifike e kyçe restauruese në monumentet brenda tij të të gjitha periudhave. Projektet restauruese me financim të Bashkbimit Europian janë pjesë thelbësore e ndryshimit pozitiv por ende nuk ka një qartësi të linjave rrugore të cilat do të lidhin by-passin e Fierit me Apolloninë, dhe sa ky aks do të lehtësojë aksesin e vizitorëve por edhe të banorëve vendas.

Nga Apollonia fillonte në antikitet një degë e rëndësishme e Via Egnatia-s e natyrshëm qyteti është destinacion i vizitorëve të shumtë, të cilët mbërrijnë jo vetëm me automjete por edhe me mjete të tipit biçikletë, dhe ku nuk mungon hapësira për itinerare të cilat mund ti drejtojnë vizitorët drejt detit Adriatik, sikurse edhe itinerare mes fshatrave të cilat ndodhen në lindje të Apollonisë në drejtim të qytetit të Fierit.

Bashkia Fier, ka potencialin gjithashtu edhe të prezencës së manastirit të Shën Kozmait në Kolkondas, një monument që është natyrshëm pjesë e itinerareve të kishave bizantine të

ultësirës perëdimore sepse bart historinë e Shën Kozmait dhe frymën e pelegrinazhit historik. Kombinimi i resurseve të pasura kulturore me përmirësimin e infrastrukturës rrugore por edhe asaj turistike sjell pashmangshmërisht zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik lokal e rritje të interesimit të banorëve për vlerat që i rrethojnë.

Për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që e ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve te Kulturës.

Monumentet kulturore janë:

- Kisha e Shën Kollit, Vanaj
- Kisha e Shën Gjergjit, Libofshë
- Kisha e Shën Kozmait, Kolkondas
- Kisha e Shën Premtes, Hoxharë
- Vila Romake, Plyk
- Manastiri i Shën Mërisë, Pojan
- Qyteti antik Apolonia, Pojan
- Tempulli antik, Shtyllas

Zonat kryesore me vlerë historike janë:

- Apolonia
- Manastiri i Shën Mërisë
- Manastiri i Ardenicës (nuk është në bashkinë e sotme, por është në afërsi)

Parku i Apollonisë është arkivuar në shqyrtim për t'u konsideruar pasuri botërore nga UNESCO-ja nga Ministria e Mjedisit.[21] Parku i Apolonisë është një zonë prej 81 ha, kufiri i të cilës u caktua si një zonë arkeologjike e mbrojtur, e përbërë nga një zonë me intensitet të lartë arkeologjik (A) dhe (B) një zonë për zhvillimin e hapësirës së mbrojtur. Krahas Parkut Arkeologjik të Apolonisë, në Bashkinë e Fierit ndodhen dhe 17 monumente kulture të kategorisë së parë.

Kisha e Shën Mërisë ndodhet mbi fshatin Pojan, në manastirin i Shën Mërisë së Apolonisë. Kjo kishë është një nga monumentet më të rëndesishme arkitektonike të kultit mesjetar në Shqipëri. Për arsye të mungesës së mbishkrimit themelor që dëshmon datën e saktë të ndërtimit, studiuesit janë përpjekur të nxjerrin konkluzione në mënyrë të tërthortë, duke u detyruar të mbeshteten në piktura, mbishkrime dhe stile arkitektonike, që ruan në vetvete ky manastir. Kompleksi i Manastirit të Marisë Hyjlindëse përbehet, nga kisha e Shën Mërisë, paraklisi i Shën Mitrit dhe skevofilakioni (vendi i enëve të kultit), të cilët i janë ngjitur kishës në anën veriore. Tre studiues të këtij manastiri si Aleksudhi, Leon Hezej dhe Dome mendojnë se, kisha e Shën Mërisë duhet të jetë ndërtuar mbi themelet e faltores (tempullit) së Apolonit.[22]

Qyteti antik i Apolonisë mendohet të jetë themeluar rreth vitit 600 para Krishtit. Fiset ilire që gjendeshin në afërsi të Apolonisë ishin Bylinët, Desaretët dhe Taulantët. Apolonia njihej si një port lumor dhe të ardhurat më të mëdha i kishte nga marrëdhëniet tregtare. Një tërmet i fuqishëm që zhvendosi rrjedhjen e lumit Vjosa dhe shtoi distancën e Apolonisë me detin Adriatik, u bë shkak që të fillonte rënia. Shkaqet ekonomike së bashku më forcimin e

vendbanimeve të tjera antike bëri që Apolonia të humbiste vlerën e saj. Gjatë periudhave të mëvonshme ajo nuk u shtrytëzua më si vendbanim, por shpesh gurët u mbartën nga Apolonia për të ndërtuar vepra të tjera më në fushë. Apolonia njihej edhe si pika e nisjes së pjesës jugore të rrugës Egnantia, që lidhte Perandorinë Romake me trevat më në thellësi të Ballkanit[23].

Kolona e Shtyllasit përbëhet nga gurë gëlqerorë të punuar. Ajo përbëhet nga 7 blloqe guri në formë trung koni. Shtylla është e vendosur mbi një kodër rreth 50 m mbi nivelin e detit nga ku dallohet shumë qartë tempulli i Pojanit dhe kisha e Shën Premtes në Hoxharë. Zona ku ndodhet shtylla është një pllajë e vogël me një sipërfaqe 5700 m² dhe mendohet që këtu afër të ketë patur ndërtime të tjera[24].

Figura 11. Monumentet dhe zonat të mbrojtura.



Burimi: Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

1.2 Dokumentet e planifikimit të hartuara më parë

Ky seksion fokusohet në analizimin dhe vlerësimin e studimeve dhe planeve të hartuara më parë, propozimet dhe strategjitë e të cilave ndikojnë në zhvillimin e territorit të Bashkisë Fier. Planet dhe studimet e mëparshme janë të ndryshme përsa i përket tematikave dhe shkallës së hartimit. Në vazhdim jepet një përmbledhje e gjetjeve kryesore të këtyre planeve.

- **Plani i viteve 1980 – Portëz**

Në vitet 1980 janë realizuar një seri planesh për njësinë administrative Portëz, të cilat shprehin propozime të zhvillimit të fshatrave Lalar, Mbyet, Patos Fshat, Kraps dhe Portëz. Këto plane rregulluese janë miratuar kryesisht në vitet 1985 dhe fokusohen kryesisht në çështje që lidhen me parametrat e dendësisë, ndarje të ngastrave individuale, si dhe propozimin e vendbanimeve të reja, objekteve arsimore, shëndetësore, kulturore dhe të shërbimeve.

- **Plani Ndërvendor i Përgjithshëm (Bashkia Patos, Roskovec, Komunat Bubullimë, Mbrostar, Zharrëz, Kuman dhe Portëz)**

Përdorimi i propozuar i tokës: Ky është një plan i cili është hartuar në vitin 2013 nga GR Albania dhe Abkons. Ai synon të krijojë një vizion rajonal të zhvillimit të territoreve dhe fokusohet në objektiva dhe propozime strategjike të përgjithshme rajonale dhe të veçanta në nivel njësie administrative. Referuar skenarit strategjik të zhvillimit të territorit të këtij plani, njësia administrative Portëz do të ketë një karakter bujqësor-blegtoral, si dhe do të jetë i orientuar drejt zhvillimit të mesëm të industrisë së hidrokarbureve (pjesa jugore e territorit të saj).

Nga ana tjetër njësia administrative Mbrostar do të ketë një karakter kryesisht bujqësor. Ndërkohë që zhvillimi i industrisë së hidrokarbureve sipas këtij skenari do të jetë i ulët në pjesën më të madhe të territorit ndërsa në pjesën juglindore të territorit të njësisë zhvillimi i kësaj industrie do të jetë i lartë. Ky plan, nëpërmjet hartës së përdorimit të tokës së propozuar, propozon një sërë ndryshimesh në njësitë administrative Portëz dhe Mbrostar.

Kështu, propozohen qendra shëndetësore të reja, ambiente sportive, shkolla dhe lejimi i shfrytëzimit të burimeve të naftës në fshatin Vërri të njësisë administrative Mbrostar. Ndërkohë që fshati Kallm i Madh dhe Kallm i Vogël sipas propozimeve të këtij plani do të jenë e pjesë e zonave me fleksibilitet të lartë të zhvillimit të industrisë së hidrokarbureve përfshirë këtu; nxjerrjen, përpunimin dhe depozitimin e hidrokarbureve.

Territori bujqësor ekzistues i njësisë administrative Mbrostar do të ketë një karakter bujqësor, por do të jetë një zonë fleksibël me nivel të ulët të zhvillimit të industrisë së hidrokarbureve. Pra do të lejohet nxjerrja dhe përpunimi i burimeve të hidrokarbureve, por jo në nivelin e shfytëzimit të fshatit Kallm i Madh dhe Kallm i Vogël. Nga ana tjetër fshati Mbrostar për vetë shtrirjen e tij pranë autostradës do të ketë një karakter industrial-tregëtar.

Përdorimi i tokës së njësisë administrative Portëz do të jetë i orientuar drejt përdorimit bujqësor, natyror dhe pjesërisht (vetëm në fshatin Lalar) përdorimi i tokës orientohet drejt zhvillimit të mesëm të industrisë së hidrokarbureve.

Figura 12. Skenari Strategjik i Zhvillimit të Territorit, 2013



Burimi: PNV, 2013

- **Strategjia rajonale e zhvillimit të Qarkut të Fierit**

Kjo strategji nuk është dokument ligjor, por është më tepër një kornizë për mënyrën se si do të zhvillohet Qarku i Fierit prej vitit 2003 deri në vitin 2015. Objektivat strategjikë të këtij dokumenti fokusohen në uljen e varfërisë, përmirësimin e kushteve të arsimit, nxitjen e barazisë gjinore dhe nxitjen e qëndrueshmërisë së mjedisit.

Konkretisht ky dokument propozon ngritjen e tregjeve rajonale dhe pikave të grumbullimi, industrializimin e bujqësisë, nxitjen e projekteve profesionale, rikonstruksionin 100% të ndërtesave shkollore, rikonstruksionin e rezervuareve të naftës, hartimin e planit të manaxhimit të burimeve natyrore, krijimin e industrisë ricikluese në Lushnjë etj.

- **Plani i Manaxhimit për Parkun Arkeologjik të Apollonisë**

Ky është një plan i hartuar në vitin 2014, si pjesë e programit "ChWB, Cultural heritage management plans in the Western Balkan". Ky plan shoqërohet edhe me një rregullore të përdorimit të tokës që ka për qëllim vendosjen e disa rregullave dhe udhëzimeve në lidhje me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit të Parkut Arkeologjik të Apollonisë, ku zona e mbrojtur konfliktohet me përdorimin bujqësor dhe banim. Aktualisht Plani nuk është miratuar nga Ministria e Kulturës, por ky dokument merr në konsideratë propozimet e tij, si i vetmi instrument që trajton zonën e mbrojtur të Parkut të Apollonisë, si dhe zonën e ndikimit të tij.

Sipas këtij Plani dhe legjislacionit përkatës[25], Hapësira e mbrojtur e Parkut ndahet në dy zona (A dhe B), ku zona A ka intensitet të lartë arkeologjik dhe përfshin murin e qytetit antik, e zona B është zonë e mbrojtur e Parkut, me prezencë mbetjesh arkeologjike jashtë murit të Parkut, që shërben si zonë "tampon". Rregullorja e zhvillimit përcakton se në zonën A, nuk

lejohen në mënyrë kategorike ndërtime të reja, apo konvertim toke në truall. Për sa i përket aktivitetit bujqësor, ndalohet rreptësisht ai me teknologji të rëndë plugimi, me thellësi mbi 50 cm. Kështu, në zonën A lejohen vetëm kultura bujqësore që i shtrijnë rrënjët 30-50 cm në tokë. Gjithashtu lejohen vetëm ndërhyrjet me karakter hulumtues dhe kulturor të përcaktuara nga Plani i Manaxhimit të Parkut.

Ndërkohë zona tampon B ndahet në disa nënzona, në bazë të karakterit të tyre: Nënzona B1 është zona jashtë mureve të qytetit, por me intensitet të lartë arkeologjik, e cila u nënshtrohet të njëjtave rregulla si zona A. Nënzona B2 i përket zonave të banuara brenda kufijve të parkut, si fshati Kryegjatë, Sop, etj. Këto zona duhet t'i nënshtrohen PDZRK për zhvillime, të përputhshme me këto kritere:

- Përdorimet e lejuara do jenë të përputhshme me aktivitete e funksione, si banim, bujqësi, bujtina, agroturizëm, etj.
- Lartësia e ndërtesave nuk mund të jetë më shumë se 2 kate, 8 metra
- Ndërtesat duhet të kenë tipologji me çati të pjerrët, pa çarje
- Materialet e përdorura duhet të jenë prej qeramike

Në nënzonën B3 ndalohet çdo lloj ndërtimi dhe konvertimi i tokës bujqësore në truall, por nuk ka kushtëzime për aktivitetet bujqësore.

Figura 13. Zonimi i hapësirës së mbrojtur të Parkut Arkeologjik të Apollonisë



Burimi: Plan i Menaxhimit për Parkun Arkeologjik të Apollonisë, 2014

Përveç hapësirës së mbrojtur të Parkut, në Planin e Menaxhimit parashikohen rregulla edhe për zonën përreth tij, ku dallohen Zona I, me vlera të larta peizazhistike, e Zona II, me vlera socio-kulturore. Në Zonën I, e cila përkon me fushëpamjen nga kodra e Apollonisë drejt bregdetit, propozohet që të mos lejohen ndërtime në tokën bujqësore, dhe në rast të krijimit të një fashe ekonomike përgjatë *bypass*-it, ajo të izolohet me brez mbrojtës gjelbërimi të lartë.

Në Zonën II, e cila u përket fshatrave Pojan, Radostinë dhe Shtyllas, propozohet të realizohen zhvillime në përputhje me karakterin e Parkut, sipas këtyre kushteve:

- Lartësia maksimale e lejuar e ndërtesave mos të kalojë 3 kate, 10 metra;
- Tipologjia e ndërtesave të jetë me çati te pjerrëta dhe pa çarje;
- Intesiteti i ndërtimit të mos kalojë shifrën 1 m^2/m^2 dhe KSHT për ndërtim mos të tejkalojë raportin 30%;
- Të parashikohet forcimi i identitetit të fshatit duke krijuar qendërsi me përdorime miks ku lejohen aktivitete si: hoteleri, zona pushimi, bujtina, restorante, bare, dyqane të punime artizanale, etj..

Figura 14. Zonimi i hapësirës përreth Parkut të Apollonisë



Burimi: Plan i Menaxhimit për Parkun Arkeologjik të Apollonisë, 2014

Plani parashikon edhe kushte mbi qarkullimin në brendësi të Parkut. Në zonën A, nuk lejohet asnjë automjet motorik, me përjashtim të rasteve emergjente. Gjithashtu kërkohet që të shmanget kalimi nga fshati Pojan në Kryegjatë nëpërmjet parkut, me të finaliauar rrugën përgjatë kanalit. Në zonën B ndalohet qarkullimi i automjeteve të rënda, mbi 4 ton.

- **Planet e Zhvillimit të Komunave Dërmenas dhe Topojë**

Këto janë dy plane zhvillimi të realizuara prej Fondit Shqiptar të Zhvillimit në kuadër të projektit "Punët në Komunitet II" të financuara prej Bankës Botërore. Ato analizojnë gjendjen aktuale të territoreve të dy ish-komunave Dërmenas dhe Topojë, ndërsa propozimet e tyre do të kenë një jetëgjatësi prej 15 deri në 20 vite. Këto plane kanë për synim të orientojnë zhvillimin dhe investimet në bazë të qëllimeve strategjike.

Për shkak të karakterit të tyre të ngjashëm, të dyja njësitë administrative, sipas këtij plani do të kenë një orientim drejt sektorit të turizimit, ndërkohë që fusha të tjera prioritare do të jenë: zhvillimi social, zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike dhe qeverisja e mirë.

Ky plan propozon: hartimin e një plani hapësinor për bregdetin i cili do të marrë parasysh kthimin e zonës bregdetare të kësaj njësie administrative në një zonë turistike atraktive si dhe zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe për infrastrukturën (rrjeti vaditës – kullues, sigurimin e ambjenteve shkollore, rrugë të reja lidhëse etj).

- **Plani i Përgjithshëm Rregullues i Qytetit të Fierit, 2006**

Ky është një plan i miratuar i cili është hartuar në vitin 2006 dhe ka patur për synim manaxhimin e territorit deri në vitin 2021. Plani është hartuar nga Bashkia e vjetër e qytetit të Fierit në bashkëpunim me Co-PLAN-in. Propozimet e këtij plani janë organizuar sipas fashave strukturore dhe fokusohen në fashën e Lumit Gjanica, hekurudhës, fashën Seman – Patos, fashën agropeisazhistike dhe fashën e Apollonisë.

Në fashën e Gjanicës propozohet të krijohen hapësira publike ndërsa fasha e hekurudhës dhe e Seman - Patos do jenë të dedikuara drejt funskioneve mikse të banimit, shërbimeve dhe hapësirave publike. Në fashën agropeisazhistike propozohet të ketë një zhvillim bujqësor, ekonomik dhe tregëtar. Ndërsa, në fashën e Apollonisë, propozohet të ndërtohet një park zoologjik, botanik dhe një park argëtimi. Përsa i përket infrastrukturës rrugore, ky plan vendos theksin në plotësimin e rrjetit unazor duke përfunduar pjesën tjetër të unazës ekzistuese dhe krijimin e një unaze më të vogël në qendrën e qytetit. Gjithashtu ky plan propozon fuqizimin e tre akseve kryesore lidhëse: rrugën aktuale të hyrjes nga Tirana, rrugën në drejtim të Grecallisë dhe lidhjen në drejtim të Semanit.

Ky plan propozon një brez ekonomik me gjërësi 100 m në konturin jugor të autostradës si dhe përforcimin e zonave ekzistuese ekonomike të qytetit.

Figura 15. Zonimi funksional



Burimi: Plani i Përgjithshëm Rregullues i Qytetit të Fierit, 2006

Plani propozon urbanizimin e tokave periferike bujqësore të qytetit duke i mbushur ato me ndërtime me funksion banimi. Gjithashtu, plani propozon rikonceptimin e zonës së hekurudhës, ku zona me magazina dhe sipërfaqe shërbimi të degraduara të kthehet në zonë të re banimi me banesa kolektive deri në 10 kate. Në këtë rast propozohet të përdoret edhe instrumenti i zhvillimit "Intesitet me kusht" me qëllimin që të sigurohen kate banimi edhe për të pastrehët.

Plani bën një sërë propozimesh me karakter mjedisor si: planifikimin e zonave të gjelbëra periferike si p.sh. Vadhizë – Radostinë, transformimin e grumbullimit të mbeturinave në Park dhe vendosjen e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza në veriperëndim të qytetit.

Ky plan ka bërë propozime edhe mbi përdorimin e tokës. Kështu në pjesën veriore të qytetit dhe konkretisht në zonën e ish-Komunës Qendër propozohet një zonë spitalore, ndërkohë që zona në rrugën e Dërmenasit do të jetë një zonë mikse me prioritet ekonomik. Ndërkohë, fshatrat Vadhizë dhe Radostinë pritet të urbanizohen, kurse pjesa jugore e Radositës është propozuar të jetë një park periferik.

- **Plan i përgjithshëm ndërvendor i Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qendër**

Plan i përgjithshëm ndërvendor i Bashkisë Fier është një plan i miratuar në vitin 2013 dhe përfshin territorin e Bashkisë së vjetër të qytetit të Fierit dhe ish-Komunën Qendër. PNV-ja risjell në vëmendje propozimet e bëra nga Plani Rregullues i qytetit të Fierit i hartuar në vitin 2006. Ndër të tjera, ky plan merr në konsideratë dhe bën pjesë të njësive strukturore të propozuara zonën e ish-Uzinës së Azotikut dhe propozon të kthejë një pjesë të madhe të territorit të saj në zonë të gjelbër. Ndërkohë pjesën tjetër të kësaj zone ia dedikon funksioneve ekonomike dhe objekteve të banimit. Plani synon të fuqizojë sektorin privat me drejtim kryesor agrobiznesin dhe turizmin si dhe fuqizimin e një filiali univeristar në qytet.

Figura 16. Koncepti i rrjetit rrugor të propozuar



Burimi: PNV i Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qendër, 2013

Nga pikëpamja infrastrukturore, Plani risjell konceptin e 3 Unazave urbane, ku unaza 3 është tërësisht e re dhe shtrihet në tokë bujqësore, përgjatë kanaleve kryesore kulluese përreth qytetit. Përveç tyre, në Plan përcaktohen 5 radiale urbane, të cilat përcaktojnë drejtimet e hyrjes për në qytet: aksi i Grecallisë, rruga e Mbrostarit, rruga e Darzezës, Aksi i Levanit dhe ai i Portëzës. Plani parashikon një numër të madh "Tegelash", të cilat përfaqësojnë lidhjet e unazave dhe radialeve me *bypass*-in, në kushtet kur propozohet një rrugë shërbimi përgjatë tij.

- **Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik**

Me vendim të KKT-së nr. 1, datë 04.07.2013 është miratuar Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans-Adriatik (Projekti TAP), i cili kushtëzon të gjitha autoritetet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Linja e gazsjellësit shtrihet edhe përgjatë territorit të Bashkisë së re të Fierit, përgjatë njësive administrative Mbrostar, Libofshë, Topojë dhe Qendër. Përveç shtrirjes së linjës së gazit, ky projekt propozon edhe ndërtimin e një stacioni kompresor në Fier pikërisht në bregun perëndimor të NJA Topojë, në pjesën veriore të fshatit Sheq Marinas. Ky kompresor do të shërbejë si një stacion pompimi gazi i cili kompreson gazin për ta transportuar në destinacionin tjetër. Ndërkohë propozohet edhe ndërtimi i një stacioni valvulash shumë pranë bregut të detit midis Liqenit të Petritit dhe Grykës së Gjemisë. Nga pikëpamja infrastrukturore, projekti TAP parashikon ndërtimin e 3 rrugëve lokale, në fshatrat Vajkan, Gjokalli dhe Grykë.

Figura 17. Linja TAP dhe Fasha e saj e mbrojtjes

Burimi: PKS TAP, 2013

Ky projekt, në bazë të VKM Nr.2, datë 10.12.2012 është shpallur Cështje e Rëndësisë Kombëtare në Planifikimin e Territorit, duke përfshirë një korridor me gjerësi 500 m të Projektit (250 metra në secilën anë të gazsjellësit). Ndërkaq, bazuar në Dokumentin e Rregullores për Lejen Zhvillimore Komplekse për Gazsjellësin Transadriatik[26], gjurma e tij do ketë 3 zona sigurie (8m, 20 m dhe 100 m në secilën anë) dhe 2 zona të konsultimit (450 m dhe 650 m në secilën anë) për zhvillime të karakterit të ndryshëm.

- **Plan i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit**

Plan i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit është një plan i cili ka për qëllim të shërbejë si një kornizë rregulluese për të siguruar standarde në planifikimin e zonës bregdetare të territorit të Shqipërisë. Zona e marrë në studim ka një orientim të përgjithshëm veri – jug dhe prek edhe pjesën perëndimore bregdetare të Bashkisë së re të qytetit të Fierit, përkatësisht, njësitë administrative Dërmenas, Topojë dhe Libofshë. Referuar këtij plani, zona bregdetare e bashkisë Fier bën pjesë në rajonin numër 2 dhe quhet "rajoni i agrikulturës".

Ky plan vendos edhe rregulla mbi mënyrën e zhvillimit të zonave bregdetare, kështu propozohet që: të ndalohen ndërtime të përhershme në një distancë prej 200 m nga bregdeti si dhe të ndalohet ndërtimi nën kuotën +60 m mbi nivelin e detit në bregdetin e jugut. Ndërsa në qendrat urbane, ku karakteri i zhvillimit është urban dhe jo turistik, lartësitë e ndërtesave duhet të jenë deri në 5 kate.

Konkretisht në zonën bregdetare të Bashkisë së re të Fierit propozohen këto ndërhyrje:

- ndërtimi i objekteve turistike lokale në Topojë dhe Darzezë;
- ndërtimi i tregjeve ushqimore në njësinë administrative Levan dhe Mbrostar;
- ndërtimi i një porti jahtesh në Darzezë
- ndërtimi i një landfilli rajonal në pjesën veriore të qytetit të Fierit.
- Shpallja e një Zone të Rëndësisë Kombëtare përgjatë bregut, kufizuar nga kanali kryesor kullues, duke përfshirë fshatin Darzezë dhe gjithe Pyllin e Pishë Poros.

Gjithashtu, në Rregulloren e bashkëngjitur Planit, parashikohen disa parime në lidhje me zhvillimin urban dhe harmonizimin e potencialeve turistike e ekonomike të zonave. Respektivisht, disa nga këto parime, janë:

- Densifikimi i zonave të urbanizuara ekzistuese, paraprakisht zënies së territoreve të reja të lira, periferike, në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore.
- Zonim të aktiviteteve të brezit 200 metra në bregdet, ku deri në distancën 100 metra nga vija bregdetare lejohen vetëm struktura 1 katëshe, e 100-200 m lejohen struktura e infrastruktura të përheshme, me interes publik, deri në 2 kate.
- Vija e ndërtimit nga bregdeti, "vija blu", për strukturat e lehta shërbyese, si dhoma zhveshjeje, dushet, bare, fast-food, tualetet, mund të konsiderohet në nje fashë maksimale duke filluar nga 50m nga vija bregdetare
- Kufizim të lartësisë në kate në zonën bregdetare (përtej 200 m nga vija bregdetare)
- Ruajtje të tipologjive tradicionale të banimit në fshatrat pranë vijës bregdetare
- Në zonën turistike të bregdetit, rrjeti rrugor duhet të zhvillohet dhe të mirëmbahet sipas standardeve europiane dhe duhet të jetë i pajisur me korsi për biçikletat dhe këmbësorët.
- Etj.

Figura 18. PINS Bregdeti, Harta e detajuar e segmentit 2

Burimi: AKPT, 2015

- **Plani i Përgjithshëm Kombëtar**

Ky është një dokument i hartuar nga Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit dhe synon të japë një vizion të qartë mbi zhvillimin e

territorit të Shqipërisë në vitet 2015- 2030. Ai përqëndrohet në qëllime specifike strategjike të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve, mbrojtjen e interesave publike dhe private si dhe nxisin planifikimin e harmonizuar të territorit.

Konkretisht, Plani Kombëtar e trajton Bashkinë Fier si një nga qendrat urbane të rëndësisë kombëtare (kryeqendra) dhe si pjesë e rrjetit të rrugëve prioritare të vendit. Si një qendër e tillë, Bashkia Fier do të jetë një qendër kryesore e zhvillimit ekonomik dhe nyje kryesore e grumbullimit, shpërndarjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Gjithashtu ky plan e trajton Fierin si një nga qendrat urbane të cilat do të jenë qendra të shërbimit shëndetësor të përparuar, qendra të arsimit të lartë dhe qendra kërkimore të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.

Nga pikëpamja ekonomike dhe infrastrukturore, Fieri konsiderohet si një ndër qendrat primare të rajonit ekonomik Fier-Vlorë, nyje multimodale me tendenca për konsolidim, densifikim e përforcim në pjesën urbane, dhe konsolidim e përforcim drejt sektorëve të ekoturizmit përgjatë fashës bregdetare.

Figura 19. Rajonet ekonomike



Burimi: PPK, 2016

1.3 Pozicionimi strategjik dhe pikat e forta në territor

Fieri shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të Fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të Detit Adriatik. Bashkia e Fierit shtrihet në një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme duke parë që në këtë bashki kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit të cilët janë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane). Autostrada, e cila do të lidhë Lushnjën me Fierin dhe Vlorën, do të jetë një arterie e fuqishme transporti nga dhe në drejtim të Fierit. Ajo do të kalojë në një distancë afërsisht 2 km nga qendra e Fierit [27]. Qendra e qytetit ka dy lidhje kryesore, një pjesën veriore me rrugën e Celigradit dhe një tjetër në pjesën perëndimore me rrugën e Semanit. Një tjetër linjë e rëndësishme komunikacioni është infrastruktura hekurudhore ku në Bashkinë e Fierit kalojnë linjat Tiranë - Vlorë dhe Tiranë - Ballsh.

Figura 20. Pozicionimi i Bashkisë Fier në kontekst rajonal



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Bashkia e Fierit karakterizohet nga një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metrash mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnjë, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë.

Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale. Ajo përbën 5.7%[28] të tokës bujqësore; kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron Parkun Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë; trashëgon zona

industriale dhe naftëmbajtëse si dhe gëzon pozicion strategjik avantazhues për sa i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të Gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Reforma Administrativo - Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndikoi në Bashkinë e Fierit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë, duke i shtuar në përbërje të saj edhe njësi të reja administrative. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 17 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 ha dhe një popullsi prej 82,262 banorësh (Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Fierit, 2006). Pas reformës, Bashkia e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km2[29] si dhe një popullsi prej 122,475 banorësh[30]. Ajo përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. Bazuar po në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit, ndërsa qarku vetë ka në përbërje të tij bashkitë e reja të Mallakastrës, Patosit, Fierit, Lushnjes, Roskovecit dhe Divjakës.

Figura 21. Kufijtë territorialë, Bashkia Fier 2015.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN,2015

Bashkia e re e Fierit përfshin në territorin e saj administrativ qendra, të cilat historikisht kanë qenë me rëndësi ekonomike dhe urbane për rajonin. Fieri u konsolidua si qendër urbane me ndërtimin e Urës mbi Gjanicë në vitin 1764. Kjo urë bashkoi fshatrat Fier i Madh dhe Shkozë, përkatësisht në perëndim dhe në lindje të lumit. Pas ndërtimit të urës u ngritën vepra të tjera, duke përmendur këtu Kishën e Shën Gjergjit në 1786 dhe një han. Roli i Fierit si qendër e rëndësishme tregtare dhe i Lumit Gjanica si element qytet-formues, u rikonfirmua

në mesin e shekullit XIX, kohë kur u krijua tregu i Vrionasve, buzë këtij lumi, duke organizuar rreth 122 dyqane.

Rëndësi të veçantë si qendër ekonomike Fieri e mori gjatë periudhës së industrializimit, që filloi me ndërtimin e termocentralit, ngritjen e Uzinës së Pastrimit të Pambukut në vitin 1952, që u pasua nga ngritja e fabrikave të industrisë ushqimore, si ajo e vajit, margarinës, e verës etj. Fieri zinte 12% të prodhimit të përgjithshëm industrial të vendit. Degët kryesore të industrisë ishin energjetika (nxjerrja dhe përpunimi i naftës, prodhimi i energjisë elektrike), industria kimike, mekanike dhe ushqimore.

Rënia e sistemit komunist në vitet 1990, ashtu si në gjithë Shqipërinë edhe në Bashkinë Fier, solli ndryshime të mëdha në aspektin ekonomik, territorial dhe mjedisor. Kështu para viteve 1990, degët kryesore të ekonomisë së qytetit të Fierit ishin industria e naftës, industria kimike, mekanike, energjetike, bujqësia etj., kurse pas viteve 90, pati një dobësim të këtyre industrive dhe zhvillim të sektorit të tregtisë dhe atij të ndërtimit. Po ashtu, në vitet e fundit vihet re një rigjallërim i bujqësisë dhe blegtorisë, të cilat janë edhe nga sektorët me potencialet më të mëdha për punësim dhe zhvillimin ekonomik të bashkisë.

Figura 22. Shtimi i sipërfaqeve të ndërtuara 1990 – 2013.



	Nj. Adm Cakran	Nj. Adm Dermenas	Fier	Nj. Adm Frakull	Nj. Adm Levan	Nj. Adm Libofshë	Nj. Adm Mbrostar	Nj. Adm Portez	Nj. Adm Qëndër_ Fier (Çlirimi)	Nj. Adm Topoje
Sipërfaqe e ndërtuar 2008-2013	111434	66369	293416	104772	106420	66031	260409	174993	182807	48044
Sipërfaqe e ndërtuar '90-2007	3011154	1509329	2791802	1100377	1811669	1674422	2151778	2803559	2090413	1286101
Sipërfaqe e ndërtuar para '90	2611610	1946789	3474527	1546118	2071456	1896693	1178418	1864834	1516284	2142126

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Nga ana tjetër, lëvizjet e lira të popullsisë ndikuan në presionet për zhvillimin e territorit dhe mënyrën e transformimit të tij gjatë periudhës së tranzicionit. Si pasojë e këtyre lëvizjeve, në fund të vitit 1991, popullsia e qytetit të Fierit u dyfishua. Në dy vitet e para pas viteve ’90-të, popullsia u rrit me ritme shumë të shpejta, më pas fluksi i rritjes ra dhe në rast se nuk e marrim parasysh rritjen e dy viteve te para, mesatarja e rritjes vjetore në vitet 1991 – 2004 ka qene 2.32% në vit. Si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë por edhe mungesës së reformës së planifikimit, mungesës së kontrollit të zhvillimit, rikthimit të pronës private dhe lëvizjes së lirë të popullsisë, sot në bashkinë Fier ekzistojnë zona dhe zhvillime informale, me banesa individuale dhe me mungesë infrastrukture publike, të ndërtuara kryesisht gjatë viteve 1990-

2000, me hapësira të mëdha bujqësore dhe natyrore të ndërtuara, mungesë të hapësirave publike dhe një tërësi zonash dhe objektesh industriale të braktisura dhe pa funksion.

Këto dukuri erdhën edhe si pasojë e ndarjes së tokës bujqësore në bazë të Ligjit nr. 7501 "Për tokën bujqësore", pasi territori i Bashkisë Fier u parcelizua në prona individuale për çdo fermer.

Figura 23. Harta e shtrirjes së sipërfaqeve të ndërtuara



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Me rishpërndarjen e tokave, pronarët e morën të mirëqenë jo vetëm të drejtën e pronësisë së tokës, por edhe të drejtën e zhvillimit në të. Ndryshimet e përmendura më sipër evidentohen edhe në analizën e sipërfaqeve të ndërtuara që është kryer nga grupi i punës. Bazuar në këtë analizë, rezulton se pothuajse në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Fier janë dyfishuar sipërfaqet e ndërtuara. Shtimi më i madh i këtyre sipërfaqeve ka ndodhur nga vitet 1990 deri në 2007, ndërsa në vitet 2008-2013, sipërfaqet e ndërtuara kanë ardhur duke rënë.

Shtimi më i madh sipërfaqeve të ndërtimeve ka ndodhur në njësitë administrative Cakran, Mbrostar, Qendër dhe Fier,[31] njësi të cilat janë vendosur pranë infrastrukturave rrugore më të rëndësishme të bashkisë.

Ky presion zhvillimi i viteve të para të tranzicionit, i kombinuar me institucione publike qendrore dhe vendore të papërgatitura për t'iu përgjigjur me nivelin e duhur te planifikimit të territorit dhe infrastrukturat publike, rezultoi shpesh-herë kaotik, duke shkaktuar probleme si mjedisore, ashtu edhe efiçencë të investimeve publike dhe private, në mungesë të një vizioni më të integruar dhe strategjik të zhvillimit të territorit. Qëllimi i analizave të prezantuara në vijim është pikërisht evidentimi i disa prej këtyre problematikave, por edhe avantazheve konkurruese të Bashkisë Fier, mbi të cilat mund të kapitalizohen përpjekjet për zhvillimin e territorit, qoftë nga institucioni i Bashkisë, ashtu edhe nga palë private të interesuara për ta zhvilluar jetën dhe biznesin e tyre në këtë territor.

Pikat e forta në territor:

Ky seksion trajton elementet që kanë vlerë të spikatur territoriale, apo historike, duke gjeneruar kështu formë apo aktivitete rreth vetes. Këta elementë janë baza e zhvillimit të mëtejshëm të vendbanimeve. Ato mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/pengojnë zhvillimin, duke realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/qendror, por edhe sipërfaqësor, në formën e fashave të ndikimit. Elementët e tillë mund të jenë natyrorë, por edhe artificialisht të krijuar nga njeriu.

Në territorin e bashkisë Fier, **elementet e forta natyrore** janë të shumtë dhe lidhen me gjendjen topografike dhe pasuritë e shumta ujore. Ndër to mund të përmendim:

- Dunat e Semanit, të cilat gjenden në pjesën perëndimore të territorit të Bashkisë dhe janë pjesë e zonës bregdetare të Adriatikut. Ato përbëjnë një potencial të rëndësishëm natyror për zhvillimin e turzimit dhe mbrojtjen e plazhit në këtë zonë;
- Pishat e zeza në bregdetin e Poros janë masivi i drurëve të cilët përbëjnë atë quhet Pylli i Pishë-Poros dhe përbën një element të rëndësishëm natyror i cili kufizon shtrijen e ndërtimeve në këtë zonë por edhe orienton për zhvillim e turizmit bregdetar. Ndikimi i këtij elementi është sipërfaqësor dhe ndikon në mënyrë të përgjithshme të gjithë territorin e bashkisë;
- Kurora e lumit të vjetër të Semanit (Libofshë Adriatik) është një element natyror i fortë i pajisur me drurë të lartë pranë fshatit Adriatik dhe pranë Lumit të Semanit. Kjo shihet si një pikë qendrore natyrore në mes të fushave bujqësore;
- Rrapet e rrugës Fier-Vlorë dhe rrapi i pazarit të Cakranit (Çaireve) janë elementë natyrorë të cilët përbëjnë potencial për krijimin e hapësirave publike pranë tyre si dhe orjentojnë krijimin e qendrave të vendbanimeve. Këto hapësira mund të kthehen në pika kyçe të itenerareve natyrore të cilat do të propozohen në territoret e bashkisë Fier;
- Parku i Levanit është një element kyç natyror i bashkisë Fier i cili ka një potencial të jashtëzakonshëm peisazhistik. Ai shërben si element qëndror për gjithë territorin e Bashkisë pasi ndodhet shumë pranë rrugëve kryesore ekzistuese dhe pranë vendbanimeve kryesore.

Elementët artificialë janë po aq të rëndësishëm në mënyrën e ndikimit në territor ashtu si elementët natyrorë. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e

identitetit kulturor dhe historik të zonës. Këto elemente janë të rëndësishme për potencialin që ato mbartin për sa i përket zhvillimit social–ekonomik të bashkisë Fier. Ndër to përmendim:

- **Elementet e forta artificiale**

Në territorin e Bashkisë Fier shtrihen një numër i madh objektesh të shpallura monumente, si: Kisha e Shën Kollit, Vanaj, Kisha e Shën Gjergjit, Libofshë, Kisha e Shën Kozmait, Kisha e Shën Premtes, Hoxharë, Vila Romake, Plyk - Manastiri i Shën Mërisë, Pojan - Qyteti antik Apolonia, Pojan - Tempulli antik, Shtyllas. Këto kisha janë elemente kryesorë territorialë për shkak të impaktit që kanë në zhvillimin territorial, ekonomik dhe social të territorit ku shtrihen. Këto objekte kulturore përbëjnë një potencial të madh historik, kulturor për zonën. Ato priren të orientojnë zhvillimin e territorit ku pranë të cilave mund të përcaktohen qendrat urbane, qendrat e vendbanimeve, hapësirat publike, atraksionet turistike si pjesë e programeve turistike etj.

Figura 24. Elementet e forta në territor, nivel qyteti



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Zona industriale

Uzina e Plehrave Azotike është një element i rëndësishëm territorial artificial i cili lidhet ngushtësisht me identitetin e qytetit të Fierit. Impakti më i madh është ai në aspektin mjedisor si dhe në aspektin social – ekonomik. Zona industriale e Azotikut zë një hapësirë të konsiderueshme, rreth 50 Ha, dhe për momentin shërben si vend-depozitim i mbetjeve të asbestit, pa funksione të tjera mbështetëse të veprimtarisë industriale. Rijetëzimi i këtij

brownfield-i dhe rehabilitimi tërësor i tij është një ndër prioritetet që merr parasysh ky document në zhvillimet strategjike të ardhshme.

Zona Naftënxjerrëse e Mbrostarit është nje element tjetër formë-gjenrues, i cili përbën dhe potencial edhe kufizim për territorin e Bashkisë Fier. Ajo e kufizon territorin në aspektin e përdorimit bujqësor e implikimeve mjedisore, orienton zhvillimin e vendbanimeve dhe bujqësisë në zona të tjera dhe kthehet në qendër të zhvillimit të industrisë.

Figura 25. Elementet e forta në territor



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Institucione Shëndetësore**

Spitali Rajonal i Fierit ka një impakt të gjërë në jetën e komunitetit në bashkinë e Fierit si një element i fortë fizik i cili ndikon në plotësimin e shërbimeve publike bazë. Përveç tij, spitali i ri rajonal i Fierit, i cili pritet të ndërtohet në Pyllin e Levanit, do ketë mbulim për gjithë Rajonin e Shqipërisë së Jugut, duke përbërë një ndër investimet më të mëdha të karakterit social në bashki.

- **TAP**

Projekti për Gazsjellësin Trans-Adriatik kalon nëpër Bashkinë Fier në zonën veriore të saj, në njësitë administrative Topojë, Libofshë, Qendër dhe Mbrostar. Ky projekt është miratuar dhe kushtëzon të gjitha autoritet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Projekti i TAP dhe gjurma e tij (përfshirë këtu edhe fashën e linjës prej 500 m, e cila është shpallur Zonë e Rëndësisë Kombëtare) ka një ndikim në territorin fizik të bashkisë, pasi në zonën ku kalon gjurma e gazsjellësit do të ketë kushtëzime përsa i përket zhvillimit të territorit. Fasha do të shërbejë si zonë buferike dhe nuk do të lejohen ndërtimet në tre brezat e parë të saj (8, 20 dhe 100 metra në secilën anë).

1.4 Analiza e mjedisit dhe e problemeve mjedisore

1.4.1 Metabolizmi i territorit

Analiza e metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM-së nr. 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuara janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe manaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve) sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore manaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- **Energjia në Rajon**

Rajoni që përbëhet nga bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnjë, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd dhe Pogradec [32] ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: Bankers (Patos-Marinëz), TransAtlantic (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), Sherwood (Kuçovë), Transoilgroup (Visokë); Phoenix (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Po ashtu, energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore të energjisë.

Lumenjtë si Shkumbini, Osumi dhe Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë por edhe për bizneset, industritë apo institucionet, siç mund të shihet edhe më poshtë në Figurën 8. "Fluksi i energjisë në rajon".

Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak, por janë të mëdha potencialet që kjo zone ka për të përdorur këto energji. Energjia e erës ka potencial të përdoret në Ultësirën Perëndimore, ku shpejtësia mesatare arrin vlerat 2.1-3.5m/s[33]. Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veri-perëndimore) mund të përdoren për prodhimin e energjisë.

Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Rrezatimi arrin vlera nga 1450 Kwh/m² deri në 1650 Kwh/m².[34] Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore.

Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime gjeotermale, temperatura e të cilave arrin >80 °C. Gjithashtu, në Fier puset gjeotermale mund të përdoren për prodhimin e energjisë.

Figura 26. Fluksi i energjisë në rajon.



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015[35]

- **Uji në Rajon**

Rajoni është i pasur më ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si: Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë. Në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë uji, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje dhe përcjellshmëri uji shumë të ndryshueshme shumë të lartë e të lartë, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore janë të cënuara nga ndotja. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

Figura 27. Fluksi i ujit (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) në rajon.



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN[36]

- **Analiza e metabolizmit në Bashkinë Fier**

Analiza e metabolizmit të territorit e Bashkisë të Fierit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Fieri ka në sipërfaqe[37] prej 620 km² dhe popullsi 122,475 banorë[38]. Flukset e analizuara në kuadër të analizës së metabolizmit janë energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim për të kuptuar problemet mjedisore dhe të humbjeve.

- **Fluksi i energjisë**

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Fier. Ky fluks tregon, gjithashtu, për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie, të cilat kanë konsum më të lartë dhe janë të mbishfrytëzuara.

a) Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e bashkisë Fier

Territori i Fierit shtrihet në një zonë me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore të shumta dhe brenda tij. Në kufi me Selenicën në Vjosë është planifikuar vetëm një hidrocentral me fuqi mbi 50MW[39].

Territori i Fierit është pjesë e zonës gjeotermale Ardenicë, e cila shtrihet në rajonin e Myzeqesë, në lindje, veri dhe perëndim të qytetit të Fierit. Në territorin e bashkisë Fier janë katër burime gjeotermale që duhen konsideruar për prodhimin e energjisë gjeotermale. Temperatura e këtyre puseve arrin nga 20°C deri në 60°C. Në thellësi temperatura vjen duke u rritur gradualisht, derisa arrin 105.8°C në thellësinë 6,000m. Këto burime gjeotermale në territorin e bashkisë mund të shfrytëzohen për prodhimin e energjisë. Në këtë mënyrë, ulet niveli i përdorimit të energjive të tjera. Puset dhe burimet gjeotermale që ndodhen në territorin e Fierit janë: burimi Ardenica 3 me temperaturë që arrin në 45.8°C në thellësinë 1,940 m dhe debiti 15-18 l/sekondë; burimi Ardenica 12 me temperaturë 32°C; pusi Semani 1 me temperaturë 35°C; dhe burimi Semani 3 me temperaturë 67°C (Frashëri, Çermak et al., 2004)[40].

Një tjetër burim alternativ energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Fierit është energjia diellore. Fieri ndodhet ndërmjet izolinjave 1,650-1,800 kW/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të Fierit luhatet nga 1,705 në muaj (dhjetor) në 7,210 në muaji korrik[41]. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimi e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike[42].

b) Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT-it, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Fier[43] dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Tabela 1. Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	2,821,977
Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare (NjEF)	722,600

Burimi: INSTAT, 2011 (Census)

Për vitin 2011, sipas INSTAT-it, numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri total i familjeve në Shqipëri, duke iu referuar tabelës së mëposhtme është **722,600 familje.** Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: Konsumi i

energjisë elektrike nga familjet **(2,587,535)**/nr. e familjeve **(722,600) =** Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit **(3.6 MWh).** Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë numrin e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

Tabela 2. Bilanci i energjisë elektrike, 2011

Emërtimi	**Energjia (MWh)**
Energji në dispozicion (Burimet)	**7,532,055**
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Konsumi i energjisë elektrike	**7,210,731**
Humbjet në rrjet	2,179,157
Familjet	**2,587,907**
Të tjera	2,443,667

Burimi: INSTAT, 2011 (Census)

Figura 28. Konsumi i energjisë elektrike, Bashkia Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN,2015

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT-it, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në qarkun Fier, nga NjEF[44], vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 51.87% të NjEF-ve në bashkinë Fier përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (23.44%) dhe më pas nga energjia elektrike (12.71%)[45]

Tabela 3. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale

Fier: Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	82,074	35,149	46,925
Dru	42,574	6,537	36,037
Energji elektrike nga rrjeti	10,434	8,653	1,781
Gaz	19,242	14,289	4,953
Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, naftë etj.)	365	221	144
Pa ngrohje	9,459	5,449	4,010

Burimi: INSTAT, Census 2011

Figura 29. Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale.



Burimi: INSTAT, Census 2011

- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e bashkisë Fier dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim*[46](uji i mbushur në shishe), shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdorim nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e

Bashkisë Fier) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor[47].

Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 18.3 km² në të gjithë territorin e bashkisë Fier[48]. Në ujërat sipërfaqësore të Fierit bëjnë pjesë lumenjtë Seman, Gjanica dhe Vjosë, përrenjtë dhe degëzimet e tyre si dhe të gjitha kanalet ujitëse.

Figura 30. Harta e konsumit të ujit të pijshëm në territorin e Fierit



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Sa i përket përdorimit të ujërave nëntokësore, ato furnizojnë akuiferet me porozitet çarje-karst dhe përcjellshmëri uji të ndryshueshme shumë të lartë - të lartë në deltën e Vjosës dhe përcjellshmëri mesatare uji përgjatë Semanit në veri të qytetit të Fierit deri në Dermenas. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 8.28 l/sekondë (harta hidrografike, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - SHGJSH)[49]. Këto ujëra nëntokësore përdoren për konsumim, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në Bashkinë Fier, rezulton që i gjithë territori i bashkisë ka mbulim jo shumë të mirë me shërbimin e ujësjellës – kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm Ujësjellës-Kanalizime Fier[50], furnizohet me ujë nga ujëmbledhësi Kafaraj, i cili shfrytëzon nëntë puse,

ndër të cilët tre janë të reja dhe gjashtë të vjetra. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet nga ujëmbledhësi Kafaraj është 700 l/sek.

Ujësjellësi Patos ka për qëllim ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Patosit dhe gjatë rrugës furnizon me ujë edhe njësinë administrative Cakran (Varibob, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos) dhe Portëz. Ky ujësjellës furnizohet nga tre pus-shpime në fshatin Varibob. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga këto puse është 60 l/sekondë. Njësia administrative Libofshë e merr shërbimin nga Ndërmarrja Ujësjellës Lushnjë Fshat.

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat e UK-së Fier dhe në të dhënat e INSTAT-it, Census 2011 (Grid) për popullsinë, numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Fier. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë. Sasia totale e ujit të prodhuar nga ndërmarrjet e ujësjellësit në Bashkinë Fier është 3,484.8 m³/orë ndërkohë që kërkesa për ujë është 1517.3 m³/orë[51].

- **Fluksi i ushqimit**

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Fier analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport. Sipas Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë (DRB-së) në Fier, në territorin e Fierit prodhohet një sasi e konsiderueshme produktesh bujqësore dhe blegtorale[52].

Tabela 4. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Bashkinë Fier

Përbërës Niveli I		**Përbërës Niveli II**	**Prodhim**
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	39,556
		Perime (ton)	45,541
		Patate (ton)	4,155
		Fasule (ton)	3,750
		Bimë industriale (ton)	
		Foragjere (ton)	505,743
	Prodhime në sera	Perime (ton)	2,480
	Dru frutorë	Pemë frutore (ton)	7,090
		Ullinj (ton)	5,141
		Agrume (ton)	2,363
		Rrush gjithsej(ton)	12,188
Prodhimi Blegtoral	Prodhim Blegtoral	Qumësht (ton)	62,620
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël)	8896

		(ton)	
		Lesh (ton)	141
		Vezë (ton)	20,478,840
		Mjaltë (ton)	137

Burimi: DRB Fier 2015; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e Bashkisë Fier është 435,8 km^2, ku 358.5 km^2 është tokë bujqësore e kultivuar me lloje të ndryshme kulturash bujqësore. Toka shumë e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e ka bërë Fierin mjaft të rëndësishëm në nivel kombëtar për nivelin e lartë të prodhimeve bujqësore.

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat e INSTAT-it (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Siç mund të kuptojmë nga fluksi hyrjet (prodhimet) janë më të larta se daljet (treg dhe eksport). Kjo ndodh, sepse një pjesë e këtyre produkteve shkojnë për konsum vetjak, një sasi e caktuar është humbje dhe një pjesë tjetër shkon për shitje në mënyrë informale.

Tabela 5. Prodhimet dhe konsumi (treg dhe eksport) për qarkun e Fierit

Përbërës Niveli I		**Përbërës Niveli II**	**Prodhim**	**POTENCIALET PRODHUESE**	
				Treg	**Eksport**
Prodhim Bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	155,153		
		Perime	296,417	93,353	33,780
		Patate (ton)	35,044		
		Fasule (ton)	8,472		
		Bimë industriale	1,974		
		Foragjere (ton)	1,710,079		
	Prodhime në sera	Perime (ton)	38,552	33,902	10,390
	Dru frutorë	Pemë frutore	24,341	15,890	1,400
		Ullinj (ton)	27,436	19,853	-
		Agrume (ton)	4,586	1,045	-
		Rrush gjithsej (ton)	44,973	30,700	13,530
Prodhimi Blegtoral	Prodhim Blegtoral	Qumësht (ton)	217,163	300,432	-
		Mish (gjedhi, derri, shpendësh, ruminantësh të vegjël) (ton)	25,900	45,745	-
		Lesh (ton)	413		
		Vezë (ton)	91,041,000	-	-
		Mjaltë (ton)	255	436	-

Burimi: INSTAT 2014, përpunoi Bashkia Fier dhe Co-PLAN

Figura 31. Fluksi i ushqimit për produktet blegtorale (në kton), Bashkia Fier, 2014 dhe krahasuar me bashkitë e tjera të rajonit



Burimi: INSTAT 2014, përpunoi Bashkia Fier dhe Co-PLAN

Figura 32. Fluksi i ushqimit për produktet bujqësore(kton), Bashkia Fier 2014 dhe krahasuar me bashkitë e tjera të rajonit



Burimi: INSTAT 2014; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 33. Fluksi i ushqimit (kton), Qarku i Fierit (2012-2014)



Burimi: INSTAT 2014; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 34. Fluksi i ushqimit (kton), krahasimi me qarqe të tjera



Burimi: INSTAT 2014; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 35. Fluksi i ushqimit (kton) Qarku Fier, 2014.



Burimi: INSTAT 2014; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 36. Fluksi i ushqimit në Bashkinë Fier



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

- **Fluksi i mbetjeve**

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Në territorin e Fierit shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ofrohet në nivelin 80-100%. Vend-depozitimi i mbetjeve në Fier nuk është inxhinierik-sanitar dhe ndodhet në Sheq të Madh, 4 km nga qendra e qytetit. Vendndodhja e vend-depozitimit të Fierit është e papërshtatshme, shumë pranë shtratit të Lumit Gjanica dhe vendbanimeve. Sipërfaqja e këtij vend-depozitimi është 6.2 ha. Diferencimi i mbetjeve në burim nuk kryhet dhe rezulton në mungesë të riciklimit apo përpunimit të mbetjeve[53]. Tregues i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për t'u ricikluar nga kompanitë ricikluese të vendosura në Shqipëri. Në vitin 2013 në Shqipëri janë importuar 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të riciklueshme[54].

Në territorin e bashkisë së Fierit operojnë katër kompani ricikluese, dy prej të cilave riciklojnë mbetje urbane. Njëra (ABA 2011 Sh. p. k.) është e vendosur në Sheq të Madh, pranë shtratit të Lumit Gjanica dhe tjetra (RECOLIGHT Sh. p. k.) në afërsi të fshatit Portëz, sërish pranë shtratit të Lumit Gjanica[55]. Kompania për riciklimin e metaleve (PIU - ECO Sh.p.k.) vendoset në afërsi të bashkimit të Lumit Seman me Lumin Gjanicë, shumë pranë shtratit të Lumit Seman, ndërsa kompania për riciklimin e vajrave dhe produkteve të tij (TOT

- TRADING IN OIL & TRANSPORT) ndodhet në qytetin e Fierit, në afërsi të zonës industriale[56].

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Fier (territori pas reformës), jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT-it për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg[57]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i

Fierit. Sasia e gjeneruar në qytetin e Fierit, në zonën urbane, arrin vlera 1,392-3,381 ton/vit për km² [58].

Figura 37. Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN-i, 2015

Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë, për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend-depozitimi (jo-sanitar) i vendosur gjatë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ulin nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat nëntokësorë.

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e Bashkisë Fier është përafërsisht 83.3%, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 46%, 15% plastika dhe 15% letra[59]. Procesi

i riciklimit është i ndërlikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj që të realizohet ky proces.

- ***Përfundime***

Fluksi i ushqimit tregon se Fieri është i specializuar më tepër në perime e drithëra (sigurisht dhe foragjere) sesa frutorë. Kjo lidhet me cilësinë e lartë të tokës (boniteti që përgjithësisht është 4 ose më pak) dhe të territorit fushor.

Sa i përket energjisë, Fieri ka potencial të lartë për përdorim të burimeve alternative, si energjia gjeotermale, dielli dhe era në zonën bregdetare. Mirëpo, edhe nga shifrat e nivelit kombëtar, kuptohet se prodhimi i energjisë vazhdon te jetë i fokusuar tek burimet ujore. Fakti që eksporti përbën vetëm 8.6% të asaj që importojmë, veç humbjeve në rrjet, tregon edhe që potenciali i burimeve alternative nuk përdoret. Po ashtu, përdorimi nga familjaret është thuajse i njëjtë, madje më i lartë sesa konsumatorët e tjerë së bashku. Pavarësisht humbjeve në rrjet kjo përqindje e lartë konsumi nga familjarët tregon se burimet alternative duhet të synojnë jo vetëm sektorët e tjerë të ekonomisë, si bujqësia etj., por edhe konsumatorët familjarë.

1.4.2 Mjedisi

A. Kushtet gjeomorfologjike të territorit

Territori i Bashkisë së Re të Fierit[60] shtrihet në zonën qendrore-perëndimore të përfshirë në konturin jugor të krahinës me dalje në detin Adriatik. Territori i Bashkisë Fier shtrihet mbi depozitimet kuaternare, ndërsa pjesa juglindore nga depozitimet e Pliocenit dhe shtrihet kryesisht në qendrën midis dy njësive strukturore, asaj lindore Kreshpan-Ardenicë-Divjakë dhe perëndimore periklinali verior i strukturës së Frakullës.

Për sa i përket relievit, territori[61] i Bashkisë së re të Fierit ka një reliev kryesisht fushor dhe kodrinor. Pjesa fushore ndahet në dy nënzona që janë i) nën-njësia fushore bregdetare dhe ii) nën-njësia fushore paramalore**.** ***Nën-njësia fushore*** bregdetare shtrihet përgjatë detit Adriatik dhe dallohet për pjerrësi dhe lartësi në nivelin e detit. Në disa zona si në Divjakë, lartësia shkon deri nën nivelin e detit. Kjo zonë dallohet për deltat e lumit Osum dhe grykëderdhjen e kanalit të Ngjalës e shumë kanaleve të tjera ujitëse. Në zonën afër bregdetit gjenden dunat ranor, marshet (toka pothuajse të përmbytura nga deti Adriatik që gjenden më shumë në Lagunën e Karavastasë) dhe vatet. Këto të fundit janë ato pjesë të bregdetit që janë nën ndikimin e baticave dhe zbaticave.

Në ***nën-njësinë bregdetare*** gjendet një pjesë e mirë e Fushës së Myzeqesë së Madhe, Fushës së Myzeqes së Vogël (fusha e Frakullës, Roskovecit, Bubullimës, Fierit, Pojanit dhe Hoxharës) të cilat përshkohen nga një sistem i dendur kanalizimesh dhe përdoren për kultivim të kulturave bujqësore. Lartësia mbi nivelin e detit e këtyre fushave shkon nga 0 në 5km mbi nivelin e detit. ***Nën-njësia fushore paramalore*** përfshin territorin e shfrytëzuar për zhvillimin e qyteteve Fier e Lushnjë (dhe Ballsh). Kjo nën-njësi përfshin nga territore të sheshta deri tek kodrat me lartësi deri në 700m.

Figura 38. Relievi në Bashkinë Fier



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Njësia morfologjike kodrinore zhvillohet në zonën qendrore, lindore dhe juglindore të territorit të qarkut. Menjëherë sapo përfundon njësia fushore shfaqen format e kodrave (kodrat e Divjakë-Ardenicës, Karbunarës, Frakullës e Mallakastrës) të cilat kanë kuota nga 10 m.n.d. deri në 700 m.n.d. Shpatet e kodrave e kodrinave të kësaj njësie morfologjike kanë pjerrësi nga 5 deri në 350 dhe drejtime rënie të ndryshueshme. Shpatet shpesh janë të rrumbullakosura nga modelimi i shkaktuar nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore. Në vitet ’70 deri ’80 të shekullit të kaluar, ky sistem kodrash iu nënshtrua procesit të tarracimit, proces i cili i ka hequr pamjen natyrale të tyre. Në të shumtën e rasteve këto kodra janë të mbjella me pemë frutore, por nuk përjashtohen rastet edhe kur ato përmbajne pyjet natyrale. Është pikërisht kjo njësi morfologjike e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenomene shpati të tipit rrëshqitje të dherave dhe të shkëmbinjve.

- **Zonimi Gjeoteknik i Shqipërisë**

Relievi i larmishëm i vendit tonë me njësi fushore, kodrinore dhe malore krijon një peizazh natyror tërheqës dhe njëkohësisht, edhe të prirur ndaj rreziqeve natyrore për vetë përbërjen e tij. Si rezultat, në varësi të relievit, territori në vend dallohet për nivele të ndryshme qëndrueshmërie. Përveç një sipërfaqeje që zë rreth 10% të territorit kombëtar që është e

qëndrueshme, pjesa tjetër e tokës është e paqëndrueshme. Kjo e fundit shprehet nëpërmjet formave të ndryshme që SHGJSH-ja i klasifikuar si më poshtë[62]:

1. *Rënie shkëmbinjsh* (kryesisht në zona malore (në Alpeve) dhe shpate gëlqerore të zbuluara.
2. *Shembje* (kryesisht në zonat malore).
3. *Rrëshqitje me rrokullisje* (në shpate me shkëmbinj rreshporë ose molasës deltinore dhe shpate prej konglomerati me pjerrësi > 45˚ dhe shpate me drejtim të kundërt).
4. *Rrëshqitje me zhvendosje* (prek shkëmbinjtë e fortë gëlqeroë ose shtresa rreshpore).
5. *Rrjedhje, sidomos ato sipërfaqësore, në trajtën e laharëve* (në zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore 200mm, luginat me përrenj me pjerrësi të madhe (Elbasan, Përmet, Korcë etj.).

Duke u bazuar në karakteristikat e territorit lidhur me fenomenet e rrezikut gjeomorfologjik, SHGJSH-ja ka përcaktuar zonimin gjeoteknik të Shqipërisë, sipas të cilit territori i vendit tonë ndahet në tre zona të qëndrueshmërisë natyrore[63]:

- *Terrene të qëndrueshme* që mbulojnë 56.6% të vendit. Gjenden kryesisht në zona me shkëmbinj magmatikë efuzivë dhe intruzivë, gëlqerorë të epokave të ndryshme, dolomite, brecke dhe konglomerate me cimentin karbonatik, shkëmbinj metamorfikë dhe rreshpe. Brenda zonës njihen fenomenet e shkëputjes së blloqeve, rrëshqitjes e rrokullisjes dhe/ose zhvendosjes.
- *Terrene relativisht të qëndrueshme*, që mbulojnë rreth 33.6% të territorit. Gjenden kryesisht në zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë të suitës Luma, efuzivë sedimentarë, zona me shkëmbinj rreshporë, shkëmbinj evaporitë dhe molasa të konglomerateve ranore. Këto zona dallohen për rrëshqitje, ose rënie të tavaneve në zgavrat e nëndheshme.
- *Terrene të paqëndrueshme* që zënë rrreth 9.8% të sipërfaqes së vendit. Këto janë terrene me përbërje të ndryshme shistesh, molasash e konglomeratësh ranore. Dallohen për rrëshqitjet rrokullisëse dhe me zhvendosje, si dhe për rrjedhjet e tokës.

Figura 39. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë



Burimi : Shërbimi Gjeologjik Shqiptar[64]

Nga leximi i hartës së zonimit gjeoteknik të Shqipërisë, në Bashkinë Fier, në terren mbizotërojnë kryesisht tokat e lidhura (me ngjyrë blu) relativisht të qëndrueshme në zonën Cakran dhe në pjesën lindore të NjA-së Mbrostar.

Rrëshqitja/Rrëzimi i gurëve

Rrëshqitjet e dheut janë një fenomen i kufizuar në zona të caktuara në Qarkun dhe Bashkinë Fier.

Në përgjithësi, ky fenomen është më tepër i përhapur në formacionet argjilore dhe me pjerrësi të dukshme. Përveç zonave me pjerrësi të lartë, fenomeni i rrëshqitjes është përhapur edhe në zonat me shpate që preken pak nga dielli si dhe në fund të shpateve, nëpër të cilat kalojnë lumenj, ose përrenj të ndryshëm duke i gërryer ato.

Për sa i përket vendndodhjes, rrëshqitjet janë përqendruar kryesisht në zonën veri dhe jug-lindore të Bashkisë, në NjA-të Libofshë, Mbrostar dhe Portëz.

Shkaqet kryesore të rrëshqitjeve [65] përfshijnë faktorë natyrorë gjeologjikë (ndërtimin gjeologji-klitologji, pjerrësinë e shpatit mbi 5-20°, strukturën, tektonikën, zonat ose shpatet që nuk rrihen nga dielli ku lagështira e vazhdueshme ka shkaktuar rrëshqitje etj.) dhe faktorë të jashtëm (përmbajtjen e lartë të ujërave nëntokësore, reshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme etj.). Kohët e fundit, rrëshqitjet janë theksuar për shkak të shpyllëzimeve të shumta. Shpeshherë, tokat pyjore janë shndërruar në bujqësore duke prishur kështu ekuilibrin natyror.

Figura 40. Rrëshqitjet në Bashkinë Fier



Burimi: SHGJSH, 2014, Punoi: Co-PLAN 2016

Erozioni/Vatrat e Erozionit

Erozioni mbetet një ndër problematikat kryesore pothuajse në të gjithë botën dhe, sigurisht, edhe në vendin tonë. Vetëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX është llogaritur se degradimi i tokës për shkak të erozionit ka përfshirë rreth 43% (ose 5 miliardë ha) të territorit në shkallë botërore[66]. Ndër shkaqet kryesore të këtij degradimi janë përdorimi i tokës nga njeriu për qëllime të ndryshme. Më konkretisht, faktorët që ndikojnë ndjeshën në rritjen e erozionit janë kryesisht i) reshjet (dhe sidomos shirat e rrëmbyeshme), intensiteti dhe shpërndarja e tyre luajnë një rol të rëndësishëm, ii) përbërja e tokës/shkëmbinjve (kapaciteti i infiltrimit dhe niveli i stabilitetit të strukturës së tokës), iii) pjerrësia (gjatësia dhe niveli i pjerrësisë), si dhe iv) bimësia ose shtresat bimore që mbulojnë tokën.

Edhe në Fier, erozioni është fenomen i pranishëm në territor. Sipas SHGJSH-së[67], ky fenomen është i përhapur si në zonën fushore (erozioni tokësor) ashtu dhe në zonën bregdetare (erozioni detar). Zona të tëra, kryesisht të përbërjes litologjike argjilore e flishore, janë të prekura nga erozioni tokësor i cili, nga ana e tij, është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve ’80-‘90 të shekullit të kaluar, si dhe gjatë këtyre viteve të fundit. Ky erozion shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor. <u>*Erozioni sipërfaqësor*</u> prek kryesisht zonat kodrinore, aty ku kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike flishore (*rripi i ngushtë i Kodrave të Cakranit deri në Mollaj)*[68] *e argjilore (pothuajse në të gjitha fushat e bashkisë*). Erozioni fundor shfaqet në brigjet e lumenjve. Dallohen erozioni *në Lumin Vjosa* në [69] sektorë të caktuar si *Frakull, Trevëllazen, Mifol, Varibob e Bishan*. Erozioni dallohet edhe përgjatë *gjithë brigjeve të lumit Seman*, ku pothuajse mungon tërësisht brezi bimor mbrojtës gjatë gjithë shtrirjes së tij në territorin e Bashkisë.

Figura 41. Erozioni në Bashkinë Fier



Burimi: SHGJSH 2014, Punoi: Co-PLAN

Është e rëndësishme të theksohet se shpyllëzimet e vazhdueshme dhe pa kriter gjatë viteve të fundit në territorin e Bashkisë (nga vitet 1980 e deri më sot) si dhe mungesa e praktikave të mira bujqësore për manaxhimin e tokës kanë luajtur një rol parësor në shtimin e fenomenit të erozionit në territor.

Në zonat pyjore ose kullosore, erozioni ka ardhur si pasojë e keqmanaxhimit, mbishfrytëzimit të tyre, shpyllëzimeve ose dëmtimit të bimësisë së ulët (nën-pyllit). Është e rëndësishme të theksojmë se sekreti i pyjeve në mbrojtjen e tokës nga erozioni qëndron pikërisht në lënien e sipërfaqes së tokës dhe të mbulesës së saj bimore të paprekur. Kjo bën të mundur që bimësia, jo vetëm pyjet, të zhvillohet dhe të krijojë një mbulesë të të gjithë sipërfaqes. Ndryshe nga sa mendohet, nuk mjaftojnë vetëm drurët e lartë (pyjet) me rrënjët e tyre të thella që të mbrojnë pyjet nga erozioni. Është *tabani i tokës* (sipërfaqja) që mbron tokën nga erozioni. Në qoftë se sipërfaqja e tokës është e zbuluar, pikat e shiut që bien nga gjethet e pemëve të larta ushtrojnë presion të lartë mbi dherat e tokës duke e gërryer atë. Mbulesa e tokës me një shtresë bimore shërben si masë efikase për mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye, bimësia e ulët nëpër pyje ka një ndikim të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Përveç shpyllëzimit e dëmtimit të bimësisë në pyje, shkak tjetër kryesor i erozionit është edhe hapja ose ndërtimi i rrugëve të reja, zhvillimi i veprimtarive të ndryshme për shfrytëzimin e drurit (prerje, grumbullim, transporti me makina, shitje etj.) si dhe hapja e shtigjeve të ndryshme për aktivitetet rekreative të cilat nuk kanë munguar në vitet e fundit së bashku me rrugët për shfrytëzimin e minierave (guroreve). Hapja e rrugëve të reja në zona kodrinore pa marrë masat e duhura mund të shkaktojë humbjen e 100Mg/ha dhera të shkaktuara nga erozioni.[70]

Për sa i përket erozionit në tokat bujqësore të vendit tone, rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë ndërsa në Qarkun e Fierit konsiderohet i lartë.[71]

Tabela 6. Vlerësim teorik i nivelit të erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

		Indeksi i erodibilitetit (gërryëshmërisë)				Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
Rrethet	Sip (Ha)	Absol.	Rel.	Indeksi i erozionit të tokës	Indeksi i pjerrësisë	Absol.	Rel.	Vlerësimi
Lushnjë	46,136	5.7	2	2	1.60	6.4	2	Mesatar
Fier	60,674	6.7	3	3	1.68	15.1	3	I lartë

Burimi: AKM 2013

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor, sidomos në rripin e ngushtë të kodrave të Cakranit deri në Mollaje që i përkasin NjA-ve Cakran, Levan, Dërmenas dhe në një pjesë të kufizuar të qytetit të Fierit. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu erozion të tokës nëse nuk përdoren praktika të mira bujqësore gjatë përdorimit të tyre për bujqësi.

Erozioni në toka bujqësore, përveç shkaqeve natyrore, ka ardhur edhe si rrjedhojë e keqmanaxhimit të tokës. Gjatë gjithë territorit të vendit dhe brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra me tokë të punuar thellë dhe të zhveshur tërësisht nga bimësia. Në tokat bujqësore veçanërisht, në vendin tonë, bujqit ose fermerët gjatë punimit ende vazhdojnë ta zhveshin tokën tërësisht nga të gjitha mbetjet bimore të të mbjellave të stinëve të mëparshme pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës. Ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika kultivimi

të konsoliduara për shmangien ose zbutjen e erozionit (punimin e tokës duke e trazuar sa më pak atë, ruajtjen e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimin e mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjellja e foragjereve ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet etj.) në vendin tonë mbetemi ende mbrapa.

Për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e erozionit në territorin e Bashkisë, mjafton të analizojmë vëllimin e rezervuarëve dhe digave në territorin e saj. Nga një analizë e hollësishme e 12 rezervuarëve të pranishëm në Bashki, është vënë re se pothuajse të gjithë rezervuarët kanë pësuar zvogëlim të volumit të tyre për shkak të erozionit. Më problematike mbetet diga e Levanit, zvogëlimi i kapacitetit të së cilës arrin deri në 51% e ndjekur nga rezervuari në Lalar me 35% dhe Zharrëz e Visokë me 30%.

Figura 42. Vëllimi i rezervuarëve/digave mbushur me erozion (%)



Burimi: MBZHRAU, Punoi: Co-PLAN

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit të territorit bujqësor, pyjor e kullosor, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i territorit në disa zona. Nuk ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave bujqësore kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[72].

B. Burimet ujore sipërfaqësore, nëntokësore, bregdeti dhe përmbytjet në Bashkinë Fier

- **Burimet ujore sipërfaqësore**

Bashkia e Fierit ka një rrjet të pasur hidrik. Territori i saj përshkohet nga rrjedha e poshtme e lumenjve Seman, Vjosë dhe Gjanica që derdhet në Seman. Vjosa e Semani dallohen për burime të bollshme ujore gjatë stinës së dimrit. Semani përshkon Bashkinë e Fierit në drejtim veri-perëndim dhe jug-lindje me gjatësi prej 40.3km. Gjatë gjithë territorit të bashkisë, Lumi Seman krijon dredha të shumta, duke marrë formën e një koni me kufij të gjarpëruar. Pika më jugore e konit është afër qytetit të Fierit në Mbrostar ku edhe bashkohet me Gjanicën. Semani derdhet në Detin Adriatik, ku ka krijuar një deltë të gjerë. Në të dyja anët e lumit janë krijuar pellgje të vogla ujore ndër të cilat dallohet kryesisht Pellgu Lugaj (osa Liqeni i Petritit). Vjosa përshkon Bashkinë e Fierit duke krijuar dredha të shumta deri në grykëderdhje në një gjatësi prej 24.5km. Lumi Vjosa shërben edhe si kufi administrativ ndërmjet bashkive të Fierit, Vlorës dhe Selenicës. Përveç lumenjve, bashkia dallohet për një rrjet kanalesh ujitëse-kulluese mjaft të rëndësishme për bujqësinë që kultivohet në zonën e Myzeqesë gjatë gjithë vitit. Ndër këto kanale mund të përmendim Kanalin e Myzeqesë me degëzimet e tij në të dyja

anët në fushën e Sheqit dhe me dalje të drejtpërdrejtë në detin Adriatik, Kanalin e Dhënve (Kanalin Ujitja) që e përshkon bashkinë pothuajse paralelisht me lumin Seman deri në Mbrostar me grykëderdhje të drejtpërdrejtë në plazhin e Semanit, si dhe Darëzeza e Re, në të cilin derdhen një sërë kanalesh ujitës dhe kullues.

Figura 43. Burimet ujore në Bashkinë Fier

Burimi: SHGJSH, përpunoi Co-PLAN dhe Bashkia Fier

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të Bashkisë dhe të qyteteve përreth.

Problematikat e burimeve ujore sipërfaqësore

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve siç janë gërryerja e shtratit, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrështitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së tyre.[73] Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmanaxhimi të gjatë që janë kryesisht *i) ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; ii) humbje të florës dhe faunës ujore, dhe iii) ndotje.*

***Ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve*:** Hidromorfologjia e lumenjve lidhet kryesisht me tipare fizike të një lumit të cilat janë kryesisht[74] *morfologjia e kanalit* dhe *lloji i rrjedhës* (natyrale ose e modifikuar), *përbërja litologjike e shtratit* (lloji, sasia e përbërjes shkëmbore in shtrat), *struktura dhe stabiliteti i brigjeve* mjaft e rëndësishme sepse tregon ndikimin që do të ketë lumi në gërryerjen e brigjeve dhe, si rrjedhojë, në sasinë e sedimentit që do të përfundojë në lumë, *digat/pengesat* përgjatë rrjedhës të cilat ndikojnë në ndryshimin e shpejtësisë së rrjedhës së lumit dhe largësinë e rrjedhjes së lirshme të ujit deri në largësinë të cilën është në gjendje të trasportojë sedimentin, *bimësia në shtratin e lumit* (habitatet, biodiversiteti, bimësia etj), *brezi i bimësisë mbrojtëse përgjatë brigjeve*, *përdorimi i tokës në afërsi* (rreth 20 metra nga bregu) dhe *gjerësia e zonës me ndikim nga përmbytjet*.

Në vendin tonë, ndërhyrjet në lumenj janë të shumëllojshme, si në shtrat ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosja e mbulesës bimore, marrjen e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa, ndërtime afër lumenjve, hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gërmimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që prodhojnë mbetje, shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj. [75] Të gjitha këto kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat, edhe nga studimet e Shërbimit Gjologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve. Një përshkrim i shkurtër i rezultateve të analizës në Basenin e lumit Seman e Vjosë paraqitet më poshtë.

Thellimi i shtratit të lumenjve në Basenet e lumenjve Seman e Vjosë

Me qëllim analizimin e gjendjes së lumenjve në vendin tonë dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit të fenomeneve gjeologjike dhe ndërhyrjes së njeriut në shtratin e tyre, SHGJSH-ja ka monitoruar[76] basenet e lumenjve në vend, ndër të cilët edhe basenet e Semanit e Vjosës.

Pellgu i Lumit Seman: është monitoruar në pesë pika/profile monitorimi për periudhën 2008-2016. Këto profile janë shpërndarë në Lumin Osum (dy pika) dhe në Lumin Seman (tre pika). Në lumin Devoll nuk ka profile të monitoruara. Megjithatë, duke qenë se në zonën fushore përpara bashkimit, lumenjtë Osum e Devoll paraqesin ngjashmëri hidromorfologjike, rezultatet e lumit Osum në dy pikat e monitorimit Urë Vajgurore në Osum dhe Urë e Kuçit në Seman, në një farë mënyre janë tregues edhe të gjendjes së Lumit Devoll.

Tabela 7. Vendndodhja e profileve të monitorimit

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit
38	Seman	Ura e Re Berat	2008-15
39		Ura Vajgurore	2008-15
40		Ura e Kuçit	2009-15
41		Imësht	2009-16
42		Ura e Mbrostarit	2007-15

Burimi: SHGJSH, 2015

Ndër problematikat kryesore të nxjerra në pah nga ky monitorim është prania e ***erozionit fundor*** në segmentë të ndryshme të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme. Në të gjitha pikat ka patur erozion të theksuar fundor i cili shfaqet me *ulje të shtratit të lumit*. Më i theksuar është vënë re në *Urë Vajgurore* në vitet 2008-2015 (43.2cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në Imësht (34.8cm), Ura e Mbrostarit (19.4cm) dhe Ura e Kuçit me 13cm.

Figura 44. Profilet e monitorimit të gjendjes së shtratit të lumenjve në Basenin e L. Seman



Burimi: SHGJSH, 2016

Tabela 8. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman

Nr.	Vendi i profilit të monitorimit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi Total	Ecuria deri 2015			Trendi 2011-2015		
				Erozion	Neutral		E	N	A
38	Ura e Re Berat	2008-15	-16.8	+			+		
39	Ura Vajgurore	2008-16	-43.2	+			+		
40	Ura e Kuçit	2009-15	-13.0		+		+		
41	Imësht	2009-16	-34.8	+			+		
42	Ura e Mbrostarit	2007-15	-19.4	+				+	

Burimi: SHGJSH, 2016

Figura 45. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor.



Burimi: SHGJSH, punoi: Co-PLAN

Erozioni i brigjeve të lumit është i theksuar, në veçanti në brigjet anësore të Urës Vajgurore i cili arrin deri në 250 metra në thellësi të terracës.

Ndërkohë, në lumë janë vënë re edhe ***ndërhyrje të gabuara për mbrojtjen e lumit*** nga erozioni në rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore Lushnjë-Berat. Një shembull është argjinimi i meandrës i cili ka shkaktuar erozion.

Shkurtimisht, problematikat kryesore që janë vënë re gjatë monitorimit janë[77]:

- ulje të shtratit për shkak të erozionit fundor;
- përmbytje në zonën e poshtme të lumit Seman dhe në zona të caktuara të rrjedhës së tij;
- ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.);
- dëmtim të florës dhe faunës së lumit;
- dëmtim të peizazhit lumor;
- erozion të tokës bujqësore në segmentet Berat-Urë-Vajgurore, Gostimë, Salcë-Kozarë, Çiflig, Arrëz, Ndërmenas, Marinzë, Jogodin, Mbrostar etj;
- rrezikime të objekteve inxhinierike (ura mbrojtëse, argjinatura etj.) në Vetrik, Vlashuk, Çipllak, Segmentet Berat-Urë Vajgurore, Gorican-Mbrostar etj.;
- ulje e nivelit të ujërave nëntokësore në puset e ujit, stacione pompimi jashtë funksionit.

Thellimi i shtratit në Basenin e Vjosës:[78] Pellgu i Lumit Vjosë (Baseni) është monitoruar në 5 pika/profile monitorimi për periudhën 2008-2015. Këto profile janë shpërndarë në lumin e Vjosës (3 pika) dhe në lumin e Drinos (2 pika)[79]

Tabela 9. Vendndodhja e profileve të monitorimit në Basenin e L. Vjosë.

Nr.	Lumi	Vendi i profilit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi total erozioni) në cm.
43	Vjosë	Andon Poçi	2008-15	-27.9
44		Ura e Subashit	2008-15	-32.9
45		Tepelenë	2009-15	-47.0
46		Poçem	2014-15	-19.0
47		Ura e Mifolit	2008-15	-25.5

Burimi: SHGJSH, 2016

Siç ka ndodhur me lumin Seman, nga rezultatet e monitorimit është vënë re se edhe lumi Vjosë ka pësuar ulje të shtratit të tij (erozion fundor) pothuajse në të gjithë segmentin e monitoruar. Intensiteti i erozionit fundor ndryshon sipas segmentit të lumit ku më i theksuar është vënë re në Tepelenë në vitet 2009-2015 (-47.0 cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në Urën e Subashit (-32.9cm) i monotoruar në periudhë kohore 2008-15 dhe në profilin e monitorimit Ura e Mifolit (-25.5cm), monitoruar në të njëjtën periudhë kohore.

Tabela 10. Erozioni fundor ndër vite në lumin Vjosë.

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi Total
43	Vjosë	Andon Poçi	2008-15	-27.9
44		Ura e Subashit	2008-15	-32.9
45		Tepelenë	2009-15	-47.0
46		Poçem	2014-15	-19.0
47		Ura e Mifolit	2008-15	-25.5

Burimi: SHGJSH, 2016

Figura 46. Erozioni fundor në shtratin e lumit Vjosë (ndryshimi total në cm)



Burimi: SHGJSH, punoi Co-PLAN

Siç shihet më sipër, Drinosi është dega e lumit që dallohet për shfrytëzimin më të madh të inerteve ndërkohë që në Vjosë është vënë re kryesisht në Urën e Mifolit dhe deri në 5-6 km sipër saj.

Problematikat e vëna re gjatë monitorimit të shtratit të lumit janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë pothuajse të gjitë morfologjinë e lumit. Ndër më kryesoret, SHGJSH-ja thekson[80]:

- uljen e shtratit të lumit për shkak të erozionit fundor (shkaktuar pjesërisht nga shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumit);
- erozion të tokës bujqësore në sektorë të caktuar të Vjosës si Frakull, Trevëllazën, Mifol, Varibob dhe Bishan (dhe në sektorë të degës së Drinosit si Lazarat, Palokastër, Ura e Subashit dhe Viruar);
- rrezikime të objekteve inxhinierike (ura mbrojtëse, argjinatura, rrugë etj.) në segmentin e Drinosit (Drinos-Odrie, Hekal-Selishtë-Hambar, Ura e Mifolit-Ada);
- ulje të nivelit të ujërave nëntokësore në puset e ujit në rrjedhën e mesme dhe të ulët (stacione pompimi jashtë funksionit);
- degradim të strukturës së kanalit rrjedhës, kryesisht në Drinos;
- përmbytje në rrjedhën e poshtme të lumit në afërsi të Gjirokastrës në Drinos;
- ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.);
- dëmtim të florës dhe faunës së lumit;
- dëmtim të peizazhit lumor;
- ndikim në modifikimin e vijës bregore.

Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et

Pellgu i lumit Seman është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve. Në fakt, në pellgun e Semanit deri më tani janë ndërtuar gjashtë HEC-e, ndërkohë që pesë të tjerë janë në ndërtim dhe 66 janë planifikuar për t'u ndërtuar.

Tabela 11. HEC-et në Basenin e lumit Seman.

BASENI I SEMANIT			
Nr	**Emërtimi i HEC**	**KapacitetI**	**Lumi**
Në prodhim			
1	Gjanc	1-10MW	NN
2	Vithkuq	1-10MW	Treska
3	Bogova	1-10MW	NN

4	Ujanik	1-10MW	NN
5	Lenia	1-10MW	NN
6	Holta	1-10MW	NN
Në ndërtim			
7	Nice	1-10MW	Nice
8	Treska 1	1-10MW	Treska
9	Treska 2	1-10MW	Treska
10	Nishovë 1	0-1MW	Nishovë
11	Banjë	>50MW	Devoll
Planifikuar per ndërtim			
12	Gjerbes	0-1MW	Gjerbes
13	Darsi 1	0-1MW	Darsi
14	Darsi 2	0-1MW	Darsi
15	Darsi 3	0-1MW	Darsi
16	Mollas	0-1MW	Mollas
17	Arrëz	0-1MW	Arrëz
18	Vokopola	0-1MW	Vokopola
19	Bigas Veleshnje	0-1MW	Begas-Veleshnje
20	Vlasçuk	1-10MW	Devoll
21	Vertoipi	1-10MW	Osum
22	Nishovë 2	0-1MW	Nishovë
23	Corovodë	0-1MW	Corovodë
24	Prishtë 1	0-1MW	Prishtë
25	Prishtë 2	0-1MW	Prishtë
26	Staravecka 1	0-1MW	Staravecka
27	Staravecka 2	0-1MW	Staravecka
28	Staravecka 3	0-1MW	Staravecka
29	Helmes 1	1-10MW	Helmes
30	Helmes 2	1-10MW	Helmes
31	Faqekuq 1	1-10MW	Faqekuq
32	Faqekuq 2	1-10MW	Faqekuq
33	Velushe	10-50MW	Osoje
34	Treska 3	1-10MW	Treska
35	Treska 4	1-10MW	Treska
36	Qytezë	0-1MW	Qytezë
37	Kozel 1,2	1-10MW	Osum
38	Belesova 1,2	1-10MW	NN
39	Holtë 2	1-10MW	Holtë
40	Kabash-Pukë	0-1MW	Kabash
41	Sotirë 1	1-10MW	Sotirë
42	Sotirë 2	1-10MW	Sotirë
43	Skënderbegas	>50MW	Toorricë
44	Kërpicë	1-10MW	Kërpicë
45	Dobrenjë-Tomorricë	0-1MW	Dobrenjë-Tomorricë
46	Kukur 1	1-10MW	Kukur

47	Kukur 2	1-10MW	Kukur
48	Kukur 3	1-10MW	Kukur
49	Kukur 4	1-10MW	Kukur
50	Kukur 5	10-50MW	Kukur
51	Bratila 1	>50MW	Devoll
52	Bratila 2	1-10MW	Devoll
53	Zerec 1	0-1MW	Zerec
54	Zerec 2	0-1MW	Zerec
55	Moglicë	>50MW	Devoll
56	Cemerica 1	1-10MW	Cemericë
57	Cemerica 2	1-10MW	Cemericë
58	Cemerica 3	1-10MW	Cemericë
59	Strelce 1	0-1MW	Strelce
60	Strelce 2	0-1MW	Strelce
61	Lozhan 1	0-1MW	Dolanit
62	Lozhan 2	0-1MW	Dolanit
63	Verba 1	0-1MW	Verba
64	Verba 2	0-1MW	Verba
65	Babjen	0-1MW	Babjen
66	Shpella poshtë 1	0-1MW	Poshtë
67	Shpella poshtë 2	0-1MW	Poshtë
68	Hohist	1-10MW	Devoll
69	Grapsht	1-10MW	Devoll
70	Vranisht	1-10MW	Devoll
71	Stropan	1-10MW	Devoll
72	Brecen Mnekula	1-10MW	Devoll
73	Kuk Menkulas	1-10MW	Devoll
74	Dobjan Menkulas	1-10MW	Devoll
75	Miras Menkulas	1-10MW	Devoll
76	Dardhë 1	0-1MW	Devoll
77	Dardhë 2	1-10MW	Devoll

Burimi: AKBN dhe Riverwatch.eu

HEC-et janë ndërtuar në degët kryesore të lumit Seman (Devoll dhe Osum) si dhe në degë të nivelit të dytë (degë të degëve) të cilat shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumenjtë kryesorë Osum e Devoll, e si rrjedhojë, edhe Seman. Njëkohësisht, ata shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për lumenjtë në fjalë.

Hidrocentralet janë përdorur për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë në 50 vitet e fundit. Megjithatë, edhe pse HEC-et sjellin përfitime ekonomike dhe prodhim energjie, ata kanë ndikimet e tyre në mjedis dhe, në qoftë se nuk ndërtohen sipas parimit të përdorimit të integruar të burimeve ujore (që nënkupton përdorim i ujit duke patur parasysh edhe nevojat e sektorëve të tjerë të ekonomisë për ujë), rrezikojnë të krijojnë konflikte sociale.

Figura 47. HEC-et në Pellgun e lumit Seman.



Burimi: Riverwatch.eu

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një sistemi lumor duke ndryshuar karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Kryesisht, pasojat e ndërtimit të një HEC-i janë:

- *trasformimi i rrjedhës së lumit në* pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në *sistem të një rezervuari artificial* me ujëra të ndenjura;
- *bllokimi i qarkullimit të peshqve* ose specieve të tjera ujore;
- *prishja e ekuilibrave* e *proceseve fizike* dhe *habitateve* në rrjedhën pas digës. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror shkaktojnë prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve duke shkaktuar erozionin detar, ishujve, zonave pjellore të lumenjve dhe zona të tjera kënetore;
- *ndryshimi i rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror*, të trashë, në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën për faktin se jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit;
- *grumbullimi i sedimentit pas digës* që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme. Kur një lumë nuk merr sedimente mjaftueshëm, zakonisht tenton ta zëvendësojë atë duke gërryer brigjet e lumit e shaktuar thellim të shtratit;
- *thelimi i shtratit të lumit* i cili ul edhe nivelin e ujit në akuiferë.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në lumenjtë e Basenit të Semanit e Vjosës (në lumenjtë kryesorë dhe degët e tyre), mendohet se ndikimi në mjedis, në bujqësi, në ekonominë e zonave përreth si dhe në bregdetin e Fierit, mund të jetë i theksuar.

HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit që është mjaft e rëndësishme për bujqësi në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për bujqësi dhe sektorë të tjerë edhe pse ky mbetet objekt studimi në të ardhmen (vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave dhe sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit që ato lënë me rrjedhje të lirë

mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës, pas digës, në të ardhmen). Është shumë e rëndësishme të theksohet se lumi Devoll është jetik për zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë Fier dhe në bashkitë e tjera nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye, ndryshimi i rrjedhës së ujit apo pakësimi i sasisë së ujit që mund t'u shkojë fshatarëve për përdorim në periudhat e kultivimit nuk përbën më një problem vetëm mjedisor, por mbi të gjitha, një problem social që do të kërkonte zgjidhje të menjëhershme.

Njëkohësisht, pakësimi i rrjedhës së lumit Devoll e Osum mund të çojë edhe në zvogëlimin e sasisë së ujërave të akuiferëve të Semanit (Akuiferi i Beratit i cili ushqehet nga lumi Devoll e Osum, Akuiferi i Semanit etj.). Akuiferët shërbejnë si burim për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkive të ndryshme (shihni seksionin e ujësjellësit). Me pak fjalë, digat e HEC-eve, në rast së nuk janë planifikuar dhe nuk manaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar që garantojnë përdorimin e ujit edhe për bujqësi dhe aktivitetet të tjera ekonomike për popullsinë e zonave përreth, mund të shkaktojnë probleme të mëdha mjedisore dhe sociale.

Ndikimi i HEC-eve ndihet fuqishëm edhe në bregdet, edhe pse kjo është një problematikë që zakonisht ndodh në vazhdën e dhjetë ose njëzet viteve (problem afatgjatë). HEC-et, siç u theksua më sipër, duke penguar transportin e materialit zhavorror drejt grykëderdhjeve të lumenjve krijojnë erozion bregdetar me kalimin e viteve (shihni seksionin e Vijës Bregdetare). Rëndësia e materialit zhavorror në plazhe vihet re dhe vërtetohet në deltat e vjetra të lumenjve si p.sh. delta e vjetër e lumit Seman. Nga momenti që në këtë zonë nuk ka patur prurje zhavorrore nga lumi, kjo zonë ka pësuar erozion detar të theksuar. Në deltën e sotme të lumit Seman, fatmirësisht nuk është vënë re erozion. Megjithatë, nisur nga studimet e kryera nga SHGJSH-ja, kjo zonë ka pësuar një ulje drastike të prurjeve zhavorrore (grumbullimve) nga lumi gjatë viteve 2008-2014 (nga 59.7% grumbullim në vitin 1980-2008 ka arritur në 3.8% në periudhën më të afërt 2008-2014).

Dëmtime të zonës ripariane përgjatë brigjeve të lumenjve

Mungesa e manaxhimit të lumenjve Vjosë, Seman e Gjanicë ka dëmtuar edhe brigjet e lumenjve, në veçanti, brezin e gjelbër (zona ripariane) të Semanit i cili ka pësuar dëmtime të theksuara. Në shumë zona ky brez është ngushtuar, mungojnë të gjithë brezat e bimësisë së nevojshme nga bimët e ulëta deri tek ato të larta, ose nuk ekziston më. Duke qenë se lumi kalon në toka bujqësore, në të shumtën e rasteve brezi i gjelbër është kultivuar si tokë bujqësore. Kjo ka ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Konkretisht, zvogëlim/ngushtim i brezit të gjelbër është vënë re përgjatë gjithë trupit ujor tëlLumit Seman, ndërkohë dëmtime e deri në humbje të këtij brezi vërehen në *seksionin e lumit që kalon ndërmjet Mbrostarit dhe Portëzës*. Mungesa e brezit të gjelbër në grykëderdhje të lumit në Topojë ka lejuar edhe depërtimin e ujërave të kripura në brendësi të territorit duke kthyer tokat bujqësore në toka të pakultivueshme. Përveç Semanit, Bashkia Fier përshkohet edhe nga Gjanica. Ndryshe nga Semani, Gjanica ka prurje me densitet më të ulët dhe, në një farë mënyre, ngjan më tepër me një kanal përshkues se sa një lumë natyror. Bujqësia, mbetjet bujqësore, erozioni ujor, ndotjet industriale dhe urbanizimi janë faktorët kryesorë të ndotjes së ujit të këtij lumi dhe të asaj sipërfaqeje të kufizuar të brezit të gjelbër të mbetur përgjatë brigjeve të tij.

Përmbytja e disa segmenteve të Gjanicës e Semanit:

Bashkia e Fierit karakterizohet nga një terren i sheshtë ku mbizotërojnë fushat. Mungesa e pjerrësisë në këto fusha krijon probleme të mëdha për qarkullimin e ujërave në rast shirash të rrëmbyeshme duke krijuar përmbytje të zonave më të ndjeshme. Në Bashkinë e Fierit përmbytjet ndodhin përgjatë Gjanicës, afër kanalit të Urës së Mbrostarit, në rrjedhën e poshtme dhe në disa zona të caktuara të rrjedhës së mesme të Semanit dhe në rrjedhën e poshtme të Vjosës[81].

Shpesh përmbytjet ndodhin edhe për shkak të mugesës së një rrjeti kanalizues të ujërave të zeza dhe ujitje-kullim, i domosdoshëm për zona pa pjerrësi si kjo e Bashkisë Fier. Siç raportohet, pjesa më e madhe e rrjetit mbledhës të kanalizimeve të ujërave të ndotura është ndërtuar në vitet 1968-1980. Ky rrjet është zgjeruar dhe rehabilituar shumë pak pas ndërtimit të tij.[82] Si rrjedhojë, terreni i sheshtë dhe rrjeti i pamjaftueshëm i ujërave të zeza si dhe teknologjia e vjetër e këtij rrjeti (tubacionet) e shkatërrojnë rrjetin e tij në raste shirash të rrëmbyeshme[83].

Humbja e sipërfaqes së tokës bujqësore në brigjet e lumenjve (Erozion i tokës bujqësore)

Mungesa e fashës së gjelbër ka patur pasojat e saj në dëmtimin e mëtejshëm të lumenjve. Në fakt, përgjatë brigjeve të lumenjve Vjosë e Seman vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës. Erozioni i tokes bujqësore është vënë re përgjatë të gjitha brigjeve të lumit Vjosë në përgjithësi dhe më i theksuar në sektore te caktuar të lumit si *Frakull, Trevëllazen, Mifol, Varibob, Bishan, të Vjoses.*[84] Gjatë brigjeve të Vjosës jnë vënë re edhe rrezikime dhe prishje te objekteve inxhinierike, si ura, vepra mbrojtese dhe argjinatura (segmented Hekal-Selishte-Hambar, Ura e Mifolit-Ada)[85]. Në Lumin Seman erozioni vihet re kryesisht në zonat bujqësore në rrjedhën e tij të poshtme dhe në disa segmente në rrjedhën e mesme (nga zona Patos-Marinë e deri në grykëderdhje)

Shfrytëzimi i inerteve lumore

Shtretërit e lumenjve zakonisht janë zona të ndërlikuara dhe me një natyrë të brishtë që dëmtohen lehtësisht. Kjo natyrë rrjedh nga i) përbërja e tyre gjeologjike me dhera të shkrifta, rëra e zhavorre kryesisht, dhe nga ii) prania e lartë e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore, të cilat kanë energji që varet nga stadi i zhvillimit të lumit dhe nga sasia e reshjeve që bie në territor[86]. Për këtë arsye, shtretërit e lumenjve janë trajtuar si fenomene rreziku gjeologjik për vetë natyrën e tyre të paqëndrueshme**.**[87]

Megjithatë, në dy dhjetëvjeçarët e fundit, edhe në Bashkinë e re të Fierit, inertet e shtretërve të lumenjve janë shfrytëzyar në maksimum, pa kriter dhe në mungesë të plotë të një studimi të mirëfilltë të zonave ku shfrytëzimi mund të lejohet pa dëmtuar lumenjtë. Vetëm në territorin e ri të Bashkisë së Fierit ushtrojnë veprimtarinë e tyre për shfrytëzimin e inerteve lumore dy karriera lumore në shtratin e Semanit dhe tetë karriera lumore në shtratin e Vjosës. Për bashkitë e tjera ku kalojnë këto lumenj nuk njihet numri i veprimtarive të tilla. Si pasojë, shfrytëzimi i inerteve lumore (karrierat lumore) ka dëmtuar rëndë Vjosën e Semanin duke çuar edhe në uljen e shtratit të tyre, zvogëlimin dhe zhdukjen e biodiversitetit si dhe ndotjen e akuiferëve[88].

Tabela 12. Karrierat lumore në Bashkinë e re Fier.

N.	Qarku	Lumi	Adresa e aktivitetit	Procesi	Kategoria e lejes	Nr. i lejes nga MM
1	Fier	Seman	Lumi ***Seman*** në zonën e fshatit Kallm i Madh	Karrierë lumore	B	
2	Fier	Seman	Shtrati i lumit ***Seman,*** në krahun e rrjedhës së poshtme të tij, në segmentin Kallm - Belinë, Fier	Karrierë lumore	B	440
3	Fier	Vjosë	Shtrati i lumit ***Vjosë,*** ferma e Rromës, Fier	Karrierë lumore	B	590
4	Fier	Vjosë	Lumi ***Vjosë,*** zona e Kanishtës	Karrierë lumore	B	233
5	Fier	Vjosë	Lumi ***Vjosë,*** në zonën Varibob (Cakran) - Kashishtes	Karrierë lumore	B	300
6	Fier	Vjosë	Në lindje të fshatit Fermë, komuna Cakran, Fier, lumi ***Vjosë***	Karrierë lumore	B	551
7	Fier	Vjosë	Në largësi 500 m në vijë ajrore nga fshati Kafaraj, Fier **(*Vjosë*)**	Karrierë konglomeratesh	B	463
8	Fier	Vjosë	Lumi ***Vjosë,*** në jug të fshatit Hambar, Buzmadh, Cakran, Fier	Karrierë lumi	B	416
9	Fier	Vjosë	Lumi ***Vjosë,*** në zonën e fshatit Buzëemadh, komuna Cakran, Fier	Karriere inertesh lumore	B	391
10	Fier	Vjosë	Zona e quajtur Ada Myrtezi, Frakull, qarku Fier **(*Vjosë*)**	Shfrytëzim rëre	B	3798/3

Burimi: ARM Fier, 2015

Shfrytëzimi i burimeve ujore nga industria e naftës: Industria e naftës dallohet për shfrytëzim të sasive të mëdha të ujit të cilat i siguron kryesisht nga burimet ujore sipërfaqësore ose nëntokësore. Sasitë më të mëdha të ujit nevojiten gjatë shpimeve të puseve të reja dhe gjatë pastrimit dhe mirëmbajtjes së herëpashershme të puseve. Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, procesi i shpimit të një pusi të vetëm kërkon nga 7 deri në 15 milionë litra ujë edhe pse shifra është relative në varësi të teknologjisë së përdorur[89]. Nw Bashkinw e Fierit, njw sasi uji pwr shfrytwzim nga industria e naftws merret nga lumi Seman dhe nga burime ujore nëntokësore (mbi 200m thellwsi[90]). Nw disa raste, nuk përjashtohet ripërdorimi ose riciklimi i ujërave industriale.

Pwr shkak tw mungesw sw tw dhwnave, në Bashkinë Fier dhe në vendin tonë, mbetet ende e panjohur sasia e ujit të lumnjve dhe tw Semanit, nw rastin specifik, që shfrytëzon çdo industri gjatë shpimeve dhe gjatë aktivitetit të saj normal të nxjerrjes së naftës. Njëkohësisht, përcaktimi i ndikimit në mjedis dhe qëndrueshmërisë së shfrytëzimit të burimeve ujore të Semanit mbetet një sfidë për arsye se Agjencia e Basenit Ujor të Semanit nuk ka një Plan të Manaxhimit të Basenit Ujor të Semanit në të cilin përcaktohen sasitë e lejuara për shfrytëzim nga sektorë të ndryshëm të industrisë pa cënuar ruajtjen e lumit.

Ndotja

Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Fier, lumenjtë janë përdorur si burime pritëse të ujërave të zeza ndërsa shtretërit ose brigjet janë përdorur si vend-depozitime të mbetjeve të ngurta. Ky është shembulli i lumit Seman e Gjanica në të cilët janë shkarkuar ujërat e zeza të patrajtuara, duke e ndotur atë. Përveç ujërave të zeza, lumenjtë Gjanica dhe Seman kanë qenë vazhdimisht nën ndikimin e industrisë së naftës dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tyre. Për shembull, shumë puse të naftës janë hapur në largësi minimale nga lumi. Si rrjedhojë, cilësia e ujërave të lumenjve është varfëruar ndër vite. Lumenjtë janë ndotur me produkte nafte, ujëra të zeza, produkte bujqësore etj.

Monitorimi i ndotjes: Duke patur si qëllim përaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë Qendrore, dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, Co-PLAN-i[91] kreu monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Semanit (Osum, Devoll, Seman e Gjanicë). Pikat e monitorimit dhe disa parametra kimikë[92] janë të përbashkët me monitorimet e ujërave të lumenjve kryesorë të Basenit të Semanit të kryera nga AKM-ja në vitin 2013[93] me përjashtim të pikës Mujalli[94]. Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh direktiva të ndryshme të Bashkimit Europian. Parametrat e monitoruar janë si më poshtë vijon:

- parametra fiziko-kimikë*:* pH, tejdukshmeria, perçueshmeria elektrike, lënda e ngurtë pezull (TSS), lënda e ngurtë e tretur, oksigjeni i tretur, temperatura dhe nevoja biologjike për oksigjen;
- ushqyesit: $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, Sulfidet;
- bakteria: bakteria koliform;
- Metale të rënda: Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Mangnez (Mn), Nikel (Ni), Zink (Zn), Bakër (Cu), Co, Krom (Cr), Mërkur (Hg), Arsenik (As), Barium (Ba), Brominë (Br)

Pikat e monitorimit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13. Pikat e monitorimit të Basenit Seman.

N.	Lumenjtë	Vendndodhja e pikës së marrjes së mostrave të ujit
1	L. Seman	Lushnjë (para hyrjes në Patos Marinëz)
2		Ura e Mbrostarit në Fier (para bashkimit me L. Gjanica)
1	L. Gjanicë	Ballsh –Panahori (para kalimit në Ballsh)
2		Mbrostar (pas landfillit Fier, para bashkimit me L. Seman, Ura e Rr. Teodor Muzaka)
1	L. Osum	Kanionet e Osumit: afër burimit, para Çorovodës
2		Uznovë (para bashkimit me L. Zagoria)
3		
4		Ura e Goricës, Berat
5		Urë Vajgurore (në hyrje të Bashkisë Kuçovë tek Ura e rrugës SH-72)
6		Arrëz (para bashkimit me L. Devoll)
1	L. Devoll	Moglicë, Korçë
2		Arrëz (para bashkimit me L. Seman)
1		Tri Urat - Çarshovë

2	L. Vjosa	Ura e Mifolit
3		Në derdhje të Vjosës (afër Dëllinjës / ose Pishë Poros)

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pikat e monitorimit ***Seman 2, Gjanicë 2*** tek Ura e Mbrostarit, ***Vjosë 2*** tek Ura e Mifolit dhe ***Vjosë 3*** në grykëderdhje të lumit gjenden brenda dhe në kufi të Bashkisë së Fierit. Pikat e monitorimit dhe disa parametra kimikë[95] janë të përbashkët me monitorimet e ujërave të lumenjve kryesorë të Basenit të Semanit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)[96] me përjashtim të pikës Mujalli në Seman[97]. Për interpretimin e rezultateve (standardet) janë marrë parasysh direktiva të ndryshme të Bashkimit Europian.

Figura 48. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Seman, brenda territorit të Bashkisë Fier



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

<u>Rezultatet e monitorimit</u>:

Nga monitorimi i kryer në Seman e Vjosë u vu re se ujërat e lumenjve Gjanicë dhe Seman, nga Ura e Mbrostarit deri në grykëderdhje, janë acidike (**ph**<7) ndërsa ujërat e lumenjve Osum, Devoll, dhe Vjosë janë alkalinë (pH>7) në të gjitha pikat e monitorimit, brenda dhe jashtë territorit të bashkisë. Këto gjetje janë të ngjashme me rezultatet e raportuara nga AKM-ja, me përjashtim të disa pikave (Seman 2 dhe Gjanicë 1 dhe 2).

Figura 49. pH i ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3
pH	8.39	8.17	8.18



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6
pH	6.1	6.2	6.2	6.5	8.65	8.44	8.4	8.2	8.4	8.4	8.07	8.1

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në lumenjtë Seman dhe Vjosë, ***thellësia e depërtimit të dritës*** është në nivele të pranueshme në pjesët e sipërme të rrjedhës, por depërtimi i dritës paraqet probleme më të theksuara në zonat me erozion të lartë (në Seman para hyrjes në Patos-Marinëz dhe në Urën e Mbrostarit, ndërsa në Osum, në segmentin Urë Vajgurore-Arrëz, përpara bashkimit me Devollin).

Figura 50. Tejdukshmëria e ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3	Stand. Rek
Tejdukshmeria (cm)	100	31.25	81.25	100



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
Tejdukshmeria (cm)	37.5	44.37	35	0	0	43.75	88	113	106.25	125	43.75	38	100

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Përçueshmëria elektrike ndryshon ndërmjet lumenjve, duke pasur vlera më të larta se standardet mjedisore në lumenjtë me ujëra acidikë (Gjanicë e Seman në segmentin Ura e Mbrostarit-Grykëderdhje). Vlerat luhaten nga 601-661 µS/cm. Në lumenjtë e tjerë të pellgut të Semanit dhe në Vjosë, vlerat janë brenda normës me vlera që ndryshojnë nga 309-454 µS/cm dhe 315-439 µS/cm përkatësisht.

Figura 51. Përçueshmëria elektrike e ujërave në basenet e Semanit dhe Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3	Standard Rek
Përçueshmëria elektrike (µS/cm)	411	439	315	500



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard Rek
Përçueshmëria elektrike (µS/cm)	601	661	658	620	419	454	364	326	316	309	392	389	500

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Vlerat e ***NBO_5***[98] janë brenda normës[99] në të gjitha pikat e monitorimit, vlera këto të ndryshme nga vlerat e monitoruara nga AKM-ja[100]. Megjithatë, vlerat brenda normave të NBO_5 tregojnë qartë nevojën për të analizuar NBO_5 në lidhje me parametrat e tjerë dhe me vendndodhjen e burimeve kryesore të ndotjes në lumë (industrisë përkundrejt ujërave të zeza të zonave të banuara, përmbajtjes së metaleve të rënda përkundrejt ushqyesve etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë ngadalëson ose zvogëlon ndjeshëm NBO_5 sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Figura 52. Vlerat e NBO5 dhe oksigjenit të tretur në basenet e Semanit dhe Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3	Standard
Oksigjeni i tretur (mg/l)	8.61	8.59	9.05	4.0
NBO5 (mg/l)	0.25	0.16	0.32	6



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
Oksigjeni i tretur (mg/l)	8.2	7.02	8.2	7.1	8.61	8.8	8.4	9.0	8.7	8.9	8.52	8.73	4
NBO5 (mg/L)	2.4	0.2	1.6	0.4	1.3	0.28	0.4	1.5	0.4	0.48	0.12	0.19	6

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Lënda e ngurtë pezull (TSS[101]) është <2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit të Semanit e Vjosës dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore, me përjashtim të lumit Gjanica në afërsi të Urës së Mbrostarit. Në këtë pikë, vlerat e lëndës pezull janë 49.8mg/l dhe shënojnë një rritje të theksuar në krahasim me pikat e tjera.

Figura 53. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në basenet e Semanit dhe Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3	Standard
Lenda e ngurte e tretur (mg/L)	212	227	162	500
Lenda e ngurte pezull (mg/l)	2	2	2	25



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
Lënda e ngurtë e tretur (mg/l)	312	343	342	322	216	235	187	167	162	159	202	200	500
Lënda e ngurtë pezull (mg/l)	2	2	2	49.8	2	2	2	2	2	2	2	2	25

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkohë, lënda e ngurtë e tretur (TDS[102]) ka vlera më të larta krahasuar me TSS-në në basenet e të dy lumenjve. Kjo lidhet me burimet e TDS-së që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të TDS-së vihen re në Seman e Gjanicë.

Semani ka përmbajtje të lartë të disa përbërësve të azotit, veçanërisht të nitriteve ($N\text{-}NO_2$) dhe amoniakut ($N\text{-}NH_4$). Përmbajtja e ***nitriteve*** është e lartë në pikën e monitorimit afër Urës së Mbrostarit në Gjanicë, në lumin Devoll përpara bashkimit me Osumin dhe pothuajse në të gjitha pikat e monitorimit të lumit Osum, me përjashtim të pikës së monitorimit në Çorovodë[103]. Përmbajtja e ***amoniakut*** është brenda normave të lejuara, me përjashtim të Gjanicës 2, pika e monitorimit afër Urës së Mbrostarit ku përmbajtja e amoniakut është tejet e lartë. Vlerat e amoniakut janë pothuajse të njëjta me monitorimin e AKM-së[104], ku përmbajtja e $N\text{-}NH_4$ është brenda normave të lejuara. Përmbajtja e ***nitratit*** ($N\text{-}NO_3$) është

brenda normave të lejuara[105] në të gjitha pikat e monitorimit, në të katër lumenjtë e monitoruar.

Figura 54. Nitratet, nitritet dhe amoniaku në Basenin e Semanit.



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
NO3 (mg/l)	0.6	0.42	0.32	0.15	1.2	0.25	0.24	0.337	0.33	0.39	0.37	0.42	6
NO2 (mg/l)	0.02	0.29	0.01	0.02	0.023	0.05	0.022	0.028	0.027	0.051	0.13	0.18	0.03
NH4 (mg/l)	0.09	0.13	0.026	1.645	0.16	0.27	0.08	0.22	0.06	0.17	0.03	0.44	1

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Ndërkohë, përmbajtja e përbërësve të azotit (nitratit, nitriteve dhe amoniakut) në ujërat e Vjosës është brenda normave të lejuara, gjetje këto që përputhen me vlerat e AKM-së.

Figura 55. Nitratet, nitritet dhe amonium në Basenin e Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 2	Vj. 3	Standard
NO2 (mg/l)	0.005	0.018	0.010	0.03
NO3 (mg/l)	1.5	1.4	1.1	6
NH4 (mg/l)	0.13	0.06	0.17	1

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Në rast se përcaktimi i gjendjes së ujërave të Semanit bëhet në bazë të ***standardeve të përdorura nga AKM-ja***[106], vlerat e nitrateve, nitriteve dhe amoniakut në Seman dhe Vjosë janë të ngjashme me vlerat e monitorimit të AKM-së, brenda normave të lejuara në pothuajse të gjitha pikat e monitorimit. Rezultatet ndryshojnë vetëm në Urën Vajgurore (me përmbajtje më të lartë nitritesh) dhe në Urën e Mbrostarit (ku amoniaku i kalon vlerat e lejuara mjedisore të AKM-së).

Përbërësit e azotit janë ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por të mbipërdorur në bujqësi dhe shkaktojnë ndotjen e lumenjve për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike në to. Sulfatet në Vjosë dhe Seman janë në nivele të ulëta krahasuar me standardin[107] dhe më të larta hasen në Seman (Devoll 2, përpara bashkimit me Osumin).

Nivele të larta të ndotjes në Seman e Vjosë hasen sa i përket bakterieve koliforme dhe metaleve të rënda. Bakteria koliform gjendet mbi vlerën 200Cfu/100ml. [108] Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës së monitorimit të mëtejshëm të ujërave të këtyre lumenjve për të përcaktuar nëse këto ujëra janë të përshtatshme për ujitje dhe veprimtari argëtuese.

Metalet e rënda janë matur në dy pika për çdo lumë[109] të basenit të Semanit dhe në dy pika për Vjosën, të cilat janë jashtë dhe brenda territorit të bashkisë. Në basenin e Semanit, ujërat janë të ndotur me plumb (Pb), cadmium (Cd), nikel (Ni), hekur (Fe), bakër (Cu), dhe krom (Cr). Kadmiumi gjendet në përmbajtje më të larta se plumbi. Ndërkohë, vlerat e manganezit (Mn) dhe zinkut (Zn) janë brenda parametrave mjedisorë.

Metalet e rënda gjenden në sasi më të larta se vlerat e lejuara edhe në pikat e monitorimit të Lumit Vjosë, sidomos Pb, Cd, Ni, Cu, Cr dhe Fe.

Figura 56. Metalet e rënda në basenet e Semanit.



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Pb (µg/l)	930	490	150	260	180	160	290	7.2
Cd (µg/l)	477	175	433	203	1070	1230	1140	0.09
Ni (µg/l)	1640	430	1440	700	310	180	510	20



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Cu (mg/l)	0.37	0.32	0.08	0.11	0.13	0.002	0.11	0.04
Cr (mg/l)	0.06	0.11	0.07	0.05	0.06	0.05	0.05	0.002



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Fe (mg/l)	34	16	16	15	9	20	36	0.3



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Mn (µg/l)	6	3.25	0.23	0.58	0.13	0.27	4.5	100



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Zn (µg/l)	2.05	1.74	2.28	5.22	0	0.03	0.8	1000

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Figura 57. Metalet e rënda në Basenin e Vjosës.



	Vj. 1	Vj. 3	Standard
Cd (µg/L)	269	110	0.09
Ni (µg/L)	210	220	20
Pb (µg/L)	160	150	7.2



	Vj. 1	Vj. 3	Standard
Cu (mg/l)	0.12	0.18	0.04
Cr (mg/l)	0.05	0.03	0.002



	Vj. 1	Vj. 3	Standard
Fe (mg/l)	27.5	28	0.3

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Rezultatet e monitorimit të ujit tregojnë se ujërat e lumenjve të Vjosës e Semanit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Burimet e ndotjes janë të ndryshme, kryesisht aktivitetet njerëzore (industria e naftës, nëntoka e ndotur e Azotikut, vend-depozitimet e mbetjeve, bujqësia etj.) edhe pse është e rëndësishme që të studiohet përmbajtja e metaleve në gjendje natyrore. Meqenëse ujërat e lumenjve të basenit të Semanit e Vjosës përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e këtyre lumenjve të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshme për ujitje dhe argëtim (not). Niveli i ndotjes me metale

të rënda duket i lartë në Seman dhe Osum (Urë Vajgurore dhe përpara bashkimit me Devollin). Lumi më i ndotur është Semani gjë që mund të shpjegohet me faktin se Semani grumbullon ndotjen e të dyja degëve të tij kryesore, të Osumit dhe të Devollit. Për më tepër, duke kaluar në një zonë bujqësore, Semani grumbullon edhe plehrat kimike dhe kimikate të tjera të përdorura në bujqësi. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit, nga një burim uji për bujqësinë, Semani mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Për fat të keq, ndotja e Vjosës dhe Semanit transmetohet edhe në deltat e tyre në grykëderdhje. Delta e Semanit krijohet në një rrip ranor të gjerë e cilësor për zhvillimin e plazheve dhe transmeton ndotjen e lumit përgjatë ujërave të plazhit dhe afër zonës së mbrojtur të Pishë-Poros.

Një tjetër faktor që vlen të studiohet për basenin e Semanit e Vjosës nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit, është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tyre nga pengesat fizike, kryesisht hidrocentralet (HEC-et). HEC-et që ndërpresin Vjosën, në prodhim ose të ato të projektuara, ndodhen jashtë kufijve të bashkisë (p.sh. në Langaricë që është në ndërtim), me përjashtim të një HEC-i të planifikuar pas Selenicës, pikërisht në fillesën e kufirit të Bashkisë së Fierit. Megjithatë, HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e sedimentit dhe ushqyesve që kontribojnë në rritjen e algave, uljen e sedimentit të transportuar përgjatë rrjedhës e në grykëderdhje të lumit duke dëmtuar plazhet, pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit pas barrierës etj.

Burimet kryesore të ndotjes së lumenjve

Urbanizimi i rajoneve të pozicionuara thuajse të gjitha ndërmjet brigjeve të lumenjve me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm, zgjerimi i metropoleve, zhvillimi i hovshëm i industrisë, sektori i bujqësisë dhe shumë aktivitete të tjera prodhuese industriale kanë shfrytëzuar ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore si pritësin kryesor të shkarkimeve.

Ndotja e lumenjve në Republikën e Shqipërisë mund të përkufizohet si ndër më primitivet dhe të pakontrolluarat, duke qënë se edhe vetë entitetet shtetërore që parashikojnë me ligj mbrojtjen e lumenjve, shkarkojnë ujërat e tyre të ndotura pa kriter në këto sipërfaqe me ujëra të rrjedhshme. Në vendin tonë, mbrojtja e burimeve ujore nga ndotja parashikohet në Ligjin 111/2012[110] por zbatimi i tij ne terren mbetet jo-efektiv. Si rrjedhojë, sot ende ndeshemi me derdhjen e ujërave industriale apo urbane të patrajtuara në lumë.

Kontribuesit kryesore të ndotjes së lumenjve në Bashkinë Fier sot janë:

- *Ujërat e Ndotura Urbane*: Shkarkimi i drejtpërdrejtë i tyre nga sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura në sipërfaqe ujore *(pa iu nënshtruar proceseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura);*
- Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane në Urën e Mbrostarit në afërsi të brigjeve të lumenjve *(infiltrimi i shllameve dhe derdhje aksidentale të mbetjeve të ngruta në ujrat e rrjedhshme të lumit);*
- Ujërat industriale në përgjithësi dhe ujërat nga industria e naftës: Shkarkime të ujrave industriale që janë përdorur në procese të ndryshme industriale të patrajtuara shkaktojnë ndotje të rëndë të ujërave rur (rafinimi i naftës, shpëlarje, miniera, metalurgji, riciklime, servise etj);
- Shkarkimet dhe infiltrimet e ujërave të përdorura në sektorin e bujqësisë;
- Shkarkimet e ujrave të larta (niveli i aciditetit në ujrat e shiut është gjithnjë e në rritje si edhe mikroorganizmat dhe mbetjet që mbartin si pasojë e shpëlarjes së pellgut ujëmbledhës);

- Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve për materiale inerte.

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujor dhe në mjediset pritëse të cilat bartin përfundimisht këtë ndotje (zakonisht grykëderdhjet). Këtu vlen të theksohet se pritësi kryesor i ndotjes së lumit Seman (bashkë me Osumin e Devollin) është deti Adriatik. Për këtë arsye, në deltën e lumit Seman vërehen nivele të larta të ndotjes së ujërave dhe sasi e madhe e mbetjeve të ngurta. Njollat e ndotjes janë të dukshme edhe përgjatë rrjedhës së këtij lumi sa herë që sasi të konsiderueshme shkarkimesh përfundojnë në këtë lumë.

Gjendje emergjente lidhet me lumin Gjanicë, i cili rrjedh përmes pjesës më të urbanizuar dhe më të populluar të Fierit. Krahas problemeve mjedisore qe paraqet ky lumë në lidhje me potencialin e tij të shpeshtë për dalje nga shtrati dhe përmbytje të banesave e bizneseve, shkarkime të lëngëta nga industria e naftës por edhe nga sipërmarrës të tjerë privatë, së bashku me ndotjen e vend-depozitimit të mbetjeve, kanë kontribuar në krijimin e arteries ndofta më ndotëse në Republikën e Shqipërisë me pasoja të rënda për biodiversitetin, bujqësinë, dhe si rrjedhojë, shëndetin e njeriut.

***Ndotja nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane*:** Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Fierit dhe thuajse aspak në NjA-të e saj. Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në pjesën më të madhe është i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij dhe teknologjisë së përdorur (ndërtimi i tubave me material betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç). Ky sistem mbledh shkarkimet e ujërave të ndotura dhe të larta (sistem i kombinuar) të cilat i derdh në Gjanicë dhe Seman të patrajtuara paraprakisht.

Këto ujëra bartin jo vetëm elementë organikë ndotës, por edhe të gjithë gamën e kimikateve dhe përbërësve të detergjentëve që përdoren në banesa në jetën epërditshme. Njëkohësisht, në lumë shkarkohen edhe mbetjet e lëngëta të prodhuara nga restorante, biznese të vogla, industria etj.

Për parandalimin e ndotjes së lumenjve nga ujërat e ndotur, është parashikuar të ndërtohet impianti i trajtimit të ujrave të ndotura urbane paralelisht me rehabilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujrave të ndotura.

***Ndotja nga vend-depozitimet e mbetjeve urbane*:** Në lidhje me vend-depozitimet e mbetjeve, aktualisht qyteti i Fierit, NjA-të Mbrostar, Portëz, Qendër dhe Topojë i depozitojnë mbetjet në vend-depozitimin e qytetit të Fierit, 3km larg qendrës së qytetit. Ky vend-depozitim kufizohet në veri me kanalin e Hoxharës dhe në Perëndim me kanalin Vjosë-Levan-Fier e lumin Gjanicë. Sipërfaqja e vend-depozitimit të mbetjeve është rreth 5.2ha. Mbetjet shkarkohen në terren të hapur dhe hera-herës digjen. Trajtimi dhe eliminimi i tyre ende është shumë problematik, pasi kjo fushë është në përdorim prej më shumë se 40 vitesh. Ky vend-depozitim ka mbi 40 vjet që është në përdorim dhe është në një gjendje alarmante, pasi mbetjet aty nuk kalojnë në asnjë proces trajtimi. Një pjesë e mbetjeve përfundojnë në ujrat e lumit Seman nëpërmjet Gjanicës. Fakti që ky vend-depozitim nuk ka inkorporuar asnjë lloj izolimi inxhinierik apo sistemi të kapjes së shllameve, është tregues i depërtimit të ndotjes nga vend-depozitimi në ujërat e lumit Gjanicë e më tej në Seman dhe në ujëra nëntokësorë. Aktualisht, ky vend-depozitim përbën një zonë të nxehtë mjedisore, e cila duhet të mbyllet dhe të rehabilitohet në mënyrë urgjente.

Krahas vend-depozitimit të mësipërm, në territorin e bashkisë gjenden edhe vend-depozitime të tjera të shpërndara në territor jashtë kushteve higjieno-sanitare dhe teknike pavarësisht nëse janë pajisur me autorizim. Njësia administrative Libofshë depoziton mbetjet në dy fusha depozitimi të autorizuara të cilat ndodhen në Agim tek brezi i argjinaturës, dhe në Ndërmenas.

Njësitë e tjera administrative përdorin disa vend-depozitime të improvizuara, të papërshtatshme, jashtë kushteve higjieno-sanitare, të cilat janë kthyer në zona të nxehta mjedisore.

Figura 58. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi 2005-2015.



Burimi: Bashkia Fier & Co-Plan

Ndotje nga industria e naftës: Në Bashkinë e Fierit, industria e naftës është mjaft aktive, kryesisht në zonën e Mbrostarit në Kallm dhe në Cakran në Kreshpan. Në Bashki operojnë disa kompani naftënxjerrëse ndikimi i të cilave në mjedis ndryshon në varësi të teknologjisë që ato përdorin. Në zonat e shfrytëzuara në të shkuarën dhe që ende vazhdojnë të jenë në pronësi të Kompanisë Albpetrol, ndotja e tokës dhe e burimeve ujore përreth puseve është e dukshme dhe në nivele tejet të larta për shkak të përdorimit të teknologjisë së vjetër. Me reshjet e shiut, ndotja përfundon në burimet ujore më të afërta dhe më tej në lumin Seman dhe në detin Adriatik. Në përgjithësi, në zonat nën shfrytëzimin e Albpetrolit vihet re braktisja e puseve dhe një mungesë e theksuar e investimeve në mbrojtje të mjedisit. Një situatë e ndryshme paraqitet në zonat naftënxjerrëse të shfrytëzuara nga Kompania Bankers Petroleum Ltd. Nga vëzhgimet në terren, ndryshe nga puset e Albpetrolit, puset në zonën në shfrytëzim nga Kompania Bankers Petroleum Ltd., dhe lumi Seman, nuk paraqesin shenja ndotjeje të dukshme falë përdorimit të një teknologjie të re dhe investimeve të kryera në mbrojtje të mjedisit gjatë viteve të operimit.

Figura 59. Gropë ekologjike për mbetjet e naftës në Pyllin e Levanit.

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Megjithatë, duhet theksuar se ndikimi i industrisë së naftës në cilësinë e ujërave të lumenjve në Bashkinë Fier nuk njihet për shkak të mungesës së të dhënave. Lumi Seman në Fier

monitorohet për parametra të përgjithshëm dhe mikroelemente[111], ndërkohë që mungon monitorimi për parametrave specifikë lidhur me përbërësit e naftës dhe kimikatet/aditivët që i shtohen ujit gjatë shpimit për shkrirjen e shtresës shkëmbore (ujit të kthyer ose shtresor).

Ndotja nga aktiviteti i shfrytëzimit të materialit inert nga shtrati i lumenjve: Ndonëse ky aktivitet është trajtuar nga akte të ndryshme ligjore në funksion të mbrojtjes së territorit dhe mjedisit, si në Vendimin nr.1 të datës 21.06.2006 Për "Reduktimin e shfrytëzimit të inerteve në shtretërit e lumenjve," vihet re se firmat ndërtuese vazhdojnë edhe sot shfrytëzimin e inerteve nga shtretërit e lumenjve. Vlerësohet se 2,000km^2 inerte të shtretërve natyrorë të lumenjve në Shqipëri janë zhvendosur nga ekskavatorë për në lavatriçe të cilat gjenden jo larg nga shtretërit e lumenjve.

Në Fier, një shembull i shfrytëzimit intensiv të inerteve vihet re në shtratin e lumit Seman shumë pranë Urës Mbrostar. Ky shtrat i është nënshtruar aktivitetit intensiv të shfrytëzimit të inerteve dhe, si pasojë, modifikimit të vazhdueshëm të shtratit të tij. Humbjet e biotës ujore në këto raste janë maksimale, të cilat shoqërohen më pas me ndryshim rrënjësor të cilësisë së këtyre ujrave. Në disa raste, ndikimi i këtij aktivitetit përkthehet në erozioni dhe në përkeqësimin e shtratit të lumit.

Ndotja nga ujërat e larta dhe sektori i bujqësisë**:** Këta janë faktorë me ndikim relativisht më të ulët krahasuar me burimet e lartpërmendura. Por, nëse marrim në konsideratë gjurmët e ndotjes së gjetur në ujërat e lumenjve tanë, prania e aciditetit të ujërave të shiut ka ndikuar në nivelin e pH në ujërat e rrjedhshëm. Ndotja e lumenjve nga ujërat e bardha vjen për arsye se këto ujëra grumbullojnë të gjitha llojet e ndotjes së mundshme që gjendet në territorin e pellgut ujëmbledhës të lumit dhe e trasportojnë atë nëpër degët e lumit e më pas e shkarkojnë në rrjedhën lumore.

Krahas ujërave të larta, përdorimi i ujërave të ëmbël në bujqësi, ku ndodh edhe përzierja e tyre me kimikatet e përdorura në këtë sektor, gjeneron një nivel të konsiderueshëm ndotje, e cila kur bie në kontakt me biotën ujore shkakton shqetësime në florë dhe faunë, si pasojë e elementeve kimike të shpërbëra në këto ujëra.

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Bashkia Fier bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit me toka pjellore që kultivohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Vend të rëndësishëm zë kultivimi i drithërave, perimtaria, bostanoret, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese, që ka bërë të mundur kultivimin e bujqësisë intensive përgjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe lumi i Semanit së bashku me kanalet e Darëzezës e Vijës së Ngjalës të cilët përshkojnë territorin e Bashkisë në pjesën perëndimore dhe derdhen në detin Adriatik.

Ndërsa nga njëra anë Bashkia Fier ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Semanit, Osumit e Devollit të cilët janë të rëndësishëm për zhvillimin e Bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtyre lumenjve, që vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Semanit (ku përfshihen edhe Osumi e Devolli) janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, përdorimi i ujërave

mund të rrezikojë shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit së bashku me degët e tij (Devolli dhe Osumi), nga burim uji për bujqësinë, këta lumenj mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Duke parë gjendjen në të cilën ndodhen lumenjtë në Bashkinë Fier, rekomandohet që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumenj (projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre). Veçanërisht, mungesa e zonave ripariane, përmbytjet dhe mungesa e elementeve mbrojtëse të peizazhit në toka bujqësore, janë arsye thelbësore të marrëdhënies problematike lumë-burime ndotëse. Pra, përveç trajtimit/shmangies së ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Devolli dhe Osumi për manaxhimin e integruar të këtyre lumenjve.

Me qëllim shmangien e mbishfrytëzimit të burimeve ujore, rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit (ABU Seman), të ndërmarrë projekte që synojnë përcaktimin e sasisë së ujërave sipërfaqësore (ose nëntokësore) që shfrytëzojnë industritë në përgjithësi dhe industria e naftës në veçanti. Një projekt i tillë kontribuon në përdorimin e ujërave në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme në Bashki duke shmangur konfliktet që mund të krijohen nga mungesa e ujit në lumë për përdorim në bujqësi për shkak të mbishfrytëzimit të tij nga industria e naftës.

- **Burimet ujore nëntokësore**

Në Territorin e Bashkisë së re të Fierit gjendet një numër i madh pellgjesh ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës.[112] Akuiferët përbëjnë burimet kruesore të furnizimit me ujë për popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e Bashkisë së re të Fierit dhe të bashkive përreth. Akuferët janë të llojeve të ndryshme. Megjithatë akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst përbëjnë burimet ujore kryesore për Fierin.

Figura 60. Akuiferëve në Qarkun e Fierit.



Burimi: SHGJSH 2014

Akuiferët zënë një sipërfaqe të gjerë në bashki edhe pse është e vështirë të përcaktohet me saktësi shtrirja e tyre në territor për shkak të studimeve të kryera në nivel rajoni [113]. Konkretisht, në territoren e Bashkisë së Fierit gjenden akuiferët e mëposhtëm[114].

Figura 61. Qarku Fier: Sipërfaqja e Akuiferëve sipas llojit (në %).



Burimi: SHGJSH, 2014, përpunoi Bashkia Fier dhe Co-PLAN

Aquiferët me porozitet ndërkokrrizor: Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor janë akuiferë që shtrihen kryesisht përgjatë shtratit të lumenjve kryesorë. Janë tejet të rëndësishëm për shkak të përcjellshmërisë dhe kapacitetit të lartë ujëmbajtës. Në Bashkinë e Fierit, ky lloj akuiferi shërben për furnizimin me ujë të Bashkisë dhe fshatrave përreth. Për shkak të ndyshimeve në ujë-përcjellshmërisë, ky akuifer ndahet në i) akuifer me ujë-përcjellshmëri shumë të lartë - të lartë, dhe ii) akuifer me ujë-përcjellshmëri mesare. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i këtyre dy lloj akuiferëve.

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor me ujë-përcjellshmëri shumë të lartë - të lartë: Gjendet në depozitime të llojit alevrite, rëra, zhavore. Ky akuifer shtrihet në Pellgun i Vjosës (Akuiferi i Vjosës) dhe në Pellgun e Lushnjës. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i Akuiferit të Vjosës, i cili është me rëndësi të madhe për Bashkinë e Re të Fierit.

- <u>Akuiferi i Vjosës</u>

Akuiferi i Vjosës shtrihet përgjatë luginës së Vjosës, nga fusha e Hekalit deri në grykëderdhje të lumit, në të dy krahët e tij. Bën pjesë në grupin e akuiferëve të rëndësishëm për furnizimin me ujë të popullsisë së Fierit. Nga Romasi deri në Urën e Mifolit, zhavoret e këtij akuiferi dalin në shtratin e lumit. Ndërsa në të gjithë pjesën tjetër, ato mbulohen nga mbulesa suargjilore. ***Akuiferi ushqehet nga lumi Vjosa, kryesisht në zonën nga Adbunanca në afërsi të Mifolit,*** ku zhavorroret zbulohen në sipërfaqe në shtratin e lumit Vjosa. Në pjesën tjetër të akuiferit zhavorroret mbulohen nga një shtresë argjile, gjë që vështirëson komunikimin e ujërave të lumit me akuiferin. Burim ushqimi për akuiferin shërbejnë edhe *pellgu ujëmbledhës i lumit të Vjosës*, edhe pse nuk është i rëndësishëm për lumin. Ujërat e akuiferit ndjekin rrjedhën e lumit duke u shkarkuar në detin Adriatik. Shtresat ujëmbajtëse dallohen për ujë-përcjellshmëri të lartë, sidomos në zonat Çerven dhe Kafaraj (Frakull). Qyteti i Fierit dhe i fshatrave përreth furnizohet me ujë nga pus-shpimet në zonën e Kafarajt.

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor me ujë-përcjellshmëri mesatare - të ulët: Në këtë akuifer përfshihen *pjesa fundore e lumit Seman* para derdhjes në det, konkretisht:

- zona në krahun e djathtë të lumit nga Kallmi në Mbrostar,
- zona në krahun e majtë të lumit nga Sheqi deri në Grecalli, si dhe
- zona Ndërnenas – Metaj, zona e lumit Gjanica, zona e fushës së Cakran – Gorishovës.

Ky akuifer dallohet për ujëra me cilësi të mirë me përjashtim *të zonës Ndërmenas - Metaj* ku SHGJSH-ja raporton praninë e ujërave me cilësi të keqe. Ujërat janë të pakta dhe mund të shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm për fshatra të vegjël.

Akuiferët me porozitet poro-çarje

Ashtu si dhe akuiferët me porozitet të shkrifët, edhe ky lloj akuiferi ndahet në akuifer me ujë-përcjellshmëri mesatare dhe akuifer me ujë-përcjellshmëri të ulët. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i të dyja llojeve:

Akuiferët me porozitet poro-çarje me ujë-përcjellshmëri mesatare: Në qarkun e Fierit shtrihen në një sipërfaqe rreth 225 km2 ose rreth 12% të sipërfaqes së përgjithshme. Ky akuifer ka dalje në sipërfaqe në *rajonin e Frakulles, Krapsit e Buzëmadhit (jug te Fierit).* Në këtë akuifer dallohen pakoja ranoro konglomeratike dhe pakoja e konglomerateve masive. Pakoja e fundit e konglomerateve shtrihet nga *fshati Golem në veri të Lushnjës e deri në pjesën më veriore*.

Ushqehet nga *reshjet atmosferike* të cilat pjesërisht në fushën e Lushnjës drenojnë në zhavoret aluviale të varrosura të sinklinalit të Lushnjës, si dhe në drejtim të detit Adriatik. Ujërat e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vogla.

Akuiferët me porozitet poro-çarje me ujë-përcjellshmëri të ulët: Këto depozitime shfaqen në sipërfaqe në një varg strukturash. Ndërtojnë pjesën jugore të monoklinalit të *Patosit, nga kodrat e Krapsit, Visokë e deri në Ruzhdie, bërthamën e strukturës Stan Karbunarë, krahun lindor i antiklinalit të Ballagatit, muldën e Galushit, sinklinalin e Vrapit, në Visokë, Ngjeqar, Cukalat, Kutalli*. Këto depozitime kanë përhapje të gjerë si në sipërfaqe ashtu dhe në thellësi.

Ushqehet kryesisht nga reshjet dhe shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteve të vogla. Në thellësi këto depozitime janë takuar pothuajse në të gjithë zonën me shpime të naftës e gazit.

Akuiferët me porozitet çarje-karst

Këta akuiferë përfaqësohen nga antiklinali i *Kremenarës (mallakaster) dhe antiklinali i Shëndëllisë (Finiq-Ballsh).* Ujëmbajtja e tyre është e konsiderueshme. Fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar. Burimi më i madh që del nga ky akuifer është burimi i Poçemit. Ushqimi kryesor i këtij akuiferi janë reshjet atmosferike. Ky burim mendohet se ***ushqehet nga lumi Vjosa***. Dallohet për ujëra me cilësi shumë të mirë.

Jo akuiferë

Depozitime detare, lagunore, kënetore kryesisht rëra, argjila, alevrite, torfa, mbetje organike në qarkun e Fierit shtrihen në pjesën perëndimore të kodrave të Kryekuqit e Ardenicës nga Shënepremtja, Divjaka në Karavasta, Ndërnenas e deri Topojë e Pojan. Ndërsa në pjesën lindore shtrihen në jugperëndim të qytetit të Lushnjës si dhe në fushën e Semanit në të dy krahët e lumit nga Toshkëzi në Mbrostar, Arapaj e deri në Sheqisht në jug. *Ujërat e këtyre depozitimeve nuk kanë rëndësi për pirje*.

- ***Problematikat e pellgjeve ujore nëntokësore (akuiferëve)***

Në 20 vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia dhe industria) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët. Për më tepër, pjesa e Ultësirës Perëndimore të vendit tonë ku bën

pjesë edhe territori i Bashkisë së re të Fierit është zonë me industri të theksuar naftënxjerrëse, zhvillim të bujqësisë së shkallës dhe zona të urbanizuara që kanë çuar në ndotjen e lumenjve kryesorë (lumenjtë e Basenit të Semanit). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet depërtimit të ujërave të lumenjve nëpër akuiferë. Ndotja e akuiferëve që shërbëjnë për furnizimin me ujë të popullsisë përbën rrezik për shëndetin e njeriut dhe banorëve. Më poshtë paraqiten problemet kryesore të ujërave nëntokësore të Qarkut të Fierit (ndotja dhe mbishfrytëzimi) dhe në veçanti të Akuiferit të Vjosës dhe Akuiferit të Semanit me shtrirje përgjatë lumenjve përkatës.

***Mbishfrytëzimi i ujërave/mungesa e njohjes së kapacitet ujor të shfrytëzuar*:** Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacit të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi etj[115]. Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan manaxhimi gjë që do të bënte të mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit të tyre furnizues. SHGJSH-ja[116] raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Fierit ka ardhur si rezultat i: i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi sidomos në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale, ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose ilegale për shfrytëzimin e ujit për bujqësi dhe industri, iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë me presion dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Vetëm në Bashkinë e re të Fierit, sipas llogaritjeve të bëra kohët e fundit,[117] për plotësimin e nevojave të popullsisë së bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, shfrytëzohet një sasi prej 23,484.8m^3 ujë/orë ndërkohë që kërkesa aktuale është 1517.3m^3/orë. Pra, nga pus-shpimet ka një mbishfrytëzim total prej 1,870m3/orë[118]. Megjithatë, shifrat e sakta të shfrytëzimit me ujë nuk njihen për arsye se një pjesë e mirë e popullsisë nuk mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë. Nga një total prej 194,023 banorë, rrreth 7% e popullsisë (13,587) nuk kanë rrjet furnizimi me ujë të pijshëm. Zonat pa lidhje me rrjetin janë kryesisht zonat rurale dhe përfshijnë fshatrat e mëposhtme:[119]:

Tabela 14. Fshatrat pa sistem furnizimi me ujë të pijshëm.

Nr.	Komuna	Fshati	Sistemi i furnizimit me ujë	Popullsia e përditësuar
1	Komuna Dërmenas	Pojan, Kryegjatë, Havaleas dhe Radostimë, Sulaj dhe Muçaj	Burime private	4,092
2	Komuna Portëz	Kraps, Mbyet, Patos Fshat	Burime private	5,182
4	Komuna Cakran	Tojkan	Burime private	221

Burimi: USAID 2014[120]

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm në zonat rurale i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje vetjake të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme[121]. Këto burime apo pus-shpime, përveç se hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogjeologjike, e bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve[122].

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve ndërkokrrizorë dhe karstikë shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të jashtëligjshme[123]. Si rrjedhojë, sasia totale

e ujit që shfrytëzohet për çdo akuifer për qëllime të ndryshme nga sektorët e ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferët (hyrje dhe dalje të ujit).

***Kripëzimi i akuiferit të Vjosës nga depërtimi i ujit të detit*:** Në vitet e fundit, SHGJSH-ja ka raportuar fenomenin e depërtimit të ujërave të kripura të detit në Akuiferin kuaternar të Vjosës. Ky fenomen raportohet të ketë prekur rreth 45-53 % të sipërfaqes së tij duke ndikuar ndjeshëm cilësinë e ujërave të akuiferit, sidomos në pus-shpimet Kafaraj ku është vënë re përmbajtje e lartë e klorit mbi vlerat e lejuara (rreth 293 mg/l kundrejt 250 mg/l që është vlera e lejuar) si pasojë e këtij fenomeni. Vlen të përmendet se pus-shpimet e Kafarajt furnizojnë me ujë të pijshëm qytetin e Fierit dhe fshatrat përreth. Sipas SHGJSH-së, depërtimi ka ndodhur si rrjedhojë e mbishfrytëzimit dhe shfrytëzimit të ujërve nëntokësore, sidomos në krahun e majtë të lumit Vjosa.

Ndotja e akuiferëve (e Akuiferit të Vjosës): Në Bashkinë e Fierit, akuiferët ndërkokrrizorë të gjendur drejtpërdrejt nën lumenj janë ndotur. SHGJSH-ja ka raportuar ndotjen e Akuiferit të Vjosës [124] me metale të rënda (Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr) dhe përbërës të azotit (NH_4 dhe NO_2), kryesisht në zonat Kafaraj e Pishë-Poro. Në të tre stacionet e monitoruara ujërat janë shumë të forta, veçanërisht në Kafaraj e Pishë-Poro dhe të forta në Novoselë e Pishë-Poro[125]. Akuiferi dallohet edhe për përmbajtje të ulët oksigjeni në disa raste dhe me ujëra të forta dhe shumë të forta gjë që vërteton praninë e disa metaleve të rënda në sasi të konsiderueshme në akuifer. Shqetësues është fakti se përmbajta e metaleve të rënda luhatet nga vlerat e lejuara deri në tejkalimin e permbajtjes maksimale të lejuar (PML). Më poshtë paraqitet një përmbledhje e parametrave problematikë të nxjerrë në pah gjatë monitorimit të AKM-së në Akuiferin e Vjosës**.**

Tabela 15. Akuiferi i Vjosës: parametrat problematikë në tre pus-shpimet e ti: Novoselë, Kafaraj dhe Pish-Poro[126].

Akuiferi i Vjosës		
Stacioni i monitoruar	**Parametri i monitoruar**	**Përmbajtja**
Kafaraj	Fortësia e përgjithshme (Fp)	Mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm
Pish - Poro	Mineralizimi i përgjithshëm (Mp)	Mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm
Kafaraj	Natriumi (Na)	Mbi Përmbajtjen Maksimale të Lejuar (PML)
Pish - Poro	Mbetja e thatë (Mth)	Mbi normën e lejuar
Kafaraj e Novoselë	Kalciumi (Ca)	Me vlera nga ato të rekomanduara deri nën PML-në.
Novoselë, Kafaraj, Pishë - Poro	Magnezi (Mg)	Mbi PML
Kafaraj e Pishë-Poro	Hekuri (Fe)	Me vlera nga ato të rekomanduara deri mbi PML
Novoselë e Kafaraj	Amoniaku (NH_4)	I pranishëm në të tre monitorimet
Novoselë, Kafaraj, Pishë - Poro	Sulfatet (SO_4)	Mbi rekomandimin por nën PML.
Novosele, Pishë - Poro	Nitritet (NO_2)	Gjendet nën PML
Kafaraj	Nitritet (NO_2)	Mbi normë e mbi PML (në fazen e tretë të monitorimit)
Pishë - Poro	Permbajtja O_2	Nën normën e lejuar
Novoselë	Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr	Me vlera nga ato të rekomanduara deri në PML

Burimi: SHGJSH raportuar nga AKM,[127] Përpunoi: Co-PLAN

Siç vihet re në tabelën sipër, ndotja vihet re në të tre pus-shpimet e monitoruara: ***Novoselë***, ***Pishë-Poro*** dhe ***Kafaraj***. Në Pishë-Poro e Kafaraj gjenden përbërësit e azotit (nitritit NO_2 dhe

amoniakut NH_4) prania e të cilëve mund të shpjegohet me përdorimin e plehrave kimike në bujqësi ose në aktivitete të tjera. Bujqësia e kultivuar në zonat fushore përreth lumit Vjosë (në Fushën e Vjosës) në vitet e fundit ka çuar edhe në rritjen e përdorimit të plehrave kimike të pasura me azot, fosfor, sulfate etj. të cilat kanë aftësinë të ndikojnë në ndotjen e drejtpërdrejtë të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore. Përbërësit e azotit dhe sidomos nitratet janë plehra kimikë që përfundojnë nëpër burime ujore si rrjedhojë e vetive të tyre lëvizëse të larta. Për rrjedhojë, përdorimi i tyre në mënyrë të papërshtatshme (në kohë me shi apo në sasi më të mëdha se nevojat e bimëve) çon në rrëshqitjen e tyre nga toka në ujë duke shkaktuar ndotjen e burimeve sipërfaqësore dhe, nëpërmjet tyre, edhe burimet nëntokësore të ujit. Për më tepër, në akuifer vihet re edhe mungesa e oksigjenit, kryesisht në shpimin Pishë-Poro, si dhe prania e metaleve të rënda Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr.

Edhe pse elementë si Mg, Cl, SO4, gjenden në kushte normale nëpër akuiferë në varësi të përbërjes së shkëmbinjve ku shtrihet akuiferi, mbetet shqetësues niveli i lartë i të gjitha mikroelementeve Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, sidomos në push-shpimin ***Novoselë***. Përmbajtja e mikroelementëve në akuifer luhatet nga brenda normës deri në përmbajtjen maksimale të lejuar (mbi normën e rekomanduar).

Vlen të theksohet se disa nga mikroelementët e monitoruar: Pb, Ni dhe Cr janë lëndë kancerogjene. Prania e tyre në akuifer mbi normën e lejuar përbën rrezik serioz për shëndetin e ***100,690 banorëve*** që furnizohen me ujë nga Akuiferi i Vjosës e që janë banorët e qytetit të Fierit dhe të komunave Cakran, Topojë, Levan, Frakull dhe Dërmenas.

Ndotja më e theksuar në këtë akuifer është raportuar në ***Pishë-Poro*** dhe ***Kafaraj***. Për shkak të ndotjes, SHGJSH-ja ka rekomanduar ***mbylljen e pus-shpimit Pishë Poro*** në Akuiferin e Vjosës dhe ***ndërprerjen e lejeve për shpime*** hidrogjeologjike pranë stacionit të shfrytëzimit ***Kafaraj***.

Tabela 16. Vendndodhja e pus-shpimeve në Bashkinë e re të Fierit sipas ujësjellësve

Nr.	Qyteti / Komuna	Nr. i popullsisë	Ujësjellësi	Fshatrat e furnizuara	Nr. Pop. furnizuar	Pus-shpimet: Vendi
1	Qyteti Fier	55,845	UK Fier	Qyteti Fier	55,845	Pellgu ujëmbajtës i Kafarajt, Baseni i Vjosës (11.5km në jug të Fierit, 9km në perendim të zonës së Lumit të Gjanicës).
2	Komuna Cakran	16,692	Ujësjellësi i Patosit	Fshatrat Varibob, Vjosë, Kreshpan dhe Gjorgos (dhe Patos)	5,089	3 pus-shpime në Varibob, rreth 1km në lindje te fshatit Varibob
			Ujësjellësi Gjanç-Selishte	Fshatrat Cakran, Cakran i Ri, Vreshtas, Gorishovë, Buzmadh, Floq dhe Gjonçë	10,995	3 pus-shpime pranë lumit Vjosë rreth 2km në perëndim të fshatit Gjonçë
			Ujësjellësi Hambar	Hambar	608	1 pus-shpim në lindje të fshatit Hambar pranë lumit Vjosë
3	Komuna Mbrostar Ura	10,519	Ujësjellësi i Varri-Vajkan-Kallm	Verri, Vajkan, Kallm i Madh dhe Kallm i Vogel	5,168	2 pus-shpime në Petovë Bishti
			Ujësjellësi Mbrostar-Petovë	Mbrostar, Petovë	5,351	1 pus-shpim pranë lumit Seman, në mesin e dy fshatrave Mbrostar dhe Petovë

4	Komuna Libofshë	10,397	Ujësjellësi Rajonal Libofshë	Adriatik, Hasturkas, Ndërmenas, Havaleas, Gozhdaras, Daullas, Agimi, dhe Metaj	5,691	Elektropompa vanaj (Xhepaj) stallë në anën tjetër të hekurudhës nga 2 pus-shpime
			Ujësjellësi i Libofshës	Libofshë	2,526	1 pus-shpim në stallë në anën tjetër të hekurudhës
			Ujësjellësi i Rreth Libofshës	Rreth Libofshë	1,801	1 pis-shpim pranë fshatit Rreth Libofshë
			Ujësjellësi Vanaj	Vanaj	379	1 pus-shpim në qendër të fshatit Vanaj
5	Komuna Qender	12,337	Ujësjellësi Çlirimi	Çlirimi	2,814	1 pus-shpim në afërsi të fshatit Radostimë
			Ujësjellësi Mujalli	Mujalli	727	1 pus-shpim në lindje të fshatit Mujalli, 1.4 km pranë lumit Seman, në afërsi të Petovë Gjokdesh
			Ujësjellësi Vadhizë	Vadhizë	879	1 pus-shpim në afërsi të fshatit Vadhizë
			Ujësjellësi Fier	Gracalli, Daullas, Afrimi i Ri, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza dhe Romet	7,917	Pellgu ujëmbajtes i Kafarajt, Baseni i Vjosës (11.5km në jug të Fierit, 9km në perendim të zonës së lumit të Gjanicës).
6	Komuna Dermenas	12,534	Ujësjellësi Dermenas-Hoxharë	Dermenas, Hoxharë	2,346	1 pus-shpim në lindje të fshatit Pojan
			Ujësjellësi Hamil-Baltez	Hamil-Baltez, Muçaj dhe Sulaj	2,932	2 pus-shpime në veri pranë fshatit Radostimë
			Ujësjellësi Pishë Poro-Seman	Dorëzezë e Re, Povelçë	3,165	Pus-shpimet pranë lumit Seman në afërsi të fshatit Pishë-Poro
7	Komuna Topojë	7,599	Ujësjellësi Pishë Poro-Seman	Topojë, Seman, Gjokalli, Sheq Marinas, Sheq, Fushë, Grykë, Seman i Ri, Kavaklli	7,599	Pus-shpimet pranë lumit Seman në afërsi të fshatit Pishë-Poro
8	Komuna Levan	17,557	Ujësjellësi Peshtan i Madh	Peshtan i Madh me një popullsi prej 944 banorë		1 pus-shpim rreth 900m në perëndim të fshatit Peshtan i Madh
			Ujësjellësi Ferras	Ferras	1,987	1 pus-shpim pranë fshatit Ferras
			Ujësjellësi Qarr	Qarr	1,137	1 pus-shpim pranë fshatit Qarr
			Ujësjellësi Martine	Fshatin Martine	747	1 pus-shpim pranë fshatit Martine
			Ujësjellësi Shtyllas	Shtyllas	1,418	1 pus-shpim rreth 1.3km në veri të fshatit Peshtan i Madh
			Ujësjellësi Bishan	Bishan	896	1 pus-shpim pranë fshatit Bishan
			Ujësjellësi Fier	Peshtan i Vogel	651	Pellgu ujëmbajtes i Kafarajt, Baseni i Vjosës (11.5km në jug të Fierit, 9km në perëndim të zonës së lumit të Gjanicës).

			Ujësjellësi Pishe-Poro-Seman	Pishë-Poro, Bashkim, Boçovë	3,661	Pus-shpimet pranë lumit Seman, në afërsi të fshatit Pishë-Poro
9	Komuna Frakull	10,557	Ujësjellësi Fier	Komuna e Frakullës	10,557	Pellgu ujëmbajtës i Kafarajt, Baseni i Vjosës (11.5km në jug të Fierit, 9km në perëndim të zonës së lumit të Gjanicës).
			Ujësjellësi Frakull e Vogël	Frakull e Vogël	1,257	1 pus-shpim pranë lumit Vjosë, në afërsi të fshatit Ada Musalla
10	Komuna Portez	11,359	Ujësjellësi Portëz	Fshatin Portëz	3,824	1 pus-shpim pranë lumit Gjanicë afër fshatit Mbyet
						1 pus-shpim në veri pranë fshatit Portëz.
			Ujësjellësi Lalar	Lalar me 1,072		1 pus-shpim pranë lumit Gjanicë afër fshatit Lalar
			Ujësjellësi Mbyet	Mbyet (70% popullsisë)	700	1 pus-shpim pranë lumit Gjanicë rreth 400m larg fshatit Mbyet
			Ujësjellësi Fier	Mbyet (30% popullsisë)	300	Pellgu ujëmbajtës i Kafarajt, Baseni i Vjoses (11.5km në jug të Fierit, 9km në perendim të zonës së lumit të Gjanicës).

Burimi: USAID[128]

- ***Burimet e ndotjes së akuiferëve***

Mungesa e zonave higjieno-sanitare: Burimet e ndotjes së akuiferit janë të shumta. Megjithatë, SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë si përreth pus-shpimeve të ligjshme ashtu edhe përreth pus-shpimeve të paligjshme. Pus-shpimet e ligjshme janë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të pupullsisë dhe nga industria. Një numër i madh i tyre gjenden përgjatë luginës së Semanit dhe Vjosës dhe pellgjeve ujëmbledhëse të tyre. Pus-shpimet e jashtëligjshme gjenden gjatë gjithë territorit, sidomos në zonat rurale që nuk janë të lidhura me rrjetin e furnizimit të ujit (rreth 7% e popullsisë së Fierit nuk furnizohet me ujë të pijshëm)[129]. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm[130] ose nëpërmjet pus-shpimeve. Për sa i përket pus-shpimeve industriale, numri i pus-shpimeve, sasia e ujit që pompohet dhe gjendja e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve industriale nuk njihet. Përveç kësaj, në Bashkinë e Fierit mungojnë edhe të dhëna rreth përdorimit të ujit nëntokësor nga industria e naftës.

Ky shfrytëzim i ujërave nëntokësore në mënyrë jo-profesionale si dhe të pakontrolluar si nga popullsia ashtu edhe nga industria rrezikon i) uljen e prurjeve në stacionet e pompimit, si dhe ii) prishjen e cilësisë së ujërave të akuiferëve të Qarkut Fieri duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi[131]. Mbetet fakt se për asnjërin nga këto pus-shpime (individuale, të ujësjellësve apo industriale) pavarësisht nëse janë të ligjshëm apo jo, nuk dihet nëse përreth tyre ka zona të mbrojtjes higjieno-sanitare. Mungesa e zonave higjieno-sanitare bën të mundur që e gjithë ndotja përreth pus-shpimeve të kalojë drejtpërdrejtë në akuifer.

***Ndotja e shkaktuar nga mbishfrytëzimi i ujërave të akuiferit*:** Përveç mungesës së zonave higjieno-sanitare dhe ndotjes së lumit Seman e Vjosë, SHGJSH-ja thekson se ndotja e ujërave të akuiferëve ndodh edhe për shkak të mbishfrytëzimit të ujërave të tyre. Ky mbishfrytëzim rrezikon të përkeqësojë cilësinë e këtij akuiferi për shkak se një veprim i tillë shton kripëzimin e ujit mbi normat e lejuara për pirje.

***Ndotja e akuiferëve nëpërmjet ujit të lumenjve Seman e Vjosë*:** Një tjetër burim ndotjeje për akuiferët e Qarkut Fier mbeten edhe lumenjtë Seman e Vjosë të cilët shërbejnë si burim ushqyes për akuiferët e shtrirë përgjatë rrjedhës së tyre. Burimi kryesor i ndotjes sipërfaqësore të Akuiferit të Vjosës, për shembull, mbetet vetë lumi Vjosa për shkak të lidhjes së mirë hidraulike që kanë ujërat e tij me akuiferin në disa zona ku zhavorroret e akuiferëve dalin në sipërfaqe (nuk kanë të mbivendosur një shtresë argjile që të shërbejë si shtresë mbrojtëse siç ndodh në Akuiferin e Vjosës nga Romasi deri në Urën e Mifolit ku zhavoret e këtij akuiferi dalin në shtratin e lumit)[132]. Për këtë arsye, mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Vjosë nga ndotja në njëzet vitet e fundit mund të ketë shkaktuar ndotjen e këtij akuiferi.

Një tregues i mundshëm i ndotjes së Akuiferit të Vjosës nga lumi Vjosa është prania e përbërësve të azotit (*NH_4, NO_2*) dhe e disa metaleve të rënda (*Ni, Pb, Cu e Cr*) si në ujërat e lumit Vjosa[133] ashtu edhe në ato të Akuiferit të Vjosës[134]. Duhet theksuar se Pb[135], Cd, Ni dhe Cr janë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Pb[136] përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve sepse mund të shkatërrojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme, dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Cd njihet si lëndë kanceroze[137] dhe shkakton sëmundje të zemrës, dëmton zhvillimin e organeve, të sistemit tretës, nervor, sistemit të frymëmarrjes etj. Ni[138] është klasifikuar si lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut sepse dëmton sistemin kardiovaskular, imunitetin, rrugët e frymëmarrjes etj. Ndërsa Cr[139] (*chromium* ose krom) është klasifikuar si lëndë kanceroze për njeriun[140]. Doza të larta kromi shkatërrojnë sistemin imunitar, veshkat, dhe rrugët e frymëmarrjes.

Duke qenë se ujërat e lumit Vjosë shërbejnë si burim për Akuiferin me të njëjtin emër, dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit të Vjosës me shtrirje përgjatë lumit Vjosë në disa zona është i lartë (nga Romasi deri në Mifol, për shembull)[141], derdhja e ujërave të ndotura në Vjosë përbën element ndotjeje të Akuiferit. Sipas SHGJSH-së[142], rreziku i ndotjes së Akuiferit i Vjosës rrezikon ndotjen nëpërmjet vetë lumit Vjosa si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse në disa zona[143]. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta e të lëngëta si dhe mungesa e marrjes së masave për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të Vjosës dhe Semanit nga ndotja urbane dhe industriale mund të ketë shkaktuar ndotjen e akuiferëve përkatës të lumenjve.

***Ndotja e akuiferëve nga shfrytëzimi i inerteve lumore të Semanit e Vjosës*:** Lumenjtë Seman dhe Vjosë ushqejnë me ujë akuiferët përkatës në Qarkun e Fierit. Si rrjedhojë, dëmtimi i lumenjve ndikon drejtpërdrejtë në dëmtimin e akuiferëve. Sipas SHGJSH-së,[144] shfrytezimi i zhavorreve të lumenjve dëmton rëndë burimet ujore, si nga ana sasiore, ashtu edhe cilësore sepse zvogëlon zonën e ushgimit të akuiferëve dhe prish regjimin e ujërave nëntokësore në zonat e gërrmimeve. Për fat të keq, në vendin tonë lumenjtë janë shfrytëzuar në të gjitha mënyrat e mundshme. Vjosa dhe Semani janë shfrytëzuar vazhdimisht në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme për materialin e tyre inert në rrjedhën e mesme dhe të poshtme (foto shfrytëzim të paligjshëm). Deri më sot, janë 14 aktivitete të regjistruara që ushtrojnë veprimtarinë e tyre përgjatë lumit Seman e Vjosë vetëm në Qarkun e Fierit me pasoja të rënda për akuiferët dhe bashkinë (përmbytje të zonave përreth lumit duke çuar në humbje të tokave bujqësore si dhe ndotje të ujërave të akuiferit për shkak të prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjikë) që ende duhen përcaktuar. Aktiviteteve të ligjshme i shtohen edhe ato të paligjshme, numri dhe vendndodhja e të cilëve mbetet e paditur.

***Ndotja nga karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë*:** Në Rrethin e Fierit janë dhënë disa leje mjedisore për shfrytëzimin e gëlqerorëve, rërës bituminoze, dhe argjilës. Përveç prishjes së peizazhit në rastet kur gërmimet janë sipërfaqësore, gëlqerorët ndotin mjedisin me retë e pluhurit që ngrenë gjatë aktivitetetit të tyre. Sipas SHGJSH-së, "reja e pluhurit që

krijohet nga ky aktivitet ndot në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme ajrin, ujërat sipërfaqësorë, tokat bujqësore"[145].

Më poshtë është sjellë tabela e plotë e aktiviteteteve minerare gëlqerore në rrethin e Fierit. Nga ky aktivitet janë dëmtuar gjithsej 2.5km^2 sipërfaqe. Numri i aktiviteteve të tilla që nuk janë më në veprim dhe i sipërfaqeve të përdorura dhe të braktisura nuk njihet.

Tabela 17. Karrierat për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë në Bashkinë Fier.

Rrethi	Data	Lloji i mineralit	Km^2	Tipi i lejes
Fier	20.08.2003	Rërë bituminoze	1.5540	Shfrytëzimi
Fier	06.12.2007	Argjilë	0.0500	Shfrytëzimi
Fier	16.09.2008	Argjilë	0.0600	Shfrytëzimi
Fier	04.06.2009	Rërë bituminoze	0.3900	Shfrytëzimi
Fier	28.12.2009	Konglomerat	0.0270	Shfrytëzimi
Fier	19.11.2012	Gëlqeror	0.0319	Shfrytëzimi
Fier	01.07.2013	Rërë bituminoze	0.4240	Shfrytëzim

Burimi: Ministria e Industrisë dhe Energjisë, 2015

***Ndotje nga industria e naftës*:** Zakonisht, një ndër rreziqet më të mëdha që i kanoset mjedisit nga industria e naftës është rreziku i ndotjes së akuiferëve. Në rast ndotjeje, pastrimi i ujërave të akuiferëve është proces tejet i kushtueshëm, ose edhe i pamundur. Duke qenë se ujërat e akuiferëve lëvizin shumë ngadalë, atëherë duhen dhjetëvjeçarë përpara se një ndotës të pastrohet ose të migrojë në zona të tjera. Një shembull i tillë është rasti i nitrateve ose pesticideve e 1-2-3-Trichloropropane. Kjo e fundit nuk është përdorur që në vitin 1970. Megjithatë vazhdon të gjendet nëpër akuiferë[146].

Në Bashkinë e Fierit, industria e naftës është mjaft aktive (për më shumë informacion, shihni seksionin e zonave të nxehta mjedisore). Aktivitetet përfshijnë nga shpimet për kërkim nafte deri në nxjerrje dhe përpunim të saj, ndaj edhe ndotja e ujërave nëntokësore nga industria e naftës nuk është e pazakontë edhe pse nuk ka të dhëna të mjaftueshme.

Pus-shpimet janë përqendruar kryesisht në ***Akuiferin me porozitet ndërkokrrizor me ujë-përcjellshmëri mesatare-të ulët***. Sipas SHGJSH-së, në këtë akuifer përfshihen zonat e mëposhtme:

- pjesa fundore e lumit Seman para derdhjes në det që përfshin zonën në krahun e djathtë të lumit ***nga Kallmi në Mbrostar***,
- zona në krahun e majtë të lumit nga Sheqi deri në Grecalli, dhe
- zona Ndërnenas-Metaj, zona e lumit Gjanica, zona e fushës së ***Cakran-Gorishovës***, zona e fushës së Kutës dhe përroit të Pavlit në strukturën e Kremenarës[147].

Nga hartëzimi i objekteve në territorin e Bashkisë Fier, pus-shpimet janë përqendruar në zonën Kallm, në anën e djathtë të lumit Seman ***nga Kallmi në Mbrostar.*** Sipas SHGJSH-së, rezervat ujore të akuiferëve të cekët në këtë zonë janë të pakta. Megjithatë, ato mund të shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrave të vegjël nëpërmjet puseve ose burimeve që rrjedhin nga ky akuifer. Zona e dytë është zona në jug të vendburimit të naftës në Kreshpan. Në jug të Kreshpanit ndodhet akuiferi shtrirja e të cilit përkon me zonën e fushës së ***Cakran-Gorishovës***

Në zonën ***nga Kallmi në Mbrostar*** në Bashkinë e Fierit, shpimet për naftë kanë takuar disa shtresa ujëmbajtëse[148] ose pus-shpimet janë kryer drejtpërdrejtë në akufer. Kjo vihet re nga dixhitalizimi i pus-shpimeve dhe akuiferëve në Bashki. Për zonën Kreshpan, nuk të dhëna rreth vendndodhjes së pus-shpimeve.

Figura 62. Harta e puseve të naftës dhe akuiferëve në Qytetin e Fierit.



Burimi: SHGJSH DHE Bashkia Fier, Punoi: Co-PLAN

Ndërsa ndotja e ujrave sipërfaqësore nga nafta është e dukshme, ndotja e ujërave nëntokësore është vështirë që të përcaktohet, për shkak të mungesës së të dhënave ose të dhënave të pakta dhe shpeshherë jo të plota. Teorikisht, industria e naftës, për vetë natyrën e aktivitetit të saj, gjatë zhvillimit të aktiviteteteve të industrisë mund të ndotë akuiferët në disa mënyra në rast se nuk merren masat e duhura teknike për mbrojtjen e tyre. Më konkretisht, industria e naftës mund të ndotë nëpërmjet hapjes së drejtpërdrejtë të puseve në burime ujore nëntokësore, rrjedhjes së lëndës së lëngshme dhe të *ujit shtresor* gjatë aktivitetit, migrimit nëntokësor të ujit shtresor dhe gazrave, përdorimit të ujit në kohëra (ose në zona) kur uji nuk është i bollshëm, dhe trajtimit të papërshtatshëm të ujërave industriale dhe shkarkimeve të tyre në burime ujore.

Ndotja nëpërmjet pus-shpimeve: Me qëllim shmangien e ndotjes së tokës dhe ujërave, puset e naftës vishen me shtresa të ndryshme (cases), ndër të cilat edhe një shtresë që shërben për parandalimin e rrjedhjeve të pusit dhe depërtimin e tyre në rrethinat e tij (në tokë ose ujë) gjatë aktivitetit naftënxjerrës. Për të njëjtin qëllim, kur puset dalin jashtë funksionit, si në rastet kur kompania vendos se nuk janë me leverdi ekonomike, puset mbyllen dhe izolohen.

Në rastet kur puset shpohen në thellësi në prani të një akuiferi siç ka ndodhur në Akuiferin e Semanit në Fier, puset e naftës kalojnë nëpër akuifer duke e ndotur atë me ujë të kripëzuar (me kripëra /substance kimike të ndryshme), hidrokarbure dhe materiale të tjera toksike. Ndikimi i puseve të industrisë së naftës në këtë akuifer në Bashkinë Fier dhe në zona të tjera në vendin tonë, mbetet ende i panjohur për shkak të mungesës së të dhënave. Megjithatë,

ekziston mundësia që Akuiferi i Semanit në Kallm dhe Akuiferi i Vjosës në jug të Cakranit (në zonën naftëmbajtëse Kreshpan) të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë viteve. Vetëm vendndodhja e puseve në akuifer krijon mundësinë për ndotje të ujërave të akuiferit në rast se nuk janë ndjekur rregulla rigoroze sipas standardeve teknike më të mira për veshjen anësore të pusit. Mundësia e një ndotjeje të trashëguar shtohet më tej po të mendojmë se teknologjia e mëparshme e përdorur nga Kompania Albpetrol për shfrytëzimin e zonës naftëmbajtëse të Fierit ka qenë e vjetëruar.

Për më tepër, ***në vendin tonë mungon edhe legjislacioni i posaçëm që rregullon hapjen e puseve pranë ose në akuifer*** gjë që mund të ketë stimuluar kompanitë të anashkalojnë rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në ligjin nr. 111/2012.[149] që përcakton Shërbimin Gjeologjik Shqiptar si autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e burimeve ujore deri në një nivel të caktuar. SHGJSH-ja përcakton masat për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore, si dhe miraton dhënien e lejeve për pus-shpime në ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës. Megjithatë, asnjë ligj nuk shprehet në lidhje me mbrojtjen e Akuiferëve nga pus-shpime të tipit industrial (instalime të përhershme siç janë puset e naftës), duke lënë kështu hapësirë për abuzime. E gjithë kjo ndodh në kundërshtim me ligjet dhe praktikat e vendeve më të zhvilluara. Në SHBA, për shembull, përpara se një kompani të fillojë aktivitetin e saj për nxjerrjen dhe prodhimin e naftës, prodhimin e energjisë gjeotermale dhe nxjerrjen e mineraleve, kërkon leje për përjashtimin e akuiferit më të afërt nga lista e trupave ujorë të përdorur për furnizimin me ujë të popullsisë[150]. Në këtë mënyrë, industria, e ndërgjegjshme se veprimtaria e saj mund të shkaktojë ndotje të akuiferit dhe si rrjedhojë rrezik për shëndetin e banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer, nuk ndiqet penalisht për dëmtimin e akuiferëve, dhe sigurisht nuk vepron në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve Ujore të Përdorura për Furnizim të Popullsisë me Ujë.[151] Mbetet fakti se akuiferi i përjashtuar nuk shërben më si burim ujor për pije.

Me fjalë të tjera, mungesa e një kuadri legjislativ të plotë që synon mbrojtjen dhe përmirësimin e burimeve ujore nëntokësore lë hapësirë për industrinë në përgjithësi dhe kompanitë e naftës në veçanti të përcaktojnë dhe respektojnë standardet e tyre.

Ndotja e ujërave nëntokësore nëpërmjet puseve të ri-injektimit të ujërave shtresorë:Gjatë prodhimit të naftës dhe gazit prodhohet një sasi e konsiderueshme ujërash të ndotura të cilat mund të përmbajnë edhe metale helmuese dhe lëndë radioaktive[152]. Shpesh, këto ujëra janë edhe më të kripura se ujërat e detit. Për këtë arsye, në qoftë se nuk manaxhohen siç duhet, përbëjnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut[153].

Për shmangien e ndotjes që mund të shkaktonte vend-depozitimi i këtyre ujërave në sipërfaqe, duke filluar që në vitet 1930,[154] ujërat e ndotura të industrisë së naftës janë ri-injektuar në puse me qëllim shmangien e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë. Ri-injektimi i tyre nënkupton rikthimin ose hedhjen e ujit të dalë nga puset e naftës (ujit shtresor) pas shpimit ose gjatë prodhimit të naftës, përsëri në nëntokë. Ri-injektimi i ujërave të prodhuar nga industria e naftës dhe e ujërave shtresorë është praktikë e ndjekur edhe sot.[155] Në Bashkinë Fier, ri-injektimi është konfirmuar të ndodhë si praktikë nga Kompania Bankers. Krahas shpimeve, në vitin 2015, Bankers kishte planifikuar edhe kalimin e 20% të puseve në puse për ri-injektim.

Për shkak të rrezikut që paraqet për ndotjen e ujërave nëntokësore nga një migrim nëntokësor të mundshëm të ujit të prodhuar dhe shtresor dhe të gazrave, [156] ri-injektimi në vende të ndryshme të botës rregullohet me ligj.[157] Fatkeqësisht, në vendin tonë ri-injektimi nuk rregullohet me ligj. Si rrjedhojë, kompanitë nuk janë të detyruara të ndjekin rregulla

specifike gjatë ri-injektimit përveç praktikave të mira të punës të kompanisë. Për këtë arsye, mund të thuhet se në Bashkinë e Fierit, ashtu si edhe në bashki të tjera ku operon industria e naftës në vend, mbetet i panjohur *i) fakti nese ri-injektimi mund të kryhet në shtresat shkëmbore të bashkisë, ii) vendndodhja e puseve të ri-injektimit, iii) numri i tyre, iv) teknologjia e përdorur për veshjen e puseve v) gjendja dhe kushtet e puseve të ri-injektimit, vi) ndikimi i tyre në Akuiferët e Semanit (në Kallm) dhe Vjosës (Gorishan) etj., si dhe në ujërat nëntokësore.*

Ndotja e trashëguar shkaktuar nga mungesa e gropave ekologjike: Gropat ekologjike/vaskat e naftës në vendin tonë janë *landfill*e specifike ku depozitohen materialet e përdorura gjatë aktivitetit të nxjerrjes së naftës. Zona e Fierit, edhe pse ka një aktivitet të theksuar të industrisë së naftës, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2014, nuk ka një gropë ekologjike në të cilën të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit të naftës së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, supozohet se produktet e naftës janë hedhur së bashku me mbetjet urbane duke ndotur tokën dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

Ndotja e mundshme e ujërave nëntokësore të akuiferëve të thellë nga industria e naftës: Në vendin tonë, studimet rreth ujërave të akuiferëve janë përqendruar rreth akuiferëve të cekët (më pak se 200m të thellë). Studimet rreth akuiferëve të thellë mungojnë.

Nga bisedat në terren me operatorë të naftës[158]rezulton se në vendin tonë, industria e naftës shfrytëzon ujërat e akuiferëve të thellë argjilorë (nën 200m thellësi) për nevojat e saj gjatë zhvillimit të aktiviteteve. Për fat të keq, është e pamundur të përcaktohet ndikimi i industrisë në këto ujëra, ndotja, qëndrueshmëria, rreziqet në shtresat e tokës etj.

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Fier rezulton se grupi i puseve të Kallmit është shpuar drejtpërsëdrejti në akuifer. Duke patur parasysh aktivitetin intensiv të naftës në të shkuarën dhe teknologjinë e vjetëruar të përdorur për shpimet në të shkuarën, si dhe duke patur parasysh se shumë puse naftë kalojnë nëpër akuiferë, ekziston mundësia që Akuiferi i Semanit në Kallm dhe Akuiferi i Vjosës në Kreshpan të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë viteve të aktivitetit të saj. Dyshime të thella mbeten edhe për ndotjen e akuiferëve të thellë (nën 200m thellësi) uji i të cilëve shfrytëzohet gjerësisht nga industria e naftës.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin e Semanit dhe të Vjosës është *mungesa e monitorimit të ujërave të këtyre akuiferëve për ndotje nga industria e naftës edhe pse kjo zonë është me rëndësi të veçantë për industrinë e hidrokarbureve*. Industria e naftës ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e Akuiferit të Semanit përdoren me ujë nga disa fshatrat dhe Akuiferi i Vjosës përdoret për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët, është i domosdoshëm monitorimi i të dy akuiferëve për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite. Ndotja e Akuiferit të Vjosës nëpërmjet pus-shpimeve në vendburimin e naftës në vendburimin e naftës në Cakran (Kreshpan) mund të përbëjë problem të jashtëzakonshëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Fier dhe në NjA-të që furnizohen me ujë nga ky akuifer. Me pak fjalë, industria e naftës, në rast se nuk ka marrë masat e mbrojtjes së burimeve ujore nëntokësore në këtë zonë rrezikon të ndotë një ndër burimet ujore kryesore për furnizimin me ujë të popullsisë.

Si përfundim, përveç lumenjve, Bashkia përballet me problemet që kanë të bëjnë me ndotjen e Akuiferit të Semanit dhe Vjosës dhe të akuiferëve të thellë për të cilët ka mungesë totale të dhënash. Për rrjedhojë, duke parë teknologjinë e vjetër dhe të papërshtatshme për mbrojtjen e burimeve ujore që industria e naftës ka përdorur në të shkuarën dhe shpimet në akuifer, është

e rëndësishme *që të ndërpritet menjëherë furnizimi me ujë i popullsisë nga Akuiferi i Semanit (puset e fshatrave Kallm)* dhe, njëkohësisht, të merren masa të menjëhershme për monitorimin specifik të ujërave të Akuiferit të Semanit në Kallm dhe Akuiferit të Vjosës në Gorishovë, me qëllim që të përcaktohet nëse ujërat e këtyre dy akuiferëve janë ende të përshtatshme për furnizimin me ujë të popullsisë së Fierit e më tej. Rekomandohen njëkohësisht studime rreth akuiferëve të thellë dhe ndikimit të industrisë në cilësinë e ujërave dhe në përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

- **Bregdeti**

  - ***Vija bregdetare në Shqipëri***

Shqipëria ka një vijë bregdetare prej rreth 427 km, nga të cilat 273 km i përkasin bregdetit fushor të Adriatikut dhe 154 km bregdetit shkëmbor të Jonit.[159] Baseni sedimentar shqiptar vazhdon edhe në shelfin detar shqiptar të Adriatikut, gjeologjia e të cilit ka kushtëzuar morfologjinë dhe dinamikën e hapësirës detare të litoralit. Kështu, nga Vlora në jug e deri në gjirin e Drinit në veri, litorali është i sheshtë, i cekët e me depozitime ranore deri në izobatin 50 m, me bregdet grumbullues dhe vende-vende sektorë zhytjeje në të cilët vërehet ingresioni i detit drejt steres e në zona të caktuara me gërryerjeje (erozion)[160]. Bregdeti i nënshtrohet rregullisht ndikimeve të proceseve natyrore (gjeologjike e hidrologjike) dhe transformohet në kohë. Mirëpo, efekte në hapësirën bregdetare kanë edhe ndërhyrjet e ndryshme të njerëzve, si pasojë e të cilave, bregdeti shqiptar përballet me transformime të vazhdueshme e të shpejta, që ndryshojnë nga zona në zonë.

Fenomenet kryesore që vihen re në vijën bregdetare të Shqipërisë janë **zhytja** dhe **erozioni** detar (tkurrja e plazheve), si dhe **grumbullimet** (zgjerimi i plazheve), në segmente të caktuara.[161] Zakonisht, plazhet formohen kur sasia e materialit të ngurtë zhavorror e ranor që ndodhet në plazh ose që sjell lumi është më e madhe se sasia e materialit të marrë nga deti. Pra, formimi i plazhit si fenomen mund të shihet thjesht si një bilanc ndërmjet sasisë së sjellë/prurjeve të ngurta të lumit dhe sasisë së marrë nga deti. Kur sasia e materialit të ngurtë të sjellë nga lumi në breg të detit është më e madhe, kemi të bëjmë me zgjerim të plazhit. Në rast të kundërt, kemi të bëjmë me erozion ose përparim të detit drejt tokës.[162] Por, si rezultat i rritjes së nivelit të detit, ose i thyerjeve tektonike mund të hasen edhe zhytje të hapësirës së litoralit, të cilat gjithashtu rezultojnë në tkurrje e deri në humbje të plazheve.

Erozioni ndodh për arsye natyrore e njerëzore. Si **shkaqe natyrore** mund të përmenden: ngritja e nivelit të detit, e cila ndikon ndjeshëm për shkak të lartësisë (0 m në nivelin e detit në të cilën ndodhen plazhet); zvogëlimi i sasisë së materialit të ngurtë të ardhur nga malet, përmes lumenjve etj. Në Shqipëri, erozioni është vënë re kryesisht në plazhet që ndodhen në grykëderdhjet e vjetra të lumenjve që tashmë janë devijuar (si në Patok, Vlorë, Velipojë etj), fenomen ky që pritet të ndodhë në të gjitha grykëderdhjet e vjetra të lumenjve në të ardhmen[163].

Ndërhyrjet njerëzore që kanë përshpejtuar fenomenin e erozionit nëpër plazhe lidhen kryesisht me i) ndërhyrje në basenin ujëmbledhës të lumenjve, dhe ii) ndërhyrje në bregdet dhe në plazhe. Në Shqipëri, të dyja janë tepër të ndjeshme. Si rezultat, në vitet e fundit ka një tendencë drejt erozionit detar e parashikohet që në 20-vjeçarin e ardhshëm, intensiteti i erozionit të rritet[164]. Duhet shtuar se, përveç grykëderdhjeve të vjetra të lumenjve, erozioni është vënë re edhe në grykederdhjet e reja te tyre. Kjo është vënë re në dhjetevjeçarin e fundit

kryesisht në grykëderdhjet aktuale të lumenjve Seman, Vjosë e Shkumbin. Në grykëderdhjet e reja të lumenjve gjejme seksione me erozion, me depozitim dhe me balancë. Si shkaqe kryesore që shtyjnë drejt erozionit edhe në grykëderdhjet e reja të lumenjve mund të përmendim si më poshtë vijon[165]:

- Ndërhyrjet e njeriut përgjatë zonës ujëmbledhëse të lumenjve (pellgut ujëmbledhës);

- Ndërtimin e hidrocentraleve në zonat e larta të lumenjve / ndërtimin e kaskadave të mëdha. Meqenëse veprat argjinore / HEC-et luajnë rolin e pritave, ato zakonisht parandalojnë arritjen e materialit të ngurtë në plazh duke përfunduar në fund të rezervuarit. Një fenomen i tillë është duke ndodhur kryesisht në lumin Seman, si edhe Bunë, Mat e Drin;

- Marrja e inerteve nga shtrati i lumit që prish ekuilibrin e vetë shtratit dhe pengon sedimentin të vazhdojë me rrjedhën, meqenëse sedimenti përfundon duke mbushur gropat e krijuara. I njëjti fenomen ndodh edhe nëpër bregdet kur merret rëra apo materiale të tjera në plazh. Marrja e vazhdueshme e inerteve nga shtrati i lumit kërcënon zhdukjen ose dëmtimin e plazheve;

- Ndërtimet pa leje të dy dhjetëvjeçarëve të fundit në bregdet, ose në zonat afër bregdetit. Këto ndërtesa pengojnë lëvizjen e lirë të sedimentit duke prishur balancën e plazhit (Seman, Vlorë, Lukova);

- Devijimi i rrjedhës së lumit në mënyrë artificiale (siç është devijimi i rrjedhës së lumenjve Ishëm në Patok, ose Drini e Buna);

- Urbanizimi ka gjithashtu ndikimin e tij në bregdet duke shkaktuar erozion, sidomos tek lagunat dhe ndërmjet plazheve.

Si përfundim, mund të thuhet se në Shqipëri, përveç erozionit të lartë të tokës në shkallë vendi, hasim edhe fenomenin e erozionit detar në grykëderdhjen e lumenjve, për shkak të ndërhyrjeve të shumta në rrjetin hidrik të vendit (në lumenj), si dhe urbanizimit të zonave me ndikim të drejtpërdrejtë në plazhe. Për më tepër, zhytja e brigjeve detare dhe ngritja e nivelit të detit si pasojë e ndryshimeve klimatike janë dy faktorë të tjerë që nuk duhet të lihen të anashkaluar e të mos merren në konsideratë në studimin e bregdetit.

- ***Vija bregdetare në Bashkinë Fier[166]***

Fieri ka një vijë bregdetare të gjatë rreth 30 km e cila shtrihet gjatë detit Adriatik dhe është tejet dinamike.[167] Në këtë vijë bregore derdhen dy lumenjtë kryesorë të pjesës jugore të Shqipërsië, përkatësisht Semani e Vjosa. Deltat e këtyre dy lumenjve, përfshirë lagunën e Karavastasë, janë edhe kufizuesit natyrorë të hapësirës bregdetare të Bashkisë Fier. Nga pikëpamja e ndarjes së bregdetit të Adriatikut për studim, hapësira litorale e Fierit u përket dy zonave, përkatësisht asaj qendrore (që përfundon në plazhin e Semanit dhe asaj jugore e cila në veri mbyllet me plazhin e Pishë-Poros e Darëzezës. Delta e Semanit e ka ndryshuar rreth 4 herë pozicionimin e saj në 150 vitet e fundit dhe nga një pozicion shumë i afërt me lagunën e Karavastasë, aktualisht ndodhet e zhvendosur në jug. Në fotot ajrore të bregdetit vihet re edhe grykëderdhja e vjetër e Lumit Seman, e cila tani ka marrë formën e një freskoreje. Grykëderdhja e Vjosës, nga ana tjetër, ka pësuar zhvendosje të jashtëzakonshme në shekuj,

me drejtimin nga Vlora (Skelë) në veri të lagunës së Nartës aktualisht. Hapësira bregdetare është krijuar veçanërisht nga prurjet dhe këto lëvizje të lumenjve, ku Semani dallohet për aluvione e sedimente për shkak të erozionit të lartë në shtratin e tij, krahasuar me Vjosën e cila ka brigje shumë më pak të gërryeshme.

Përveç lumenjve, në bregdet derdhen drejtpërsëdrejti një rrjet kanalesh ujitëse-kulluese, mjaft të rëndësishme për zonën bujqësore të Fierit dhe Lushnjës. Ndër to mund të përmendim Kanalin Darëzeza e Re në pjesën jugore, Vija e Ngjalës (Kanalin Ujitës) që e përshkon bashkinë pothuajse në paralel me lumin Seman deri në Mbrostar me grykëderdhje të drejtpërdrejtë në plazhin e Semanit, si dhe Kanali i Myzeqesë (në veri të lumit Seman i cili shërben edhe si kufi natyror mes Bashkive Fier e Lushnjë) me degëzimet e tij në të dyja anët në fushën e Sheqit dhe me dalje të drejtpërdrejtë në detin Adriatik. Kanalet mbartin sasi të larta nutrientësh (nitrate e fosfate) që shpëlahen nga toka bujqësore, ndërsa ai i Vijës së Ngjalës mbart edhe një pjesë të mirë të ndotjes që sjell Gjanica (afluent i Semanit që kalon mespërmes Fierit dhe sjell mbetjet e rafinerisë së naftës në Ballsh).

Duke parë ndryshimet e vazhdueshme të vijës bregdetare në Bashkinë Fier, në vitin 2014, SHGJSH-ja kreu një studim të vijës bregdetare për periudhën kohore **1939-2014**. Studimi përfshiu **segmentin bregdetar nga Lumi Shkumbin deri në Lumin Seman** dhe u përqendrua në tre periudha kohore (1939-1980, 1980-2008 dhe 2008-2014)[168]. E gjithë gjatësia e bregdetit të monitoruar u nda në tre segmente të cilat përshkruhen më poshtë, së bashku me rezultatet e studimit për secilin segment:

- <u>Segmenti I:</u>

Në litoralin e ri në veri të **plazhit të Divjakës, deri në kanalin e Vahut**, kanali i komunikimit të Godullës (laguna më e re e) krijuar midis Lagunës së Karavastasë e detit me gjatësi 9.1 km. Në këtë segment, nga monitorimet e kryera është vënë re se ka patur **grumbullim** në vitet 1939-2008 dhe **erozion** në vitet 2008-2014.

Figura 63. Plazhi i Divjakës

Burimi: Burimi: Google Earth, Punoi: Co-Plan

Plazhi i Divjakës është krijuar nga tërheqja e detit në të shkuarën në vitet 1980-2014, e cila ka arritur deri në 300 m. Kjo është edhe zona e plazhit sot, e cila është zgjeruar me një ritëm mesatar prej 8.8 m/vit. Tërheqja ka ndodhur në gjatësi rreth 1,750 m me një trashesi nga 0.4 m deri ne 2.4 metra ose mesatarisht 1.3 m. Plazhi ka patur grumbullim. Megjithatë, **cilësia e detit nga 374 m deri në breg të detit ka ardhur duke u përkeqësuar**. Kjo për shkak se në vitet e fundit ka patur prurje materiali të imët (fraksion të imët argjilor të dheut/jozhavorror).

- Segmenti II

Në **deltën e vjeter të lumit Seman** ose hapësira bregdetare para fshatit Bedat që është monitoruar nga AKM-ja ka patur **erozion** gjatë të tre periudhave të marra në shqyrtim. Ky fenomen parashikohet të vazhdojë në të ardhmen për shkak të mungesës së prurjeve të ngurta nga lumi. Më konkretisht, ndryshimet kryesore gjatë viteve në fjalë janë paraqitur më poshtë:

i. Në vitet 1980-2014, deti ka përparuar në drejtim të tokës rreth 1 m ose 41.4 m/vit

ii. Në vitet 2008-2015, ka një ngadalësim të intensitetit vjetor erozional me 6.3-21m/vit.

Figura 64. Grykëderdhja e Kanalit të Myzeqesë.

Burimi: Burimi: Google Earth, Punoi: Co-Plan

- Segmenti III

1 km në jug të grykëderdhjes së ujëmbledhësit të Myzeqesë deri në grykëderdhjen e sotme të lumit Seman, duke përfshirë dhe 1.7 km të krahut jugor të saj dhe ka një gjatësi të përgjithshme 7.9 km. Dinamika e vijës bregore në këtë segment është shumë intensive, duke lëvizur në drejtim të detit dhe duke krijuar një sipërfaqe litorali prej 1,276 ha. Delta aktuale ka dinamikë grumbulluese për shkak mbathjes me aluvione që sjell lumi.

Figura 65. Segmenti bregor nga Ujëmbledhësi i Myzeqese në Grykëderdhjen e lumit Seman.



Burimi: Google Earth, Punoi: Co-Plan

Përmbledhje e gjetjeve të studimit: Sipas studimeve të SHGJSH-së të raportuara nga AKM-ja 2014[169], zonat bregore që janë prekur nga fenomenet e erozionit dhe grumbullimit në periudhën **1939 – 2014**, janë si më poshtë vijon:

Si **zona të kërcënuara nga erozioni detar** (ku ndodh tkurrja e plazhit/përparimi i detit) janë:

i. Pjesa veriore dhe ajo jugore e plazhit të Divjakës;

ii. Segmenti që perfshin grykederdhjet e vjetra të lumit Seman.

Zona nën grumbullim të vazhdueshëm (ku ndodh zgjerimi i plazhit) janë:

i. Pjesa qëndrore e plazhit të Divjakës;

ii. Zona në afërsi të grykëderdhjes aktuale të lumi Seman.

Në plazhin e Divjakës dhe vijën bregore nga Grykëderdhja e ujëmbledhësit të Myzeqesë deri në Grykëderdhjen e lumit Seman, sidomos kjo e fundit, ka patur fenomene **grumbullimi** të vazhdueshëm.

Figura 66. Fenomeni i grumbullimit në plazhin e Divjakës e Semanit ndër vite.



Burimi: AKM 2014, Punoi: Co-Plan

Megjithatë, sipërfaqja me grumbullim ka ardhur duke u ulur ndjeshëm ndër vite. Kjo tregon se erozioni është shtuar nga viti në vit. Në periudhën 1939-80 vihet re periudha me grumbullime të theksuara (59.7%) e cila është ulur gradualisht deri në 36.5% në vitet 1980-2008 duke arritur periudhën me prurjet më të pakta me 3.8% në periudhën më të afërt (2008-2014).

Ndërkohë, në jug të deltës aktuale të Semanit shtrihet plazhi i Semanit, i cili përfaqëson një nga sektorët zhytës të litoralit të Adriatikut në Shqipëri. Sipas studimeve neotektonike, një thyerje tektonike përmbysëse e mbihipëse depërton nga deti në stere në grykëderdhjen e vjetër të Vjosës, vijon paralel me bregun deri në veri të plazhit të Semanit ku futet përsëri në det. Plazhi i Semanit ndodhet në perëndim të vijës së thyerjes tektonike dhe në pjesën e ulur të thyerjes. Për rrjedhojë, ai gjendet në një regjim zhytës. Shumë objekte që 20-35 vite më parë ndodheshin në stere, aktualisht ndodhen në det. Për shembull bazamenti i pusit të thellë të naftës Semani-3, që u ndërtuar në vitin 1969, në fillim gjendej 265 m larg bregut. Mirëpo ingresioni (përparimi) i detit drejt bregut në periudhën 1969-1983 ka ndodhur me rreth 9.4 m/vit dhe nga 1983 deri në vitin 2004 me 8.1m/vit. Avancimi i detit drejt steres është rreth 300 m, por në seksione të caktuara të vogla arrin deri në 2.5-3 km[170]. Ndërkohë, drejt

grykëderdhjes së Vjosës nuk vihet re një proces zhytjeje intensiv si në Seman[171], dhe në këtë pikëpamje plazhet e shtrira në jug të fshatit Darëzezë janë më të qëndrueshme dhe të rekomandueshme për zhvillimin e turizmit.

Figura 67. Pamje satelitore e evolucionit gjeomorfologjik të bregdetit nga grykëderdhja e lumit Vjosa deri ne grykëderdhjen e lumit Shkumbin në litoralin shqiptar, për periudhën e verës (Gusht 1981, Korrik 1989 dhe tetor 2001) dhe thyerjet aktive të përmbysura e të mbihedhura



Burimi: Aliaj Sh. etj. 2000, Frashëri A. etj. 2011, Pano N. etj. 2005; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Një tjetër element për t`u marrë seriozisht në konsideratë janë kushtet gjeologo-inxhinierike dhe rreziqet gjeologjike në territorin e bregdetit, jo thjesht përgjatë vijës bregdetare, por edhe tokat që shtrihen në brendësi, deri në Topojë e Boçovë. Aktualisht zona ka një funksion të përzier dhe në shtresa paralele: plazhi, zona natyrore dhe më pas toka bujqësore dhe fshatrat. Për shkak të pozicionimit dhe hapjes drejt detit, interesi për të realizuar në zonë zhvillime me karakter turistik është i lartë. Mirëpo, përtej faktit se brigjet ujore, zona e mbrojtur natyrore e Pishë-Poros dhe toka bujqësore mbartin shumë kushtëzime ligjore, kushtet gjeologo-

inxhinierike janë një tjetër faktor real që kushtëzon format e mundshme të zhvillimit. Kështu, edhe pse në rekomandimin e tij të përgjithshëm, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar e konsideron zonën e fushës (ultësirës bregdetare të Adriatikut në Fier) si "pa fenomene të rrezikut gjeologjik", në një nivel më të detajuar, SHGJSH-ja shprehet se:

i) zona e bregut nga Karavastaja e deri në grykëderdhjen e Vjosës (pjesa veriore e saj), përbëhet nga dhera pa kohezion, praktikisht rëra, kokrrizat përbërëse të të cilave lëvizin lirisht e të pavarura nga njëra-tjetra në mënyrë të menjëhershme, sapo mbi to të veprojnë ngarkesa të lindura si rezultat i aplikimit të ndërtimeve mbi to. Fenomeni i lëngëzimit të rërës (si më poshtë) është shumë i mundur në këtë brez, në rast të ndërtimeve që do të prishnin ekuilibrin e ndjeshëm të këtij territori.

ii) zona paralel me bregun, nga Karavastaja, në zonën e Hoxharës e duke vazhduar në Povelçë e më në jug, në Boçovë e deri në pjesën veriore të grykëderdhjes së Vjosë përbëhet nga dhera me veti të veçanta, që konkretisht në këtë zona janë llume argjilore dhe argjila të kripura (Lakr). Këto janë dhera me veti specifike shumë të ulëta, si rezultat i prezencës në to të ujërave sipërfaqësore, apo nëntokësorë. Sipas SHGJSH-ja, nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike këto formime kërkojnë në mënyrë kategorike përmirësim të vetive gjeoteknike gjatë hapjes së themeleve. Kjo ka rëndësi sepse përndryshe rrezikohet lëngëzimi i rërave dhe intruzionet e rërës. Ky fenomen ndodh në hapësirën bregdetare të Divjakë-Semanit (trevë me moshë gjeologjike të re dhe shumë të re), që ka qenë det në një kohë jo shumë të largët. Nëse këtyre tokave/dherave u prishet ekuilibri që kanë vendosur, ato janë të prirura të lëngëzohen dhe të injektohen në trajtë intruzionesh nëpër çarje të ndryshme, apo edhe të shpërthejnë në trajtë fontanash në sipërfaqe. Sipas SHGJSH-së, lëngëzime të rërave dhe çedime të ndryshme të truallit për shkak të këtij lëngëzimi, mund të krijohen edhe për shkak të rritjes së ngarkesës nga ndërtimet. Duke ditur se në 15 vitet e fundit janë kryer jo pak ndërtime pa leje, është e paqartë, por edhe shumë e mundur që shtresa të reagojnë nga shtimi i ngarkesave të reja, duke realizuar edhe tronditje sizmike të shkallës 8-9 ballë.

Figura 68. Zonat ku ndodh fenomeni i lëngëzimit të rërave



Burimi: SHGJSH, 2014

Pra në lidhje me ndërtueshmërinë në këto troje (si më sipër) SHGJSH-ja rekomandon që Pra

në lidhje me ndërtueshmërinë në këto troje (si më sipër) SHGJSH rekomandon që duhet vepruar me kujdes dhe çdo ndërtim apo studim për zhvillim duhet të paraprihet patjetër nga studime të hollësishme gjeologo-inxhinierike të sheshit të ndërtimit dhe më gjerë, për të garantuar marrjen e masave që realizojnë qëndrueshmërinë e ndërtimit. Rekomandohet që asnjë ndërtim të mos kryhet në këtë zonë në mungesë të këtyre studimeve të hollësishme.

- ***Ekosisteme Natyrore të ndikuara nga ndryshimet e vijës bregdetare të Bashkisë***[172]

Sipas AKM-së, sistemet me vlerë të lartë ekonomike dhe ekologjike që kërcënohen nga dinamikat e vijës bregore të Bashkisë janë:

a. Pylli i Divjakës;
b. Pylli i zonës së Semanit dhe Pishë-Poro;
c. Laguna e Kravastasë dhe
d. Godulla e re e krijuar.

Laguna e vjetër e Karavastasë kërcënohet nga mosmirëmbajtja e kanalit të komunikimit det-Lagunë, e cila po shkakton kënetëzimin e saj e si rrjedhojë, dëmtimin e ekosistemit me vlera shumë të medha ekonomike dhe ekologjike, jo vetëm për zonën por dhe më gjerë[173].

Monumente abiotike të natyrës në afërsi dhe nën ndikimin e vijës bregdetare:

- **Dunat e Semanit** (ndërmjet Darëzezës së Re dhe Grykëderdhjes së vjetër të Semanit)

Figura 69. Segmenti më i lartë (mbi 4m) i Dunave përgjatë vijës bregdetare të Bashkisë Fier.

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Dunat në vijën bregdetare të bashkisë Fier shtrihen në veriperëndim të Povelçës dhe Seman Plazh. Ato përfaqësojnë grupe dunash të krijuara nga veprimtaria grumbulluese e erës në rërën e plazheve. Sipas raportit të AKM-së, 2015, ato shfaqen rreth 1km të gjata, 15m të gjera dhe 6m të larta. Sipas vizitave në terren (06/2016), të kryera nga ekspertë të mjedisit të Bashkisë Fier dhe Co-PLAN-it, rezulton se ndryshimet klimatike dhe aktiviteti njerëzor, jo vetëm në bregdetin e Fierit, por edhe në lumenjtë Seman e Vjosë në një hark kohor të shkurtër ka ndryshuar ndjeshëm pozicionimin dhe përmasat e Dunave. Dunat në seksionin Povelçës (veriperëndim) e deri tek fillimi i Plazhit të Semanit shfaqen të fragmentuara e me një lartësi jo më të madhe se 1.5m, lartësia 6m shfaqet vetëm në fund të seksionit Seman Plazh. Si rezultat i gjendjes së mirë të dunës, në gjendje të mirë shfaqet edhe sipërfaqja me bimësinë specifike (Tamarix, Acacia Salin, Salix si dhe shkurre e barëra të tokave të kripura)

nga krahu tjetër i dunës. Këto duna mbartin vlera shkencore (biologjike), ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike.

- **"Kurora" e lumit Seman** (në Fshatin Adriatik të Libofshës)

Kurora i përket rrjedhës së poshtme të shtratit të vjetër të lumit Seman, me sipërfaqe prej 43.5ha, disa km e gjatë dhe 1m mbi nivelin e detit. Nga ana administrative, gjendet në fshatin Adriatik afër Fshtatit Metaj, NjA-ja Libofshë. Kurora gjendet 15 km nga qyteti i Fierit. Kurora dallohet për shumëllojshmëri të lartë speciesh të drurëve pyjorë ku mbizotëron plepi i bardhë *populous alba*, rrënja *quercus robur*, vidhi *ulmus sp*., rrapi *platanus sp*. etj. Si kati i parë i bimësisë pyjore dhe shkurre si thanukla *cornus sanguinea*, murrizi *crataegus sp*, dëllinja e zezë (*juniperus communis*), dafina (*laurus nobilis*), lofata (*cercis siliquastrum*), xanë (*spartium junceum*, trëndafili i egër (*rosa canina*, kulumbria *prunus spinosa* si dhe një shumëllojshmëri bimësh të tjera. Sipas AKM-së, ky është pyll me vegjetacion autokton dhe karakteristik i zonës gjë për të cilin është shpallur Monument Natyre. Ka rëndësi shkencore sidomos biologjike, ka vlera të veçanta ekologjike[174].

Nga vizitat në terren (06/2016, realizuar nga ekspertë të mjedisit të Bashkisë Fier dhe Co-PLAN-i), rezulton se disa nga problematikat e këtij objekti vijnë si pasojë e mungesave në investime, e të mbrojtjes së Kurorës. Si rezultat, janë kryer prerje të paligjshme dhe kullotje pa leje në brendësi të saj. Po ashtu, mungesa e politikave promovuese për zonën si atraksion turistik, ndërkohë që potenciali mbetet i madh, ka bërë që zona të jetë në harresë, apo e panjohur. Sipas vizitave në terren dhe konsultave me ekspertët dhe banorët e Kurorës zgjidhja e problematikës konsiston në: pastrimin e shesheve dhe korridoreve ekzituese në brendësi të saj; rrethimin e objektit në anën ku kufizohet me tokë pasi tre anet e tjera kufizohet me ujë; mbrojtjen nga kundravajtësit; hartimin e stendave informuese mbi burimet natyrore që ka ky objekt; krijimin në përputhje me ligjin për zonat e mbrojtura të vendeve shlodhëse/pritëse brenda objektit, për qëllime studimi dhe edukimi; pastrimin e trungjeve të plepave nga bima parazitare e kulprës ose Hedra Helix; si dhe mbrojte të drurëve të veçantë si rrënja dhe vidhi[175].

Habitatet CORINE të pyjeve të rrezikuara në bregdetin e Bashkisë Fier:

Disa nga habitatet CORINE janë tipike për vendin tonë dhe përfshijnë kryesisht tipet e pyjeve definë -frashër, pyjet xunkth - frashër, pyjet dushk - frashër, pyjet e pishës etj. Një pjesë e këtyre habitateve është dëmtuar ose kërcënon të zhduket. Në Bashkinë e Fierit, habitatet pyjore të rrezikuara janë[176]:

- Habitate të rrezikuara (EN): Habitatet e pyjeve me dushk-frashër (*Quercetum-Fraxinetum angustifolia*), **Kurorë (Fier**)

- Habitate të përkeqësuara (VU):Habitatet me makie të *Juniperus macrocarpa*, Divjakë, **Bregdet Pishë – Poro (Fier**)

- **Përmbytjet**

Vendi ynë është kërcënuar nga përmbytjet e lumenjve ndër vite. Sipas studimeve të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) të vitit 2003[177] informacionet e para rreth përmbytjeve në vend janë rregjistruar në vitet 1854-1871, periudhë gjatë së cilës kanë ndodhur 11 përmbytje. Përmbytjet kanë patur shkaktuar dëme të konsiderueshme në

vend. Megjithatë, përmbytja e viteve 1962-1963 konsiderohet përmbytja me ndikim më të madh. Lumenjtë e Drinit dhe të Bunës përmbytën fushat e Shkodrës dhe Zadrimës, lumenjtë Mat dhe Drin përmbytën fushën e Lezhës, lumi Ishëm përmbyti fushën e Thumanës ndërsa lumenjtë Shkumbin dhe Seman kanë përmbytur fushat përreth tyre (harta x). Sipas llogaritjeve të asaj kohe, janë përmbytur gjithsej 70,000 ha tokë bujqësore duke shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë e banorëve vendas.

Tabela 18. Zonat e përmbytura në dimrin e viteve 1962-1963

Zonat e përmbytura	Sipërfaqja e përmbytur (ha)	Kohëzgjatja (Ditë)
Bregu i Bunës (Fushat e Zadrimës së Shkodrës dhe të Lezhës)	18,575	22
Drini i Lezhës dhe Mati (Fushta ndërmjet të dy lumenjve)	3,122	10
Mati dhe Ishmi (Fushta ndërmjet të dy lumenjve)	5,825	7
Lumi Shkumbin (Fushat poshtë Rrogozhinës, në të dy anët e lumit)	6,896	7
Lumi Semani (Fushta në të dy brigjet e tij)	26,738	35
Lumi Vjosa (Fushta në të dy brigjet e lumit, poshtë Urës së Mifolit)	3,538	20

Burimi : Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, 2003, Punoi: Co-PLAN

Përmbytje të tjera të një shkalle të gjerë janë regjistruar në vitet 1970-71 dhe në vitin 2002. Në vitin 1970-71 ndikimet më të mëdha janë ndjerë në luginën e Vjosës. Lumi i Vjosës llogaritet të ketë përmbytur 14,000 ha dhe shkaktuar dëmtime dhe shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompimit, etj. Në shtator të vitit 2002, përmbytjet janë përsëritur duke mbuluar me ujë rreth 30,000 ha tokë bujqësore. Lumenjtë që dolën nga shtrati ishin lumi Erzen dhe, mbi të gjitha, degët kryesore të lumenjve Vjosë (Drinosi), Seman (Gjanica) si dhe përrenj të tjerë të vegjës (Gjadri, Përroi i Manatinës në Lezhë dhe Përroi i Zezës). Edhe pse mungojnë të dhënat, përmbytjet kanë vazhduar sërish (në vitin 2014-15) duke shkaktuar dëme të mëdha në vendet ku ato ndodhin.

***Përmbytje nga lumenjtë kryesorë*:** Sipas një studimi të kryer nga Prograi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara[178], rreziku më i madh i përmbytjeve në vendin tonë vjen nga sistemi lumor kryesor (lumenjtë e mëdhenj). Përmbytjet zakonisht janë të lidhura ngushtë me periudhën kur sasia e reshjeve është më e lartë në vend e cila përkon me muajt nëntor-mars. Këto janë edhe muajt kur bien rreth 80-85% të reshjeve në vend[179]. Në përgjithësi, dhe sidomos në kohët e fundit, reshjet intensive janë të befasishme dhe dallohen për një kohëzgjatje për rreth 8-10 orë. Si rrjedhojë, lumenjtë kryesorë të vendit arrijnë kapacitetin e tyre maksimal deri në dalje nga shtrati duke përmbytur tokat përreth. Gjatë përmbytjeve, prurja specifike e lumenjve në vendin tonë luhatet nga 0.5-2.5 $m^3/s/km^2$.[180]

Tabela 19. Karakteristikat kryesore hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve më të mëdhenj në vend

Pellgu ujëmbledhës	Sipërfaqja (km^2)	Prurja specifike ($l/s/km^2$)	Prurja vjetore (milion m^2)	Raporti vjetor i prurjes së lagët/thatë (1)	Raporti 10-vjeçar i prurjes (2)	Aftësia mbrojtëse e rezervuarit (milion m^2)
Drini	19,582	35	11,110	5,7 (Dhjetor/Gusht)	13	2,700 (Fierza)
Mati	2,441	40	3,250	10 (Dhjetor/Gusht)	25	240 (Ulëza)
Erzeni-Ishmi	1,439	24-31	660	9-10 (Janar,Shkurt/Gusht)	55	Nuk ka
Shkumbini	2,445	26	1,900	10,8 (Prill-Gusht)	24	Nuk ka
Semani	5,649	16	2,700	14,8 (Shkurt,Mars,Gusht)	18	700 (Diga e Banjës)(3)
Vjosa	8,1	26	5,550	7,3 (Shkurt/Gusht, Shtator)	21	Nuk ka

Burimi : PNUD, 2003

(1) Raporti midis prurjes në muajin më të lagët me atë në muajin më të thatë; 2) Raporti midis prurjes më të lartë dhe asaj më të ulët brenda një 10 vjeçari; 3) Rezervuar i papërfunduar

Përmbytje nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë*:* Një karakteristikë e përmbytjeve në vendin tonë është se shpesh ato shkaktohen edhe nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë, krysisht në luginat e Shqipërisë Veriore, Qëndrore dhe Jugore. Studimet tregojnë[181] se lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë që përmbyten në vend janë përrenjtë e Përmetit, Zaranikës e Manazderës në Elbasan, Manatisë, Lanës dhe Zezës si dhe lumenjtë Kiri, Tërkuza, Gjolja e Drionosi. Përrenjë të tjerë që përbëjnë rrezik të ndjeshëm janë ai i Gjadrit, Droja, i Korçës dhe i Vërdovës[182].

Tabela 20. Lumenjtë/përrenjtë e vegjël me pirije për përmbytje në basenet Shkumbin, Seman e Vjosë

Lumi ose Përroi	**Rajoni / Zona e ndikimit**
Përroi i Zaranikës	Qyteti i Elbasanit (pjesërisht)
Përroi i Manasderës	Rruga Elbasan-Librazhd
Lumi i Gjanicës	Qyteti i Fierit (pjesërisht)
Lumi i Drinosit	Qyteti i Gjirokastrës (pjesërisht) dhe rruga Tepelenë-Gjirokastër-Kakavijë

Burimi: PNUD, 2003

***Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në rang vendi*:** Vendi ynë rrezikon dëmtime të mëdha në rast se përmbytjet janë për periudhë rikthimi 50 vjet dhe 100 vjet. Nga studimet e kryera nga PNUD, pasojat janë pothuajse të papërfillshme (me ndikim të kufizuar ose pa pasoja) në rastin e përmbytjeve me rikthim në 50 vjet. Kjo në rast se merren të gjitha masat për paradalimin e tyre (kur sistemi i pendave është i padëmtuar dhe instalimet e pompimit janë të gjitha në punë). Masa të tilla janë në gjendje të shmangin rreziqet që i kanosen ultësirës perëndimore.

Përmbytjet me rikthim në më shumë se 50 vjet duket se janë përmbytjet që kanë një ndikim më të fuqishëm në vend. Këto lloj përmbytjesh (të rikthimit me 100 vjet, p.sh.) mund të krijojnë të njëjtat kushte si përmbytja e vitit 1962/63. Shkalla e rrezikshmërisë nga këto përmbytje ndyshon nga zona në zonë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se rajonet me rrezikun më të ulët të përmbytjeve në periudhë rikthimi 100vjet janë ultësirat perëndimore, rajoni i Alpeve të Shqipërisë dhe krahina malore juglindore.

Rrezikshmëria më e lartë e përmbytjeve paraqitet në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Devoll dhe Osum, pjesën e poshtme të Shkumbinit, lumenjtë Drini i Zi, Mati, rajoni i Bregut të Detit dhe lumenjtë Kiri, Gjadri, Lesniqja, Gomisqja, Ishmi dhe lumenjtë e krahinave malore jugore dhe qëndrore të Shqipërisë, si Drinosi, Shushica etj. Në pjesët e tjera të vendit rreziku është më i ulët.

Tabela 21. Zonimi i rrezikut të përmbytjeve në Shqipëri për periudhë rikthimi 100 vjet

Shkalla e rrezikut të përmbytjes	Prurje e pikut specifik (PPS-$m^3/s/km^2$)	Sipërfaqja	
		Km^2	%
E ulët	<2	6,660	23,5
E mesme	2-3	11,433	40,3
E madhe	3-4	5,878	20,7
E lartë	4-5	2,837	10.0
E skajshme	>5	1,564	5,5
Totali		28,372	100.0

Burimi : PNUD, 2003

Figura 70. Rrezikshmëria e përmbytjeve në vend për periudhë rikthimi 100 vjet



Burimi: PNUD, 2003, Punoi: Co-PLAN

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, në pjesën më të madhe të territorit, rreziku i përmbytjeve në vend me rikthim në 100 vjet është i mesëm në 11,433 km^2 (40.3%) i ndjekur nga ai i ulët (23.5%, e më tej i madh (20.7%), i lartë (10%) dhe i skajshëm (5.5%). Duhet theksuar se të tre kategoritë e fundit me rrezik të i lartë, të madh dhe të skajshëm që kanë ndikimin më të fuqishëm në vend përfshin 36.2% të territorit. Pra, Shipëria është vend tejet i rrezikuar nga përmbytjet ku vetëm 23.5% e territorit nuk kërcënohet nga pasojat e rënda të përmbytjeve. Në pjesën tjetër, është tejet e rëndësishme që planifikimi i territorit të bëhet duke patur parasysh pasojat e mëdha në rast përmbytjesh me kthim 100 vjeç.

Rreziku nga përmbytjet e sistemi kryesor lumor me rikthim 100 vjet në Fier: Për sa i përket Bashkisë së Fierit, përmbytjet parashikohen të shkaktohen nga lumenjtë kryesorë që janë Vjosë, Seman dhe dega e tij Gjanica.

Siç u theksua më sipër, përmbytjet me rikthim në 50 vjet janë të parashikueshme dhe, vetëm duke marrë masat e duhura, mund të shmangen pasojat e tyre. Kjo është vërtetuar mbas përmbytjeve të vitit 1962-63 mbas të cilave janë marrë masa për parandalimin e përmbytjeve të tilla duke dhënë rezultate të kënaqshme në parandalimin e pasojave të rënda në përmbytjen e viteve 1970-71. Sipas PNUD-it, mbas vitit 1962-63, Masat për parandalimin strukturor dhe kontrollin e përmbytjeve (duke përjashtuar digat), të ndërmarra në vend, janë mbështetur në një periudhë rikthimi të ujërave nga përmbytjet prej 50 vjetësh. Këto masa përfshijnë

rindërtimin dhe ngritjen e argjinaturave të reja në pjesën e poshtme të lumenjve kryesorë. Ndërkohë, nuk janë marrë masa për përmbytje me rikthim në 100 vjet. Për këtë arsye, vendi ynë dhe, rrjedhimisht edhe Bashkia Fier, nevojitet të planifikojnë zhvillimin e territorit duke patur parasysh ndikimet e përmbytjeve me rikthim në 100 vjet. Pasojat e përmbytjeve të këtij lloji të parashikuara nga PNUD-i për Bashkinë Fier janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme 9studimet janë kryer në nivel rrethi sipas ndarjes territoriale administrative përpara Reformës së re Territoriale):

Tabela 22. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore për periudhë rikthimi 100-vjet dhe nevojat e fatkeqësisë sipas pellgjeve ujëmbledhëse në Rrethin e Fierit

Lumenjtë	Sasia e fshatrave	Sasia e komunave	Sasia e ndërtesave	Sip. e ndërtimit (m^2)	Popullsia
SEMANI	90	30	15,516	1,147,540	83,829
	37	12	7,830	562,900	41,704
VJOSA	29	8	4,579	346,380	24,858
	19	6	3,076	255,600	15,528
	56	18	10,906	818,500	57,232

Burimi : PNUD, 2003, Punoi: Co-PLAN

Figura 71. Harta e rrezikut të përmbytjes së Ultësirës Perëndimore me rikthim 100 vjet



Burimi : PNUD, 2003

Sipas parashikimeve të PNUD-it, nevojat për përmbytje me rikthim 100-vjet nga pellgjet e Semanit janë më të mëdhatë (figura 33). Në territorin e ish-rrethit të Fierit, vetëm nga një fenomen i tillë, parashikohet përmbytja e 37 fshatrave, 12 komunave, 7,830 ndërtesa si dhe e 562,900m^2 sipërfaqe toke. E gjithë kjo me pasoja të rënda për 41,704 banorë. Megjithatë, edhe përmbytjet nga lumi Vjosa nuk janë të vogla edhe pse me ndikim rreth dy herë më të vogël në popullsi (255,600 banorë kundrejt 562,900 banorë nga përmbytjet e Semanit). Në total, nga përmbytjet e Semanit dhe Vjosës me kthim në 100 vjet në Bashkinë Fier (territorin e Ish-Rrethit të Fierit) parashikohet të preken rreth 57,000 banorë dhe 11,000 banesa.

Ndërkohë, llogaritet se shifrat do të shumëfishoheshin në rast përmbytjesh të njëkohësishme nga disa pellgje.

Si përfundim, duke parë se parashikimet rreth ndikimit të përmbytjeve në vend janë kryer në vitin 2003, dhe se gjatë këtij 13-vjeçari regjimi i reshjeve ka ndryshuar duke çuar kështu në shpeshtimin e përmbytjeve dhe rritjen e ndikimit të tyre në territoret e bashkive, mendohet se pasojat e përmbytjeve me rikthim 50 ose 100 vjet të jenë edhe më të theksuara. Për këtë arsye, përveç marrjes së masave të duhura për parandalimin e përmbytjeve me rikthim 100 vjet, nevojiten edhe studime të reja më të përditësuara rreth përmbytjeve në vendin tonë.

C. Ajri

Cilësia e ajrit në Bashkinë Fier ndyshon sipas zonave. Në qytet dhe në afërsi të zonave të nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve vlerat e ndotjes paraqiten relativisht të larta[183], ndersa në zonat rurale cilësia e ajrit është e nje cilësie të mirë.

Sipas AKM-së, gjatë viteve 2002-2014, duke përjashtuar këtu vitin 2013, në qytetin e Fierit janë monitoruar gjashtë parametra të cilat janë PM_{10}, SO_2, NO_2, O_3 , LNP dhe PB[184].

Të dhënat e përftuara nga monitorimi i vazhdueshëm ndër vite, tregojnë një përqendrim mbi normat e BE-së dhe ato shqiptare të katër elementëve ndotës në ajër, ***LNP, PM_{10}, O_3*** dhe ***SO_2***.

Vlerat e Ozonit dhe dioksidit të sulfurit paraqiten në rënie vitet e fundit. Në 2011, vlerat e SO_2 paraqiten brenda normave kufij të BE-së dhe ato shqiptare, ndërsa O_3 ka tendencë rënieje.

Vlerat e parametrave LNP dhe PM_{10} vazhdojnë të mbeten të larta duke tejkaluar me 2-3 herë normat e BE-së.

Tabela 23. Vlerat mesatare të treguesve të monitoruar nga 2002-2014 ne Bashkinë Fier dhe normat e lejuara të BE-së dhe Shqipërisë

Vlera mesatare e parametrave të monitoruar ndër vite	**Parametrat e monitoruar (në µg/M_3)**					
	So_2	**NO_2**	**Pb**	**O_3**	**LNP**	**PM_{10}**
2002	21	21	0.23	51	258	109
2003	19.75	18	0.21	73.5	215	92
2004	18.5	15	0.19	96	172	75
2005	18	23	0.25	100	203	93
2006	24	25	0.29	100	219	106
2007	25	24	0.25	98	213	102
2008	32	33	0.32	70	238	112
2009	33	27	0.25	74	225	110
2010	26.7	31	0.24	62.6	195	93
2011	19.6	31.5	0.23	76	185	89
2012	20	25		74	221	97
2014		25.33				95
Norma R.SH[185]	20.00	40	1	40	140	40
Normat BE[186]	20.00	40	0.5	40	90	40

Burimi: MM, 2002-2014 dhe AKM 2014, Punoi: Co-PLAN

Marrë si reference të dhënat e mësipërme të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapësirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O_2 me rëndësi për cilësinë e ajrit në qendrat urbane.

Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë[i], ndikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjendje të gaztë nga gjethet e tyre.

Në tabelën e mëposhtme, sipërfaqa e gjelbër për banor në zonat urbane është më e vogël se standardi, edhe pse Bashkia Fier ka hapësira të mjaftueshme për të arritur standardet e nevojshme të gjelbërimit të përgjithshëm publik dhe gjelbërimit të veçantë. Gjelbërimi në nivel njësie strukturore është 1,83m^2/banorë kundrejt 2,5m^2 që është standardi (INSTAT). Një situatë e ngjashme paraqitet lidhur me gjelbërimin masiv (0.60m^2/banorë kundrejt 4 që është standardi) dhe me gjelbërimin rrugor, sheshet, brigjet ujore dhe zonat urbane. Vetëm në zonat periferike vihet re se sipërfaqja e gjelbër është ose tejkalon standardet.

Tabela 24. Bilanci i gjelbërimit publik në Bashkinë Fier

Zona e gjelbër	Standardi m^2/banor	Vlera ekzistuese			Vlera e propozuar		
			m^2/banor			m^2/banor	
		ha	(INSTAT)	(GJC)	ha	INSTAT	GJC
Gjelbërim në nivel njësie strukturore	2.5	10.4	1.83	2.73	39.00	8.16	9.36
Gjelbërim masiv parqe e lulishte	4	3.40	0.60	0.89	110.00	23.01	26.41
Gjelbërim rrugor , sheshe, brigje ujore në zonë urbane	2.5	9.84	1.74	2.59	14.30	2.99	3.43
		32.70	5.77	8.60	0	0.00	0.00
a&b&c	9	56.34	9.94	14.81	163.30	34.16	39.20
Park periferik	17	109.00	19.23	28.66	180.00	37.66	43.21
ç&d: Gjelbërim i Përgjithshëm Publik	26	165.34	29.17	43.47	343.30	71.82	82.41
Fidanishte	PA	0	0.00	0.00	10	2.09	2.40
Zonë ripariane	PA	1,018.00	179.58	267.63	1,460.0	305.43	350.47
Kopësht zoologjik	PA	0	0.00	0.00	0	0.00	0.00
Kopësht botanik	PA	0	0.00	0.00	10.0	2.09	2.40
Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	PA	13,853	2443.77	3,641.98	13,943.0	2,916.88	3,347.02
Pyje (pyllëzim)	PA	1,898	334.82	498.99	70	14.64	16.80
Zona të mbrojtura natyrore	PA	25,440	4,487.80	6,688.22	28,483	5,958.75	6837.44
Gjelbërim i veçantë	PA	42,209	7,445.98	11,097.00	43,976	9,200	10,556

Burimi: Bashkia Fier, 2016

- **Burimet kryesore të ndotjes**

Burimet kryesore të ndotjes në Bashkinë Fier janë industria naftënxjerrëse, aktivitete të tjera industriale dhe mjetet motorike (automjetet) në zonat urbane.[187]

Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria etj.). Megjithatë, në Bashkinë Fier, ndotja nga makinat dhe industria e nxjerrjes së naftës mbeten burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Fier.

Figura 72. Vlera mesatare e treguesve të monitoruar 2002-2014.



Burimi: MM 2002-2012 dhe AKM 2014, Punoi: Co-Plan

***Industria e nxjerrjes së naftës*:** sipas të dhënave të ish-Bashkisë Fier, shkakton ndotjen e ajrit me SO_2, H_2S, CO_2, avuj uji dhe mbetje të karbonit. Zonat të cilat ndodhen në afërsi të këtyre industrive janë shumë të prekura nga smogu, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme jo vetëm në mjedis, por edhe shëndetin e njerzëve. Shpeshherë, në këto zona janë raportuar sëmundje të rënda kancerogjene në rrugët e frymëmarrjes.

***Ndotja nga mjetet e trasportit*:** Sipas të dhënave nga Bashkia Fier, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e trasportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO_2 përkatësisht),
- substancat sulfurike (SOx),
- lënda e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM_{10} dhe $PM_{2.5,}$ kryesisht),
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve),
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC).

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth ***5 ton CO_2 në vit*** (4.7 ton metrik)[188]. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si më poshtë.

Figura 73. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë.



Lënda djegëse	Gallon	g/Gallon	g/Liter
Benzinë	1	8,887	2,347.70
Naftë	1	10,180	2,689.27

Burimi: US EPA, 2016

Sasia e ndotësve që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobuz urban, kamion etj.), mosha dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet atmosferike (shi apo diell etj.), gjendja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës etj.[189]

Në rast ndryshimesh të këtyre kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

***Rritja e numrit të makinave*:** Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë.[190] Ndërkohë, në Bashkinë Fier, numri i makinave të regjistruara është më i vogël se mesatarja kombëtare, 78 makina/1000 banorë (INSTAT 2011) ose një total prej 9,555 makina në nivel Bashkie dhe 4368 makina në Qytetin e Fierit. Numri i makinave në Bashkinë e Fierit për vitet 2015-2016 mungon.

Figura 74. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite[191]



Burimi: Ministria e mjedisit dhe UNDP, 2016[192]

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike. Nga statistikat e viteve 2005-2013,[193] ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Figura 75. Numri i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave që transportohen me tren në Shqipëri.



Burimi: Ministria e mjedisit dhe UNDP, 2016[194]

Me rritjen e makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO_2, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO_2 në vit/makinë, sasia e CO_2 e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) ***në nivel bashkie është rreth 47,775 ton CO_2/vit*** (9,555 automjete x 5 ton CO_2/automjet ne vit = 47,775 ton/CO_2/vit) ndërsa në nivel ***qyteti 21,840 ton CO_2/vit***. Pra, 45.7% e sasisë së gazrave të dioksidit të karbonit shkarkohet vetëm në Qytetin e Fierit.

Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni etj.) po shtohen. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të shtetit shqiptar kanë shkuar në infrastrukturë rrugore[195]. Ndërkohë, transporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asociimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-së[196]. Megjithatë, fondet për zhvillimin e trasportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse: Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qendror Teknik. Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*[197], *benzinës dhe solar-mazutit*. Mostrat e analizuara për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin.

Figura 76. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara.



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Co-PLAN[198]

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur më poshtë[199]

Tabela 25. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri.

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numër)
11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
Totali	**122**			**31**

Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik)[200]

Për naftën, nga 122 mostrat e analizuara, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuara, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 129% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.

Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në naftë është *10 ppm*. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezulton se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër. Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendence në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë squfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e squfurit në rastin e naftës arrin kufij më të lartë se sa në rastin e benzinës (figura 65).

Figura 77. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %).



Burimi: AKM (Inspektorati Qendror Teknik), Përpunoi: Co-PLAN[201]

Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin[202]. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë squfuri (mbi 3%). Në bazë të standardit S SH UNI 6579, për analizimin e lëndës diegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në gazoil është < 3%. Nga mostrat e analizuara rezulton se përmbajtja e squfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lënda djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.[203]

Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë së Automjeteve, përgatitur nga ECAT[204], në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet se *87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën* dhe *13% benzinën*.

Ndotja nga mosha e vjetër e mjeteve të transportit: Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura[205]. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.[206] Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës djegëse.

Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara ***para*** vitit 1986 dhe 27% e atyre ***pas*** vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pamvarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koefiçentin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është është K 2.5.[207].

Figura 78. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit.



Burimi: ECAT 2008[208], Përpunoi: Co-PLAN

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por në motorat e vjetër përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.[209]

***Ndotja nga sektori i ndërtimit*:** Sipas të dhënave nga Bashkia Fier, burim tjetër për ndotjen e ajrit janë edhe ndërtimet e reja në zona të ndryshme të qytetit, të cilat ndonëse janë të pajisura me VNM[210], ku përcaktohen qartë rregullat që duhet të ndjekin kantierët e ndërtimit, ndodh shpesh që punimet kryhen pa marrë masat e nevojshme dhe koha e ndërtimit është më e gjatë se sa është planifikuar. Në shumë raste, zonat e banuara janë pre e pluhurit (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$)

në ajër të shkaktuar nga kantierët e ndërtimit të ndërtesave dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë.

***Vend-depozitimet e mbetjeve*:** Janë një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjieno-sanitare për depozitimin e mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka ka aromë të keqe dhe, në përqendrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

***Sektori i bujqësisë**:* gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e Bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

- **Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut**

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj., shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O_3, CO, CO_2, SO_x (SO_2), PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), Pb, VOC dhe O_3. Më poshtë sillet një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasojat akumulative/grumbulluese).

Monoksidi i karbonit (CO)[211]: Ekspozimi ndaj përqendrimeve të larta të monoksidit të karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve, të përziera dhe të vjella. Problem kritik ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatëzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e demtimit të fetusit, lindjen e foshnjës me peshë të ulët dhe dëmtim të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shatëzëna, të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulëta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngët.

Dioksidi i karbonit (CO_2)[212]: Dioksidi i Karbonit në formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjedis me përqendrim të $CO_2 \geq 10\%$ mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjenjash, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqendrimi të lartë të CO_2 mund të dëmtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO_2, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë problem me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtimin e sistemit nervor qëndror, kontraktimin e muskujve, ngritjen e tensionit të gjakut. Gjithashtu ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, problem me lekurën, djegie të syve dhe zhurma në vesh.

SO_2[213]: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO_2 në ajër mund të jetë i rrezikshëm për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve më të ulëta të SO_2 mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mblidhen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj

grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe te njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO_2.

PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$)[214]: Është vërtetuar shkencërisht se përqëndrimet e larta të grimcave në ajër (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohëshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet që përdorin lëndë djegëse diesel, janë vërtetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.

Pb[215]: Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme, dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pamvarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera dhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

VOC[216]: Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe sistemit nervor qëndror. Ndësa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojnë probleme në sy, acarim të rrugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

O_3: Ekspozimi ndaj përqendrimit të lartë të Ozonit (O_3) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O_3 mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike, si dhe mund të rritë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, zvogëlojë sistemin imunitar, përkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe të shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simtomat fillestare të ndikimit të O_3 në shëndet fillojnë me irritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shkaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt dhe në gjoks. Futja e O_3 në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku, si dhe lodhje dhe të vjella.

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Ndotja e ajrit në Bashkinë Fier shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, industria e naftës në zona të caktuara dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si industria dhe ndërtimet. Për më tepër, ndotja theksohet edhe për shkak të mungesës së sipërfaqeve të gjelbra urbane sipas standardeve. Fatkeqësisht, në Bashki cilësia e ajrit nuk monitorohet rregullisht për shkak të mungesës së monitorimeve të vazhdueshme në kohë me pajisje fikse.

Me qëllim shmangien e rreziqeve që i kanosen banorëve në zonat urbane (kryesisht nëpër zonat e qyteteve) nga ndotja e ajrit nga mjetet e transportit dhe nga burime të tjera industriale (nga nafta) apo nga sektori i ndërtimeve, është tejet e rëndësishme që të merren masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit nga shkarkimet e automjeteve të transportit në nivel bashkie dhe burimeve të tjera ndotëse.

Ndotja e ajrit në Bashkinë Fier ndihet kryesisht në zonat më të populluara urbane (në zonat qendrore të qytetit) dhe në zonat naftënxjerrëse. Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit rekomandohet marrja e masave për uljen e ndotjes në ajër, veçanarisht në zonat urbane dhe të naftës. Disa nga këto masa mund të jenë planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimin e politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e hapësirave të gjelbra, bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore si dhe kufizimin e ndërtimive në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Fierit dhe në zonat naftënxjerrëse gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që nevojitin plane të cilësisë së ajrit

D. Pyjet dhe Kullotat nën Administrim

Mbështetur në VKM Nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë" sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor publik janë transferuar në pronësi të Bashkisë Fier, me përjashtim të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor që janë pjesë e territorit të zonave të mbrojtura.

Sot, Bashkia Fier ka në pronësi të saj 5,288.85 ha sipërfaqe pyjore dhe kullosore, pa zonat e mbrojtura. Sipërfaqen më të madhe e zë ajo pyjore me 2,827.99ha të sipërfaqes totale e ndjekur nga sipërfaqet improduktive me 937.00ha dhe sipërfaqet bimore dhe pyjore me vlera të përafërta (371.24 dje 387.85 përkatësisht). Interes paraqesin dhe sipërfaqet kullotëse, me një sipërfaqe 537,10 ha.

Më poshtë do të paraqesim dhe kategoritë e përdorimit të sipërfaqes pyjore dhe kullosore në bashki në përqindje.

Tabela 26. Kategoritë e përdorimit të territorit në përqindje

Nr.	Kategoria e përdorimit të sipërfaqes pyjore dhe kullosore në nivel Bashkie	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja (%)
1	Ara	34.50	0,59
2	Djerrë	41.50	0.57
3	Inproduktive	937.00	15.93
4	Kullotë	537.10	9.1
5	Pyll	2827.99	48.1
6	Sipërfaqe bimësie	371.24	5.6
7	Ujore	387.85	6.6
8	Boshe	38.00	0.7
9	Pa Info	113.65	1.9

10	Zonë e mbrojtur	592.07	10.91
	Sip. TOTALE pa ZM	5288.85	
	Sip. TOTALE me ZM	5880.90	100

Punoi : Co-PLAN, 2016

Figura 79. Shpërndarja e sipërfaqeve pyjor e kullosore sipas NJA-ve në Bashkinë Fier (në %)



Burimi: Bashkia Fier, Përpunoi: PLGP/Co-PLAN

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kategoritë e përdorimit të ekonomive pyjore/kullosore në secilën prej Njësive Administrative të bashkisë. Sipërfaqet janë paraqitur të ndara në tre kategorive kryesore që janë pyje, kullota dhe sipërfaqe bimësie. Në këto zona ka dhe toka djerrë, tokë iproduktive, boshe por edhe sipërfaqe për të cilat bashkia nuk ka të dhëna rreth përdorimit të tyre.

Tabela 27. Shpërndarja e ekonomive pyjore në Bashkinë Fier

Nr	Ekonomia pyjore/Kullosore	Kategoria e përdorimit	Sipërfaqja (ha)	Totali (ha)	Totali (%)
NjA FRAKULL					
1	Levan-Shtyllas	Pyll	145.15	674.72	12.76
		Djerrë	10.6		
		Sipërfaqe bimësie	101.35		
	Lumi Vjosë	Sipërfaqe bimësie	71.52		
		Pa Info	22.8		
	Peshtan-Cakran	Pyll	307.3		
		Sipërfaqe bimësie	16		
NjA CAKRAN					
2	Rromes	Pyll	89.4	1,124.47	21.26
	Lumi Vjosë	Pyll	137.4		
	Peshtan-Cakran	Pyll	416.57		
	Cakran-Roskovec	Kullotë	481.1		
NjA LIBOFSHË					
3	Vjakan-Libofshë	Pyll	30	1,169.93	22.12
	Bregdet Seman Ndernenas	Pyll	24		
		Ujore	200		
		Inproduktive	752		
	Lumi Seman 1	Pyll	86.1		

		Sipërfaqe bimësie	48.43		
		Djerrë	29.4		
NjA TOPOJË					
	Bregdet Seman Ndërnenas	Pyll	232	662.5	12.53
		Ujore	100		
		Inproduktive	186		
4	Lumi Seman 1	Pyll	144.5		
NjA LEVAN					
	Pishë	Pyll	5.9	214.25	4.05
	Levan-Shtyllas	Pyll	27.75		
		Sipërfaqe bimësie	33.2		
5		Bosh	7		
	Lumi Vjosë	Sipërfaqe bimësie	13		
		Pa Info	59.75		
	Peshtan-Cakran	Pyll	67.65		
NjA QENDER					
6	Lumi Seman 1	Pyll	81.42	81.42	1.54
NjA MBROSTAR					
	Vjakan-Libofshë	Pyll	55.2	68.8	1.30
		Sipërfaqe bimësie	3.6		
7	Ana e Lumit Seman 2 Rroskovec	Sipërfaqe bimësie	10		
NjA DERMENAS					
	Bregdet Pishë-Poro	Pyll	282.7	473.2	8.95
		Ujore	87.9		
		Boshe	1.5		
	Cakran-Roskovec	Kullotë	56		
	Levan-Shtyllas	Sipërfaqe bimësie	5		
8	Pishë	Pyll	40.1		
NjA PORTËZ					
	Lumi Seman 2 Roskovec	Sipërfaqe bimësie	31	819.54	15.50
		Djerrë	1.5		
	Kraps Gjorgos	Pyll	680.72		
		Sipërfaqe bimësie	38.72		
		Boshe	36.5		
9		Pa Info	31.1		
TOTALI		**5,288.83**			**100.00**

Punoi: Co-PLAN, 2016

Nga tabela vihet re se NjA Cakran dhe Libofshë kanë sipërfaqen më të madhe me pyje, kullota dhe sipërfaqe me bimësi. Në të dy NJA-të është e përqëndruar 21-22% e shumës totale të fondit pyjor e kullosor. Në Frakull gjendet sipërfaqja më e madhe e tokës djerrë (10.6 ha) ndërsa në Kraps Gjorgos të NjA Portëz gjendet sipërfaqja më e madhe pyjore (680.72 ha). Sa i përket sipërfaqeve të fondit kullosor në Cakran-Roskovec të NjA Cakran, 481.1ha janë sipërfaqe kullosore.

Fondi Pyjor është paraqitur më poshtë i hartëzuar në GIS duke u bazuar tek hartat e viteve 1984-1985 dhe ndryshimet e fondit pyjor të identifikuara në ortofoton e 2015 dhe *Google imagery 2016*.

Figura 80. Harta e fondit pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Fier, Përpunoi Co-PLAN, 2016.

Për sa i përket pronësisë së pyjeve në Bashki mbas ndarjes së re administrative, 4,140.9ha sipërfaqe pyjore i përket Bashkisë Fier, ndërkohë 7,221ha shfaqen në pronësi të Bashkisë sipas hartave e vjetra të viteve 1984-1985 tashmë të dixhitalizuara.

Një vend të rëndësishëm në Bashkinë Fier e zënë edhe zonat e mbrojtura me një sipërfaqe totale prej 592,07 ha. Pyjet dhe zonat e mbrojtura nuk janë pjesë e fondit pyjor të bashkisë por mbeten gjithsesi një pasuri e saj. Zonat e mbrojtura përbëjnë një sipërfaqe me shumëllojshmëri faune dhe flore, pasuri e cila duhet ruajtur dhe mbrojtur nga dëmtimet që mund t'i shkaktohen. Zonat e mbrojtura në Bashkinë e Fierit janë të lokalizuara kryesisht në NjA-të Levan, Dërmenas dhe Libofshë. Të dhënat rreth zonave të mbrojtura në Bashkinë Fier në nivel sipërfaqeje janë paraqitur më poshtë.

Tabela 28. Ekonomitë pyjore/kullosore në zonat e mbrojtura,Bashkia Fier

NjA-të	**Ekonomia Pyjore/Kullosore (Zonë e Mbrojtur)**	**Kategoria e përdorimit të territorit**	**Sipërfaqja (ha)**
Levan	Levan Shtyllas	Pyll	173.05
		Bosh	7
Dermenas	Bregdet Pishe - Poro	Pyll	66.1
	Pishë	Pyll	322.3

Libofshë	Lumi Seman 1	Pyll	20.6
Nëntotali		Bosh	7
		Pyll	582.05
TOTALI		592.05	

Punoi : Co-PLAN, 2016

Në NjA Dermenas, në zonën Pishë sipërfaqja pyjore zë 322.3ha, më shumë së gjysma e sipërfaqes totale. Ndërsa në NjA-në Libofshë në Lumin Seman 1 shtrihet edhe sipërfaqja më e vogël e fondit pyjor prej 20ha. Një sipërfaqe prej 7ha në zonën Levan Shtyllas është boshe, sipërfaqe kjo e cila e çon totalin e fondit pyjor në këto zona në 582,05ha.

Në veri në NjA- Libofshë ndodhet monumenti natyror i "***kurorës***" ku gjenden edhe grupimet e pemës së Rrënjës (*Cearcus Robur*) dhe Vidhit. Në jugperëndim, në grykëderdhje të lumit Vjosa në NjA Levan shtrihet zona e mbrojtur e "***Pyllit të pishës***" me faunën dhe florën specifike e cila ndahet mes bimëve jo tolerante dhe tolerante ndaj kripës si bima e Marinës (Tamarix) e cila ndihmon në pastrimin/rimëkëmbjen e tokave të kripura, bimësia barishtore si kashta, jambruku, pirra, xhuka e butë dhe e egër, si dhe në afërsi të trupave ujorë me ujë të ëmbël gjendet kallami i egër. Në Jug, në kufi mes NjA-ve Levan dhe Frakull ndodhet "***Pylli Hajler, Levan"*** ku rriten edhe grupimet më të reja të drurit të lisit (Quercus petrea). Këto monumente natyrore mbeten pikësorë për Bashkin Fier, pasi paraqesin potencial për zhvillim të turizmit natyror. Elementë të fortë natyrorë në territorin e Bashkisë mbetet vetë topografia fushore, kodrinore dhe specifikisht pasuritë e shumta ujore të cilat bëjnë pjesë edhe në rrjetin e zonave të mbrojtura. Disa nga këto pasuri ujore janë Vija Bregdetare dhe ligatinat, rezervuaret si ai i Zharrëzës, Lalarit, Tërbullit, Frakullës dhe Libofshës, lumenjtë Vjosë, Gjanicë dhe Seman si dhe Kanali i Vijës së Ngjalës. Të gjitha këto pasuri ujore kanë ndikim të vazhdueshëm në territor duke tërhequr vazhdimisht aktivitetin njerëzor si me të mirat dhe të këqijat e tij, ndaj edhe mbrojtja e vazhdueshme e këtyre zonave mbetet prioritet për të shmangur konfliktet me mjedisin.

- **Problematikat e fondit pyjor e kullosor**

Mungesa e invetarizimit të fondit pyjor e kullosor: të dhënat rreth sipërfaqeve pyjore e kullosore në vendin tonë dhe në Bashkinë Fier bazohen në inventarizimin e bërë në vitet 1984-1985. Që nga regjistrimi i fundit, nuk ka patur përpjekje të reja për një inventar të përditësuar edhe pse me ligj parashikohet inventarizimi çdo dhjetëvjeçar. Si rrjedhojë, në vendin tonë dhe në Bashkinë Fier, të dhënat e inventarit të mësipërm shpesh nuk përkojnë me sipërfaqert aktuale pyjore e kullosore në terren.

Humbje të sipërfaqes pyjore: Një ndër problematikat kryesore të pyjeve në Bashki është humbja e sipërfaqes pyjore në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Nga inventarizimi i fundit i pyjeve në vitin 1984-1985 deri në vitin 2015, Bashkia Fier ka humbur ose tjetërsuar sipërfaqe pyje dhe kullotash në masën 23% të sipërfaqes së saj.

Probleme me llogaritjen e sipërfaqes pyjore për shkak të hartave të vjetra: Meqënëse analiza është kryher në GIS, vlen të merret parasysh ekzistenca e një niveli të vogël gabimi pasi hartat e vjetra janë të një teknologjie të vjetër, lexueshmëria e legjendës dhe simbolikës është e vështirë si dhe mbivendosja me ortofoton e 2015 gjithashtu krijon një nivel gabimi si pasojë e ndryshimeve në territor. Vizitat e vazhdueshme në terren dhe puna e specialistëve të DSHP-së mund të zgjidhi përfundimisht këtë ngërç duke saktësuar informacionin.

Mungesë dixhitalizimi: Kohët e fundit Bashkia Fier ka marrë në dorëzim materialet përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që kanë marrë në pronësisë, pas ndarjes së re administrative. Aktualisht, ka filluar procesi i dixhitalizimit të këtyre hartave.

Problematika specifike tjera sipas pyjeve: Në analizën e mëposhtme identifikohen disa nga Ekonomitë Pyjore që i përkasin Fondit Pyjor të Bashkisë Fier si dhe problematikat kryesore

Objekti i Malit të Cakranit: Objekti i Malit të Cakranit ndodhet në NjA Cakran të Bashkisë Fier. Në këtë objekt gjendet material drusor i rrëzuar i cili në mënyrë jo të drejtpërdrejtë bëhet burim infeksioni për drurët e tjerë. Si pasojë e shpërbërjes së materialit drusor në ndërverprim me kushtet atmosferike dhe pedologjike, prerjet e paligjshme, kullotjet pa leje të cilat aktualisht janë sporadike por të pranishme, mungesa e një strategjie afat gjatë për përdorimin e objektit si pikë turistike dhe promovimi i tij janë disa nga problematikat aktuale me të cilat përballet objekti. Si rrjedhojë, heqja e materialit drusor të rrëzuar, ripyllëzimi me bimë të cilat i rezistojnë erërave të forta dhe kushteve atmosferike dhe pedologjike, promovimi i burimeve natyrore të objektit dhe shpallja e tij si pikë me interes turistik janë disa nga qasjet të cilat mund t'i jepnin zgjidhje problemeve që mbart dhe, si rrjedhojë, edhe mbrojtjes së tij.

Objekti Kurora: (Kurora është Monument Natyre dhe aktualisht transferuar ish-Komunës Libofshë me V.K.M nr. 89, ndaj dalja e V.K.M-së së re e cila do ti kalojë pronat pyll Bashkisë duhet të thjeshtëzojë realizimin e qëllimeve për administimin dhe mirë-menaxhimin e Kurorës.)

Mungesa e investimeve, mbrojtja e objektit nga prerjet e paligjshme, kullotja pa leje së bashku me mungesën e politikave promovuese të objektit si pikë me ineteres turistik, janë disa nga problematikat aktuale me të cilat përballet objekti. Si rrjedhojë, pastrimi i shesheve dhe koridoreve egzistuese, rrethimi i objektit nga ana ku kufizohet me tokë, mbrojtja nga kondravajtësit, informimi i publikut për ruajtjen, promovimi i burimeve natyrore të objektit, krijimi i vendeve shlodhëse brenda objektit, pastimi i trungjeve të plepave nga bimë parazitare si *Kulpres* ose *hedra helix* si dhe mbrojtja e drurëve të veçantë si *Rrënja* dhe *Vidhi* janë disa nga qasjet të cilat mund t'i jepnin zgjidhje problemeve që mbart dhe, si rrjedhojë, edhe mbrojtjes së tij.

Objekti i Kërrnicës: Shfrytëzimi pa kriter i objektit për peshkim, mbrojtja dhe shtimi i florës dhe faunës aktuale mbetet problematika më e madhe me të cilën përballet objekti i Kërrnicës.

Objekti i Argjinaturës së Lumit Seman: Kullotja pa kriter, erozioni dhe gërryerrja e shtratit të Lumit Seman janë problematikat kryesore, të cilat, nëpërmjet pyllëzimit të zonës ripariane dhe mbrojtjes së objekteve të pyllëzuara mund të rimëkëmbin sistemin ekologjik të objektit.

- Përfundime dhe rekomandime

Ruajtja e fondit pyjor përbën aktualisht një ndër problematikat më të mëdha në vendin tonë dhe jo vetëm. Në rang bashkie, sipërfaqet e fondit pyjor kanë të nevojshme:

- *Hartimin e planeve për menaxhimin e të çdo ekonomie pyjore e kullosore* në Bashki. Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar NjA-së Cakran sepse aty ndodhet një numër i madh pemësh i rrëzuar.
- *Mbjellja e zonave ripariane* përgjatë lumit Seman me qëllim kthimin e këtyre zonave në objekte mbrojtëse dhe rigjenerimin e florës dhe faunës.
- *Marrja e masave për ndalimin e peshkimit pa kriter* në Objektin e Kërrnicës duke krijuar mundësinë e shtimit të faunës në zonë.

- Hartimin e një *Plani Veprimi për rehabilitimin e sipërfaqeve të djegura* që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale (për shembull. sipërfaqet me pisha) por dhe mbjelljen e tyre me pemë të cilat kanë qënë autoktone.
- Marrjen e *masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarreve*, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjt e zonës)

E. Ndryshimet klimatike

- **Ndryshimet klimatike në Rajon**

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- rritja e temperaturës me 1.7 – 3.5^{o}C deri në vitin 2100,
- ulja e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi i regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[217].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësimin e ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshimeve të habitateve, paksimin e numrit dhe llojeve të specieve, shtimin e llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.[218]

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materiale për ndërtim dhe të korra, të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës që është zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike që parashikohet të ndodhin në rajon renditen më poshtë:[219]

- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperatures do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëborës parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin nga kjo.
- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

- **Ndryshimet klimatike në Shqipëri (ndikimet në Bashki)**

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të këtë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë[220]:

- rritja e temperaturave,
- ulja e sasisë së reshjeve,

- shtimi i fenomeneve ekstreme të motit,
- rritja e nivelit të detit[221].

Sipas të dhënave të nxjerra nga kërkimet e shumta në lidhje me **ngrohjen globale** dhe efektet e saj në territor, edhe për Bashkinë Fier sektorët që do të preken më shumë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore[222]. Gjatë vitit 2014, zona e Darëzesës ishte dëshmitare e përmbytjeve masive, ku u dëmtuan shumë kultura bujqësore dhe vendbanime. Në kushtet kur niveli i detit do të rritet deri me 24cm në vitin 2050 dhe njëkohësisht me rritjen e nivelit të lumit Seman, shumë sipërfaqe jo vetëm bujqësore, por edhe vendbanime do të përmbyteshin dhe do të humbnin funksionin e tyre. Për këtë arsye duhet menduar strategjikisht për ndërtimin e pritave mbrojtëse për mosdepërtimin e ujërave të detit në tokat fushore të zonës së Myzeqesë.

Rritja e temperaturave: Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990.

Tabela 29. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990).

Stinët		**Vitet**		
	2030	**2050**	**2080**	**2100**
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[223], Punoi: Co-Plan

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7^{o}C dhe skenari maksimal 2.2^{o}C. Ndërsa në vitin 2080 temperatura mund të rritet me 2.8^{o}C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar mendohet të arrijë shifrën 3.5^{o}C. Në vitin 2100 temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1^{o}C.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8^{o}C në vitin 2050 dhe një rritje me 4.6-6.0^{o}C në vitin 2100, referuar me temperaturat e vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25^{o}C në vitet 2050 dhe në 30oC në vitin 2100.

Figura 81. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës.



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[224], Përpunoi: Co-Plan

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta, dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 30. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend.

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 1961-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Nr. i ditëve me Tmaks >35° C	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. i ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperaturë të ftohtë	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi:Ministria e Mjedisit 2016[225], Punoi: Co-Plan

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme, përgjatë gjithë viteve të ardhshme deri në vitin 2100, do të kemi një rritje të ditëve më temperatura maksimale mbi 35°C, ku ng 1.7-5.8 ne periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, nërsa në pjesën qëndrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, ditët me valë të nxehta do të rriten përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990 në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qëndrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë aspak të pranishme në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valët e të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 31. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime.

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me Tmin < 0°C	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
Ditë me valë të ngrohta	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390
	Jug	1168	1130	1110	1090	10702

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[226], Punoi: Co-Plan

Si pasojë e rritjes së temperaturës, rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësira të konsiderueshme dhe të nxehta. Ndikim të menjëhershëm do të ketë

në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjat vitit (Tabela X).

Tabela 32. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje më vitin 1990.

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3to 10.75)	-14.26 (-45.1to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[227], Punoi: Co-Plan

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080 dhe deri në mbi 18% në vitin 2010. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore (Tabela X), vihet re se stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhë të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Fier do të ketë një sërë problemesh në zhvillimin bujqësor, i cili është sektori me numrin më të madh të të punësuarve në territor. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet më kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje dhe njga ana tjetër një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve të bujësisë (parazitë, mikrobe, insekte), do të jetë një problem ekzistent më rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Për zhvillimin e sektorit bujqësor sa më të qëndrueshëm duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për adoptimin e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve, në vendin tonë kanë qënë të pranishme fenomenet ekstreme te motit si përmbytjet, valët e të nxehtit, etj. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve i ndihmuar nga shirat intensive që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të teritorit të Fierit janë bërë pre e përmbytjeve të vazhdueshme nga lumenjtë (Vjosa dhe Seman). Në vitet e fundit, ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave intensivë, të cilët janë tepër problematikë në fryrjen e menjëhershme të lumenjëve, dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet

që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përballimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

Rritja e nivelit të detit[228]: Niveli i detit Adriatik ka pësuar një rritje prej 15cm gjatë shekullit të shkuar, Në dekadat e ardhshme deri në vitin 2100, niveli i detit pritet të rritet me 40cm. Rritja e konsiderueshme e nivelit të detit do të sjellë një sërë pasojash negative përgjatë vijës bregdetare, kryesisht në tokat bujqësore, habitatet bregdetare dhe mbi zonat turistike. Si rezultat i ritjes së nivelit të detit, deri në vitin 2050, rreth 1,082.45km^2 (32% e zonës bregdetare, osë 3.76% e sipërfaqes së vendit) do të vuajë pasoja të drejtpërdrejta nga përmbytjet. Pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore do të konsiderohen të humbura, apo të papërdorshme, për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe kripëzimit. Shumica e habitateve bregdetare të tilla si dunat ranore, ligatinat me ujë të njelmët, lagunat, do të pësojnë ndryshime të konsiderueshme, disa prej tyre do të kenë humbur totalisht funksionin dhe të tjera do të jenë të dëmtuara në shkallë relativisht të lartë.

Në vitet e fundit, SHGJSH-ja ka raportuar fenomenin e depërtimit të ujërave të kripura të detit në Akuiferin kuaternar të Vjosës. Ky fenomen raportohet të ketë prekur rreth 45 - 53% të sipërfaqes së tij duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e ujërave të akuiferit, sidomos në pus-shpimet **Kafaraj,** ku është vënë re përmbajtje e lartë e klorit mbi vlerat e lejuara (rreth 293 mg/l kundrejt 250 mg/l që është vlera e lejuar) si pasojë e këtij fenomeni.[229] Vlen të përmendet se pus-shpimet e Kafarajt furnizojnë me ujë të pijshëm qytetin e Fierit dhe fshatrat përreth. Sipas SHGJSH-së, depërtimi ka ndodhur si rrjedhojë e mbishfrytëzimit dhe shfrytëzimit të ujërve nëntokësore, sidomos në krahun e majtë të lumit Vjosa. Gjithashtu ky fenomen ka ndikuar së tepërmi në intensifikimin e erozionit bregdetar dhe kripëzimin e tokave bregdetare, duke i kthyer në toka joproduktive, apo me rendiment të ulët prodhimi. Në të ardhmen këto problem pritentë rriten, gjithashtu, duke u bazuar në lartësinë e ulët mbi nivelin e detit në të cilën ndodhen disa zona të banuara, shumë shpejt do të hasen probleme serioze nga rritja e nivelit të detit, e cila është parashikuar (38-40 cm deri në vitin 2100).

- **Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike**

Bujqësia[230]: Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndjeshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve etj.). Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjen e kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me ritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësirës dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet klimatike, pasi rritja e temperaturës shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarine e tyre ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Fier, sektori i bujqësisë është shumë i rëndësishëm për ekonominë e zonës. Problemet që sjell ndryshimi i klimës do të shkaktonin një ndikim të madh negativ në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, si pasojë uljen e të ardhurave për banorët. Problemet kryesore në territorin e bashkisë mund të hasen në përshtatjen e kulturave me ndryshimin e klimes, plotësimin e kërkesës për ujë për vaditje dhe humbjen apo kripëzimin e tokave bujqësore nga rritja e nivelit të detit.

Burimet ujore (Energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)[231]: Përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtesia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave itensive parashikohen të jenë më të shpeshta duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend plotësohet nga HEC-et, rritja e temperturës do të shtojë mungesën e ujit për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji dhe bujqësinë. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrirja e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi etj. Prodhimi i energjisë pritet të ketë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qënë së ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq diferenca midis prodhimit dhe nevojës së ujit mund të zbuten me çështje teknike dhe të politikave.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jetë një problem serioz dhe më i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimit në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimtarisë.

Turizmi[232]: Kontributi i sektorit të turizmit për PBB-në është 7.6%, referuar vitit 2009. Ndryshimi i klimës është parashikuar të ketë një ndikim jo të vogël në sektorin e turizmit në vend, pozitiv dhe negativ. Deri në vitin 2030 parashikohet që periudha tetor-maj të jetë e papërshtatshme për turizëm ndërsa periudha tjetër do të ofrojë një rehati për zhvillimin e turizmit të diellit dhe detit. Të dhënat për vitin 2050 përcaktojnë prillin si muaj të pranueshëm për zhvillimin e turizmit bregdetar, ndërsa periudha maj - tetor cilësohet si e shkëlqyer për shvillimin e turizmit bregdetar. Parashikimet për vitin 2080 përcaktojnë vetëm muajt dhjetor, janar dhe shkurt si të muaj të papërshtatshëm për turizem diellor e detar, ndërsa muajt e tjerë janë mëse të përshtatshëm. Aktualisht, 80% e turistëve që hyjnë në Shqipëri janë të përqëndruar në zonën bregdetare. Me rritjen e temperaturave, ky numër pritet të rritet duke çuar kështu në rritjen e presionit ndaj mjedisit, ndotjes të zonave nga mbetjet, ndotjen e ajrit dhe ujit. Manaxhimi i mbetjeve, ujërave të ndotur urbane si dhe siguria për ujë të pastër është një nga sfidat kryesore me të cilat do të përballet sektori i turizmit në vend.

Në territorin e Bashkisë Fier, turizmi zë një pjesë të ndjeshme të ekonomisë vendase, kryesisht ai bregdetar, i cili zhvillohet kryesisht në Darzezë, Ishëm, Pishë-Poro. Zona bregdetare e territorit të Bashkisë, krahas rritjes së periudhës së përshtatshme për të zhvilluar turizmin bregdetar nga parashikimet e rritjes së temperaturave, do të haset me një sërë problemesh të tjera, ndaj të cilave duhen planifikuar masa të vazhdueshme të cilat duhet të monitorohen vit pas viti. Fenomenet të cilët do të ndikojnë negativisht në zhvillimin e turizmit bregdetar janë: rritja e nivelit të detit dhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit. Rritja e nivelit të detit do të sjellë përparimin e tij në drejtim të tokës (rritja e parashikuar 38-40cm deri në vitin 2100) [233] dhe vija bregdetare do të përballet me ndryshime të

konsiderueshme, plazhet me rërë të cilët sot janë të pranishëm do të pësojnë tkurrje e deri zhdukje, aktivitetet ndihmëse të turizmit (hotele, bare, restorante etj.) do të jenë pre e erozionit bregdetar dhe perparimit të detit në drejtim të tokës, duke i përmbytur e demtuar deri në shkatërrimin e tyre. Në këtë situatë të parashikuar nga skenaret e mundshme mbi rritjen e nivelit të detit, do të shihet një ndikim i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e turizmit dhe ekonomisë që varet prej tij. Për këtë arsye duhen parashikuar masa që në kohë të hershme.

Popullsia: Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe në veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizëm dhe bujqësi. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikrobeve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peisazhit). Rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet e lumenjve do të jenë një problem tepër shqetësues në zonat fushore, kënetat apo ish-kënetat të cilat janë në disnivel nga deti (deri në 2m). Në këto zona ka ardhur në rritje numri i popullsisë që nga viti 1950, kur toka bujqësore është përfituar nga bonifikimi i kënetave dhe shkripëzimi i tokave në afërsi të vijës bregdetare.

Përveç ndikimit mbi popullsinë, një numër i konsiderueshëm i banesave të ndërtuara gjatë 24 viteve të fundit pritet të dëmtohen nga përmbytjet. Rreth 41,625 banesa të vendosura deri në 0.5 m mbi nivelin e detit rrezikohen të përmbyten deri në vitin 2030, dhe 48,730 ndërtesa të cilat janë ndërtuar mbi nivelin e detit priten të preken nga përmbytjet pas vitit 2050. Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasi shumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuences së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturë sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte etj. [234]

Siç shikohet, ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.[235] Në këtë kontekst shihet mëse e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masat për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtjen ndaj erozionit të tokës etj.

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të theksuar në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.[236] Në këtë kontekst, shihet mëse e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtjen nga erozioni i tokës dhe ai detar etj.

Duke vëzhguar me kujdes skenaret e trajtuara më sipër, popullsia në territorin e Bashkisë Fier do të përballet me jo pak probleme në të ardhmen ndër të cilat mund të përmendim:

përmbytjet nga rritja e nivelit të detit, shtimin e rasteve të zjarrit, thatësirat e zgjatura, përmbytjet nga fryrja e rrjedhave të lumenjëve dhe kërkesat në rritje për ujë në bujqësi dhe në uljen e sasisë së ujit të përdorshëm për të. Njëkohësisht, parashikohet edhe humbje të sipërfaqes së tokës në pjesën bregdetare të territorit të bashkisë. Popullsia në territorin e Bashkisë, në zonat të cilat janë në kuota të ulëta mbi nivelin e detit, do të pësojnë dëmtime nga rritja e nivelit të detit, kripëzimin e ujit të pishëm dhe kripëzimin e tokave bujqësore. Ndërsa zonat e banuara në afërsi të brigjeve të lumenjve do të preken së tepërmi nga përmbytjet, të cilat priten të shtohen si pasojë e shirave intensive. Zhvillimi bujqësor do të sigurojë të ardhura më të pakta për banorët, pasi rritja e periudhës së thatësirave çon në rritjen e kërkesës për ujë dhe aktualisht kanalet ujitës nuk janë totalisht në funksion. Gjithashtu parazitet dhe shtimi i numrit të insekteve që trasmentojnë sëmundje do të jetë një problem serioz në përhapjen e epidemive të ndryshme.

F. Vatrat e nxehta mjedisore/hotspotet

Kryesisht, në Republikën e Shqipërisë ndotjet më të mëdha janë trashëguar nga aktiviteti industrial, i cili u zhvillua gjatë dekadave kur vendi udhëhiqej nga politikat e sistemit komunist. Të gjitha industritë e asaj kohe prodhuan mjaftueshëm mbetje të cilat qëndruan të magazinuara në nivele primitive të sigurisë teknike. Në vitin 1990, industria kontribuonte në më shumë se 37% të GDP-së në vend. Ky tregues u ul në 12% në vitet 1999 ku edhe sot karakterizohet nga ulje-ngritje të cilat janë kryesisht produkt i politikave të paqëndrueshme miratuar e shfuqizuar në vendin tonë.

Problematikat lidhur me këto zona filluan të dalloheshin me shkatërrimin e këtyre industrive dhe lënien pa mirëmbajtje e kontroll të depozitave me kimikate dhe elementë ndotës në mjedis, afrimin e zonës urbane me ato industriale, si dhe edhe papërgjegjshmëria e individit e ndërlikuan mjaftueshëm situatën e këtyre vatrave.

Sot, numurohen të paktën 9-10 vatra të nxehta mjedisore (*prioritare*) në të gjithë vendin, por lista mund të zgjatet nëse tregohemi të matur dhe realistë kur marrim në konsideratë ndotjet e vazhdueshme të prodhuara nga ujërat e ndotura të zonave urbane dhe industriale si dhe vlerësojmë gjendjen e vend-depozitimeve në të gjithë vendin e veçanërisht në vend-depozitimet që ndodhen në brigjet e lumenjve apo në zona totalisht të papërshtatshme nga ana gjeologjike.

Në Bashkinë Fier, industria ka qenë boshti kryesor i zhvillimit të kësaj Bashkie si kryeqendër e rajonit, e fokusuar në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të naftës dhe prodhimin dhe riciklimin e vajrave.

Sipas raportit të UNECE-s mbi hotspotet në vendin tonë, të hartuar në vitin 2012[237], Bashkia e Fierit ka dy vatra të nxehta mjedisore që janë Uzina e Plehrave Azotike dhe zona naftënxjerrëse Patos-Marinëz. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i këtyre dy vatrave.

Uzina e Plehrave Azotike në Fier është identifikuar si zonë e nxehtë mjedisore. Në të ruhen ende në fuçi 25 ton NH_3 të lëngshëm, bakër dhe amoniak. Toka përreth uzinës rezulton e ndotur me nikel (Ni) në disa seksione të saj. Sipas AKM-së, me largimin nga objekti industrial nuk vihet re një ulje e ndjeshme e nivelit të përmbajtjes së metaleve të rënda përveç manganit dhe nikelit[238].

Zona naftënxjerrëse Patos-Marinëz, Ballsh e Kuçovë, edhe pse nuk është përcaktuar si vatër mjedisore, sipas raportit të UNEP-it, është e ndotur rëndë me hidrokarbure[239]. Në fushat e

naftës në Patos–Marinzë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore po ndoten rëndë nga puset e naftës, pompat, tubacionet, impiantet paratrajtuese. Në atmosferë po shkarkohen gazra sulfurike dhe hydrokarbone. Ujërat me përmbajtje mbetje të naftës po shkarkohen në lumë duke ndotur Gjanicën dhe mbase edhe duke ndikuar në cilësinë e ujërave të përdorura për pije[240].

Ndotje nga Rafineria e Naftës: Në ambjentet e ish-TEC-it në Fier, ushtron aktivitetin Rafineria e Naftës e cila është vrojtuar tek gjeneron ndotje në gjendje të gaztë dhe të lëngët. Krahasimisht me vite më parë, kur intensiteti i aktivitetit të kësaj hapësire industriale ka qënë i lartë, ndotja në ajër konsiderohet se është reduktuar ndjeshëm si pasojë e aktivitetit të reduktuar në këtë zonë.

Figura 82. Rafineria e Naftës në zonën e ish-TEC-it

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Pozicionuar në jug të qytetit, kjo hapësirë industriale prej 45ha e cila shfrytëzohet nga aktivitete private prodhuese, nevojitet që t'i është nënshtrohet një studimi në kuadër të hartimit të një projekti rehabilitimi, në të cilin janë duke u kryer sa më parë analizat specifike që paraqesin nivelet e ndotjes në tokë – ajër dhe ujërat nëntokësor prej të cilave do të rrjedhin edhe sugjerimet mbi metodat e ndryshme të rehabilitimit të kësaj zone.

***Zona të ndotura nga mbetjet*:** Sa i përket mbetjeve inerte është vlerësuar se në vitin 2009 janë gjeneruar 8400-9000 ton mbetje ndërtimore të depozituara në mënyrë të diferencuar në fushën e mbetjeve Fier. Gjithashtu këtu mund të përmendim se një sasi e konsiderueshme mbetjesh është gjeneruar gjatë ndërtimit të rrugës automobilistike By-Pass-i Fier (në proces ndërtimi) dhe autostradës Levan – Vlore (inaguruar në 2012). Këto mbetje inerte janë depozituar fillimisht në vend-depozitimet stacionare për t'u ripërdorur më pas për mbushje ose transferuar në fushën e mbetjeve Fier.

Aktualisht si gjenerues të mbetjeve inerte mund të përmendim ndërhyrjet infrastrukturore që po ndodhin në Bashkinë Fier si, Rehabilitimi i Ujësjellës Kanalizime Fier dhe ndërhyrjet për rrjetin nëntokësor të transmetimit të energjisë elektrike.

Gjenerues të mbetjeve inerte jane identifikuar edhe vete bizneset e regjistruara në Bashkinë Fier si edhe banorët e saj. Zhvillimi urban dhe infrastrukturor me ndërhyrjet e kryera deri me tani në kuadër të rritjes së cilësisës së jetës dhe përmirësimeve, kanë qenë një nga kontribuesit kryesorë të kësaj rryme të mbetjeve duke shkaktuar jo pak herë probleme me trajtimin e këtyre mbetjeve.

Kryesisht mbetjet jo-Bashkiake janë nën përgjegjësine manaxhuese të vetë gjeneruesit. Roli i vetëm i Bashkisë është të përcaktojë se një vend-grumbullim të përkohshëm për këto mbetje për sa kohë është edhe afati i lejes ndërtimore të subjektit

Gjatë vitit 2015, Bashkia Fier ka prodhuar një sasi mbetjesh prej 7217 ton, të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet si dhe prishjet e objekteve pa leje. Deri më sot, Bashkia nuk ka një vend-depozitim të posaçëm për depozitimin e mbetjeve inerte.

Qyteti i Fierit ka numrin më të madh të bizneseve të regjistruar në Bashki (530 biznese të mëdha dhe 1,860 biznese të vogla). Ndërkohë në lidhje me numrin e turistëve, vetëm NjA-ja Dërmenas deklaron se ka një numër prej relativisht 17,000 turistësh në vit në pjesën bregdetare të saj.

Gjithashtu vlen të theksohet se Industria kryesore e Bashkisë Fier është ajo e Naftës dhe Kimike, të pozicionuara e të shpërndara në të gjithe territorin e Bashkisë. Duke pasur një pasuri të tille si fushat naftëmbajtëse më të mëdha në Europë (Patos-Marinza), kjo i ka dhënë hov të fuqishëm zhvillimit të industrive përpunuese të naftës dhe kimikateve. Aktualisht në Fier, kapacitetet përpunuese të rafinerive nuk i kalojnë Ƞ=20% rendiment si edhe industria e plehrave kimike momentalisht nuk është aktive. Stoku i materialeve ndotëse të shpërndara për-rreth Bashkisë vlerësohet të jete i lartë dhe në nivele kritike lidhur me impaktin e tij direkt në shëndetin publik.

Mbetjet e gjeneruara nga industria e naftës në Marinzë dhe rafinerisë në Ballsh derdhen direkt në lumin Gjanicë duke e transformuar atë në një nga transportuesit më të mëdhenj të mbetjeve industriale në vend. [241]

Çdo muaj, vlerësohet se shkarkimet në lumin Gjanicë janë rreth 12.57 – 12.91 m^3 ujëra të patrajtuara dhe produkte të naftës ku ka rezultuar se përqëndrimi i naftës në këto ujëra shkon CC=0.2-6mg/l.[242]

Fabrikat tashmë jo-aktive të nitratit në Fier stokojnë mbetje kancerogjene shumë të rrezikshme të cilat nëpërmjet drenimit të ujërave të shiut derdhen në akuiferin e lumit Gjanicë. Janë rreth 850m^3 arsenik të groposura jo në kushtet teknike më optimale.

Si mbetje industriale me potencial ndotes mund të klasifikojmë edhe Ujërat e Ndotura Urbane, të cilat përmbajnë solucione dhe kimikate të ndryshme të përdorura nga njësitë familjare, si edhe shkarkime të ndryshme të bizneseve private. Këto ujëra të ndotura të cilat grumbullohen nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, janë identifikuar të shkarkohen direkt në Gjanicë në më shumë se dy pika të ndryshme.

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre aktiviteteve prodhojnë mbetje të rrezikshme dhe si të tillë janë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve nëpërmjet Ligjit 10463 dt.22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet rigorozisht të monitorohen, regjistrohen dhe transportohen siç përshkruhet në ligj. Më poshtë paraqitet lista ekzistuese e aktiviteteve gjeneruese të këtyre mbetjeve në Bashkinë Fier, të cilat janë të pajisura me Leje Mjedisore.

***Venddepozitimi i mbetjeve*:** Në lidhje me vend-depozitimet e mbetjeve, aktualisht qyteti i Fierit, Nj.A-ja Komuna Mbrostar, Nj.A-ja Komuna Portëz, Nj.A-ja Qendër dhe Nj.A-ja Komuna Topojë, i depozitojnë mbetjet <u>në vend-depozitimin e qytetit të Fierit</u>, 3km larg qendrës së qytetit. Makinat e bashkisë Fier ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve vetëm në zonat që janë të pajisura me kontenierë si Nj.A-ja Mbrostar, Portëz, Qendër, dhe Topojë. Mbetjet urbane depozitohen në afërsi të qytetit, në aksin hyrjes nga Tirana, 3km nga qendra e qytetit. Ky vend-depozitim ka mbi <u>40 vjet</u> që është në përdorim dhe është në <u>një gjendje alarmante</u>, pasi mbetjet aty nuk kalojnë në asnjë proces trajtimi. Një pjesë e mbetjeve përfundojnë në ujrat e lumit Seman, ku degë të tij kalojnë buzë vend-depozitimit. Aktualisht

ky vend-depozitim përbën një zonë të nxehtë mjedisore, e cila duhet sa më shpejt të mbyllet dhe të rehabilitohet.

Sipërfaqja e vend-depozitimit të mbetjeve është rreth 5.2 ha. Mbetjet shkarkohen në terren të hapur dhe hera-herës digjen. Trajtimi dhe eliminimi i tyre ende është shumë problematik, pasi kjo fushë është në përdorim prej më shumë se 40 vitesh, shumë pranë vijës ujore të Vijës së Ngjalës, ku toka është argjilore pa kullim dhe e parrethuar. Mjetet teknologjike që hyjnë në fushë depozitim kanë shumë vështirësi në hyrje dhe dalje, pasi infrastruktura është e papërshtatshme. Mbetjet të cilat mbërrijnë në vend-depozitim depozitohen në formë kavaletash me anë të dy mjeteve mjaft të amortizuara.

Njësia administrative Libofshë depoziton mbetjet në dy fusha depozitimi të autorizuara. Konkretisht këto fusha ndodhen në Agim tek brezi i argjinaturës, dhe në Ndërmenas.

Njësitë e tjera administrative përdorin disa vend-depozitime të improvizuara, të papërshtatshme, jashtë kushteve higjieno-sanitare, të cilat janë kthyer në zona të nxehta mjedisore. Në rastin e njësisë Cakran mbetjet nuk hidhen në asnjë vend të caktuar, vetëm përgjatë anëve të rrugëve të njësisë.

Në territorin e Bashkisë Fier aktualisht nuk ka asnjë impiant për trajtimin e mbetjeve, por nga qeveria shqiptare pritet së shpejti të ndërtohet landfill-ii për rajonin e Fierit. Kur ky projekt të jetë gati atëherë, të gjitha njësitë në territorin e bashkisë do të depozitojnë mbetjet në këtë landfill, dhe vend-depozitimet ekzistuese do të duhet të rehabilitohen me kalimin e kohës.

Figura 83. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi në harkun kohor 2005-2015.



Burimi: Bashkia Fier & Co-Plan

Vend-depozitimi në veri të qytetit, duke u kufizuar nga dy rrjedha sipërfaqësore si lumi Gjanicë dhe Kanali i Madh, kombinuar kjo edhe me elementët e sigurisë të cilët mungojnë në këtë sit përbën pikërisht një vatër të nxehtë mjedisore për Bashkinë Fier. Shpeshtitë e prurjeve maksimale qoftë të lumit Gjanicë apo edhe nga reshjet e dendura kanë përmbytur seksione të caktuara të këtij vend-depozitimi. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:

- emetimet e gazrave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme;
- shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore;
- infiltrimin e shllameve nga dekompozimi i mbetjeve në ujërat nëntokësore.

Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të lumit Gjanicë dhe kanalit të madh si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Nevojitet një plan për mznaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

Zonat me nivel të lartë ndotje, sidomos industriale, pranë qytetit të Fierit përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të adoptojë bashkia e Fier për manaxhimin e integruar të mbetjeve.

- **Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës**

Industria e naftës, për vetë natyrën e aktivitetit të saj, mund të krijojë ndotje në mjedis gjatë fazave të ndryshme të procesit të nxjerrjes së naftës (shpimit, dekantimit, transportit dhe përpunimit etj.)

Nxjerrja dhe përpunimi i naftës kalon në disa faza siç janë shpimi i puseveve, dekantimi, transporti për në rafineri, dhë përpunimi i saj në rafinerinë e naftës. Në të gjitha fazat, nafta krijon mbetje[243] të cilat mund të ndotin mjedisin.

Faza e shpimit: Ka ndikim jo të vogël në mjedis, në varësi të teknikave të përdorura. Teknikat e shpimeve për naftë janë të ndryshme. Për një kohë të gjatë, kompanitë kanë përdorur teknikën e shpimit me *puse me trungje vertikale* (puset e zakonshme). Krahas shpimit horizontal, është përdorur gjerësisht edhe *shpimi me puse horizontale*. Pusi shtrihet horizontalisht në shtresën shkëmbore në të cilën shpohet për një largësi të theksuar (ndryshimi është 3,000m kundrejt 15m). Këto puse bëjnë të mundur shpimin në zona ndryshe të paarritshme me teknologjinë e vjetër (nën akuiferë, zona të mbrojtura etj.). Distancat horizontale nga zona e pusit në sipërfaqe deri në fundin e pusit në tokë mund të arrijnë deri në 8km.

Një teknologji tjetër që ka gjetur përdorim të gjerë nga industria e naftës në dhjetëvjeçarin e fundit është shpimi me *puse me trungje horizontale me çarje/plasje* të shkëmbinjve me ujë[244] (*hydraulic fracturing*). Sipas Agjencisë Amerikane për Mjedisin (EPA) puset shpohen me trung vertikal nga 100 deri në mijëra metra nëntokë, dhe mund të përfshijnë puse me trungje horizontale ose me drejtim të caktuar që shtrihen me mijëra metra. Çarjet krijohen duke hedhur sasi shumë të mëdha lënde të lëngshme me presion të lartë në pusin e shpuar enkas dhe në shkëmbinjtë ku ndodhet nafta. Likuidi (ose balta siç quhet shpesh) përbëhet kryesisht nga ujë, propant dhe kimikate që përdoren për të hapur dhe zgjeruar plasjet e krijuara në shkëmb. Këto plasje mund të jenë me qindra metra të gjata. Propantët përfshijnë rërë, peletë qeramike, ose pjesëza të tjera të pashtypshme.

Pasi mbaron procesi i hedhjes së lëndës së lëngshme (ujit me kimikatet në pus), trysnia e brendshme e shtresës shkëmbore shtyn lëndën e lëngshme që të dalë në sipërfaqe nëpërmjet pusit të shpuar. Ky ujë rikthehet në sipërfaqe. Shpesh njihet me emrin *ujë i prodhuar*. Në përbërjen e tij mund të gjenden edhe kimikatet e shtuara përpara injektimit dhe materialet që ndodhen natyrshëm në shtresën shkëmbore si *kripëra të ndryshme, metale, hidrokarbone, rodionuklide* etj. Uji i kthyer magazinohet në vend në kontenierë të mëdhenj ose në gropa ekologjike në pritje për trajtim ose riciklim. Në shumë raste, ky ujë shpesh ri-injektohet[245]. Në zonat ku ri-injektimi nuk është i mundur, uji i prodhuar mund të trajtohet në impiante të trajtimit të ujërave të zeza dhe, më tej, të shkarkohet në ujëra sipërfaqësorë. Teknologjia e shpimit me puse me trungje horizontale *me çarje/plasje* është ekonomikisht e leverdishme. Ajo ka bërë të mundur shfrytëzimin e shtresave shkëmbore që dikur nuk paraqisnin interes ekonomik. Megjithatë, kjo teknologji mund të ketë ndikim të lartë në burime ujore për disa arsye:

- *është teknologji që kërkon sasi tepër të mëdha uji* (procesi i shpimit të një pusi harxhon nga *7 deri në 15milion litra ujë)*[246]. *Sasi të mëdha uji përdoren edhe gjatë pastrimit të puseve dhe mirëmbajtjes së tyre*.
- *një pjesë e ujit të përdorur gjatë shpimit kthehet mbrapsht (ujë i kthyer/prodhuar*). Sasia e kthyer varet nga shtresa shkëmbore naftëmbajtëse.
- *Nga puset mund edhe të dalë ujë shtresor,* (uji që del nga shtresat shkëmbore dhe, për këtë arsye, ka përmbajtje të lartë kripërash dhe lëndësh toksike).

Pra, me pak fjalë, shpimet krijojnë mbetje të lëngëta, materiale të ndryshme, minerale dhe lëndë të tjera që duhet të hiqen nga pusi. Përgjithësisht, nga procesi i shpimit del ***balta e papërdorshme, uji i podhuar, uji shtresor dhe mbetjet nga pusi***. Uji shtresor dhe i prodhuar shndërrohen në mbetje të lëngëta të cilat kompanitë zakonisht i grumbullojnë në *gropa ekologjike* deri në një zgjidhje përfundimtare (ri-injektim, trajtim të ujërave nga vetë kompania dhe shkarkimin e tyre në një burim sipërfaqësor, derdhje të ujërave në një sipërfaqe të caktuar në tokë, dërgim për trajtimin e ujërave në një impiant të përshtatshëm për trajtimin e tyre etj.).

Uji i prodhuar nga veprimtaria e nxjerrjes së naftës përmban ***kripëra, boron, metale të rënda, si dhe lëndë radioaktive*** të cilët nuk treten vetvetiu në mjedis[247]. Për më tepër, ujërat e përdorura (balta ose uji i prodhuar) mund të përmbajnë edhe kimikate të ndryshme të përdorura nga kompania gjatë fazës së shpimit e shfrytëzimit që zakonisht nuk njihen për shkak të sekretit industrial. Kimikatet përdoren gjerësisht gjatë procesit të prodhimit të naftës.

Faza e dekantimit[248]: Pas nxjerrjes së naftës, kompanitë bëjnë *dekantimin* ose ndarjen e naftës nga fraksionet e tjera (uji dhe gazi). Kontenierët e dekantimit mund të jenë depozita ndarjeje horizontale ose vertikale të llojeve të ndryshme dhe dallohen nga njëri tjetri nga qëllimi për të cilin përdoren. *Depozitat e dekantimit* kanë si qëllim kryesor ndarjen e naftës nga uji dhe gazi dhe më tej, dërgimin e naftës për në fazën tjetër të përpunimit (rafineri). Depozitat e dekantimit ndryshojnë nga *depozitat e ujit të prodhuar* (*baltës ose ujit shtresor*). Këto të fundit shërbejnë si mjet depozitimi për mbetjet e lëngëta mbasi nafta është dekantuar, ose trajtuar. Këto mbetje përmbajnë ende sasi të ndryshme nafte dhe qëndrojnë në depozitë në pritje për ri-injektim ose dërgim në vend-depozimimet përfundimtare. Pajisjet për ndarjen (dekantimin) dhe trajtimin e fluidëve të prodhuar nga industria e naftës janë të llojeve të ndryshme dhe veprojnë nën presion të ulët ose të lartë. Në të gjitha pajisjet e dekantimit që përdoren në industrinë e prodhimit të naftës ndodh ndarja e ujit, gazit dhe naftës. Gazi zakonisht del nga kontenieri nëpërmjet valvulave të daljes në pjesën e sipërme të saj ndërsa uji dhe nafta, në pjesët e poshtme përkatëse. Me kalimin e kohës, uji me densitet më të lartë se nafta depozitohet në fund të kontenierit. Nivelet e likuideve mbahen nëpërmjet valvulave të derdhjes. Në momentin që arrihet niveli i para-programuar i likuideve, valvulat e derdhjes shkarkojnë ujë dhe naftë nga kontenieri i dekantimit për ta dërguar në depozita të caktuara. Pra, në përgjithësi:

- Uji, nga fundi i depozitës shkarkohet në një depozitë uji.
- Nafta shkarkohet në një depozitë nafte.
- Gazi shkarkohet vazhdimisht në ajër nëpërmjet valvulës së daljes në pjesën e sipërme të depozitës.

Pas dekantimit, nafta transportohet në rafineritë përkatëse të përpunimit, nga ku fillon një cikël krejt i ri ndotjeje dhe emetimesh në atmosferë.

Figura 84. Depozitë dekantimi me ndarje të lirë (majtas), me dy faza (djathtas)



Burimi: Agjencia e Mjedisit SHBA, Përpunoi: Co-PLAN

Figura 85. Depozita dekantimi larëse (majtas), Depozitë dekantimi me tre faza (djathtas)



Burimi: Agjencia e Mjedisit SHBA, Përpunoi: Co-PLAN

1.4.3 Peizazhi, Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- **Peizazhi**

Metodologjia e Ndjekur dhe Qëllimi i Analizës

Analiza peizazhistike e ndjekur për leximin e tipologjive të peizazhit në territorin e Bashkisë Fier kryhet nëpërmjet qasjes ekologjike/mjedisore të leximit të territorit. Peizazhi dhe imazhi që ai ofron prioritatizohet në këtë analizë. Duhet të kuptohet se peizazhi është ajo çka duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në dy drejtime: i) estetik; ii) funksional dhe në lidhje me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon në atë estetik. Pra mes shumë zgjidhjeve estetike që mund të realizohen në peizazh, zgjidhen ato që garantojnë pacënueshmërinë dhe mbrojtjen e mbarështimin e funksoneve dhe shërbimeve ekologjike.

Peizazhi është ndarë në pesë fasha (tipologji) kryesore: ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor***. Ndarja e fashave, ndonëse mbetet konceptuale për shkak të shkallës (studim në nivel territori të të gjithë bashkisë), elementet e forta si rrugë, sipërfaqe ujore, fusha apo kodra janë identifikuar fillimisht nga ortofotot dhe vizitat në terren dhe më pas janë përdorur si pika referimi për ndarjen e kufijve mes fashave.

Komponentët mjedisorë të kësaj analize kanë si qëllim identifikimin e tipologjive të peizazhit duke u fokusuar më pas tek elementet përbërëse të **Peizazhit Natyror**. Qëllimi i analizimit të elementeve të peizazhit natyror mbetet mbrojtja e tyre dhe e funksioneve të tyre nga aktiviteti njerëzor dhe më specifikisht ai bujqësor pasi zhvillimi i vrullshëm urban ka copëzuar pjesën më të madhe të këtyre elementeve, të cilat janë vendimtare në ruajtjen e biodiversitetit të Bashkisë Fier. Këto elementet janë identifikuar e më pas interpretuar në hartën përkatëse për të vënë në pah anët e mira, ato problematike dhe dobësitë e elementëve mbizotëruese të peizazhit natyror. Objektivat e pritshme të kësaj analize janë:

- Identifikimi i shumëllojshmërisë peisazhistike (fashave), duke përdorur elementet natyrore lokale me nevojë të ulët për mirëmbajtje, të cilat ndjellin dhe forcojnë peisazhin vendas;
- Ruajtja e karakteristikave vizuale të fashave;
- Identifikimi dhe ruajtja e funksioneve e për rrjedhojë e shërbimeve të ekosistemit përmes masave që do të propozohen;
- Identifikimi dhe sigurimi i zonave të pushimit, monumenteve identifikuese (*landmarks*) në të gjitha tipologjitë e peizazheve të gjetura brenda territorit të Bashkisë;
- Propozimi dhe sigurimi i zonave "*tampon*" për të reduktuar ndotjen akustike në peizazh, të shkaktuar nga zonat urbane e industriale, për të bllokuar erën dëmtuese në zonat rurale si dhe për të ofruar barrierë në fashën natyrore me qëllim krijimin e "zemrës" së habitatit të pandikuar nga aktiviteti njerëzor.

Një analizë e tillë konsiderohet risi për kontekstin shqiptar, e aq më tepër për Bashkinë Fier, në kushtet kur problemet madhore të ndotjes së dukshme të ekosistemit, ndryshimet klimatike, humbjet në biodiversitet dhe ritmet e shpejta të aktivitetit njerëzor e urban, shpeshherë e anashkalojnë aspektin peizazhistik, ndoshta duke e konsideruar thjesht estetik. Edhe një herë theksojmë se aspekti estetik i pezazhit është tejet i rëndësishëm pasi tratimi i duhur rrit vlerën e territorit për qëllime ekonomike. Megjithatë, çdo ndërhyrje në peizazh që shpesh lexohet si estetike, në thelb është një masë (mundësisht jo teknologjike, por natyrore) që ruan ekosistemin, shërbimet e tij dhe sigurinë e jetës së qytetarëve. Shumë nga propozimet në këtë seksion por edhe në vijim në rastin e zonave të mbrojtura, të bregdetit, lumenjve etj. janë masa peizazhistike për konservimin e shërbimeve të ekosistemit.

Termat e përdorura në analizën peizazhistike janë pjesërisht të njohura përmes legjislacionit për zonat e mbrojtura, dhe një pjesë tjetër të importuara dhe përshtatura nga literatura për peizazhin. Kuptimi i tyre është si më poshtë:

- ***Ekosistem***[249] është një kompleks dinamik komunitetesh: bimë, kafshë, mikrobe dhe mjedisi jo i gjallë, që ndërveprojnë si njësi funksionale;
- ***Matrica*** është mbulesa e tokës, dominuese dhe e nderlidhur mbi pjesën kryesore të sipërfaqes së tokës (psh. pylli, bujqësia, urbanizimi);
- ***Copëzat e tokës*** janë zona shumë këndore (jo lineare), më pak të bollshme dhe të ndryshme nga matrica;

- ***Rrip i gjelbër*** është vijë lineare bimësie autoktone (barëra, shkurre etj) e cila shpreh lagështinë sezonale të dherave në territor;
- ***Ngastra*** janë tipe të izoluara bimësie ose habitate të cilat tregojnë modele të përsëritura (p.sh. një grupim me pisha). Ngastrat duhet të jenë aq të mëdha sa të mund të sigurojnë ***zemrën e habitatit*** ose pjesën e brendshme të tij. Për shumë specie, brendësia e habitatit fillon reth 50m në thellësi të habitatit (matur në lidhje me kufirin);
- ***Korridori*** është një copëz toke lineare ose e zgjatur, që lidh copëzat e tjera të tokës në matricë si ngastrat etj. Ato luajnë një rol të rëndësishëm si shtigje kryesore për lëvizjen e energjisë, materialeve dhe organizmave. Korridori mund të jetë i vazhdueshëm, i fragmentarizuar si dhe i gjerë apo i ngushtë;
- ***Mozaiku*** është një përmbledhje e copëzave të tokës, ku asnjëra prej të cilave nuk është aq dominuese sa të ndërlidhet nëpër peizazh (bashkësia e ngastrave dhe korridoreve në një peizazh përbën një mozaik);
- ***Zonë Ripariane*** është një zonë me pemë dhe shkurre, e vendosur afër përrenjve, liqeneve, pellgjeve dhe tokave të lagura. Zona merr ndotjen nga derdhjet sipërfaqësore dhe vërshimet e ujërave të cekëta nën sipërfaqe. Gjithashtu, rrit mbrojtjen e habitatit të jetës së egër, ndikon në temperaturën e ujit dhe ndihmon në stabilitetin e brigjeve të përroit.
- ***Erëpritës (quhet zone amortizuese tek harta e elementeve peizazhistik por do ndërruar ne erëprites pasi tingellon me shqip)*** është një ose shumë radhë pemësh ose shkurresh të cilat e mbrojnë dheun nga erozioni i erës, bimët e ndjeshme, manaxhojnë dëborën, përmirësojnë efikasitetin e kullimit, mbrojnë bagëtitë dhe strukturat, krijojnë ose rrisin habitatin e jetë së egër;
- ***Zonë Amortizuese (i*** referohet **zonës buferike** në ligjin nr. 8906[250]***)*** është zonë e cila mbron zemrën e habitatit dhe llojet;
- ***Fond pyjor***[251] janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.
- ***Pyll mbrojtës,*** sipas ligjit nr. 9385[252], *"Pyje mbrojtëse janë pyjet e përcaktuara kryesisht për qëllime mbrojtëse të vetë pyllit, të tokës pyjore dhe të tokave, që shtrihen përreth zonave urbane, pellgjeve ujëmbledhëse, për të luftuar a parandaluar dukuritë e gërryerjes, të ndikimit të erërave, çrregullimeve në rrjedhjet ose burimet ujore dhe sigurimin e funksioneve ekologjike"*. Por është tërësia e bimësisë (pjesa më e madhe janë bimë autoktone të zonës) në një habitat e cila siguron ***zemrën e habitatit*** ose pjesën e brendshme të tij. Pylli mbrojtës zakonisht karakterizohet nga bimësi kompakte ku vërehen të treja katet (barërat, shkurret dhe pemët) por nuk mund të shihet në brendësi të pyllit.
- ***Pyll produktiv*** karakterizohet nga bimë frutor si ulliri dhe cungishte si lisi të cilat mbillen dhe manaxhohen nga njeriu por njëkohësisht kanë rol të rëndësishëm në mjedisin e egër pasi specie të ndryshme ushqehen dhe strehohen në këto pyje.
- ***Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore*** është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve, të burimeve pyjore e jopyjore bashkë shoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.
- ***Fragmentizim*** është ndarja në seksione të peizashit (urban, industrial, rural dhe natyror) nëpërmjetë rrugëve, shtrirjes së tokës bujqësore apo infrastrukturës njerëzore, e cila krijon pengesa për rrjedhën normale të aktiviteteve të jetës së egër në territor.

Funksionet/Shërbimet e ekosistemit që janë marrë në konsideratë janë:

1. **Mbështetëse** *(Supporting)*: Këto nevojiten për të bërë të mundur prodhimin e shërbimeve të tre kategorive të tjera në vijim (habitat i përshtatshëm për riprodhim, ciklet e ujit dhe të *nutrientëve*, materiali gjenetik dhe evolucioni për speciet e egra, formimi i tokës dhe mbajtja *(retention)* e saj).
2. **Siguruese/Prodhuese** *(Provisioning)*: Ekosistemi ofron një sërë të mirash materiale dhe shërbimesh për konsum njerëzor (*ushqim, ujë, energji, lëndë të parë, burime mjekësore, dekoracione*).
3. **Rregulluese** *(Regulating)*: Procese ekologjike dhe sisteme të mbështetjes së jetës përmes cikleve e proceseve biogjeokimike dhe biosferike (cilësia e ajrit, rregullimi i klimës, zbutja e shqetësimeve – mbrojtja nga përmbytjet dhe stuhitë & kontrolli i erozionit, pastrami i ujit/cilësia & trajtimi i mbetjeve/ndotjes, polinimi, kontrolli biologjik etj.)
4. **Kulturore/Informative**: zhvillim mendor dhe i njohjes (estetik, shëtitje në natyrë, veprimtari rekreative dhe turistike, frymëzim kulturor dhe artistik, vlera historike e shpirtërore, arsim dhe shkencë etj.)

Peizazhi dhe tipologjitë përkatëse

Analiza Peizazhistike e qytetit të Fierit trajton një sërë komponentësh peizazh-formues, të cilët kategorizohen në: ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor***. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata unifikohen në një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Figura 86. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat).



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016.

Ky diversitet peizazhistik dominohet nga ***fasha rurale***, e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë në

mënyrë spontane nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare etj.); dhe ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më komplekse në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, koridore të gjelbra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqia më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë Fier

Figura 87. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor.



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet.

Dy tipologjitë e tjera peizazh-krijuese të Bashkisë Fier janë ***fasha/njolla urbane***; ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter "***formal***". Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh dekoruese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial dominon pjesën Verilindore-Lindore të territorit, specifikisht një pjesë të konsiderueshme të NjA-së Mbrostar. Ky peizazh ka po ashtu karakter "***formal",*** ndonëse bimësia është më e rrallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e ***sipërfaqeve ujore***, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumenjtë Vjosë, Gjanicë dhe Seman, të cilët shtrihen: i) Vjosa, në fashën rurale në jug të territorit përgjatë NjA-ve Cakran, Frakull dhe Levan; ii) Gjanica, mes fashës natyrore dhe asaj urbane në qendër të teritorit në NjA-të

Portëz, Fier, Qendër; dhe iii) Seman, në pjesën Veriore të territorit, përmes NjA-ve Mbrostar, Qendër, Libofshë dhe Topojë.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, ***rrugët*** ashtu si edhe sipërfaqet ujore shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar "çarje" të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojne edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën më poshtë (***Harta Peizazhistike dhe Rrugët***), rrugët shfaqen si "kanale" lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike ato karakterizohen vetëm nëpermjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

Figura 88. Harta Peizazhistike dhe Rrugët.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016.

Elementet përbërëse të peizazhit natyror të territorit

Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Fier, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore, merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Fier, si ***zonat ripariane***, ***korridoret***, ***kopshtet ujëmbajtëse*** etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat *ripariane,* të cilat natyrshëm shtrihen përgjatë trupave ujorë si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare ndalin erozionin ujor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë ketë mjedis, krijojnë një mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për

mbarështimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepricë), që rezultojnë nga përdorimi i kimikateve në tokë bujqësore.

Figura 89. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë. Rezervuari i Levanit.

Burimi: Google Imagery, 2015

Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore në tërësi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujore ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (afër ujrave të ndenjura, si liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujrave rrjedhës, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumenjtë Seman dhe Gjanicë janë dy raste të cilët e shfaqin dukshëm këtë fenomen. Nga 34.2 km gjatësi që ka lumi Seman përgjatë shtrirjes së tij në territorin e Bashkisë Fier (seksioni ku bashkohet me Lumin Gjanica e deri ne grykëderdhjen e tij), vetëm 12.42 m janë zonë ripariane. Ndërkohë nga 25.7 km gjatësi që ka Lumi i Gjanicës, vetëm 5.8 km zonë ripariane ka mbetur e patjetërsuar në tokë/aktivitet bujqësor apo tjetërsuar si pasojë e urbanizimit. Bimësia lokale në to karakterizohet nga bimësia si: kallami, robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Latanus), shelgu (Salix), plepi i bardhë (Populus Alba) dhe shkurre si: mersina, gjineshtra (Sportum Juniceun), dëllinjë (Juniperus), shiqop (Rika Arborea) dhe marina (Tamarix) në afërsi të pikes së shkarkimit të këtyre lumenjve në det. Në sipërfaqet ku zona ripariane ende ekziston, shtresat përbërës të saj si ajo e sipërme, mesme dhe e mbulimit të tendës rrallë gjenden të pandikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbur shtresa e mbulimit të terrenti në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqësore dhe herë shtresa e mesme e tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë, nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e nga ana tjetër erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmbytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi toka.

Figura 90. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës.

Burimi: Google Imagery, 2015

Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke ***lidhur*** parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe ***vendkalime*** për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë ***barrierë*** natyrore për erën. Në territorin e Bashkisë Fier rripat e gjelbër dominojnë peizazhin natyror. Ato ndahen në dy kategori; ***natyrore*** dhe ato ***të mbjella*** nga fermerët me bimë si: robinja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Latanus), shelgu (Salix) dhe plepi i bardhë (Populus Alba), të cilët në pjesën më të madhe shtrihen përgjat tokave bujqësore si elemente ndarës pronësie, por edhe si pasojë e kushteve të krijuara për rritjen dhe zhvillimin natyror të këtyre bimëve në këto rripa të gjelbërt dhe korridore.

Figura 91. Harta e Elementeve Peizazhistike



Korridoret (të cilët karakterizohen nga shërbimet e shumta ekologjike në përgjithësi të përherëshme si: strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimi për jetën e egër, por edhe ato të përkohshme si: vendkalimet dhe ushqimi sezonal) dhe korridoret lidhës (të cilët janë në shkallë më të vogël dhe si pasojë ofrojnë shërbime ekologjike të përkohshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastre, por kanë rol kyç në ruajtjen e biodiversitetit dhe mikroklimës, ndaj rimëkëmbja e këtyre sistemeve do të shtonte/risillte specie të ndryshme të faunës lokale. Në tërësi nga elementet përbërëse të peizazhit natyror në Bashkinë Fier mbizotërojnë: tokat e lagura, korridoret lidhës, rripat e gjelbër, trupat ujorë dhe parcelat e ndara. Elemente të tjera si korridoret, ngastrat, rezervat apo matricat janë tepër të copëzuara për shkak të aktivitetit njerëzor.

- ***<u>Përfundime</u>***

Komponentët peizazh-formues si ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit por problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre.

Peizazhi Urban dhe ***Industrial***, karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qëndrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordurea të ngritura e disa pa bordurëa. Ndërkohë pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekorative apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/dominuese apo edhe të padëshiruar shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbëra penguese të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruar ndodhin në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi mungojnë bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi dy metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët, si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.

Të tri tipologjitë e peizazhit ***rural***, ***natyror*** dhe ***ujor*** karakterizohet nga elementë të ndryshëm, por shkalla e lartë e ndërveprimit mes tyre bën që edhe problematikat e njërit të shfaqen edhe tek tjetri. Sipërfaqet ujore të cila karakterizohen nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale nuk mund të shihen veçmas nga fasha rurale e natyrore pasi here-herë ato shfaqen si "*hinka*" ku marrin dhe mbajnë materialet organike në matricën përreth si dherat, farat etj, dhe herë thjesht si "*kanale*" ku rrjedh energjia, ushqimi etj.

Peizazhi ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqet i "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesen tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë kur trupi ujor përshkon fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, një tjetër element lidhës në territor janë ***rrugët.*** Ato krijojnë "çarje" mes fashave por edhe "lidhje" fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike pasi si fasha ujore edhe ato shpërhapen në territor ku ndryshimi peizazhistik bëhet edhe më i dukshëm.

Figura 92. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Peizazhi ***Natyror*** mbetet më kompleksi ndër fashat peizazhistike. Ai karakterizohet nga një sërë elementësh peizazhistikë të cilët shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë. Hartat më sipër shfaqin këto elemente dhe rreziqet me të cilët përballen disa prej tyre. Tokat e lagura rrezikojnë të kripëzohen si pasojë e erozionit detar, trupat ujorë rrezikojnë daljen nga shtrati si pasojë e tjetërsimit të zonës ripariane dhe shfrytëzimit të materialeve inerte, si dhe fragmentimi i ngastrave natyrore dhe mungesa e theksuar e korridoreve të kalimit rrezikon largimin e jetës së egër nga kjo fashë.

- **Zonat e Mbrojtura**

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat menaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[253].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[254] dhe zënë rreth 16%[255] të teritorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[256] i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore;vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 33. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	**Emërtimi**	**Karakteristikat**
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyrorë përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[257].
Kategoria IV	Rezervat natyror i menaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i menaxhuar/ Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1,000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Burimi: Ligji Nr 8906/.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868/2008

Menaxhimi i zonave të mbrojtura në vend

Kohët e fundit, Shteti Shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm përpara për zhvillimin e zonave të mbrojtura. Qeveria ka plotësuar më tej kudrin ligjor dhe institucional për menaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 8906, dt. 06.06.2002, Për Zonat e Mbrojtura (i ndryshuar) i cili ka si qëllim kryesor shpalljen, ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të

menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në vend është edhe miratimi i VKM-së Nr. 102 i datës 12.02.2015 i cili krijoi dhe përcaktoi funksionet e Agjensisë Kombëtarë të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM). AKZM dhe AdZM kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për menaxhimin e zonave të mbrojtura në vend, mbështetjen e ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave për zonat e mbrojtura, hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit dhe të veprimit, monitorimin, mbledhjen e informacionit dhe lajmërimin e organeve kopetente kur vërëhen shkelje në zonat e mbrojtura.[258] Pas përpjekjeve të shtetit shqiptar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, mund të themi që menaxhimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura është qartësuar në kontekstin e përgjegjësive institucionale.

Në këtë fazë, AKZM[259] ka hartuar Programin Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 për menaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i menaxhimit të ZM-ve sipas standarteve të BE-së, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshmë burimet natyrore. Për më tepër, Qeveria ka marrë masa konkrete për zbatimin e ligjeve mbi zonat e mbrojtura dhe menaxhimin e tyre. AKZM, në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit, ka hartuar planet e menaxhimit për disa zona të mbrojtura (Plani i menaxhimit të Parkut kombëtar të Malit të Tomorrit, Divjakë- Karavastas, etj) dhe është drejt përfundimit të hartimit të planeve të menaxhimit[260] për zona të tjera. AKZM shtrin aktivitetin e saj në çdo qark nëpërmjet degës së saj rajonale (AdZM-të e qarqeve). AdZM-të kanë në fokus të tyre zbatimin e planeve dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në teritorin e tyre të kompetencës (të qarkut përkatës) dhe bashkëpunimi më AdZM-të e tjera përkatëse kur zona e mbrojtur i kalon kufinjtë e qarkut. AdZM-të kanë një staf të caktuar në varësi të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që ndodhen në territorin e administruar prej tyre (disa punonjës në rastet e menaxhimit të një parku komëtar që llogaritet të ketë një sipërfaqe të madhe që përfshijnë kryesisht specialistë monitorimi dhe disa roje).[261]

Me gjithë punën e mirë të bërë nga AKZM, zbatueshmëria e ligjit për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura ende haset me vështirësi. Mungesa e planeve të menaxhimit dhe mungesa e kapaciteteve për zhbatimin e planeve të menaxhimit për disa zona mbetet ndër vështirësitë kryesore. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, momentalisht AKZM është duke bërë një punë të mirë në drejtim të rritjes së kapaciteteve lokale dhe plotësimit të stafit të nevojshëm për menaxhimin sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.

Zonat e Mbrojtura në Bashkinë Fier

Bashkia e Fierit, falë shtrirjes së saj gjeografike, është e pasur me zona të mbrojtura të shumëllojshme të cilat janë paraqitur më poshtë.

Tabela 34. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Fier

Emërtimi i ZM-së	**Kategoria**	**Përshkrim i shkurtër**	**Rëndësia**
Kategoria III - Monument natyror			
Dunat e Semanit,	III	Gjatësi: 1km, Gjerësi : 15m Lartësi : 6m, Bimësi barishtore	Shkencore, biologjike, ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike

Kurora e lumit të vjetër të Semanit,	III	Sipërfaqe : 43.5ha, 1m mnd Flora përfaqësohet nga : plepi bardhë, rrënja, vidhi, rrapi, dëllinja zezë. Bimësi autoktone.	Biologjike, ekologjike dhe shkencore
Rrapet e rrugës Fier-Vlorë,	III	Lartësi : 20-25m Diametër : 80-100cm Dëmtime të rënda si pasojë e zhvillimit infrastrukturorë	Biologjike, ekologjike dhe shkencore
Rrapi i pazarit të Cakranit,	III	Mosha: mbi 300vjeçare Për shkak të moshës ka hyrë në fazën e tharjes	Historike, biologjike dhe ekologjike
Kategoria IV - Rezervat natyror i menaxhuar/Park Natyror			
Parku i Levanit	IV	Sipërfaqe : 200ha, Flora ka përfaqësues kryesorë : lisin, dushkun, pishën mesdhetare	Mbrojtjen e peizazhit,biologjike, dhe zhvillimin e turizmit
Pishë Poro	IV	Sipërfaqe : 1500ha, Flora përfaqësohet nga pisha mesdhetare, psamofite, halofitet. Fauna përfaqësohet nga lundërza, trofta, rrëmbenjësi	Mbrojtjen e peizazhit, biologjike dhe zhvillim turizmi

Burimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

- *Rezervatet Natyrore të Menaxhuar*

Rezervatet Natyrore të Manaxhuara manaxhohen nga AKZM-ja. Aktualisht nuk ka informacion nëse këto zona janë të pajisura me plane manaxhimi. Sipas AKZM-së, këto zona kanë vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve lokale, AdZM-ja Fier dhe NjA-ja Fier të cilat mbrojnë dhe kontrollojnë veprimtaritë brenda zonave të mbrojtura. AdZM Fier ka përcaktuar disa punonjës për mbikqyrjen e rezervateve natyrorë të manaxhuar brenda Qarkut Fier, kryesisht roje mjedisore.[262]

Pishë-Poro (Kategoria IV):[263] është një zonë në pjesën jugore të Bashkisë, e cila në pjesën më të madhe të saj është e pasur me pisha mesdhetare. Sipërfaqja e saj shkon deri ne 1,500ha[264]. Në këtë pjesë janë të vendosura *dunat ranore* me lartësi 4m dhe të populluara nga bimësi psamofite, halofite, tipike të zonave detare. Në këtë zonë janë edhe disa trupa ujorë që nga vendasit quhen hauze: Hauzi i Koçit, Hauzi i Gjatë dhe ai i Ujit të Bardhë. Përsa i përket *faunës* aty janë të vendosura specie të ndryshme peshqish si qefulli, lavraku, koca. Në pellgun e grykederdhjes së Vjosës takohet edhe lundërza (*Lutra lutra)* . Kjo zonë është mjaft e rëndësishme edhe sa i përket prezencës së *shpendëve, kryesisht atyre ujore dimërues si disa lloje rosash, karabullaku i madh dhe ai i vogël, çafka e madhe e bardhë, çafkën e vogël të bardhë, çafkën e përhime, bajzë, kojlikë, sqepbizë, pulëbardha*. Aty është i vendosur rrëmbenjësi (*Falconiformes*), shqipja peshkngrënëse, shqipja e kënetës.

Figura 93. Pishë Poro

Burimi : Arkiva Co-PLAN, 2016

Nga mungesa e një plani manaxhimi, vitet e fundit vihet re një degradim i kësaj zone. Prerjet masive dhe zjarret e rëna para 2014 e kanë dëmtuar shumë këtë zonë. Megjithatë, përpjekje për mbrojtjen e zonave të mbrojtura ka patur. Prej AdZM-së Fier është caktuar një roje mjedisore dhe dy specialistë për mbulimin e kësaj zone. Një njësi e Rojes së Gjelbër prej dy muajsh ka nën monitorim këtë zonë duke ushtruar funksionin e saj në respektimin e moratoriumit të pyjeve dhe gjuetisë.

Parku i Levanit (Kategoria IV)[265] ka një sipërfaqe prej 200ha dhe popullohet nga pyjet e dushkut ku karakteristikë është pema e lisit (relativisht në një moshë të re). Megjithatë, parku është ripyllëzuar edhe me pisha mesdhetare. Me qëllim ruajtjen e këtij parku, është me rëndësi hartimi i planit të menaxhimit në mënyrë urgjente.

Figura 94. Parku Levan

Burimi : Arkiva Co-PLAN, 2016

- *Monumentet e Natyrës*

Aktualisht nuk ka një plan menaxhimi për monumentet e natyrës, edhe pse vazhdimisht kryhet monitorimi i gjendjes së tyre dhe merren masa për përmirësimin dhe mbrojtjen e cilësisë së tyre. Sa i përket menaxhimit të Monumenteve të Natyrës, në AdZM e Qarkut Fier rezultojnë 21 punonjës që merren me menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në tërësi.[266] Duhet shtuar se edhe Bashkia e Fier ka përgjegjësi për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësinë së mjedisit në territorin e saj. Prandaj lind nevoja që në të ardhmen, bashkia të bashkëpunojë me AdZM Fier për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.[267] Monumentet e natyrës në Bashkinë Fier janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

Dunat e Semanit (Kategoria III):[268] shtrihen në zonën bregdetare pranë fshatit Povelçë. Këto duna janë formuar nga veprimtaria e erës mbi rërën e plazhit. Ato janë rreth 1 km të gjata, 15m të gjera dhe 6m të larta[269]. Dunat me lartësi deri në 6m shfaqen në pjesën e fundit të plazhit të Semanit. Aty bimësia shfaqet në gjëndje shumë të mirë. Këto duna janë të vlerësuara për rëndësinë shkencore (biologjike), ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike që ato kanë[270].

Figura 95. Dunat e Semanit

Burimi : Arkiva Co-PLAN, 2016

Kurora e lumit të vjetër të Semanit (Kategoria III):[271] Ky monument natyre shtrihet në një sipërfaqe prej 43.5ha[272] në rrjedhën e dikurshme të lumit të Semanit. Kurora e Fierit është rreth 1m mbi nivelin e detit(mmnd). Kjo zonë karakterizohet nga një biodiversitet i larmishëm. Plepi i bardhë (*populous alba)*, rrënja (*quercus robur)*, vidhi (*ulmus sp*.), rrapi (*platanus sp*.) si kati i parë i bimësisë pyjore dhe shkurre si thanukla (*cornus sanguinea)*, murrizi (*crataegus sp)*, dëllinja e zezë(*juniperus communis*), dafina (*laurus nobilis*), lofata (*cercis siliquastrum*), xanë (*spartium junceum)*, trëndafili i egër (*rosa canina)*, kulumbria (*prunus spinosa)* janë disa nga shumëllojshmëritë e bimëve të vendosura në këtë zonë. Kjo kurorë përbën një pyll me bimësi vendase (autoktone) dhe karakteristike të zonës, faktor për të cilin është shpallur Monument Natyre.

Figura 96. Kurora e lumit të vjetër Fier

Burimi : Arkiva Co-PLAN, 2016

Rrapet e e rrugës Fier-Vlorë (Kategoria III): Kjo zonë u shpall monument natyror i menaxhuar me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqipëtare". Rrapet gjenden në dalje të rrugës Fier në drejtim të Vlorës dhe kanë një lartesi 20-25m dhe diametër rreth 80-100cm[273]. Aspektet biologjike, ekologjike dhe shkencore janë veçoritë që vlerësohen së tepërmi në këtë zonë të mbojtur. Fatkeqësisht, gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës automobilistike, disa prej këtyre pemëve janë dëmtuar. Dëmtimi vazhdon edhe në ditët e sotme për arsye se këto pemë përdoren nga njerëzit si vend për vendosjen e reklamave.

Rrapi i pazarit të Cakranit ose i Çaireve (Kategoria III): Kjo zonë u shpall monument natyror i menaxhuar me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqipëtare". Rrapi ndodhet në qendër të fshatit Cakran, në qytetin e Fierit. Ai quhet ndryshe edhe Rrapi i Pazarit sepse aty zhvillohej pazari i Cakranit. Ky rrap është një dru rrapi i veçuar me moshë mbi 300 vjeçare[274]. Për shkak të moshës, rrapi ka hyrë në fazën e tharjes. Rrapi ka një rëndësi të veçantë historike, biologjike dhe ekologjike arsye për të cilën është shpallur monument natyre.

Figura 97. Rrapi i pazarit të Cakranit

Burimi : AKZM

- *Parqe kombëtare të rëndësishme në afërsi të Bashkisë:*[275]

Në rastin e Bashkisë së Fierit nuk mund të lëmë pa përmëndur afërsinë me Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë dhe ndikimin që mund t'i sillte këtij parku veprimtaritë e ndryshme të Bashkisë Fier. Për këtë arsye, më poshtë paraqiten në mënyrë të përgjithshme karakteristikat kryesore të këtij parku.

Parku i Divjakë-Karavastasë ka një sipërfaqe 22,230.24ha[276]. Brenda territorit të këtij parku përfshihen laguna e Karavastase dhe trupat e tjerë ujorë, pylli Pisha e Divjakës, Habitati i Kularit, në pjesën perëndimore të pyllit të Gjenerukës, shtretërit e vjetër dhe të rinj të lumenjve, tokë bujqësore, tokë inproduktive dhe hapësira urbane. *Pylli Pisha e Divjakës* (1,250 ha) dallohet për një biodiversitet të lartë flore dhe faune. Kryesisht i përbërë me pishë mesdhetare, ka në brendësi gërshetim me vidh, rrënjë, frashër, verri dhe shkurrore merzinë, xinë, lofatë, thanë, kulumbri. Në brendësi gjen edhe bimë endemike si *Aster Albanicus Paparistoi* dhe *Orcis Albanicum Paparistoi*. Në park numërohen rreth 250 specie të florës, nga të cilat 12 me status të rrezikuar. Ky është habitati i bilbilit këngëtar, bufit, qukapikut, skifter këmbëkuqit, shqipes se kënetave, shqipes së detit (e zhdukur prej disa vitesh), etj.

Laguna e Karavastasë ka një sipërfaqe rreth 4,300 ha dhe renditet ndër lagunat më të mëdha në detin Mesdhe. Laguna e Karavastasë është nën mbrojtjen e Konventës Ndërkombëtare Ramsar që prej vitit 1994, si një habitat me rëndësi për shpendët dimërues të ujit. Laguna njihet si habitati i pelikanit kaçurrel *(Pelecanus crispus).* Në qendër të lagunës ndodhet i vetmi vend folezimi i tij në Shqipëri. Flora përfaqësohet nga psamofitet, halofitet dhe hygrofite, pylli me pishë të butë dhe të egër, me prani të dëllënjës kokërrmadhe *(Juniperus monocarpa).* Aty gjënden 3 lloje endemike salepesh të gjinisë Orchis dhe lloji endemik Aster albanicus. Përsa i takon faunës, në park numerohen ***245 lloje shpendësh, 25 lloje mamiferesh dhe 29 lloje zvarranikësh*** përhapje gjen lundërza *(Lutra lutra)*[277], çakalli, dhelpra, baldosa, etj. Ky park është një burim tërheqës natyror sikurse dhe arkeologjik për arsye se në brendësi të tij gjendet Kisha Bizantine e Karavastase e shekullit XVI.

Fatmirësisht, parku ka marrë vëmendjen e duhur kohët e fundit. Në dhjetor të 2015[278] është miratuar Plani i Menaxhimit për Pyllin Kombëtar të Divjakë-Karavastasë. Në këtë Plan Menaxhimi , fokus të veçantë zë përmirësimi dhe mirëmbajtja e konservimit të diversitetit dhe habitateve, krijimi i infrastrukturës për të orjentuar dhe rritur kënaqësinë e vizitorëve, kualifikimi i stafit dhe rritja ekonomike e zonës përreth dhe nërgjegjësimi i tyre për rëndësinë që ka parku.

Tabela 35. Numri i individëve të shpendëve në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta

Emri shqip	Emri latinisht	Numri i individëve
Karabullaku	Phalacrocorax	1144
Pelikani	Pelecanus	147
Kredharak	Prodiceps	186
Çafka	Ardeidae	494
Flamingo	Phoenicopterus	165
Rosa	Anas	26289
Zhytësa	Mergus	31
Bajza	Fulica	3763
Gicville	Vanellus	532
Sqepbiza	Recurvirostra	5
Vraponjës	Charadrius	61
Gjalacë	Pluvialis	916
Gjelëza	Calidris	2513
Shapka	Gallinago	15
Kojkë	Numenius	187
Qyrylykë	Tringa	268
Pulëbardha	Larus	4130
Dallëndyshe deti	Sterna	55
Huta	Buteo	1
Shqipe	Circus	8
Skifterë	Falco	4
Gjeraqina	Accipiter	2

Burimi: Adzm Fier, 2016

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Bashkia Fier ka pasuri të mëdha ujore. Territori i Bashkisë Fier përshkrohet nga lumenjtë Vjosë dhe Seman si dhe nga një rrjet i pasur kanalesh ndër të cilët dallohen kanalet Darëzezë dhe Vija e Ngjalës. Në pjesën perëndimore, Bashkia ka dalje të drejtpërdrejtë në Detin Adriatik. Gjatë gjarpërimeve të shumta në afërsi të zonës bregdetare dhe në grykëderdhjet e tyre, lumenjtë kanë krijuar laguna të shumta që shërbejnë si habitat kryesor për florën dhe faunën në Bashki. Për më tepër, lumenjtë shërbejnë edhe si burim ushqyes për biodiversitetin. Kohët e fundit AdZM Fier ka bërë një punë të kënaqshme për menaxhimin e zonave të mbrojtura në territor. Megjithatë, lipset që Bashkia të ndërmarrë disa masa për ruajtjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura në mënyrë që këto të fundit të shndërrohen në një pasuri për bashkinë për zhvillimin e turizmit.

Me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, rekomandohet që Bashkia të bashkëpunojë ngushtë me AdZM Fier për hartimin e projekteve të përbashkëta që mund të përfshijnë hartimin e planeve të menaxhimit për të gjitha zonat e mbrojtura, hartimin e një plani të emergjencave (për zjarrin dhe rreziqet gjeologjike, etj), promovimin e vlerave shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura, ndërgjegjësimin e banorëve në afërsi ose brendësi të territorit të zonave të mbrojtura për ruajtjen e këtyre zonave të ndjeshme mjedisore. Njokohësisht, rekomandohet që Bashkia të marrë masa për menaxhimin e bregdetit sipas modelit të menaxhimit të Parkut Natyror Lagunë-Karavasta, si dhe të shmangë ndërhyrjet në grykëderdhjet (deltat) e lumenjve Seman e Vjosë si dhe të kanaleve Darëzezë e Vijë e Ngjalë, për shkak se shërbejnë si zonë vendstrehimi dhe zona për ushqimin e shpendëve shtegtarë. Me rëndësi të veçantë mbetet bashkëpunimi me AdZM Fier edhe për përcaktimin e zonave të tjera brenda territorit të Bashkisë që mund të shpallen të mbrojtura.

- **Biodiversiteti**

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[279]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[280], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km. [281] Zona veriore e vendit ka një reliev malor, ku karakterizohet nga diversitet i formacioneve shkëmbore që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.[282]

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe

ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth ***7,233 taksone bimore***[283] (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe ***5,438 lloje kafshësh***[284] (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rralla, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të teritorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.[285] Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratorë. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.[286] Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratorë dhe insektet.[287]

- ***Speciet e rrezikuara në Shqipëri***

Në territorin e vendit gjenden rreth *91 lloje të kërcënuara speciesh në nivel global*. Në këtë listë përfshihen pelikani kaçurrel (Crispus crispus), breshka shqiptare e ujit (Pelophylax shqipericus) dhe blini (Acipenser sturio), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.[288] Sipas IUCN,[289] 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuara.

Tabela 36. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri.

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX – Të zhdukura	0	5
CR – Të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN –Të rrezikuara	123	56
VU – Të pambrojtura	120	154
LR – Rrezik i ulët	59	238
DD – Mungojnë të dhëna	30	72
NE – Të pavlerësuara	3	7

Burimi: Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[290].

Figura 98. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi.



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[291]. Përgatiti: Co-PLAN

Lista e Kuqe e faunës dhe florës së egër është miratuar në dhjetor 2013, me Urdhër të Ministrit Nr. 1280, datë 20.11.2013. Llojet e mbrojtura të florës janë 402 nga 361 që ishin në

Listën e Kuqe paraprake të vitit 2007. Llojet e mbrojtura të faunës janë 575, i njëjti numër me listën e vitit 2007.

- ***Biodiversiteti në Bashkinë Fier***

Bashkia e Fierit ka një sipërfaqe prej 620km^2, prej të cilës 20% është natyrore. Bashkia e Fierit kufizohet nga dy lumenj kryesor si Vjosa dhe Semani. Ajo gjithashtu ka dalje edhe në zonën bregdetare. Zonat natyrore, në të cilat përfshihen edhe pyjet e kullotat, së bashku me pasuritë ujore përbëjnë habitatin kryesor të florës e faunës në territorin e Bashkisë. Në Bashkinë e Fierit takojmë zona të tilla natyrore në të cilat vendosen shumëllojshmëria e llojeve të rralla dhe me rëndësi të veçantë. Përgjithësisht, këto zona i takojmë pranë zonave të mbrojtura natyrore, përgjatë lumenjve dhe përgjatë vijës bregdetare. Habitati në zonën e Pishë-Poros, Parkun e Levanit, Dunat e Semanit, në Kurorën e vjetër të Lumit Seman në Fier dhe në zonën e pyllit të Cakranit është i larmishëm për nga ana fluoristike dhe faunistike. Në këto zona takohen bimësi psamofite, halofite, dhe hygrofite, pyje me pishë medhetare dhe me prani të kafshëve, si urithi, çakalli, nusja lalës, dhelpra, thëllëza, sorra e një sërë zvarranikësh.

Numri i specieve floristike dhe faunistike që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre nuk njihet. Megjithatë, njihet përafërsisht numri i specieve në rrezik zhdukjeje (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 79 specie (rreth 10% e specieve në zhdukje në vend). Këto i përkasin kryesisht shpendëve, florës dhe insekteve.

Tabela 37. Flora dhe fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Fier[292].

Kategoritë Taksonomike	Nr. total i specieve në vend	Nr. i specieve të rrezikuara në vend	**Nr. i specieve të rrezikuara, Bashkia Fier**	% e specieve të rrezikuara, Bashkia Fier
Kërpudha	800	16	**0**	0
Bimësi	3,228	363	**13**	3,5%
Insekte	680	108	**7**	6,5%
Peshq	311	61	**9**	14,7%
Amfib	15	15	**3**	20%
Zvarranikë	37	37	**2**	5,4%
Shpendë	330	120	**40**	33,3%
Gjitarë	91	46	**5**	10,8%
Totali	5,492	766	**79**	10%

Burimi: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqipëtare, Punoi: Co-PLAN

- ***Flora në Bashkinë Fier***

Në zonën e Bashkisë Fier nuk njihet numri total i llojit të specieve të florës pasi mungojnë studime specifike me qëllim njohjen e florës në Bashki. Megjithatë, karakteristikë e Bashkisë Fier janë pemët e larta, si pishat e buta dhe të egra, selvia dhe shqema. Në pjesët pyjore të kësaj Bashkie ndeshim dushkun, plepin dhe pishën mesdhetare. Sa i përket shkurreve, më të përhapurat në rang Bashkie janë makja mesdhetare dhe marea. Këto shkurre janë të gjelbra gjatë gjithë vitit.

Shkaqet kryesore që kanë rrezikuar rritjen e numrit të specieve të bimësisë në zhdukje janë grumbullimi pa kriter i bimëve të ndryshme për tregti si bimë mjekësore, veprimtaria e njerëzve në zonat ku kanë përhapje speciet e bimësisë, përhapja e rrallë dhe e kufizuar e

specieve të ndryshme, ndjeshmëria e lartë ndaj ndryshimit të klimës, përdorimi i metodave të gabuara për grumbullim (me shkulje, duke dëmtuar rrënjët) dhe kullotja intensive dhe dëmtimi i habitatit të bimësisë.

- ***Fauna në Bashkinë Fier***

Sa i përket faunës në zonën e Bashkisë, ashtu si edhe në rastin e florës, nuk njihet numri total i specieve që jetojnë në territorin e Bashkisë. Megjithatë, në Bashki gjendet një shumëllojshmëri kafshësh, shpendësh dhe zvarranikësh. Pyjet e pishës shërbejnë si strehë për kafshët si çakalli, dhelpra, nusja lalës etj. Në Bashkinë Fier gjejmë lloje të ndryshme zvarranikësh por dhe shumëllojshmëri shpendësh, shtegtarë ose jo shtegtarë. Edhe pse nuk njihet me saktësi numri i specieve në zhdukje, nga Libri i Kuq i Faunës Shqiptare (Tiranë, nëntor 2006) është vënë re se numri i tyre arrin në 53 specie. Llojet e specieve në zhdukje janë të ndryshme, por ndër to dallohen lloje të rralla speciesh të faunës shqiptare si kali i detit (*Hippocamus Guttulatus*), çafka e vogël e bardhë (*Egretta Garzetta*), lejleku i zi (*Ciconia Nigra*), huta (*Buteu buteo*), shqiponja perandorake (*Aquila Heliaca*), skifteri kthetraverdhë (*Falco Naumanni*), laraska e detit (*Haematopus Ostralegus*), sqepbiza (*Recurvirostra Avosetta*), çakalli (*Canius Aureus*), lakuriqi i natës bisht-lirë (*Tadarida Teniotis*) etj.

Shkaqet kryesore që kanë rrezikuar shtimin e numrit të specieve të faunës në zhdukje janë grumbullimi pa kriter për tregtim, balsamim dhe konsum ushqimor, dëmtime dhe prishje e habitatit ku janë të vendosura specie të caktuara, ndotja e ujërave detare, gjuetia e jashtëligjshme dhe peshkimi intensiv, pakësimi i ushqimit, veprimtaria koleksionuese dhe shqetësimet në vendet e folezimit gjatë riprodhimit dhe dëmtimet fizike.

- ***Problematikat kryesore të biodiversitetit në Bashki***

Në përgjithësi, shkaqet kryesore që kërcënojnë humbjen e biodiversitetit në bashki janë renditur më poshtë:

- *Mospatja e një plani manaxhimi/veprimi* për mbrojtjen e zonave natyrore në Bashkinë Kuçovë;
- *Urbanizimi*: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore. Shndërrimi i sipërfaqeve natyrore në urbane ka çuar në uljen e numrit të specieve taksonomike;
- *Fragmentimi i habitateve* nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjedhoje e ndërtimit të infrastrukturës/rrugëve në toka bujqësore e natyrore pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme;
- *Gjuetia e jashtëligjshme* ka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera;
- *Shpyllëzimi* ka qenë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e shkuara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzime masive kanë ndodhur edhe me qëllim shndërrimin e tokae pyjore në toka bujqësore. Kjo ka bërë

të mundur uljen e numrit të specieve në këto zona. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10 vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend;

- *Kullotja* e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Kuçovës nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë;
- *Zhvillimi i bujqësisë së shkallës*: Zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar edhe pse disa nga tokat bujqësore të përftuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90 të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore po i rikthehen në gjendjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në mënyrë të pakontrolluar, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore;
- *Mbledhja e bimëve mjekësore* është një tjetër aspekt i rëndësishëm që ka çuar në zvogëlimin e numrit të specieve të veçanta në zonë. Kjo sepse mbledhja bëhet pa kriter dhe kryesisht me shkulje (duke i shkulur me rrënjë) të këtyre bimëve;
- *Gjuetia pa kriter e kafshëve* duke mos lejuar zbatimin e moratoriumit për gjuetinë;
- *Industria e naftës:* Industra e naftës është një ndër ndotësit kryesorë të ujit e ajrit në Bashki.

Tabela 38. Speciet floristike në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Fier.

Nr.	Emërtimi në latinisht	Emërtimi në shqip	Rreziku	Foto
1	Ephedra Distachia	Gjunjëz	Aktiviteti antropoik	
2	Hypericum Perforatum	Lulebasani	Mbikullotja, bujqësia	
3	Juniperus Oxycedrus	Dëllinja e Kuqe	Shfrytëzimi pa kriter	
4	Panctratium Maritimum	Zambak deti	Veprimtaria antropike	
5	Sambucus Nigra	Shtog i zi	Mbledhja si bimë mjeksore.	

6	Satureja Montana	Trumzë, Shtërmen	Dëmtimi i rrënjëve gjatë shkuljes.	
7	Baldellia Ranunculoides	Baldelë Zhabinëngjashme	Ndjeshmëri e lartë ndaj klimës.	
8	Nuphar Lutea	Lëkue i verdhë	Ndjeshmëri e lartë ndaj klimës.	
9	Centaurea Pindicola	Kokoçeli Pindit	Individë shumë të rrallë	
10	Conium Maculatum	Kakudë	Individë shumë të rrallë	
11	Orchis Albanica	Salep Shqiptar	Individë të rrallë	
12	Sinapis Pubescens	Sinap Pushlor	Individë të rrallë	
13	Gladiolus Palustris	Gladiolë Moçalesh	Prishja e habitatit	

Burimi : Libri i Kuq i Florës Shqiptare

Tabela 39. Fauna në rrezik zhdukjeje në Bashkinë Fier .

Nr	Emërtimi në Latinisht	Emërtimi në shqip	Rreziku	Foto

1	Helix Lucorum	Kërmilli i Shkurreve	Tregtimi	
2	Helix Secernenda	-	Mbledhja pa kriter. Tregtimi	
3	Chamelea Gallina	Molusk	Mbledhja për ushqim	
4	Danaus Chrysipus	Shtegëtarja Krisipus	Prishje habitati, koleksionim	
5	Coenonympha Tullia	Tulia	Dëmtimi i habitatit dhe rreziku nga specieve të futura (invazive)	
6	Minois Dryas	Driada	Koleksionimi	
7	Neohipparchia Statilinus	Statilinia	Dëmtim dhe prishje habitati si dhe koleksionim	
8	Charaxes Jasius	Dybishtakja Jasius	Koleksionimi	
9	Azuritis Reducta	Admiralja Njollëbardhë	Dëmtimi dhe prishja e habitateve. Koleksionimi	

10	Euplagia Quadripunctari	Trashaluqja Hera	Koleksionime dhe dëmtimi i habitatit.	
11	Hippocamus Guttulatus	Kali i Detit	Ndotja e detit dhe peshkimi intensiv.	
12	Crytodactylus Kotschyi	Gekonidi i Kotsiçit	Shqetësimet dhe dëmtimi i habitatit	
13	Elaphe Quatrolineata	Bolla me 4 Vija	Dëmtime nga frika	
14	Egretta Garzetta	Çafka e vogël e bardhë	Gjuetia, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të folezimit, gjuetia	
15	Ciconia Nigra	Lejleku i zi	Gjuetia, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të folezimit, gjuetia	
16	Aythya Nyroca	Kryekuqja e vogël		
17	Buteu buteo	Huta	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të folezimit, gjuetia	
18	Haliaeetus Albicila	Shqiponja e detit	Dëmtimi i vend-folezimit	

19	Circateus Gallicus	Shqiponja Gjarpërngrënëse	Pakësimi ushqimit, shqetësimi vendeve të flozimit, gjuetia	
20	Accipiter Gentilis	Gjeraqina	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi vendeve të folezimit, gjuetia	
21	Aquila Heliaca	Shqiponja Perandorake	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendeve të folezimit, gjuetia	
22	Falco Naumanni	Skifteri Kthetraverdh	Gjuetia nga njeriu.	
23	Falco Peregrinus	Krahëthati	Gjuetia nga njeriu.	
24	Apus Apus	Dejka	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
25	Porzana Porzana	Porzana Pikaloshe	Shtegëtare, gjuetia e paligjshme dhe mungesa e ushqimit	
26	Crex Crex	Mbreti Shkurtes	Gjuetia	
27	Tetrax Tetrax	Pula Livadheve	Dëmtimi i habitatit dhe gjuetia	
28	Otis Tarda	Pula me mjekër	Nuk ka të dhëna në vitet e fundit	

29	Haematopus Ostralegus	Laraska Detit	Gjuetia, shqetësimi gjatë periudhës së riprodhimit, mungesa e habitateve.	
30	Himantopus Himantopus	Kalorësi	Gjuetia e jashtëligjshme, shqetësimi dhe dëmtimi i foleve.	
31	Recurvirostra Avosetta	Sqepbiza	Gjuetia e jashtëligjshme, shqetësimi dhe dëmtimi i foleve.	
32	Larus Cachinnans	Pulëbardha Këmbëverdhë	Shumë të ndjeshme ndaj shqetësimeve humane	
33	Sterna Sandvicensis	Streni Dimërak	Gjuetia në zonat bregdetare	
34	Tyto Alba	Kukuvajka Mjekroshe	Balsamimi	
35	Apus Pallidus	Dajaka e zbehtë	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
36	Merops Apiaster	Gargulli	Gjuetia për tregtim, shqetësimi	
37	Coracias Garrulous	Grifsha e Detit	Dëmtimi i habitateve	
38	Upua Epops	Pupëza	Gjuetia për tregtim, shqetësimi	

39	Jynx Torquilla	Qafëdredhësi	Gjuetia sportive, shqetësimet nga njeriu	
40	Picus Canus	Qukapiku i Përhimë	Gjueti për balsamim, shqetësimi	
41	Picus Virdis	Qukapiku Gjelbër	Gjuetia dhe shqetësime humane	
42	Densdrocopos Leucotos	Qukapiku Larosh	Shqetësime humane dhe gjuetia	
43	Locustella Fluviatilis	Bilbili Lumthit	Balsamosja, dëmtimi i habitateve	
44	Hippolais Olivetorum	Përqeshësi i madh i ullinjve	Dëmtimi i habitateve	
45	Sylvia Ruepelli	Bilbilthi Gumëzhimë	Dëmtimi i habitateve dhe vendfolezimit	
46	Remiz Pendulinus	Kolovatësi	Dëmtimi habitateve dhe vendfolezimit	
47	Lanius Minor	Larashi i vogël ballzi	Dëmtimi i habitateve dhe vendfolezimit	
48	Lanius Excubitor	Larashi i madh i përhimë	Shqetësimi i vendfolezimit	

49	Tadarida Teniotis	Lakuriq nate bisht-lirë	Njihet shumë pak	
50	Muscardinus Avellanarius	Gjumashi i lajthisë	I njohur në mënyrë të pamjaftueshme.	
51	Canius Aureus	Çakalli	Zvogëlimi i habitateve	
52	Lutra Lutra	Vidra	Ndotja e ujërave, peshkimi intensiv, gjueti e jashtëligjshme	
53	Meles Meles	Baldosa	Dëmtimi i habitateve dhe gjuetia e jashtëligjshme	

Burimi : Libri i Kuq i Faunës Shqiptare

- ***<u>Përfundime dhe rekomandime</u>***

Bashkia e Fierit ka një sipërfaqe prej 620km^2, prej të cilës 20% është natyrore. Territori i Bashkisë kufizohet nga dy lumenj kryesorë si Vjosa dhe Semani. Ajo gjithashtu ka dalje edhe në zonën bregdetare. Zonat natyrore, në të cilat përfshihen edhe pyjet e kullotat, së bashku me pasuritë ujore përbëjnë habitatin kryesor të florës e faunës në territorin e Bashkisë. Përgjithësisht, këto zona i takojmë pranë zonave të mbrojtura natyrore, përgjatë lumenjve dhe përgjatë vijës bregdetare (Pishë-Poro, Parku i Levanit, Dunat e Semanit, Pylli i Cakranit etj.) të cilat janë të larmishme për nga ana fluoristike dhe faunistike.

Për fat të keq, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjekësore pa kriter etj.) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyrore etj.). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.

Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia i) të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e

llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan manaxhimi për mbrojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.

1.5 Analiza demografike dhe e mirëqenies social-ekonomike

1.5.1 Demografia

Bashkia Fier, është qëndra me e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me te njëjtin emer. Me ndarjen e re administrative, kjo bashki përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Fierit, dhe nëntë komunat: Qender Fier, Libofshë, Topojë, Dermenas, Mbrostar, Levan, Frakull, Portëz dhe Cakran. Nga këndvështrimi strukturor demografik, në bashkinë Fier banojnë rreth 39% përqind e popullatës së qarkut Fier, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 61% është e shpërndarë në bashkitë e tjera: Lushnjë, Divjakë, Roskovec, Patos, Mallakastër, respektivisht me rreth 27%, 11%, 7%, 7% dhe 9% e popullatës gjithsej te qarkut.

Popullata rezidente e bashkisë Fier, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është më shumë se dyfishuar duke shënuar një numër popullsie stok në fillim te vitit 2015, në 122 mijë banorë*.

Tabela 40. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2015

	Viti 2011	Viti 2015
BASHKIA FIER	**126,305**	**122,475**
Fier	58,460	56,687
Qënder Fier	4,404	4,270
Libofshe	6,437	6,242
Topoje	4,445	4,310
Dermenas	8,153	7,905
Mbrostar	7,809	7,573
Levan	8,541	8,282
Frakull	7,139	6,923
Portez	8,646	8,384
Cakran	12,271	11,899
QARKU FIER	**324,864**	**315,012**

Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve[293]

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqendruar kryesisht në qytetin e Fierit me rreth 46%, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë ‰ është e shpërndarë në nëntë komunat e saj. Nga keto komuna, veçohet komuna Cakran me rreth 10% të popullatës së bashkisë ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur te komunave është afërsisht e njëjtë rreth (5-6%).

Figura 99. Populllsia e Bashkisë Fier sipas NJA



Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Popullsia e bashkisë Fier, e krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie me rreth 4000 banorë, ose me 3% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në te gjitha njësitë vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve '90-të.

Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Fier *lidhen me faktorët e emigrimit, uljen e ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmet e larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model–profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.*

Tabela 41. Popullsia sipas gjinisë Bashkia Fier, për vitet 2011-2015

	Viti 2011			Viti 2015		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
BASHKIA FIER	**126,305**	**63,459**	**62,846**	**122,475**	**62,131**	**60,344**
Fier	58,460	29,030	29,431	56,687	28,422	28,265
Qender Fier	4,404	2,182	2,222	4,270	2,136	2,134
Libofshë	6,437	3,201	3,236	6,242	3,134	3,107
Topojë	4,445	2,242	2,203	4,310	2,195	2,115
Dermenas	8,153	4,202	3,951	7,905	4,114	3,792
Mbrostar	7,809	3,982	3,827	7,573	3,899	3,674
Levan	8,541	4,222	4,319	8,282	4,133	4,149
Frakull	7,139	3,688	3,451	6,923	3,611	3,312
Portëz	8,646	4,389	4,257	8,384	4,297	4,087
Cakran	12,271	6,322	5,949	11,899	6,190	5,709
QARKU FIER	**324,864**	**164,097**	**160,767**	**315,012**	**160,663**	**154,349**

Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve

Popullsia e bashkisë Fier, nga këndvështrimi gjinor, ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në

të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2015, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra*100) tregon së për vitin 2015 raporti gjinor është rritur në favor te popullatës së meshkujve, krahasuar me situaten e raportit gjinor për vitin 2011 (103 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2015).

Tabela 42. Raporti gjinor për bashkinë Fier, 2011-2015.

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	koefiçienti gjinor në %	
	2011	2015
BASHKIA FIER	**101**	**103**
Fier	99	101
Qendër Fier	98	100
Libofshë	99	101
Topojë	102	104
Dermenas	106	108
Mbrostar	104	106
Levan	98	100
Frakull	107	109
Portëz	103	105
Cakran	106	108
QARKU FIER	**102**	**104**

Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve

Gjithashtu nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë Fier me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, gjithnjë në favor te popullatës së meshkujve. Vlerat në rritje të raportit gjinor, veçanërisht në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me rritjen e dominancës së popullsisë rurale ndaj asaj urbane në bashkinë/qarkun e Fierit. Aktualisht, për vitin 2015, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 41%:59%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukture urbane/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2015, rreth 57% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane. Një tjetër faktor mund te konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit te abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj.

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe mosha mesatare e re e saj, (38 vjeç ndërsa mesatarja në nivel kombëtar është 37 vjeç) tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Fier vazhdon të jetë akoma një popullsi e re, sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Tabela 43. Popullsia rezidente, sipas grup-moshave.

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	**Viti 2011**				**Viti 2015**			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
BASHKIA FIER	**126,305**	**24,723**	**85,443**	**16,139**	**122,475**	**23,973**	**82,852**	**15,650**
Fier	58,460	10,613	40,170	7,677	56,687	10,291	38,952	7,445
Qendër Fier	4,404	907	2,963	535	4,270	879	2,873	519
Libofshë	6,437	1,009	4,344	1,083	6,242	979	4,213	1,051
Topojë	4,445	699	2,995	751	4,310	678	2,904	728
Dermenas	8,153	1,746	5,485	921	7,905	1,693	5,319	893
Mbrostar	7,809	1,830	5,116	864	7,573	1,774	4,961	837

Levan	8,541	1,708	5,687	1,145	8,282	1,657	5,515	1,111
Frakull	7,139	1,536	4,823	781	6,923	1,489	4,676	757
Portëz	8,646	1,875	5,812	959	8,384	1,818	5,636	930
Cakran	12,271	2,800	8,048	1,423	11,899	2,715	7,804	1,379
QARKU FIER	**324,864**	64,760	220,898	39,206	**315,012**	62,796	214,199	38,017

Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve

Për vitin 2015, struktura moshore e popullatës së bashkisë Fier, tregon së 68% e saj i takon grup-moshës 15-64 vjeç, dhe 20% grup-mosha 0-14 vjeç, të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomikisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancen ekonomike te zonës, kjo duhet analizuar së bashku me të dhënat për punësimin.

Figura 100. Struktura moshore, 2015



Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë Fier, tregon se popullata e kësaj grup-moshe është e pranishme me të njëjtat nivele (66-69%) edhe në komuna. Gjithsësi, ndërmjet tyre, konstatojmë se komuna Topojë ka nivelin më të ulët të grup-moshës së re (0-14 vjeç) me 16% dhe më të lartin e grup-moshës së vjetër (+65), me 17%. Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grup-moshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varësisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizen socio-ekonomike.

Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e përformancës ekonomike të zonës në studim.

Treguesit e varesisë klasifikohën në: treguesit e varësisë totale (raporti i grup-moshave [(0-14)+ (+65)] /(15-65) ndaj popullsisë në moshë pune, treguesi i varesisë së të rinjve (raporti i gup-moshës (0-14)/(15-65) dhe treguesi i varesisë së të moshuarve (raporti i grup-moshës (+65)/(15-65). Koefiçienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo pune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jo pune, "mbulohen"/përballohen nga 100 individë në moshë pune.

Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq me shumë mund te rritet potencialisht performanca ekonomike. Ndërkohë, koefiçienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë repektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç.

Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varesisë së të rinjve, është i ngjashem me treguesin e varesisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një përiudhe të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varesisë së të moshuarve, është "sinjal" për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmiresuar jetesën dhe mirëqënien e kësaj kategorie të popullsisë.

Konkretisht, për bashkinë Fier, treguesit e varësisë moshore totale, e varesisë së të rinjve dhe varesisë së të moshuarve paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela 44. Koefiçientët e varësisë

Koeficientet e varësisë, qarku, bashkia, komunat 2011	KOEFIÇIENTET E VARËSISË, 2011-2015		
	varësia totale	varësia e të rinjve	varësia e të moshuarve
BASHKIA FIER	**48**	**29**	**19**
Fier	46	26	19
Qendër Fier	49	31	18
Libofshë	48	23	25
Topojë	48	23	25
Dermenas	49	32	17
Mbrostar	53	36	17
Levan	50	30	20
Frakull	48	32	16
Portëz	49	32	16
Cakran	52	35	18
QARKU FIER	**47**	**29**	**18**

Burimi: Instat 2011, llogaritje të autorëve

Mbështetur në këta tregues konstatojme së treguesi i varesisë totale për bashkinë e Fierit shënon vlerën 48 (pra 48 banorë të moshës joaktive (0-14 vjeç dhe +65 vjeç) "përballohen" nga 100 banorë te moshës aktive për punë(15-64 vjec), ndërkohë që vlera e ketij treguesi në nivel kombëtar është 47.

Viti 2011 është viti në të cilin ky tregues ka shënuar vleren e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturin episod të "dividendit demografik" dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky "dividend demografik", kjo varet nga efektiviteti i politikave social-ekonomike te politikë-bërësit, përfshirë këtu në mënyrë të veçantë edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë punëtore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive që do të ndikojnë jo vetem në përmiresimin e përformancës ekonomik,e por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.

Ndërkohë që koefiçienti i varësisë totale, flet për ekzistencen e "dividendit demografik", analiza e treguesve të tjerë të varesisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 19%) dhe një rënie të grup-moshave te reja, (nga 60% në 23%) duke demonstruar qartazi për "shenjat" në hyrjen në një faze te re demografike te popullsisë, atë "të plakjes".

Rritja e grup-moshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmiresuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave. Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajonve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve[294] të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

Në vijim po paraqesim tabelat me numrin e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Fier, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie te konsiderueshme, e cila si mesatare vjetore (periudha 2015-2031) llogaritet të jetë rreth 1%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe me rreth 15%.

Tabela 45. Popullsia e bashkisë Fier, 2011-2031

	2011	2015	2016	2021	2026	2031
BASHKIA FIER	**126,305**	**122,475**	**119,776**	**114,004**	**108,501**	**103,277**
Fier	58,460	56,687	55,438	52,766	50,219	47,801
Qendër Fier	4,404	4,270	4,176	3,975	3,783	3,601
Libofshë	6,437	6,242	6,104	5,810	5,530	5,263
Topojë	4,445	4,310	4,215	4,012	3,818	3,634
Dermenas	8,153	7,905	7,731	7,359	7,003	6,666
Mbrostar	7,809	7,573	7,406	7,049	6,709	6,386
Levan	8,541	8,282	8,100	7,709	7,337	6,984
Frakull	7,139	6,923	6,770	6,444	6,133	5,838
Portëz	8,646	8,384	8,199	7,804	7,427	7,069
Cakran	12,271	11,899	11,637	11,076	10,541	10,034
QARKU FIER	**324,864**	**315,012**	**308,070**	**293,223**	**279,070**	**265,633**

Burimi: Instat 2015, llogaritje të autorëve

Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënieje, sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e cila për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

1.5.2 Zhvillimi dhe përfshirja sociale

- **Arsimi**

Niveli arsimor: Popullsia e Bashkisë Fier ka një nivel të përgjithshëm arsimi mesatar në raport me bashki të ngjashme[295], dhe të favorshëm në lidhje me bashkitë fqinje në Qarkun Fier. Shkalla e analfabetizmit në bashkinë Fier arrin shifrën 3.2%, më e lartë se niveli kombëtar dhe ai i qarkut, dhe i pafavorshëm në raport me bashkitë e të njëjtit lloj (me përjashtim të Elbasanit, me nivel 3.50%) dhe bashkitë fqinje (përjashtuar Mallakastrën dhe Roskovecin, me vlera respektive 3.70% dhe 3.90%). Tendenca e përgjithshme e analfabetizmit në nivel qarku ka qenë një ulje drastike në periudhën 1989-2001, nga 7.3% në rreth 0.94%[296], si dhe një rritje e konsiderueshme në periudhën 2001-2011, nga 0.94% në 3.18% (e vërejtur edhe në nivel kombëtar, nga 1.4% në 2.8%). Kjo tendencë sjell në vëmendje probleme të mundshme të lënies së shkollës për shkak të aksesit të dobët në të, kushteve të varfërisë etj.

Në nivel njësish administrative, vërehet se shkalla e analfabetizmit më e lartë i takon Njësisë Levan, e më e ulëta Fierit e Topojës. Në Levan dhe Qendër-Çlirim prania e minoriteteve rome[297] ndikon në këtë tendencë. Vlerësohet se rreth 61% e familjeve rome nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë, ose hasin vështirësi në edukimin e fëmijëve, për shkak të mungesës së fondeve për libra e mjete shkollore, vendndodhjes së largët të shkollave, nevojës për t'u kujdesur për vëllezërit e motrat më të vogla, martesave të parakohshme etj.

Ndërkaq, sa i takon nivelit arsimor të popullsisë, në Bashkinë Fier 52.9% e banorëve kanë përfunduar nivelin bazë arsimor (fillor ose 9-vjeçar). Kjo shifër është më e ulët se vlera e Qarkut Fier, por e përafërt me pjesën më të madhe të bashkive të ngjashme, me përjashtim të Vlorës, ku vlera (44.4%) është më pozitive. Siç paraqitet edhe tendenca në nivel kombëtar, kjo shifër e lartë dëshmon për një shoqëri në thelb rurale, pa akses të mirë në shërbimet edukative.

Në nivel bashkie, përqindja e popullsisë që ka përfunduar vetëm ciklin fillor apo 9-vjeçar luhatet në vlera 60-70%, me përjashtim të qytetit të Fierit (36.23%). Kjo tregon për një shpërndarje të pabarabartë në territor të kapitalit njerëzor të kualifikuar, i cili është përqëndruar vetëm në qendrën kryesore të shërbimeve dhe punësimit.

Përqindja e popullsisë me arsim të mesëm të përfunduar në Bashkinë Fier paraqitet më e lartë se niveli kombëtar dhe i qarkut (32.5%, kundrejt 31.4% dhe 30%). Së bashku me bashkinë Patos dhe Lushnjë (pjesë e qarkut Fier), Fieri ka potencial për të investuar në këtë popullatë, duke nxitur punësimin në sektorë shërbimesh, ose vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Vlen për t'u theksuar se popullsia e re e bashkisë Fier (ku rreth 1/6 i përket grup-moshës 0-15 vjeç) lë mundësi për përmirësime në aspektin arsimor në të ardhmen. Në nivel njësish administrative, përqindja e popullsisë me arsim të mesëm varion nga 26% në 33%, përveç Fierit ku është niveli predominues (47%). Vërehet se nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes

pranisë së shkollave të mesme dhe frekuentimit të saj, ashtu sikundër nuk vërehet situatë arsimi më e mirë në njësitë administrative më afër qytetit të Fierit (si p.sh. Çlirim e Mbrostar) në raport me njësitë më periferike.

Ndjekja e arsimit të lartë në nivel bashkie shënon vlerën 9.7%, shumë më të ulët se bashkitë e ngjashme, dhe se niveli kombëtar (11.8%), por mjaft favorizuese në raport me bashkitë e tjera të qarkut (Lushnja, Mallakastra etj.). Një arsye për këtë nivel të ulët është edhe mungesa e një universiteti në Qarkun Fier, gjë që bën të detyrueshme zhvendosjen për arsye shkollimi. Kjo vërehet kryesisht në qytetin e Fierit, ku 16.72% e popullsisë ka përfunduar arsim universitar e pasuniversitar, e më pak në njësi si Portëza, Cakrani etj.

Në tërësi, vitet mesatare të shkollimit për bashkinë Fier dëshmojnë për norma më të ulëta se niveli kombëtar (9.9 kundrejt 10.2), mjaft më të ulëta se bashkitë konkurruese, por shumë favorizuese në nivel qarku, sidomos kundrejt bashkive Divjakë, Mallakastër e Roskovec. Kjo kërkon një mobilizim më të mirë të kapitalit njerëzor, për të fuqizuar pozicionin rajonal/në nivel qarku në lidhje me ofrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar ose të specializuar.

Tabela 46. Niveli arsimor i bashkisë Fier, në raport me bashki të ngjashme

Njësia	Niveli i analfabetizmit	% e popullsisë me arsim të ulët	% e popullsisë me arsim të mesëm	% e popullsisë me arsim të lartë	Vitet mesatare të shkollimit
SHQIPËRI	**2.80%**	**52.10%**	**31.40%**	**11.80%**	**10.2**
QARK FIER	**3.18%**	**57.70%**	**30.04%**	**7.36%**	**9.7**
Bashkia Fier	***3.20%***	***52.90%***	***32.50%***	***9.70%***	***9.9***
Bashkia Vlorë	2.70%	44.40%	36.20%	14.40%	10.6
Bashkia Elbasan	3.50%	53.90%	29.90%	10.80%	10
Bashkia Durrës	2.10%	52.10%	33.60%	11.50%	10.3
Bashkia Shkodër	2.70%	52.20%	31.90%	11.50%	10.2
Bashkia Lushnjë	*2.90%*	*56.70%*	*31.30%*	*7.80%*	*9.8*
Bashkia Patos	*2.80%*	*54.10%*	*35.20%*	*5.30%*	*9.7*
Bashkia Divjakë	*3.10%*	*68.50%*	*23.30%*	*3.60%*	*9.1*
Bashkia Mallakastër	*3.70%*	*62.10%*	*26.80%*	*5.70%*	*9.4*
Bashkia Roskovec	*3.90%*	*71.00%*	*20.20%*	*2.60%*	*8.9*
Bashkia Tiranë	1.60%	31.40%	39.60%	25.30%	11.8

Burimi: Instat, 2011

Tabela 47. Shkalla e analfabetizmit, niveli maksimal i shkollimit dhe vitet mesatare të shkollimit, në nivel bashkie dhe njësish administrative

Njësia	Niveli i analfabetizmit	% e popullsisë me arsim të ulët	% e popullsisë me arsim të mesëm	% e popullsisë me arsim të lartë	Vitet mesatare të shkollimit
SHQIPËRI	**2.80%**	**52.10%**	**31.40%**	**11.80%**	**10.2**
QARK	**3.18%**	**57.70%**	**30.04%**	**7.36%**	**9.7**
BASHKI FIER	**3.20%**	**52.90%**	**32.50%**	**9.70%**	**9.9**
Fier	2.20%	36.23%	47.05%	16.72%	11.13
Cakran	3.30%	70.10%	27.06%	2.84%	8.79

Çlirim (Qendër)	3.30%	66.57%	29.42%	4.01%	9.19
Dërmenas	4.90%	64.35%	32.46%	3.19%	8.96
Frakull	4.20%	69.55%	27.16%	3.29%	8.90
Levan	5.90%	66.08%	30.07%	3.85%	8.81
Libofshë	3.30%	61.74%	33.67%	4.59%	9.17
Mbrostar	4.00%	70.61%	26.06%	3.33%	8.98
Portëz	4.70%	70.11%	27.01%	2.88%	8.72
Topojë	2.80%	68.75%	27.31%	3.94%	8.78

Burimi: Instat, Census 2011

Figura 101. Shkollimi i përfunduar në % për secilën NjA, në nivel bashkie, qarku, kombëtar.



Burimi: Instat, Census 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Figura 102. Numri mesatar i viteve të shkollimit, sipas NjA



Burimi: Instat, Census 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Figura 103. Niveli i analfabetizmit sipas NJA



Burimi: Instat, Census 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Aksesi në arsim: Për të vlerësuar shërbimin arsimor në aspektin e cilësisë dhe aksesueshmërisë janë marrë në konsideratë katër tregues. Së pari, është evidentuar pozicionimi në territor dhe rrezja e mbulimit të objekteve arsimore të llojit kopsht, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme. Së dyti është vlerësuar kapaciteti mbajtës i tyre, sipas indikatorit sipërfaqe/student dhe student/klasa. Së treti, është analizuar kapaciteti akademik, i vlerësuar sipas raportit nxënës/mësues. Dhe së fundi, është identifikuar gjendja fizike e objekteve arsimore në lidhje me 7 indikatorë kryesorë.

Në Bashkinë Fier gjenden 85 kopshte, 18 shkolla fillore, 63 shkolla 9-vjeçare, 18 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 4 shkolla profesionale.

Tabela 48. Numri i objekteve arsimore, Bashkia Fier.

	Çerdhe[298]	Kopshte	Cikli fillor	Shkolla 9-vjeçare	Shkolla të mesme të përgjithshme	Shkolla të mesme profesionale
Fier	2	16	0	12	2	2
Cakran	p/i	8	4	6	1	0
Çlirim Qendër	0	9	3	3	0	1
Dermenas	p/i	8	0	6	2	0
Frakull	p/i	7	3	5	1	0
Levan	p/i	9	2	6	1	0
Libofshë	0	5	1	4	1	0
Mbrostar	0	6	0	6	1	0

Portëz	0	6	3	4	0	0
Topojë	0	6	2	3	1	0
TOTAL publike	***2****	***80***	***18***	***55***	***10***	***3***
private	0	5	0	8	8	1
TOTAL	**2***	**85**	**18**	**63**	**18**	**4**

Burimi: Ministria e Arsimit, 2012[299] dhe Bashkia Fier, 2015

Figura 104. Numri i kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe shkollave të mesme (publike) për NJA, në nivel qarku



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012[300]; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Nga pikëpamja e numrit të objekteve arsimore, Bashkia Fier paraqitet mjaft e favorizuar në nivel qarku, pothuajse në vlera të njëjta me Bashkinë Lushnjë, dhe duke tejkaluar numrin e ofruar në njësitë administrative të Bashkive Divjakë, Patos, Mallakastër e Roskovec. Asnjë nga njësitë administrative brenda bashkisë nuk ka mungesë kopshtesh, apo shkollash 9-vjeçare (ose fillore). Shkollat e mesme janë të shpërndara njëtrajtësisht në territor (1 për secilën njësi), me përjashtim të Portëzës, e cila e merr shërbimin e arsimit të mesëm në qytetin e Fierit, dhe Qendër-Çlirimit, ku funksionon një shkollë e mesme profesionale bujqësore.

Në qytetin e Fierit kemi mbulimin më të mirë me objekte arsimore, ku ndodhen 2 çerdhe publike, 16 kopshte publike dhe 5 private, 12 shkolla 9-vjeçare publike dhe 8 private, si dhe 13 shkolla të mesme. Nga këto, 2 janë gjimnaze publike, 8 janë shkolla të mesme private, si dhe 3 të tjerat janë shkolla profesionale, si më poshtë:

1. Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota", e cila ofron degët mekanikë, elektrikë, teknologji informacioni dhe teknologji kimike
2. Shkolla e mesme artistike "Jakov Xoxa"
3. Shkolla e mesme private sportive, "Tole Alba".

Vërehet mungesë e institucioneve të arsimit të lartë, si publike, ashtu edhe private, në të gjithë qarkun, gjë që nxit zhvendosjen e popullatës së re për arsye studimi.

Nga pikëpamja e aksesueshmërisë së objekteve arsimore, është kryer një llogaritje[301] mesatare e sipërfaqes urbane që nuk mbulohet nga ky shërbim.

Sipërfaqe urbane pa akses të mirë në:

- **kopësht**: ***1999.52 ha,*** **50.4%** e territorit urban (sidomos në qytet dhe në fshatrat Peshtan Bregas, Cakran, Varibop, Kreshpan, Kraps, Frakull e Madhe, Drizë, Afrim, Sulaj, Mbrostar, Venaj etj)
- **shkollë 9-vjeçare**: 439.17 ha; **11%** e territorit urban (periferi e Fierit, fshatrat Grykë, Metaj, Kallm i Vogël, Kraps etj)
- **shkollë e mesme**: 745.3 ha; **18.8%** e territorit urban (në fshatrat Plyk, Portëz, Peshtan, Kraps, Pishë, Mbrostar, Petovë, Ndërnënas etj)

Nga pikëpamja e kapacitetit mbajtës është vlerësuar treguesi "Sipërfaqe ndërtimi për nxënës", nga i cili rezulton se shkollat 9-vjeçare publike dhe shkollat e mesme kanë kushte problematike të ambienteve. Kjo manifestohet edhe në rang qarku dhe kombëtar, ku realizohet vlera 3-5m^2/student, në vend të standardit 20-30m^2/student. Gjendja e kopshteve duket më e mirë, me kapacitet mesatar 18m^2/fëmijë. Gjithsesi kjo i dedikohet kryesisht numrit të vogël të fëmijëve që ndjekin kopshtin, dhe jo sipërfaqeve të mëdha të shërbimit parashkollor të ofruara për ta.

Figura 105. Mbulimi me kopshte



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012 dhe Bashkia Fier, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Figura 106. Mbulimi me shkolla 9-vjeçare



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012 dhe Bashkia Fier, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Figura 107. Mbulimi me shkolla të mesme



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012 dhe Bashkia Fier, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Raporti mesatar nxënës/klasë është relativisht i ulët (15-18 nxënës për klasë), por kjo gjithashtu i referohet numrit të ulët të nxënësve nëpër shkolla, dhe jo kapaciteteve akomoduese të tyre.

Tabela 49. Treguesit e kapacitetit mbajtës të objekteve arsimore në nivel bashkie.

	Nr. i objekteve	Fëmijë (nxënës) gjithsej	Sipërfaqe mesatare për fëmijë (nxënës) (m2)	Standardi Sn/nxënës (m2)	Mesatarja Sn/nxënës për Shqipërinë / Qarkun	Nr. edukatorë (mësues)	Nr. mesatar i fëmijëve (nxënësve) /klasë
Çerdhe publike	2	90	p/i	25-30	p/i	p/i	p/i
Kopshte publike	80	3115	17.91	18-25	9.86 / **9.27**	161	11
Kopshte private	5	233	p/i	18-25	p/i	p/i	p/i
Shkolla 9 vjeçare publike	73	15516	3.7	20-25	4.64 / **4.15**	1044	15
Shkolla 9 vjeçare private	8	1727	p/i	20-25	p/i	p/i	p/i
Shkolla të mesme publike	13	3863	4.05	20-30	3.67 / **3.56**	261	18
Shkolla të mesme private	9	1550	p/i	20-30	p/i	p/i	p/i

Burimi: Ministria e Arsimit, 2012; Përgatiti: Co-PLAN, 2015 (p/i = pa informacion)

Figura 108. Mbulimi me objekte arsimore në nivel qyteti (Fier)



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Një indikator tjetër që merret në konsideratë për të studiuar kapacitetin mbajtës të shkollave është sipërfaqja e oborrit, e cila duhet të jetë minimalisht 1000-2000m^2 për secilin objekt arsimor, për të mbuluar nevojën për terren sportive, aktivitete mësimore e rekreative etj.[302] Nga studimi në nivel bashkie[303], vërehet se ky tregues për shkollë të mesme është 4200 m^2, pra rreth 1.5 m^2/student, shifër që e tejkalon standardin ligjor. Edhe për shkolla fillore e 9-vjeçare sipërfaqja mesatare e oborrit arrin 2600 m^2, ndërsa për kopshte të veçuara mesatarja e sipërfaqes ka vlerën 1200m^2 (në raport me standardin 1000-1500m^2), pra në standarde të pranueshme hapësinore. Gjithsesi duhet patur parasysh që pjesa më e madhe e kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare ndajnë një oborr të përbashkët.

Edhe në qytetin e Fierit, sipërfaqja e oborrit të objekteve arsimore përputhet me standardet, por ka vlerë më të ulët se në zona rurale: kopshtet kanë sipërfaqe mesatare parcele 1700m^2, shkollat 9-vjeçare 2800m^2 dhe shkollat e mesme 3400 m^2. Ky vlerësim supozon se e gjithë parcela përdoret si oborr nga objekti arsimor përkatës.

Sa i takon kapacitetit akademik, përgjithësisht në shkollat e mesme raporti mësues-student është mjaft i favorshëm, duke variuar 1-20 studentë për mësues. Në nivel qarku, ky raport është mesatarisht 21.8, ndërsa në nivel NA brenda bashkisë Fier, është minimalisht 4 në Dërmenas dhe maksimalisht 20 në Libofshë. Shkollat 9-vjeçare kanë gjithashtu kapacitet të mirë akademik, që varion nga 5-15 studentë/mësues. Ndërkohë, pjesa më e madhe e kopshteve e kanë kapacitetin të lartë, 15-25 fëmijë/edukator. Gjithsesi, në nivel qarku, njësitë

administrative të bashkisë Fier kanë vlera shumë të mira të treguesve të kapacitetit mbajtës të përgjithshëm.

Figura 109. Kapaciteti akademik për kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme, nivel objekti arsimor, për Bashkinë Fier.



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012; Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Figura 110. Kapaciteti akademik për kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme, për NjA në nivel Qarku.



Burimi: Ministria e Arsimit, 2012; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Vlerësimi i gjendjes fizike të objekteve arsimore është bërë duke marrë parasysh shtatë indikatorë: kushtet e mureve të jashtme, kushtet e mureve të brendshme, gjendjen e çatisë, gjendjen e tavanëve të brendshëm, gjendjen e themeleve, cilësinë e dyerve dhe cilësinë e dritareve[304].

Nga ky evidentim rezulton se në asnjë nga objektet arsimore në Bashkinë Fier nuk është në gjendje rreziku për asnjë nga këto kushte. Gjithsesi, disa nga kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare kanë nevojë për ndërhyrje rikonstruktuese pjesore. Kopshti në fshatin Darzezë paraqet problematikë në të gjithë aspektet fizike të ndërtesës dhe kërkon ndërhyrje të shpejtë rehabilituese. Gjithashtu, shkolla 9-vjeçare e fshatit Fushë, në Topojë, ka nevojë për rehabilitim të kushteve fizike. Pjesa tjetër e objekteve kanë nevojë për ndërhyrje të pjesshme, kryesisht në tavanet e brendshme, dyer e dritare.

Tabela 50. Lista e objekteve arsimore në nevojë për ndërhyrje rikonstruktuese.

Emërtimi		Fshati/ Qyteti	NJA	Problem 1	Problem 2	P3	P4	P5	P 6	P7
Kopshte	n/a	Darzezë	Dërmenas	muret e jashtme	muret e brendshme	çatia	themelet	dyert	dritaret	tavani
	n/a	Grykë	Topojë	muret e jashtme	dyert	dritaret	themelet			
	n/a	Hasturkas	Libofshë	tavani	dritaret					
	Hiqmet Buzi	Kallm i Madh	Mbrostar	dyert	dritaret					
	n/a	Povelçë	Dërmenas	tavani						
	n/a	Portëz	Portëz	tavani						
	Shyqyri Behari	Kraps	Portëz	tavani						
	Jakov Xoxa	Fier	Fier	dyert						
Shkolla 9-vjeçare	n/a	Fushë	Topojë	muret e jashtme	muret e brendshme	çatia	themelet	dyert	dritaret	
	Hiqmet Buzi	Kallm i Madh	Mbrostar	tavani	dyert	dritaret				
	Jakov Xoxa	Fier	Fier	dyert	dritaret					
	Kozma Ndreçka	Rreth Libofshë	Libofshë	themelet						
	Shyqyri Behari	Kraps	Portëz	tavani						
	Dino Ismaili	Levan	Levan	tavani						

Burimi: Ministria e Arsimit (2012)

Objektet e tjera arsimore në territorin e Bashkisë Fier janë në gjendje shumë të mirë, ose me problematika të vogla.

- **Shëndetësia**

Gjendja e përgjithshme e shëndetit publik: Qarku Fier paraqet një gjendje shëndetësore relativisht të mirë në nivel kombëtar. Vdekshmëria foshnjore, e llogaritur për moshën 0-1 vjeç arrin 4.15/1000 lindje të gjalla, ndërkohë që në Shqipëri kjo shifër është 7.2/1000[305]. Vërehet një përmirësim i dukshëm nga nivelet e vitit 2001, ku vdekshmëria foshnjore shënonte 17.4[306] për 1000 banorë. Personat me të paktën një aftësi të kufizuar përbëjnë 6.55%[307] të popullsisë, krahasueshëm me nivelin kombëtar (6.2%).

Në nivel bashkie, shpërndarja e personave me aftësi të kufizuara është predominuese ne Fier (2379 persona), por në raport me popullsinë e NjA-së. Topoja përbën rastin më problematik, me 13.8% të popullsisë të regjistruar si me aftësi të kufizuar, ndërkohë që për Fierin, kjo vlerë është më e ulëta (4.9%). Përgjithësisht problematikat shëndetësore i takojnë pamundësisë për të ecur (28%) dhe vështirësive në shikim (17%), problematika të lidhura drejtpërdrejt me barrierat fizike dhe mënyrën e projektimit të zonave urbane. Shpërndarja e defekteve të lindura për qarkun Fier shënon vlerën 10.5 për 1000[308] lindje të gjalla, më e ulët në raport me mesataren e Shqipërisë (14.3) dhe e krahasueshme me qarqe të ngjashme (

Sa i takon gjendjes së përgjithshme të sëmundshmërisë, sëmundjet kryesore që prekin popullsinë e Qarkut Fier janë sëmundjet diareike, më të përhapura gjatë stinës së verës, që zënë 50% të sëmundjeve infektive dhe vijnë kryesisht nga ndotja e ujit dhe e ajrit. Kjo sindromë ka prekur rreth 6200 individë vetëm në vitin 2013, shifra më e lartë në nivel kombëtar, pas Qarkut të Durrësit[309].

Tabela 51. Numri dhe përqindja e personave me aftësi të kufizuar, sipas gjinisë e llojit të paaftësisë, në nivel NjA-je.

	TOTAL		Meshkuj		Femra		Lloji i paaftësisë					
Njësia	**Me *AK**	**% ndaj totalit**	**Me *AK**	**% ndaj totalit**	**Me *AK**	**% ndaj totalit**	**Në shikim**	**Në dëgjim**	**Në ecje**	**Në kujtese**	**Në kujdes të vetes**	**Në komunikim**
Cakran	668	7.38	303	6.52	365	8.30	217	176	403	250	221	200
Dërmenas	474	7.75	208	6.69	266	8.84	163	107	262	144	125	135
Fier	2,379	5.20	1,075	4.79	1,304	5.61	800	666	1,553	711	689	564
Frakull	294	5.49	133	4.83	161	6.19	111	86	159	116	125	112
Levan	506	7.75	241	7.58	265	7.92	220	167	276	150	168	143
Libofshë	484	9.33	214	8.42	270	10.21	241	198	335	183	171	167
Mbrostar	280	4.90	138	4.76	142	5.05	100	80	139	103	109	92
Portëz	411	6.35	176	5.38	235	7.35	181	116	247	155	140	117
Qendër	288	8.62	131	7.97	157	9.25	111	79	142	62	53	39
Topojë	495	13.83	218	12.20	277	15.47	221	152	256	125	140	123
BASHKI	**6,279**	**6.5**	**2,837**	**6.91**	**3,442**	**8.42**	**2,365**	**1,827**	**3,772**	**1,999**	**1,941**	**1,692**

Burimi: Instat, Census 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015
**AK= aftësi e kufizuar*

Sëmundjet akute të frymëmarrjes, si astma dhe bronkitet, të përhapura në dimër kanë si shkak përdorimin e sistemeve ngrohëse pra, kryesisht, nga ajri i ndotur. Gjithashtu sëmundjet kardiovaskulare janë të dendura ndër sëmundjet kronike dhe shkaktaret kryesore të vdekjeve[310]. Prezenca e hipertensionit është vërejtur në 21.5% të femrave dhe 36.9% të meshkujve të Rajonit Bregdetar, vlera më e lartë në nivel kombëtar[311], dhe krahasuar me Tiranën urbane (5 dhe 8%).

Figura 111. Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar sipas NJA; grafiku i llojeve të aftësive të kufizuara



Burimi: Instat, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Në Bashkinë Fier janë regjistruar edhe disa raste aksidentesh të lidhura me shëndetin publik, në periudhën 2013-2015. Në njësinë Cakran në vitin 2013 është përhapur një epidemi gastroenterite, e cila preku 165 individë dhe u përhap edhe në njësitë fqinje: Frakull, Portëz dhe Hekal, si pasojë e helmimit nga ushqimet dhe pijet[312]. Gjithashtu, aksidenti i shpërthimit të fontanave në puset e naftës të Marinzës, Fier, shkaktoi probleme shëndetësore në popullsinë e zonës, që mund të kenë lidhje me çlirimin e gazit metan gjatë aksidentit[313]. Është i pranishëm gjithashtu edhe rreziku i sëmundjeve kancerogjene, kryesisht në rrugët e frymëmarrjes, si pasojë e ndotësve të ajrit të çliruar nga industria e naftës, si: SO_2, H_2S, CO_2 etj.

Infrastruktura shëndetësore: Sistemi i kujdesit shëndetësor përbëhet nga një rrjet shërbimesh, duke filluar që nga spitali, qendrat shëndetësore, ambulancat, lloje të ndryshme klinikash të specializuara (si klinikat dentare, poliklinikat etj), shërbimet ndihmëse farmaceutike, publike apo private, si dhe institucionet e dekoncentruara të shëndetit. Në nivel qarku, në Fier ndodhen 3 spitale rajonale, të cilat ofrojnë 668 shtretër, dhe 184 qendra shëndetësore[314], së bashku me ambulancat që mbulojnë secila 1-2 fshatra. Vlerësohet se distanca mesatare nga qendra shëndetësore më e afërt është rreth 19 minuta, ndër më të lartat në nivel kombëtar. Në raport me qarqet e ngjashme[315], Fieri ka numrin më të madh të qendrave shëndetësore dhe mjekëve, pas Durrësit e Tiranës. Raporti nr.mjekësh/10,000 banorë është 11, më i ulët se mesatarja kombëtare (12.6). Gjithashtu edhe kapaciteti i spitaleve (shtretër/10,000 banorë) është i ulët, 22.2, duke e renditur qarkun e Fierit në disavantazh, pas qarqeve të tjera të ngjashme, si dhe më ulët se mesatarja kombëtare (30.6).

Në nivel bashkie, Fieri ka 1 spital rajonal, të vendosur në qytetin e Fierit, 12 qendra shëndetësore dhe 85 ambulanca[316]. Gjithashtu në qytetin Fier ndodhet 1 polikliniké, 1

farmaci shtetërore, 3 konsultore fëmijësh, 2 konsultore të nënës me fëmijë dhe 18 qendra të shërbimit të mjekut të familjes. Njësitë e tjera administrative kanë secila nga një qendër shëndetësore, e cila manaxhon ambulancat respektive nëpër fshatra (5-11 për secilën njësi).

Tabela 52. Treguesit e infrastrukturës shëndetësore në nivel qarku.

Qarku	Mjekë në qendra shëndetësore	Nr. total Mjekesh	Nr. spitalesh	Nr. shtretërish	Mjekë për 10.000 banorë	Shtretër për 10.000 banorë
FIER	**184**	**332**	**3**	**668**	**11.0**	**22.2**
DURRËS	230	386	2	464	15.0	18.0
ELBASAN	170	311	6	1020	10.8	35.5
SHKODËR	119	225	2	653	10.7	31.0
TIRANË	369	1,013	7	2190	13.7	29.6
VLORË	128	256	4	706	14.3	39.5

Burimi: Instat, MSH dhe ISSH, 2014

Figura 112. Distanca mesatare në minuta nga qendra shëndetësore më e afërt, nivel qarku.



Burimi: Instat, 2012

Figura 113. Shpërndarja e ambulancave konsultatore sipas NjA-së, në nivel qarku



Burimi: MSH 2014, DRSH Fier, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Tabela 53. Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe ambulancave, në raport me standardin e planifikimit

Njësia	Qendra Shëndetësore	Ambulanca	Niveli aktual në raport me standardin	Nr. mjekësh	Nr. infermierësh
Mbrostar	1	5	1	4	14
Topojë	1	7	5	3	13
Frakull	1	9	6	4	13
Portëz	1	6	2	4	12
Libofshë	1	11	8	p/i	p/i
Dermenas	1	10	6	5	14
Levan	1	11	7	6	19
Q. (Çlirim)	1	7	5	p/i	p/i
Cakran	1	11	5	p/i	p/i
Fier	3	8	-20	22*	45*
BASHKI FIER	**12**	**85**	24	p/i	p/i

Burimi: Ministria e Shëndetësisë 2014, DRSH Fier 2015; llogaritje të autorëve

*-Këto vlera llogaritin vetëm punonjësit e Qendrave Shëndetësore nr. 2 e 3, në mungesë informacioni për QSH1
p/i=pa informacion

Nëse marrim parasysh një standard 1 qendër shëndetësore për 10,000 banorë[317], rezulton se të gjitha njësitë administrative janë të mbuluara shumë mirë nga ky shërbim, sepse ato nuk kanë popullsi më të lartë se 10,000 banorë[318]. Ndërkaq, në qytetin Fier 3 qendrat shëndetësore nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e popullsisë prej 56,687 banorësh, dhe nevojiten 2-3 të tjera. Ndërkaq, në lidhje me shpërndarjen e ambulancave, në nivel qarku vërehet që njësitë administrative të Bashkisë Fier kanë një numër më të madh në raport me bashkitë e tjera dhe nuk ka asnjë njësi pa ambulanca. Njësitë Cakran, Libofshë, Levan e Dërmenas kanë numrin më të madh të ambulancave në qark, pas Fier Sheganit. Secila NjA e bashkisë Fier përmbush standardin për ambulance të përcaktuar në Rregulloren e Planifikimit të Territorit (1 për 1,500-2,000 banorë), me përjashtim të qytetit Fier, i cili ka mungesë prej rreth 20 ambulancash konsultatore. Ky shërbim mbulohet nga poliklinika, 3 konsultoret e fëmijëve, 2 konsultoret e nënës me fëmijë dhe 18 qendrat e shërbimit të mjekut të familjes. Sa i takon mjekëve, për secilën qendër shëndetësore kemi një mesatare prej 3-5 mjekësh dhe 12-19 infermieresh, për zonat rurale, e 10 mjekë dhe 20-25 infermiere për qytetin. Në zonat rurale nuk ka specializim të mjekëve, dhe mbizotërojnë mjekët e familjes, kurse në qytet dallohen specializime si: pediatër, patologë, epidemologë etj. Përveç objekteve shëndetësore, në qytetin e Fierit ndodhet edhe Drejtoria e Shëndetit Parësor, si dhe Laboratori Shtetëror i Analizave Baktereologjike.

Aktualisht gjendja fizike e objekteve shëndetësore është jo e mirë, sidomos në ambulancat e zonave rurale dhe në polikliniken e qytetit. Zona spitalore e Fierit, e shtrirë në afërsi të qendrës, është në degradim për shkak të ndërtimeve informale rreth saj. Gjithashtu, spitali i fshatit Seman, Topojë, prej vitesh është jashtë funksionimit, për shkak të degradimit fizik dhe mungesës së stafit mjekësor në të.

- **Punësimi**

Bashkia Fier ka një situatë punësimi relativisht të mirë në raport me bashki të tjera të ngjashme, si Elbasani, Durrësi e Shkodra. Papunësia për bashkinë Fier arrin 29.5%, e përafërt me mesataren kombëtare dhe lehtësisht më e lartë se Qarku Fier. Gjithsesi, në raport me bashkitë fqinje, bashkia Fier shënon shkallën më të lartë të papunësisë, me përjashtim të Patosit (49%). Vërehet një diferencë papunësie prej rreth 5.3% mes femrave e meshkujve, më e lartë se mesatarja kombëtare (3.5) dhe e qarkut (5), gjë që dëshmon për prirje më të larta punësimi te meshkujt se te femrat. Papunësia te të rinjtë në bashkinë Fier (56,10%) shfaqet si problematikë në raport me nivelin kombëtar, të qarkut, si dhe bashkitë e ngjashme.

Tabela 54. Shkalla e papunësisë në Bashkinë Fier, krahasuar me bashkitë e ngjashme.

Njësia	Papunësia femra	Papunësia meshkuj	Papunësia gjithsej	Diferenca e papunësisë f-m (%)	Papunësia tek të rinjtë
SHQIPËRI	**31.40%**	**27.90%**	**29.30%**	**3.5**	**52.90%**
QARK FIER	**27.10%**	**22.10%**	**24.60%**	**5**	**46.60%**
Bashkia Fier	**32.20%**	**26.80%**	**29.50%**	**5.4**	**56.10%**
Bashkia Vlorë	31.50%	24.30%	27.00%	7.2	51.50%
Bashkia Elbasan	36.30%	29.60%	32.10%	6.7	54.60%
Bashkia Durrës	34.10%	30.10%	31.60%	4	49.50%
Bashkia Shkodër	40.20%	40.00%	40.10%	0.2	63.60%
Bashkia Lushnjë	*21.60%*	*16.40%*	*18.30%*	*5.2*	*36.90%*

Bashkia Patos	*55.90%*	*45.60%*	*49.00%*	*10.3*	*70.20%*
Bashkia Divjakë	*7.90%*	*6.00%*	*6.70%*	*1.9*	*21.70%*
Bashkia Mallakastër	*29.20%*	*19.20%*	*22.30%*	*10*	*49.20%*
Bashkia Roskovec	*34.60%*	*32.70%*	*33.30%*	*1.9*	*58.10%*
Bashkia Tiranë	25.60%	23.30%	24.30%	2.3	48.00%

Burimi: Instat, 2011

Tabela 55. Punëkërkuesit aktivë sipas qarqeve, për vitin 2014.

Qarku	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Të rinj 15-24	Arsim Fillor	Arsim i mesëm i përgjithshëm	Arsim i mesëm profesional	Arsim i lartë
Fier	16.755	9.485	7.270	2.767	8.445	3.678	3.337	1.296
Vlorë	9.479	5.029	4.450	1.673	5.216	2.560	720	983
Elbasan	16.308	7.774	8.534	2.797	9.032	5.263	1.773	241
Durrës	9.734	4.650	5.084	1.590	5.386	2.590	1.021	737
Shkodër	16.449	7.719	8.730	2.089	8.004	5.537	2.120	788

Burimi: Vjetari Statistikor, Instat 2015

Ndërkaq, nga analiza demografike[319] vërehet se popullsia ekonomikisht aktive (15-64) në Bashkinë Fier përbën 68% të popullsisë. Kjo do të thotë që potencialisht, performanca ekonomike e bashkisë duhet të ishte mjat e mirë në lidhje me punësimin. Nëse analizojmë pjesëmarrjen aktive në forcën punëtore, në nivel qarku, shohim se në vitin 2014 kishte 16,755 punëkërkues aktivë, të regjistruar. Ky numër është mjaft i madh në raport me qarqe të tjera të ngjashme, dhe i përket kryesisht bashkive Fier dhe Patos, që kanë normën më të lartë të papunësisë në nivel qarku. Vlen të theksohet se këta punëkërkues kanë kuotat më të larta të arsimit universitar (1,296), si dhe të mesëm profesional (3,337), në raport me qarqet e tjera, dhe shënojnë një numër të madh të rinjsh të moshes 15-24 vjeç (2,767). Këto janë shifra inkurajuese në lidhje me pozicionimin e bashkisë Fier në "basenin e punësimit" rajonal.

Figura 114. Niveli i papunësisë i femrave, meshkujve, dhe diferenca e papunësisë femra-meshkuj sipas bashkive, në nivel qarku.



Burimi: Instat, 2011; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Ndërkaq, në nivel bashkie, papunësia më e lartë i takon njësive administrative Portëz dhe Qendër, të cilat ndodhen më pranë qendrës së Fierit. Ndërkaq, njësitë Frakull dhe Libofshë kanë papunësinë më të ulët. Kjo lidhet kryesisht me karakterin bujqësor të zonave dhe vetëpunësimin në sektorin bujqësor. Diferenca e papunësisë mes femrave dhe meshkujve ka tendenca të larta (14-17%), sidomos në Libofshë, Qendër e Topojë, ku edhe shkalla e përgjithshme e papunësisë është më e lartë. Gjithsesi në njësitë Dërmenas dhe Frakull vërehet papunësi më e lartë tek meshkujt se tek femrat.

Punësimi i të rinjve është problematik pothuajse në të gjithë njësitë administrative, duke u luhatur nga 50 në 65% të popullsisë të moshes 15-24 vjeç. Papunësia më e lartë vërehet në njësitë Levan, Qendër e Portëz, për arsye të punësimit të përgjithshëm të ulët.

Tabela 56. Shkalla e papunësisë në Bashkinë Fier, sipas gjinisë dhe njësisë administrative.

	Papunësia femra	Papunësia meshkuj	Papunësia gjithsej	Diferenca e papunësisë f-m	Papunësia tek të rinjtë
CAKRAN	33.20%	29.10%	31.15%	4.1	50.20%
DERMENAS	31.10%	36.40%	33.75%	-5.3	58.00%
FIER	30.90%	25.20%	28.05%	5.7	59.00%
FRAKULL	12.60%	17.70%	15.15%	-5.1	43.50%
LEVAN	48.30%	30.90%	39.60%	17.4	62.80%
LIBOFSHË	13.00%	11.50%	12.25%	1.5	29.10%
MBROSTAR	38.00%	26.10%	32.05%	11.9	52.30%
PORTËZ	52.40%	42.10%	47.25%	10.3	64.60%
QENDËR	45.70%	31.60%	38.65%	14.1	60.00%
TOPOJË	39.10%	21.40%	30.25%	17.7	57.60%
BASHKI FIER	**32.20%**	**26.80%**	**29.50%**	**5.4**	**56.10%**
QARK FIER	**27.10%**	**22.10%**	**24.60%**	**5**	**46.60%**

Burimi: Instat, 2011

Figura 115. Niveli i papunësisë i femrave dhe meshkujve, sipas NjA-ve



Burimi: Instat, 2011

Tabela 57. Sektori i punësimit në nivel bashkie, krahasuar me bashkit të ngjashme dhe bashkitë e tjera të qarkut.

	Industri	Shërbime	Bujqësi
Shqipëri	20,40%	53,50%	26,10%
Qark Fier	17,20%	35,30%	47,50%
Bashkia Fier	25,40%	50,50%	24,10%
Bashkia Vlorë	26,70%	60,20%	13,10%
Bashkia Shkodër	25,00%	63,10%	11,90%
Bashkia Elbasan	20,90%	51,40%	27,70%
Bashkia Durrës	28,70%	62,20%	9,10%
Bashkia Lushnjë	9,60%	31,10%	59,30%
Bashkia Divjakë	7,30%	14,60%	78,10%
Bashkia Patos	37,40%	42,10%	20,50%
Bashkia Roskovec	15,30%	28,50%	56,20%
Bashkia Mallakastër	21,20%	29,50%	49,30%

Burimi: Instat, 2011

Treguesit e punësimit përgjithësisht janë të lidhur ngushtë me sektorin kryesor ekonomik. P.sh, në nivel qarku, Bashkia Fier ka sektor kryesor punësimi shërbimet (50,5%), ndjekur nga industria e bujqësia me peshë pothuajse të barabartë. Kjo e rendit bashkinë në pozicion më të ekuilibruar se bashkitë e tjera të ngjashme me të, si Vlora apo Durrësi, që paraqesin disbalanca mes punësimit parësor në sektorin e shërbimeve, dhe punësimit në bujqësi. Në raport me bashkitë fqinje, Bashkia Fier ofron punësimin më të lartë në shërbime, ndjekur nga Bashkia Patos e më pas nga Bashkia Lushnjë. Kjo dëshmon për një pozitë konkurruese në nivel qarku sa i takon diversifikimit ekonomik dhe ofrimit të shërbimeve.

Në nivel bashkie, të gjithë njësitë administrative kanë karakter mbizotërues bujqësor, me përjashtim të Fierit, ku 65,86% e popullsisë aktive është e punësuar në shërbime. Libofsha dhe Frakulli kanë karakterin më rural, me mbi 60% të popullsisë të punësuar në bujqësi. Ndërkaq, me punësim më të diversifikuar paraqiten njësitë Mbrostar, Portëz e Qendër, që ndodhen më pranë qendrës urbane, dhe kanë mjaft prioritet edhe industrinë.

Tabela 58. Sektori i punësimit, statusi i punësimit dhe punësimi sipas nivelit arsimor, nivel NJA.

	Sektori i punësimit			**Statusi i punësimit**		**Punësimi sipas niv.arsimor**		
Njësia Administrative	Industri	Shërbime	Bujqësi	Vetë-punësim	Punësim me pagë	fillor/9-vjeçar	i mesëm	i lartë
Fier	30,70%	65,86%	3,44%	67,30%	32,70%	17,85%	50,22%	31,93%
Cakran	16,10%	29,10%	54,80%	25,30%	74,70%	61,44%	29,81%	8,75%
Dërmenas	20,20%	38,36%	41,44%	38,50%	61,50%	57,05%	35,08%	7,87%
Frakull	12,80%	26,20%	61,00%	23,50%	76,50%	64,19%	28,58%	7,23%
Levan	16,80%	39,70%	43,50%	38,00%	62,00%	57,12%	31,38%	11,50%
Libofshë	9,40%	23,30%	67,30%	21,70%	78,30%	52,29%	39,72%	7,99%

Mbrostar	24,30%	29,00%	46,70%	35,70%	64,30%	60,50%	32,43%	7,07%
Portëz	28,10%	39,00%	32,90%	39,90%	60,10%	60,55%	28,93%	10,52%
Qendër (Clirim)	29,50%	33,10%	37,40%	46,30%	53,70%	60,41%	31,92%	7,67%
Topojë	21,40%	29,80%	48,80%	35,50%	64,50%	57,06%	33,26%	9,68%
Bashkia Fier	25,40%	50,50%	24,10%	51,70%	48,30%	36,20%	42,20%	21,60%

Burimi: Instat, 2011

Figura 116. Punësimi sipas sektorëve, nivel NJA.



Burimi: Instat, 2011; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Figura 117. Statusi i punësimit dhe punësimi sipas nivelit arsimor, për NJA.



Burimi: Instat, 2011; Përgatiti Co-PLAN, 2015

Nga pikëpamja e statusit të punësimit, predominojnë të vetëpunësuarit ndaj të punësuarve me pagë. Veçanërisht e theksuar kjo dukuri është në njësitë Cakran, Frakull dhe Libofshë, me karakter thellësisht bujqësor dhe vetëpunësim në këtë sektor. Ndërkohë, në Fier punësimi me pagesë përbën mbi 60% të situatës së punësimit. Pjesa më e madhe e të punësuarve në nivel bashkie i takojnë shkollimit fillor e të mesëm. Shkollimi fillor i të punësuarve përbën mbi 60% të rasteve në njësitë administrative rurale, ku niveli i përgjithshëm arsimor është i ulët. Në Fier predominojnë të punësuarit me arsim të mesëm (50%) dhe të lartë (32%), gjë që dëshmon për thithjen e fuqisë punëtore të kualifikuar në qytet.

Tabela 59. Punësimi sipas sektorëve në periudhën 2010-2014, si dhe punëkërkuesit e papunë, në nivel qarku.

	2010	2011	2012	2013	2014
administratë publike	14285	13658	14561	13636	13596
sektor privat jo-bujqësor	16754	16092	16159	16424	17671
sektor privat bujqësor	92609	80191	84588	81194	77373
punëkërkues të papunë të regjistruar	16258	15700	16124	16490	16755

Burimi: Vjetari Statistikor, Instat 2015

Nëse studiojmë ecurinë e punësimit sipas sektorëve në nivel qarku, do të vërejmë tendenca të vogla uljeje në sektorin bujqësor dhe në administratë publike, dhe rritje të lehtë në sektorin privat jo-bujqësor. Pesha e punësimit në administratë publike është 13 % e forcës punëtore të punësuar, shifër mjaft e lartë duke konsideruar peshën e vogël specifike që zënë shërbimet në punësimin në nivel qarku. Gjithashtu, punëkërkuesit e papunë përbëjnë një përqindje të lartë, me tendenca uljeje nga viti 2010 në 2014.

Figura 118. Punësimi sipas sektorëve në periudhën 2010-2014, si dhe punëkërkuesit e papunë, në nivel qarku.



Burimi: Vjetari Statistikor, Instat 2015

- **Mirëqënia social-ekonomike**

Niveli i përgjithshëm ekonomik: Nga pikëpamja e të ardhurave të familjeve dhe nivelit të varfërisë, Qarku Fier paraqet vlera të moderuara në raport me qarqet e ngjashme. Të ardhurat mujore të sugjeruara nga Anketa e Buxhetit të Familjes për periudhën 2006-2007 tregojnë se Fieri, me të ardhura mesatare familjare prej 38,190 lekësh në muaj, qëndron shumë larg vlerave të qarkut Vlorë e Durrës, por më në avantazh në raport me Shkodrën dhe Elbasanin. Ky tregues për bashkinë Fier në ditët e sotme pritet të jetë më i lartë (mbi 40,000), për shkak të tendencave të përgjithshme të rritjes së vlerës së shtuar bruto në nivel qarku, veçanërisht pas vitit 2009, dhe pozitës së favorizuar të Bashkisë Fier në lidhje me bashkitë e tjera të qarkut, sa i takon diversifikimit ekonomik.

Tabela 60. Burimet e të ardhurave mujore, në nivel qarku.

QARKU	Fier	Vlorë	Durrës	Elbasan	Shkodër	Tiranë
Të ardhurat mujore gjithsej	**38.190**	51.394	45.025	29.049	34.779	58.812
Të ardhura nga puna me pagë	**14.519**	15.489	19.288	11.684	12.264	30.389
Të ardhura nga biznes privat bujqësor dhe jo bujqësor	**11.235**	16.246	11.843	8.967	12.417	15.822
Pensionet	**6.322**	7.498	6.435	5.210	6.123	6.202
Të ardhura nga pronësia	**673**	3.589	1.534	118	197	1.979
Pagesa të tjera dhe pagesa ekstra	**558**	771	362	1.027	538	713
Ndihma ekonomike	**133**	16	59	146	284	65
Transferta nga jashtë shtetit	**4.376**	6.871	4.735	1.686	2.285	2.837
Të ardhura në kesh nga të afërm brenda vendit	**298**	471	596	161	563	498
Të ardhura të tjera	**76**	442	174	50	107	306

Burimi: Anketa e buxhetit të familjes, 2006-2007

Figura 119. Burimi i të ardhurave të familjeve, nivel qarku.



Burimi: Anketa e buxhetit të familjes, 2006-2007

Burimi kryesor i të ardhurave në Qarkun Fier është puna me pagesë, e ndjekur nga të ardhurat prej bizneseve private dhe pensionet. Tranfertat nga jashtë shtetit zinin një përqindje të konsiderueshme në periudhën e anketimit, por pritet të jenë ulur pas vitit 2009.

Vërehet që në raport me qarqet e ngjashme, të ardhurat nga pronësia janë shumë të ulëta, dhe punësimi me page ka prioritet të dukshëm në raport me vetëpunësimin.

Në një vlerësim të përafërt të shpenzimeve totale mujore të familjeve, në nivel qarku, për vitin 2013, vërehet se Qarku Fier ka shpenzimet më të ulëta totale dhe për frymë, në raport me qarqe të ngjashme. Gjithsesi, në nivel bashkie, nuk ka të dhëna që të vërtetojnë këtë tendencë disfavorizuese ndaj mirëqënies ekonomike të familjeve.

Tabela 61. Shpenzimet e familjeve, nivel Qarku.

Qark	Shpenzimet totale të familjeve (lek)	Shpenzimet për frymë (lek)
Fier	**41372**	**10287.6**
Elbasan	45890	10746.9
Durrës	49347	11485.8
Shkodër	50405	11953.1
Vlorë	46885	12516.6
Tiranë	53334	13148.9

Burimi: LSMS 2013, llogaritje të ISB-së

Sa i takon nivelit të varfërisë së përgjithshme, Studimi për Matjen e Standardit të Jetesës, LSMS (*Instat*, 2012) ka marrë nën studim 5 indikatorë të varfërisë, të konsideruar si nevoja bazë: furnizimi me ujë dhe kushtet higjienike, strehimi, furnizimi me energji elektrike, mbipopullimi dhe përqindja e kryefamiljarëve me arsim fillor. Nga të dhënat rezulton se 3,4% e familjeve në qarkun Fier kishin pamjaftueshmëri të 3 ose më shumë indikatorëve,

10,6% të 2 indikatorëve dhe 86% të asnjë apo 1 indikatori. Në raport me qarqet e ngjashme, situata e Fierit paraqitet relativisht e mirë sa i takon varfërisë ekstreme (ku vetëm Vlora rezulton më mirë) dhe relativisht problematike në lidhje me varfërinë, më të lartë se të gjithë qarqet, përveç Elbasanit.

Tabela 62. Niveli i varfërisë sipas plotësimit të nevojave bazë, nivel qarku.

Kategoria	Fier	Vlorë	Elbasan	Durrës	Shkodër	Tiranë	Shqipëri
Jo të varfër (1 ose pa nbp)	86.0	92.4	83.6	90.0	88.3	92.6	88.5
Të varfër (2 nbp)	10.6	6.2	11.7	6.4	8.2	5.5	8.4
Shumë të varfër (3 ose më shumë nbp)	3.4	1.4	4.7	3.6	3.6	1.9	3.0

Burimi: LSMS, 2012

Sa i takon kushteve të pamjaftueshme, problematika kryesore për Qarkun Fier është arsimi i pakët i kryefamiljarëve (rreth 59% e tyre me arsim fillor). Të gjithë indikatorët janë të lartë ose të krahasueshëm me nivelin kombëtar, me përjashtim të furnizimit me energji elektrike, ku nuk është vëzhguar asnjë rast problematik.

Tabela 63. Nevoja bazë të paplotësuara, në nivel qarku.

	Ujë dhe kushte higjienike të papërshtatshme	Strehim i papërshtatshëm	Furnizim i pamjaftueshëm me energji	Mbipopullim (më tepër se 3 persona në dhomë)	Arsimi (kreu i shtëpisë me arsim fillor ose më të ulët)
Fier	6.9	6.1	0.0	7.2	59.3
Shqipëri	4.6	6.7	1.6	6.1	55.2

Burimi: LSMS, 2012

Mirëqenia sociale: Nga pikëpamja e shërbimeve sociale, Qarku Fier ka një numër krahasimisht të lartë insititucionesh sociale (19), më të lartë se Elbasani dhe Vlora, por më të ulët se Durrësi e Shkodra. Në nivel qarku janë në funksionim 2 qendra për të moshuar (1 publike e 1 private), 9 qendra sociale për fëmijë (jo publike), 3 shërbime sociale private, për familjet dhe komunitetet, 3 shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuar, dhe një qendër sociale për të rinj.

Tabela 64. Institucione sociale në nivel qarku.

Qarku	Shërbime Sociale pub/priv
FIER	**19**
ELBASAN	12

DURRËS	22
SHKODËR	42
VLORË	9
TIRANË	103

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

Tabela 65. Shërbimet Sociale në Qarkun Fier

Qarku Fier	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	1
Shërbime sociale për fëmijët	0	9
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	3
Shërbime sociale për PAK	0	3
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	**1**	**18**

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

Përveç këtyre qendrave, në qytetin e Fierit ka disa institucione social-kulturore, që kontribuojnë në mirëqenien e popullsisë urbane. Disa nga këto objekte janë:

- Teatri "Bylis";
- Teatri i Kukullave;
- Qendra Kulturore e Fëmijëve "Llambi Bego";
- Muzeu Historik;
- Biblioteka e qytetit;
- Klubi i sportit "Apollonia".

- ***Përfundime mbi sfidat dhe problematikat sociale***

Bashkia Fier në 1 janar 2015, regjistroi një numër te popullsisë rezidente prej 122 mijë banorë nga te cilet 61 mijë meshkuj dhe 60 mijë femra. Rreth 46% e popullsisë së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe 54% si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grup-moshës 15-64 vjeç dhe 20% grup-moshës 90-14 vjeç, tregues këto që demonstrojnë potencial te lartë te popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e së cilës në tregun e punës do te ndikojë në rritjen e përformances ekonomike dhe përmiresimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente, si dhe mosha mesatare e saj, relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.

Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta te migrimit te brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetem në rënien e numrit te popullsisë, por edhe në ndyshimin drastik të strukturës së saj demografike.

Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës rezidente te qarqëve/bashkive është edhe migrimi i brëndshëm i popullsisë, pra levizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.

Sipas projeksioneve të popullsisë - skenari i rritjes së mesme - popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Popullsia rezidente e bashkisë Fier deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".

Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qëndror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori te popullatës, me qëllim rritjen dhe përmiresimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

Niveli i përgjithshëm arsimor i popullsisë është jo i favorshëm, me 60-70% të popullsisë në njësitë administrative rurale që ka përfunduar vetëm arsimin fillor, dhe shkallë analfabetizmi të lartë në njësitë ku kemi prezencë popullsie rome, si Qendër dhe Levan. Ndjekja e arsimit të lartë shënon nivelet më të ulëta në krahasim me bashkitë e të njëjtit lloj.

Bashkia Fier ka 85 kopshte, 63 shkolla fillore e 9-vjeçare dhe 22 shkolla të mesme të përgjithshme, nga të cilat 4 janë profesionale, me drejtim artistik, sportiv, teknik e bujqësor. Mbulimi me kopshte është mjaft i dobët, ku mbi 50% e territorit nuk mbulohet me këtë shërbim, ndërkohë që shkollat 9-vjeçare mbulojnë 89% të territorit urban dhe ato të mesëm 82%. Nevoja më e lartë për kopshte i takon qytetit të Fierit dhe njësive Dërmenas, Libofshë, Portëz dhe Cakran, për shkolla 9-vjeçare Dërmenasit dhe Libofshës, si dhe për shkolla të mesme Portëzës dhe Levanit. Objektet arsimore nuk zbatojnë standardet e sipërfaqes/student, por përgjithësisht kanë kushte të mira fizike dhe kapacitet akademik të lartë në raport me qarkun.

Shëndeti publik i bashkisë Fier rrezikohet nga sëmundjet diareike, kardiovaskulare, mundësitë e epidemive gastro-enterite për shkak të ushqimit, si dhe nga sëmundjet kancerogjene të frymëmarrjes për shkak të ndotësve të industrisë së naftës apo shpërthimeve aksidentale të gazit metan.

Shërbimi shëndetësor përbëhet nga 1 spital rajonal, 12 qendra shëndetësore dhe 85 ambulanca, të cilat mbulojnë nevojat e pjesës më të madhe të popullsisë. Në qytetin e Fierit gjenden shërbimet mjekësore të specializuara, si konsultore të fëmijës e nënës, poliklinika etj. Gjendja fizike e spitalit, poliklinikës dhe ambulancave nuk është e mirë dhe kërkon ndërhyrje rikonstruktuese.

Bashkia Fier ka shkallën më të lartë të papunësisë në qark, pas Patosit. Papunësia prek më tepër femrat se meshkujt dhe pothuajse 50% të fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeç. Sektori i shërbimeve është më dominant, por në njësitë rurale mbizotëron punësimi në sektorin bujqësor. Vërehen tendenca për kalim nga punësim në sektor bujqësor në punësim në sektor privat. Të ardhurat për frymë dhe shpenzimet mesatare mujore të familjeve në nivel qarku dëshmojnë për mirëqenie më të ulët se qarqe të ngjashme. Niveli i varfërisë së skajshme është më i mirë se në rajon. Mirëqenia sociale mbulohet pjesërisht nga disa institucione të kujdesit të të rinjve e të moshuarve, dhe disa qendra kulturore e sociale në qytetin e Fierit.

1.6 Zhvillimi ekonomik urban dhe rural

1.6.1 Zhvillimi ekonomik

- **Kuadri makroekonomik në nivel qarku**

Produkti i Brendshëm Bruto për banorë (PBB): Produkti i Brendshëm Bruto është një tregues ekonomik i cili tregon se çfarë vlere me çmimet e tregut kanë të mirat materiale dhe shërbimet të cilat janë prodhuar brenda një vendi gjatë një periudhe kohore prej një viti (Opendata.al, 2011).

Sipas INSTAT-it[320], në vitin 2012, Produkti i Brendshëm Bruto për frymë në Qarkun e Fierit rezulton të ketë një vlerë prej 520,813 Lekë. Krahasuar me të dhënat e qarqeve të tjera, Qarku i Fierit rezulton të renditet në tre qarqet me vlerën më të lartë të Prodhimit të Brendshëm Bruto për fryme, ai qëndron pas Qarkut të Tiranës dhe Durrësit (Tabela 32).

Tabela 66. Prodhimi i brendshëm bruto, viti 2012.

Qarqet	PBB çmime korrente (milion lekë)	Struktura ndaj PBB-së (%)	PBB për frymë (në lekë)	Struktura e indeksit për frumë ndaj PBB-së (%)
Shqipëria	***1335489***	***100***	***460436***	***100***
Fier	**166222**	**12.4**	**520813**	**113.1**
Tiranë	510093	38.2	649737	141.1
Durrës	132212	9.9	481007	104.5
Vlorë	77182	5.8	422054	91.7
Elbasan	105245	7.9	346054	75.2
Shkodër	71805	5.4	323480	70.3

Burimi: INSTAT, 2012

Krahasuar me mesataren Shqipërisë për PBB-në për frymë, e cila është 460 mijë Lekë, Qarku i Fierit renditet i dyti dhe vjen pas Qarkut të Tiranës me një vlerë prej 521 mijë Lekë.

Bazuar në vlerësimet e INSTAT-it për PBB-në e Qarkut të Fierit për banorë mund të thuhet se nga viti në vit PBB-ja e këtij qarku ka ardhur me një rritje graduale. Megjithatë kjo rritje vihet re vetëm pas vitit 2009, pasi rezulton se prej vitit 2008 deri në vitin 2009 PBB-ja e Qarkut Fier ka rënë me 2,6%. Nderkohë në vitin 2010, PBB-ja është rritur me 8% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2011, rezultatet tregojnë se PBB-ja e Qarkut është rritur me 7,3%. Duket se rritja më e madhe e PBB-së në këtë qark ka ndodhur në vitin 2013 me një rezultat 113%, e cila përkthehet në një diferencë rritjeje me 13,1% krahasuar me vitin paraardhës (Tabela 2).

Për të përmbledhur rezultatet e mësipërme, ajo çka bie më tepër në sy në rastin e Qarkut të Fierit është niveli i lartë i PPB-së krahasuar me qarqet e tjera dhe me mesataren e Shqipërisë, por edhe një rritje e saj vit pas viti. Pavarësisht kësaj, ashtu siç u theksua më lart, në vitin 2009 ka ndodhur një ulje e PBB-së dhe kjo lidhet me numrin e ndërrmarjeve për Qarkun e Fierit në këtë vit. Pra, ashtu siç tregohet edhe në tabelën 3, numri i ndërrmarjeve për vitin

2009 ka pësuar një ulje prej 30 të tilla dhe kjo rrjedhimisht çon në uljen e të mirave materiale të prodhuara dhe për pasojë dhe një ulje të PBB-së me një shifër relativisht të vogël prej 2,6%. Në bazë të kësaj analize rezulton se me rritjen e numrit të ndërrmarjeve ndër vite është rritur edhe vlera e PPB-së.

Tabela 67. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas viteve.

Qarqet	2008	2009	2010	2011	2012*
Shqipëria	***100***	***100***	***100***	***100***	***100***
Fier	**88.5**	**85.9**	**93.9**	**100.2**	**113.1**
Tiranë	165	160.6	149.5	143.9	141.1
Durrës	107.4	106.3	110.8	106.7	104.5
Vlorë	100.7	100.7	93.7	98.9	91.7
Elbasan	68.1	69.4	76.1	77.3	75.2
Shkodër	71.1	72.9	76.6	73.5	70.3

Burimi: INSTAT, 2012

Tabela 68. Numri i ndërmarjeve sipas Qarqeve deri në vitin 2013

Qarqet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	62162	73672	80077	94533	94953	103038	109039	106837	111083
Fier	6634	7475	7859	8690	8661	9416	9924	9527	9830
Tiranë	22947	27477	29660	34964	34856	39656	42117	43295	47477
Durrës	7433	9117	10101	11566	11731	12316	12918	11625	10599
Vlorë	4958	5712	6028	7164	7447	8516	9153	8929	9363
Elbasan	4256	4887	5744	6727	6754	6972	7611	7311	7442
Shkodër	2270	3455	4012	5800	5956	6258	6607	6543	5945

Burimi: INSTAT, 2013

Tabela 69. Vlera e shtuar Bruto

Qarqet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Shqipëria	574246	633247	679634	737636	795185	872641	973827	1028519	1094635	1162335
Fier	57878	63519	68002	72340	77839	83683	91124	98869	109520	114046
Tiranë	50733	56748	61103	66314	70984	75208	85442	88150	100353	107394
Durrës	53769	57072	61746	67299	73049	81237	89661	94218	103066	109256
Vlorë	34452	38042	40964	43697	46928	50604	56563	62311	65892	72675
Elbasan	209060	231468	249461	275872	298720	335035	376788	389312	397867	422147
Shkodër	35583	39825	42522	45657	48870	51823	57922	63209	68439	70592

Burimi: INSTAT, Llogaritë Rajonale 2015

Bazuar në të dhënat e INSTAT deri në vitin 2012, Qarku i Fierit rezulton të ketë një rritje të nivelit të vlerës së shtuar Bruto nga viti në vit. Vlera më e fundit e llogaritur e V.SH.B-së është e vitit 2012 dhe është 151, 7%. Në këtë rritje të vazhdueshme të V.SH.B-së në Qarkun e

Fierit kanë kontribuar sektorë të tilë si: industria e nxjerjes së naftës, bujqësia, peshkimi. dhe industria e shërbimeve. Vihet re një diferencë e madhe midis Industrisë së Nxjerrjes dhe asaj të Përpunimit. Ndërkohë që Industria Nxjerrëse zë 61%, si industria më kontribuese në nivelin e Vlerës së Shtuar Bruto, Industria Përpunuese zë vetëm 8%. Pra, pavarësisht se janë industri që lidhen me njëra-tjetrën ato nuk i shërbejnë njëra-tjetrës. Një kontribut të ulët në nivelin e V.SH.B-së jep edhe industria e ndërtimit, një industri e cila ka "ngrirë" që prej vitit 2009 për shkak të kufizimeve ligjore të Ligjit të Planifikimit të Territorit nr. 107, 2014. Një rol po kaq dytësor në rritjen e nivelit të Vlerës së Shtuar Bruto zë edhe Transporti duke kontribuar me vetëm 4%.

Tabela 70. Vlera e Shtuar Bruto.

Qarqet	**Fier**	Tiranë	Durrës	Vlorë	Elbasan	Shkodër
Bujqësia dhe Peshkimi	19.9	8.2	7.6	7.3	12.3	8.3
Industria	28.7	27.3	10.6	4.8	7.7	4.5
Industria Nxjerrëse	61.1	10.7	2.3	7.2	2.3	1.2
Industria Përpunuese	7.9	37.9	16	3.3	11.2	6.6
Ndërtimi	5.8	56	6.4	6.1	5.3	4.3
Shërbimet	6.3	49.7	11.5	5.4	6.6	4.6
Tregti, Hotele dhe Restorante	6.5	55	11.4	4.5	8.5	3
Transporti	4	33.1	38.6	6.2	4.1	3
Posta dhe Telekomunikacioni	4.8	59.2	5.7	5.5	4	3.9
Shërbime të tjera	6.7	48.2	8.7	5.8	6.3	5.7
VSHB me çmime bazë	12.4	38.2	9.9	5.8	7.8	5.3

Burimi: INSTAT, 2012

Produktiviteti për sektor:

Tabela 71. GVA – Industria dhe Shërbimet, 2012

Qarqet	**Popullsia**	**GVA Sektori i Industrisë**	**% e punësimit në sektorin e industrisë**	**Nr. i të punësuarve në sektorin e industrisë**	**Produktiviteti në industri (%)**	**GVA Sektori i Shërbimeve**	**% e punësimit në sektorin e shërbimeve**	**Nr. i të punësuarve në sektorin e shërbimeve**	**Produktiviteti në shërbime (%)**
Fier	310331	39916	17.1	20776	1.9	10264	35.3	42888	0.24
Tiranë	749365	53697	22.3	66927	0.8	18257	71	273086	0.09
Durrës	262785	15296	29.3	26140	0.6	14203	58	51745	0.27
Vlorë	175640	20349	26.1	16847	1.2	10175	56.9	36728	0.28
Elbasan	295827	135087	14.9	16067	8.4	63322	37.4	40328	1.57
Shkodër	215347	21178	21.8	12652	1.7	12001	56.2	32616	0.37

Burimi: Instat, Llogaritë Rajonale 2015

Në tabelën nr.37 paraqitet produktiviteti në sektorin e industrisë dhe atë të shërbimeve. Është e dallueshme se produktiviteti në sektorin e industrisë është më i lartë me një shifër prej 2% ndërsa në sektorin e shërbimeve vlera e produktivitetit është vetëm 0, 24%

Territoret "grumbulluese" ose "zbrazës", lëvizjet migratore

Tabela 72. Diferenca midis emigrantëve dhe emigratëve per 1000 persona, për Qarkun Fier dhe qarqe të krahasueshme

Qarqet	Popullsia (2011)	Hyrjet (2001-2011)	Daljet (2001-2011)	Norma e migrimit neto
Fier	310331	16037	25660	-31.01
Tiranë	749365	112180	11940	133.77
Durrës	262785	34059	10481	89.72
Vlorë	175640	9790	12999	-18.68
Elbasan	295827	9357	243881	-50.79
Shkodër	215347	9170	17613	-39.21

Burimi: INSTAT, 2011

Në raport me të dhënat e qarqeve të tjera, Qarku i Fierit rezulton si një nga vendet "zbrazëse", ku rreth 31% e popullsisë në vitin 2011 ka migruar. Duket se destinacioni i qytetarëve të Qarkut të Fierit kanë migruar në Qarqet e Tiranës dhe Durrësit, qarqe të cilat në bazë të studimit të INSTAT-it rezultojnë të jenë dhe zonat më "grumbulluese" për Shqipërinë.

Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve/qark: Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri më i lartë i të punësuarve në Qarkun e Fierit është në sektorin e Bujqësisë me 48%, më pas në sektorin e shërbimeve. Ndër sektorët me më pak të punësuar është ai i industrisë me vetëm 17%.

Tabela 73. Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve/qark.

Sektorët	Shqipëri	Fier
Të punësuar në industri	20.4	17.1
Të punësuar në shërbime	53.5	35.3
Të punësuar në bujqësi	26.1	47.5

Burimi: INSTAT, 2011

- **Analiza e tregut të punës**

Tabela 74. Të punësuarit sipas sektorëve në Qarkun Fier.

Sektorët	2010	2011	2012	2013	2014
Të punësuar në administratën publike	14285	13658	14561	13636	13596
Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor	16754	16092	16159	16424	17671

Të punësuar në sektorin privat bujqësor	92609	80191	84588	81194	77373
Të punësuar në administratën publike lokale	1597	1548	1660	1745	1691
Të punësuar në administratën publike lokale, Komunë	932	903	950	1047	1024
Të punësuar në administratën publike lokale, Bashki	563	538	601	590	559
Të punësuar në administratën publike lokale, Qark	102	107	109	108	108

Burimi: Vjetari Statistikor Rajonal 2015

Në përmbledhje të tabelës nr.40 mund të thuhet se banorët në Bashkinë e Fierit janë të punësuar më tepër në sektorin privat bujqësor pavarësisht se numri i tyre ka qënë në ulje vit pas viti (kemi parasysh këtu vitet 2010-2014). Numri më i lartë i të punësuarve në sektorin privat të bujqësisë është në vitin 2010 me një numër të punësuarish prej 92,609 banorë dhe numri i ulët i të punësuarve në këtë sektor është në vitin 2014 me një numër të punësuarish prej 77,373 banorë.

Sektori i dytë me punësimin më të lartë në Qarkun e Fierit është sektori privat jo-bujqësor. Është e dukshme se ky sektor ka ardhur në zhvillim nga viti në vit pasi dhe numri i të punësuarve në këtë sektor ka ardhur në rritje. Kështu në vitin 2010 numri i të punësuarve ka qënë 16,754 mijë kurse në vitin 17,671 mijë. Pra ka një rritje prej 1,000 të punësuarish.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, numri i të punësuarve më i ulët rezulton të jetë në sektorin e Administratës Lokale në Qark. Për shkak të vetë organizimit, funksionimit dhe përgjegjësive të Qarkut si njësi administrative, numri i të punësuarve jo vetëm që është më i ulët krahasuar me sektorët e tjerë, por edhe më i qëndrueshëm ndër vite.

Raporti midis biznesit të madh dhe biznesit të vogël në Bashkinë e Fierit:

Tabela 75. Biznesi i madh dhe i vogël në Bashkinë Fier.

Lloji i biznesit	Fier	Cakran	Libofshë	Dërmenas	Frakull	Levan	Qendër	Mbostar	Topojë	Portëz
Biznes i Madh	738	23	0	5	9	14	53	28	6	20
Biznes i Vogël	2227	73	173	92	45	86	140	188	77	86
Total	2965	96	173	97	54	100	193	216	83	106

Burimi: Bashkia Fier, 2015

Qyteti i Fierit ka të zhvilluar një numër të madh biznesesh të mëdha dhe të vogla me një shifër prej 2,965 të tillë. Rreth 75% e bizneseve të regjistruara në ketë Bashki janë biznese të vogla, ndërsa pjesa tjetër, 738 të tilla, janë biznese të mëdha.

Më së shumti bizneset e mëdha gjenden në formën e njësive të importit dhe eksportit, njësive të shërbimeve, filiale bankash, restorante dhe bare, filiale me artikuj ushqimore dhe industrialë, shërbime private shëndetësore, shërbime arsimore private dhe tregje private.

Përsa iu përket bizneseve të vogla, më së shumti dominojnë aktivitete në formën e linjave të transportit të udhëtarëve, restoranteve dhe bareve, supermarketeve, farmacive, parukerive, konfeksioneve, sherbimeve shëndetësore, serviseve të automjeteve dhe shitësve ambulantë.

Njësia administrative Frakull ka një dominancë të evidentueshme të bizneseve të vogla në raport me bizneset e mëdha. Në 54 biznese të regjistruara në këtë komunë, 45 prej tyre janë biznese të vogla. Bizneset e vogla në këtë rast janë më të orientuara drejt shërbimeve dhe gjenden më tepër në formën e bareve, dyqaneve ushqimore dhe restoranteve. Ndërsa bizneset e mëdha gjenden më tepër në formën e karburanteve, baxhove, pikave të inerteve etj.

Figura 120. Shpërndarja e bizneseve sipas llojit, në NJA rurale të Bashkisë Fier



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Nga ana tjetër njësia administrative Portëz ka një numër biznesesh prej 146 dhe vetëm 40 prej tyre janë biznese të vogla. Bizneset e vogla iu janë dedikuar shërbimeve dhe gjenden në formën e dyqaneve ushqimore, furrave të bukës dhe bareve.

Bazuar në të dhënat e marra nga njësia administrative Libofshë, rezulton se kjo njësi administrative ka në përbërje të saj një numër biznesesh prej 173 të tilla. Ajo çka është

interesante në këtë rast është se në njësinë administrative të Libofshës nuk ka asnjë biznes të madh të regjistruar.

Ndërkohë ashtu si edhe në njësitë e tjera, mbizotërues është sektori i shërbimeve me 98%. Njësia administrative Dermenas ka në përbërje të saj një numër prej 97 biznesesh ku vetëm pesë prej tyre deklarohen si biznese të mëdha. Pjesa më e madhe e bizneseve orientohet në sektorin e shërbimevee dhe tregëtisë, ndërsa industria ushqimore në këtë rast zë një vend tepër modest.

Njësia administrative Cakran ka në përbërje të saj 96 biznese ku vetëm 23 prej tyre janë të deklaruara si biznes i madh. Këto biznese janë të orientuara drejt shërbimeve dhe gjenden në formën e objekteve tregtare për shitjen e artikujve të ndryshëm dhe bareve. Industria ushqimore vjen në vend te dytë dhe gjendet në formën e baxhove dhe furrave të bukës.

Figura 121. Shtrirja e veprimtarive ekonomike në bashkinë Fier

Burimi: Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Në njësinë administrative Levan gjenden 100 biznese, ku 14 prej tyre rezultojnë të jenë biznese të mëdha. Bazuar edhe në grafikun nr 8. bizneset e Levanit më së shumti gjenden në formën e shërbimeve. Gjithashtu, i njëjti fenomen ndodh edhe në njësinë administrative Mbrostar ku 97% e bizneseve gjenden në formën e shërbimeve.

Njësitë administrative Qender dhe Topojë janë dukshëm të orientuara ndaj shërbimeve, por ndjehet lehtë edhe prania e bizneseve me drejtim industrial, siç është industria përpunuese dhe ajo e nxjerrjes dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit

Në përmbledhje të gjetjeve të mësipërme mund të thuhet se kategoritë dominuese të bizneseve operuese në njësitë administrative së Bashkisë së re të Fierit: njësi shërbimi, njësi të industrisë së lehtë dhe njësi tregtare. Është i evidentueshëm një orientim i bizneseve drejt sektorit të shërbimeve. Ndërkohë sektorë të tjerë si indutstria janë në vend të dytë.

Figura 122. Harta e Ndërveprimit Ekonomik në Bashkinë e Fierit.



Burimi: Ministria e Çështjeve Vendore

Ndërveprimi ekonomik: Referuar Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe konkretisht hartës së ndërveprimit ekonomik në Bashkinë e Fierit (figura 58) mund të thuhet se ekziston dukshëm një ndërveprim ekonomik midis qytetit të Fierit dhe njësive administrative përbërëse të Bashkisë së madhe. Konkretisht, bazuar në përqindjen e të punësuarve që udhëtojnë drejt qytetit të Fierit, vihet re se njësitë më ndërvepruese janë ato te Levanit, Portëzës, Libofshës, Dermenasit, Topojës dhe Mbrostarit. Ndërkohë ndër këto njësi administrative, Portëza, Mbrostari dhe Dermenasi kanë krijuar "lidhjet" më të forta.

Kjo nuk është rastësore pasi referuar pozicionit gjeografik të tyre, këto njësi administrative ndodhen më pranë qytetit çka e bën këtë ndërveprim ekonomik edhe më të thjeshtë dhe

efiçent. Në hartën e analizuar nuk shpjegohen ndërveprimet ekonomike midis njësive por në pargrafët e mëposhtëm, kjo lidhje do të analizohet nga një kendvështrim tjetër alternativ, atë të bashkëveprimit tregtar në sektorin e Bujqësisë.

Diversifikimi i ekonomisë: Bazuar në të dhënat e INSTAT-it (viti 2012) për punësimin sipas sektorëve të ekonomisë rezulton se pothuajse të gjitha njësitë administrative të Bashkisë së re Fier orientohen drejt ekonomisë agrare. Ky rezultat lidhet me potencialet natyrore bujqësore që kanë këto njësi administrative, profil të cilit nuk i shpëtojnë as njësitë administrative të Dermenasit dhe Topojës, ku pavarësisht potencialit të tyre turistik, ai që mbizotëron është sektori i bujqësisë. Megjithatë, duhet thënë që ky profil ekonomik agrar mund të përforcohet artificialisht edhe nga fakti që metodologjia e përllogaritjeve statistikore të punësimit sipas INSTAT-it konsideron të punësuar në sektorin bujqësor edhe personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum si dhe duke marrë parasysh informalitetin në punësim në sektorët e tjerë të ekonomisë.

Nga ana tjetër Fieri është njësia administrative që orientohet tërësisht drejt ekonomisë aglomeruese duke u bërë kështu një qendër e mirëfilltë shërbimesh për gjithë bashkinë e re. Në rastin e qytetit të Fierit, ekonomi dytësore është industria dhe tregtia.

Figura 123. Diversifikimi ekonomik i bashkisë

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Aktualisht, në Bashkinë e Fierit ekzistojnë dy pika grumbulluese të produkteve bujqësore të vendosura në fshatin Levan dhe një pikë grumbulluese të produkteve bujqësore e gjendur në fshatin Mbrostar. Këto janë dy pika grumbulluese private dhe të licencuara, të pajisura me ambiente frigoriferike, të cilat presin produkte bujqësore prej 90 fermerëve të të gjitha njësive administrative përreth (Drejtoria e Bujqësisë Fier, 2015). Më konkretisht, pasi grumbullojnë produkte nga fermerët e fshatrave përreth, dy pikat grumbulluese të Fierit i magazinojnë produktet dhe më pas i eksportojnë në Kroaci dhe Kosovë. Nga ana tjetër pika grumbulluese e Mbrostarit ka një lidhje tregtare kombëtare, pasi produktet që grumbullon dhe magazinon i

shet në tregjet vendase, si në Tiranë, Korçë dhe Vlorë. Pika grumbulluese e Mbrostarit është edhe një nga furnizuesit e tregut të shumicës së qytetit të Fierit.

- **Sektori industrial**

Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Qarkut të Fierit për shkak të rë rezervave të mëdha të hidrokarbureve që gjenden në të. Kjo evidentohet edhe në ndikimin që kjo industri ka në rritjen e Vlerës së Shtuar Bruto në rang vendi[321].

Bashkia Fier, për shkak të rezervave natyrore të mëdha të naftës, bën pjesë në bllokun F të kërkimit të naftës prej Kompanive AlbPetrol dhe Bankers Petroleum Ltd. (AlbPetrol.al).

Në Qarkun Fier shtrihet një nga rezervat më të mëdha të hidrokarbureve në vend, ajo e Patos-Marinzës. Patos Marinza është një nga rezervat më të mëdha naftëmbajtëse në Europë e cili ka filluar të shrytëzohet në vitin 1930 dhe llogaritet të ketë një sasi nafte prej 2 miliardë fuçi (320 x 10^6 m^3) ose 11,854 fuçi në ditë (onepetro.org).

Aktualisht ekziston edhe një vendim i hidrokarbureve me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM nr, 509 datë 08.08.2007) për kontrollimin dhe kërkimin e depozitave naftëmbajtëse në zonën Cakran – Mollaj. Periudha e zhvillimit dhe prodhimit të kësaj marrëveshjeje zgjat 25 vjet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit (AlbPetrol.al).

Tabela e mëposhtme tregon prodhimin e naftës bruto në Shqipëri dhe specifikisht në blloqet kërkuese të Patos Marinzës dhe Cakran- Mollaj. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve, nafta e prodhuar eksportohet jashtë por edhe shitet në tregun vendas. Kështu në tremujorin e parë të vitit më shumë së 50% e prodhimit është shitur brenda vendit ndërsa në tre-mujorin e dytë më shumë se 75% e prodhimit është eksportuar jashtë.

Tabela 76. Prodhimi mujor i naftës bruto në Shqipëri (janar – qershor, 2015)

Kompania	Vendburimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Bankers	Patos-Marinzë	100465	85322	99467	94874	100256	96968
TransAtlantic	Ba-He	503	449	502	475	459	480
	Cakran-Mollaj	1798	1764	1922	1950	1736	1770
	Go-Ko	2790	1764	3255	3420	3534	3420
	Delvinë	6	1				1
	Shuma TA	5097	3978	5679	5845	5729	5671
Sherwood	Kuçovë	191	195	243	74	208	222
Transoilgroup	Visokë	2170	2100	2325	2220	2263	2130
Phoenix	Amonicë	480	480	478	463	515	528
Marrëveshjet Hidrokarbure		108403	92075	108192	103476	108971	105519
Albpetrol		4124	3726	3892	3784	3940	3700
Total		112527	95801	112084	107260	112911	109219

Burimi: AKBN, 2015

- **Gazi natyror**

Figura 124. Gjurma e gazsjellësit TAP në territorin e Bashkisë Fier.



Burimi: www.tap-ag.al

Është fakt që linja e gazsjellësit Trans-Adriatik do të shtrihet edhe përgjatë territorit të Bashkisë së re të Fierit. Ashtu siç edhe dallohet në hartën e mësipërme, kjo linjë do të shtrihet konkretisht në njësinë administrative të Mbrostarit, Libofshës, Topojës dhe Qendër. Gjithashtu projekti i TAP-it propozon edhe ndërtimin e një stacioni kompresor në Fier pikërisht në bregun perëndimor të Komunës Topojë.

Shqipëria në përgjithësi por edhe Qarku i Fierit në veçanti do të kenë përfitime strategjike dhe gjithpërfshirëse nga projekti i TAP-it. Përfitimet kanë të bëjnë me:

- Rritje të mundshme të PBB-së së Shqipërisë
- Rritje të mundësive të punësimit
- Investime sociale dhe mjedisore
- Investime në infrastrukturën rrugore lokale (www.tap-ag.al)

Lidhur me burimet e gazit natyror në Bashkinë Fier mund të thuhet se territori i bashkisë përbëhet nga burime të konsiderueshme të gazit natyror. Sipas informacioneve zyrtare të marra pranë AlbPetrol-it rezulton se në bashkinë Fier ekzistojnë dy poligone të rëndësishme të burimeve të gazit natyror. Një prej tyre është ai i Frakullës. Ky Poligon ka një shtrirje gjatësore dhe shtrihet deri në afërsi të Frakullës së vogël dhe Murtezisë.

Poligoni tjetër shtrihet pranë bregdetit të bashkisë dhe prek zonat e Pishë-Poros dhe Darzezës.

- **Turizmi në Bashkinë Fier**

Turizmi zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve nëpërmjet sigurimit të mundësive të punësimit, mirëqënies, infrastrukturës dhe aktiviteteve të ndryshme të shërbimit.

Duke iu referuar pasurive natyrore, pozicionimit pranë detit por edhe ekzistencës së monumenteve të kulturës, monumenteve të natyrës dhe zonave arkeologjike mund të thuhet se Bashkia e re e Fierit ka një potencial të madh turistik. Si potenciale turistike në këtë Bashki mund të përmendim: Parkun Arkeogjik të Apollonisë, Parkun e Levanit, rezervatin Natyror të Pishë-Poros dhe plazhet me rërë përgjatë bregdetit si: plazhi ne Seman, Hidrovor, Pishe-Poro, Darzezë etj. Nga ana tjetër një potencial turstik ngelen edhe grykëderdhjet e lumenjve: Vjosa, Shkumbin dhe Seman të cilët ofrojnë potenciale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme natyrore. Zonat kënetore të pasura me florë dhe faunë diverse janë një potencial tjetër turistik për Bashkinë e re.

Figura 125. Atraksionet kulturore të vizituara, 2013



Burimi: Strategjia e zhvillimit të turizmit në Shqipëri, 2013

Për të parë se sa të shfrytëzuara janë elementët turistikë të Bashkisë Fier nga turistët dhe në mungesë statistikave të fluksit të vizitorëve për të gjithë elementët përbërës, po kufizohemi vetëm tek të dhënat e fluksit të turistëve në Parkun e Apollonisë. Referuar grafikut nr 15. mund të thuhet se Parku i Apollonisë, krahasuar me parqet e Butrintit apo atij të Lezhës, është më pak i vizituar nga turistët. Në këtë rast mund të thuhet se Bashkia e re e Fierit pavarësisht potencialeve turistike që ka nuk shihet si destinacion turistik kryesor. Qytete si Saranda apo Lezha rezultojnë të jenë më tepër konkuruese në aspektin e atraksioneve

kulturore. Ky është një fakt i cili duhet të merret parasysh në zhvillimin e politikave të zhvillimit për qytetin e Fierit.

Për të parë sesa konkuruese është Bashkia e re e Fierit në aspektin e turizmit në raport me Bashkitë e tjera të bregdetit shqiptar mjafton të analizojmë numrin e ndërmarrjeve aktive në fushën ekonomike të hotelerisë, bareve dhe restoranteve. Krahasuar me Bashkitë Vlorë dhe Durrës, Bashkia e Fierit ofron më pak shërbime hotelerie duke e bërë këtë Bashki një destinacion jo parësor të turizmit në Shqipëri.

Tabela 77. Ndërrmarjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, 2012.

Rrethi	Durrës	Fier	Sarandë	Vlorë
Gjithsej	***9997***	***5180***	***2203***	***6051***
Bujqësia dhe Peshkimi	192	59	122	284
Industria	869	530	206	538
Ndërtimi	544	252	128	373
Tregëtia	4542	2504	996	2277
Hotele, Kafe, Restorante	1570	638	256	1084
Transporti dhe Telekomunikacioni	1034	553	202	653
Shërbime të tjera	1246	644	293	842
Shërbime	***3850***	***1835***	***1021***	***2579***

Burimi: INSTAT, 2012

Punësimi dhe mobiliteti (lëvizshmëria): Nga analizat e kryera rezulton se ekziston dukshëm një ndërveprim ekonomik midis qytetit të Fierit dhe njësive administrative përbërëse të Bashkisë së madhe. Konkretisht, bazuar në përqindjen e të punësuarve që udhëtojnë drejt qytetit të Fierit, vihet re se njësitë me ndërvepruese janë ato të Levanit, Portëzës, Libofshës, Dermenasit, Topojës dhe Mbrostarit[322]. Ndër këto njësi administrative, Portëza, Qendra, Mbrostari dhe Dërmenasi kanë krijuar "lidhjet" më të forta. Kjo nuk është rastësore, pasi referuar pozicionit gjeografik të tyre, këto njësi administrative ndodhen më pranë qytetit, çka e bën këtë ndërveprim ekonomik edhe më të thjeshtë dhe efikas. Duke vënë re këtë mobilitet të fuqisë punëtore, është e rëndësishme që kjo pjesë e analizës të konsiderohet edhe gjatë hartimit të politikave që kanë të bëjnë me strehimin dhe transportin publik.

- ***Përfundime***

Qarku i Fierit është një nga qarqet me nivelin më të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto në Shqipëri.

Evidentohet një mbizotërim i qartë i sektorit të shërbimeve në raport me sektorin e turizmit dhe atë të industrisë, pavarësisht potencialeve turistike që gjenden në territorin e bashkisë dhe faktit se industria është një nga sektorët me ndikimin më të madh në rritjen e Vlerës së Shtuar Bruto.

Njësitë administrative Levan, Topojë, Portëz, Libofshë, Dërmenas dhe Mbrostar rezultojnë si njësitë më ndërvepruese me qytetin e Fierit. Në të njëjtën kohë, Mbrostari dhe Levani rezultojnë si njësi kyçe të pikave të grumbullimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore

Njësitë administrative të Dërmenasit dhe Libofshës kanë numrin më të madh të fermave blegtorale, ndërsa njësia administrative e Frakullës ka numrin më të madh të serrave bujqësore.

1.6.2 Analiza e sektorit të Bujqësisë

- **Kuadri Ligjor për bujqësinë, tokën bujqësore dhe zhvillimin rural**

Sipas ligjit nr. 9817 datë 22.10. 2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", objektivat e përgjithshme të qeverisë në lidhje me zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimin rural lidhen me rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, rritjen e prodhimit të përgjithshëm kombëtar, duke garantuar cilësi dhe siguri ushqimore dhe në të njejtën kohë duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin. Përsa i përket rolit dhe funksioneve të qeverive lokale në këtë drejtim, ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, përmbledh funksionet e zgjeruara të bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave pas reformes administrative territoriale, duke përfshirë: administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes, kullimit të tokave, pyjeve dhe kullotave vendore si dhe manaxhimin e institucioneve në shërbim të këtyre fuksioneve. Për më tepër, bashkitë kanë funksion krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët; dhe së fundmi, bashkitë janë përgjegjëse për shërbimin veterinar vendor, informacionin statistikor bujqësor dhe administrimin e kadastrës së tokave bujqësore.

Përsa i përket aspektit të planifikimit, objektivat e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural janë të lidhura me rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara, rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe rritjen e prodhimtarisë së sektorit (Strategjia Ndërsektoriale për Zhvilllimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020). Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, specifikohet mbrojtja e tokës nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përvec ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, çdo infrastrukturë tjetër publike, nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, me sipërfaqe dhe kritere të veçanta të përcaktuar në pikat 1-12. Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e qeverisjes vendore në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.

Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh si në tokë urbane, pyjore, kullotë, livadh dhe tokë e pafrytshme bëhet sipas përcaktimit në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim te tij. Më specifikisht, ligji cilëson që në tokat bujqësore të kategorisë së parë, dytë, tretë dhe katërt të bonitetit mundësohet kalimi në

sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza, si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e karriera, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka dhe ndryshimi për sipërfaqet deri në 5 ha bëhet me urdhër të ministrit përkatës, kurse për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë bashkisë (me përfaqësues të drejtorive specifike në qark, kryetarin e bashkisë dhe juristin e bashkisë). Megjithatë, këto ndryshime qoftë në rast të pronësisë private, qoftë si pronë e bashkisë ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjata të kulturave bujqësore, që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë. Kurse, ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për sipërfaqet deri në 5 ha, dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqet mbi 5 ha. Në tokat bujqësore, në të gjitha kategoritë e bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor. Sipas ligjit nr. 10 263, datë 08.04.2010 "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara", toka bujqësore konsiderohet si e pakultivuar në rastet kur autoritetet vendore kanë vërtetuar se toka nuk është kultivuar për të paktën 2 vjet rradhazi. Në këto raste, kur pronari i tokës nuk ushton të drejtën për kultivimin e saj, bashkia ka të drejtë ta nxjerrë në ankand për ta ofruar me qira sipas procedurave të përcaktuara nëkëtëligj.

Akte të tjera nënligjore që i shërbejnë zhvillimit të përgjithshëm bujqësor dhe rural përfshijnë VKM-në nr. 52, datë 21.01.2015 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015" dhe udhëzimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave nr. 4, datë 25.02.2015 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të cilat përcaktojnë mbështetjen financiare për vitin 2015, nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili bazohet në rajonizimin e aktiviteteve sipas hartës bujqësore të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Ligje të tjera që organizojnë veprimtarinë bujqësore përfshijnë ligjin nr.9199, datë 26.02.2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit, të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në këtë ligj, për prodhimin e produkteve organike dhe ligji nr.38, datë 05.04.2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", ku shprehet përcaktimi i rregullave, kritereve dhe kushteve për themelimin e administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, si dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Ruaral dhe Bujqësor 2014-2020: Kjo strategji shkon në të njëjtin drejtim me perspektivën e vendit në antarësimin në BE dhe si rrjedhojë mbështetet në parimet dhe objektivat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP) dhe politikat e paraaderimit (IPARD), duke patur në fokus edhe kushtet dhe problemet specifike

të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është trajtimi i sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe agro-përpunimit në vend, si edhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale.Në lidhje me zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, objektivi lidhet me rritjen e konkurrueshmërisësë sektorit, duke mbështetur sektorët prioritarë, rritjen e sipërfaqeve bujqësore të shfrytëzuara, për të rritur madhësinë mesatare të fermës, e si rrjedhim edhe produktivitetin.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar: Në lidhje me sektorin e bujqësisë, plani kombëtar përqendrohet në qëllime specifike strategjike, të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve, mbrojtjen e interesave publike dhe private si dhe nxitjen e planifikimit të harmonizuar të territorit. Më konkretisht, Plani Kombëtar i Planifikimit të Territorit e trajton Bashkinë Fier si një nga qendrat urbane të rëndësisë kombëtare (kryeqendra) dhe si pjesë e rrjetit të rrugëve prioritare të vendit. Si e tillë, Bashkia Fier do të jetë një qendër kryesore e zhvillimit ekonomik dhe si nyje kryesore e grumbullimit, shpërndarjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Një ndër objektivat më prioritare të Planit Kombëtar është ruajtja maksimale e fondit të tokës bujqësore, duke ndaluar çdo ndërtim që nuk i shërben sistemit bujqësor. Për më tepër, plani synon vendosjen e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhimi-grumbullim-përpunim-eksportim, si dhe investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanaleve ujitëse, vaditëse, hidrovore etj. Një tjetër politikë që mbështet Plani Kombëtar në këtë drejtim është dhe krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor.

- **Analiza e përgjithshme mbi sektorin e bujqësisë në Qarkun e Fierit**

Bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm në ekonominë e gjithë Qarkut të Fierit e në ekonominë kombëtare, e matur me kontributin e saj në Produktin e Brendshëm Bruto, punësimin dhe stabilitetin makroekonomik. Qarku i Fierit rezulton të ketë rritjen më të madhe në vend përsa i përket sektorit të bujqësisë, me 19.9 % të nivelit të vlerës së shtuar bruto (VSHB) nga viti në vit[323]. Në përgjithësi, sektori i bujqësisë në Shqipëri ka treguar një kapacitet të lartë të përshtatjes dhe të rezistencës ndaj krizave të ndryshme, si tranzicionit të tejzgjatur nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut, si dhe ndaj krizës më të fundit ekonomike globale. Megjithatë, performanca ekonomike e sektorit bujqësor në vend është ende e pamjaftueshme për shkak të fermave të vogla dhe të fragmentuara, nivelit të ulët të teknologjisë dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit krahasuar me mesataret e BE-së. Edhe në Bashkinë e Fierit, ashtu si në të gjithë vendin, sektori bujqësor është përqëndruar fuqishëm rreth bujqësinë familjare. Në rang kombëtar, më shumë se 90 përqind e 380,000 fermave janë nën 2 hektarë dhe llogariten rreth 95 për qind të tokës së përdorur, duke e bërë Shqipërinë të vetmin vend në Evropë që mbështetet kryesisht në një shkallë të vogël, jo-intensive të prodhimit të brendshëm[324] . Në bashkinë e Fierit veprojnë 374 ferma blegtorale dhe 24,667 ferma bujqësore (nga 52,169 ferma bujqësore totale që veprojnë në qarkun e Fierit), me një sipërfaqe totale prej 108.3 ha.[325] Fermat familjare janë kontribuesi më i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërisht për treg. Kontributi i tyre në punësim është i rëndësishm duke qënë se shumica e fermave individuale shërbejnë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetëpunësuarit në këtë sektor.

Sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë (Census 2011), numri i banorëve në zonat urbane në rang vendi tani e tejkalon numrin e banorëve në zonat rurale, një ndryshim të konsiderueshëm krahasuar me fillimin e viteve '90, kur rreth 2/3 e popullsisë jetonte në zonat

rurale. Në ndryshim nga prirjet e përgjithshme kombëtare, numri i banorëve në zonat rurale të Bashkisë Fier e tejkalon numrin e banorëve në zonat urbane, përkatësisht me 53% popullsi rurale dhe 46% popullsi urbane[326]. Kjo dëshmon se bashkia Fier ka një karakter të rëndësishëm bujqësor, edhe pse niveli i të punësuarave në sektorin bujqësor është vetëm 24,1%, krahasuar me 25.4 % në sektorët e industrisë dhe 50.5 % në sektorin e shërbimeve[327]. Në fakt mendohet se në vitet e ardhshme kur sektori të modernizohet dhe produktiviteti të rritet, numri i personave të punësuar në sektorin e bujqësisë mund vazhdojë të ulet. Përmirësimi i përdorimit të tokës do mundësojë punësim shtesë. Megjithatë, sipas parashikimeve të qeverisë shqiptare, bujqësia do të mbetet një sektor kryesor punësimi edhe në vitin 2020[328].

Në përgjithësi, sektori bujqësor në Shqipëri karakterizohet nga niveli i lartë i fragmentimit. E njëjta dukuri ndodh edhe në Bashkinë Fier. Madhësia mesatare e fermës brenda bashkisë konsiderohet të jetë 1.42 ha, (1.52 ha në qarkun Fier) krahasuar me 1.2 ha në rang kombëtar, ndërkohë që madhësia e parcelës është 0.27 ha në rang kombëtar dhe 0.43 në Bashkinë Fier[329]. Këto të dhëna dëshmojnë se fermat në bashki janë më të mëdha se mesatarja kombëtare, megjithatë sektori bujqësor vazhdon të ngelet mjaft i fragmentarizuar. Në fermat e vogla dhe të fragmentuara rritet kostoja e prodhimit, ujitjes, karburantit, transportit në masën 20-35 %. Nga ana tjetër 1-3 % e tokës bujqësore humbet nga perdorimi vjetor. Në këto kushte krijohen vështirësi në ujitjen, kullimin, zbatimin e teknologjive bujqesore dhe si pasojë, fermat e vogla dalin në treg me sasi shumë të vogla të produkteve bujqësore dhe eksporteve. Rritja e madhësisë së fermës konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar efiçencën ekonomike në sektorin bujqësor dhe për t'u bërë më konkuruese në treg. Aktualisht, nevojat për produkte blegtorale dhe bujqësore mbulohen nga importi, i cili mbetet shumë i lartë krahasuar me eksportet. Megjithatë, potencialet për rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral brenda bashkisë janë të mëdha, për shkak të burimeve të papërdorura tokësore, me rreth 20-25 % të siperfaqes së tokës arë çdo vit dhe të dendësisë dhe numrit të vogël të krerëve të bagëtive (veçanërisht të lopës), rendimentet e të cilave do të rriten me rritjen e prodhimit te foragjereve dhe rrjedhimisht do të rritej shfrytezimi i nënprodukteve. Në përgjithësi, vendi ka zona me dendësi të ulët të bagëtive të imëta dhe zona të pashfrytëzuara të tokës bujqësore, të cilat mund të prodhojnë shumë më tepër foragjere nëse do të kenë ujitje (Strategjia Ndërsektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020).

- **Rajonalizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë**

Rajonet bujqësore zakonisht përcaktohen si zona me një homogjenitet të lartë në reliev, llojin e tokës, kushtet klimatike, praktikat bujqësore, kulturat e prodhuara bujqësore, dhe shoqatat bujqësore. Duke qenë se territori i Shqipërisë është relativisht i vogël dhe kushtet gjeografike përgjatë territorit nuk janë shumë të ndryshueshme, vendi ynë nuk ka një ndarje specifike në rajone bujqësore. Megjithatë, për të sjellë variacione rajonale në bujqësi, është realizuar rajonizimi i kulturave bujqësore, ku rrethe të caktuara, në bazë të kushteve specifike, si relievi, klimë e përshtatshme, lloji i tokës, traditë kultivuese etj, janë specializuar sipas përparësisë drejt disa kulturave të veçanta.

Kështu, gruri për shëmbull, edhe pse mbillet në të gjitha zonat e Shqipërisë siguron rendiment të kënaqshëm vetëm në disa zona të vendit, në të cilat bën pjesë edhe Bashkia Fier**.** Zakonisht përfitueshmeria nga kultivimi i grurit është i ulët, duke përfaqësuar kështu një aktivitet jo shumë të leverdisshëm nëse krahasohet me kultura të tjera. Kjo situatë

kushtëzohet nga një sërë faktorësh, por nuk mund të neglizhohet edhe madhësia e vogël e fermës. Megjithatë, bima e grurit ka efektivitet ekonomik dhe mund të kultivohet duke përdorur me racionalitet burimet natyrore (tokë, ujë, vegjetacion, peizazh) në disa zona, ndaj dhe mbjellja duhet të jetë sipas përparësisë, ku rrethi Fier cilësohet si rrethi i dytë prioritar mbas Korçës në rang kombëtar. Bimë të tjera që mendohen të rajonizohen në rrethin e Fierit janë ajo e misrit, e fasules dhe patates verore.

Rritja dhe kultivimi i perimeve konsiderohet të sjellë të ardhura të larta ekonomike, në nivel lokal, por edhe për shtimin e të ardhurave të fermerëve, duke qënë dhe një drejtim prioritar i prodhimit bimor, i shprehur në Strategjinë ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit rural. Me kalimin e viteve është rritur kultivimi i perimeve në sera, ku dhe niveli i përfitimit të të ardhurave për njësi sipërfaqe, është më i madh. Prodhimi i perimeve (konsum, industri përpunuese, eksport) duhet të rajonizohet në Fier, për shkak të kushteve të përshtatshme. Në përgjithësi, të gjitha rajonet, të cilat kanë kushte eko-klimatike të favorshme për kultivimin e perimeve, e shohin si të nevojshme skemën mbështetëse të qeverisë mbi serrat me ngrohje dhe serrat me plastmasë, dhe rajoni i Fierit renditet ndër të parët në lidhje me rëndësinë e mbështetjes për të dyja.

Tabela 78. Rajonalizimi i kulturave bujqësore dhe blegtorale

Qarku Fier			
	Bimët e Arave	**Pemët frutore**	**Blegtoria**
Përparësi kryesore	Grurë, misër, fasule, perime e bostan, perime në sera, foragjerë	Ullishtaria	Gjedhë/lopë, derra
Përparësi mesatare	Patate, bimë medicinale	Pjeshkë, vreshtari, agrume	Bletët
Jo përparësi	Duhan	Mollë, arrorë, kumbulla, qershi	Të leshta, të dhirta

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, 2014[330]

Frutikultura zë një vend të rëndësishëm në prodhimin bujqësor, pavarësisht se rajoni i Fierit nuk e ka si përparësi kryesore rajonizmin e pemëve frutore. Megjithatë mendohet se në kategorinë mesatare të përparësisë peshën specifike më të lartë duhet ta zerë kultivimi i pjeshkës, kumbullës dhe shegës.

Analiza dhe vlerësimi i matricës së ullishtarisë nga ekspertët e bujqësorë tregon se Fieri është ndër rajonet, ku ullinjtë duhet të jenë prioritarë dhe të zenë një vend të konsiderueshëm në zhvillimin bujqësor. Zhvillimi i ullishtarisë në këtë rajon lidhet me nivelet e treguesve ekonomikë të prodhimit, por mbi të gjitha, me përshtatshmërinë e kushteve tokësore dhe klimatike, ndaj dhe rajonizimi i tyre duhet te jetë në zonën kodrinore të bashkisë së Fierit. Momentalisht, gjenden XX ha e XX rrënje ullinj të kultivuar në Bashkinë e Fierit. Ullishtet shekullore dhe ato deri 50 vjeçare zënë jo me pak se 70 % te sipërfaqes, por janë në shumicë të braktisur dhe të pashfrytëzuar, për shkak se ndodhen në terrene të larta e me infrastrukturë të dobët. Në rast se do të fillohej të rehabilitohej pjesërisht infrastruktura në këto zona, produktiviteti i ullirit do të rritej në sasi të konsiderueshme. Disa nga problemet e përgjithshme të prodhuesve të ullirit lidhen me copëtimin e fermave të ullirit me prona tepër të vogla, përdormin masiv të punës së krahut në 100 % të operacioneve, investime të vogla në

këtë drejtim, të cilat po shkaktojnë degradimin e ullishteve shekullore dhe dëmtojnë gjithë zinxhirin e prodhimit deri tek konsumatori. Në rastet e agropërpunimit, linjat e përpunimit kanë nevojë të inspektohen, që të përmbushin të gjitha parametrat higjieno-sanitare të vajit dhe të sigurisë të përcaktuar në legjislacionin vendas dhe rregulloret e BE-së për vajin për eksport.

Figura 126. Harta e territoreve të ullishtave ekzistuese në qarkun Fier



Burimi: QTTB-Vlore

Rajoni i Fierit, është pjesë e skemës së qeverisë për mbështetjen në kultivimin e ullirit. Duke konsideruar kushtet e përshtashme tokësore e klimatike të Bashkisë Fier (zona jugore dhe juglindore) për këtë kulturë, nevojat për ullinj kokërr dhe vaj ulliri, efektivitetin ekonomik që paraqet ulliri si dhe ndikimin pozitiv në biodiversitet, por edhe zhvillimin e industrisë agropërpunuese, rezulton se bashkia është e favorizuar në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj kulture. Agrumet kanë përhapje më të kufizuar se ajo e ullirit dhe të kërkesave të veçanta klimatike mbillen më pak në Fier. Analiza dhe vlerësimi i produktivitetit të vreshtarisë tregon se duke konsideruar përshtatshmërinë e kesaj bime me kushtet klimatike dhe tokësore, rajonizimi i saj duhet të jetë në rajonin e Fierit, sidomos në zonën kodrinore të tij.

Duke konsideruar kapacitetet për mbarështrimin e gjedhit (lopës), Bashkia e Fierit futet në grupin e parë dhe më të rëndësishmin në mbarështimin e gjedhit. Në përgjithësi, qarku i Fierit vlerësohet si një ndër qarqet parësore, ku gjykohet se skema “mbështetje për viçat për

mish"duhet bërë me prioritet, për shkak të shkallës më të lartë të përmirësimit racor, rendimentit më të lartë në prodhimin foragjer, dhe aplikimin e kryqezimit me racat e mishit. E njejta gjë, vlerësohet edhe për mbarshtimin e derrit.

Prodhimet organike: "Prodhime organike" janë të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve "Bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në ligjin nr.9199, datë 26.02.2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio". Një nga parimet kryesore për prodhimet organike lidhet me sasinë totale të plehrave kimikë, e cila nuk mund t'i kalojë 170 kg azot për vit/hektarë të përdorur në një zonë bujqësore. Sipas studimit të ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë[331]produktet relativisht më të lehta për t'u prodhuar "bio" që mund të kultivohen në këtë zonë janë: ulliri dhe vaji i ullirit; perime si: qepa, domatja, speci, patëllixhani, lakra, lulelakra, sallatrat, brokoli, spinaqi, erëzat e guzhinës, patatja; nga frutat: hurma, shega dhe fiku; si produkte blegtorale: mishi i viçit në alpe, mishi i qingjave dhe kecave, djathi i dhisë dhe mjalti. Mbështetja e prodhimeve organike duhet të orientohet në zonat kodrinore dhe malore ku ndotjet janë më të pakta dhe mjedisi ruhet më mirë. Bashkia e Fierit ka një potencial të lartë për prodhimin e produkteve bio, për shkak të terrenit të përshtatshëm sidomos në zonën juglindore të saj, ku relievi është më i ngritur, me prirje të buta kodrinore-malore, gjithashtu dhe për shkak të klimës së favorshme. Megjithatë, mbështetja financiare për fermat "bio" duhet të rritet dhe të kalohet nga mbështetja e fermave individuale në grup fermerësh dhe në *eco-village* (fshatra ekologjikë).

Klima: Klima përbën njërin prej potencialeve më të mira të bashkisë për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe paraqet rëndësi të veçantë për zhvillimin e gjithanshëm të saj. Ndikimi i pozitës gjeografike, dalja e gjerë në detin Adriatik dhe relievi kryesisht fushor kanë bërë të mundur që në bashki të mbizotërojë klimë tipike mesdhetare fushore, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të butë e të lagësht. Vetëm në pjesën lindore dhe juglindore dominimi i relievit të ulët kodrinor ka kushtëzuar klimën e butë mesdhetare kodrinore, gjë që vihet re në luhatjen fare të vogël që pësojnë vlerat e elementëve klimatikë. Në zonën më të lartë të Bashkisë Fier, në majën e malit të Cakranit, temperatura minimale arrin deri nën -7 ose -8°C. Dimri në këto zona është më i ftohtë në krahasim me zonat e tjera. Në Bashkinë Fier, temperatura mesatare e ajrit në janar është 15°C dhe ajo minimale -5 deri në -7°C. Në përgjithësi, pozita gjeografike dhe topografia e terrenit e bëjnë të gjithë qarkun e Fierit si më të pasurin me energji termike. Për këtë qëllim në këtë bashki duhet të tregohet interes i veçantë në të ardhmen, për shfrytëzimin dhe përdorimin e energjisë diellore, duke patur parasysh direktivat e Bashkimit Europian për zhvillimin e energjive të rinovueshme.

- **Zhvillimi i bujqësisë në vite**

Historiku i Zhvillimit të bujqesisë: Bujqësia, në periudha të ndryshme është zhvilluar në përputhje me format e organizimit të pushtetit lokal, format organizative të strukturave dhe ekonomive bujqësore, pronësinë mbi tokën, mënyrën e planifikimit në ekonomi dhe planifikimin e territorit. Edhe në Qarkun e Fierit dhe njësitë e sotme administrative të bashkisë së Fierit, është ndjekur e njëjta rrugë dhe janë zbatuar të njëjtat parime.

Deri në 1990: Menjëherë pas reformës agrare, bujqësia deri në vitin 1990, ka qenë e organizuar në dy forma (kooperativat bujqesore dhe fermat shtetërore bujqësore). Në të dyja format e organizimit, toka ishte shpallur me kushtetutë pronë shtetërore. Deri ne vitin 1990, në pikëpamjen territoriale, Fieri ka funksionuar si rreth i veçantë, në të cilin përfshihej bashkia e sotme, e re e Fierit, bashkia e Ballshit, bashkia e Patosit dhe Roskovecit. I gjithë

rrethi administronte rreth 71,200 ha tokë të punuar bujqësore ose 0.288 ha/ frymë. Nga kjo, 82.2 % e sipërfaqes ishte toke are, 4.6% pemëtore, 2.5 % vreshta dhe 10.6 % ullishte. Bujqësia ishte e organizuar në 20 kooperativa dhe 5 ferma shtetërore[332]. Në këtë periudhë, Fieri ishte një rreth i rëndësishëm industrial dhe bujqësor. Megjithatë, prodhimi i përgjithshëm industrial ishte 2 herë më i lartë se sa prodhimi bujqësor. Terreni bujqësor dominohej nga sipërfaqet fushore, kodrinore dhe malore. Baza e produkteve përbëhej nga drithërat (gruri dhe misri), perimet, foragjerët, pambuku, duhani, ulliri, pemëtaria, vreshtaria. Rrethi i Fierit në të gjitha kulturat zinte midis rretheve vendin 1-6. Ne kushtet e organizimit të bashkisë së re, ku Mallakastra nuk është më pjesë e saj dhe dominon terreni fushor, rriten mundësitë për një prodhim bujqësor të qendrueshëm, për shtim të eksporteve dhe nivelit ekonomik në zonën rurale.

Pas vitit 1990**:** Ndryshimet e rëndësishme të viteve '90-të lidhen me privatizimin e tokës bujqësore, shpërbërjen e ish-kooperativave dhe fermave shtetërore bujqësore; ndryshimin e formave të organizimit; zëvendësimin e planifikimit të centralizuar me parimet e ekonomisë së tregut. Struktura ekonomike bujqësore ndryshoi në mënyrë rrënjësore, duke ia lënë vendin krijimit të fermave të vogla familjare. Rishpërndarja e tokës bujqësore gjatë reformës së tokës në fillim të viteve '90 krijoi një strukturë fermash të vogla dhe të fragmentuara. Këto dukuri erdhën si pasojë e ndarjes së tokës bujqësore në bazë të Ligjit nr. 7501 "Për tokën bujqësore", pasi territori i Bashkisë Fier u parcelizua në prona individuale për çdo fermer. Me organizimin e Qarkut të Fierit, Ballshi u bë rreth më vete dhe në qark u përfshinë rrethi i Fierit, Lushnjës dhe Mallakastrës. Ne këtë periudhë, zhvillimi i bujqësisë u kufizua nga copëtimi i lartë i tokës, ekzistenca e fermave tepër të vogla, ndryshimi drastik i strukturës së prodhimit, dëmtimi i bazës ekonomike dhe strukturës bujqësore dhe mungesa e mbështetjes financiare në zbutjen e efekteve negative të tranzicionit në këtë sektor. Si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë, por edhe mungesës së reformës së planifikimit, mungesës së kontrollit të zhvillimit, rikthimit të pronës private dhe lëvizjes së lirë të popullsisë, sot në bashkinë Fier ekzistojnë zona dhe zhvillime informale, me banesa individuale dhe me mungesë infrastrukture publike, të ndërtuara kryesisht gjatë viteve 1990-2000, me hapësira të mëdha bujqësore dhe natyrore të ndërtuara.

Në vitet e fundit vihet re një rigjallërim i bujqësisë dhe blegtorisë, të cilat janë edhe nga sektorët me potencialet më të mëdha për punësim dhe zhvillimin ekonomik të bashkisë. Organizimi i fundit administrativ dhe territorial i 2015-s synon zhvillimin e qëndrueshëm të zonës rurale, përftimin e shërbimeve, rritjen ekonomike si dhe mbrojtjen e territorit dhe mjedisit. Në Sektorin e prodhimit bimor në bashkinë Fier vihet re një rritje e prodhimit për çdo kulturë në tre vitet e fundit, ku rritja e prodhimit evidentohet pothuajse për të gjitha kulturat kryesore bujqësore. Vlen të përmendet që si rrjedhojë e politikave mbështetëse të qeverisë, si për shembull nëpërmjet skemës mbështetëse për plastmasën në serra, ky trend i rritjes së prodhimit ruhet nga viti në vit.

Tabela 79. Prodhimtaria bujqësore në periudhën 2013-2015, Bashkia Fier

	Viti 2013		**Viti 2014**		**Viti 2015**	
Kulturat	Sipërfaqe (dynymë)	Sasia (kuintalë)	Sipërfaqe (dynymë)	Sasia (kuintalë)	Sipërfaqe (dynymë)	Sasia (kuintalë)
Agrume			13	130	13	130
Fasule	1,851	7,254	750	1,200	1,370	2,344
Fruta të tokës	1,241	7,830	1,594	90,585	1,720	108,505

Perime	629	39,665	526	34,847	1,013	76,670
Pemtari	6,363	24,788	10,423	23,805	12,696	28,340
Vreshta	3,087	23,210	3,389	37,140	3,675	47,051

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Fier, 2015

Në sektorin e agropërpunimit, vihet re një vazhdimësi e të njejtit trend prodhimi në tre vitet e fundit, pa ndonjë rritje të konsiderueshme përgjatë viteve me përjashtim të prodhimit të bukës dhe verës, kurse në disa raste shihet një zvogëlim i aktiviteteve agropërpunuese, përkatësisht në prodhimin e embëlsirave dhe produkteve të baxhos (tabela XX). Aktivitetet kryesore të sektorit të agroindustrisë në Bashkinë e Fierit janë të lidhura kryesisht me prodhimin e bukës dhe përpunimin e ullirit. Përqëndrimi tek aktiviteti i përpunimit të ullirit lidhet edhe me potencialin e madh prodhues të pemëtarisë në rang bashkie. Kurse përsa i përket lidhjes mes aktivitetit prodhues të frutave të tokës, nga të cilat Bashkia Fier ka një produktivitet shumë të lartë, me aktivitete agropërpunese në këtë fushë, shihet se ky i fundit është jo ekzistues për Bashkinë e Fierit. Vlen të theksohet se bashkia ka një avantazh të konsiderueshëm në prodhimin e frutave dhe se mbështetja nga ana e qeverisë për hapjen e aktiviteteve agropërpunuese në këtë fushë, shihet me prioritet për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit. Nga ana tjetër aktiviteti i prodhimit të verës është në proporcion të drejtë me potencialin prodhues të vreshtarisë.

Tabela 80. Produktet e agropërpunimit në periudhën 2013-2015

Aktiviteti	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Përpunim Ulliri	20	19	21
Prodhim buke	39	45	66
Baxho	16	17	16
Prodhim ëmbëlsirash	17	15	15
Prodhim vaji	1	1	1
Prodhim vere	5	3	7
Prodhim mishi	5	5	5

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Fier, 2015

Për sa i përket potencialeve prodhuese blegtorale në Bashkinë Fier, nga të dhënat e deklaruara nga fermerët e zonës rezulton se potencialet prodhuese blegtorale kanë ardhur drejt uljes (Tabela 46). Megjithatë, pavarësisht mungesës së statistikave zyrtare, por sipas intervistave të kryera në Drejtorinë e Bujqësisë Fier, këto shifra të ulëta në dukje janë vetëm si rezultat i evidentimit jo to plotë dhe deklarimit jo të plotë të prodhimeve nga vetë fermerët, por që në realitet prodhimi blegtoral ka ardhur duke u rritur përgjatë viteve[333].

Tabela 81. Potenciali prodhues blegtorial

Produkti	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Qumësht	*53906	49086	24169
Mjaltë	331	414	210
Mish	39050	34112	32134

**-Sasia është e shprehur në kw*

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Fier, 2015

- **Toka Bujqësore**

Sipas klasifikimit të Censusit 2011, në Bashkinë e Fierit, qyteti i Fierit konsiderohet si qendër me rëndësi kombëtare, kurse njësitë administrative Mbrostar, Qendër dhe Portëz si njësi suburbane, dhe 6 njësi vendore mikse fushore (Cakran, Libofshë, Dërmenas, Topojë, Levan, dhe Frakull),[334] të cilat mbajnë peshën kryesore të zhvillimit të bujqësisë në zonën e bashkisë.

Të paktën 37% e popullsisë jetojnë në zona ku mbizotëron ekonomia bujqësore, por shifra është edhe më e lartë, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë. Sipas INSTAT-it (Census 2011), 53 % e popullsisë jeton në zonat rurale të Bashkisë Fier.

Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e Bashkisë Fier është 43,580 ha, e cila kultivohet ne masen 80 %. Toka shumë e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e ka bërë Fierin mjaft të rëndësishëm në nivel kombëtar në vendin që zë për nivelin e lartë të prodhimeve bujqësore. Zhvillimi i bujqësisë në Bashkinë e Fierit favorizohet nga larmia e tokave[335] ku dallohen: i) tokat e hinjta kafe që shtrihen në zonën kodrinore në kodrat e Pojanit, Grecallise, Levanit, Frakulles, Libofshes, Verrise, me pjerrësi >15% dhe që i nënshtrohen gërryerjes; ii) tokat e hinjta kafe livadhore, të cilat kanë vlera bujqësore të mira, pasi thellësia e tokës është mesatare dhe janë te përshtatshme për pemëtarinë, veçanerisht për kultivimin e ullirit, por edhe vreshtat; iii) tokat livadhore aluvionale qe shtrihen ne brigjet e lumenjve Seman dhe Vjosë ose bregdetit (Seman, Grecalli, Cakran, Agimi, Pojan, Frakull etj), të cilat zënë rreth 30 % te sipërfaqes së tokave të Bashkisë së Fierit, kanë kapacitet prodhues dhe janë të përshtatshme për shumë aktivitete bujqësore. Në këtë tip dominojnë tokat me horizont aktiv mesatar në të thellë dhe thellësia e tokes është mbi 40 cm; iv) tokat livadhore moçalore, të cilat gjenden në gropa të vogla në pjesën lindore të rrethit dhe janë kryesisht toka trofike. Sipërfaqen më të madhe e zënë tokat fushore nëntipi livadhor, të hinjta kafe dhe tokat aluvionale deri në 15 m lartësi mbi nivelin e detit, në masivin që fillon nga Povelça, Semani, Bishani e Agimi, Pojani, Grecalli, Libofsha, Levani e Frakulla dhe vazhdon me Cakranin, ku tokat bujqësore potenciale shtrihen në 11-70 m lartësi.

Në këtë zonë dominojnë tokat me horizont humusor mesatar 20-40 cm dhe mbi 40 cm dhe sipërfaqe të kufizuara 0-20 cm. Dominojnë tokat me taban të thellë 40-90 cm dhe mbi 90 cm. Treguesit e pasqyruar, tregojnë se tokat janë me kapacitet të lartë prodhues dhe mundësitë janë për rendimente dhe prodhime më të larta. Sipas vlerësimit agroprodhues (boniteti) në këtë zonë dominojnë tokat e klasave I-V; v) tokat e kripura, të cilat shtrihen kryesisht përgjatë bregdetit dhe gjenden nën lartësinë 2.5m mbi nivelin e detit. Sipërfaqja totale e tokave të kripura, së bashku me tokat me vatra kripëzimi arrin deri në 6,573 ha[336], ndërsa tokat e evidentuara plotësisht të kripura në nivele të ndryshme arrijnë në 4,711 ha. Tokat e kripura përqendrohen kryesisht në Povelçë, një zonë bujqesore, ku është investuar deri në vitin 1990. Sipas nivelit të kripëzimit, 4,711 ha tokat e kripura ndahen në:

- Toka dobësisht të kripura: 1,374 ha
- Toka mesatarisht te kripura: 1,617 ha
- Toka të kripura: 1,429 ha
- Shumë të kripura: 291 ha[337]

(Këtu duhet vendosur harta e bonitetit që është në proces digitalizimi)

Duke analizuar karakteristikat dhe treguesit e tokave (thellësia e tokës dhe e horizontit humusor), treguesit e relievit, përshtatshmërine e tokës, rendimentet dhe prodhimet e realizuara dhe gjithë faktorët kufizues, rezulton se aktualisht kapaciteti prodhues i tokave bujqesore shfrytëzohet në masën 65-70 % (Lushaj Sh, 2016). Në këto kushte nevojitet një harmonizim i të gjithë faktorëve dhe përmirësimit teknologjik të ujitjes e kullimit, farave të fidanëve, fragmentimit të tokës, rritjes së ngarkesës së gjedhit/lopës për çdo 100 ha dhe thellimit të rajonizimit të prodhimit bujqësor etj.

Figura 127. Harta e tokave të kripura në Bashkinë e Fierit.



Burimi: IST; Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Pjesa perëndimore e bashkisë përkon edhe me vijën bregdetare ku gjenden toka të kripura, moçalore dhe aluvionale. Gjithashtu, ka lloje të veçanta tokash si aluvionale që takohen në luginat e Semanit, tokat e kripura që shtrihen në Hoxharë si dhe tokat moçalore të Roskovecit[338]. Veprimtaria e dy lumenjve të mëdhenj të vendit (Seman e Vjosë) ka ndikimet e saj në vijën bregdetare të Bashkisë së Fierit. Kjo vihet re në ndryshimet e vazhdueshme që ndodhin në plazhet e kësaj vije. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe studime të tjera kanë raportuar erozion detar të vijës bregdetare për shkak të ndërhyrjeve në lumë përgjatë zonave brenda dhe jashtë bashkisë[339]. Fieri vuan edhe nga kënetëzimi[340] i tokave[341] i cili përfshin kryesisht pjesët që janë ndikuar nga ujërat rrjedhës dhe gropëzime të ndryshme të ujërave të fjetur dhe me përmbajtje lëndësh organike të kalbëzuara. Një zonë e tillë dallohet sidomos tek ish-këneta e Mbyetit që shtrihet nga bregu i Lumit Seman deri në skajin jugor në afërsi të autoparkut të sotëm[342].

Në shumë njësi administrative të Bashkisë së Fierit, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial, si në Mbrostar dhe Portëz. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të ndryshme (si në hyrje të fshatit Verri pranë Pad K dhe gropa ekologjike në Kallm të Madh)[343] dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftënxjerrës ndër vite (një shembull i tillë është fshati Kallm[344]).

- **Prodhimet Bujqësore dhe Blegtorale**

Të dhënat e tabelës x tregojnë se Bashkia e Fierit është e specializuar më tepër në prodhimin e kulturave bujqësore si perime dhe drithëra (sigurisht dhe foragjere dhe sipërfaqe më të kufizuara me pemëtari). Kjo lidhet me cilësinë e lartë të tokës (boniteti që përgjithësisht është IV ose më pak) dhe të territorit fushor. Në pjesën juglindore të bashkisë, si pasojë e përshtatshmërisë së formave të buta kodrinore të relievit dhe klimës së butë kontinentale, kultivohen drufrutorët dhe kryesisht ullinjtë. Për sa u përket produkteve blegtorale, mbarështimi i gjedhëve konsiderohet të jetë përparësi në bashki, megjithatë në vitet e fundit, ka njohur progres aktiviteti i mbarështimit të të imtave (deleve dhe dhive), ku llogaritet një rritje e numrit të krerëve të deleve në masën 122 % dhe të dhive 141 %[345].

Nga zonat me produktivitetin më të lartë bujqësor në bashki, dallohet fusha e Myzeqesë së Fierit, ku kultivohen drithërat (grurë, misër, thekër), pemëtaria, ullishtat, vreshtaria dhe blegtoria[346]. Kohët e fundit është raportuar një rritje e sipërfaqes së mbjellë me perime (kryesisht shalqi e pjepër), kultura foragjere, vreshtari e pemëtari, e cila justifikohet me përmirësimin e infrastrukturës rrugore që lidh fshatrat me qytetin e Fierit[347] dhe rritjes së kërkesës së banorëve vendas për këto produkte. Megjithatë Fieri është akoma larg mundësive dhe traditës së eksportimit të produkteve bujqësore dhe veçanërisht të perimeve. Në të ardhmen, është theksuar mbështetja e mbjelljeve të reja në vreshtari, pemëtari, dhe ullishte (për fshatrat Radostinë, Havaleas, Pojan në Komunën Ndërmenas) me financime të qeverisë qëndrore[348].

Njëkohësisht, në zonat bujqësore të Fierit vihet re edhe zhvillimi i mëtejshëm i blegtorisë (si për shembull në Dërmenas)[349] favorizuar nga kostoja e ulët e zhvillimit të këtij sektori në krahasim me bujqësinë, kushtet klimatike dhe relievi i përshtatshëm i zonës. Zhvillimi është reflektuar në rritjen e numrit të krerëve dhe krijimin e minifermave (miniferma zakonisht janë fermat me mbi 5 krerë lopë), të krijuara sidomos në vitet e fundit. Përveç blegtorisë, në vend ka marrë zhvillim edhe rritja e shpendëve në pulari në disa komplekse (si p.sh. në Dërmenas)

për prodhimin e zogjve dhe të mishit etj. Zhvillimi i komplekseve të shpendëve dhe derrit është një mundësi e bashkisë dhe një traditë e zonës.

- **Infrastruktura Bujqësore**

Fermat blegtorale: janë një tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në Bashkinë e Fierit. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale së Bujqësisë,[350] Bashkia e re e Fierit ka në territorin e saj 374 ferma blegtorale. Numrin më të madh të tyre e kanë njësitë administrative të Dermenasit dhe Libofshës. Ndërsa njësitë administrative me orientim të ulët blegtoral janë Portëz, Qendër dhe Frakull[351].

Serrat: Sipërfaqja totale me serra për Bashkinë Fier është rreth 65 ha, ku numërohen përafërsisht 254 pronarë serrash, nga të cilët 40 % janë përqendruar vetëm në njësinë administrative të Frakullës. Njësia administrative Topojë rezulton të mos ketë sipërfaqe me serra, të asnjë lloj tipi, kurse në njësitë e Cakranit apo në qytetin e Fierit, numri i tyre është i vogël. Serrat kryesisht janë sera plastmase, me ngrohje diellore dhe janë të mbjella kryesisht me domate, tranguj, por edhe perime të tjera. Historiku i zhvillimit të bujqësisë në këtë zonë, niveli i eksportit të perimeve të realizuar dhe kushtet klimatike e tokësore mundësojnë rritjen e sipërfaqeve me serra per kultivimin e perimeve, luleshtrydhes dhe produkteve te tjera, duke mundësuar rritjen e eksporteve. Serrat me xham sigurojne produktivitet më të lartë dhe hershmëri.

Tabela 82. Numri i pronarëve të serrave bujqësore në bashkinë Fier.

Njësia administrative	**Pronarë në numër**	**Sipërfaqe e serrave gjithsej (m2)**				**Mbjelljet në sera**			**Të tjera jo perimore**
		Plasmas		Xham		Produkte			
		Ngrohje	Diellore	Ngrohje	Diellore	Domate	Trangull	Të tjera	
Qendër	12	0	30500	0	0	20500	0	10000	0
Dërmenas	14	0	12000	0	0	10000	0	2000	0
Topojë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Levan	27	5000	32560	0	0	15350	0	500	2500
Frakull	103	0	321500	0	0	28000	0	10000	297000
Cakran	6	0	3000	0	0	2200	800	0	14000
Portëz	24	0	54500	0	0	30000	0	12000	11000
Mbrostar	52	5500	117500	0	0	80000	10000	33000	0
Libofshë	12	0	13900	0	0	11200	2000	700	0
Fier	4	0	52600	0	0	2600	0	50000	0
Total Bashkia Fier	**254**	**10500**	**638060**	**0**	**0**	**199850**	**12800**	**118200**	**324500**

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Fier

Fieri njihet si zona me traditë në kultivimin në serra në sipërfaqe disa herë më të madhe nga sot. Dhe mundësitë e rritjes së sipërfaqes ekzistojnë në të gjithë zonën në të gjitha format (me xham, me ngrohje, me plastmasë), veçanërisht në Levan, Frakull, Qendër, Mbrostar, Portëz) dhe prodhimi total dhe për eksport të mund të shumëfishohet

Infrastruktura bujqësore: Aktualisht, në Bashkinë e Fierit ekzistojnë dy pika grumbulluese të produkteve bujqësore të vendosura në fshatin Levan dhe një pikë grumbulluese e produkteve bujqësore e gjendur në fshatin Mbrostar. Këto janë dy pika grumbulluese private dhe të licencuara, të pajisura me ambiente frigoriferike me kapacitet rreth 500 ton, të cilat presin produkte bujqësore prej 90 fermerëve të të gjitha njësive administrative përreth[352] (Drejtoria e Bujqësisë Fier, 2015). Më konkretisht, pasi grumbullojnë produkte nga fermerët e fshatrave përreth, dy pikat grumbulluese të Fierit i magazinojnë produktet dhe më pas i eksportojnë në Kroaci dhe Kosovë. Nga ana tjetër pika grumbulluese e Mbrostarit ka një lidhje tregtare kombëtare, pasi produktet që grumbullon dhe magazinon i shet në tregjet vendase, si në Tiranë, Korçë dhe Vlorë. Pika grumbulluese e Mbrostarit është edhe një nga furnizuesit e tregut të shumicës së qytetit të Fierit. Për më tepër, në njësinë administrative të Mbrostarit, në fshatin Vajkan është duke përfunduar ndërtimi i një pike të re grumbullimi me një kapacitet frigoriferik prej 140 tonësh, e cila do të funksionojë për grumbullimin e fruta-perimeve. Pavarësisht ekzistencës së këtyre pikave të grumbullimit dhe bazuar në potencialin prodhues bujqësor në territor shihet nevoja e propozimit të pikave të tjera grumbulluese të produkteve bujqësore.

Figura 128. Pikat e grumbullimit në bashkinë e Fierit.



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, përpunoi Co-PLAN, 2016

Tabela 83. Aftësia ujitëse e tokave bujqësore 2013 -2014

Njësia administrative	Aftësia ujitëse në fund të vitit 2013 (ha)				Aftësia ujitëse në fund të vitit 2014			
	Sip. e tokës gjithsej	Aftësia ujitëse		Sipërfaqe faktike e ujitur	Sip. e tokës gjithsej	Aftësia ujitëse		Sipërfaqe faktike e ujitur
		Potenciale	Aktuale			Potenciale	Aktuale	
Qendër	2372	1822	1060	265	0	1964	450	390
Dërmenas	5417	4000	2000	1010	0	5350	1588	1510
Topojë	5050	2970	1000	330	0	5040	1700	1926
Levan	5678	3751	3050	440	0	5671	1600	1750
Frakull	2284.97	1409	1280	1077	0	2200	1786	2150
Cakran	4935.3	2410	1800	830	155.9	2665	639	674
Portëz	2039	950	250	100	0	490	170	60
Mbrostar	3280	2670	2400	275	0	3065	760	230
Libofshë	6276	4800	1500	330	245	5504	0	90
Fier	1160	1160	1160	0	0	924	0	20
Total Bashkia Fier	**38492.27**	**25942**	**15500**	**4657**	**400.9**	**32873**	**8693**	**8800**

Burimi: Bashkia Fier, 2015

Sistemi i kullimit dhe i vaditjes: Sipërfaqja faktike e ujitur në njësinë vendore Fier është tepër e ulët në krahasim me aftësinë ujitëse të infrastrukturave vaditëse të Bashkisë, që vjen si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes të kanaleve vaditëse, stacioneve të pompimit dhe tharjes së rezervuareve. Ndërkohë njësitë më emergjente për nevojat ujitëse të tokave bujqësore ngelen njësia administrative Qendër, Libofshë, Portëz dhe Topojë. Gjithsesi material shtesë lidhur me infrastrukturën vaditëse mund të shihet në seksionin e analizës së sistemit të kullimit dhe ujitjes.

Bazuar në analizën e përdorimit ekzsitues të tokës në Bashkinë e Fierit, vihet re një evidentim shumë i ulët i infrastrukturës rrugore pranë tokave bujqësore. Infrastruktura rrugore është e përqëndruar në qendrat e fshatrave me qëllim lidhjen e lagjeve, ndërsa tokat bujqësore janë pothuajse të palidhura me rrjetin rrugor. Kjo ndikon në gjithë sistemin e mundshëm tregtues të kulturave bujqësore. Nga ana tjetër mund të evidentohet linja hekurudhore e mallrave që prek njësitë administrative Qender, Libofshë dhe Portëz, një avantazh ky për tregtimin e produkteve bujqësore.

Inovacionet në Bujqësi: Në përgjithësi, niveli i investimeve në bujqësi dhe në sektorin agro-ushqimor në rang kombëtar apo lokal, është ende i ulët. E njëjta gjë vihet re dhe për Bashkinë Fier, që pavarësisht skemave mbështetëse direkte/indirekte të qeverisë dhe donatorëve të huaj, inovacionet në sektorin bujqësor mbeten në nivele të pamjaftueshme. Disa nga projektet apo ndërhyrjet në përmirësimin e kushteve specifike në sektorë të ndryshëm të bujqësisë në vitet e fundit përfshijnë:

- Projektin e Bashkisë Fier me mbeshtetjen financiare të USAID-it, fokusuar kryesisht për prodhimin e fidanëve dhe bimëve dekorative me kosto zero për gjelbërimin e mjedisit në 18 hektarë tokë bujqësore, e cila është pjesë e shkollës së mesme bujqësore rajonale "Rakip Kryeziu" Fier.

- Investime të drejtpërdrejta të Ministrisë së Bujqësisë, përmes krijimit të fermave model, të cilat do të shërbejnë si katalizatori i modelit të zhvillimit të bujqësisë, si dhe bashkimit/konsolidimit të tokave, për të ulur koston e prodhimit të fermerëve.

Risi të reja në këtë fushë për të ardhmen mund të konsiderohet edhe mbështetje për të filluar aktivitete të reja (*start-up*) të prodhimeve plotësuese ose alternative te diversifikimit të ekonomisë rurale, që nuk janë domosdoshmërisht pjesë e traditave disa vjeçare kultivuese si p.sh: prodhimi i bimëve mjekësore, erëzave, bimëve dekorative, kërpudhave, kërmijve, prodhimi i produkteve bujqësore specifike për biokarburant në të ardhmen etj, ose aktivitete që nuk lidhen detyrimisht me produktin bujqësor apo blegtoral, por tregtimi i tyre mund të zhvillohet në portën e fermës, agro-turizëm dhe aktivitete shoqëruese (kalërimi, turizmi, peshkimi, gjuetia).

- ***<u>Sfidat dhe Përfundimet</u>***

Në ndryshim nga prirjet e përgjithshme kombëtare, numri i banorëve në zonat rurale të Bashkisë Fier e tejkalon numrin e banorëve në zonat urbane, përkatësisht me 53% popullsi rurale dhe 46% popullsi urbane[353]. Për më tepër, sipas skenarëve vlerësues të projeksionit të popullsisë (2015-2031), mendohet se përveçse një rënie prej 1% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, numri i banorëve në zonat urbane do të tejkalojë numrin e banorëve në zonat rurale. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosjeje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brendshëm dhe ndër të tjerave, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor[354]. Kjo prirje demografike me migrim të të rinjve ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural në bashkinë e Fierit si dhe vendosjen e balancave të drejta e të qëndrueshme rural–urbane dhe mbrojtjen e tokave potenciale bujqësore.

Aktiviteti bujqësor është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Fierit, por nga pikëpamja mjedisore haset me dy sfida të mëdha: 1) me faktin që bujqësia po shndërrohet gradualisht nga familjare në intensive; 2) me mungesën e përgatitjes teknologjike dhe të njohurisë mbi tokën për t'u përshtatur me këtë shndërrim.

Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme, e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese, i cili mundëson kultivimin e bujqësisë intensive gjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe Baseni i Semanit dhe Vjosës, të cilët përshkojnë territorin e bashkisë në pjesën qendrore e jugore përkatësisht dhe përbëjnë burim për ujitjen e bimëve. Ndërsa nga njëra anë Bashkia e Fierit ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Semanit e Vjosës, të cilët janë të rëndësishëm edhe për Fierin, nxori në pah problematikat e këtyre lumenjve të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga veprimtaria njerëzore dhe ndotjen e tyre. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Semanit e Vjosës janë të ndotura thellë me metale të rënda. Dhe si pasojë përdorimi i ujërave të ndotur për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit produkteve bujqësore. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes

së ujërave të Semanit e Vjosës, nga burim uji për bujqësinë, këta lumenj mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Në shumë njësi administrative të Bashkisë së Fierit, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftënxjerrës ndër vite.

Mungesa e rehabilitimit te sistemit te kullimit e ujitjes, për më tepër në zonën fushore ku ujërat nëntokësore janë në afërsi të sipërfaqes dikton nevojën urgjente të rehabilitimit të sistemit.

Problematika të tjera që po hasen në zhvillimin e bujqësisë në Fier lidhen kryesisht me degradimin e tokave për shkak të erozionit, kripëzimit, kënetëzimit, përmbytjeve, gërryerjeve të tokës dhe shembjes së brigjeve të lumenjve shkaktuar nga Semani e Vjosa. Edhe pse Fieri renditet si zonë me tregues të ulët erozioni vjetor, në muajt e reshjeve të shumta erozioni arrin në 10 ton/ha/vit. Ndër zonat e prekura nga erozioni dallohet fshati Lalar dhe në zona të tjera kodrinore të njësive administrative Mbrostar dhe Portëz ku erozioni është rritur progresivisht në vitet e fundit[355]. Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit, një nga dukuritë që po vihet re është ai i degradimit të tokës. Nuk ka shifra në nivel vendor, por në rang vendi vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[356].

Toka në Fier vuan edhe nga përmbytjete vazhdueshme të shkaktuara nga Semani dhe Vjosa edhe pse ndërtimi i paneleve mbrojtëse ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes. Ndër zonat më të prekura nga përmbytja në Fier janë zallishtorja dhe tarraca e parë e mbizallishtores[357]. Sipas AKM-së, Lumi Seman përmbytet në rrjedhën e poshtme dhe në zona të caktuara të rrjedhës së mesme. Lumi i Vjosës përmbytet në rrjedhën e poshtme të tij dhe në afërsi të Gjirokastrës në Lumin Drinos[358]. Përmbytjet shoqërohen me depozitime të ngurta në tokat bujqësore, gërryerje të brigjeve në Lumin Vjosë[359] ose ndryshim të vijës bregdetare dhe gërryerje të tokës bujqësore. Sipas AKM-së[360], Lumi Vjosë ka shkaktuar erozionin e tokës bujqësore në sektorë të caktuar si Lazarat, Palokastër dhe Virua të degës së Drinosit, Frakull, Trevëllazën, Mifol, Varibob, Bishan, të Vjosës. Rrezikime dhe prishje të objekteve inxhinierike, siç janë ura, vepra mbrojtëse dhe argjinatura (segmentet Drinos-Odrie, Hekal-Selishte-Hambar, Ura e Mifolit-Ada). Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, brezi i gjelbër (zona ripariane) e Semanit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë të gjithë brezat e bimësisë së nevojshme nga bimët e ulëta deri tek ato të larta, ose këto breza nuk ekzistojnë).

Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës. Konkretisht, zvogëlimi/ngushtimi i brezit të gjelbër është vënë re përgjatë gjithë trupit ujor të Lumit Seman, ndërkohë dëmtime e deri në humbje të këtij brezi vërehen në seksionin e lumit që kalon ndërmjet Mbrostarit dhe Portëzës.

Bujqësia, mbetjet bujqësore, erozioni ujor, ndotjet industriale dhe urbanizimi janë faktorët kryesorë të ndotjes së ujit të lumit të Gjanicës. Përbërësit e azotit janë ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por të mbipërdorur në bujqësi dhe shkaktojnë ndotjen e lumenjve për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike në to. Në

qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit, nga një burim uji për bujqësinë, Semani mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Problemi më i madh është në zonën e Povelçës, ku tokat para 30 vitesh iu nënshtruan procesit të shkripëzimit, por pas vitit 1990 ky proces u ndërpre. Në varësi të nivelit të kripëzimit tokat dobësisht të kripura mund të përdoren për bujqësi veçanërisht për bimet foragjere specifike të qëndrueshme ndaj kripes dhe pjesërisht nga tokat mesatarisht të kripura nëpërmjet përmirësimit të sistemit të kullimit. Ndërsa tokat e kripura dhe shume të kripura mund të kalojnë për përdorime të tjera.

- ***<u>Rekomandime</u>***

Është shumë e rëndësishme që zhvillimi i bujqësisë të ecë në dy binarë paralelë: bujqësi shkalle /intensive dhe bujqësi familjare. Kjo e fundit është përqendruar në shkallë të gjerë kryesisht në zonat malore-kodrinore. Përveç sigurimit të mbijetesës së popullatave të zonave me reliev të thyer, kjo bujqësi ka treguar se i reziston faktorëve klimatikë dhe ekonomikë dhe luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit.

Në zonën fushore intensifikimi i bujqesisë, puna për zmadhimin e fermave së paku në dy herë, konsolidimi i tokës dhe përmiresimi i sistemeve të prodhimit siguron nje zhvillim te bujqësisë, mirëqenie, të ardhura dhe mbrojtjen e tokës. Në bazë të kushteve konkrete në territorin e bashkisë bëhen efektive zbatimi i sistemeve bujqësore të diferencuara për zonën fushore, për zonën kodrinore dhe specifike për tokat e kripura dhe ato me pjellori të kufizuar. Në zonën kodrinore prioritet mbetet zhvillimi i pemëtarise, ullirit dhe vreshtarisë, në zonën fushore bimët e arave, shtimi i gjedhit në blegtori, serrave të perimeve.

Masa të tjera mund të jenë edhe mbështetja e drejtpërdrejtë financiare e fermerëve jo vetëm me qëllim shtimin e prodhimit bujqësor, por edhe me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ata duhen mbështetur edhe që të kryejnë eksperimentime lidhur me diversifikimin e të mbjellave, futjen e varietete të ndryshme agronomike që i rezistojnë ndryshimeve klimatike, ndërtimin e sistemeve të lajmërimit për mbrojtjen nga temperaturat tejet të ulëta (ngricat) dhe të larta (thatësirave) etj., që bëjnë të mundur përshtatjen e bujqësisë me ndryshimet klimatike.

Një masë tjetër e rëndësishme është edhe futja e shërbimit keshillimor të agronomisë falas për fermerët, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e teknologjive te avancuara të kultivimit, ujitjes, kullimit, sistemit të farave, përmirësimit të strukturës së prodhimit dhe zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme.

Futja e sistemeve me ujitje me pika, me riciklim të ujit të shiut ose e sistemeve të qëndrueshme të punimit të tokës janë themelore për zhvillimin e bujqësisë në një kohë thatësire. Njëkohësisht, duke informuar fermerët rreth përdorimit me kujdes e në sasinë e duhur të plehrave kimike, agronomët ndikojnë në uljen e përdorimit të tyre dhe si rrjedhojë, ndikojnë në shmangien e ndotjes së ujit nga bujqësia.

Konsolidimi i tokës, për zonat fushore, tipike për bashkinë e Fierit mbetet çelësi i suksesit për transformimin e bujqësisë dhe instrument i rëndesishëm në zhvillimin rural, duke filluar nga format më të thjeshta të punës në grupe, shoqata fermerësh, tregu i tokes deri në zbatimin e politikave favorizuese shtetërore dhe mbështetjes për fermerët që konsolidojnë tokën.

- ***<u>Rekomandime të tjera:</u>***

- *Balancat rural-urbane duhet të forcohen në funksion të mbrojtjes së tokave me potenciale bujqësore, nëpërmjet planifikimit;*
- *Duhet të zbatohet kriteri i pershtatshmerisë së tokave bujqësore në përputhje me efektivitetin ekonomik dhe kërkesat e bimëve sipas vlerësimit të tokës;*
- *Duhet të konsolidohet toka bujqësore në kuadër të nismave të bashkisë, grupeve të interesit dhe politikave në nivel kombëtar;*
- *Duhet të përfundojë procesi i regjistrimit të pronësisë dhe krijimi i dokumentacionit bazë;*
- *Duhet të ngrihen laboratorë për zbatimin e teknologjive bujqësore për të kryer analizat e tokës dhe për të përdoriur kimikatet mbi bazën e këtyre analizave, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.*

1.6.3 Pronësia mbi token dhe pronat publike

- **Evidentimi i pronave publike**

Kjo analizë ka për qëllim analizimin e mënyrës së përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen, funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë.

Sipas legjislacionit[361] përkatës, me "pronë e paluajtshme publike" kuptohet ajo pjesë e pronave të paluajtshme të shtetit që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell përfitime në favor të publikut të gjerë. Të tilla janë:

- Vija bregdetare për të hyrë në tokë, ujërat territoriale, shtretërit dhe brigjet e lumenjve, të përrenjve a rrjedhave të tjera ujore, liqeneve, lagunave dhe rezervuarëve natyrorë ose artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, të gurëve dhe dherave në shtretër të lumenjve, të liqeneve e rezervuarëve, ashtu siç është përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.
- Zonat historike, arkeologjike dhe kulturore, si dhe parqet me rëndësi kombëtare ose vendore.
- Zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike.
- Burimet natyrore dhe rezervat minerare e inertet, ashtu siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi.
- Janë, gjithashtu, prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe pyjet, kullotat dhe livadhet, si dhe çdo lloj tjetër prone e paluajtshme e ndërtuar mbi to, që i shërben drejtpërdrejt mbrojtjes dhe zhvillimit të tyre.
- Janë, gjithashtu, prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe aktivet e ngurtësuara (ose të trupëzuara), që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve publike si:
    - rrugët dhe urat, hekurudhat dhe sistemet ndihmëse të lidhura më to;
    - infrastruktura aeroportuale;
    - sistemet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë;
    - sistemet e shërbimit të telekomunikacionit dhe të postës;
    - sistemet e funizimit me ujë të pijshëm, si dhe të derdhjeve të ujërave të zeza të qendrave të banuara;
    - ndërtimet me interes të njohur historik, arkeologjik dhe kulturor;

- parqet, lulishtet, sheshet publike në qytete e qendra të banuara, ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin, shkencën, kulturën dhe sportet, për shërbimin shëndetësor e shoqëror, për institucionet qendrore dhe vendore, si dhe rezidencat qeveritare së bashku me trojet mbi të cilat ngrihen këto prona.

Këto prona të paluajtshme publike tjetërsohen ose jepen në përdorim sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta.

Për të bërë analizën e pronave publike të Bashkisë Fier është shfrytëzuar informacioni i marrë nga Agjencia e Inventaraizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave Fier, nga Përdorimi i Tokës[362] dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Për të paraqitur një gjëndje sa më të plotë të pronave publike të kësaj bashkie, të dhënat e Inventarit janë krahasuar me të dhënat nga Përdorimi i Tokës. Megjithatë informacioni bazë është pikërisht Inventari i Pronave Publike[363]. Në këtë inventar përfshihen të gjitha pronat të çdo kategorie dhe që janë aktualisht të regjistruara ose jo në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si edhe prona të tjera të paluajtshme të shtetit, që nuk janë pronë publike si toka bujqësore, troje, ndërtesa, aktive të ngurtësuara të ndërmarrjeve apo shoqërive anonime, aksionet e të cilave në momentin e inventarizimit janë nën administrimin e shtetit.

Kategoritë qe u morën në shqyrtim janë:

- Emri i pronës,
- Sipërfaqja totale e pronës
- Funksioni i pronës,
- Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative,
- Institucioni / Enti përdoruës (Statusi juridik i përdorimit) etj.

Për Bashkinë Fier nga Inventari i Pronave Publike[364] kemi të evidentuara këto kategori kryesore:

Tabela 84. Kategoritë e pronave sipas Inventarit të Pronave Publike

Funksioni i Pronës	Nr.	Sipërfaqja (m^2)	Raporti në %
Truall	96	475,706.30	9.17
Shërbim Shëndetësor	18	50,878.28	0.98
Arsim	71	320,407.13	6.17
Kulturore	6	28,986.39	0.56
Funerale	43	617,984.32	11.91
Mbrojtje civile	98	252,319.76	4.86
Ekonomi	4	39,309.35	0.75
Ujitje, kullim, depozitim uji	1	15,307.96	0.29
Sportive	21	151,469.24	2.91
Hapërsira Publike	6	49,364.82	0.95
Bujqësi/Blegtori	26	1,749,892.28	33.73
Pa funksion/ pa informacion	62	483,241.93	9.31
Infrastrukturë	305	763,078.75	14.70
Administratë	3	3,148.15	0.06
Të tjera	5	186,706.52	3.59
Totali i Pronave Publike	765	5,187,801.22	100

Burimi: Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP); Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Siç mund të shihet nga ky evidentim, numër më të madh (305) të pronave publike e zënë ato me funksion **infrastrukturë.** Ky rezultat vjen pasi këtu përfshihen një sërë elementesh si rrugë, ura, kanalizimeve dhe sipërfaqe të tjera të cilat janë të shumta në numër.

Për sa i përket hapësirave publike në listë parqiten vetëm 6, por duhet të shtojmë se një pjesë e pronave që llogariten si hapësirë publike sipas legjislacionit[365] përkatës janë futur tek kategoria infrastrukturë, (të tilla si rrugë, trotuare, bulevard, etj.)

Pronat publike me përqindjen dhe sipërfaqen më të madhe që kemi në bashki përbëhen nga prona që shfrytëzohen për bujqësi apo blegtori si psh: tokë arë, kullota. Kjo situatë ekziston pasi në këtë bashki, përshkak të relievit të favorshëm dhe llojit të tokave, apo edhe rrjetit hidrik, favorizohet zhvillimi i këtij sektori.

- **Shërbimet publike**

Për shërbimet publike, nga Inventari i Pronave Publike kemi rreth 71 prona me funksion arsim, të cilat janë: parashkollor (19), parauniversitar (58) dhe 0 universitar. Gjithashtu kemi 18 prona me funksion shërbim parësor shëndetësor. Ndërkohë nga përdorimi i tokës kemi të evidentuar 125 prona me funksion arsimore nga të cilat 53 janë arsim parashkollor; 61 janë arsim i ulët, 10 janë arsim i mesëm dhe 1 i lartë. Gjithashtu nga përdorimi i tokës kemi në total 65 prona me shërbim shëndetësor, nga të cilat:

Tabela 85. Pronat publike për shërbimin parësor shëndetësor nga përdorimi i tokës

Aktiviteti i pronës	**Nr.**	**Sipërfaqe në m^2**
Qendër spitalore	4	6,667.39
Poliklinikë	2	2,095.49
Maternitete	1	1,225.70
Qendra Shëndetësore	39	17,959.21
Ambulanca- konsultore	2	353.39
Shërbim dentar	6	2,911.11
Farmaci	9	3,515.86
Tjetër	2	1,925.14
Total	65	36,653.33

Burimi: Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP); Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Bashkia Fier mban përgjegjësi[366] për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave që kanë funksion arsimi parauniversitar, duke përjashtuar këtu shkollat profesionale. Për sa i përket arsimit parashkollor, bashkia mban përgjegjësi për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor në kopshte e çerdhe. Ndërkohë për pronat me funksion shërbim shëndetësor, përgjegjësitë e bashkisë të përcaktuara në ligj janë: ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave.

Siç mund të shohim nga krahasimi i të dhënave të mësipërme, Inventari i Pronave Publike paraqet shifra më të vogla kur krahasohet me vlerat e gjetura nga Përdorimi i Tokës. Një nga arsyet është se për disa prona (kryesisht ato me funksion arsim), ka disa funksione në të njëjtën ndërtesë. Vihet re shpesh se në Inventar janë shënuar në të njëjtën pronë njëkohësisht arsimi parashkollor dhe ai parauniversitar, ku herë-herë gjendet dhe shërbimi shëndetsor parësor. Kjo ndodh kryesisht në zonat rurale, ku kopshtet janë një ose 2 klasa në ndërtesat e shkollave 9-Vjeçare. Për Bashkinë Fier kemi të paktën 6 prona që janë të kategorizuara si

aktivitet parauniversitar. Kjo situatë tregon se ka nevojë për përmirësime në strukturë në mënyrë që sipas standarteve këto funksione të jenë në godina të veçanta.

Figura 129. Vendndodhja e Pronave Publike: Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës



Burimi: Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP); Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Figura 130. Vendndodhja e pronave me funksion Arsim; Krahasim i të dhënave nga Inventari i Pronave Publike me Përdormin e tokës



Burimi: Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP); Përgatiti: Co-PLAN, 2016

- **Prona me funksion mbrojtje civile**

Këto janë zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike. Në Fier, ashtu si edhe në shumë vende të tjera në të gjithë territorin e Shqipërisë, ka shumë prona të tilla të cilat na kanë mbetur nga e kaluara dhe janë jashtë funksionit. Në këtë bashki ka përkatësisht 98 të tilla me një sipërfaqe totale 252,319.76 m^2. Këto prona mund të shfrytëzohen për funksione të tjera sipas nevojave.

Figura 131. Vendndodhja e pronave publike me konflikt



Burimi: Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP); Përgatiti:Co-PLAN, 2016

Nga evidentimi i pronave publike nga të dhënat e Inventarit, mund të bëjmë edhe një krahasim me ortofoto për të parë nëse kemi konflike pronësie, domethenë nësë në parcelën e pronës publike ka pasur ndërhyrje të tjera. Kjo është me rëndësi për tu analizuar pasi pas viteve 1990 kemi pasur një ndërtim të lartë të godinave informale, që janë realizuar edhe mbi prona publike. Nga ky krahasim me ortofoton mund të themi se kemi 37 prona publike ku kemi raste konflikti. Këto prona janë në përgjithësi troje të ish magazinave apo dyqaneve, por kemi edhe raste kur kemi ndërtime në oborret e

shkollave dhe qendrave shëndetësore. Këto situate paraqesin probleme për përdorimin dhe menaxhimin e të gjithë pronës publike sipas kompetencave të parashikuara në ligj.

Në foton e ilustruar më poshtë paraqit një rast konflikti ku në parcelën (prone publike) e një shkolle. Janë bërë ndërtime private.

Figura 132. Shembull konflikti në pronën publike me funkion arsim

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

1.7 Analiza e infrastrukturave publike

1.7.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik

- **Konteksti infrastrukturor rajonal**

Në Bashkinë Fier kalon Korridori i VIII dhe Korridori i Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane) që janë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit. Korridori VIII fillon nga porti i Vlorës (përveçse në portin e Durrësit) në jug të vendit, kalon më pas në

autostradën “100 vjetori i Pavarësisë”, vazhdon në Levan ku është duke u ndërtuar bypass-i i cili është një nga më të rëndësishmit, më pas ky korridor kalon në periferi të Lushnjës, Rrogozhinës vazhdon drejt Elbasanit dhe më tej.

Si pjesë e këtyre korridoreve dhe autostradës Fier-Vlorë, po ndërtohet Autostrada Mbrostar-Levan që kalon në periferi të qytetit të Fierit (në perëndim). Kjo rrugë do të bashkohet në Mbrostar dhe aty do të ndërtohet një bypass, ku një degëzim i tij të çon në qytetin e Fierit, kurse degëzimi tjetër të çon në autostradën e Levanit, një segment rrugor, i cili aktualisht po ndërtohet. Ndërtimi i linjës së re (Mbrostar – Levan) do të sjellë zhvillim në pjesën perëndimore të qytetit të Fierit duke e kthyer atë në një nga pikat kryesore të lëvizshmërisë të Korridorit VIII.

Projekti i *bypass*-it rrugor i referohet ndërtimit të tipit autostradë interurbane me gjatësi afërsisht 22 km, gjerësi 22 m (2X2 korsi), me vlerë prej 60 milionë Euro financuar nga BERZH-i dhe BEI. Në këtë seksion është parashikuar ndërtimi i 3 urave me gjatësi nga 80 m secila në Lumin Seman, në kanalin e Hoxharës dhe atë të Pojanit. Janë parashikuar gjithashtu 4 kryqëzime në disnivel si dhe 2 gjysëm kryqëzime. Kryqezimet në disnivel janë parashikuar të ndërtohen si mbikalime për lëvizjen e trafikut kryesor, si dhe rrethrrotullim në bazë për lëvizjen e trafikut lokal.[367]

Figura 133. Fieri në raport me infrastrukturën rajonale.



Burimi: ARRSH; Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Për më tepër, qyteti i Fierit do të lehtësohet për sa i përket trafikut në zonën urbane sepse automjetet që kanë për qëllim të shkojnë në destinacionin tjetër do të kalojnë

tranzit në periferi të qytetit dhe jo në brendësi duke krijuar trafik të panevojshëm siç ka ndodhur deri tani. Një çështje e rëndësishme për planin do të jetë parashikimi i forcimit të lidhjeve të qytetit me bypasi-in dhe përcaktimi i hyrjeve të qytetit, ku edhe përdorimi i tokës do të jetë më i zhdërvjellët.

Përsa i përket infrastrukturës kombëtare, në Bashkinë Fier kalon Rruga Shtetërore 4 (SH4) e cila është pjesë e Korridorit VIII dhe Korridorit të Kaltër. SH4 fillon në Durrës dhe përfundon në Kakavijë, duke kaluar në Lushnjë, Fier dhe Gjirokastër. Në këtë itinerar nis *Route 853* e cila përfundon në Janinë. Një tjetër aks i rëndësishëm është rruga shtetërore SH8 e cila nis në qytetin e Fierit dhe përfundon në Sarandë. [368]

Nga informacionet e marra nga ARRSH (Autoriteti Rrugor Shqipetar) për investimet rajonale për Bashkine Fier në vitin 2015 është bërë një studim për rehabilitim e aksit Fier-Patos e cila do të sjellë një lidhje më të mirë bashkinë e Patosit

- **Të dhëna të përgjithshme mbi infrastrukturën rrugore në Bashkinë Fier**

Nga analiza e kryer nga grupi i punës mund të thuhet se në Bashkinë Fier shtrihen **3,622.1 km rrugë.** Sipas planit rregullues të Bashkisë Fier (2006) rezulton se vetëm në qytetin e Fierit ka pasur **49,730 km** rrugë. Kjo tregon se infrastruktura rrugore është rritur me dhjetra herë në krahasim me Bashkinë e vjetër të Fierit. Arsyeja kryesore e këtij ndryshimi të madh ka të bëjë me ndarjen e re territoriale, pasi tashmë në llogaritjen e sipërfaqeve të rrugëve përfshihen edhe rrugët e gjendura në njësitë e reja administrative të bashkisë.

Infrastruktura rrugore e bashkisë së re zë një sipërfaqe prej 1,178.4 ha, ndërsa referuar Planit Rregullues të Bashkisë Fier, në vitin 2012, në bashkinë e vjetër të Fierit shtriheshin rreth 59.2 ha[369].

Për sa i përket aksesit, kjo bashki ka lidhje optimale me bashkitë e Vlorës, Patosit, Gjirokastrës dhe Lushnjës, ku mund të përmendim Autostradën "100-Vjetori i Pavarësisë" (Levan-Vlorë), lidhjen Levan-Tepelenë, e cila është pjesë e Korridorit të Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane) si dhe Autostradën Mbrostar-Levan. Këto kanë qenë investimet më të rëndësishme infrastrukturore që janë bërë vitet e fundit në Bashkinë Fier. Në veri Bashkia e Fierit ka një lidhje të rëndësishme me Bashkinë e Lushnjës (pjesë e Korridorit VIII) ku në këtë bashki ka një degëzim që të çon në Bashkinë e Divjakës.

Në veriperëndim Bashkia e Fierit nuk ka një lidhje optimale me infrastrukturë rrugore kryesore që lidh Bashkinë e Fierit me Bashkinë e Divjakës. Pjesa tjetër e bashkisë ka akses të mirë.

- **Kategorizimi i rrugëve**

Kategorizimi i rrugëve ekzistuese të Bashkisë Fier është kryer në bazë të Ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë". Sipas këtij Kodi, rrugët klasifikohen si vijon:

Tabela 86. Klasifikimi i infrastrukturës rrugore sipas Kodit Rrugor.

Kategoria e rrugëve ekzistuese sipas Kodit Rrugor	Gjatësia e rrugës (km)
Autostradë	47.9
Rruge ndërqytetëse kryesore	29.3
Rruge ndërqytetëse dytësore	18.9
Rruge urbane kryesore	11
Rruge urbane dytësore	551
Rruge lokale	2964
Gjithsej	**3622.1**

Përgatiti: Co-PLAN, 2015

Figura 134. Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Nga tabela e mësipërme rezulton se në Bashkinë Fier rrugët kryesore urbane përbëjnë vetëm 11 km (të cilat shkrihen kryesisht në qytetin e Fierit), kurse numrin më të madh e përbëjnë rrugët lokale 2964 km linear të cilat shtrihen në periferi të qytetit si dhe në territoret e njësive të tjera administrative. Referuar llogaritjeve të kryera nga grupi i punës, rrugët urbane zënë 59.2 ha kurse rrugët rurale 119.2 ha. Këto të dhëna tregojnë mbizotërimin e rrugëve rurale ndaj atyre urbane. Këta tregues theksojnë edhe njëherë ndryshimet territoriale që kanë ndodhur në territorin e kësaj bashkie pas ndarjes së re administrative. Për t'u theksuar është që në këtë analizë nuk janë vendosur rrugët e parcelave të cilat shtihen në një distancë 13.8 km linear.

Profilet e infrastrukturës rrugore bazuar Kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë:
Autostradë: Rrugë interurbane ose urbane me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafik-ndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjence, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa kryqëzime në nivel, e pajisur me rrethim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor dhe e dallueshme me sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe shpejtimi. [370]

Figura 135. Prerja tip e Autostradës.



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Rruga interurbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekt anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor.

Figura 136. Prerja tip e rruges interurbane kryesore



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Rrugë interurbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.

Figura 137. Prerja tip e rrugës interurbane kryesore



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Rrugë urbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.

Figura 138. Prerja tip e rrugës urbane kryesore.



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Rrugë urbane dytesorë: Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.

Figura 139. Prerja tip e rrugës urbane dytësore.



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Rrugë lokale: Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij Neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Figura 140. Prerja tip e rrugës lokale.



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Nga klasifikimi i rrugëve sipas funksionit dhe mënyrës së lidhjes mes tyre, rezulton:

Tabela 87. Infrastruktura rrugore sipas funksionit.

Kategoria e rrugëve ekzistuese sipas përdorimit	Gjatësia e rrugës (km)
Arterie	81.3
Autostradë	56.4
Bujqësore	2047.2
E brendshme kryesore	150
E brendshme dytësore	550.6
Kolektor	390.3
Peizazhi	143
Rekreative	159.6
Shërbimi	31.9
Total	**3622.1**

Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Në aspektin e funksionit të akseve rrugore, mbizotërojnë rrugët bujqësore (56 % të totalit), ndjekur nga rrugët e brendshme dytësore (15 %). Në tërësi, sistemi rrugor i bashkisë ka nevojë për përmirësime të shumta sidomos në lidhjet e brendshme.

Figura 141. Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

*Rrugët urbane dhe rurale:*Me ndarjen administrative të vitit 2016 vërejmë që infrastruktura rrugore ka pësuar shumë ndryshime ku mund të përmendim që sipërfaqja e rrugëve në planin rregullues të Bashkisë Fier 2006 ishte 59.2 Ha. Infrastruktura rrugore e Bashkisë është 1178.4 ha. Kjo tregon shtrirjen e madhe që ka marrë kjo Bashki me ndarjen e re administrative.

Nga ky ndyshim qe ka ndodhur shohim që rrugët urbane zënë 59.2 ha kurse rrugët rurale 119.2 ha. Kjo tregon që në bashki mbizotërojnë rrugët rurale dhe rëndësinë që duhet t'i jepet kësaj infrastrukture në hartimin e planit të përgjithshëm vendor. Kjo infrastrukturë shtrihet në pjesën jashtë qytetit në ish-njësitë e vjetra administrative që iu janë bashkuar Bashkisë Fier.

- **Gjendja e infrastrukturës rrugore**

Krahas llojit dhe funksionit të akseve rrugore, kjo analizë merr në konsideratë edhe gjendjen fizike të infrastrukturës, në aspekt të cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës etj. Nga ky evidentim[371] rezulton se në Bashkinë e Fierit vetëm 320 kilometra rrugorë janë të shtruar dhe 3,302.1 janë të pashtruar. Rrugët me cilësi të mirë shtrihen kryesisht në qytetin e Fierit, në një pjesë të qendrave të njësive rurale, si dhe në segmentet interurbane kryesore e dytësore.

Referuar të dhënave të FShZh-së, në Bashkinë e Fierit, gjatë periudhës 2005-2013 janë financuar një tërësi projektesh infrastrukturore me qëllim rikonstruksionin e tyre. Gjithsej janë shtruar dhe rikonstruktuar 28.44 km rrugë përkatësisht: Libofshë – 0.22 km, Cakran – 2.1km, Portëz – 2.2 km, Levan – 12.73km, Frakull – 10.6 dhe Dërmenas – 0.83[372].

Figura 142. Gjendja e infrastrukturës rrugore



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Siguria rrugore**

Pikat potenciale të rrezikut: Për të bërë një vlerësim të pikave të tjera potenciale të rrezikut, janë evidentuar të gjithë pikat ku Autostrada, rrugët interurbane kryesore ose dytësore kryqëzohen me rrugë lokale Numri i tyre është shumë i lartë: 179 pika konfliktuale. Pra, duhet marrë parasysh që lëvizja në akset kryesore të Fierit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme ndaj kthesave drejt rrugëve lokale. Ndër akset më problematike mund të përmendim lidhjen me Lushnjën në veri si dhe lidhjen me Patosin në lindje. Autostrada Mbrostar-Levan sipas projektit që po zbatohet do të ketë 6 hyrje-dalje.

Figura 143. Kryqëzimet e rrugëve lokale me rrugët interurbane kryesore dhe dytësore.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Aksidentet rrugore 2008-2015: Sipas informacioneve të marra nga Instituti i Transporteve për pikat e rrezikut, në Bashkinë Fier ka disa pika problematike të cilat shtrihen kryesisht në rrugën urbane kryesore. Nga kjo analizë shihet që pikat me problematike në këtë Bashki janë:

- Ura e Mbrostarit – në këtë pikë kanë ndodhur 2 aksidente, ku 1 ka pasur seriozitet 2[373] dhe një ka pasur seriozitet 1 në vitin 2014;
- Unaza e qytetit - në këtë pikë kanë ndodhur 4 aksidente, ku 3 kanë pasur seriozitet 2 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 nga viti 2009- 2014;
- Ne rrugën Fier-Levan (tek karburant Veliaj) - kanë ndodhur 2 aksidente, ku 1 aksident ka pasur seriozitet 1 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 gjatë vitit 2014;
- Në hyrje të autostradës Levan Vlore – kanë ndodhur 2 aksidente me seriozitet 1 gjatë vitit 2013-2014;

- Në rrugën Levan Tepelenë (Kafaraj)– kanë ndodhur 2 aksidente me seriozitet 1 gjatë vitit 2013-2014;
- Në rrugën Levan Tepelenë (Varipop)– kanë ndodhur 2 aksidente me seriozitet 1 në vitin 2014;
- Në Libofshë – kanë ndodhur 2 aksidente me seriozitet 1 në viti 2014;
- Në rrugën Libofshë (Agim)– kanë ndodhur 2 aksidente, ku 1 aksident ka pasur seriozitet 1 dhe 1 ka pasur seriozitet 1 gjatë vitit 2009;
- Në Libofshë Lushnjë (Ardenicë)– kanë ndodhur 2 aksidente, ku 1 kanë pasur seriozitet 2 dhe një ka pasur seriozitet 1 në vitin 2009.

Nga evidentimi i pikave problematike ku kanë ndodhur më shumë se 1 aksident në periudhën 7-vjecare, sipas informacioneve nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe nga Policia e Shtetit, këto pika studiohen me kujdes nga ana e institucioneve Shtetërore dhe evidentohen si njolla të zeza, duke u bazuar në numrin e madh të aksidenteve që ndodhin në 1 pikë. Pika më problematike në Bashkinë e Fierit ndodhet në Unazën e Qytetit, në të cilën kanë ndodhur 4 aksidente. Në hartimin e planit rregullues të bashkisë Fier, këtyre pikave problematike do t'u jepet një rëndësi e veçantë për të ulur numrin e aksidenteve që ndodhin në këtë bashki.

Figura 144. Aksidentet e regjistruara në territorin e Bashkisë Fier për periudhën 2088-2015.



Burimi: Instituti i Transportit, Bashkia Fier, 2015; Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Transporti publik**

Transporti ndërqytetas (Interurban): Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) së bashkive me njëra-tjetrën.

Transporti publik ndërqytetas është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Transporti ndërqytetar përkufizohet si: transport i udhëtarëve me autobus i cili kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri. Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

a) bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;

b) një bashki qendër qarku me bashkitë, jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme.[374]

Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës. Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave. Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë. Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet.[375]

Referuar Drejtorisë së Transportit dhe e Licencave Profesionale (Bashkia Fier), rezultojnë 23 linja ndërqytetëse që lidhin qytetin e Fierit me qytetet kryesore te vendit. Linja më e rëndësishme për udhëtimin e qytetareve është ajo Fier-Patos, linjë të cilën e përdorin 65,200 udhëtarë në vit. Një linjë tjetër e rëndësishme është linja Fier-Tiranë, të cilën e përdorin 135,000 udhëtarë. Sipas këtyre të dhënave, rezulton se udhëtojnë rreth 370 udhëtarë në ditë.

Rrethi i Fierit ka rreth 14,540 automjete në qarkullim. Nga këto 23% janë kamionë dhe 77% autovetura. Pjesa dominuese e autoveturave (rreth 95% e tyre) përdorin si lëndë djegëse gazoil (naftë) dhe vetëm 5% e tyre përdorin benzinë. Duke pasur parasysh se një automjet harxhon mesatarisht 5 litra karburant në ditë, rezulton se për rrethin e Fierit duhet të harxhohen rreth 69,000 litra/ditë. [376]

Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës mbi treguesin e lëvizshmërisë, lëvizshmërinë më të shpeshtë Bashkia e Fierit e ka me qytetin e Tiranës dhe Mallakastrës. Nga skema e paraqitur shihet se Bashkia Fier ka 8 orare që shkojnë drejt Mallakastrës në ditë dhe kjo tregon lidhjet e shpeshta që kanë këto bashki me njëra tjetrën. Treguesi i kësaj analize është numri i orareve që nisen nga Fieri drejt qyteteve të tjera të vendit. Për t'u theksuar është dhe lidhja që ka Bashkia Fier me bashkitë Kuçovë dhe Vlorë, për të cilat konkretisht ekzistojnë 6 orare në ditë. Intensifikimi i lëvizjeve tregon marrëdhëniet që kanë këto bashki me njëra-tjetrën për sa i përket punësimit dhe shërbimit tregtar. Autobusët ndërqytetës nisen nga sheshi që ndodhet pranë stacionit hekurudhor. Sipas informacioneve të Bashkisë së Fierit, theksohet që në këtë shesh pritet të ndërtohet një terminal nga i cili do të nisen autobusët ndërqytetës.

Në qytetin e Fierit është ndërtuar një terminal i ri në bazë të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Fier dhe investitorëve privatë. Ky terminal është vendosur në unazën e qytetit, në itinerarin që lidh qytetin e Fierit me qytetin e Patosit dhe do të jetë në

funksion të linjave ndërkombëtare e ndërqytetëse. Nga ky terminal mund të nisen 12 autobusë në minutë.

Figura 145. Transporti ndërqytetës, Bashkia Fier



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Lëvizshmëria dhe transporti publik rrethqytetas: Të dhënat statistikore për përdorimin e automjetit apo transportit publik, (INSTAT, 2011) tregojnë se 52.1 % e banorëve të Bashkisë Fier shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 14.2 % me autobus, minibus ose taksi dhe 27.9 % me automjete personale (makina ose motoçikleta). Kjo dëshmon për një kulturë automobilistike jo të vogël, ku mund të përmendim lidhjen që ka bashkia e Fierit me Patosin, duke parë numrin e lartë të lëvizshmërisë (180 udhëtarë në ditë) Gjithsesi, numri i vogël i personave që përdorin transportin publik vjen si pasojë e mungesës së një sistemi të tillë brenda qytetit.

Transporti rrethqytetas është shumë i rëndësishëm në mobilitetin (lëvizshmërinë) brenda bashkisë. Kjo vjen pas reformës administrative që u bë në vitin 2015, ku

bashkive të vjetra iu bashkuan dhe ish-njësitë administrative (komunat). Transporti i udhëtarëve në linjat rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

a) njësive administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;

b) njësive administrative përbërëse të së njëjtës bashki;

c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;

ç) fshatrave dhe njësive administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën.[377]

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore. Linjat e transportit rrethqytetas mbështeten në nevojat e lëvizjes së udhëtarëve për në ose nga bashkitë qendër qarku, bashkitë e tjera dhe destinacionet dimërore apo verore dhe qendrat historike. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me qendrat e njësive administrative përbërëse dhe qendrat e njësive administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse.[378]

Një fakt i rëndësishëm që duhet përmendur është që Këshilli Bashkiak ka kompetencë të përcaktojë nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet (transporti rrethqytetas), në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave[379] Sipas ndryshimeve që kjo bashki ka bërë me shtimin e transportit publik ndërqytetas mund të thuhet që ky lloj transporti mbulon 72 km linearë. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Fier, numri i mjeteve të transportit në rang rrethi për vitin 2010 ka qenë gjithsej 14,540 mjete. Vihet re një rritje rreth 20 % çdo vit. Lista e automjeteve sipas regjistrimit tregohet në diagramën e mëposhtme:

Figura 146. Lista e automjeteve sipas regjistrimit



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Figura 147. Transporti ndërqytetës, Bashkia Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Transporti i udhëtareve për linjat "**Rrethqytetese"** është: Fier-Levan-Fier; Fier-Frakull-Fier; Fier-Seman-Fier; Fier-Pojan-Fier; Fier-Povelçë-Fier; Fier-Topoje-Fier; Fier-Ferme-Fier; Fier-Libofshe-Fier; Fier- Roskovec-Fier; Fier-Cakran-Fier; Fier-Peshtan-Fier; Fier-Bishan-Fier; Fier-Luar-Kuman-Fier; Fier-Patos-Fier.[380]

Duke u bazuar në informacionet dhe statistikat e marra nga bashkia e Fier shihet që linja që ka fluksin më të madh është ajo me Libofshën në të cilën qarkullojnë 72,000 udhëtarë në vit.

Stacionet në të cilat nisen autobuzët e transportit rrethqytetas janë:

- Stacioni i trenit
- Vendqëndrimi tek Rruga " Brigada XI Sulmuese"

- Vendqëndrimi tek rruga “Leon Rei”

Këto stacione shërbejnë edhe për transportin ndërqytetas.

Figura 148. Stacionet e Transportit publik dhe vendqëndrimet e taksive, Bashkia Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Infrastruktura hekurudhore në Fier**

Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë ka për objekt përcaktimin dhe vendosjen e rregullave dhe parimeve të përgjithshme në fushën e transportit hekurudhor dhe të veprimtarive që lidhen me të. "Infrastrukturë hekurudhore” është tërësia e të gjitha vijave hekurudhore, e degëzimeve hekurudhore, e pajisjeve dhe e instalimeve të ndërlidhjes, të sinjalizmit dhe elektrike, të domosdoshme për qarkullimin e mjeteve hekurudhore dhe për sigurinë e trafikut. "Hekurudha Shqiptare është ndërmarrje publike, me kapital tërësisht shtetëror. Ajo organizohet dhe vepron në formën e një shoqërie anonime, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”. Hekurudha Shqipetare ka për detyrë edhe administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe, nëpërmjet fondeve shtetërore, realizon investime në infrastrukturë për rinovimin e modernizimin, për mirëmbajtjen e zgjerimin e saj dhe për administrimin e sistemeve të drejtimit e të sigurisë. [381]

Linja hekurudhore në qytetin e Fierit shërben për të lidhur qytetin e Fierit me Tiranën dhe Vlorën. Bashkia Fier ka një lidhje hekurudhore edhe me Ballshin, por ajo sot funksionon vetëm për transport mallrash. Aktualisht, funksionon vetëm linja Tiranë-

Fier-Vlorë dhe treni i pasagjerëve kalon në Fier vetëm dy herë në ditë. Në Fier gjendet një stacion treni për pasagjerë, i cili ka edhe hapësirën përkatëse të parkimeve. Si ndërtesa, ashtu edhe ambienti përreth saj, aktualisht paraqiten në gjendje mjaft të degraduar. Fieri ka edhe një hapësirë të konsiderueshme të stacionit të trenave të mallrave së bashku me ofiçinat e trenave dhe magazinat. Edhe kjo zonë paraqitet mjaft e degraduar dhe shumica e objekteve që e përbëjnë këtë zonë ndodhen jashtë funksionit. [382]

Infrastruktura hekurudhore është shumë e rëndësishme në planifikimin e territorit sepse duhet të plotësohen disa kushte për të mos pasur probleme në funksionimin normal të hekurudhës. Për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore, ndalohet:

a) derdhja e ujërave të kanaleve ujitëse e kulluese dhe e ujërave të tjera në vijën hekurudhore ose në kanalet e trasesë së saj;

b) ndërhyrja në sistemin e kullimit të ujërave nga kanalet e trasesë së hekurudhurës deri në derdhjen përfundimtare;

c) hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i guroreve, zhavorishteve e ranishteve, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve. Edhe për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga HSH-ja;

ç) kalimi i mjeteve me zinxhirë dhe i mjeteve të tjera të rënda mbi vijën hekurudhore, me përjashtim të rasteve kur HSH-ja cakton vendet e lejuara dhe rregullat për kalimin e tyre;

d) çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona, lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25 - 100 metra nga ky brez. Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore, dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga HSH-ja.[383]

Figura 149. Profil i hekurudhës.



Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2016

Sipas raportit të publikuar nga Ministria e Transportit për prioritet e vitit 2014 hekurudha zë një rol të veçantë ku baza kryesore në projektet në këtë infrastrukturë janë rehabilitimi i gjendjes ekzistuese. Hekurudha Shqiptare është duke synuar që me anë të një programi investimesh ta rivendosin hekurudhën Shqiptare në kushte normale në mënyrë që të konkurojë me vendet e rajonit dhe më tej në një periudhë 8 deri në 10-vjeçare.

- ***Përfundime***

Bashkia Fier është pjesë e korridoreve të rëndësishme kombëtare duke e kthyer në një qytet me tregues të lartë lëvizshmërie. Megjithatë, nivelin më të lartë të lëvizshmërisë bashkia e ka me qytetin e Mallakastrës, Tiranës dhe Patosit

Si pasojë e reformës territoriale, Bashkia e Fierit tashmë ka një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore, të cilat gjenden në territorin e saj. Sot në territorin e bashkisë numrin më të madh të rrugëve e zënë ato lokale me funksion bujqësor.

Levani ngelet një nga nyjat më kryesore të infrastrukturave në bashki, por nga ana tjetër është e nevojshme që të tregohet vëmendje në ekzistencën e 179 pikave konfliktuale të identifikuara, përfshirë këtu edhe pikat që gjenden në Levan.

1.7.2 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

- **Ujësjellësi Fier**

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujrave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë aksionere rajonale UK Fier sh.a. e cila ofron shërbimin në Bashkinë Fier dhe NjA-të Cakran, Mbrostar, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levan, Frakull, Protëz. Kjo ndërmarrje është duke ndjekur procesin e tranzicionit[384] të sektorit sipas reformës territoriale, ku më parë shërbimi ofrohej nga dy shoqëri simotra UK Fier sh.a dhe UK Patos + UK Lushnjë Fshat e megjithatë NjA Mbrostar konsiderohej si "zonë e bardhë" në territorin e së cilës sistemi i furnizimit me ujë për konsum publik administrohen nga stafi ish-komunës ose kemi mungesë të infrastrukturës.

Bashkia Fier siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga akuiferi i Vjosës ku rreth 11.5km në jug të qytetit janë ndërtuar ndër vite 16 pus-shpime të ujit të pijshëm, të cilat nëpërmjet pompave zhytëse pompojnë ujin për konsum publik. Zona në të cilen ndodhen këto St.P quhet ndryshe pellgu ujëmbajtës i Kafarajt. Nga këto 16 stacione pompimi (St.P) vetëm 10 janë aktualisht në gjendje pune që nga rehabilitimi dhe ndërtimi i pusit më të ri realizuar në 2014 nga KfW. Kapaciteti i këtyre pompave vlerësohet të prodhojë diku tek 7,00l/sek[385]. Klorinimi ndodh në këtë St.P, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit si edhe pranë rezervuarëve.

Krahas Kafarajt, janë një sërë burimesh të tjera shumë më të vogla në kapacitet të cilat shfrytëzohen nga NjA-të e Bashkisë Fier me qëllim sigurimin e ujit të nevojshëm për konsum publik në zonat rurale të bashkisë.

Tabela 88. Prurja mesatare e burimeve të ujit në Bashkinë Fier.

Burimi i Ujit	Prodhimi	
	m³/ditë	***l/s***
3 puse të rinj *(ndërtuar në vitin 2006)*	30,240	350
12 puset e vjetër *(6 në gjendje pune)*	22,500	260
pus i ri (*Ndërtuar në viti 2014)*	7,740	90
Total	60,480	700

Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Fier. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Cilësia e ujit që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft e mirë, por në disa raste janë konstatuar ndotje të cilat shkaktohen kryesisht nga mungesa e zonave buferike dhe të mbrojtjes higjieno-sanitare pranë pus-shpimeve. Këto ujëra janë shfaqur të ndotur kryesisht si pasojë e faktorëve të renditur më poshtë:

- sharkimet të ujërave të ndotura nga banorët e NjA-vë fqinjë pranë zonës së St.P dhe rëndom mbi këtë akuifer;
- infiltrimi nga ujërat sipërfaqësore të zonës përdorur në sektorin e bujqësisë dhe industrisë së përpunimit të naftës dhe sektorëve të tjerë;
- mosrespektimi i zonave higjieno-sanitare rreth puseve;
- shportë e vogël e elemtëve të monitoruar mbi cilësinë e ujit për kosum publik.

Figura 150. Skema e furnizmit me ujë nga U.K.-ja Fier.



Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Fier. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Sasia e ujit të prodhaur nga puset e Kafarajt merret nga magjistrali Ø800 dhe shpërndahet fillimisht në rezervuarët e vegjël të NjA-ve Frakull e Levan. Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e Bashkisë Fier paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Tabela 89. Volumi i depozitimit dhe furnizimi e popullatës me ujë të pijshëm: NJA Fier

Bashkia	Popullsia	Kerkesa per Uje (m3/ore)	Sasia e Ujit te prodhuar (m3/ore)	Bilanci (m3/ore)	Kerkesa per rezervuare (m3)	Volumi i Rezervuar (m3)	Bilanci i Volumit te Rezervuar
Fier	55,845	392	2,520	**+2,128**	4,704	14,000	**+9,296**

Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Fier. Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Nga konstatimet e kryera rezulton se sistemi aktual, i cili po i nënshtrohet rehabilitimit dhe zgjerimit[386], ka një kapacitet stokues të ujit të pijshëm prej 21,125m^3. Pra duke marrë parasysh normën ditore të konsumit të popullatës prej 120 l/banor/ditë, prej analizës na rezulton se qytetit të Fierit do t'i nevojiteshin 18,260m^3 kapacitet stokues, në një kohë ku ka rreth 3,000m^3 mbi kapacitetin e nevojshëm, por duke vlerësuar se disa zona kanë bilanc negativ të volumit të nevojshëm për stokimin e ujit të pijshëm vlen të themi se nevojitet një shpërndarje më efektive e këtij elementi në skemën e përgjithshme të furnizimit me ujë bë Bashkinë Fier.

Tabela 90. Të dhëna magjistrale mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm –Fier.

NJA	Popullsia Aktuale	Kerkesa aktuale per Uje (l/sek)	Kerkesa aktuale per Uje (m3/ore)	Sasia e Ujit te prodhuar aktualisht (m3/ore)	Bilanci (m3/ore)	Kerkesa per Rezervuare (m3)	Volumi i Rezervuarit ne Sisteme (m3)	Bilanci i Volumit te Rezervuareve me Kerkesen
Fier	**55,845**	142	512	2,520	**+2,008**	6,144	14,000	**+7,856**
Cakran	**16,692**	42.5	153	176.4	**+23.4**	1,836	1,810	**-26**
Mbrostar	**10,519**	27	97	47	**-50**	1,200	500	**-700**
Libofshe	**10,397**	26.5	95.3	104.4	**+9.1**	1,144	650	**-494**
Qender	Total **12,337** NJA rurale 4,420 Fieri 7,917	31.4 11.2 20.2	113 40.5 72.5	104.9 32.4 72.5	**-8.1 Fieri**	1,360 486 870	250 Fieri	**-236 Fieri**
Dermenas	**12,534**	32	115	90	**-25**	1,400	600	**-800**
Topoje	**7,599**	19.4	70	58	**-12**	835	350	**-485**
Levan	Total **17,557** NjA rurale 10,790 Fieri 6,766	44.7 27.5 17.2	180 62	+81 62	**-99 Fieri**	250 Fieri	-938 Fieri	**180 Fieri**
Frakull	Total **10,557** NJA rurale	27 5 22	97 18.2 73.2	108 73.2	**+89.8 Fieri**	1,098 218 878	780 250 530	**-318 +32 -348**

	1,990 Fieri 7,990							
Portez	**11,359**	29	104	48.6	**-66.2**	1,250	395	**-855**
Total	**165,396**	421.5	1517.3	3,484.8	**+1,870**	18,259	21,125	**+2,866**

Burimi: ValuAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellësit Fier, Përgatiti: Co-PLAN 2016

Duke qenë gjithnjë në gjendje pune, rezervuarët, stacionet e pompimit, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk i janë nënshtruar rregullisht proceseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim. Gjithashtu, agjentët atmosferikë si edhe në disa raste vegjetacioni kanë ndikuar negativisht në higjienën e këtyre elementëve.

Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri duke marrë parasysh faktin se në këto elementë mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.

VKM-ja nr. 102, datë 16.03.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat" përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 120 litra ujë në ditë për frymë. Është kryer llogaritja e kërkesës për ujë në qytetin e Fierit. Gjatë kësaj llogaritjeje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat synohet të reduktohen deri në 35%. Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (banesa, institucione, biznese).

Tabela 91. Shërbimi furnizimit me ujë të pijshëm për NjA dhe fshatrat në Bashkinë Fier.

Nr.	**Njësitë Administrative**	**Fshatrat e NjA-ve**	**Pop.**
			%
1	**Fier**	**Me Rrjet:** Qyteti Fier dhe fshatrat fqinjë	*92*
2	**NjA Cakran**	**Me Rrjet:** Cakran, Cakran i Ri, Floq, Buz Madh, Hambar, Varibob, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos, Vreshtas, Gorishovë, Gjonç, Tojkan	*95*
		Pa Rrjet:	
3	**NjA Mbrostar**	**Me Rrjet:** Mbrostar, Verri, Vajkan, Petov, Kallmi i Madh, Kallmi i Vogël	*96*
		Pa Rrjet:	
4	**NjA Libofshë**	**Me Rrjet:** Libofshë, Rreth Libofshë, Vanaj, Daullas, Agimi, Metaj, Gozhdaras, Havaleas, Ndërnënas, Hasturkas, Adriatik	*97*
		Pa Rrjet: Hysgjokaj, Kurtin	
5	**Nj.A Qëndër**	**Me Rrjet:** Çlirim, Mujalli, Grecalli, Daullas, Afrim i Ri, Vadhizë, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza, Romët	*98*
		Pa Rrjet:	
6	**Nj.A Dermenas**	**Me Rrjet:** Dërmenas, Hoxharë, Hamil, Baltëz, Povelçë, Darëzezë e Re, Sulaj, Muçaj	*67*
		Pa Rrjet: Radostinë, Pojan, Kryegjatë, Havaleas	
7	**Nj.A Topojë**	**Me Rrjet:** Topojë, Seman, Gjokalli, Sheq Marinas, Sheq, Fushë, Grykë, Seman i Ri, Kavaklli	*70,2*
		Pa Rrjet:	
8	**Nj.A Levan**	**Me Rrjet:** Levan, Ferras, Peshtan i Madh, Peshtan i Vogël, Shtyllas, Bishan, Bashkim, Boçovë, Martinë, Pishë-Poro, Qarr	*52,9*
		Pa Rrjet:	
9	**Nj.A Frakull**	**Me Rrjet:** Frakull e Madhe, Frakull e Vogël, Adë, Peshtan Bregas,	*90,2*

		Kafaraj, Kashishtë, Sheq Musalala, Çerven	
		Pa Rrjet:	
10	**Nj.A Protëz**	**Me Rrjet:** Portëz, Plyk, Lalar,	*55*
		Pa Rrjet: Kraps, Mbyet, Patos Fshat	
Total i popullsisë së shërbyer me infrastrukturën e furnizimit me ujë për konsum publik:			**81,3**

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN, 2016

NjA-të në Bashkinë Fier në masën 81% kanë në territorin e tyre infrastrukturë të furnizimit me ujë të pijshëm por specifikisht Nj.A-të Levan, Topojë, Dërmenas dhe Protëz kanë nevojë për përmirësim të shërbimit që ofron U.K-ja ndaj popullatës së tyre. Në këto zona uji sigurohet nëpërmjet puseve dhe burimeve ujore natyrore por rrjeti nuk është shtrirë në mënyrë efikase.

- **Pus-shpimet**

Për të përmbushur nevojat e përditshme për ujë të pijshëm dhe konsum dytësor, popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar, ose individuale iniciativën për të realizuar pus-shpime.

Bashkia Fier dhe ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, mbështetet kryesisht tek puset e pellgut ujëmbajtës të Kafarajt mbi akuiferin e Vjosës për prodhimin e ujit për konsum publik të banorëve në qytet dhe fshatrat e Bashkisë. Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA-të e tjera të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pus-shpime brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.[387]

Tabela 92. Pus-shpimet në Bashkinë Fier.

Qyteti / NjA	**Ujësjellësi**	**Qyteti / NjA - Fshati i furnizuar**	**Pusshpimet: Vendndodhja**
Qyteti Fier	U.K. Fier	Qyteti i Fier	Akuiferi Vjosës (11,5km në Jug të qytetit Fier)
			Puset në zonën e Kafaraj, 11,5km në Jug të Fier (Në total 16 pus-shpime prej të cilave 12 puse janë aktive), Q = 700l/s.
NjA Cakran	Ujësjellësi Patos	Varibob, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos	3-pus-shpime dhe STP në fshatin Varibop me Q = 60l/s,
	Ujësjellësi Selishtë	Cakran, Vreshtas, Gorishovë, Buzmadh, Hambar, Floq, Gjonç	3-pus-shpime dhe STP 2 km në perëndim të fshatit Gjonç pranë lumit Vjosë, Q = 45l/s,
	Ujësjellësi Hambar	Hambar	pus-shpim dhe STP për ngritje mekanike, pranë fshatit Hambar, me Q = 2,5l/s.
NjA Mbrostar	Ujësjellësi Varri – Vajkan - Kallm	Varri,Vajkan, Kallm	2 pus-shpim dhe STP në fshatin Petovë Bisht me kapacitet Q = 8l/s, (pranë lumit Seman)
	Ujësjellësi Mbrostar	Mbrostar	pus-shpime dhe STP pranë lumit Seman, Q = 5l/s,
NjA Libofshë	Ujësjellësi Rajonal Libofshë	Adriatik,Hastrukas, Havaleas, Gozhdaras, Daullas, Agimi, Ndërmenas,Metaj	2 pus-shpime dhe STP pranë elektro-pompave Vanaj, me kapacitet Q = 8 l/s

	Ujësjellësi Libofshë	Libofshë	pus-shpim dhe STP pranë elektropompave Vanaj, me kapacitet Q = 8 l/
	Ujësjellësi Rreth Libofshë	Rreth Libofshë	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Rreth Libofshë, me kapacitet Q=2 l/s
NjA Qëndër	Ujësjellësi Çlirimi	Çlirimi	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Radostinë, Q = 4 l/s.
	Ujësjellësi Mjualli	Mjualli	pus-shpim dhe STP 1.4 km në lindje të fshatit Mjualli pranë Lumit Seman, me kapacitet Q = 3 l/s.
	U.K. Fier	Gërcalli, Daullas, Zhupan, Drizë, Afrim, Romët	Puset në zonën e Kafaraj, 11,5km në Jug të Fier (Në total 16 pus-shpime prej të cilave 12 puse janë aktive), Q = 700l/s.
	Ujësjellësi Vadhizë	Vadhizë	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Vadhizë, Q = 2 l/s.
NjA Dërmenas	Ujësjellësi Dërmenas Hoxhar	Dërmenas, Hoxhar	pus-shpim dhe STP në Dërmenas, Q = 5 l/s.
	Ujësjellësi Hamil Baltez	Hamil, Baltëz, Muçaj, Sulaj	2 pus-shpime dhe STP në Radostinë, Q = 5 l/s
	Ujësjellësi Pish Poro	Pish Poro, Darzezë, Povelçe	3 pus-shpime dhe STP në Pishë-Poro, Q = 30 l/s
NjA Topojë	Ujësjellësi Pish Poro	Topojë, Seman, Gjokali, Sheq Marinas, Sheq, Grykë, Seman i ri, Kavaklli	3 pus-shpime dhe STP në Pishë-Poro, Q = 30 l/s.
NjA Levan	Ujësjellësi Peshtran i Madh	Peshtan i madh	pus-shpim dhe STP rreth 1km në Perëndim të fshatit Peshtan, me kapacitet Q =5 l/s
	Ujësjellësi Ferras	Ferras	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Ferras, Q = 4 l/s
	Ujësjellësi Qarr	Qarr	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Qarr, Q = 4 l/s
	Ujësjellësi Martine	Martine	pus-shpim dhe STP pranë fshatit Martine, Q = 4 l/s
	Ujësjellësi Pish Poro	Pish Poro, Boçovë, Bashkim	3 pus-shpime dhe STP në Pishë-Poro, Q = 30 l/s
	U.K. Fier	Levan	Puset në zonën e Kafaraj, 11,5km në Jug të Fier (Në total 16 pus-shpime prej të cilave 12 puse janë aktive), Q = 700l/s.
	Ujësjellësi Shtyllas	Shtyllas	Pus-shpim dhe STP rreth 1.5 km në Veri të fshatit Peshtan, me kapacitet Q = 15 l/s
	Ujësjellësi Bishan	Bishan	Pus-shpim dhe STP pranë fshatit Bishan, Q = 4 l/s
NjA Frakull	U.K. Fier	Frakull, Çerven. Peshtan Bregas, Ade, Kafaraj	Puset në zonën e Kafaraj, 11,5km në Jug të Fier (Në total 16 pus-shpime prej të cilave 12 puse janë aktive), Q = 700l/s.
	Ujësjellësi Frakull e Vogël	Frakull e vogël, Sheq Musalala	Pus-shpim dhe STP në fshatin Ada Musalla, pranë lumit Vjosë Q = 30l/s,
NjA Protëz	2 * Ujësjellësa Protëz	Protëz	Pus-shpim dhe STP në fshatin Mbyet pranë Gjanicës,Q=5l/s pus-shpim dhe STP në veri të fshatit Protëz, Q=3l/s
	Ujësjellësi Lalar	Lalar	Pus-shpim dhe STP pranë fshatit Lalar pranë lumit Gjanicë Q=2,5 l/s
	Ujësjellësi Mbyet	Mbyet	Pus-shpim dhe STP pranë fshatit Mbyet, Q=2 l/s

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN 2016

Nga analiza e realizuar në tabelën e mësipërme vlersojmë se nga të gjithë burimet dhe pus-shpimet operative brenda territorit të Bashkisë Fier, ekziston një kapacitet prodhimi i ujit të destinuar për konsum publik prej **Q_{tot}=960 l/sek**. Kjo pasuri kërkon mbrojtje maksimale ndaj ndotjes prej faktorëve të jashtëm, duke i siguruar një proces natyral të rigjenerimit dhe pastrimit të pellgjeve ujëmbajtëse.

Nevojitet që në secilin pus-shpimi të integrohen tre nivelet e zonave strikte të mbrojtjes higjieno-sanitare.

Figura 151. Puset e ujit në Kafaraj pranë lumit Vjosë dhe zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare



Burimi: PLGP/ValuAdd 2015

Aktualisht po realizohen ndërhyrje në rrjetin e furnizimit me ujë të Bashkisë Fier, ku po zbatohet projekti i relizuar me mbështetjen e KfW-së, në të cilin janë parashikuar të ketë rehabilitim të sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë si edhe të lidhjeve me shtëpitë. Një investim, i cili kap shifrën fillestare e 10 milionë Euro-ve të ndara në dy Lot-e.

- Rehabilitim dhe zëvendësim i rrjetit të furnizimit me ujë në qendër qytet Fier,
- Ndërtimi i dhomës së komandimit në hyrje të Fierit (zëvendësim i elementeve hidraulikë komandues)
- Rehabilitim dhe zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë për Zonën Afrim I,
- Rehabilitim dhe zgjerim i rrjetit të furnizimit me ujë për Zonën Bishanak,

Masa që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçencës së këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Në vlerësimin tonë nevojitet që, për të qënë sa më miqësorë me mjedisin, të kontrollohen në mënyrë dinamike sasitë e ujit të prodhuar nga pus-shpimet e Kafarajt (përfshirë këtu edhe puset e shpërndara në NjA-tv e Bashkisë Fier) në varësi të kërkesës për konsum. Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA[388] i cili në mënyrë automatike do të monitorojë nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e më pas po në mënyrë automatike do të udhëzojë pompat në Konjat dhe NjA lidhur me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Figura 152. Zonat e shërbyera nga U.K.-ja Fier.



Burimi: Bashkia Fier & Co-PLAN, 2016

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujërave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave, pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar pët t'u mbyllur.

Gjithashtu një masë tjetër, e cila shkon përkrah atyre që po ndërmerr aktualisht projekti në zbatim pranë Bashkisë Fier për rritjen e efiçencës së sitsemit, ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale, si edhe nivelet kryesore e dytësore të rrjetit të shpërndarjes për konstatim dhe shkëputje të lidhjeve të paligjshme. Kjo masë do të ndikonte duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmonte që sasia e faturuar e ujit të ishte sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve hidraulike në projektim.

Krahas masave të lartpërmendura duhet të theksojmë se Njësitë Administrative Dërmenas, Protëz dhe Mbrostar shfaqin mjaft probleme lidhur me mbulimin e tyre të plotë me këtë shërbim. Objektiv duhet të mbetet zgjerimi i sistemit edhe në këto NjA gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm.

Figura 153. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në Bashkinë Fier.



Burimi: ValuADD, PLGP, Bashkia Fier; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

- ***<u>Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm</u>***

Për sa u përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Shtrirjen jo të plotë të sistemit të furnizimit me ujë për konsum publik në Bashkinë Fier.

- Në zonat ku ofrohet furnizimi me ujë, ka vështirësi për mbulimin e nevojave me ujë gjatë periudhës së verës, kur kërkesa për konsum rritet si pasojë edhe e

përdorimit të këtyre ujërave për vaditje dhe si pasojë e shpërdorimit nga konsumatorë të papërgjegjshëm.

- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacione të vjetëruara, ose të bllokuara (rrjeti shpërndarës funksionon me tubacione gize ndërtuar 70 vite më parë dhe tubacione çeliku me moshë 30-vjeçare).

- Humbjet në sistem aktualisht vlerësohen të jenë midis 40-65% (faktor i cili rrit kërkesën për ujë gjatë verës deri në 210-255 *litra/ditë/banorë*). Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.

- Gjendja jo e mirë e depozitave. Mosha mesatare e këtyre depozitave vlerësohet të jetë mesatarisht 50-vjeçare.

Tabela 93. Gjendja e tubacione të rrjetit shpërndarës.

Fusha e përdorimit	**Gjatësia e tubacioneve (m)**
Rrjeti i Unazave të Qytetit (DN 250-400)	8,200
Rrjeti i Unazave të Qytetit (DN 500-800)	4,800
Totali	**13,000**

Burimi: PLGP/ValuAdd 2015

- **Sistemi i ujërave të ndotura urbane**

Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Fierit dhe thuajse aspak në NjA-të e saj. Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij, si edhe konstruksionit të tubove materiali betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç. Ky sistem është i kombinuar dhe mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura gjithashtu edhe ujërat e larta. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujore sipërfaqësore më të afërta.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura urbane është i tillë që njëkohësisht ai grumbullon ujrat e larta, si edhe shkarkime të ndryshme e të pakontrolluara që ndodhin në kolektorë, apo kanale të hapura dedikuar këtij sistemi.

Zonat Urbane: Sot, Bashkia Fier mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura vetëm një pjesë të popullsisë së qytetit të Fiers, por nuk disponohet një shifër përmbledhëse e saktë si pasojë e mungesës së dixhitalizimit të rrjetit të kanalizimeve në këtë Bashki.

Zonat Rurale: Në zonën rurale të Bashkisë Fier nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura.

Ujërat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive të cilat nuk respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë

shtepiave të tyre e që gjithashtu janë në kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare të largimit të tyre.

Sistemi i ujërave të ndotura për qytetin është i kombinuar, që do të thotë se ujërat e zeza mblidhen së bashku me ujërat e reshjeve (ujërat e bardha). Tubacionet e këtij sistemi janë të përmasave Ø200 - Ø1,000 prej betoni të cilat në gjatësi lineare të kompozuar, së bashku në formën e rrjetit të grumbullimit të këtyre ujërave, arrijnë rreth 29km tubacione dhe kolektorë.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në Bashkinë Fier për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[389]

Ky sistem është ndërtuar rreth viteve 1968 dhe 1980, vite këto që përkojnë me ndërtimin e banesave të reja. Pas viteve '90, nuk është ndërhyrë më në këtë sistem.

Si rrjedhojë, ndërtimet e pas viteve '90 janë të pakontrolluara dhe të paplanifikuara[390] në aspektin e ofrimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizime.

- **Problematikat e rrjetit të kanalizimeve**

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në Bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efiçencë funksionin bazë. Përveç Qytetit të Fierit, pjesa tjetër e Bashkisë nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat ku ky rrjet shtrihet, hasen shume probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar ose i dëmtuar, pa llogaritur ndotjen e ujërave të lumit të Seman dhe kanaleve kullues e vaditës, që shkaktohet nga derdhja e ujërave të ndotura të patrajtuara.

Si përfundim mund të thuhet se në Bashkinë Fier:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm, edhe në vetë zonën urbane në Fier (në qytetin e Fierit ofrohet vetëm në masën 85%).

- Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar, ose është shtrirë në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë standardeve higjieno-sanitare.

- Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndotin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore të kanaleve dhe emisarëve, si edhe kemi shkarkime direkte në ujërat e lumit Seman e Shkumbin.

- Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujrave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare, ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara).

Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura urbane është parashikuar të ndërtohet paralelisht me rehabilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujërave të ndotura. Nevojitet një studim përcjellës për të përcaktuar karakteristikat dhe elementet kryesore ndotës të ujërave në Fier në mënyrë që të përzgjidhet metodologjia dhe teknika më e përshtatshme trajtuese në impiant. Gjithashtu, pozicioni në terren që do të ketë kjo vepër, mbart potencial të konsiderueshëm rreziku ndaj ndotjes së mjedisit për faktin se është shumë pranë trupave ujore sipërfaqësore e njëkohësisht pranë zonave të populluara.

1.7.3 Ndriçimi i mjediseve publike

Në këtë seksion do të analizohet ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik në Bashkinë Fier. Në fillim prezantohen kompetencat ligjore të pushtetit vendor mbi ofrimin e këtij shërbimi. Më pas, kjo ndiqet nga një analizë statisikore e ofrimit të shërbimt të ndriçimit publik ku janë vënë në dukje zonat që kanë sistem të amortizuar të ndriçimit publik, si dhe zonat në të cilat nuk ofrohet ky shërbim. .

Strategjia e Decentralizimit dhe Reforma Administrativo –Territoriale në lidhje me ofrimin e shërbimimeve publike (shërbimi i ndriçimit publik): Me reformën administrative territoriale, nga 374 Komuna dhe Bashki u krijuan 61 Bashki të cilat u formuan si rezultat i bashkimit të disa NJQV-ve. Me reformën administrative territoriale, bashkive të reja iu lindi nevoja të ofrojnë shërbimet publike për një territor më të madh dhe një popullsi më të shumtë në numër. Kjo ndodhi edhe me Bashkinë Fier e cila duhet të ofrojë shërbimin e ndriçimit publik në të gjitha NjA-të përbërësë të saj.

Përsa i përket strategjisë së decentralizimit, ofrimi i shërbimeve publike ku bën pjesë dhe ndriçimi publik, i përket funksioneve të veta të pushtetit vendor të cilat bashkia duhet t'i ofrojë në mënyrë eksluzive në territorin që administron.

Ligji nr 139/2015: Për Vetëqeverisjen Vendore: Në këtë ligj, në nenin 10 pika 3.I.ç thuhet se pjesë e funksioneve të veta të bashkive është dhe ndriçimi i mjediseve publike. Gjithashtu në nenin 16 pika 3 a thuhet se bashkia krijon të ardhura nga tarifat vendore për shërbimet publike që ofrohen. Një ndër këto shërbime publike është dhe ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik.

Ligji nr 9632: Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar: Në këtë ligj në kreun VII për tarifat vendore dhe administrimin e tyre në pikën 2 thuhet se tarifat vendore vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin si dhe rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe vendos nëse këto tarifa mbildhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga agjentë të jashtëm.

Ligji nr 125/ 2013: Për Konçensionet dhe Partneritetin Publik Privat: Në këtë ligj në nenin 4 thuhet se zbatimi i konçensioneve ose i partneriteteve publike private lejohet në shërbime publike të tilla si ndriçimi publik në territorin e njësive vendore. (Kjo pikë është shtuar me ligjin nr 88/ 2014 "për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr 125/2013 Për konçensionet dhe Partneritetin Publik Privat". Pra nisur nga ky ligj ekziston mundësia edhe për të dhënë shërbimin me konçesion tek privati, mjafton që shërbimi i ndriçimit të ofrohet në territor.

Pronësia dhe Administrimi i shërbimit të ndriçimit publik në Bashkinë Fier: Sipas strukturës organizative të Bashkisë Fier në vitin 2015[391] shërbimi i ndriçimit publik administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Komunale e cila ndahet në disa sektorë. Pjesë e kësaj drejtorie është dhe sektori i shërbimt të ndriçimit publik. Ky sektor ka në përbërjen e tij 6 punonjës (1 inxhinier elektrik dhe 5 specialistë të fushës). Sektori ka në pronësi të tij edhe mjete teknologjike ndihmëse për kryerjen e shërbimit si për shembull mjet teknologjik me kosh hidraulik.

Drejtoria e Shërbimeve Komunale që merret me administrimin e shërbimit të ndriçimit publik minimalisht një herë në vit duhet të bëjë inventarizimin e infrastrukturës së ndriçimit publik në tërësi. Analiza e kryer është mbështetur në të dhënat që Bashkia Fier ka mbledhur nga kryerja e inventarëve. Stafi i shërbimit të ndriçimit publik manaxhon mirëmbajtjen e rrjetit që mund të jetë ndërrimi i llambave të djegura, riparimi i shtyllave dhe kabllove të dëmtuara, si dhe riparimi i pajisjeve të tjera elektrike në funksion të ndriçimit publik.

Vendimet mbi buxhetin, strukturën e personelit apo ndryshime të nevojshme mbi administrimin e shërbimit të ndriçimit publik miratohen nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Fier.

- **Ofrimi i Shërbimit të ndriçimit publik**

Objekt i ndriçimit publik mund të jenë akset rrugore për makinë, rrugët e këmbësorëve, sheshet urbane, lulishtet sidhe ndërtesat e institucioneve të ndryshme publike (ndriçimi i jashtëm i tyre). Për momentin Bashkia Fier ofron shërbimin e ndriçimit publik në Qytetin e Fierit si dhe në NjA-të Libofshë, Topojë, Qendër-Fier, Dërmenas, Levan, Frakull, Portëz dhe Cakran, ndërsa në NjA-në Mbrostar ky shërbim nuk ofrohet. Kjo sepse ish-Komuna Mbrostar nuk ka patur investime në këtë fushë dhe nuk ka patur mundësi financiare për ofrimin e këtij shërbimi tek banorët e saj. Në Bashkinë e Fierit në total ka rreth 75 km rrjet rrugor të ndriçuar, në rreth 175 akse rrugore, gjithashtu ka 6 sheshe dhe 3 lulishte të ndriçuara nga shërbimi i ndriçimit publik. Në total janë 2,471 shtylla të ndriçimit publik ku 515 prej tyre janë shtylla betoni, ndërsa 277 prej tyre janë shtylla dekorative. 392

Në seksionin e mëposhtëm do të analizohet sistemi i ndriçimit sipas njësive administrative përbërëse të Bashkisë Fier. Do të evidentohet mbulimi i territorit në përqindje të këtij shërbimi, cilat akse mbulohen në detaj, cilësia e elementëve të sistemit si dhe probleme të tjera lidhur me sistemin.

Në Fier ka në total rreth 35.22 km rrjet rrugor të ndriçuar në rreth 79 akse rrugore. Gjithashtu ekzistojnë rreth 6 sheshe dhe 3 lulishte të ndriçuara nga shërbimi i ndriçimit publik. Në total janë 1,595 shtylla të ndriçimit, ku 337 prej tyre janë shtylla betoni që janë në administrim të OSHE, 277 prej tyre janë shtylla të ndriçimit dekorativ si dhe 9 prej tyre janë shtylla me ndriçim LED. Numri i kokave të ndriçimit ose i llambave është 2,108 ku 16 prej tyre janë llamba të ndriçimit LED.

Figura 154. Rrjeti rrugor i ndriçuar, Bashkia Fier.



Burimi: Bashkia Fier, Përgatiti: Co- PLAN, 2016

Në Qytetin e Fierit kemi rreth 33.6 % të rrjetit rrugor të ndriçuar çka është një tregues i ulët përsa i përket raportit ndërmjet rrugëve të ndriçuara dhe të pa ndriçuara. Vlen të përmendet se akset kryesore të qytetit janë të ndriçuara ndërsa akset të cilat janë të pa ndriçuara janë akset sekondare dhe terciare. Ky sistem punon rreth 4,000-4,200 orë në vit që do të thotë rreth 11-11.5 orë në ditë

Nuk ka informacion se në cilat vite janë bërë investimet në ndriçimin e rrjetit rrugor por gjendja e këtij sistemi duket përgjithsisht e amortizuar përveç investimeve të reja siç është rruga e re këmbësore në afërsi të qendrës së Bashkisë, që është pajisur me ndriçim të ri dekorativ dhe disa rrugeve të tjera që kanë patur investime të reja. Ka patur disa projekte për përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi, por këto projekte nuk janë zbatuar. Reth 25-30% e sistemit të llambave janë të fikura si pasojë e problemeve me pagesën e energjisë elektrike. Kjo sjell reduktimin e cilësisë së ofrimit të

shërbimit. Ka disa akse rrugore në të cilat vërehen probleme me mosfunksionimin dhe amortizimin e sistemit të ndriçimit.. Akset të cilat përbëjnë probleme të mosfunksionimit të ndriçimit publik janë:

Rruga "Harrulla Bozdo": Në këtë rrugë ndriçimi nuk punon në një gjatësi prej rreth 350 m me një numer rreth 10 shtyllash në të dyja anët e rrugës. Këto shtylla janë të palidhura me sistemin elekrik sepse është dëmtuar sistemi i lidhjes, si dhe ka shtylla të cilave iu mungon koka e ndriçuesit.
Rruga "Skënderbeu": Në këtë rrugë sistemi i ndriçmit publik nuk punon në një gjatësi prej 380 m. Janë rreth 15 shtylla jashtë funksionit të cilat nuk janë të lidhura me kabllo, i cili është dëmtuar si dhe në disa raste evidentohet dhe dëmtimi i kokave të ndriçuesve.
Rruga "Brigada IX Sulmuese": Sistemi i ndriçimit publik në këtë rrugë nuk funksionon në një gjatësi prej 410 m, ku 16 shtylla janë jashtë funksionit si pasojë e dëmtimit të shtyllave dhe dëmtimit të kokave të ndriçimit të tyre.
Unaza e Qytetit (pjesa juglindore e saj): Në këtë aks rrugor sistemi i ndriçimt publik nuk funksionon në një gjatësi prej 360 m ku 9 shtylla nuk funksionojnë si pasojë e dëmtimit të kabllos së lidhjes si dhe dëmtimit të kokave të ndriçimit.[393]

NjA Libofshë: Në njësinë administrative Libofshë, ndriçimi publik ofrohet vetëm në dy fshatrat kryesorë. Në total kemi një numër prej 27 shtyllash të cilat janë shtylla betoni të administruara nga OSHE-ja. Duhet të përmendet se këto shtylla janë të gjitha jashtë funksionit si pasojë e dëmtimit të tyre dhe të kabllove të cilat lidhen me sistemin elektrik.

NjA Topojë: Në këtë njësi administrative, të gjithë fshatrat kanë ndriçim publik. Në total ka një numër prej 234 shtyllash. Këto shtylla janë shtylla metalike me gjatësi të ndryshme dhe kryesisht kanë nga një kokë ndriçimi. Vlen të theksohet se rreth 133 shtylla të sistemit të ndriçimit janë në funksion, pjesa tjetër është jashtë funksionit si pasojë e mungesës së kabllos lidhëse me kabinat elekrike. Raportohet se ka një mungesë prej 1,550 m kabllo që lidh shtyllat me kabinat elektrike.

NjA Qender Fier: Në këtë njësi, shërbimi i ofrimit të ndriçimi publik ofrohet në të gjithë fshatrat. Në total ka një numër prej 258 ndriçuesish, ku rreth 45% e tyre nuk janë në funksion. Arsyet e mos unksionimit janë mungesa e kabllos, dëmtimi i kokave të ndriçuesve si dhe të shtyllave.

NjA Levan: Në Njësinë Administrative Levan shërbimi i ndriçimit publik ofrohet në 7 nga 13 fshatrat e njësisë. Në total ka 147 ndriçuesa nga të cilët 23 nuk janë në gjendje pune për arsye të mungesës së kabllove lidhëse si dhe dëmtimit të shtyllave.

NjA Dërmenas: Në Njësinë Administrative Dërmenas shërbimi i ndriçimit publik ofrohet vetëm në 3 fshatra: Dërmenas, Darzezë dhe Pojan. Në total kemi rreth 102 shtylla nga të cilat 27 janë në gjendje pune. Duhet theksuar se ne fshatin Pojan ofrohet shërbimi i ndriçimit publik por sistemi nuk funksionon si pasojë e problemeve me kontratat e energjisë elektrike.

NjA Frakull: Në këtë njësi shërbimi i ndriçimit publik ofrohet vetëm në fshatin Frakull. Në këtë fshat ka në total rreth 25 shtylla. Këto shtylla ofrojnë shërbimin në një gjatësi prej 1 km dhe janë të gjitha në funksionim.

NjA Portez: Në këtë njësi administrative ndriçimi publik ofrohet vetëm në fshatin Portëz, në një gjatësi prej 750m, ku ka 21 shtylla.

NjA Cakran: Në këtë njësi administrative ndriçimi publik ofrohet vetëm në fshatin Cakran në një gjatësi prej 200 m dhe ka rreth 10 shtylla të cilat nuk janë në funksionim si pasojë e dëmtimit të kabllit dhe dëmtimit të shtyllave dhe kokave të ndriçuesve.[394]

Tabela 94. Kostot energjisë elekrike në raport me kostot totale të ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik.

Viti	2011	2012	2013
Kostot e energjisë elektrike në lekë	22,349,746	23,939,328	20,578,736
% e kostove të energjisë elekrike ndaj kostove totale	75.1%	79.3%	75.8%
Kostot totale në lekë	29,761,666	30,176,728	27,150,136

Burimi: Bashkia Fier, 2016

Në këtë tabelë vërehet se pjesën më të madhe të kostove e përbëjnë kostot e energjisë elektrike të cilat janë mjaft të larta. Në vitin 2011 kostot e energjisë elektrike janë 75% të totalit, në vitin 2012 rriten në 79.3% të totalit, më pas në vitin 2013 ulen në 75.8 % të totalit. Në këtë situatë duhet thënë se kostot e energjisë elekrike janë shumë të larta. Sa më të larta që të jenë këto kosto aq më pak mundësi do të kenë sektorët e tjerë për thithjen e fondeve për shembull sektori i mirëmbajtjes së rrjetit dhe mundësia për investime të reja në këtë shërbim.

Përsa i përket sektorit të të ardhurave në ofrimin e shërbimit të ndriçimit publik, në vitin 2012 këto të ardhura vlerësohen në 5,800,000 lekë. Të ardhurat mbulojnë rreth 19.2% të kostove totale dhe 24.2 % të kostove të energjisë elektrike të këtij shërbimi, që janë shifra mjaft të ulëta. Kjo vjen si pasojë e nivelit të ulët të arkëtimit të tarifave për ndriçimin. Pjesën tjetër të kostove të këtij shërbimi bashkitë detyrohen ta mbulojnë nga arkëtimi i tarifave apo taksave të tjera.

- ***<u>Përfundime</u>***

Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik hyn ndër funksionet e veta të pushtetit vendor si dhe bashkitë kanë të drejta eksluzive mbi ofrimin e këtij shërbimi në territoret e tyre. Gjithashtu Këshilli Bashkiak vendos mbi kriteret e ofrimit të këtij shërbimi.

Në Bashkinë e Fierit ky shërbim ofrohet në Qytetin e Fierit, në NjA-të Libofshë, Topojë, Dërmenas, Qendër-Fier, Portëz, Cakran, Frakull dhe Levan, ndërsa në NjA-në Mbrostar ky shërbim nuk ofrohet.

Në total në Bashkinë Fier ka rreth 75 km rrjet rrugor të ndriçuar rreth 175 akse rrugore me 2,471 shtylla ndriçimi. Në këtë bashki ka gjithashtu 6 sheshe dhe 3 lulishte të ndriçuara.

Në Qytetin e Fierit ka rreth 35.2 km rrugë të ndriçuara me rreth 33.6 % e rrjetit rrugor të ndriçuar që do të thotë se është një statistikë e ulët në raport me rrjetin e përgjithshëm rrugor. Në qytet ka rreth 1,595 shtylla nga të cilat 50 janë jashtë funksionit dhe nuk punojnë. Vlen të përmendet që ndriçimi publik në Qytetin e Fierit në disa zona është i amortizuar dhe jo cilësor. Kjo vjen si pasojë e dëmtimit të kabllove lidhëse si dhe dëmtimit të kokave të ndriçimit dhe llambave.

Përgjithësisht në njësitë administrative ky shërbim ka problematika më të mëdha se në qytetin e Fierit. Në NjA-në Libofshë ky shërbim ofrohet vetëm në 2 nga fshatrat e NjA-së. Në total ka 27 ndriçues dhe të gjithë janë jashtë funksionit. Në NjA-në Topojë ky shërbim ofrohet në të gjithë fshatrat e NjA-së. Ka një numër prej 234 ndriçuesish por rreth 43 % e këtij rrjeti është jashtë funksionit. Po ashtu në NjA-në Qendër-Fier ky shërbim ofrohet në të gjithë fshatrat, por rreth 45% e rrjetit të ndriçimit publik nuk funksionon. Në NjA-në Levan shërbimi i ndriçimit publik ofrohet në 7 nga 13 fshatrat dhe rreth 15 % e rrjetit është jashtë funksionit. Në NjA-në Dërmenas ky shërbim ofrohet vetëm në 3 fshatra dhe rreth 25 % e rrjetit është jashtë funksionit. Në NjA-në Frakull ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Frakull i Madh. Në NjA-në Portëz ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Portëz si dhe në NjA-në Cakran ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Cakran me një numër shumë të vogël ndriçuesish.

Kyesisht problematikat kyesore të mosfunksionimit të rrjetit të shërbimit të ndriçimit në NjA-të janë dëmtimi i kabllos lidhëse ndërmjet ndriçuesve dhe kabinave elektrike si dhe dëmtimi i shtyllave dhe i kokave të ndriçimit. Një problem tjetër për NjA-të është dhe pamundësia e shlyerjes së kostove të energjisë elekrike.

Përsa u përket kostove dhe të ardhurave për ofrimin e këtij shërbimi vërehet se pjesa më e madhe e kostove të këtij shërbimi janë kostot e energjisë elektrike dhe se të ardhurat janë në një nivel mjaft të ulët, rreth 19.2% të kostove totale dhe rreth 24.2% të kostove të energjisë elekrike. Kjo situatë do të thotë që niveli i arkëtimit të tarifave të ndriçimit është mjaft i ulët dhe për të ofruar këtë shërbim, Bashkisë Fier i duhet të akordojë fonde shtesë. Në këtë situate, kur fondet shkojnë për pagesat e faturave të energjisë elektrike kemi më pak fonde që shkojnë për mirëmbajtjen ose dhe për investime të reja.

1.7.4 Mbetjet e ngurta

- **Manaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Fier**

Bashkia Fier ofron shërbimin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta për 72%[395] të popullsisë së Bashkisë Fier, ku respektivisht Nj.A-të Mbrostar dhe Qendër e ofrojnë këtë shërbim për 100% të popullësisë së tyre, pjesërisht Nj.A-të Protëz, Levan, Libofshë dhe Topojë, ndërsa Nj.A-ja Dermenas mbeten jashtë skemës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve duke gjetur zgjidhje alternative aspak miqësore me mjedisin.

Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve të shpërndara në funksion të dendësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore dhe transportimi i tyre drejt vend-depozitimit si edhe stokimit të tyre përfundimtar. Manaxhimi i mbetjeve të ngurta kryhej rregullisht nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike nën administrim e vetë Bashkisë ndërsa Nj.A-ja Levan deklaron se këtë shërbim e ka patur të kontraktuar.

Në lidhje me sasinë e mbetjeve të gjeneruara, sipas të dhënave të deklaruara nga të gjitha njësitë administrative, Bashkia e re Fier gjeneron rreth 131 ton/ mbetje në ditë ose 919 ton/javë. Sipas këtyre të dhënave, norma mesatare e gjenerimit të mbetjeve në ditë llogaritet të jetë 1.1 kg/banorë/ditë mbetje në nivel territori të ri të Bashkisë. Ndërkohë vetë qyteti i Fierit e ka normën e gjenerimit të mbetjeve 1 kg/banorë/ditë mbetje deri në 1.4 kg/banorë/ditë mbetje, ndërkohë zonat tjera rurale kanë një normë gjenerimi prej 0.6 kg/banorë/ditë mbetje.

Duhet theksuar se mbetjet nuk grumbullohen në të gjithë territorin e Bashkisë Fier. Vetëm qyteti i Fierit, NjA-të Mbrostar dhe Qendër mbulojnë 100% popullsinë me shërbimin e mbetjeve (Tabela x). Në njësitë e tjera, përqindja e popullsisë e cila mbulohet me shërbim varion nga 5% (Cakran) – 74% (Topojë. Njësia Dërmenas deklaron se nuk e ofron këtë shërbim në territorin e saj).

Figura 155. Grafiku i ofrimit të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Fier



Burimi: Bashkia Fier, Përgatiti: Co-Plan[396], 2016

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Gjatë vitit 2015, Bashkia Fier ka prodhuar rreth 45,000 ton mbetje[397], me një sasi prodhimi prej **0.4 ton/banor/vit[398]**. Sasia e mbetjeve të prodhuara ka ardhur duke u rritur nga viti në vit (Tabela 57). Nga një krahasim i bërë për periudhën kohore 2003-2015 rezulton se sasia e mbetjeve të prodhuara nga viti 2003 në vitin 2015 është thuajse pesëfishuar (0.08 ton/banor/vit në vitin 2003, kundrejt 0.4/ton/banor/vit në vitin 2015). Për më tepër, në vitin 2014, sasia e mbetjeve të prodhuara për banor në vit në Bashkinë Fier ka tejkaluar paksa mesataren e sasisë së podhuar në rang vendi. Megjithatë, duhet theksuar se prej vitit 2014 e në vazhdim tendenca rritëse e gjenerimit të mbetjeve ka mbetur konstante, projeksion i cili vazhdon edhe në pasqyrimin e të dhënave për vitin 2015 si edhe në parashikimet për vitet që do të pasojnë.

Tabela 95. Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Bashkinë Fier dhe në rang vendi.

Mbetjet Urbane Fier– Projeksion (ton/banor.vit)							
Viti	**2003**	**2006**	**2009**	**2012**	**2014**	**2015**	**Viti**
Fier	0.08	0.207	0.218	0.36	0.3	0.4	***ton/ban***
Mesatare gjenerimi për banorë në R.SH	0.118	0.241	0.292	0.392	0.253	0.315	***ton/ban***

Burimi: Instat & ARM Fier

Figura 156. Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Fier.



Burimi: Instat & ARM Fier

- **Venddepozitimi i Mbetjeve**

Në lidhje me vend-depozitimet e mbetjeve, aktualisht qyteti i Fierit, Nj.A Komuna Mbrostar, Nj.A Komuna Portëz, Nj.A Qendër dhe Nj.A Komuna Topojë, i depozitojnë mbetjet në vend-depozitimin e qytetit të Fierit, 3km larg qendrës së qytetit. Makinat e bashkisë Fier ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve vetëm në zonat që janë të pajisura me kontenierë si Nj.A-të Mbrostar, Portëz, Qendër, dhe Topojë. Mbetjet urbane depozitohen në afërsi të qytetit, në aksin e hyrjes nga Tirana, 3km nga qendra e qytetit. Ky vend-depozitim ka mbi 40 vjet që është në përdorim dhe është në një gjendje alarmante, pasi mbetjet aty nuk kalojnë në asnjë proces trajtimi. Një pjesë e mbetjeve përfundojnë në ujrat e lumit Seman, ku degë të tij kalojnë buzë vend-depozitimit. Aktualisht, ky vend-depozitim përbën një zonë të nxehtë mjedisore, e cila duhet të mbyllet dhe të rehabilitohet sa më shpejt.

Sipërfaqja e vend-depozitimit të mbetjeve është rreth 5.2 ha. Mbetjet shkarkohen në terren të hapur dhe hera-herës digjen. Trajtimi dhe eliminimi i tyre ende është shumë problematik, pasi kjo fushë është në përdorim prej më shumë se 40 vitesh, shumë pranë vijës ujore të Vijës së Ngjalës, ku toka është argjilore pa kullim dhe e parrethuar. Mjetet teknologjike që hyjnë në fushën e depozitim kanë shumë vështirësi në hyrje dhe dalje, pasi infrastruktura është e papërshtatshme. Mbetjet të cilat

mbërrijnë në vend-depozitim depozitohen në formë kavaletash me anë të dy mjeteve mjaft të amortizuara.

Njësia administrative Libofshë i depoziton mbetjet në dy fusha depozitimi të autorizuara. Konkretisht, këto fusha ndodhen në Agim tek brezi i argjinaturës, dhe në Ndërmenas.

Njësitë e tjera administrative përdorin disa vend-depozitime të improvizuara, të papërshtatshme, jashtë kushteve higjieno-sanirate, të cilat janë kthyer në zona të nxehta mjedisore. Në rastin e njësisë Cakran mbetjet nuk hidhen në asnjë vend të caktuar, vetëm përgjatë anëve të rrugëve të njësisë.

Në territorin e Bashkisë Fier aktualisht nuk ka asnjë impiant për trajtimin e mbetjeve, por nga qeveria Shqiptare pritet së shpejti të ndërtohet landfill-i për rajonin e Fierit. Kur ky projekt të jetë gati atëherë, të gjitha njësitë në territorin e bashkisë do t'i depozitojnë mbetjet në këtë landfill, dhe vend-depozitimet ekzistuese do të duhet të rehabilitohen me kalimin e kohës.

Figura 157. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi në harkun kohor 2005-2015



Burimi: Bashkia Fier & Co-Plan, 2015

- **Pikat e Grumbullimit**

Me përjashtim të qytetit të Fierit, njësisë Libofshë dhe njësisë Qendër, asnjë nga njësitë e tjera nuk deklaron të ketë pika grumbullimi mbetjesh të pajisura me kontenierë. Aktualisht mbetjet depozitiohen në fusha të hapura, ku një pjesë e tyre janë të autorizuar (*por nuk mund të marrin më autorizim mjedisor*) si në qytetin e Fierit (1), Nj.A Portëz (1), Levan (1), Libofshë (2) dhe Topojë (5). Në njësitë e tjera administrative mbetjet kryesisht depozitohen në vende të hapura, buzë rrugës, apo buzë luginave të lumenjve (janë identifikuar rreth 13 vend-depozitime të paautorizuara).

Ndonëse shërbimi kryhet rregullisht dhe sipas një standardi të caktuar vetëm në qytetin e Fierit, nga të dhënat e mbledhura nga njësitë administrative, ato deklarojnë se ofrojnë shërbimin në njësinë e tyre me një frekuencë të caktuar, e cila në shumë

raste nuk është e rregullt, duke shkaktuar shpesh herë probleme me situatën mjedisore, pasi mbetjet në pikat e grumbullimit mund të qëndrojnë disa ditë pa u evaduar.

Duke qënë se Bashkia Fier është faktori kryesor në zonën strategjike për manaxhimin rajonal në qarkun Fier, ndërtimi i landfilli-t dhe pikave të transferimit për këtë Bashki duhet të parashikojë manaxhimin sa më efiçent të këtij proçesi si edhe të zgjidhë problemin e pikave të paligjshme të grumbullimit dhe ndotjen e mjedisit.

Figura 158. Foto nga vend-depozitimi i mbetjeve Fier

Burimi: Arkiva Co-Plan

Duke patur referencë hartat dhe raportet e SHGJSH-së[399], akuiferi i Vjosës në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier deri në deltën e lumit në bregdet, është me përbërje aluvionale (zhavorrore dhe poroze) ku përcjellshmëria dhe koefiçenti i infiltrimit të ujërave është mjaft i lartë. Ndryshe paraqitet situata sa i përket akuiferit të Lumit Seman ku kemi të bëjmë me toka të cilat kanë përbërje aluvionale me rëra dhe alevorite ku përcjellshmëria është mesatare. Vend-depozitimi aktual ndodhet mbi këtë akuifer dhe kufizohet në Veri dhe Perëndim prej Lumit Gjanica & Vijës së Ngjalës.

Një terren i tillë bën të mundur depërtimin e shllamit të mbetjeve në ujërat e lumit Gjanicë dhe Vijës së Ngjalës për t'u infiltruar më tej në ujërat e akuiferit të Fierit, i cili përdoret për furnizimin me ujë të popullsisë së zonave përreth por impakt direkt ka edhe mbi cilësinë e ujërave që përdoren në bujqësi. Ndotja është edhe më e theksuar në kohë reshjesh të cilat përshpejtojnë depërtimin e ujërave sipërfaqësore në akuiferin e Fierit.

Ndotje shkaktohet edhe nga çlirimi i gazrave toksike (metani CH_4) si produkt i procesit të kompostimit të shtresave më të vjetra të mbetjeve organike dhe jo vetëm. Ky produkt kimik, në formën e tij të gaztë mund të kapej me anë të skemave të rikuperimit ku do të përpunohej e të ofrohej si një LDG (Lëndë Djegëse Gaz) për të prodhuar enegji elektrike ose mekanike. Në rastin e vend-depozitimit Fier, gazi metan, çlirohet i gjithi në atmosferë duke kontribuar si gaz i efektit serë gjithashtu duke ndotur me aromën e tij të fortë.

Gjithashtu, nëpërmjet fotove ajrore, janë vënë re ndryshime në shtrirjen dhe hapësirën që ka marrë ky vend-depozitim gjatë periudhës 2005-2015. Këto ndryshime të forta në shtrirjen që ka zënë ky vend-depozitim kanë ndryshuar edhe mikrotipologjinë e truallit ku ndodhet ky vend-depozitim brenda një harku kohor 5-10-vjeçar. Përveç ndotjes së ujit, vend-depozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë.

- **Mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi)**

Sa i përket mbetjeve inerte është vlerësuar se në vitin 2009 janë gjeneruar 8,400-9,000 ton mbetje ndërtimore të depozituara në mënyrë të diferencuar në fushën e mbetjeve Fier. Gjithashtu këtu mund të përmendim se një sasi e konsiderueshme mbetjesh është gjeneruar gjatë ndërtimit të rrugës automobilistike By-Pass Fier (në proces ndërtimi) dhe autostradës Levan – Vlore (inaguruar në 2012). Këto mbetje inerte janë depozituar fillimisht në vend-depozitimet stacionare për t'u ripërdorur më pas për mbushje ose transferuar në fushën e mbetjeve Fier.

Aktualisht si gjenerues të mbetjeve inerte mund të përmendim ndërhyrjet infrastrukturore që po ndodhin në Bashkinë Fier si, Rehabilitimi i Ujësjellës Kanalizime Fier dhe ndërhyrjet për rrjetin nëntokësor të transmetimit të energjisë elektrike.

Figura 159. Grafiku i gjenerimit të mbetjeve inerte në vite, Bashkia Fier krahasuar me mesataren në Republikën e Shqipërisë



Burimi: INSTAT, Punoi: Co-PLAN

Gjenerues të mbetjeve inerte jane identifikuar edhe vete bizneset e regjistruara në Bashkinë Fier si edhe banoret e saj. Zhvillimi urban dhe infrastrukturor me ndërhyrjet e kryera deri me tani në kuadër të rritjes së cilësisës së jetës dhe përmirësimeve, kanë qenë një nga kontribuesit kryesorë të kësaj rryme të mbetjeve duke shkaktuar jo pak herë probleme me trajtimin e këtyre mbetjeve.

Kryesisht mbetjet jo-Bashkiake janë nën përgjegjësinë manaxhuese të vetë gjeneruesit. Roli i vetëm i bashkisë është të përcaktojë një vend-grumbullim të përkohshëm për këto mbetje për sa kohë është edhe afati i lejes ndërtimore të subjektit.

Gjatë vitit 2015, Bashkia Fier ka prodhuar një sasi mbetjesh prej 7,217 ton, të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet si dhe prishjet e objekteve pa leje. Deri më sot, Bashkia nuk ka një vend-depozitim të posaçëm për depozitimin e mbetjeve inerte.

Zonat problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në Bashkinë Fier janë kryesisht pikësore, të lokalizuara në hapësira fushore, kodrinore si edhe përgjatë brigjeve të lumit Seman, Vjosë e Gjanicë si edhe disa pjesë të argjinaturës së lumit janë të mbuluar me mbetje inerte dhe dallohen qartësisht seksione ku shtrati i lumit është shfrytëzuar pa kriter për nxjerrje inerti[400].

Zona ripariane e anëve të lumit dikur e mbjellë me pemë dhe vegjetacion mbrojtës, sot është thuajse tërësisht e zëvendësuar nga masive inertesh ose mure mbajtëse b/a. Këto ndërhyrje nuk e kanë ndaluar erozionin anësor të lumit, veçse e kanë zhvendosur atë në seksione të tjera më të ndjeshme.

Aktualisht, Bashkia Fier po operon me hapa galopante në përmirësimin e hapësirës publike dhe efiçencës infarastrukturore të saj. Kjo ka sjellë një rritje të normës së gjenerimit të mbetjeve të ndryshme inerte të cilat do të reflektohen në raportin e ardhshëm të gjendjes në mjedis.

- **Mbetjet Spitalore**

Sipas të dhënave të grumbulluara nga ARM-ja & Bashkia Fier, sasia totale e vlerësuar për mbetjet spitalore të prodhuara në Fier është rreth 32 ton/vit[401]. Mbetjet prodhohen nga 135[402] subjekte (tabela 58). Kjo sasi përfshin mbetjet e prodhuara nga Spitalet, qendrat shëndetësore, si dhe laboratoret stomatologjike dhe mjekësore.

Mbetjet spitalore manaxhohen nga subjektet private, të cilat i tërheqin mbetjet periodikisht sipas kontrates se lidhur me organet shëndetësore. Kompania duhet të ofrojë shërbimin e sterilizimit dhe grirjes së mbetjeve spitalore të paktën dy herë në javë. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjetet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Më parë mbetjet trajtoheshin nga spitali rajonal i Fierit, ndërsa në lidhje me njësitë e tjera nuk ka informacione të sakta për ofrimin e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në zonat e tyre, mënyra e ofrimit, infrastruktura për grumbullimin dhe transportin dhe trajtimin final të tyre.

Tabela 96. Prodhuesit e mbetjeve spitalore

Kategoria	Fier
Depo Farmaceutike	5
Farmaci	75
Klinikë Dentare	33
Klinikë Mjekësore	4

Laboratore	12
Qendra Shëndetësore	2
Spitale	4
Total	135

Burimi: RGJMS 2015

- **Mbetjet Industriale**

Qyteti i Fierit ka numrin më të madh të bisneseve të regjistruar në Bashki (530 bisnese të mëdha dhe 1,860 bisnese të vogla). Ndërkohë në lidhje me numrin e turistëve, vetëm NjA-ja Dërmenas deklaron se ka një numër prej relativisht 17,000 turistësh në vit në pjesën bregdetare të saj.

Gjithashtu vlen të theksohet se Industria kryesore e Bashkisë Fier është ajo e Naftës dhe Kimike, të pozicionuara e të shpërndara në të gjithe territorin e Bashkisë. Duke pasur një pasuri të tille si fushat naftëmbajtëse më të mëdha në Europë (Patos-Marinza), kjo i ka dhënë hov të fuqishëm zhvillimit të industrive përpunuese të naftës dhe kimikateve. Aktualisht në Fier kapacitetet përpunuese të rafinerive nuk i kalojnë Þ=20% rendiment si edhe industria e plehrave kimike momentalisht nuk është aktive. Stoku i materialeve ndotëse të shpërndara përreth Bashkisë vlerësohet të jetë i lartë dhe në nivele kritike lidhur me impaktin e tij direkt në shëndetin publik.

Mbetjet e gjeneruara nga industria e naftës në Marinzë dhe rafinerisë në Ballsh, derdhen direkt në lumin Gjanicë duke e transformuar atë në një nga transportuesit më të mëdhenj të mbetjeve industriale në vend. [403]

Tabela 97. Aktivitete gjeneruese të mbetjeve në Bashkinë Fier, sipas lejeve që posedojnë[404]

	Aktiviteti	Vendndodhja	Subjekti	Kategori	Tipi Mbetjeve te Gjeneruara	Leja
1	Magazinim & tregtim solari. Fabrikë e prodhimit të emulsioneve bituminoze.	Sheqi Madh / Fier	**Alb-Impex sh.p.k**	6, 5, 4	Mbetje të dala nga rafinimi naftës, pastrimi i gazit natyror dhe trajtime pirolotike të karbonit. Mbetje të kimise minerale dhe procese të kimise organike	B
2	Ndërtim & funksionim i impiantit termik me gaz të lëngshëm.	Ngjale / Fier	**ASG Poëer S.A**	13, 10	Mbetje nga proceset termike & Mbetje të karburanteve të lëngshme	A
3	Shfrytëzim dhe prodhim hidrokarburi.	Cakran / Fier	**Stream Oil & Gas LTD**	1, 5, 13	Mbetje nga kërkimi dhe shfrytëzimi, mbetjet nga rafinimi i naftës, pastrimi gazit natyror, mbetje të karburanteve të lëngshme.	A
4	Nxjerrje nafte.	Patos-Marinëz / Fier	**Bankers Petrolium**	1, 5, 13	Mbetje nga kërkimi dhe shfrytëzimi, mbetjet nga rafinimi i naftës, pastrimi gazit natyror,mbetje të karburanteve të lëngshme.	A
5	Magazinim & përpunim i nënprodukteve të naftes	Mrostar / Fier	**Resuli-ER sh.a**	20, 13, 5, 6	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme, mbetje nga rafinimi i naftës dhe pastrimi i gazit natyror. Mbetje të kimisë organike	C
6	Shfrytezim me puse - vendburim Gazi	Frakull / Fier	**ALBPETROL sh.a**	1, 5, 13	Mbetje nga kërkimi dhe shfrytëzimi, mbetjet nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror, mbetje të karburanteve të lëngshme.	A
7	Shfrytezim me puse - Vendburim Gazi	Dremenas / Fier	**ALBPETROL sh.a**	1, 5, 13	Mbetje nga kerkimi dhe shfrytezimi, pastrimi gazit natyror,mbetje te	A

					karburanteve te lengshme.	
8	Depozitë e gazit të lëngshëm & nafte	Drizë / Fier	**MARE OIL sh.a**	20, 13	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme.	B
9	Depozitë karburanti	Fier	**A & A Oil 10 sh.a**	20, 13	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme.	B
10	Linjë tubacioni naftësjellës	Fier - Vlorë	**Albania Pipeline Sevice sh.a**	20, 16	Mbetje industriale, mbetje të paspecifikuara në listë	A
11	Puse kërkimi	Topojë / Fier	**Bankers Petrolium**	20, 13	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme,	A
12	Depozita shitblerjeje karburanti dhe hidrokarbure të rënda, përpunim nafte bruto dhe reshpës bituminoze, riciklim i mbetjeve të naftës, mbetjeve urbane dhe të plastikës.	Protëz / Fer	**EDIPAK 3 sh.p.k**	20, 13, 5, 6	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme, mbetje nga rafinimi i naftës dhe pastrimi i gazit natyror. Mbetje të kimisë organike	B
13	Karrierë Lumore	Vjosv / Fier	**ADF Rromes sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i minerave & karreierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/ gërmime	B
14	Karrierë lumore	Vjosë / Fier	**Albjon sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
15	Karrierë lumore	Seman / Fier	**A.D.S sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
16	Karrierë lumore	Voribop / Fier	**EPIC D.S sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
17	Karrierë lumore	Sheqi Madh / Fier	**Fortis - 2 sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
18	Fabrikë Tullash	Sheqi Madh / Fier	**Fortis - 2 sh.p.k**	16, 17	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara ne listë.	
19	Karrierë lumore	Cakran / Fier	**General Beton**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
20	Karrierë lumore	Cakran / Fier	**T-Zyka sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
21	Karrierë konglomerati	Kafarj / Fier	**Construction Albania Enterprise sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
22	Karrierë lumore	Cakran / Fier	**Jogi sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
23	Karriere Lumore	Cakran / Fier	**5-Vellezerit sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
24	Shfrytezim Rere	Frakull / Fier	**Albjon sh.p.k**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B
25	Prodhim asfalti & betoni	Frakull / Fier	**CASAVECCHIO**	1, 17	Mbetje që dalin nga shfrytëzimi i Minerave & Karrierave, si edhe trajtimet fiziko-mekanike të materialeve. Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime	B

26	Linjë prodhimi betoni dhe Impiant Fraksionimi Inertesh	Protëz / Fer	**Beton E.G Fier**	16, 17, 6, 10	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë. Mbetje të kimisë minerale. Mbetje nga proceset termike	B
27	Shfrytëzim rëre bituminoze	Protëz / Fer	**BRACK KAPPA**	20, 13, 5, 6	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme, mbetje nga rafinimi i naftës dhe pastrimi i gazit natyror. Mbetje të kimisë organike	B
28	Fabrikë Tullash	Protëz / Fer	**SEMANI sh.p.k**	16, 17	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë.	B
29	Shfrytëzim rëre bituminoze	Protëz / Fer	**RAKIPI sh.p.k**	20, 13, 5, 6	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme, mbetje nga rafinimi i naftës dhe pastrimi i gazit natyror. Mbetje të kimisë organike	B
30	Linjë për prodhim të betonit, asfaltobetonit, magazinim të lëndës së parë, tregtim, import-eksport të tyre dhe njësi shërbimi në funksion të aktivitetit (furnizim me karburant, riparim, rregullim të automjeteve,lavazh, bar-restorant, zyra administrative)	Drizë / Fier	**SPARTAKU sh.p.k**	16, 17, 6, 10, 20	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë. Mbetje të kimisë minerale. Mbetje nga proceset termike. Mbetje urbane dhe industriale.	B
31	Landfill për mbetjet me përmbajtje arseniku	Ish-Azotiku / Fier	**METE**	6, 7, 16	Mbetje të industrisë minerare, mbetje të proceseve të kimise oganike, mbetje të paspecifikura në listë.	B
32	Përpunim i mbetjeve urbane për qëllime riciklimi	Fier	**Recolight sh.p.k**	16, 20	Mbetje të paspecifikuara në listë & mbetje urbane përfshi fraksionet e mbledhura veçmas.	B
33	Gropë ekologjike për magazinimin e mbetjeve vajore të ngurta dhe të lëngta	Mbrostar / Fier	**Bankers Petrolium**	13	Mbetje vajrash dhe mbetje e karburanteve të lëngshme	B
34	Manaxhim i mbetjeve urbane të riciklueshme dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane tv qytetit të Fierit	Sheqi Madh / Fier	**ABA 2011 sh.p.k**	6, 7, 16,13	Mbetje të industrisë minerare, mbetje të proceseve të kimise oganike, mbetje të paspecifikura në listë. Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme.	B
35	Gropë ekologjike për magazinimin e mbetjeve hidrokarbure	Kuman / Fier	**Bankers Petrolium**	13	Mbetje vajrash dhe mbetje e karburanteve të lëngshme	B
36	Grumbullim dhe magazinim të mbetjeve të hidrokarbureve dhe mbetjeve industriale.	1 Maji Fier	**GS GREEN STANDART sh.p.k**	20, 13	Mbetje industriale, mbetje karburantesh të lëngshme, mbetje nga rafinimi i naftes dhe pastrimi i gazit natyror.	B
37	Rehabilitim të mjedisit të puseve, grumbullim, etiketim, transportim, tranzitim të mbetjeve të lëngta, të ngurta, të ndotura me hidrokarbure të naftës bruto dhe pikë shërbimi për automjete në funksion të kësaj veprimtarie.	Patos-Marinëz / Fier	**Mimoza GJANI**	16, 17, 6, 10, 20	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë. Mbetje të kimisë minerale. Mbetje nga proceset termike. Mbetje urbane dhe industriale.	B
38	Fermë pulash	Libofshë / Fier	**Ferro sh.p.k**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B
39	Pulari	Protëz / Fer	**Hoxhaj sh.p.k**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B
40	Pulari	Mbrostar / Fier	**ALB BACE sh.p.k**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B

41	Import, magazinim dhe tregtim Freoni (R-22)	16 Prilli / Fier	**KEDO sh.p.k**	14, 16	Tretës të mbetjeve organike ftohes & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
42	Mulli bluarje. Prodhim mielli	Mbrostar / Fier	**Abdurramani sh.p.k**	20, 2	Mbetje urbane përfshirë fraksione të tjera. Mbetje që dalin nga përpunimi ushqimit	B
43	Prodhim vajrash vegjetale	11 Janari / Fier	**Vajra Bimore sh.a**	2, 13	Mbetje që dalin nga përpunimi ushqimit, mbetje vajrash	B
44	Import, magazinim dhe tregtim Freoni (R-22)	15 Tetori / Fier	**VILSON DHIMA**	14, 16	Tretës të mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
45	Fabrikë Polisteroli	Mbrostar / Fier	**ROVER 08 sh.p.k**	14, 16	Tretës të mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
46	Shpime pusesh testim	Seman / Fier	**Bankers Petrolium**			A
47	Rritje intensive e shpendëve në instalim, therje, përpunim, ambalazhim dhe magazinim i nënprodukteve të tyre.	Levan / Fier	**Altin Sadikaj**	1, 5, 13	Mbetje nga kërkimi dhe shfrytëzimi, mbetjet nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror,mbetje të karburanteve të lëngshme.	B
48	Importim, depozitim dhe tregtim gazi freon-ftohes (R22)	Ish-Uzina e pambukut	**AMIS sh.p.k**	14, 16	Tretës të mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
49	Importim, depozitim dhe tregtim gazi freon-ftohës (R 22)	Apollonia / Fier	**AVA sh.p.k**	14, 16	Tretës tv mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
50	Rritje intensive e shpendëve në instalim, therje, përpunim, ambalazhim dhe magazinim i nënprodukteve të tyre.	Protëz / Fer	**DRIZA sh.p.k**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B
51	Riveshje e gomave të përdorura	Fier	**Nuhaj sh.p.k**	15, 8, 20	Mbetje të ripërdorimit të materialeve, mbetje nga fabrikimi dhe shpërndarja e lëndëve veshëse & mbetje industriale	B
52	Përpunim i mbetjeve urbane për qëllime riciklimi	Mbrostar / Fier	**Recolight sh.p.k**	20, 16		B
53	Import i 32 toneve gazi ftohës HCFC 22, CHCF2Cl (R134A)	19 Nëntori / Fier	**AVA sh.p.k**	14, 16	Tretës te mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
54	Përpunim tekstilesh, lavanderi, lyerje dhe përdorim i detergjenteve industriale	Kryengritje / Fier	**BLUE SKY sh.p.k**			B
55	Import, magazinim dhe tregtim Freoni (R-22)	29 Nentori / Fier	**AVA sh.p.k**	14, 16	Tretës te mbetjeve organike ftohës & pompues. Mbetje të paspecifikuara në listë	B
56	Impiant per përpunimin dhe riciklimin e vajrave lubrifikante të përdorur dhe mbetjeve të hidrokarbureve.	Fier	**Resuli-ER sh.a**	16, 20	Mbetje te paspecifikuara në listë & mbetje urbane përfshi fraksionet e mbledhura veçmas.	B
57	Rehabilitim të puseve, grumbullim etiketim, transportim, tranzitim të mbetjeve të lëngshme, të ngurta, të ndotura me hidrokarbure të naftës bruto dhe pikë shërbimi për automjete në funksion të kësaj veprimtarie.	Fier	**ALB-STAR sh.p.k**	16, 17, 6, 10, 20	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë. Mbetje të kimisë minerale. Mbetje nga proceset termike. Mbetje urbane dhe industriale.	B

58	Impiant për trajtimin e mbetjeve të naftës Albpetrol të vendosura në "Qafën e Stefanit" për shndërrimin e tyre në Lëndë Djegëse Alternative të Ngurta (LDAN) dhe transportimin e LDAN-it për t'u bashkëdjegur në fabrikën e çimentos	Fier	**ANTEA - CEMENT sh.a**	16, 17, 6, 10, 20	Mbetje inerte nga ndërtimi/prishja/gërmime. Mbetje të paspecifikuara në listë. Mbetje të kimisë minerale. Mbetje nga proceset termike. Mbetje urbane dhe industriale.	B

	Mbetje organike
	Mbetje inerte
	Mbetje industriale

Burimi:ARM Fier

Çdo muaj, vlerësohet se shkarkimet në lumin Gjanicë rreth 12.57 – 12.91 m^3 ujra të patrajtuara dhe produkte të naftës ku ka rezultuar se përqëndrimi i naftës në këto ujëra shkon CC=0.2-6mg/l.[405] Fabrikat tashmë jo-aktive të nitratit në Fier stokojnë mbetje kancerogjene shumë të rrezikshme të cilat nëpërmjet drenimit të ujërave të shiut derdhen në akuiferin e lumit Gjanicë. Janë rreth 850m^3 arsenik të groposura jo në kushtet teknike më optimale.

Si mbetje industriale me potencial ndotës mund të klasifikojmë edhe Ujërat e Ndotura Urbane të cilat përmbajnë solucione dhe kimikate të ndryshme të përdorura nga njësitë familjare, si edhe shkarkime të ndryshme të bizneseve private. Këto ujëra të ndotura të cilat grumbullohen nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, janë identifikuar të shkarkohen direkt në Gjanicë në më shumë se 2 pika të ndryshme.

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre aktiviteteteve prodhojnë mbetje të rrezikshme dhe si të tillë janë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve nëpërmjet Ligjit 10463 dt. 22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet rigorozisht të monitorohen, regjistrohen dhe transportohen siç përshkruhet në ligj.

Mbetjet Elektronike

Rregullat për trajtimin dhe kasifikimin e mbejteve E.E nuk parashikojnë depozitimin e tyre në landfill. Pra aktualisht Bashkia Fier duke qenë se të gjitha objektet apo materialet e klasifikuara si mbetje i manaxhon duke i transportuar dhe stokuar në Vend-depozitimin Fier, lind nevoja që të ndërtohet një qendër për trajtimin e diferencar të kësaj rryme.

Gjenerues të këtyre mbetjeve janë si familjarët ashtu edhe bizneset private që operojnë në Bashkinë Fier. E vetmja mënyrë për të arritur manaxhimin e mbetjeve tek ata dhe jo mbetja tek konteinieri është nëpërmjet realizimit të një plani specifik të manaxhimit për këtë rrymë dhe aktivizimi i fushatave sensibilizuese.

- **Mbetje të tjera**

Ndër mbetjet e tjera mund të klasifikojmë:

- mbetjet nga gomat e përdorura,
- mbetjet nga karkasat e makinave,
- mbetjet nga vajrat e përdorur etj.

Edhe këto rryma të identifikuara, siç ndodh me mbetjet EE nuk diferencohen apo të trajtohen por grumbullohen së bashku me mbetjet urbane dhe derdhen në vend-depozitimet e përcaktuara.

Diferencimi në burim si edhe trajtimi i seleksionuar sipas parimit Redukto – Ripërdor – Riciklo është sfida më e madhe që parashtrohet në Bashkinë Fier, sfidë e cila vjen paralelisht me rehabilitimin e zonave të ndotura nga depozitimi jashtë kushteve teknike të mbetjeve deri më sot.

Në funksion të gjeneruesëve të identifikuar si edhe atyre potencialë nevojitet që të merren masa për trajtimin e mbetjeve me origjinë industriale, pra mbetjeve me potencial rreziku të lartë. Duke qenë detyrim ligjor i adresuar, vetë prodhuesit, qoftë nga Ligji Nr. 9537, datë 18.05.2006 por edhe nga Leja Mjedisore që ata posedojnë, Bashkia Fier mund të asistojë në përcaktimin e një pozicioni ku këto mbetje do të depozitohen dhe trajtohen të diferencuara.

- **Riciklimi**

Ndërkohë në asnjë nga njësitë administrative nuk deklarohet të ketë patur iniciativa për riciklimin apo kompostimin e mbetjeve në territoret e tyre. Megjithatë qyteti i Fierit në kuadër të një projekti me Ambasadën Hollandeze, në vitin 2010, prezantoi skemën për grumbullimin e mbetjeve me tre kosha dhe dërgimin e mbetjeve të riciklueshme në pikën e grumbullimit pranë vend-depozitimit të mbetjeve.

Në territorin e bashkisë së Fierit operojnë katër kompani ricikluese, dy prej të cilave riciklojnë mbetje urbane. Njëra (ABA 2011 Sh. p. k.) është e vendosur në Sheq të Madh, pranë shtratit të Lumit Gjanica dhe tjetra (RECOLIGHT Sh. p. k.) në afërsi të fshatit Portëz, sërish pranë shtratit të Lumit Gjanica. Kompania për riciklimin e metaleve (PIU - ECO Sh.p.k.) vendoset në afërsi të bashkimit të Lumit Seman me Lumin Gjanicë, shumë pranë shtratit të Lumit Seman, ndërsa kompania për riciklimin e vajrave dhe produkteve të tij (TOT - TRADING IN OIL & TRANSPORT) ndodhet në qytetin e Fierit në afërsi të zonës industriale[406].

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Fier (territori pas reformës), jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT-it për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 1-1.4 kg[407]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Fierit. Sasia e gjeneruar në qytetin e Fierit, në zonën urbane, arrin vlera 1,392-3,381 ton/vit për km² [408].

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e Bashkisë Fier është përafërsisht

83.3%, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 46%, 15% plastika dhe 15% letra[409]. Procesi i riciklimit është i ndërlikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj që të realizohet ky proces.

Referuar informacioneve të mbledhura nga Bashkia Fier, njësia vazhdon grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku sasinë më të madhe të mbetjeve e zë rryma e plastikës së trashë me 73ton/vit mbetje të grumbulluar, e shoqëruar nga plastika e hollës me 62ton/vit dhe më pas letra dhe kartoni 16ton/vit.[410]

- ***Përfundime***

Fillimisht Bashkia Fier ka nevojë për të përditësuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë[411].

Vend-depozitimi në veri të qytetit, duke u kufizuar nga dy rrjedha sipërfaqësore si lumi Gjanicë dhe Kanali i Madh, kombinuar kjo edhe me elementët e sigurisë të cilët mungojnë në këtë sit përbën pikërisht një vatër të nxehtë mjedisore për Bashkinë Fier. Shpeshtitë e prurjeve maksimale qoftë të lumit Gjanicë apo edhe nga rreshjet e denduara kanë përmbytur seksione të caktuara të këtij venddepozitimi. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:

- Emetimet e gazrave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme.
- Shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore.
- Infiltrimi i shllameve nga dekompozimi mbetjeve në akuiferin e Fierit.

Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të lumit Gjanicë dhe kanalit të madh si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për manaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) administrohen nga subjekte private në varësi të kushteve kontraktuale. Monitorimi i këtyre kontratave në terren paraqet mangësi pasi janë identifikuar shkarkime industriale në zonat ku janë puset aktive të naftës, vërehen emetime të gazrave në atmosferë prej impianteve të përpunimit të naftës si edhe shkarkime të ndryshme identifikuar gjatë vizitave në terren.

Skema të ndryshme të 3R (Reduktim – Riciklim – Ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në Bashkinë Fier. Faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti Rom & Egjiptian në Fier. Fushata dhe projekte pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili mund të ripërdoret sërish në bujqësi.

Projekti për ndërtimin e landfill-it rajonal në Bashkinë Fier paraqet një iniciativë pozitive për manaxhimin e mbetjeve në tërësi. Duke qënë i pozicionuar pranë brigjeve

të Lumit Gjanicë dhe krahas masave paraprake të marra për mbrojtjen mjedisore nga impaktet që do të ketë ky impiant nevojitet që monitorimi mbi të të jetë i shpeshtë.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, pranë qytetit të Fierit përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të adoptojë bashkia e Fier për manaxhimin e integruar të mbetjeve. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Fier.

1.7.5 Sistemi i kullimit dhe ujitjes

Analiza e këtij seksioni është zhvilluar në bazë të të dhënave dhe materialeve satistikore dhe hartografike që disponojmë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si dhe janë perpunuar nga Co-PLAN-i. Materiale të tjera janë përdorur edhe nga Bordi i Kullimit të cilat i kemi përfshirë në dokument.

Ky seksion do të vlerësojë gjendjen ekzistuese të infrastrukturave të bujqësisë në Bashkinë Fier. Me infrastrukturë bujësore kuptohet tërësia e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorisë, si dhe të gjitha veprat inxhinerike me funksion të bujqësisë si për shembull: argjinaturat, rezervuaret ujitëse, digat, stacionet e pompimit dhe hidrovoret [412].

Në fillim do të shpjegohet mënyra e funksionimit të infrastrukturës bujqësore, më pas do të analizohet legjislacioni si dhe kompetencat mbi administrimin e infrastrukturave bujqësore si dhe analizimi më i detajuar i rezervuareve dhe agjinaturave të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Fier. Së fundmi do të vlerësohet gjendja ekzistuese e kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorive të tyre.

Infrastruktura bujqësore kryesisht përbëhet nga rrjeti i kanaleve që janë të ndara në kanale vaditëse dhe kulluese. Kanalet vaditëse kanë funksion që të bëjnë shpërndarjen e ujit të domosdoshëm në parcelat bujqësore Kanalet vaditëse ndahen në tre kategori: kanale të parë, të dytë dhe të tretë. Kanalet e parë janë kanalet kryesorë të cilët e çojnë ujin nga rezervuarët drejt tokave të cilat do të vaditen më pas shpërndarja e ujit kalon nga kanalet e para në të dyta dhe në fund në kanalet e tretë.

Kanalet kulluese janë kanalet që bëjnë mbledhjen e ujit të tepërt të parcelave bujqësore dhe e çojnë atë drejt lumenjve, liqeneve ose detit. Këto kanale janë po aq të rëndësishme sepse e mbrojnë tokën bujqësore nga përmbytjet. Kanalet e treta kulluese mbledhin ujin nga parcelat e vogla dhe çojnë atë në kanalet sekondare ose të dyta e më pas në kanalet kryesore që e çojnë ujin në lumenj ose në dete.

Argjinaturat janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës bujqësore sepse bëjnë mbrojtjen e tokave bujqësore nga vërshimet e lumenjve. Gjithashtu rezervuarët janë vend-depozitimet e ujit të cilat janë të lidhura kryesisht me kanalet kryesore vaditëse dhe shërbejnë si ushqyes kryesorë të ujit me të cilin vaditen tokat bujqësore.

- **Korniza ligjore mbi kullimin dhe vaditjen**

Ligji nr. 8518 datë 30.07.1999 " Për ujitjen dhe kullimin" i ndryshuar me ligjin nr. 9860 datë 21.01. 2008: Ky ligj përcakton Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si organ kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe kullimit.

Manaxhimi i skemave të kullimit dhe të vaditjes bëhet nga njësi më të vogla që janë Bordet e Kullimit të cilat ndodhen në çdo qark me perjashtim të Lushnjës që ka bord kullimi të veçuar.

Në nenin 56 (në pikën ç) përcaktohen distancat e ndërtimit të objekteve të përdorimeve të ndryshme në raport me infrastrukturën bujqësore (kanalet vaditëse dhe kulluese). Distanca minimale që lejon ligji për ndërtimin e objekteve ne raport me kanalet kryesore është tetë metër ndërsa distanca minimale që lejon ligji në raport me kanalet dytësore dhe tretësore është katër metër.

Bordet e Kullimit janë struktura teknike të specializuara në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.691, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020" propozon ndryshime lidhur me kompetencat e njësive administrative vendore të cilat tashmë do të kenë nën administrimin e tyre edhe manaxhimin e rrjetit dytësor dhe tretësor të sistemeve kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin , nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit". Në këtë vendim propozohet që bashkive t'iu transferohet e drejta e manaxhimit dhe administrimit të infrastrukturës bujqësore dytësore dhe tretësore, asetet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe makineritë e rënda nga Bordet e Kullimit tek bashkitë në territorin e të cilave ndodhen këto infrastruktura.

Kalimi i manaxhimit te infrastrukurës bujqësore nga Bordet e Kullimit tek bashkitë pritet të ketë efekte pozitive në sektorin bujqësor.

- **Analiza e argjinaturave dhe e rezervuarëve ujitëse në Bashkinë e Fierit**

Në Bashkinë Fier në total kemi rreth 76.8 km argjinaturë ku 30.8 km ndodhen në dy anët e kanalit të parë kullues të Kosharës ndërsa 43.3 km ndodhen në dy anët e lumit Seman gjithashtu në pjesën jugperendimore të bashkisë ndodhet argjinatura e lumit Vjosë me një gjatësi prej 2.7 km.

Tabela 98. Vëllimi dhe gjendja e teknike e rezervuarëve në Bashkinë Fier.

Emri i ujëmbledhësit	Vëllimi i ujit në 1000 m^3	Gjendja e trupit të digës	Gjenda e shkarkuesit	Gjendja e ujëlëshuesit

Kurjan	25,500	e mirë	funksional	funksional
Lalar	490	e mirë	funksional	funksional
Libofshë	348	e mirë	funksional	funksional
Frakull e Vogël	617	e mirë	funksional	funksional
Zharrëz	1,390	e mirë	i dëmtuar	funksional
Levan	40	e mirë	i dëmtuar	i bllokuar

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe e Administrimit të Ujrave, 2016

Rezervuarët të cilët kanë impakt më të madh në skemat e rrejtit vaditës të Bashkisë Fier janë Rezervuarët e Kurjanit (që ndodhet jashtë kufinjve administrativë të Bashkisë Fier), Libofshës, Frakullës së vogël dhe Levanit. Rezervuarët e Lalarit dhe Zharrëzës kanë impakt më të vogël sepse lidhen me skema më të vogla ujitëse. Peshën kryesore të ujitjes e përmban Rezervuari i Kurjanit i cili është dhe më i madhi përsa i përket vëllimit të ujit dhe për nga gjendja teknike është plotësisht funksional. Rezervuarët me problematikë për nga gjendja teknike janë rezervuarët e Zharrëzës dhe të Levanit.

Figura 160. Infrastruktura bujqësore sipas llojit të kanaleve.



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Përpunuar nga Co-PLAN, 2016

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të kanaleve bujqësore: Në hartën e mëposhtme është paraqitur rrjeti i infrastrukturës bujqësore të Bashkisë Fier. Dallohet qartë që zona bujqësore në këtë bashki ka një shtrirje të gjerë si pasojë e terrenit fushor. Gati të gjitha njësitë administrative kanë toka bujqësore me përjashtim të NjA-ve Cakran, Frakull, Levan dhe Libofshë që kanë dhe zona kodrinore të cilat nuk janë të pajisura me kanale vaditëse ose kulluese. Në këtë hartë janë paraqitur kryesisht kanalet e dyta dhe të para vaditëse dhe kulluese, ndërsa për kanalet e treta disponohet shumë pak informacion. Kanalet kryesore janë: Kanali i Hoxharës, Kanali Vjosë-Levan-Fier, Kanali Bregdetar i Majtë, Kanali Bregdetar i Djathë, Kanali i Kënetës, Kanali i Martinës dhe Kanali i Kalinorës. Këto kanale kryesisht janë në gjendje të mirë por kanë nevojë për pastrime të herëpashershme. Problemi kryesor janë kanalet e dyta, në pjesën më të madhe të tyre këto kanale janë pjesërisht të bllokuar ose të bllokuar plotësisht kjo vjen si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes së këtyre kanaleve.

Tabela 99. Infrastruktura bujqësore sipas llojit, kategorisë dhe gjendjes në Bashkinë Fier në km linearë.

	Gjatësia në km linearë	% ndaj Totalit
Lloji i Kanaleve		
Kulluese	616.2	73.48%
Vaditëse	222.4	26.52%
Total	838.6	100.00%
Kanalet sipas kategorisë		
Kanale të parë	322.2	38.42%
Kanale të dytë	449	53.54%
Kanale të tretë	67.4	8.04%
Total	838.6	100.00%
Gjendja e kanaleve		
Të lirë	350	41.74%
Për mirëmbajtje	418.6	49.92%
Të bllokuar	70	8.35%
Total	**838.6**	**100.00%**

Burimi: Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Përpunuar ngaCo-PLAN2016

Në Bashkinë Fier nga të dhënat që janë marrë në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave rrjeti i infrastrukturës bujqësore vlerësohet të jetë rreth 837 km linearë, ku 26.5 % janë kanale vaditëse dhe 73.5 % janë kulluese. 38.4% janë kanale të parë, 53.5 % janë kanal të dytë dhe 8.1 % janë kanale të tretë. Gjendja ekzistuese e kanaleve paraqitet jo shumë e mirë, rreth 41.8 % e kanaleve janë te lirë, 50% e tyre kanë nevojë për pastrime dhe mirëmbajtje dhe 8.2% e tyrë janë të bllokuar plotësisht. Për të patur një rrjet plotësisht të mirëmbajtur duhet të pastrohet dhe rehabilitohet rreth 60 % e rrjetit i cili ka nevoja urgjente për ndërhyrje.

- ***Përfundime***

Nga analizimi i gjendjes ekzistuese duhet të thuhet se situata e gjendjes teknike e rezervuareve paraqitet jo e mirë. Rezervuarët në të cilët ka nevojë për rehabilitime janë rezervuarët e Zharrëzës dhe të Levanit. Gjithashtu nga analizat e mësipërme, kanalet kullues dhe vaditës të dytë paraqesin problematikën më të madhe. Këto kanale në pjesën më të madhe të tyrë janë të bllokuar nga inerte dhe mbetje bujqësore. Gjthashtu vërehet se rrjeti i kanalizimeve bujqësore ka nevojë të rehabilitohet në masën 60 % të tij.

1.8 Strehimi

Qëllimi i kësaj analize është të kuptuarit e gjendjes aktuale të strehimit në Bashkinë e Fierit, si dhe përcaktimin e disa kritereve bazë nëpërmjet të cilave do të bazohen dhe rekomandimet për zgjidhjen e nevojave përmes PPV-së. Bazuar mbi analizën e gjëndjes ekzistuese si dhe standardet orientuese të vendosura nga legjislacioni sektorial përkatës (VKM Nr.502), është bërë dhe përcaktimi i kritereve të cilat do të meren parasysh gjatë hartimit te rekomandimeve të çështjeve të strehimit.

Për të bërë këtë analizë duhet bërë përzgjedhja e kritereve treguese të gjendjes ekzistuese të cilat i vijnë në ndihmë analizës së strehimit, si dhe përcaktimin e kritereve që ndikojnë në zhvillimin territorial për qëllime banimi në të ardhmen. Kritere të cilat janë përcaktuar si më poshtë:

- popullsia për njësi administrative (ekzistuese dhe e pritshme);
- sipërfaqe ndërtimi për qëllime banimi / banor (ekzistuese dhe e propozuar);
- numri mesatar i kateve (ekzistuese dhe e propozuar);
- koefiçenti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim (ekzistuese dhe e propozuar)
- koefiçenti i shfrytëzimit të tokës për infrastrukturë (ekzistuese dhe e propozuar);

Standardet e shërbimeve të ofruara brenda njësive të banimit si:

- gjelbërim (m^2 / banor);
- zona sportive (m^2 / banor);
- sipërfaqe parkimi (m^2 / banor).

Konkretisht nëpërmjet përcaktimit të intervaleve apo vlerave mesatare që do të ketë secili nga kriteret e cituara më sipër do të ndihmojë në parashikimin e nevojave për strehim për zonat e reja te banimit, si dhe parashikimin e shërbimeve për zonat ekzistuese të banimit.

Bazuar në të dhënat e regjistrimit te përgjithshëm të popullsisë si dhe në trendin që kanë pësuar treguesit demografikë (si lindshmëria, vdekshmëria, emigracioni dhe popullsia), popullsia e Fierit ka pësuar ulje. Ndarja e re administrative ka dyfishuar numrin e popullsisë së Bashkisë Fier i cili në fillim të vitit 2015 shkoi në 122,000 banorë, ndonëse të dhënat e bashkisë raportojnë 200,000 banorë. E shprehur në përqindje rreth 46% e popullsisë është e përqendruar kryesisht në qytetin e Fierit, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në 9 njësitë administrative të saj (Çekran, Çlirim Qëndër, Dërmenas, Frakull, Levan, Libofshë, Mbrostar, Portëz, dhe Topojë). Numri total i popullsisë për këtë qark ka pësuar rënie nga viti në vit, sikundër rënia e

popullsisë totale por edhe rënia e popullsisë në pjesën më të madhe të qarqeve të tjera të vendit (me përjashtim të qarqeve Tiranë dhe Durrës).

Tabela 100. Sipërfaqet e ndërtimit për qëllime banimi sipas Njësive Admninistrative të Bashkisë Fier.

Njësia Administrative	Sipërfaqe ndërtimi (m2)	Nr. i popullsisë	m^2/Banor
Cakran	731015	11722	62.36261647
Dërmenas	870674	7788	111.7968359
Fier	3269611	55845	58.54796301
Frakull	377778	6820	55.39259658
Levan	988860	8159	121.1986352
Libofshë	472013	6149	76.76258877
Mbrostar	632826	7460	84.82928417
Portëz	509730	8259	61.7180754
Qendër	427116	2673	159.7889458
Topojë	453447	4246	106.7939497

Burimi: Bashkia Fier, dhe llogaritje të autorëve

Ndarja e funksioneve të territorit të Bashkisë Fier nuk është plotësisht e dedikuar tek një kategori e vetme përdorimi toke, pasi nga analiza e kryer evidentohen edhe mbivendosje të përdorimeve. Këto mbivendosje kanë të bëjnë kryesisht me përdorimet: banim-bujqësi, bujqësi-industri, natyrore-banim dhe banim-shërbime. Sipas statistikave nga harta e përdorimit ekzistues të tokës rezulton se rreth 3.4% e territorit të Bashkisë Fier klasifikohet si territor me funksion banimi.

Mbivendosja e përdorimeve banim-bujqësi është e përhapur pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë së re. Urbanizimi i tokës bujqësore në formën e lagjeve dhe fshatrave është një dukuri mjaft e përhapur, raste në të cilat është e thjeshtë të bëhet ndarja mes Kategorisë A - Banim dhe B - Bujqësi. Por ka edhe raste të urbanizimit të tokës bujqësore në mënyrë të shpërhapur, për të cilat është përdorur kategoria e përzier Banim dhe Bujqësi. Mbivendosja e përdorimeve “bujqësi dhe industri” është e vendosur kryesisht në zonat bujqësore, të cilat tashmë janë kthyer në zona të shfrytëzimit të naftës. Kështu mund të përmendim rastin e tokave bujqësore në Kallm të Madh dhe të Vogël si dhe në zonën jugore të njësisë administrative Portëz. Mbivendosja e përdorimit “natyrore-banim” vihet re më së shumti në njësinë administrative Cakran, ku relievi kodrinor i saj ka detyruar banorët të ndërtojnë njësi banimi shumë pranë zonave natyrore.

Konkretisht territore banimi përgjithësisht përbëhen nga banesa 1-2-3 katëshe dhe janë në formën e “shpërhapjeve” urbane përgjatë rrugeve të cilat perfundojnë në ambientin rural. Gjithashtu kemi praninë e territoreve banimi me skelet urban të formuar nga ndërtime 4-5 katëshe por me ndërhyrje të forta ndaj strukturës hapësinore origjinale. Zakonisht ndërtimet që formojnë këtë skelet urban formojnë fasadat e rrugëve kryesore të qytetit. Karakteristikë është kontrasti midis hapësirave të jashtme të krijuara nga ndërtimet fasadë të skeletit urban origjinal (4-5 katëshe) dhe

hapësirave të brendshme, të cilat janë një përzierje kaotike e ndërtimeve shumëkatëshe të reja me ato 1-3 katëshe të para dhe pas viteve '90.

Bashkia propozon të përdoren për qëllime strehimi edhe 158 ish vend-strehimet (nga të cilat 20 janë te papërdorshme), përsëri numri i tyre do të ishte i pamjaftueshëm për të zbutur situatën e të pastrehëve në qytet. Kjo shtron nevojën që plani i ri rregullues i Fierit të trajtojë problemin e strehimit si pjesë integrale e tij. Për momentin e vetmja ofertë në tregun e strehimit është tregu privat i cili nuk është i përballueshëm për numrin më të madh të popullsisë të cilët si alternativë zgjedhin ndërtimin pa leje në zona informale. Perveç shesheve të ndërtimit të cilat do te vihen në dispozicion të Entit Kombetar të Banesave, plani i ri rregullues duhet të identifikojë edhe mekanizmat e nevojshëm për gjenerimin e fondeve si p.sh.: mekanizmat e mbështetjes së tërthortë të familjeve me të ardhura më të ulëta, kthimin në asete me vlera ekonomike të banesave të ndërtuara në zona informale, pasi të kryhen studimet urbanistike pjesore dhe të identifikohen mundësitë për pajisjen e tyre me infrastruktura dhe shërbime. Kjo do të rriste ndjeshëm vlerën e këtyre banesave në tregun e strehimit. Plani i ri rregullues duhet të përdoret si një instrument në ndihmë të rregullimit të situatës së strehimit ne qytet.

Strehimi social

Aktualisht në bashki numri i personave aplikues në programet e strehimit me kushte të lehtësuara është rreth 100 banorë në vit. Kjo përfshin aplikimet për banesa me kosto të ulët, pra me kredi të lehtësuar, si dhe banesa sociale me qera, në varësi të ofrimit të programeve të strehimit social vit pas viti. Përgjithësisht më pak se ½ e familjeve aplikante përfitojnë nga këto skema, në varësi të kritereve të programit. Gjithsesi vërehet një tendencë e rritjes së numrit të familjeve përfituese, nga 35 në vitin 2010 në 76 në 2013.

Tabela 101. Përfituesit e programeve të strehimit social, 2010-2013

	2010	**2011**	**2012**	**2013**
Banesa me kosto të ulët				
Familje Aplikante	85	103	107	125
Familje Përfituese	35	52	38	76
Banesa sociale me qera				
Familje Aplikante	-	-	233	-
Familje Përfituese	-	-	96	-

Burimi: Bashkia Fier

Për vitin 2015 pranë Bashkisë Fier kanë aplikuar për status të pastrehë 69 familje, pra rreth 0.2% e popullsisë.

1.9 Përdorimi i tokës, sistemet dhe strukturimi i territorit

1.9.1 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Analiza e përdorimit të tokës është hartuar nga grupi i punës pas dixhitalizimit të gjendjes aktuale të përdorimit të tokës në bazë të vizitave në terren, imazheve satelitore, punës me specialistë inxhinierë dhe topografë të njësive administrative të

Bashkisë Fier dhe informacioneve të tjera të vëna në dispozicion nga administrata e kësaj bashkie.

Leximi i territorit u krye fillimisht duke identifikuar sistemet territorial ekzistuese në Bashkinë Fier, sipas përcaktimeve të VKM nr. 671 "Për miratimin e rregullores së Planifikimit të Territorit", neni 73, ku përcaktohen 5 sisteme territoriale:

- Sistemi Urban (U)
- Sistemi Natyror (N)
- Sistemi Bujqësor (B)
- Sistemi Ujor (U)
- Sistemi Infrastrukturor (IN)

Nga analiza e sistemeve territoriale ekzistuese në bashkinë e Fierit rezulton se rreth 70% e sipërfaqes së kësaj bashkie e përbën sistemi bujqësor dhe 20% ai natyror. Sistemi urban përqendrohet kryesisht në qytetin e Fierit, ndërkohë që vërehen tendencat e zgjerimit të tij në formë gishtore drejt akseve rrezore në pjesën veri-perëndimore dhe perëndimore. Po ashtu, zhvillime lineare të sistemit urban vërehen edhe në pjesën veriore të bashkisë, përgjatë rrugës nacionale Lushnje-Fier, në njësitë administrative Levan dhe Frakull po përgjatë kësaj rruge, në njësinë administrative Portëz përgjatë rrugës ndërqytetëse Fier-Patos, si dhe rrëzë sistemit kodrinor të njësisë administrative Cakran. Sistemi urban vërehet të jetë më i ndërthurur me sistemin bujqësor në pjesën perëndimore të bashkisë, ku sidomos në njësitë administrative të Qendrës, Dermenasit dhe Topojës vërehen prirje të shpërhapjes së këtij sistemi në sistemin bujqësor. Sistemi infrastrukturor gjendet gjithmonë i ndërthurur me sistemin urban, me një raport dukshëm më të lartë në qytetin e Fierit, përkundrejt njësive të tjera administrative. Sistemi natyror vërehet i pranishëm kryesisht pranë zonave të mbrojtura, si Pishë-Poro dhe Pylli i Levanit, si dhe përgjatë tre lumenjve që përshkojnë këtë bashki. Fashat natyrore përgjatë lumenjve ngushtohen në momentin e ndërthurjes së sistemit natyror me atë urban, fenomen që vërehet më së shumti në qytetin e Fierit, ku tendencat e urbanizimit përgjatë lumit kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqes së sistemit natyror, si dhe në njësitë administrative të Mbrostarit dhe Portëzës, ku aktivitetet me karakter industrial pranë lumit Seman janë shtrirë edhe pranë fashës natyrore të këtij lumi.

Tabela 102. Sistemet Urbane

Sistemet	%
Sistemi Urban	5.98%
Sistemi Bujqesor	70.18%
Sistemi Natyror	20.56%
Sistemi Hidrografik	1.58%
Sistemi Infrastrukturor	1.70%
Fieri Total	100.00%

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Leximi i territorit të bashkisë u krye nëpërmjet kategorive dhe nënkategorive bazë të përdorimit të tokës, sipas përcaktimeve të VKM nr. 671 "Për miratimin e rregullores së Planifikimit të Territorit", neni 77, të cilave iu shtuan edhe 3 kategori të tjera bazë "Miks banim", "Miks shërbime" dhe "Miks i më shumë se 2 kategorive".

Figura 161. Sistemet e territorit



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Figura 162. Përdorimi i tokës i shprehur në sipërfaqe



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

Kategoria bazë "Bujqësi": Në këtë kategori bëjnë pjesë territore të cilat kanë si destinacion përdorimi bujqësinë. Këtu nuk bëjnë pjesë vetëm tokat bujqësore të kultivuara por edhe ato jo të kultivuara si dhe serat, kanalet ujitëse dhe infrastruktura të tjera bujqësore. Tokat bujqësore shtrihen pothuajse në të gjitha territoret e njësive administrative përbërëse të Bashkisë Fier. Të mbjellat në këtë toka bujqësore janë të ndryshme sipas stinëve, por kryesisht mbizotërojnë të mbjellat frutore dhe perimeve të stinës, në pjesën fushore, si dhe vreshtaria dhe ullishtat në relievet kodrinore të Frakullës, Cakranit dhe Libofshës.

Kategoria bazë "Banim": Në këtë kategori bën pjesë e gjithë sipërfaqja e territorit, e cila përdoret për arsye banimi. Sipas statistikave nga harta e përdorimit ekzistues të tokës rezulton se rreth 3.4% e territorit të Bashkisë Fier klasifikohet si territor me funksion banimi.

Kategoria bazë "Shërbime": Kjo është një kategori e përdorimit të tokës, e cila është e pranishme në një nivel më të ulët krahasuar me gjithë kategoritë e tjera të përdorimit të tokës. Kjo kategori është e përqendruar pothuajse në të gjitha qendrat ekonomike dhe të shërbimeve të njësive administrative, por shtrirja më e madhe e kësaj kategorie vihet re përgjatë territorit të qytetit të Fierit.

Kategoria bazë "Natyrore": Në këtë kategori janë klasifikuar zonat natyrore të mbrojtura ose jo, siç janë pyjet, zonat e shkurreve, kullotat, livadhet, tokat pa frute dhe monumentet e natyrës.

Kategoria bazë "Infrastrukturë": Në këtë kategori janë përfshirë infrastrukturat rrugore, hekurudhore, sipërfaqet e rezervuara për menaxhimin e mbetjeve urbane, infrastruktura mbitokësore të ujësjellës/kanalizime dhe transmetim e shpërndarje energjie.

Kategoria bazë "Industri dhe Ekonomi": Në këtë kategori janë përfshirë aktivitete si industri e rëndë, e lehtë, përpunuese, kimike, ushqimore, magazinime industriale si dhe nxjerrje dhe përpunim i materialeve të ndërtimit. Këto zona janë më tepër të përhapura në njësitë administrative Levan, Mbrostar, Fier, Qendër, Portëz dhe Dërmenas.

Kategoria bazë "Ujëra": Në këtë kategori janë përfshirë sipërfaqet ujore të rezervuarëve dhe lumenjve. Kjo kategori zë një sipërfaqe prej 16.62 km².

Kategoritë bazë "Arsim, Shëndetësi, Institucione": Të tre këto kategori së bashku zënë rreth 18% të territorit të Bashkisë Fier duke marrë në konsideratë dixhitalizmin e institucioneve publike, shërbimeve sociale kulturore, institucioneve të arsimit parashkollor, arsimit të ulët, arsimit të lartë, bibliotekave, qendrave spitalore, qendrave shëndetësore, ambulancave, farmacive, poliklinikave, etj.

Kategoria bazë "Banim i përzier", "Shërbime të përziera" dhe "të tjera të përziera": Megjithatë, ndarja e funksioneve të territorit të Bashkisë Fier nuk është plotësisht e dedikuar tek një kategori e vetme përdorimi toke, pasi nga analiza e kryer evidentohen edhe mbivendosje të përdorimeve. Këto mbivendosje kanë të bëjnë kryesisht me përdorimet: banim-bujqësi, bujqësi- industri, natyrore-banim dhe banim-shërbime.

Mbivendosja e përdorimeve banim-bujqësi është e përhapur pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë së re. Urbanizimi i tokës bujqësore në formën e lagjeve dhe

fshatrave është një dukuri mjaft e përhapur, raste në të cilat është e thjeshtë të bëhet ndarja mes Kategorisë A. Banim dhe B. Bujqësi. Por ka edhe raste të urbanizimit të tokës bujqësore në mënyrë të shpërhapur, për të cilat është përdorur kategoria e përzier Banim dhe Bujqësi. Mbivendosja e përdorimeve "bujqësi dhe industri" është e vendosur kryesisht në zonat bujqësore, të cilat tashmë janë kthyer në zona të shfrytëzimit të naftës. Kështu mund të përmendim rastin e tokave bujqësore në Kallm të Madh dhe të Vogël si dhe në zonën jugore të njësisë administrative Portëz. Mbivendosja e përdorimit "natyrore-banim" vihet re më së shumti në njësinë administrative Cakran, ku relievi kodrinor i saj ka detyruar banorët të ndërtojnë njësi banimi shumë pranë zonave natyrore.

Figura 163 Përdorimi ekzistues i tokës sipas Kategorive bazë



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Figura 164. Përdorimi ekzistues i tokës, sipas kategorive kryesore, nivel qyteti



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Figura 165. Shembuj të mbivendosjes të përdorimeve të tokës



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2015

- ***<u>Përfundime</u>***

Gjatë analizës së përdorimit të tokës është evidentuar qartazi se pjesa më e madhe e territorit, pra rreth 70% e tij, klasifikohet si tokë bujqësore, ndërsa 20% klasifikohet si territor natyror. Po në këtë nivel qëndrojnë edhe kategoritë Arsim, Shëndetësi dhe Institucione (18%). Ajo që bie në sy është se kategoria "Banim" zë vetëm 3,4% të territorit të bashkisë së re të Fierit.

1.9.2 Tipologjitë hapësinore

Analiza e tipologjive hapësinore evidenton mënyrat si ndërlidhen hapësirat në territor, kryesisht nga pikëpamja morfologjike. Për situatat komplekse të mbulesës së tokës dhe shtrirjes së vendbanimeve në Bashkinë Fier, një evidentim i tillë lehtëson të kuptuarit të territorit dhe procesin e përcaktimit të treguesve realistë të zhvillimit.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen e madhe hapësinore të bashkisë në raport me territorin e dikurshëm, kjo analizë trajton 3 nivele tipologjish:

-nivelin territorial: Mënyra si lidhen vendbanimet me njëra-tjetrën në rang bashkie

-nivelin e vendbanimeve rurale: Shtrirjet hapësinore të fshatrave, në raport me rrugët, relievin, etj.

-nivel zone: Ndarja e tipologjive hapësinore në përputhje me njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në njësi strukturore, skemat e rrjetit rrugor dhe hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit[413]

- **Bashkia Fier në nivel territorial**

Territori i Bashkisë Fier është rritur me mbi 110% në periudhën pas viteve ’90, duke arritur një densitet urbanizimi të lartë, me densifikim të theksuar të qendrës dhe me dukuri të shpërhapjes urbane në zonat rurale. Nga pikëpamja policentrike, 85 % e sipërfaqes është pjesë e ZFU-së me qendër Fier[414], dhe vetëm pjesa më perëndimore, bregdetare nuk mbulohet nga kjo zonë funksionale.

Struktura e lidhjes mes vendbanimeve në Bashkinë Fier është komplekse, si rezultat i terrenit të larmishëm dhe lidhjeve historike të vendbanimeve mes tyre. Zona fushore perëndimore dallohet për karakterin bujqësor të theksuar dhe situata të kufizuara urbanizimi, si për shkak të lidhjeve relativisht të dobëta infrastrukturore, ashtu edhe për zhvillimin e dobët të bregdetit.

Ndërtimi i Bypass-it të Fierit pritet të ketë impakt të rëndësishëm në mënyrën si lidhen vendbanimet mes njëra tjetrës. Deri më sot lidhja më e fuqishme ka qenë aksi Lushnje-Fier-Vlorë, i cili kalonte përgjatë rrugës “Aulona”, duke zhvilluar lidhjet lineare Lushnje- Mbrostar- Fier- Levan. Krahas këtij boshti, funksiononte edhe lidhja Fier-Portëz-Patos, si dhe grupi i vendbanimeve lineare Fier- Drizë-Plyk-Kraps-Patos Fshat.

Këto lidhje lineare fuqizuan Mbrostarin e Levanin si nyje kryesore të zhvillimit ekonomik, por segreguan pjesën tjetër të vendbanimeve fushore e kodrinore. Me realizimin e Bypass-it, si dhe me tendencën për zhvillimin e bregdetit dhe mbrojtjen e potencialeve territoriale të turizmit natyror-kulturor, marrin peshë më të madhe lidhje unazore, si Sulaj-Seman-Sheq Marinas – Topojë – Fushë – Povelcë- Darzezë- Levan; Fier-Qarr-Bishan-Bashkim-Pishë; si dhe aksi Fier-Grecalli-Daullas-Mujalli.

Në aspekt territorial dallohen lidhje të ndryshme të trajtës lineare, unazore, ose kombinime të të dyjave. Me vlerë për t’u zhvilluar janë lidhjet Ndërnënas- Hasturkas – Agim – Metaj – Libofshë, të cilat, të lidhura edhe me fshatin Adriatik, përbëjnë potencialin kryesor të lidhjes së Bashkisë Fier me Lagunën e Karavastasë dhe me tërësinë e vendbanimeve të Divjakës, në veri. Këto vendbanime aktualisht kanë shtrirje të konsoliduar, të mirëstrukturuar, e lidhje rrugore relativisht të mira.

Potencial tjetër territorial janë tërësia e vendbanimeve të shtrirja përgjatë kurrizeve kodrinore, e sidomos në rrëzë të tyre, në trajtë orbitale. Këto vendbanime lidhen në mënyrë unazore me njëra tjetrën, dhe në mënyrë radiale përkundrejt qendrës Fier. Itinerari Clirim- Radostinë- Zhupan- Kreshpan- Kafaraj- Frakull- Levan- Shtyllas-Pojan-Dërmenas mund të zhvillohet në mënyrë paralele me Bypass-in, si rrjet vendbanimesh me karakter peizazhistik, e të përforcuara nga elementi i fortë i Parkut të Apollonisë.

Figura 166. Skema e lidhjeve territoriale, nivel bashkie



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Sfida kryesore për Bashkinë Fier në aspekt të tipologjive territoriale është sigurimi i lidhjes ndërvepruese mes vendbanimeve, duke harmonizuar "fuqizimin" e Fierit si qendër ekonomike multidimensionale, me specializimin e vendbanimeve të tjera rurale, në sektorë ndihmës të bujqësisë, turizmit, industrisë dhe shërbimeve dytësore e tretësore. Krahas kësaj, sfiduese mbetet integrimi territorial i vendbanimeve kodrinore me ato fushore, i fshatrave në veri të lumit Seman me pjesën kryesore të bashkisë, si dhe bashkëpunimi ndër-bashkiak me vendbanimet e Lushnjes, Patosit, Divjakës, Vlorës e Ballshit, ku kufijtë fizikë pothuajse nuk ekzistojnë në territor.

- **Tipologjitë rurale**

Bashkia Fier përbëhet nga 10 njësi administrative, prej të cilave 9 janë të karakterit rural, dhe Fieri është plotësisht urban. Në territorin e bashkisë shtrihen 84 fshatra, të cilat kanë marrëdhënie të ndryshme të vendbanimeve brenda tyre, si dhe tipologji të ndryshme shtrirjeje përkundrejt rrjetit rrugor e terrenit.

Sa i takon mënyrës si lidhen vendbanimet brenda të njëjtit fshat, në Fier evidentohen 6 tipologji kryesore:

(1) Tipologjia e shpërhapur përfaqëson dukurinë e shtrirjes së zgjeruar hapësinore të fshatrave, pa densifikim në qendër, por në formë të njëtrajtshme, jo kompakte, në truall bujqësor (ose natyror). Problematikat e ineficencës së përdorimit të tokës dhe ofrimit të shërbimeve kërkojnë për ndërhyrje me karakter densifikues në këto raste.

(2) Tipologjia qëndrore: Kjo tipologji i përgjigjet fshatrave që përbëhen nga një vendbanim i vetëm, kompakt. Ky rast është mjaft i përhapur, dhe përkon me fshatra që nuk kanë presion zhvillimi dhe që shtrihen në territor kodrinoro-malor.

(3) Tipologjia satelitore: Ky rast nënkupton që fshati përbëhet nga disa vendbanime të shpërndara, por të lidhura hierarkisht me një qendër dominante. Këto lidhje janë tregues të tendencës për rritje të fshatrave, si dhe terrenit të vështirë, i cili kufizon vazhdimësinë urbane. Sfida kryesore e zhvillimit e fshatrave me shtrirje satelitore është përforcimi i infrastrukturës lidhëse, si dhe shmangia e ineficencës në furnizimin me shërbime bazë, si infrastrukturë ujësjellëse e kanalizimesh, shërbim menaxhimi mbetjesh, ndriçim publik, etj.

Figura 167. Tipologjitë e marrëdhënieve të vendbanimeve rurale në Bashkinë Fier



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

(4) Tipologjia nukleare: Këto tipologji hasen në fshatrat me shumë vendbanime të vogla, të shpërndara në territor në mënyrë sporadike, të palidhur. Pavarësisht prezencës së një qendre ku është zhvilluar fillimisht fshati, presioni i rritjes në kohë ka çuar në shpërndarjen e vendbanimeve të reja në mënyrë të pastrukuruar, dhe abuzuese ndaj territorit. Kjo tipologji kërkon adaptimin e ndërhyrjeve ristrukturuese dhe mbushëse urbane, për të mos copëzuar më tej terrenin bujqësor apo natyror.

(5) Tipologjia qëndrore e shpërhapur: Ky është një rast i veçantë i tipologjisë nukleare dhe satelitore, ku dominance e një qendre është e dukshme, por ka shumë vendbanime të palidhura, ose të lidhura dobët me të, të cilat janë të shpërndara në territor në mënyrë sporadike.

Në Bashkinë Fier dallohet dominancë e dukshme e tipologjisë qëndrore të shpërhapur, ku 1/3 e fshatrave kanë një qendër dominuese, dhe shumë zona banimi të shpërndara pa rregullsi ose hierarki të veçantë në territor. Kjo tipologji është më e përhapur në fshatrat kodrinorë të njësive administrative Cakran, Levan, Frakull, por edhe në ato fushore, ku dukuria e shpërhapjes urbane vihet re përgjatë rrugëve bujqësore.

Figura 168. Shembuj të tipologjisë së shpërhapur (Kreshpan)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Ndërkaq, tipologjia satelitore është mjaft e përhapur, në 24% të vendbanimeve rurale. Kjo tipologji dallohet në zona ku kushtëzimet e terrenit nuk lejojnë që vendbanimet e një fshati të zhvillohen në mënyrë të vazhduar. Gjithsesi në kushtet e sigurimit të shërbimeve në gjithë territorin, kjo tipologji shtrirjeje është e qëndrueshme. Për zona me presion më të lartë zhvillimi, si Levan, integrimi i zonave të banuara me zonat ekonomike dhe të shërbimeve përgjatë autostradës duhet të jetë më i madh. Në çdo

rast, edhe për tipologjitë satelitore, ku është e mundur, është e nevojshme të nxitet zhvillimi i konsoliduar, hierarkizimi i mëtejshëm i qendrave, si dhe shmangia e ndërtimeve në afërsi të zonave me përdorim të papërputhshëm (lumenj, industri, etj). Fshatrat me tipologji satelitore kanë dendësi, madhësi, dhe periferialitet të ndryshëm, si psh. Mbrostar, Darzezë, Kreshpan, etj.

Tipologjia qëndrore është e përhapur në zona me presion më të pakët zhvillimi, si dhe në zona me rrjet rrugor kuadratik dhe strukturë të konsoliduar. Të tillë janë Topoja, Cakrani, Ndërnënas, Hasturkas, etj. Ky rast është e optimal në mënyrën shfrytëzimit të terrenit dhe në eficiencën e ofrimit të shërbimeve bazë për fshatin.

Figura 169. Shembull i tipologjisë qëndrore (Cakran)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Së fundmi, më pak të përhapura janë tipologjitë nukleare dhe të shpërhapura. Këto dy mënyra zhvillimi hapësinor janë më pak eficentet sa i takon shfrytëzimit të territorit, sepse zënë territor të gjerë dhe nuk kanë lidhje të mirë mes vendbanimeve. Tipologjitë nukleare hasen në raste kur mungojnë qëndërsitë e mirë-përcaktuara, por formohen grupe të shumta vendbanimesh, me lidhje të dobët mes tyre. Të tilla janë fshatra në zona kodrinore, si Lalari, Patos Fshat, etj. Ndërkaq, shpërhapja haset në zona ku ka presion zhvillimi në tokë bujqësore e natyrore, si Metaj, Radostinë, Povelçë, etj. Në këto raste, në ndryshim nga tipologjia nukleare, ku nuk ka tendenca zgjerimi, është e rëndësishme të realizohet konsolidimi i zonave, sigurimi i qendrave të shërbimeve, si dhe lidhja me rrugë lokale e vendbanimeve ekzistuese, pa nxitur shpërhapje të mëtejshme.

Ndërkaq, studimi i rrjetit rrugor në brendësi të vendbanimeve rurale tregon rreth 20% e fshatrave në Bashkinë Fier kanë sistem organik shtrirjeje. Kjo do të thotë që vendbanimet ndjekin kryesisht terrenin, zonat kodrinore, etj, dhe nuk ka tendenca për rregullsi të brendshme në organizim urban. Tipologjia rrugore organike nuk siguron akses optimal në gjithë territorin e fshatrave. Të tillë janë fshatra periferikë, si Lalar,

Gjithashtu, tipologjia lineare dhe e degëzuar gjendet në rreth 40% të vendbanimeve rurale, kryesisht në fshatrat që shtrihen përgjatë rrugëve interurbane kryesore, veçanërisht në njësitë Levan, përgjatë rrugës së Semanit, përgjatë hyrjes së qytetit në Mbrostar, etj. Ndërkaq, në fshatrat me tipologji të degëzuar, krahas aksit kryesor, vendbanimi shtrihet edhe përgjatë degëzimeve të tij, duke formuar një trajtë më të kondoliduar. Në këto raste zona urbane është më e përkufizuar, gjithsesi në varësi të shtrirjes gjatësore, mund të ketë probleme në hierarkizim, caktim të një qendre funksionale për fshatin, si dhe ofrim të shërbimeve bazë.

Figura 170. Shembull i tipologjisë aglomeruese (Dërmenas)



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Figura 171. Tipologji rrjet (Topojë, Sheq Musalalaj)

Burimi: ASIG, 2016

Figura 172. Tipologji e degëzuar (Drizë, Radostinë)

Burimi: ASIG, 2015

Së fundmi, tipologjitë rrjet dhe të tarracuara, ku niveli i ndërhyrjes në strukturën urbane të vendbanimeve është më i lartë, janë shumë të pranishme në territor. Tipologjia rrjet dallohet në dy raste: fshatra me morfologji të rregullt, të planifikuar për t'i shërbyer një zone bujqësore, ku rrugët janë të lidhura në një strukturë kuadratike të rregullt; dhe fshatra me strukturë rrjet të çrregullt, ku terreni fushor ka lejuar që të zhvillohet infrastrukturë më e mirë lidhëse mes zonave. Këto tipologji duhen nxitur me tepër, veçanërisht në funksion të konsolidimit të tokës bujqësore, duke mos nxitur zhvillimin linear në gjithë territorin e përgjatë akseve dytësore, por vetëm përgjatë atyre kryesore.

Figura Figura 173. Tipologjia lineare (Poro) dhe organike (Peshtan i Vogël)

Burimi: ASIG, 2015

Figura 174. Tipologjia e shtrirjes rrugore të vendbanimeve rurale



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

- **Tipologjitë në nivel zone**

Për Bashkinë Fier është realizuar ndarja e zonave tipologjike sipas kritereve të njëtrajtshmërisë të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit, kombinuar me kritere të densitetit, funksionit predominues, dhe shkallës së miksimit të tipologjive ndërtimore. Këto kritere paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela 103. Kriteret e kombinimit të tipologjisë ndërtimore me densitetin

		densiteti				
		i lartë	i mesëm	i ulët	shumë i ulët	shumë i ulët në tokë bujqësore
tipologjia ndërtimore	gjatësore					
	vila					
	kulla					

Tabela 104. Kriteret e kombinimeve të mundshme të tipologjive ndërtimore mes tyre

		tipologji dytësore			
		gjatësore	vila	kulla	vila dhe kulla
tipologjia ndërtimore predominuese	gjatësore				
	vila				
	kulla				

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga këto kritere, klasifikimi i zonave tipologjike për Bashkinë Fier është bërë si më poshtë:

- Ndërtesa gjatësore me densitet të lartë
- Ndërtesa gjatësore me densitet të mesëm
- Ndërtesa gjatësore me densitet të ulët
- Ndërtesa gjatësore miks me zonë vilash/kullash
- Ndërtesa gjatësore miks me vila
- Ndërtesa gjatësore miks me kulla
- Ndërtesa me kulla, densitet i mesëm
- Ndërtesa me kulla, miks me vila
- Vila miks me kulla, densitet i mesëm
- Vila me densitet të lartë
- Vila me densitet të mesme
- Vila me densitet të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët
- Vila me densitet shumë të ulët në tokë bujqësore
- Zona jo banim (administrative, ekonomike, industriale, fetare, sera, shkolla, stadium, ushtarake, arkeologjike, etj)

Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në Bashkinë Fier janë vilat me densitet të ulët, të cilat zënë rreth 30 % të territorit të ndërtuar. Kjo dëshmon për karakterin relativisht rural, ku pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të shpërhapura në territor, e realizojnë dendësi të ulëta. Mjaft të përhapura janë edhe zonat me vila me densitet të mesëm, ku banesat individuale janë të tipit dupleks, ose banesë

individuale 2-3 katëshe. Këto zona dallohen kryesisht në qendrat e njësive administrative, si dhe në sistemin e vendbanimeve të shtrira në terren fushor.

Mjaft të përhapura janë edhe tipologjitë e vilave me densitet shumë të ulët, të cilat, së bashku, përbëjnë mbi 30% të zonave të banuara. Ky nivel i lartë fragmentimi të territorit, si dhe presionit të ulët të zhvillimit haset si në zonat fushore bujqësore, ashtu edhe në territorin kodrinor. Vetëm në afërsi të qytetit të Fierit densiteti rritet në mënyrë të dukshme.

Përgjithësisht në secilin vendbanim dallohet një përhapje homogjene e tipologjisë, përveç qytetit të Fierit, dhe kalimit drejt vendbanimeve të tjera përreth tij, si Clirim, Drizë, Afrim, etj, ku kalohet nga densitete të larta të vilave, në densitete të ulëta dhe shumë të ulëta.

Ndërkaq, dukuria e zënies së tokës bujqësore nga zona e banuar është mjaft e përhapur, sidomos përgjatë rrugëve bujqësore, dhe në brezin fushor përgjatë Semanit. Kjo dukuri duhet shmangur, nëpërmjet ndërhyrjeve konsoliduese dhe ristrukturuese.

Figura 175. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në Bashkinë Fier



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Së fundi, zonat industriale zënë një pjesë domethënëse të territorit artificial, rreth 18% të tij. Pjesa dominuese i takon Azotikut dhe zonës naftëmbajtëse të Kallmit, por edhe subjekteve te tjera përpunuese në bashki. Vlen për të trajtuar me kujdes kufiri i këtyre zonave, sidomos në bashkim me përdorimet e mospërputhshme, si banim, ujëra, bujqësi, etj. Përveç Azotikut e zonës së naftës, zonat e tjera industriale janë të

zhvilluara linearisht përgjatë aksit Fier-Vlorë, si dhe në mënyrë pikësore në zona të caktuara të periferisë së qytetit dhe qendrave të tjera të rëndësishme rurale.

Figura 176. Zonimi tipologjik, Bashkia Fier



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me predominancë ndërtesash gjatësore, të miksuara me kulla dhe vila, në zona me ndërtesa gjatësore me strukturë të planifikuar, homogjene, e deri në periferinë me ndërthurrje zonash vilash të densitetit të lartë e të mesëm me zona industrial. Qendra administrative nuk arrin të krijojë një qendërsi të dukshme të qytet, ndërkohë që marrëdhënia e zonave të banimit me zonat industriale periferike është gjithashtu problematike, për shkak të afërsisë së madhe dhe mungesës së brezave të mirëfilltë mbrojtës.

Rritja e mundshme e qytetit mund të kryhet duke zënë territorin bujqësor që ndodhet përreth qytetit, si dhe në mënyrë lineare drejt akseve hyrës. Densifikimi i zonave ekzistuese periferike është gjithashtu i mundur, e lehtësohet nga rrjeti kuadratik i pastër i qytetit të Fierit.

Figura 177. Zonimi tipologjik, Fier qendër



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pavarësisht karakterit urban të qendrës, me zona me ndërtesa gjatësore dhe kulla, sërish tipologjia e vilave zë sipërfaqen mbizotëruese në qytet. Respektivisht, vilat me densitet të mesëm dhe të lartë zënë 19% të zones së banuar, ndjekur nga tipologjia mikse e ndërtesave gjatësore, me vila e kulla, e cila është e përhapur në mënyrë të

dendur brenda unazës së qytetit. Tipologjia e tretë më e përhapur në qytet është ajo e zonave industriale, të cilat duhen trajtuar me kujdes në mënyrën si lidhen me pjesën tjetër të qytetit. Aktualisht ato pozicionohen në kufitë skajorë të zonave të banuara.

Nga pikëpamja e tipologjisë ndërtimore, në qytet evidentohen disa zona me tipologji hapësinore homogjene, si psh. zonat me ndërtesa gjatësore, ose zonat me ndërtesa kulla, të densiteteve të ndryshme. Për shkak të planifikimit të hershëm, me standarde diellëzimi dhe jetueshmërie të mirë, këto zona ofrojnë hapësira të përshtatshme, dhe në kushtet e presionit të zhvillimit, kanë qenë subjekt i plotësimit me vila, ose kulla, në pjesën qëndrore të qytetit. Kjo dukuri nuk është e pranishme në disa zona periferike, për shkak të cilësisë së dobët të infrastrukturës rrugore në to. Kështu, zonat me tipologji homogjene në skajin verior të qytetit duhen ruajtur nga presioni i zhvillimit, dhe të plotësohen me infrastrukturë të përshtatshme rrugore.

Ndërkaq, sfida për zonat mikse, në kushtet e mungesës së standardeve të përshtatshme të jetueshmërisë, është ristrukturimi, ndërhyrjet rigjeneruese, dhe tendenca për zëvendësim i gjurmëve të vilave të cilësisë së dobët me ndërtesa gjatësore ose të tipit kullë, të densitetit të mesëm, për të siguruar hapësirë dhe aksesueshmëri më të lartë në lagjet qëndrore të qytetit.

Figura 178. Shpërndarja e tipologjive hapësinore në qytetin e Fierit



Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Së fundmi, zonat e vilave kryesisht paraqiten mjaft të rregullta, me strukturë rrugore kuadratike, ose rrjet të çrregullt, dhe sipërfaqe të gjelbërta të karakterit privat. Në këto

zona, që shpesh arrijnë sipërfaqe mbi 50 ha, është e nevojshme të bëhet një plotësim me shërbime dhe funksione jorezidenciale, si dhe të shtohen hapësirat me përdorim dhe akses publik ose gjysëm-publik. Kjo do i shërbente rritjes së cilësisë së jetesës dhe shmangies së segregimit të popullsisë ndaj shërbimeve bazë.

1.9.3 Cilësia e hapësirave publike, strukturave, dhe territoreve

Kjo është një analizë e cila ka për qëllim analizimin e strukturave të territorit për nga cilësia e tyre fizike aktuale. Gjetjet e kësaja analize do të shërbejnë për të marrë masa për ndërhyrjet e rehabilitimit fizik, rigjenerimit, rizhvillimit apo të tjera qasje që do të ndërmerren gjatë propozimeve të planit.

Për të përcaktuar gjendjen fizike të këtyre objekteve janë përdorur hartat e vjetra ushtarake të bashkisë Fier dhe territoreve të ish- komunave, hartat e zhvillimit në vite të bashkisë, analiza e tipologjisë, të dhëna të tjera nga bashkia si dhe inventarizimi i strukturave në terren nëpërmjet vizitave të njëpasnjëshme në territorin e bashkisë.

Zonat/objektet/strukturat do të ndahen në mënyrë të përgjithshme sipas klasifikimit: në gjendje optimale, gjendje e mirë, gjendje e degraduar, shumë e ndotur, e ndotur, e shtruar, e pashtruar, në rrezik përmbytjeje, rrezik shembjeje, rrezik tërmeti etj. Të gjitha kategorizimet do të bëhen në varësi të gjendjes aktuale dhe llojit të strukturës.

Lidhur me gjendjen e infrastrukturave rrugore në territorin e Bashkisë Fier një informacion më i detajuar mund të gjendet në seksionin e analizave të thelluara të planit, atë të infrastukturave rrugore.

- **Cilësia e hapësirave publike**

Për sa i përket hapësirave publike në bashkinë e Fierit mund të thuhet se numri i tyre është relativisht i vogël dhe kryesisht shtrihen në territorin e bashkisë së vjetër të Fierit. Kështu mund të përmendim fillimisht Stadiumin në qytet "Loni Papuçiu" i cili nga vëzhgimet vlerësohet të mos jetë në gjendjen më optimale të tij dhe ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese. Një hapësirë e gjelbër "gjysëm publike" është edhe hapësira përpara institucionit të bashkisë, një hapësirë e gjelbëruar por jo e askesueshme për qytetarët dhe pa elementë urbanë plotësues. Rekomandohet që kjo hapësirë të kthehet edhe në përdorim të qytetarëve duke u pasuruar me elementë dizajni dhe elementë të tjerë të nevojshëm.

Një hapësirë tjetër që supozohet të jetë publike por që aktualisht nuk e ka një funksion të tillë është edhe fasha lumore e Gjanicës në qytet, si dhe Vjosës dhe Semanit. Rekomandohet që këto hapësira të kthehen në hapësira publike, të rehabilitohen dhe të ritrajtohen pasi sot kanë një gjendje komplet natyrale në rastet e Semanit dhe Vjosës dhe të degraduar në rastin e Gjanicës. Dy hapësira të tjera që mund të përdoren si hapësira publike janë hapësirat përpara xhamisë dhe katedrales ortodokse. Hapësirat janë në gjendje të mirë dhe janë të mbjella me pemë dhe bimë të tjera dekorative. Aktualisht, pranë rrugës "Xoxi Andoni" po krijohet një hapësirë publike e cila duket se do i nështrohet një projekti ambicioz rehabilitimi.

Një hapësirë tjetër publike e cila sot është në gjendje shumë të mirë është rruga këmbësore e re në qytet e cila është ndërtuar rishtazi në një pjesë të rrugës "Jakov

Xoxa”. Hapësira publike të tjera në qytet nuk identifikohen përveç disa hapësirave të cilat ndodhen midis pallateve, gjendja e të cilave është jo e mirë dhe ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese.

Duke folur për hapësirat publike të gjendura në NjA-të e tjera të Bashkisë Fier vlen të thuhet se ato janë më të vogla në numër dhe përgjithësisht në gjendje të degraduar. Në të shumtën e rasteve këto hapësira përkojnë me qendrat e ish–komunave ose pranë ish-shtëpive të kulturës. Për shembull përmendim këtu hapësirën publike që ndodhet në fshatin Pojan të Fierit dhe hapësirën që ndodhet pranë shtëpisë së kulturës. Megjithatë kjo hapësirë dhe ish-godina e shtëpisë së kulturës është në gjendje shumë të keqe fizike dhe të dyja kanë nevojë për ndërhyrje. Një hapësirë publike mund të quhet edhe hapësira përpara godinës së komunës Dërmenas e cila është në gjendje jo të mirë dhe ka nevojë për ndërhyrje dhe zgjerim të hapësirës.

Figura 179. Shtëpia e Kulturës, Pojan.

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

- **Cilësia e territoreve dhe strukturave/ndërtesave**

Një nga territoret në gjendjen më të degraduar në territorin e bashkisë Fier është ish-zona industriale e Azotikut e cila prej vitesh ka ngelur pa funksion dhe është pjesë e një procesi likuidimi që po zgjat disa vite në kohë. Territori vuan nga një ndotje mjedisore e madhe që vjen si pasojë e depozitimit të elementëve kimikë ndërsa objektet përbërëse të zonës industriale janë plotësisht në gjendje të degraduar. Përveç godinës së zyrave të ndërrmarjes së Azotikut, objektet e tjera janë në gjendje të

rrënuar. Në këtë zonë nevojitet një program rehabilitimi gjithëpërfshirës i cili do të kthejë territorin dhe strukturat në një zonë funksionale dhe të pastër për nga ana mjedisore.

Një zonë tjetër që mbart ndotje është zona naftënxjerrëse e Mbrostarit e cila shkakton ndotje mjedisore për shkak të pus-shpimeve të cilat gjenden aty. Territore të tjera të ndotura janë pikat e depozitimit të mbetjeve siç është ajo në veri të qytetit të Fierit apo dy depozitime të tjera në bregdet pranë Topojës. Këto territore janë të ndotura dhe kanë nevojë për rehabilitim mjedisor.

Struktura të tjera të cilat janë në gjendje të degraduar ndodhen si në qytetin e Fierit ashtu edhe në njësitë e tjera administrative.

Figura 180. Zona industriale e Azotikut.

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Kështu mund të përmendim një tërësi kompleksesh banimi në formë pallatesh deri në pesë kate të cilat janë ndërtuar para viteve ‘90 të cilat kanë nevojë për ndërhyrje rehabilituese. Disa prej tyre gjenden në afërsi të qendrës ne lagjen “29 nëntori”, pranë rrugës “Jakov Mile”, rrugës “Skënderbeu” dhe “Thoma Kopaçe”. Ndërtesa kolektive deri në pesë kate gjenden edhe përgjatë rrugës “Jakov Xoxa” por që aktualisht janë në gjendje më të mirë se të objektet e tjera të përmendura për vetë faktin se së fundmi i janë nënshtruar projektit të restaurimit të fasadave, ndërhyrje e cila erdhi sëbashku me ndërtimin e rrugës pedonale në këtë zonë. Objekte të tjera që janë në gjendje jo të mirë fizike janë në përgjithësi disa objekte social-kulturore të cilat janë ndërtuar para viteve ‘90. Objekte të tilla janë: stacioni i trenit, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme etj.

Figura 181. Stacioni i trenit, bashkia Fier

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Gjithashtu në rrugën "Enriko Veizi" ndodhen një grup objektesh magazinimi të cilat nuk janë në gjendje të mirë dhe kanë nevojë për masa rehabilituese. I njëjti problem qëndron edhe në lagjen e komunitetit Rom. Kjo është një lagje e cila ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese ose ndërhyrje rizhvillimi.

Figura 182. Objekte banimi në Darezezë.

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Lagjet periferike të qytetit të Fierit janë lagje që ndonëse janë ndërtuar pas viteve '90 dhe objektet e banimit dhe të shërbimit janë në gjendje shumë të mirë, territoret e tyre kanë një cilësi jo të mirë. Kjo për faktin se cilësia e infrastrukturave në këtë zonë

është jo e mirë ose ato mungojnë fare. Në të shumtën e rasteve rrugët janë të pashtruara, nuk kanë ndriçim dhe kanë mungesë kanalizimesh. Këto janë zona të cilat duhet të analizohen më në detaj dhe të trajtohen me programe rehabilitimi të posaçme. Në gjendje të mirë dhe jo të mirë fizike janë edhe zonat e banimit në Darzezë

Zona të tjera të cilat janë në gjendje jo të mirë fizike janë ish-zonat ushtarake si dhe ish-magazinat bujqësore të ndërtuara para viteve '90. Këto zona gjenden në: Dërmenas, Levan, Topojë, Darzezë, Cakran si dhe pranë varrezave në Portëz.

Përsa i përket cilësisë së tokave mund të përmenden këtu problemet me tokat e kripura të ndodhura në NjA-të Levan, Topojë dhe Libofshë. Këto janë sipërfaqe tokash bujqësore të cilat kanë nevojë për masa rehabilituese [415]. Njëkohësisht, ekzistojnë sipërfaqe që përmbyten si ato në tokë bujqësore përgjatë Semanit apo disa segmente në qytet përgjatë Gjanicës, tokat rreth Darëzezës etj. Më tepër informacion për këto raste jepet në seksionin e analizës mjedisore.

1.10 Rëndësia kombëtare në territor

- **Pasuri kombëtare kulturore dhe natyrore**

Parku i Apollonisë është arkivuar në shqyrtim për t'u konsideruar pasuri botërore nga UNESCO-ja në 03.04.2014 nga Ministria e Mjedisit.[416] Parku i Apollonisë është një zonë prej 81 ha, kufiri i të cilës u caktua me VKM Nr. 396, datë 31.03.2005 si një zonë arkeologjike e mbrojtur, e përbërë nga një zonë me intensitet të lartë arkeologjik (A) dhe (B) një zonë për zhvillimin e hapësirës së mbrojtur. Krahas Parkut Arkeologjik të Apollonisë, në Bashkinë e Fierit ndodhen dhe 17 [417] monumente kulture të kategorisë së parë, të cilat administrohen sipas Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore". Për monumentet e kulturës përcaktohet një zonë mbrojtëse përreth, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike dhe me përshtatshmërinë e tyre urbanistike-estetike. Përmasat e kësaj zone, ku ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor, janë përcaktuar nga organi që ka shpallur monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve te Kulturës.

Në kufirin verior gjendet Laguna e Karavastasë në Divjakë. Kjo lagunë është shpallur *park kombëtar* (Zonë e mbrojtur, kategoria II) me VKM nr. 687, datë 19.10.2007. Në jug, sistemi ligatinor i Nartës dhe Vjosës është shpallur *peizazh i mbrojtur* (Zonë e mbrojtur, kategoria V) me VKM nr. 680, datë 22.10.2004. Pylli i Levanit (199 ha) si dhe pylli i Pishë-Poros (1575 ha) janë shpallur *rezervat natyror të manaxhuar/park natyror* (Zonë e mbrojtur, kategoria V) me rregullore nga Ministria e Brendshme nr. 1, datë 27.07.1977. Këto hapësira të mbrojtura kanë një zonë buferike prej 50 m nga kufiri që kushtëzon zhvillimin. Monumentet natyrore (Zonë e mbrojtur, kategoria III) të shpallura me VKM-në nr. 676 datë 20.12.2002 janë: dunat e Semanit; pishat e zeza në bregdetin e Poros; kurora e lumit të vjetër të Semanit (Libofshë Adriatik); rrapet e rrugës Fier-Vlorë dhe rrapi i pazarit të Cakranit (Çaireve).

Tabela 105. Zonat buferike dhe karakteristikat e zonave të ndryshme të mbrojtjes

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat	Zuna buferike në metra	Shkalla e mbrojtjes

Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.	100	Shkalla e parë (i)
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.	50	Shkalla e dytë (ii)
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[418].	-	Shkalla e parë (i)
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).	50	Shkalla e tretë (iii)
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/ Peisazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peisazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peisazh i mbrojtur.	50	Shkalla e katërt (iv)
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të manaxhuara.	50	Shkalla e katërt (iv)

Burimi: Ligji Nr.9868/2008 Për Zonat e Mbrojtura

- **Manaxhimi i integruar i burimeve ujore**

Me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 14 më datë 07.03.2014, është miratuar nisma për hartimin e planit të integruar ndërsektorial për brezin bregdetar, i cili specifikon një fashë territori përgjatë bregut detar. Në këtë brez, i cili përcaktohet me hartën përkatëse419, vendimi i KKT-së pezullon dhënien e lejeve të zhvillimit nga të gjitha autoritetet e planifikimit deri në miratimin e planit në fjalë.

Po ashtu, të gjitha burimet ujore së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të Ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, "Për manaxhimin e integruar të burimeve ujore", janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Përgjatë trupave ujore, ky ligj specifikon distanca sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5m deri në 20m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100m deri në 200m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit apo manaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë në përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (Neni 9). Sipas strategjisë të decentralizimit[420] dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor (draft) sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë në administrim bashkive si funksion i tyre.

Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000-50,000 banorë.

- **Tokat Bujqësore**

Legjislacioni në fuqi dhe Ligji nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktojnë mbrojtjen nga ndërtimet, mbrojtjen e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimin e një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, në përputhje me legjislacionin e planifikimit. Ndërtimi në tokë bujqësore është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM-së nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave ose me ligj, në varësi të bonitetit dhe sipërfaqes së propozuar për konvertim, dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, Ligji nr. 8752 datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, ajrore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Nga ana tjetër, kalimi i tokave bujqësore në kategori të burimeve të tjera si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto burime për sipërfaqe deri në 1ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1ha.

- **Pyjet, drufrutorët dhe kullotat**

Përcaktuar në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30%, së bashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Bashkia e Fierit ka 52.2 km2 toka pyjore421 me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë të këtij fondi pyjor kombëtar, mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100ha. Pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e burimit të tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjate.

Për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor. Kalimi i burimit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.

Në bazë të Ligjit nr. 7929, datë 11.05.1995, "Për mbrojtjen e drufrutoreve", pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtat, pavarësisht llojit të pronësisë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore i është dhënë në administrim organeve të pushtetit vendor me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 14.10.1999.

Fondi kullosor i përbërë nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote apo livadhi nga fondi kullosor ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1ha.

- **Hidrokarburet dhe Gazsjellësi**

Uzina e Plehrave Azotike ka qenë në funksionim deri në 1993 dhe përbëhet nga uzina e plehut, ureja e vjetër dhe ureja e re. Me një sipërfaqe prej 22.27 ha, zona ka vetëm 0.52 ha të kontaminuar me arsenik dhe 4.05 ha të privatizuar[422]. Hapësira e mbetur është në pronësi publike dhe e hapur për investime të mëtejshme. Sipas VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015, objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

Brenda territorit të Bashkisë së Fierit ka rreth 2.4 km^2 hapësirë naftënxjerrëse të zonës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës, pozicionuar pranë fshatrave Kallm i Madh dhe

Kallm Maliqaj. Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga ministria përkatëse. Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me Ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993, "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", i ndryshuar, një kontraktori mund t'i jepet e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike ose private për të kryer operacione hidrokarburesh nën marrëveshjen e hidrokarbureve, ku kontraktori është palë.

Me vendim të KKT-së nr. 1, datë 04.07.2013 është miratuar Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans-Adriatik (Projekti TAP), i cili kushtëzon të gjitha autoritetet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Shoqëria Trans-Adriatik Pipeline AG do të ndërtojë një segment tubacioni rreth 24 km në të cilin ushtrohen tre zona sigurie. Në zonën e parë A prej 8 m (4m në çdo anë) nuk do lejohet asnjë ndërtesë, as plugim i thellë dhe as pemë. Në zonën e dytë B prej 40 m (20 m në çdo anë) nuk do lejohen ndërtesa banimi. Zonës së tretë C prej 400 m (200 m në çdo anë) do t'i jepet një konsideratë e veçantë autoriteteve të planifikimit ku në bazë të standardeve të sigurisë për sistemin e gazit natyror me trysni të lartë mund të kufizojnë numrin e ndërtesave në zonën e sigurisë.[423] Gjithashtu, pranë fshatit të Semanit është planifikuar një stacion pompimi me sipërfaqe rreth 40 ha.

Krahas vënies në përdorim të një sasie të pronave shtetërore, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 803, datë 30.09.2015, në territorin administrativ të Bashkisë Fier do të vendosen në dispozicion të përhershëm të Shoqërisë TAP AG: 14,566 m^2 tokë bujqësore (arë), 8,646 m^2 sipërfaqe kanal, dhe 11,819 m^2 rrugë automobilistike sipas hartës së shtrirjes së projektit.

Figura 183 Zonat e mbrojtjes së Gazsjellësit TAP



Burimi: VKM Nr.1, datë 08.04.2014, Për Miratimin e lejes zhvillimore komplekse për Gazsjellësin TransAdriatik; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

- **Të tjera**

- Sipas VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", "objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, apo për funksionimin e sigurtë të objektit që ndërtohet, gjerësia minimale e zonës mbrojtëse sanitare përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj është 50m dhe distanca minimale e mbrojtjes është 200m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj."

- Kullat e telekomunikacionit që janë të larta mbi 25 metra nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të përcaktuara si zona banimi. Distanca e tyre minimale nga kufizimi i pronës më të afërt të ndërtuar është 30 metra.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Në të mund të parashikohet vetëm mbjella e drurëve dhe gjelbërimit, ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Për qendrat e banuara, me popullsi > 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100m linear, për qendrat e banuara me popullsi < 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50m linear.

Figura 184. Zonat e rëndësisë kombëtare dhe kufizimet ligjore të territorit në Bashkinë Fier.



Burimi: Përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN në bazë të ligjeve përkatëse

1.11 Analiza e periferialitetit

Analiza e periferialitetit është mjeti që ndihmon në identifikimin e pabarazive social-ekonomike brenda territorit administrativ që po studiohet. Kjo analizë bazohet në mbivendosjen e gjetjeve të analizave social-ekonomike dhe synon të klasifikojë zona të ndryshme në qytet nga ato më të preferueshmet deri në ato më të pafavorizuarat. Ky klasifikim ndihmon bashkinë në përzgjedhjen e strategjive investuese dhe projekteve prioritare në PPV, që janë:

- largësia nga qendra e zonës së banuar;
- largësia nga qendrat e punësimit;
- lidhja me sistemin rrugor;
- furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale;
- niveli më i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore;
- plotësimi me funksione, sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës;

- niveli i kriminalitetit dhe sigurisë së jetës;
- probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social.

Mbivendosja e hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore si dhe qendrave të punësimit dhe shërbimeve ekonomike krijon mundësinë që të identifikohen në territor zonat e favorizuara (të cilat mbulohen nga rrezet e shërbimit të infrastrukturave publike dhe gjenden në afërsi të zonave ekonomike) nga ato të pafavorizuarat, duke identifikuar kështu zonat ku ka më tepër nevojë për ndërhyrje dhe investime publike.

Kjo analizë, e mbivendosur me analizën demografike, krijon lehtësi në përllogaritjen e numrit të banorëve që banojnë në zona të pafavorizuara dhe të mangësive infrastrukturore që ato kanë, proces mbi të cilin bazohet vendimmarrja përsa i përket ndërhyrjeve prioritare në terren. Analiza e periferialitetit ka fokus kryesor identifikimin e zonave rezidenciale periferike të Bashkisë së Fierit dhe evidentimin e problematikave kryesore të këtij qyteti.

Metodologjia: Si fillim është paraqitur rrjeti i infrastrukturës ekzistuese rrugore, rrjeti ekzistues i ujësjellësit - kanalizimeve dhe janë identifikuar institucionet arsimore, shëndetësore në territorin administrativ të Bashkisë.

Për objektet arsimore dhe shëndetësore, rrezja e mbulimit të këtij shërbimi është përcaktuar sipas standardeve. Gjithashtu evidentohen dhe të gjitha akset kryesore të lëvizjes me zonat e influencës per shërbimet e ofruara sipas standardeve.[424] Skema e mëposhtme tregon mbivendosjen e këtyre elementëve qendror, si institucionet arsimore, shendetësore dhe infrastrukturën kryesore rrugore dhe nëntokësore.

Nga mbivendosjet e të gjitha hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore rezultojnë të ndërthurura zona të caktuara.

Në varësi të mbulimit të tyre nga shërbimet e infrastrukturave publike mund të klasifikohen disa kategori në lidhje me periferialitetin, nga ato më periferiket të cilat nuk mbulohen nga asnjë nga shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga të gjitha shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga vetëm tre shërbime apo ato që mbulohen nga dy shërbime ose një shërbim.

A. Arsim
S. Shëndetësi
U. Ujësjellës-Kanalizime
I. Infrastrukture rrugore

Më poshtë janë kategoritë bazë të identifikimit të periferialitetit në hartë.

Kategoria 1: Zonat që mbulohen nga të gjitha shërbimet **(A+S+U+I), të shërbyera shumë mirë**

Kategoria 2: Zonat qe mbulohen nga tre shërbime **(ASU, AUI, ASI, SUI), të shërbyera mirë**

Kategoria 3: Zonat qe mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike**

Kategoria 4: Zonat qe mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I), periferike**

Kategoria 5: Zonat qe nuk mbulohen nga asnjë shërbim**, shumë periferike**

Kategoritë bazë të klasifikimit të periferialitetit janë rezultat i ndërthurjeve të shërbimeve të ndryshme publike, sipas treguesve të planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore.[425]

Tabela 106. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore.

Infrastruktura arsimore	**Numri i banorëve që shërbehet nga një njësi shërbimi**		**Rrezja e shërbimit**		**Standardet e projektimit**	
	Zona urbane	Zona rurale	Zona urbane	Zona rurale	Për ndërtesën	Për parcelën
Çerdhe	1000	1000	200-300m	200-300m	25m^2-30m^2/ fëmijë	900m^2-1500m^2
Kopësht	1500	1500	250-350m	500-600m	18m^2-25m^2/ fëmijë	1000m^2-1500m^2
Shkollë 9-vjeçare	6000	6000	500-600m	1000-1500m	20m^2-25m^2/ fëmijë	1500m^2-7000m^2
Shkollë e mesme	9000	9000	1000-1500m	2000-4500m	20m^2-30m^2/ nxënës	2000m^2-7000m^2

Burimi: Rregullorja e Planifikimit të Territorit

Tabela 107. Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore.

Emërtimi	**Sipërfaqe (m2)**	**Treguesi "1 njësi/nr. Banorësh)**
Qendra shëndetësore	300-400	Një për 250-1500
Ambulancë – Konsultore maternitet	400-6000	
Ambulancë - Konsultore	700-1000	Një për 1500-2000
Poliklinikë	2000-5000	
Dispanseri	3000	
Drejtori e Higjienës Epidemiologjike	2000-3000	
Qendër dezinfektimi, deratizimi	2000	

Burimi: Rregullorja e Planifikimit të Territorit- VKM Nr. 671

Figura 185. Harta e analizës së periferialitetit.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas kategorizimit të perfierialitetit në bashkinë e Fierit, njësitë administrative të tij që cilësohen si zona të shërbyera shumë mirë sepse në të ofrohen të gjitha shërbimet - **Kategoria 1 (A+S+U+I)**, janë njësia e Cakranit në pjesën qendrore dhe perëndimore të saj, në njësinë e Dermenasit janë disa zona banimi në perëndim të saj, në njësinë e Fierit pothuajsë gjithë sipërfaqja e saj, në njësinë e Frakullit disa zona banimi që pozocionohen në pjesën më qendrore të saj, në njësinë e Levanit disa zona banimi në pjesën qendrore dhe lindore te saj, në njësinë e Portëzës janë disa zona banimi në pjesën veriore të saj, në njësinë e Qendrës disa banime në pjesën qendrore të saj dhe në njësinë e Topojës disa zona banimi në pjesën jugore të saj.

Si zona të shërbyera mirë që mbulohen nga tre shërbime të paktën **Kategoria 2 (ASU, AUI, ASI, SUI- arsim- shëndetësi - ujësjellës, arsim – ujësjellës - infrastrukturë, arsim - shëndetësi - infrastrukturë, shëndetësi – ujësjellës - infrastrukturë)** janë përgjithësisht të gjitha njësitë administrativet e bashkisë Fier. Të gjitha njësitë administrative në Fier mbulohen nga shërbimet e arsimit (kopësht, arsim i ulët, arsim i mesëm), shëndetësi dhe infrastrukturë (ASI). Me arsim, shëndetësi dhe ujësjellës (ASU) mbulohen zona të caktuara banimi në Topojë, në Dermenas, në Qendër, në Fier, në Levan, në Portëz, në Frakull dhe Cakran. Me shëndetësi, ujësjellës dhe infrastrukurë (SUI) mbulohen disa zona banimi në Cakran, në Levan, në Frakull, në Portëz dhe Topojë.

Zonat qe mbulohen nga dy shërbime **(AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike** janë ato të kategorisë së tretë të periferialitetit dhe përgjithësisht

mbulohen të gjitha njësitë administrative të Fierit, si ajo e Fierit, Libofshës, Topojës, Qendrës, Mbrostarit, Dermenasit, Levanit, Frakullit, Portëzës dhe Cakranit (AS). Shëndetësi dhe infrastrukturë (SI) mbulohen disa zona banimi në Cakran, në Dermenas, në Frakull, në Levan, në Libofshë, në Mbrostar, në Portëz, në Qendër dhe Topojë, kurse me shëndetësi dhe ujësjellës mbulohen disa zona banimi në Cakran, në Burimi: PLGP AMFrakull, në Levan, në Portëz dhe Topojë.

Ndërsa në Kategorinë e 4 të periferialitetit, zonat qe mbulohen nga një shërbim **(A, S, U, I),** dhe që klasifikohen si **periferike** bëjnë pjesë të gjitha njësitë administrative në Fier, sepse të gjitha mbulohen nga të paktën një shërbim.

Në kategorinë 5 të kesaj analize përfshihen ato zona të cilat nuk mbulohen nga asnjë shërbim publik, zona këto të karakterizuara si shumë periferike. Këtu nuk bëjnë pjesë asnjë nga zonat banimit të Fierit. Më poshtë përfshihen të dhënat e numrit të banorëve për secilën njësi adminstrativë të Bashkisë Fier sipas kategorive të periferialitetit.

Figura 186. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Cakran.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Cakranit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 4,129 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 7,390 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 2,632 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 65 banorë.

Figura 187. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Frakull.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia adminstrative e **Frakullit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 3,395 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,680 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 732 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 20 banorë.

Figura 188. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Levan.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Levanit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 2,920 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 4,419 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 1,339 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 42 banorë.

Figura 189. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Portëz.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Portëzës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 533 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 5,422 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 2,452 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 87 banorë.

Figura 190. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Dërmenas.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Dërmenas** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 878 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 5,933 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 856 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 2 banorë.

Figura 191. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Topojë.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Topojës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 3,346 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 636 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 89 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 2 banorë.

Figura 192. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Libofshë.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Libofshës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit nuk mbulon asnjë banor. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,939 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 1,317 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 21 banorë.

Figura 193. Grafiku i periferialitetit për Njësinë Qendër.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Qendrës** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 513 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,755 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 54 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen vetëm 3 banorë.

Figura 194. Grafiku i periferialitetit për Fierin.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Fierit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit mbulon 47,699 banorë. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 3,089 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 7 banorë. Sipas Kategorisë 4 nuk mbulohet asnjë banor.

Figura 195. Grafiku i periferialitetit për Mbrostarin.



Burimi: PLGP dhe Bashkia Fier; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Njësia administrative e **Mbrostarit** sipas klasifikimit të Kategorisë 1 të periferialitetit nuk mbulon asnjë banor. Sipas Kategorisë 2 mbulohen 5,465 banorë. Sipas Kategorisë 3 mbulohen 1,520 banorë. Sipas Kategorisë 4 mbulohen 22 banorë.

Më poshtë janë të paraqitura tabela dhe grafiqe sipas sipërfaqes dhe numrit të banorëve sipas kategorive përkatëse të periferialitetit.

Tabela 108. Kategoritë e periferialitetit sipas sipërfaqes dhe popullsisë.

Kategoria	Sipërfaqja (%)	Popullsia (%)	Popullsia (banorë)
Kategoria 1. Të shërbyera shumë mirë	2%	54%	63413
Kategoria 2. Të shërbyera mirë	5%	37%	43728
Kategoria 3. Problematike me shërbimet publike	36%	9%	10999
Kategoria 4. Periferike	57%	0%	264
Kategoria 5. Shumë periferike	0%	0%	0

Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Me poshtë është e paraqitur një tabelë që përfshin të gjitha të dhënat për çdo njësi administrative përsa i përket sipërfaqes sipas çdo kategorie të klasifikimit të periferialitetit dhe numrit të banorëve në çdo kategori në secilën njësi.

Figura 196. Grafiku i periferialitetit për sipërfaqen e Fierit.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 197. Grafiku për popullsinë sipas kategorive përkatëse të periferialitetit.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 109. Treguesit për sipërfaqen dhe popullsinë sipas kategorive të periferialitetit në secilën njësi administrative të Fierit.

		Cakran	Frakull	Levan	Dermenas	Portëz	Topojë	Libofshë	Qendër	Fier	Mbrostar	Total (banorë)
Kategoria 1	**popullsia (banorë)**	4129	3395	2920	878	533	3346	0	513	47699	0	63413
	popullsia (%)	3.5	2.87	2.47	0.74	0.45	2.83	0.00	0.43	40.28	0.00	53.56
	sipërfaqja(%)	0.23	0.17	0.15	0.03	0.06	0.14	0.00	0.02	0.95	0.00	1.76
Kategoria 2	**popullsia (banorë)**	7390	3680	4419	5933	5422	636	3939	3755	3089	5465	43728
	popullsia (%)	6.24	3.11	3.73	5.01	4.58	0.54	3.33	3.17	2.61	4.62	36.93
	sipërfaqja(%)	1.05	0.40	0.52	0.43	0.56	0.27	0.28	0.39	0.80	0.27	4.97
Kategoria 3	**popullsia (banorë)**	2632	732	1339	856	2452	89	1317	54	7	1520	10998
	popullsia (%)	2.22	0.62	1.13	0.72	2.07	0.08	1.11	0.05	0.01	1.28	9.29
	sipërfaqja(%)	4.8	4.3	4.7	5.3	3.0	3.7	4.1	2.6	0.4	3.1	36.04

Kategoria 4	**popullsia (banorë)**	65	20	42	2	87	2	21	3	0	22	264
	popullsia (%)	0.05	0.02	0.04	0.00	0.07	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.18
	sipërfaqja(%)	9.44	2.0	12.4	4.6	3.8	10.3	9.6	1.7	0.0	3.3	57.2
Kategoria 5	**popullsia (banorë)**	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	popullsia (%)	0	0.00	0	0	0	0	0	0		0	0.00
	sipërfaqja(%)	0	0.00	0	0	0	0		0			0.00

Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Rezulton se asnjë banor në njësitë e Fierit nuk përfshihen në kategorinë 5, atë më periferiken. Kjo do të thotë që asnjë familje nuk klasifikohet si ato më periferike e që nuk kanë mbulim nga asnjë infrastrukurë publike.

1.12 Konkluzione dhe rekomandime për planin

Mjedisi dhe metabolizmi i territorit

Bashkia Fier bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit me toka pjellore që kultivohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Vend të rëndësishëm zë kultivimi i drithërave, perimtaria, bostanoret, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese, që ka bërë të mundur kultivimin e bujqësisë intensive përgjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe lumi i Semanit së bashku me kanalet e Darëzezës e Vijës së Ngjalës të cilët përshkojnë territorin e Bashkisë në pjesën perëndimore dhe derdhen në detin Adriatik.

Ndërsa nga njëra anë Bashkia Fier ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Semanit, Osumit e Devollit të cilët janë të rëndësishëm për zhvillimin e Bashkisë, nxorri në pah problematikat e këtyre lumenjve, që vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Semanit (ku përfshihen edhe Osumi e Devolli) janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e këtyre lumenjve përdoren edhe në bujqësi, përdorimi i ujërave mund të rrezikojë shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit së bashku me degët e tij (Devolli dhe Osumi), nga burim uji për bujqësinë, këta lumenj mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Duke parë gjendjen në të cilën ndodhen lumenjtë në Bashkinë Fier, rekomandohet që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumenj (projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen

e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efikas të tyre). Veçanërisht, mungesa e zonave ripariane, përmbytjet dhe mungesa e elementeve mbrojtëse të peizazhit në toka bujqësore, janë arsye thelbësore të marrëdhënies problematike lumë-burime ndotëse. Pra, përveç trajtimit/shmangies së ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumenjve, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Devolli dhe Osumi për manaxhimin e integruar të këtyre lumenjve.

Me qëllim shmangien e mbishfrytëzimit të burimeve ujore, rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit (ABU Seman), të ndërmarrë projekte që synojnë përcaktimin e sasisë së ujërave sipërfaqësore (ose nëntokësore) që shfrytëzojnë industritë në përgjithësi dhe industria e naftës në veçanti. Një projekt i tillë kontribuon në përdorimin e ujërave në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme në Bashki duke shmangur konfliktet që mund të krijohen nga mungesa e ujit në lumë për përdorim në bujqësi për shkak të mbishfrytëzimit të tij nga industria e naftës.

Nga dixhitalizimi i territorit të Bashkisë Fier rezulton se grupi i puseve të Kallmit është shpuar drejtpërsëdrejti në akuifer. Duke patur parasysh aktivitetin intensiv të naftës në të shkuarën dhe teknologjinë e vjetëruar të përdorur për shpimet në të shkuarën, si dhe duke patur parasysh se shumë puse naftë kalojnë nëpër akuiferë, ekziston mundësia që Akuiferi i Semanit në Kallm dhe Akuiferi i Vjosës në Kreshpan të jetë ndotur nga industria e naftës gjatë viteve të aktivitetit të saj. Dyshime të thella mbeten edhe për ndotjen e akuiferëve të thellë (nën 200m thellësi) uji i të cilëve shfrytëzohet gjerësisht nga industria e naftës.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin e Semanit dhe të Vjosës është *mungesa e monitorimit të ujërave të këtyre akuiferëve për ndotje nga industria e naftës edhe pse kjo zonë është me rëndësi të veçantë për industrinë e hidrokarbureve*. Industria e naftës ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e Akuiferit të Semanit përdoren me ujë nga disa fshatrat dhe Akuiferi i Vjosës përdoret për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët, është i domosdoshëm monitorimi i të dy akuiferëve për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite. Ndotja e Akuiferit të Vjosës nëpërmjet pus-shpimeve në vendburimin e naftës në vendburimin e naftës në Cakran (Kreshpan) mund të përbëjë problem të jashtëzakonshëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Fier dhe në NjA-të që furnizohen me ujë nga ky akuifer. Me pak fjalë, industria e naftës, në rast se nuk ka marrë masat e mbrojtjes së burimeve ujore nëntokësore në këtë zonë rrezikon të ndotë një ndër burimet ujore kryesore për furnizimin me ujë të popullsisë.

Si përfundim, përveç lumenjve, Bashkia përballet me problemet që kanë të bëjnë me ndotjen e Akuiferit të Semanit dhe Vjosës dhe të akuiferëve të thellë për të cilët ka mungesë totale të dhënash. Për rrjedhojë, duke parë teknologjinë e vjetër dhe të papërshtatshme për mbrojtjen e burimeve ujore që industria e naftës ka përdorur në të shkuarën dhe shpimet në akuifer, është e rëndësishme *që të ndërpritet menjëherë furnizimi me ujë i popullsisë nga Akuiferi i Semanit (puset e fshatrave Kallm)* dhe, njëkohësisht, të merren masa të menjëhershme për monitorimin specifik të ujërave të Akuiferit të Semanit në Kallm dhe Akuiferit të Vjosës në Gorishovë, me qëllim që të përcaktohet nëse ujërat e këtyre dy akuiferëve janë ende të përshtatshme për furnizimin me ujë të popullsisë së Fierit e më tej. Rekomandohen njëkohësisht studime rreth akuiferëve të thellë dhe ndikimit të industrisë në cilësinë e ujërave dhe në përdorimin e qëndrueshëm të tyre.

Ndotja e ajrit në Bashkinë Fier shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, industria e naftës në zona të caktuara dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si industria dhe ndërtimet. Për më tepër, ndotja theksohet edhe për shkak të mungesës së sipërfaqeve të gjelbra urbane sipas standardeve. Fatkeqësisht, në Bashki cilësia e ajrit nuk monitorohet rregullisht për shkak të mungesës së monitorimeve të vazhdueshme në kohë me pajisje fikse.

Me qëllim shmangien e rreziqeve që i kanosen banorëve në zonat urbane (kryesisht nëpër zonat e qyteteve) nga ndotja e ajrit nga mjetet e transportit dhe nga burime të tjera industriale (nga nafta) apo nga sektori i ndërtimeve, është tejet e rëndësishme që të merren masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit nga shkarkimet e automjeteve të transportit në nivel bashkie dhe burimeve të tjera ndotëse.

Ndotja e ajrit në Bashkinë Fier ndihet kryesisht në zonat më të populluara urbane (në zonat qendrore të qytetit) dhe në zonat naftënxjerrëse. Me qëllim shmangien e rrezikut që i kanoset banorëve nga ndotja e ajrit rekomandohet marrja e masave për uljen e ndotjes në ajër, veçanarisht në zonat urbane dhe të naftës. Disa nga këto masa mund të jenë planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimin e politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e hapësirave të gjelbra, bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore si dhe kufizimin e ndërtimive në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Fierit dhe në zonat naftënxjerrëse gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që nevojitin plane të cilësisë së ajrit

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të theksuar në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.[426] Në këtë kontekst, shihet mëse e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtjen nga erozioni i tokës dhe ai detar etj.

Duke vëzhguar me kujdes skenaret e trajtuara më sipër, popullsia në territorin e Bashkisë Fier do të përballet me jo pak probleme në të ardhmen ndër të cilat mund të përmendim: përmbytjet nga rritja e nivelit të detit, shtimin e rasteve të zjarrit, thatësirat e zgjatura, përmbytjet nga fryrja e rrjedhave të lumenjëve dhe kërkesat në rritje për ujë në bujqësi dhe në uljen e sasisë së ujit të përdorshëm për të. Njëkohësisht, parashikohet edhe humbje të sipërfaqes së tokës në pjesën bregdetare të territorit të bashkisë. Popullsia në territorin e Bashkisë, në zonat të cilat janë në kuota të ulëta mbi nivelin e detit, do të pësojnë dëmtime nga rritja e nivelit të detit, kripëzimin e ujit të pishëm dhe kripëzimin e tokave bujqësore. Ndërsa zonat e banuara në afërsi të brigjeve të lumenjve do të preken së tepërmi nga përmbytjet, të cilat priten të shtohen si pasojë e shirave intensive. Zhvillimi bujqësor do të sigurojë të ardhura më të pakta për banorët, pasi rritja e periudhës së thatësirave çon në rritjen

e kërkesës për ujë dhe aktualisht kanalet ujitës nuk janë totalisht në funksion. Gjithashtu parazitet dhe shtimi i numrit të insekteve që trasmentojnë sëmundje do të jetë një problem serioz në përhapjen e epidemive të ndryshme.

Fluksi i ushqimit tregon se Fieri është i specializuar më tepër në perime e drithëra (sigurisht dhe foragjere) sesa frutorë. Kjo lidhet me cilësinë e lartë të tokës (boniteti që përgjithësisht është 4 ose më pak) dhe të territorit fushor.

Sa i përket energjisë, Fieri ka potencial të lartë për përdorim të burimeve alternative, si energjia gjeotermale, dielli dhe era në zonën bregdetare. Mirëpo, edhe nga shifrat e nivelit kombëtar, kuptohet se prodhimi i energjisë vazhdon te jetë i fokusuar tek burimet ujore. Fakti që eksporti përbën vetëm 8.6% të asaj që importojmë, veç humbjeve në rrjet, tregon edhe që potenciali i burimeve alternative nuk përdoret. Po ashtu, përdorimi nga familjaret është thuajse i njëjtë, madje më i lartë sesa konsumatorët e tjerë së bashku. Pavarësisht humbjeve në rrjet kjo përqindje e lartë konsumi nga familjarët tregon se burimet alternative duhet të synojnë jo vetëm sektorët e tjerë të ekonomisë, si bujqësia etj., por edhe konsumatorët familjarë.

Peizazhi, Pyjet e Biodiversiteti

Ruajtja e fondit pyjor përbën aktualisht një ndër problematikat më të mëdha në vendin tonë dhe jo vetëm. Në rang bashkie, sipërfaqet e fondit pyjor kanë të nevojshme:

- Hartimin e planeve për menaxhimin e të çdo ekonomie pyjore e kullosore në Bashki. Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar NjA-së Cakran sepse aty ndodhet një numër i madh pemësh i rrëzuar.

- Mbjellja e zonave ripariane përgjatë lumit Seman me qëllim kthimin e këtyre zonave në objekte mbrojtëse dhe rigjenerimin e florës dhe faunës.

- Marrja e masave për ndalimin e peshkimit pa kriter në Objektin e Kërrnicës duke krijuar mundësinë e shtimit të faunës në zonë.

- Hartimin e një Plani Veprimi për rehabilitimin e sipërfaqeve të djegura që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale (për shembull. sipërfaqet me pisha) por dhe mbjelljen e tyre me pemë të cilat kanë qënë autoktone.

- Marrjen e masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarreve, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjt e zonës)

Komponentët peizazh-formues si ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit por problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre.

Peizazhi Urban dhe ***Industrial***, karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qëndrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordurea të ngritura e disa pa bordurëa. Ndërkohë pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekorative apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/dominuese apo edhe të padëshiruar shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbëra penguese të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruar ndodhin në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi mungojnë bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi dy metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët, si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.

Të tri tipologjitë e peizazhit ***rural***, ***natyror*** dhe ***ujor*** karakterizohet nga elementë të ndryshëm, por shkalla e lartë e ndërveprimit mes tyre bën që edhe problematikat e njërit të shfaqen edhe tek tjetri. Sipërfaqet ujore të cila karakterizohen nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale nuk mund të shihen veçmas nga fasha rurale e natyrore pasi here-herë ato shfaqen si "*hinka*" ku marrin dhe mbajnë materialet organike në matricën përreth si dherat, farat etj, dhe herë thjesht si "*kanale*" ku rrjedh energjia, ushqimi etj.

Peizazhi ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqet i "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesen tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë kur trupi ujor përshkon fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

Ndonëse pjesë dominuese dhe e pandashme e peizazhit urban, një tjetër element lidhës në territor janë ***rrugët.*** Ato krijojnë "çarje" mes fashave por edhe "lidhje" fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike pasi si fasha ujore edhe ato shpërhapen në territor ku ndryshimi peizazhistik bëhet edhe më i dukshëm.

Peizazhi ***Natyror*** mbetet më kompleksi ndër fashat peizazhistike. Ai karakterizohet nga një sërë elementësh peizazhistikë të cilët shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë. Hartat më sipër shfaqin këto elemente dhe rreziqet me të cilët përballen disa prej tyre. Tokat e lagura rrezikojnë të kripëzohen si pasojë e erozionit detar, trupat ujorë rrezikojnë daljen nga shtrati si pasojë e tjetërsimit të zonës ripariane dhe shfrytëzimit të materialeve inerte, si dhe fragmentimi i ngastrave natyrore dhe mungesa e theksuar e korridoreve të kalimit rrezikon largimin e jetës së egër nga kjo fashë.

Demografia

Bashkia Fier në 1 janar 2015, regjistroi një numër te popullsisë rezidente prej 122 mijë banorë nga te cilet 61 mijë meshkuj dhe 60 mijë femra. Rreth 46% e popullsisë

së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe 54% si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grup-moshës 15-64 vjeç dhe 20% grup-moshës 90-14 vjeç, tregues këto që demonstrojnë potencial te lartë te popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e së cilës në tregun e punës do te ndikojë në rritjen e përformances ekonomike dhe përmiresimin e mirëqenies së popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente, si dhe mosha mesatare e saj, relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.

Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta te migrimit te brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetem në rënien e numrit te popullsisë, por edhe në ndyshimin drastik të strukturës së saj demografike.

Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës rezidente te qarqëve/bashkive është edhe migrimi i brëndshëm i popullsisë, pra levizjet e popullatës nga një qark në tjetrin.

Sipas projeksioneve të popullsisë - skenari i rritjes së mesme - popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor, rreth 1% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.

Popullsia rezidente e bashkisë Fier deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin "divident demografik".

Për të përfituar nga ky "divident demografik", kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qëndror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori te popullatës, me qëllim rritjen dhe përmiresimin në vazhdimësi të mirëqenies së saj.

Mirëqënia ekonomiko-sociale

Niveli i përgjithshëm arsimor i popullsisë është jo i favorshëm, me 60-70% të popullsisë në njësitë administrative rurale që ka përfunduar vetëm arsimin fillor, dhe shkallë analfabetizmi të lartë në njësitë ku kemi prezencë popullsie rome, si Qendër dhe Levan. Ndjekja e arsimit të lartë shënon nivelet më të ulëta në krahasim me bashkitë e të njëjtit lloj.

Bashkia Fier ka 85 kopshte, 63 shkolla fillore e 9-vjeçare dhe 22 shkolla të mesme të përgjithshme, nga të cilat 4 janë profesionale, me drejtim artistik, sportiv, teknik e bujqësor. Mbulimi me kopshte është mjaft i dobët, ku mbi 50% e territorit nuk mbulohet me këtë shërbim, ndërkohë që shkollat 9-vjeçare mbulojnë 89% të territorit urban dhe ato të mesëm 82%. Nevoja më e lartë për kopshte i takon qytetit të Fierit dhe njësive Dërmenas, Libofshë, Portëz dhe Cakran, për shkolla 9-vjeçare Dërmenasit dhe Libofshës, si dhe për shkolla të mesme Portëzës dhe Levanit. Objektet arsimore nuk zbatojnë standardet e sipërfaqes/student, por përgjithësisht kanë kushte të mira fizike dhe kapacitet akademik të lartë në raport me qarkun.

Shëndeti publik i bashkisë Fier rrezikohet nga sëmundjet diareike, kardiovaskulare, mundësitë e epidemive gastro-enterite për shkak të ushqimit, si dhe nga sëmundjet kancerogjene të frymëmarrjes për shkak të ndotësve të industrisë së naftës apo shpërthimeve aksidentale të gazit metan.

Shërbimi shëndetësor përbëhet nga 1 spital rajonal, 12 qendra shëndetësore dhe 85 ambulanca, të cilat mbulojnë nevojat e pjesës më të madhe të popullsisë. Në qytetin e Fierit gjenden shërbimet mjekësore të specializuara, si konsultore të fëmijës e nënës, poliklinika etj. Gjendja fizike e spitalit, poliklinikës dhe ambulancave nuk është e mirë dhe kërkon ndërhyrje rikonstruktuese.

Bashkia Fier ka shkallën më të lartë të papunësisë në qark, pas Patosit. Papunësia prek më tepër femrat se meshkujt dhe pothuajse 50% të fuqisë punëtore të moshës 15-24 vjeç. Sektori i shërbimeve është më dominant, por në njësitë rurale mbizotëron punësimi në sektorin bujqësor. Vërehen tendenca për kalim nga punësim në sektor bujqësor në punësim në sektor privat. Të ardhurat për frymë dhe shpenzimet mesatare mujore të familjeve në nivel qarku dëshmojnë për mirëqenie më të ulët se qarqe të ngjashme. Niveli i varfërisë së skajshme është më i mirë se në rajon. Mirëqenia sociale mbulohet pjesërisht nga disa institucione të kujdesit të të rinjve e të moshuarve, dhe disa qendra kulturore e sociale në qytetin e Fierit.

Zhvillimi ekonomik

Qarku i Fierit është një nga qarqet me nivelin më të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto në Shqipëri.

Evidentohet një mbizotërim i qartë i sektorit të shërbimeve në raport me sektorin e turizmit dhe atë të industrisë, pavarësisht potencialeve turistike që gjenden në territorin e bashkisë dhe faktit se industria është një nga sektorët me ndikimin më të madh në rritjen e Vlerës së Shtuar Bruto.

Njësitë administrative Levan, Topojë, Portëz, Libofshë, Dërmenas dhe Mbrostar rezultojnë si njësitë më ndërvepruese me qytetin e Fierit. Në të njëjtën kohë, Mbrostari dhe Levani rezultojnë si njësi kyçe të pikave të grumbullimit dhe magazinimit të produkteve bujqësore

Njësitë administrative të Dërmenasit dhe Libofshës kanë numrin më të madh të fermave blegtorale, ndërsa njësia administrative e Frakullës ka numrin më të madh të serrave bujqësore.

Zhvillimi bujqësor

Në ndryshim nga prirjet e përgjithshme kombëtare, numri i banorëve në zonat rurale të Bashkisë Fier e tejkalon numrin e banorëve në zonat urbane, përkatësisht me 53% popullsi rurale dhe 46% popullsi urbane[427]. Për më tepër, sipas skenarëve vlerësues të projeksionit të popullsisë (2015-2031), mendohet se përveçse një rënie prej 1% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, numri i banorëve në zonat urbane do të tejkalojë numrin e banorëve në zonat rurale. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosjeje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brendshëm dhe ndër të tjerave, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor[428]. Kjo prirje demografike me migrim të të rinjve ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural në bashkinë e Fierit si dhe vendosjen e balancave të drejta e të qëndrueshme rural–urbane dhe mbrojtjen e tokave potenciale bujqësore.

Aktiviteti bujqësor është shumë i rëndësishëm për ekonominë e Fierit, por nga pikëpamja mjedisore haset me dy sfida të mëdha: 1) me faktin që bujqësia po shndërrohet gradualisht nga familjare në intensive; 2) me mungesën e përgatitjes teknologjike dhe të njohurisë mbi tokën për t'u përshtatur me këtë shndërrim.

Zhvillimin e bujqësisë në bashki, përveç klimës, terrenit dhe tokave të përshtatshme, e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë hidrik dhe i kanaleve ujitëse-kulluese, i cili mundëson kultivimin e bujqësisë intensive gjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe Baseni i Semanit dhe Vjosës, të cilët përshkojnë territorin e bashkisë në pjesën qendrore e jugore përkatësisht dhe përbëjnë burim për ujitjen e bimëve. Ndërsa nga njëra anë Bashkia e Fierit ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Semanit e Vjosës, të cilët janë të rëndësishëm edhe për Fierin, nxori në pah problematikat e këtyre lumenjve të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga veprimtaria njerëzore dhe ndotjen e tyre. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Semanit e Vjosës janë të ndotura thellë me metale të rënda. Dhe si pasojë përdorimi i ujërave të ndotur për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit produkteve bujqësore. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit e Vjosës, nga burim uji për bujqësinë, këta lumenj mund të kthehen në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Në shumë njësi administrative të Bashkisë së Fierit, territori ka përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të dhe për shkak të puseve të industrisë së naftës të përdorur gjatë aktivitetit naftënxjerrës ndër vite.

Mungesa e rehabilitimit te sistemit te kullimit e ujitjes, për më tepër në zonën fushore ku ujërat nëntokësore janë në afërsi të sipërfaqes dikton nevojën urgjente të rehabilitimit të sistemit.

Problematika të tjera që po hasen në zhvillimin e bujqësisë në Fier lidhen kryesisht me degradimin e tokave për shkak të erozionit, kripëzimit, kënetëzimit, përmbytjeve, gërryerjeve të tokës dhe shembjes së brigjeve të lumenjve shkaktuar nga Semani e Vjosa. Edhe pse Fieri renditet si zonë me tregues të ulët erozioni vjetor, në muajt e reshjeve të shumta erozioni arrin në 10 ton/ha/vit. Ndër zonat e prekura nga erozioni dallohet fshati Lalar dhe në zona të tjera kodrinore të njësive administrative Mbrostar dhe Portëz ku erozioni është rritur progresivisht në vitet e fundit[429]. Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit, një nga dukuritë që po vihet re është ai i degradimit të tokës. Nuk ka shifra në nivel vendor, por në rang vendi vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[430].

Toka në Fier vuan edhe nga përmbytjete vazhdueshme të shkaktuara nga Semani dhe Vjosa edhe pse ndërtimi i paneleve mbrojtëse ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes. Ndër zonat më të prekura nga përmbytja në Fier janë zallishtorja dhe tarraca e parë e mbizallishtores[431]. Sipas AKM-së, Lumi Seman përmbytet në rrjedhën e poshtme dhe në zona të caktuara të rrjedhës së mesme. Lumi i Vjosës përmbytet në

rrjedhën e poshtme të tij dhe në afërsi të Gjirokastrës në Lumin Drinos[432]. Përmbytjet shoqërohen me depozitime të ngurta në tokat bujqësore, gërryerje të brigjeve në Lumin Vjosë[433] ose ndryshim të vijës bregdetare dhe gërryerje të tokës bujqësore. Sipas AKM-së[434], Lumi Vjosë ka shkaktuar erozionin e tokës bujqësore në sektorë të caktuar si Lazarat, Palokastër dhe Virua të degës së Drinosit, Frakull, Trevëllazën, Mifol, Varibob, Bishan, të Vjosës. Rrezikime dhe prishje të objekteve inxhinierike, siç janë ura, vepra mbrojtëse dhe argjinatura (segmentet Drinos-Odrie, Hekal-Selishte-Hambar, Ura e Mifolit-Ada). Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, brezi i gjelbër (zona ripariane) e Semanit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë të gjithë brezat e bimësisë së nevojshme nga bimët e ulëta deri tek ato të larta, ose këto breza nuk ekzistojnë).

Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës. Konkretisht, zvogëlimi/ngushtimi i brezit të gjelbër është vënë re përgjatë gjithë trupit ujor të Lumit Seman, ndërkohë dëmtime e deri në humbje të këtij brezi vërehen në seksionin e lumit që kalon ndërmjet Mbrostarit dhe Portëzës.

Bujqësia, mbetjet bujqësore, erozioni ujor, ndotjet industriale dhe urbanizimi janë faktorët kryesorë të ndotjes së ujit të lumit të Gjanicës. Përbërësit e azotit janë ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por të mbipërdorur në bujqësi dhe shkaktojnë ndotjen e lumenjve për shkak të derdhjeve industriale, të ujërave të zeza e të gropave septike në to. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit, nga një burim uji për bujqësinë, Semani mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Problemi më i madh është në zonën e Povelçës, ku tokat para 30 vitesh iu nënshtruan procesit të shkripëzimit, por pas vitit 1990 ky proces u ndërpre. Në varësi të nivelit të kripëzimit tokat dobësisht të kripura mund të përdoren për bujqësi veçanërisht për bimet foragjere specifike të qëndrueshme ndaj kripes dhe pjesërisht nga tokat mesatarisht të kripura nëpërmjet përmirësimit të sistemit të kullimit. Ndërsa tokat e kripura dhe shume të kripura mund të kalojnë për përdorime të tjera.

Është shumë e rëndësishme që zhvillimi i bujqësisë të ecë në dy binarë paralelë: bujqësi shkalle /intensive dhe bujqësi familjare. Kjo e fundit është përqendruar në shkallë të gjerë kryesisht në zonat malore-kodrinore. Përveç sigurimit të mbijetesës së popullatave të zonave me reliev të thyer, kjo bujqësi ka treguar se i reziston faktorëve klimatikë dhe ekonomikë dhe luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit.

Në zonën fushore intensifikimi i bujqesisë, puna për zmadhimin e fermave së paku në dy herë, konsolidimi i tokës dhe përmiresimi i sistemeve të prodhimit siguron nje zhvillim te bujqësisë, mirëqenie, të ardhura dhe mbrojtjen e tokës. Në bazë të kushteve konkrete në territorin e bashkisë bëhen efektive zbatimi i sistemeve bujqësore të diferencuara për zonën fushore, për zonën kodrinore dhe specifike për tokat e kripura dhe ato me pjellori të kufizuar. Në zonën kodrinore prioritet mbetet zhvillimi i pemëtarise, ullirit dhe vreshtarisë, në zonën fushore bimët e arave, shtimi i gjedhit në blegtori, serrave të perimeve.

Masa të tjera mund të jenë edhe mbështetja e drejtpërdrejtë financiare e fermerëve jo vetëm me qëllim shtimin e prodhimit bujqësor, por edhe me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ata duhen mbështetur edhe që të kryejnë eksperimentime lidhur me diversifikimin e të mbjellave, futjen e varietete të ndryshme agronomike që i rezistojnë ndryshimeve klimatike, ndërtimin e sistemeve të lajmërimit për mbrojtjen nga temperaturat tejet të ulëta (ngricat) dhe të larta (thatësirave) etj., që bëjnë të mundur përshtatjen e bujqësisë me ndryshimet klimatike.

Një masë tjetër e rëndësishme është edhe futja e shërbimit keshillimor të agronomisë falas për fermerët, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e teknologjive te avancuara të kultivimit, ujitjes, kullimit, sistemit të farave, përmirësimit të strukturës së prodhimit dhe zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme.

Futja e sistemeve me ujitje me pika, me riciklim të ujit të shiut ose e sistemeve të qëndrueshme të punimit të tokës janë themelore për zhvillimin e bujqësisë në një kohë thatësire. Njëkohësisht, duke informuar fermerët rreth përdorimit me kujdes e në sasinë e duhur të plehrave kimike, agronomët ndikojnë në uljen e përdorimit të tyre dhe si rrjedhojë, ndikojnë në shmangien e ndotjes së ujit nga bujqësia.

Konsolidimi i tokës, për zonat fushore, tipike për bashkinë e Fierit mbetet çelësi i suksesit për transformimin e bujqësisë dhe instrument i rëndesishëm në zhvillimin rural, duke filluar nga format më të thjeshta të punës në grupe, shoqata fermerësh, tregu i tokes deri në zbatimin e politikave favorizuese shtetërore dhe mbështetjes për fermerët që konsolidojnë tokën.

Balancat rural-urbane duhet të forcohen në funksion të mbrojtjes së tokave me potenciale bujqësore, nëpërmjet planifikimit;

Duhet të zbatohet kriteri i pershtatshmerisë së tokave bujqësore në përputhje me efektivitetin ekonomik dhe kërkesat e bimëve sipas vlerësimit të tokës;

Duhet të konsolidohet toka bujqësore në kuadër të nismave të bashkisë, grupeve të interesit dhe politikave në nivel kombëtar;

Duhet të përfundojë procesi i regjistrimit të pronësisë dhe krijimi i dokumentacionit bazë;

Duhet të ngrihen laboratorë për zbatimin e teknologjive bujqësore për të kryer analizat e tokës dhe për të përdoriur kimikatet mbi bazën e këtyre analizave, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Përdorimi i tokës

Gjatë analizës së përdorimit të tokës është evidentuar qartazi se pjesa më e madhe e territorit, pra rreth 70% e tij, klasifikohet si tokë bujqësore, ndërsa 20% klasifikohet si territor natyror. Po në këtë nivel qëndrojnë edhe kategoritë Arsim, Shëndetësi dhe Institucione (18%). Ajo që bie në sy është se kategoria “Banim” zë vetëm 3,4% të territorit të bashkisë së re të Fierit.

Infrastruktura rrugore

Bashkia Fier është pjesë e korridoreve të rëndësishme kombëtare duke e kthyer në një qytet me tregues të lartë lëvizshmërie. Megjithatë, nivelin më të lartë të lëvizshmërisë bashkia e ka me qytetin e Mallakastrës, Tiranës dhe Patosit

Si pasojë e reformës territoriale, Bashkia e Fierit tashmë ka një shumëfishim të sipërfaqeve rrugore, të cilat gjenden në territorin e saj. Sot në territorin e bashkisë numrin më të madh të rrugëve e zënë ato lokale me funksion bujqësor.

Levani ngelet një nga nyjat më kryesore të infrastrukturave në bashki, por nga ana tjetër është e nevojshme që të tregohet vëmendje në ekzistencën e 179 pikave konfliktuale të identifikuara, përfshirë këtu edhe pikat që gjenden në Levan.

Furnizimi me ujë

Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm, edhe në vetë zonën urbane në Fier (në qytetin e Fierit ofrohet vetëm në masën 85%).

Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar, ose është shtrirë në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë standardeve higjieno-sanitare.

Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndotin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore të kanaleve dhe emisarëve, si edhe kemi shkarkime direkte në ujërat e lumit Seman e Shkumbin.

Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujrave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare, ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara).

Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura urbane është parashikuar të ndërtohet paralelisht me rehabilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujërave të ndotura. Nevojitet një studim përcjellës për të përcaktuar karakteristikat dhe elementet kryesore ndotës të ujërave në Fier në mënyrë që të përzgjidhet metodologjia dhe teknika më e përshtatshme trajtuese në impiant. Gjithashtu, pozicioni në terren që do të ketë kjo vepër, mbart potencial të konsiderueshëm rreziku ndaj ndotjes së mjedisit për faktin se është shumë pranë trupave ujore sipërfaqësore e njëkohësisht pranë zonave të populluara.

Ndriçimi publik

Ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik hyn ndër funksionet e veta të pushtetit vendor si dhe bashkitë kanë të drejta eksluzive mbi ofrimin e këtij shërbimi në territoret e tyre. Gjithashtu Këshilli Bashkiak vendos mbi kriteret e ofrimit të këtij shërbimi.

Në Bashkinë e Fierit ky shërbim ofrohet në Qytetin e Fierit, në NjA-të Libofshë, Topojë, Dërmenas, Qendër-Fier, Portëz, Cakran, Frakull dhe Levan, ndërsa në NjA-në Mbrostar ky shërbim nuk ofrohet.

Në total në Bashkinë Fier ka rreth 75 km rrjet rrugor të ndriçuar rreth 175 akse rrugore me 2,471 shtylla ndriçimi. Në këtë bashki ka gjithashtu 6 sheshe dhe 3 lulishte të ndriçuara.

Në Qytetin e Fierit ka rreth 35.2 km rrugë të ndriçuara me rreth 33.6 % e rrjetit rrugor të ndriçuar që do të thotë se është një statistikë e ulët në raport me rrjetin e përgjithshëm rrugor. Në qytet ka rreth 1,595 shtylla nga të cilat 50 janë jashtë funksionit dhe nuk punojnë. Vlen të përmendet që ndriçimi publik në Qytetin e Fierit në disa zona është i amortizuar dhe jo cilësor. Kjo vjen si pasojë e dëmtimit të kabllove lidhëse si dhe dëmtimit të kokave të ndriçimit dhe llambave.

Përgjithësisht në njësitë administrative ky shërbim ka problematika më të mëdha se në qytetin e Fierit. Në NjA-në Libofshë ky shërbim ofrohet vetëm në 2 nga fshatrat e NjA-së. Në total ka 27 ndriçues dhe të gjithë janë jashtë funksionit. Në NjA-në Topojë ky shërbim ofrohet në të gjithë fshatrat e NjA-së. Ka një numër prej 234 ndriçuesish por rreth 43 % e këtij rrjeti është jashtë funksionit. Po ashtu në NjA-në Qendër-Fier ky shërbim ofrohet në të gjithë fshatrat, por rreth 45% e rrjetit të ndriçimit publik nuk funksionon. Në NjA-në Levan shërbimi i ndriçimit publik ofrohet në 7 nga 13 fshatrat dhe rreth 15 % e rrjetit është jashtë funksionit. Në NjA-në Dërmenas ky shërbim ofrohet vetëm në 3 fshatra dhe rreth 25 % e rrjetit është jashtë funksionit. Në NjA-në Frakull ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Frakull i Madh. Në NjA-në Portëz ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Portëz si dhe në NjA-në Cakran ky shërbim ofrohet vetëm në fshatin Cakran me një numër shumë të vogël ndriçuesish.

Kyesisht problematikat kyesore të mosfunksionimit të rrjetit të shërbimit të ndriçimit në NjA-të janë dëmtimi i kabllos lidhëse ndërmjet ndriçuesve dhe kabinave elektrike si dhe dëmtimi i shtyllave dhe i kokave të ndriçimit. Një problem tjetër për NjA-të është dhe pamundësia e shlyerjes së kostove të energjisë elekrike.

Përsa u përket kostove dhe të ardhurave për ofrimin e këtij shërbimi vërehet se pjesa më e madhe e kostove të këtij shërbimi janë kostot e energjisë elektrike dhe se të ardhurat janë në një nivel mjaft të ulët, rreth 19.2% të kostove totale dhe rreth 24.2% të kostove të energjisë elekrike. Kjo situatë do të thotë që niveli i arkëtimit të tarifave të ndriçimit është mjaft i ulët dhe për të ofruar këtë shërbim, Bashkisë Fier i duhet të akordojë fonde shtesë. Në këtë situate, kur fondet shkojnë për pagesat e faturave të energjisë elektrike kemi më pak fonde që shkojnë për mirëmbajtjen ose dhe për investime të reja.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Fillimisht Bashkia Fier ka nevojë për të përditësuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë.

Vend-depozitimi në veri të qytetit, duke u kufizuar nga dy rrjedha sipërfaqësore si lumi Gjanicë dhe Kanali i Madh, kombinuar kjo edhe me elementët e sigurisë të cilët mungojnë në këtë sit përbën pikërisht një vatër të nxehtë mjedisore për Bashkinë Fier. Shpeshtitë e prurjeve maksimale qoftë të lumit Gjanicë apo edhe nga rreshjet e

denduara kanë përmbytur seksione të caktuara të këtij venddepozitimi. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:

- Emetimet e gazrave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme.
- Shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore.
- Infiltrimi i shllameve nga dekompozimi mbetjeve në akuiferin e Fierit.

Depozitimi i mbetjeve inerte anës brigjeve të lumit Gjanicë dhe kanalit të madh si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për manaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) administrohen nga subjekte private në varësi të kushteve kontraktuale. Monitorimi i këtyre kontratave në terren paraqet mangësi pasi janë identifikuar shkarkime industriale në zonat ku janë puset aktive të naftës, vërehen emetime të gazrave në atmosferë prej impianteve të përpunimit të naftës si edhe shkarkime të ndryshme identifikuar gjatë vizitave në terren.

Skema të ndryshme të 3R (Reduktim – Riciklim – Ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në Bashkinë Fier. Faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti Rom & Egjiptian në Fier. Fushata dhe projekte pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili mund të ripërdoret sërish në bujqësi.

Projekti për ndërtimin e landfill-it rajonal në Bashkinë Fier paraqet një iniciativë pozitive për manaxhimin e mbetjeve në tërësi. Duke qënë i pozicionuar pranë brigjeve të Lumit Gjanicë dhe krahas masave paraprake të marra për mbrojtjen mjedisore nga impaktet që do të ketë ky impiant nevojitet që monitorimi mbi të të jetë i shpeshtë.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, pranë qytetit të Fierit përbëjnë një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re që duhet të adoptojë bashkia e Fier për manaxhimin e integruar të mbetjeve. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Fier.

Sistemi i kullimit e vaditjes

Nga analizimi i gjendjes ekzistuese duhet të thuhet se situata e gjendjes teknike e rezervuareve paraqitet jo e mirë. Rezervuarët në të cilët ka nevojë për rehabilitime janë rezervuarët e Zharrëzës dhe të Levanit. Gjithashtu nga analizat e mësipërme, kanalet kullues dhe vaditës të dytë paraqesin problematikën më të madhe. Këto kanale në pjesën më të madhe të tyrë janë të bllokuar nga inerte dhe mbetje bujqësore. Gjthashtu vërehet se rrjeti i kanalizimeve bujqësore ka nevojë të rehabilitohet në masën 60 % të tij.

2. Plani i Zhvillimit të Territorit

2.1 Plani i Propozimeve Territoriale

2.1.1 Thellimi i vizionit territorial të zhvillimit

Ky seksion risjell deklaratën e vizionit të Bashkisë Fier për 15 vitet e ardhshme, të dakordësuar në Dokumentin e Strategjisë Territoriale të Zhvillimit, si dhe parimet bazë mbi të cilat është ndërtuar ky vizion.

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Fierit është hartuar në mënyrë organike, si rezultat i gjetjeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupe interesi dhe reflektimeve të grupit të punës gjatë studimit të kontekstit rajonal në të cilin ndodhet Bashkia. Po ashtu, vizioni i Fierit bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe të Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit. Mbi këto baza, pjesëmarrësit në këto diskutime, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord në formulimin e vizionit strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Fierit gjatë 15 viteve të ardhshme, si më poshtë:

"Zhvillimi i Bashkisë Fier do të udhëhiqet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe do të ketë në fokus mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, mbështetur në një mjedis të shëndetshëm dhe me aftësi vetëripërtëritëse. Koncepti i zhvillimit të Fierit shkon përtej atij ekonomik, duke synuar gjithmonë e më tepër që ky i fundit të harmonizohet me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe, promovimin e zhvillimit intelektual, si shtylla që do të garantojnë që nga ky zhvillim të përfitojnë të gjithë qytetarët, duke menduar gjithmonë për t'u trashëguar brezave të ardhshëm një territor të frytshëm e mjedis të shëndetshëm.

Bashkia Fier do të konsolidojë profilin e saj si pol i zhvillimit ekonomik rajonal, përmes diversifikimit të ekonomisë së saj dhe krijimit të kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë së kësaj Bashkie në nivel vendi dhe më gjerë. Ne besojmë tek parimi i subsidiaritetit, ndaj synojmë që polet e zhvillimit ekonomik t'i decentralizojmë në të gjithë territorin e Bashkisë Fier, aty ku potencialet për zhvillim janë më të mëdha, më të përshtatshme për t'u përdorur dhe në harmoni me mjedisin.

Përtej të gjitha burimeve të shumta që disponon Bashkia, ne besojmë që aseti më me vlerë janë qytetarët e saj. Ndaj rëndësi e veçantë do t'i jepet nxitjes së kualifikimit të burimeve njerëzore, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktivë në tregun e punës. Kjo do të përkthehet në mbështetje dhe nxitje të arsimimit të qytetarëve të bashkisë, në të gjitha ciklet, përfshirë atë profesional, duke maksimizuar kushtet për ta bërë këtë brenda Bashkisë Tonë.

Ne synojmë të ofrojmë të njëjtin standard shërbimesh në të gjithë territorin e Bashkisë, me qëllim zbutjen e pabarazisë sociale dhe ekonomike të banorëve të saj. Qëllimi është të zvogëlojmë sa më shumë të mundemi diferencën urbane-rurale përsa i përket cilësisë së shërbimeve publike si infrastruktura, arsim, shëndetësia si dhe ofrimit të

mundësive për zhvillim ekonomik. Ndaj misioni në funksion të këtij vizioni zhvillimi do të jetë vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Fier"

Figura 198. Vizioni i bashkisë dhe polet kryesore të zhvillimit.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Në vazhdim, ky vizion është përkthyer në objektiva strategjike, programe dhe projekte, sipas 5 parimeve kryesore, të cilat i shërbejnë thellimit të potencialeve aktuale, si dhe realizimit të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë të territorit:

1. Diversifikimi dhe bashkëjetesa e sektorëve të ndryshëm ekonomikë: bujqësi, shërbime, industri e turizëm si dhe promovimi i përzierjes së funksioneve (miksi);

2. Mbrojtja e tokës bujqësore dhe konsolidimi i saj;

3. Ruajtja dhe rehabilitimi i mjedisit natyror, ujor e bregdetar;

4. Projektimi i shtrirjes dhe densifikimit urban në përputhje me popullsinë e pritshme dhe kapacitetin mbajtës të zonave;

5. Lidhja e territorit nëpërmjet akseve parësore automobilistike dhe dytësore rekreative/bujqësore.

Parimi 1, diversifikimi i sektorëve ekonomikë, i përgjigjet karakterit dominues ekonomik rajonal të Fierit, si dhe potencialeve të fshehura të tij, që synohen të zhvillohen. Në territorin e Bashkisë Fier identifikohen 4 sektorë kryesorë të ekonomisë, që do jenë motorët e zhvillimit dhe punësimit për 15 vitet e ardhshme: bujqësia, mbështetur në konsolidim të tokës bujqësore, rritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë sektor, si dhe rehabilitimin e shërbimeve ndihmëse (shih Seksionin 2.1.1.d); industria, e cila bazohet në nxjerrjen e naftës në zonën ekzistuese të Mbrostarit, zhvillimin e industrisë së lehtë në zonat ekzistuese industriale dhe të Azotikut, si dhe zonat në shërbim të rrjetit TAP në afërsi të bregdetit të Semanit; shërbimet, të cilat nënkuptojnë fuqizimin e Fierit dhe të dy poleve të tjera të rëndësishme në territor: Mbrostarit dhe Levanit, me fokus tregtinë, ndërtimtarinë, rekreacionin, arsimin, shëndetësinë etj; si dhe turizmi, si një nënsektor i shërbimeve, i cili do ngrihet mbi potencialet bregdetare, kulturore, peizazhistike e agrikulturore. Për të siguruar bashkëjetesën e këtyre sektorëve, si dhe zhvillim ekonomik të barabartë nga pikëpamja e shtrirjes hapësinore, është propozuar specializimi i njësive administrative sipas skemës së mëposhtme:

Fier: Qendër multifunksionale, ekonomike, shërbimesh, arsimi, shëndetësie, kulturore, rekreative, tregtare;

Libofshë: Zhvillim i ekoturizmit dhe turizmit kulturor, bujqësi-blegtorisë dhe shërbimeve;

Topojë: Zhvillim i bujqësisë dhe përpunimit bujqësor, turizmit bregdetar, shërbimeve;

Qendër: Zhvillim bujqësor dhe shërbimesh;

Dërmenas: Zhvillim i turizmit bregdetar, kulturor dhe ekoturizmit, si dhe bujqësisë;

Levan: Zhvillim shërbimesh, bujqësie dhe ekoturizmi/turizmi bregdetar;

Frakull: Zhvillim bujqësor-blegtoral;

Cakran: Zhvillim bujqësor-blegtoral dhe turizëm kulturor/ekoturizëm;

Portëz: Zhvillim shërbimesh industriale dhe ndërtimi;

Mbrostar: Zhvillim industrial dhe nxjerrje nafte; shërbime tregtare dhe bujqësore.

Në vazhdim të kësaj, vendbanimet e secilës njësi administrative janë specializuar më tej, duke marrë në konsideratë zhvillimin ekzistues dhe potencialet avantazhuese:

- Vendbanime me karakter miks: shërbime, ekonomi e bujqësi: *Mbrostar, Libofshë, Çlirim, Levan;*
- Vendbanime bujqësore: *Seman i Ri, Grykë, Hamil, Muçaj, Hoxharë, Agim, Rreth Libofshë;*
- Qendra të grumbullimit bujqësor: *Libofshë, Cakran, Levan, Mbrostar;*
- Shërbime të bujqësisë: *Daullas, Grecalli;*

- Qendra përpunimi bujqësor (kallamishte): *Sheq Marinas, Seman;*
- Blegtori/Bujqësi/Pemëtari: *Frakull, Kafaraj, Peshtan;*
- Ekoturizëm/Agroturizëm: *Adriatik, Pojan, Bashkim, Boçovë, Levan, Hasturkas, Ndërnënas;*
- Turizëm kulturor: *Libofshë, Vanaj, Cakran, Pojan;*
- Turizëm bregdetar: *Pishë, Darzezë;*
- Industri e lehtë, ndërtimtari: *Portëz;*
- Industri e rëndë, nxjerrje nafte: *Kallm i Vogël, Kallm i Madh;*
- Shërbime: *Drizë, Drizë Myrtezaj, Afrim;*

Figura 199. Harta e specializimit ekonomik të njësive administrative.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Parimi 2 e 3 shfaqen në masat për ruajtjen e tokës bujqësore, si dhe për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, pyjeve, rehabilitimin e zonave ripariane, në masat për mbrojtjen e bregdetit, si dhe ato kundër ndotjes, të përshkruara në seksionin 2.3.

Parimi 4, projektimi i shtrirjes dhe densifikimit urban në përputhje me popullsinë e pritshme, vjen si përgjigje e drejtpërdrejtë e 3 të parave, për të strehuar nevojat për akomodimin e shërbimeve të reja, si dhe për të mbrojtur asetet ekzistuese. Ky projektim shtjellohet gjerësisht në seksionin 2.1.5 dhe synon të japë zgjidhje realiste të zhvillimit, pa çuar në spekullim të pronave.

Parimi 5 adreson lidhshmërinë në nivel bashkie, dhe më konkretisht mënyrat e lidhjeve mes vendbanimeve rurale. Duke përdorur shtigjet aktuale bujqësore, të rehabilituara, në pjesën më të madhe të territorit është realizuar lidhja me dy akse, njërin automobilistik, e tjetri me karakter më peizazhistik, në funksion të ekoturizmit dhe mobilitetit më të mirë. Seksioni 2.1.3 e shtjellon më gjerësisht këtë parim.

- **Fashat, zonat e qendërsitë**

Konceptimi i territorit nëpërmjet fashave, zonave e qendërsive është një fazë e ndërmjetme mes vizionimit territorial dhe përdorimit të propozuar të tokës e ndarjes së njësive strukturore. Fashat përbëjnë zona përkatësie të elementeve ekzistues territorial, me formë kryesisht gjatësore, që mund të shoqërojnë një aks infrastrukturor, trup ujor, apo element tjetër që gjeneron zhvillim. Fashat, në këtë mënyrë bëhen një aglomerim gjatësor përdorimesh, funksionesh e aktivitetesh të ndryshme, të cilat marrin kuptim vetëm nga lidhja nëpërmjet aksit gjatësor që i gjeneron ato. Në fazën e propozimit, fasha, nga një zonë përkatësie kthehet në një matricë funksionale të propozuar.

Qendërsitë janë nyje të rëndësishme aktivitetesh e shërbimesh të karakterit miks apo monofunksional, të cilat gjenerojnë zhvillim rreth vetes, rritje të vlerës së tokës, densifikim etj. Ndërkaq, zonat janë sipërfaqe të dedikuara ndaj një funksioni të vetëm, ose në disa raste shumë funksioneve, por që e bëjnë të identifikueshme nga zona të tjera. Nëse nuk kanë kufi të mirëpërcaktuar, ato mund të shprehen edhe si njolla.

5 Qendërsitë ekonomike dhe katër fashat ekonomike: Në Bashkinë e Fierit propozohen pesë qendërsi ekonomike kryesore, të cilat ndodhen në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme ekzistuese ose të propozuara, në zona me një profil ekonomik tashmë të konsoliduar, dhe në zona të degraduara, ish-industriale. Qendërsitë lidhen me akset kryesore rrugore nëpërmjet fashave ekonomike, pa u izoluar nga zona urbane e Fierit. Këto zona janë: Qendërsia e Azotikut, e Levanit, Grecallisë, Portëzës dhe Çlirimit. Karakteri i këtyre qendërsive është miks, industri e lehtë dhe shërbime, si dhe tregti e ndërtimtari. Në vetë qendrat e banuara, zonat ekonomike shoqërohen me shërbime që mbështesin funksionin banim, ndërsa përgjatë fashave zhvillohen aktivitete ekskluzive ekonomike, shërbimi, industrie të lehtë, të izoluara me brez bimor buferik.

Zonat industriale dhe fasha TAP: Ndër zonat industriale të propozuara në Bashkinë e Fierit dallohet zona naftënxjerrëse e Mbrostarit dhe fasha e TAP-it, me zonën e saj të shërbimit. Zona naftënxjerrëse do funksionojë në kufirin ekzistues të saj, duke marrë masa për respektimin e zones buferike 50 metra prej kufijve. Përdorimet bujqësore do të kufizohen, ndërkohë që banimi do të përqëndrohet në qendrat e fshatrave Kallm i Madh e Kallm i Vogël, duke sjellë densifikim të tyre dhe mbështetje me shërbime. Fasha TAP shfaqet si një zonë rrethuese e rezervuar e gjurmës ku kalon sistemi i gazsjellësit, respektivisht 500 m[435] në dy anët e tij, në të cilën lejohen vetëm aktivitete bujqësore. Në pikën fundore të daljes në bregdetin e Semanit (duke respektuar të pazhvilluar fashën bregdetare 200 metra nga bregu) zhvillohet një qendërsi e karakterit shërbime industriale, për furnizim me gaz në një fazë të mëvonshme të zhvillimit (5 vjeçari i dytë dhe i tretë).

Fasha e hekurudhës: Kjo fashë fizikisht është lineare dhe shtrihet përgjatë gjithë territorit të bashkisë, por mbart përdorime dhe karakter të ndryshëm. Në brendësi të qytetit të Fierit fasha e hekurudhës bëhet zona kryesore e shërbimeve në qytet, duke formuar qendërsinë e stacionit multimodal rajonal të Fierit. Në zonat ku fasha kalon në vendbanimet qendrore, si Levan, Mbrostar dhe Libofshë, ajo shndërrohet në zonë banimi miks me shërbime, si dhe zonë buferike të gjelbër. Në vendbanimet e tjera fasha humbet, dhe i lë vendin vetëm zonës buferike të gjelbëruar, me shtrirje 25 metra në dy anët e hekurudhës[436]. Gjithashtu në zonë bujqësore dhe natyrore kjo zonë buferike është përbërësja kryesore e fashës së hekurudhës.

Zonat bujqësore: Zonat e bujqësisë zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të territorit të bashkisë (70%[437] të sipërfaqes) dhe shtrihen kryesisht në pjesën perëndimore, veriore e lindore të saj, kufizuar nga zonat kodrinore dhe fasha bregdetare. Kjo zonë perceptohet si një e vetme, e ndërprerë vetëm nga vendbanimet rurale dhe aksi i *bypass*-it, si dhe akse të tjera rrugore. Koncepti kryesor i ndërhyrjes në këtë zonë është konsolidimi bujqësor, stimulimi i krijimit të kooperativave, si dhe përmirësimi i infrastrukturës kulluese e vaditëse, si dhe asaj lidhëse rrugore të parcelave bujqësore.

Njolla e tokave të kripura: Njolla e tokave të kripura shtrihet midis zonës bujqësore dhe asaj bregdetare. Në gjithë qarkun e Fierit është i dukshëm fenomeni i kripëzimit të tokës bujqësore, por në këtë brez ai është përkeqësuar, për shkak të dëmtimit të brezit mbrojtës pyjor të bregdetit, dhe përmbytjeve të shkaktuara në afërsi të deltave e shtretërve të Semanit e Vjosës. Këto toka kanë rendiment shumë të ulët bujqësor dhe propozohet t'i nënshtrohen metodave të shkripëzimit natyror, duke mbjellë bimësi të durueshme ndaj kripës.

Njolla natyrore-kodrinore: Zonat natyrore-kodrinore shtrihen në dy pjesë të territorit: sistemi kodrinor i Libofshës, në kufi me bashkinë Lushnjë, si dhe sistemet e Levanit e Cakranit në juglindje. Këto zona kanë mbulesë pyjore, të ndërthurur me kullota, si dhe mbulesë bujqësore të tipit arë, pemëtari, ullishte e vreshta. Në mes të njollave kodrinore natyrore dallohen edhe disa zona të mbrojtura, si Pylli i Levanit (Park Natyror), rrapi i Cakranit, si dhe disa monumente kulturore në Libofshë e Cakran, të cilat i bëjnë këto zona potenciale të zhvillimit të turizmit kulturor e ekoturizmit.

Fasha Lumore: Në Bashkinë Fier dallohen tre lloje fashash lumore, të cilat korrespondojnë me 3 lumenjtë kryesorë që përshkojnë territorin: Fasha e Semanit, Vjosës dhe Gjanicës. Fashat lumore përfshijnë brigjet e lumenjve, zonën buferike të ujërave[438] (20 metra), zonën ripariane ekzistuese dhe të propozuar, si dhe tërësinë e zonave urbane që zhvillohen të integruara me trupin ujor. Kështu, në Fashën Seman gjendet Kurora e Adriatikut, si monument natyre me vlerë peizazhistike, fshati Adriatik, si qendër e ekoturizmit, zona ripariane e dikurshme, e cila aktualisht është zënë nga tokë bujqësore, zona e urbanizuar e fshatit Libofshë, zona industriale naftënxjerrëse e Kallmit, zona ekonomike e Mbrostarit, ku bashkohet me Fashën Gjanica, etj.

Fasha Vjosë ka vazhdueshmëri më të theksuar, dhe përbëhet nga zona ripariane dhe buferike respektive, së bashku me sistemin e fshatrave Pishë-Poro, Kashisht, Ferras, token bujqësore dhe zonën ku kalon *bypass*-i i Fierit.

Fasha Gjanica kryesisht shtrihet në zonën e urbanizuar të Fierit, duke u integruar me blloqet e banimit, sistemin e hapësirave të gjelbërta dhe rekreative, si dhe shërbimeve, në trajtë parku linear lumor. Në dalje të qytetit Fasha Gjanica integrohet me fashën e hekurudhës, duke përfshirë tokë bujqësore, vendbanimet rurale të Drizë Myrtezaj, Plykut, Krapsit etj. Kjo fashë kufizohet në dy anët nga zonat kodrinore të Cakranit.

Fasha bregdetare: Zona bregdetare përfshin deltat e lumenjve Seman e Vjosë, si dhe brezin ranor e pyjor deri në kanalin kullues paralel me bregun. Kjo fashë akomodon zonën rezidenciale të Darzezës, rrugën e re bregdetare, zonën e resorteve në Pishë-Poro, shërbimet e tjera të dedikuara turizmit masiv, zonën ekonomike të përkatësisë së linjës TAP, zonën e mbrojtur të Pishë-Poros dhe Karavastasë, si dhe dunat e Semanit. Kjo fashë i dedikohet zhvillimit të turizmit bregdetar, të zonuar sipas tipologjive të ndryshme të plazheve dhe faciliteteve infrastrukturore ndihmëse të tyre.

Zonat e banimit: Zonat e banimit janë gjithë zonat që i përkasin shtrirjes aktuale të vendbanimeve urbane e rurale, si dhe sipërfaqet e propozuara për zhvillim urban e konvertim në truall. Mënyra e shtrirjes dhe evidentimit të tyre përshkruhet në seksionin 2.1.5.

Zona e qendrës dhe zonat U1, U2, U3: Qyteti i Fierit ka si qendërsi kryesore zonën e Qendrës së Qytetit, e cila do i nënshtroher rizhvillimit dhe do akomodojë miks aktivitetesh, institucionesh, zonash banimi dhe rekreative, duke u integruar me parkun lumor të Gjanicës.

Ndërkaq, tre zonat e kufizuara në trajtë koncentrike nga 3 unazat e propozuara të qytetit, Unaza 1 (pjesërisht ekzistuese), Unaza 2 (pjesërisht ekzistuese) dhe Unaza 3 (tërësisht e re), formojnë 3 zona me tipologji zhvillimore me densitet të ndryshëm, në ulje nga qendra drejt periferisë. Këto zona, në pikat ku ndërthurren me fashat ekonomike të Çlirimit, Grecallisë dhe Portëzës, fashën hekurudhore dhe fashën Gjanica, ndryshojnë karakter dhe tipologji, ndërkaq në pjesën tjetër mbeten konstante, si më poshtë:

U1: zonë ekzistuese e konsoliduar, me nevojë për ndërhyrje rigjeneruese dhe ristruktururese;

U2: zonë me potencial intensifikimi dhe mbushje urbane, me tipologji mikse banim e shërbim, si dhe ekonomike;

U3: zonë banim me densitet të mesëm e të ulët, e cila shërben edhe si kufi i zhvillimit perspektiv urban për qytetin e Fierit.

Figura 200. Fashat, zonat dhe qendërsitë, Bashkia Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Transformimet strategjike**

Në bashkinë e Fierit, në mbështetje të vizionit të strategjisë së territorit dhe të analizave të thelluara të tipologjive, strehimit dhe nevojës për rigjenerim, propozohen dy kolona zhvillimi: i) Transformimet strategjike dhe ii) Platforma e ndërhyrjeve në territor. Këto kolona zhvillimi, janë zemra e Planit të Zhvillimit të Territorit dhe në vijim ato zbërthehen edhe në planin e infrastrukturave, planin e përdorimit të tokës, njësitë strukturore me treguesit e tyre e, së fundi, në sistemet e territorit. Edhe instrumentet e drejtimit të zhvillimit, pra instrumentet financiare të zhvillimit të tokës (në vijim), propozohen të tilla që të mundësojnë zbatimin e këtyre kolonave të zhvillimit.

Transformimet Strategjike pasqyrojnë vizionin e zhvillimit strategjik të Bashkisë në vendimmarrje konkrete në territor. Në vijim të tij, ato synojnë të vendosin në territor nyje, apo atraktorë zhvillimi, që do të gjenerojnë presion transformues pozitiv e njëkohësisht do të rritin cilësinë e hapësirës dhe shërbimeve në të ardhmen. Këto transformime kanë efekt katalitik për të tjera transformime pozitive dhe përbëjnë në thelb sfidën madhore që Bashkia duhet të përballojë për t`i dhënë një frymëmarrje të re territorit të saj. Transformimet strategjike janë identifikuar në mënyrë përfundimtare gjatë procesit të diskutimit dhe finalizimit të infrastrukturës rrugore, dhe përdorimit të tokës.

Nga pikëpamja metodologjike, grupi i punës, pas përfundimit të vizionit të strategjisë së territorit, u thellua më tej në identifikimin e elementeve të forta të territorit dhe zonave të tyre të përkatësisë, përmes të cilave u gjeneruan fasha funksionale, qendërsi

e zona me prioritet zhvillimi. Bazuar në faktin se në cilat territore duam të shtrijmë zonat e ndërtuara dhe për cilat qëllime, u përcaktua rrjeti i infrastrukturës rrugore. Ky rrjet lidh dhe/ose përshkon fashat, qendërsitë, e zonat me prioritet zhvillimi. Pikërisht, brenda këtyra hapësirave gjeneratore janë përcaktuar edhe nyje infrastrukturore të rëndësishme dhe projekte transformuese, të cilat i quajmë transformime strategjike të territorit.

Figura 201. Projektet transformuese të Bashkisë Fier.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Për bashkinë e Fierit, Transformimet Strategjike janë:

1. Qendra e re e qytetit

Qendra e re e Fierit do jetë zona më atraktive në qytet, me një miksim funksionesh shërbimi, qendrash biznesi, banim të intensitetit të lartë, dhe hapësirë e gjerë publike, e integruar me parkun lumor të Gjanicës dhe hapësirat e tjera të gjelbëra në qytet. Duke marrë parasysh tipologjinë aktuale të zonës qendrore të qytetit, ku ka konsolidim të zhvillimit urban dhe hapësira publike e institucionale të konsoliduara ose në proces zhvillimi, është ndryshuar kufiri i Qendrës së Qytetit, për të akomoduar hapësirë më të madhe në anën e lindore të lumit Gjanica. Kjo zonë do i nënshtrohet ndërhyrjeve rikonceptuese dhe rizhvilluese, për të përfituar intensitet të lartë zhvillimi (i = 5) dhe hapësirë publike të bollshme (Kshp=30%), si dhe një fytyrë të re për qytetin. Për lehtësi manaxhimi qendra është nënndarë në 2 njësi strukturore, të kufizuara nga rruga “Dervish Hekali”, ndërkohë që kufijtë skajorë të dy njësive së

bashku janë rrugët “Glaukia”, “Adriatiku”, “Naun Kaçaku” dhe “Jani Bakalli”. Zhvillimi i zonave do bëhet nëpërmjet një konkursi, i cili do përmbajë një koncept zhvillimi për gjithë qendrën, si dhe projekt të detajuar për *LOT*-et respektive. Zona e banuar në shtratin e lumit Gjanica do jetë gjithashtu subjekt i kësaj koncept-ideje, për të përcaktuar shkallën e ndërhyrjes dhe konservimit në të. Tipologjia e propozuar për zonën janë ndërtesat e tipit kullë të densitetit të lartë, si dhe ndërtesat gjatësore të densitetit të mesëm. Zhvillimi në zonën qëndrore do ketë impakt pozitiv në imazhin e qytetit, si dhe në vlerën e pronave në zonat përreth, përgjatë lumit Gjanica dhe në brendësi të unazës U1.

Qendra e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 16 Ha, përkundrejt qendrës së vjetër (24 Ha). Ky ndryshim në kufi dhe emërtim bëhet për dy arsye: Së pari, për të vendosur në kontekst zhvillimi parësor edhe sipërfaqen e banimit në anën lindore të lumit Gjanica, deri në rrugën “Naun Kaçaku”. Së dyti, për të veçuar nga pikëpamja e manaxhimit urban zonat me mënyra ndërhyrjeje të ndryshme. Dy njësitë strukturore të Qendrës së re do t’i nënshtrohen rizhvillimit dhe rikonceptimit, pra kërkohet një tjetërsim i karakterit e tipologjisë aktuale të tyre. Ndërkaq, zonat përbërëse të qendrës së vjetër do t’i nënshtrohen kryesisht rigjenerimit dhe ristrukturimit, duke plotësuar me hapësira publike dhe rrugë të rikonstruktuara. Kështu, nga pikëpamja e ndryshimeve madhore, në këto zona nuk ndodh shumë, por në aspekt të rëndësisë territoriale si element i fortë, ato mbeten pjesë e *Qendrës së Fierit*.

Figura 202. Kufijtë e qendrës së vjetër dhe propozimi për kufinjtë e rinj të Qendrës së Fierit.

Burimi: Harta e Njësive Strukturore, Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

2. Fasha e hekurudhës dhe stacioni i ri multimodal

Në kuadër të fuqizimit të Fierit si një qendër primare[439] në kontekst kombëtar, për qytetin merr rëndësi, krahas zhvillimit ekonomik, edhe përmirësimi i lidhjes me rrjetin rajonal të lëvizshmërisë. Aktualisht në Fier ekziston stacioni i trenit, përgjatë

rrugës “Harilla Bozdo”, me sipërfaqe gjurme 1,000m^2 dhe parcele 7,000m^2. Kjo zonë shërben gjithashtu si stacion interurban autobusësh. Ndërkohë, në qytetin e Fierit funksionojnë dy stacione të tjera që ofrojnë shërbim privat, në kryqëzimin e Unazës 2 me Rrugën e Portëzës, si dhe në afërsi të varrezave të qytetit. Duke marrë në konsideratë objektivin kombëtar për fuqizimin e rrjetit hekurudhor dhe lidhjen e tij me rrjetin ndërkombëtar[440], si dhe duke konsideruar transportin publik të propozuar, është e nevojshme të ndërtohet një stacion i ri, që strehon nevojat për lëvizje pasagjerësh dhe mallrash nëpërmjet hekurudhës, zonat e nevojshme për aksesueshmëri në transport publik me autobusë, taksi etj, si dhe shërbimet ekonomike dhe tregtare plotësuese. Këto zona “përkatësie” të stacionit multimodal, me karakter shërbimesh mikse, kërkojnë sipërfaqe prej rreth 10ha, të shpërndarë në dy anët e hekurudhës. Si rezultat i analizës së aksesueshmërisë dhe tipologjisë së zonave përgjatë hekurudhës, janë identifikuar 2 njësi potenciale për ndërtimin e stacionit multimodal dhe zonave të shërbimit përreth: zona e stacionit aktual, kufizuar nga rruga “Mirëkuptimi”, rruga e Semanit, rruga “Harilla Bozdo”, si dhe deri te rreshti i tretë i ndërtesave në zonën përtej hekurudhës. Duke qenë se kjo zonë aktualisht ka zhvillim mjaft të dendur, propozohen dy mënyra si mund të kryhet zhvillimi:

- Në fazën e parë të ndërtohet vetëm stacioni me zonën rrethuese të tij, në sipërfaqe 1-2 Ha. Më pas, kur të ketë tendenca zhvillimi, të zhvillohet me PDV e gjithë zona, duke përfshirë pjesën e zgjeruar sa i përket studimit të volumetrive, ndërkohë që pjesa tjetër e zonës do të studiohet edhe për shpërndarjen e të drejtave të zhvillimit, si pjesë e marrëveshjes së PDV-së. Zona e shërbimit ndodhet në të dyja anët e hekurudhës.

- Të ndërtohet stacioni i ri në një vendndodhje të dytë, në një sipërfaqe prej 12,6 ha të shtrirë në jug të ekzistueses dhe të kufizuar nga rruga “Vasil Pecuke”, rruga “Harrila Bozdo”, vazhdimi i rrugës “Ndrek Papa”, e cila do zgjerohet në bazë të propozimeve infrastrukturore të Planit. Tipologjia ekzistuese në këtë zonë është ajo e magazinave bujqësore, vilave të densitetit të mesëm dhe hapësirave të lira bujqësore. Ndërhyrja në zonë kërkon rizhvillim tërësor, me potencial për të siguruar më shumë hapësira të lira publike.

Figura 203. Pozicioni i stacionit multimodal dhe imazh përfaqësues



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016 / Benthem Crowell Architects, Utrecht, Hollandë

Në të dy rastet, njësia e hekurudhës ka intensitet të lartë ndërtimi (i=4) dhe hapësira të gjera të përdorimit publik, veçanërisht sheshe publike dhe gjelbërim në formë lulishtesh (Kshp=30%). Përveç tyre, edhe pjesa tjetër e fashës së hekurudhës në anën lindore të saj do jetë zonë e dedikuar shërbimesh, e cila do t'i nënshtrohet rizhvillimit, në segmentin deri në rrugën "Harilla Bozdo". Këto zona përbëjnë një nga fashat e reja ekonomike të qytetit, dhe do ketë intensitet të lartë (i=3.5) dhe përdorim publik të lartë (Kshp=15%).

Në anën perëndimore të hekurudhës, në zonat që nuk përfshihen të njësia e stacionit hekurudhor, do ruhet tipologjia ekzistuese e vilave me densitet të lartë (i=1), por do shtohet një rrugë shërbimi paralele me hekurudhën, për të realizuar lidhshmëri më të mirë të dy anëve.

3. Parku lumor i Gjanicës

Projekti i parkut lumor të Gjanicës është një ndër ndërhyrjet transformuese më të rëndësishme në qytet, për disa arsye:

- Ai ndikon në rehabilitimin mjedisor të Gjanicës, i cili është trupi ujor më i ndotur në nivel bashkie, për shkak të ndotjes industriale dhe urbane.

- Nëpërmjet projektit shtohet një park urban me vlera të larta peizazhistike në qytet, i cili i mungon fondit të gjelbër actual.

- Parku i Gjanicës do realizojë lidhjen e dy pjesëve të qytetit, përkundrejt ndarjes territoriale ekzistuese, dhe mungesës së aksesit në zonat përreth lumit.

- Në gjithë fashën e njësive të përkatësisë së Gjanicës do rritet vlera e tokës dhe interesi i zhvillimit do jetë më i lartë, duke siguruar një brez tërheqës për qytetin dhe përmirësim të imazhit të tij vizual.

Bulevardi lumor i Gjanicës shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 41,2ha, nga grykëderdhja në lumin Seman në veri, në pikën e ndërprerjes me Unazën 3 në jug. Ky brez parku formohet nga zona e mbrojtjes së lumit, respektivisht 20 metra në dy anët e tij[441], si dhe territore të tjera të përdorimit natyror që i përkasin zonës ripariane ekzistuese të lumit. Në dy anët e lumit do të shtrihen dy akse këmbësore lëvizjeje, në trajtë shëtitoreje përgjatë gjithë gjatësisë së parkut. Këto shëtitore do të kenë gjerësinë 2.5-3 metra, dhe korsi të dedikuar për biçikleta, ndërkohë që kur bashkohen me rrugë ekzistuese, zgjerohen dhe bëhen rrugë lidhëse automobilistike.

Parku i Gjanicës do përfshijë trajtim të shtratit të lumit, nëpërmjet koracimit me gurë lokalë dhe gjelbërimit hidrofil, me lloje drusore si rrapi, plepi, shelgu etj. Masat e propozuara për rehabilitimin mjedisor të lumit përshkruhen në Seksionin 2.3. Materialet e përdorura në park do jenë kryesisht drusore, si shtrimi i shtegut këmbësor, ashtu edhe elementet e mobilimit urban. Përgjatë parkut do funksionojnë 17 ura, nga të cilat 5 janë ekzistuese, dhe pjesa tjetër do ndërtohen për të siguruar lidhshmërinë e tërthortë të zonës.

Urat automobilistike përfshijnë:

- 2 Ura të unazës 3 dhe nga 1 Urë të unazës 1&2, të cilat ndërtohen të reja;
- Ura ekzistuese e Unazës 1 dhe Ura në hyrje të qytetit, të cilat do zgjerohen;
- 2 Urat ekzistuese të Unazës 2 dhe Ura e Qendrës, të cilat nuk do ndryshojnë;

Urat këmbësore përfshijnë:

- 2 Urat ekzistuese, si ajo në afërsi të Kishës dhe Ura e mesit;
- 6 Ura të propozuara, të vendosura në distancë 600 – 1,000 metra nga njëra-tjetra, në varësi të zonës.

Figura 204. Imazh transformues i Parkut të Gjanicës

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

4. Akset ekonomike Grecalli, Portëz

Akset kryesore ekonomike në Bashkinë Fier gjenerohen duke kombinuar fashat territoriale (të diskutuara më sipër, në Seksionin 2.1.1a) me potencialet kryesore të zhvillimit të ardhshëm ekonomik. Nga fashat territoriale u evidentuan 4 zona lineare që kanë potencial ekonomik e shërbimesh në Bashki: Aksi i Grecallisë, ai i Portëzës, rruga e Levanit dhe rruga e Semanit. Pak më pak e theksuar kjo fashë është në hyrjen aktuale të qytetit, përgjatë rrugës "Teodor Muzaka" që lidh Fierin me Mbrostarin.

Me vendosjen në funksionim të *Bypass*-it të Fierit, dinamikat e zhvillimit potencial ekonomik ndryshojnë dukshëm në bashki. Aksi aktual hyrës merr karakter më urban, duke qenë se ai do përdoret vetëm për hyrje në qytet, jo për lëvizje tranzit. Gjithashtu, rruga e Semanit do jetë e përqendruar më tepër në shërbime të karakterit tregtar dhe të ndihmës së turizmit, si rruga kryesore e aksesit në bregdet. Rruga e vjetër Fier-Vlorë

do ruajë të njëjtën fizionomi mikse urbane dhe shërbimesh, por me tendenca të ulëta zhvillimi, për shkak të lidhjes me zonën natyrore, si dhe zonën e mbrojtur të Pyllit të Levanit. Prania e Azotikut gjithashtu e kufizon peshën e kësaj fashe si aks i dendur ekonomik.

Kështu, dy akset kryesore ku gjenerohet zhvillim ekonomik në bashki do jenë aksi i ri i Grecallisë (ish-rruga e Celigardit), si dhe aksi ekzistues i Portëzës.

Aksi ekonomik i Grecallisë shtrihet në pjesën veriore të qytetit, në formë lineare përgjatë rrugës "Kastriot Muço". Lidhja me *Bypass*-in e bën këtë aks hyrjen e re në qytetin e Fierit. Karakteri i aksit ekonomik do strehojë tendencat aktuale për zona shërbimi hotelerie dhe tregtimi, duke përfshirë edhe përdorime të tjera, si magazina tregtare, showroom-e, qendra biznesi etj. Në segmentin deri në daljen e *Bypass*-it propozohet zhvillim më intensiv (i=0.5, nga ekzistuesi 0.1), i balancuar me hapësira rekreative e publike të shumta (Kshp=20%). Tipologjia ekzistuese e fashës është tokë bujqësore, kombinuar me shërbime, me parcelë mesatare 500-600m^2. Zhvillimet e reja do realizohen përgjatë rrugës kryesore, pasi të jetë siguruar infrastrukura publike mbështetëse: rrugët e shërbimit, zona të gjelbra shoqëruese, zonat e parkimit, infrastruktura nëntokësore etj.

Ndalohet që në këtë zonë të ndërtohen objekte të industrisë së rëndë, industrisë së ndërtimit dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit, fabrika betoni, nyje betoni etj. Objektet e shërbimit duhet të jenë të larguara 25 m nga rruga kryesore dhe duhet të kenë një brez mbrojtës si hapësirë publike.

Figura 205. Skemë ilustruese konceptuale e zhvillimit të Aksit Ekonomik të Grecallisë.



Burimi: Co-PLAN, 2016

Aksi ekonomik i Portëzes është një tjetër zonë ekonomike potenciale në territorin e Bashkisë Fier. Ajo shtrihet përgjatë rrugës kryesore SH73 (rruga drejt Roskovecit) dhe përfundon në kryqëzimin e rrugës drejt Patosit dhe ka karakter të konsoliduar industrial dhe ekonomik. Pozicioni i aksit e favorizon përdorimin industrial, për shkak të largësisë nga zonat e banuara të tjera, distances nga shtretërit e lumenjve Seman e Gjanicë, dhe mospranisë së zonave të mbrojtura natyrore. Disa aktivitete të lejuara në këtë zonë ekonomike janë: objektet industriale dhe tregëtare, përpunimi i materialeve të ndërtimit, magaznimet industriale, depot e karburantit, etj, duke shmangur miksimin me përdorim banim.

Ndërtimet industriale do shtrihen në brezin e parë të parcelave bujqësore, në mënyrë gjatësore, me distancë uniforme nga rruga, siç përshkruhet në Rregulloren e bashkëngjitur. Gjithashtu propozohet të ndërtohet një brez mbrojtës me bimësi të lartë, për të realizuar një ndarje vizuale dhe fizike nga tokat bujqësore si dhe territoret e banuara dhe natyrore përreth.

5. Azotiku

Zona industriale e Azotikut është një ndër polet ekonomike më identifikuese të qytetit të Fierit.[442] Me një sipërfaqe rreth 60ha, zona përfshin Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Nga këto objekte industriale, aktualisht në funksionim është Rafineria e Naftës, si dhe disa objekte të Azotikut, si objektet që prodhojnë gaz të lëngshëm, kullat e ftohjes etj. Parku i Azotikut përbëhet nga tre seksione, të specializuara sipas prodhimit të dikurshëm: azotiku, ureja e re dhe ureja e vjetër. Aktualisht pjesa më e madhe e objekteve janë privatizuar, dhe janë në proces likuidimi dhe demolimi, për t'u shitur në ankand si pjesë të veçanta. Zona përbën një element të fortë të qytetit, i cili mund të rikthehej në një pol rekreativ nëse nuk do kishte problemet në vijim:

- Në territorin e Azotikut, respektivisht në zonën e Uzinës së Nitratit të Amonit, është depozituar një sasi prej 40 tonësh lëndë kimike helmuese, përfshirë arsenikun, i cili dikur përdorej si lëndë e parë për prodhimin e plehrave azotike. Pavarësisht çaktivizimit të mbetjeve të arsenikut dhe groposjes së standardizuar, me monitorim 30-vjeçar nga BE-ja, nuk është realizuar ende studim i përbërjes së tokës dhe ujërave nëntokësore të zonës, për të parë impaktin afatgjatë të këtyre mbetjeve.
- Ndotja e trashëguar e Azotikut, e formuar nga sasia e cianurit dhe arsenikut, ndjehet ende në ajër, deri në fshatrat Drizë, Zhupan, Plyk e lagjen "11 Janari", në një popullsi prej rreth 5,000 banorësh.
- Prezenca e rafinerisë së naftës në afërsi të Azotikut sjell gjithashtu probleme me ajrin, duke e bërë zonën të pajetueshme në terma afatgjatë.
- Pronësia e objekteve industriale është ende në proces përcaktimi, e ndarë mes Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, subjekteve që e kanë privatizuar, pronarëve potencialë që do blejnë pronat pas likuidimit etj. Për këto arsye, edhe investitorët e interesuar për të zhvilluar projekte transformuese në zonë, janë tërhequr pas një kohe të shkurtër.

Kështu, pavarësisht atraksionit potencial të zonës, propozohet që të merren masa të fuqishme rehabilituese nga ana mjedisore, duke ruajtur përdorimin industrial e ekonomik të zonës. Disa nga aktivitetet e lejuara në këtë pol janë industria e rëndë

(përfshirë këtu depozitim karburantesh, përpunim gazi, përpunim nafte, prodhim metalesh etj.), industri përpunuese, përpunim druri, magazinim karburanti, fasoneri, zyra të lira etj. Është kategorikisht e ndaluar që në këtë zonë të lejohet ndërtimi i objekteve të banimit, serrave bujqësore dhe infrastrukturave të tjera bujqësore ose blegtorale, hotele dhe zona pushimi, objekte arsimore dhe shëndetësore, argëtimi etj. në një zonë 50-100 metra rrethuese të saj.

Figura 206. Imazhe transformuese ilustruese të Azotikut.

Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN2016

6. Fashat e shërbimeve të "Rrugës së Semanit","Aulonës" dhe hyrjes aktuale në Fier

Fashat "Seman"-"Aulona"-"Teodor Muzaka" janë tre nga radialet kryesore të qytetit, të cilat kanë patur rëndësi strategjike në lëvizjen hyrëse dhe tranzitore për në qytet, si dhe në mobilitetin interurban, por tashmë marrin një karakter të ndryshëm, për shkak të prezencës së *Bypass*-it dhe zhvillimeve të reja në bregdet.

Rruga "Brigada IX sulmuese", ose siç quhet ndryshe "Rruga e Semanit" është lidhësja kryesore me gjithë zonën bregdetare, e cila aksesohet nëpërmjet aksit turistik paralel me bregdetin. Duke qenë se këto akse lidhëse me bregdetin, së bashku me rrugët panoramike, do përmbajnë korsi të dedikuar për biçikletë, si dhe duke marrë parasysh kalimin e linjave të reja të propozuara të transportit publik, traseja ekzistuese e rrugës (prej 8 metrash) do zgjerohet deri në 20 metra, duke përfshirë:

- 2 korsi biçikletash prej 1.2 metrash secila, në të dyja anët;
- 2 trotuare prej 1.5 metrash në të dyja anët;
- 4 korsi automobilistike (dhe për transport publik);
- 1 korsi parkimi, ose xhep ndalimi, në varësi të afërsisë me zonën e ndërtuar.

Kjo rrugë e zgjeruar do t'i shërbejë një zone me përdorim miks banim e shërbime, me intensitet të rritur (i=1) deri në shkollën e mesme bujqësore, si dhe me hapësirë të gjelbër të bollshme (Kshp=15%). Në këtë zonë propozohen funksione tregtare, hotelerie, bare e restorante, qendra rekreative dhe aktivitete të tjera që paraprijnë aktivitetin turistik në bashki.

Rruga "Aulona", e cila lidhet me SH8-n drejt Levanit, ka një karakter të formuluar, duke shërbyer si rrugë tranzit drejt Vlorës. Funksionet aktuale të shërbimeve tregtare

e ekonomike do shoqërohen me intensitet më të lartë zhvillimi, dhe me hapësira më të gjera të gjelbëra midis, për kufizim ndaj tokës bujqësore dhe mbrojtje vizuale dhe mjedisore ndaj efekteve të polit të Azotikut. Vetë aksi rrugor përbën njërin nga radialet e rëndësishme të qytetit, i cili do zgjerohet deri në 25 metra, duke përmbajtur:

- 2 korsi në secilin drejtim, me trafikndarës në mes;
- 2 korsi parkimi;
- 2 korsi biçikletash, në secilën anë;
- 2 trotuare në gjerësi 2.5 metra secili.

Karakteri i kësaj rruge përcaktohet nga prania e parkut periferik të Pyllit të Levanit në vazhdim të saj, si dhe pranisë së spitalit rajonal të Fierit në afërsi të Levanit. Përdorimet e lejuara përgjatë rrugës do jenë shërbimet ekonomike, tregtare, të hotelerisë, bare e restorante etj, ndërkaq ndalohen përdorimet industriale, sidomos ato përpunuese. Zhvillimi i zonës do kryhet me intensitet në ulje, deri në kufirin jugor të fshatit Drizë, për t'i lënë vend hapësirave të gjelbëra deri në Pyllin e Levanit.

Rruga "Teodor II Muzaka", ose hyrja ekzistuese e qytetit, është një zonë me tendenca zhvillimi, por e paartikuluar ende nga pikëpamja e tipologjisë hapësinore. Kjo rrugë tashmë nuk ka më funksion hyrës, por është lidhja më e shkurtër e qytetit me Mbrostarin dhe parkun e ri urban të qytetit. Si e tillë, ka potencial për t'u shndërruar në një aks shërbimesh dhe banimi miks, të ngjashëm me "Rrugën e Semanit". Intensiteti i propozuar në këtë zonë luhatet në vlerat 1-1.2, dhe propozohet të zhvillohet lidhja me parkun lumor të Gjanicës, duke formuar një rrjet të hapësirave të gjelbëra dhe publike, duke përforcuar kështu karakterin miks të zonës.

7. Rrjeti ndërurban i biçikletave

Duke qenë se zhvillimi i integruar i turizmit është një ndër synimet kryesore të bashkisë për 15 vitet e ardhshme, krijimi i një rrjeti të qëndrueshëm të itinerareve natyrore, që lidhin pikat kryesore atraktive në bashki, është prioritet. Ky projekt shoqërohet me një rrjet të dedikuar lëvizjeje me biçikletë, përgjatë Yllësisë së Fierit, lidhëseve kryesore rurale, akseve turistike dhe rrugëve panoramike, orbitaleve natyrore, si dhe akseve kryesore në nivel qyteti. Gjatësia e këtij rrjeti arrin 300 km, me korsi të dedikuara biçiklete (përgjithësisht 2 të tilla) dhe përshkon zonat kryesore tërheqëse në bashki, pikat peizazhistike, monumentet natyrore dhe zonat e mbrojtura, zonat me vlera historike, bregdetin etj. Detajime të mëtejshme të rrjetit ndodhen në seksionin 2.2.2.

Figura 207. Rrjeti i propozuar i biçikletave në bashki dhe lidhja me potencialet kulturore e natyrore.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

8. Landfilli dhe Inceneratori i Fierit

Projekti i Landfillit të ri të Bashkisë Fier është ndër projektet më ambicioze për manaxhimin e mbetjeve urbane, dhe përfshin ndërtimin e landfillit rajonal të Fierit dhe një impiant për përpunimin e mbetjeve urbane, me rikuperim të energjisë dhe prodhim të energjisë elektrike. Impianti dhe landfilli do të ndërtohen në një zonë me përdorim bujqësor në afërsi të autostradës, në Njësinë Mbrostar, e cila mbetet ende për t'u konfirmuar. Sipërfaqja e gjurmës së zënë nga ky kompleks manaxhimi mbetjesh është rreth 15 ha, ndërkohë që sipërfaqja e vetë impiantit do jetë 6 ha. Zona parashikohet të ketë një hapësirë mbrojtëse 50 metra, gjithsesi efektet negative të landfillit në ajër pritet të ndihen në një distancë prej 250 metrash nga zona, si në periudhën e ndërtimit të impiantit, por edhe gjatë operimit të tij. Seksioni 2.2.5 trajton më në detaje këtë temë.

9. Impianti i trajtimit të ujërave të zeza

Impianti i trajtimit të ujërave është një ndërhyrje transformuese e rëndësishme, për shkak të ndikimit të lartë që tenton të sjellë në pastrimin e ujërave të lumenjve Seman e Gjanicë nga ndotjet urbane. Impianti i trajtimit do të pozicionohet në pjesën veriore të qytetit të Fierit, përgjatë lumit Gjanica, dhe do zërë një sipërfaqe prej 10-20 Ha. Për shkak të aromës së fortë të nxjerrë gjatë procesit të përpunimit të ujërave të zeza, zona ka nevojë për një hapësirë mbrojtjeje minimale 50 metra, e cila duhet mbjellë me

bimësi të lartë. Masa të tjera do merren për kufizimin e përdorimeve bujqësore dhe ndalimin e përdorimit banim në një sipërfaqe 40 ha përreth impiantit, për të minimizuar efektet negative të projektit në jetueshmërinë e zonës. Ndërkaq, pastrimi fizik, kimik e biologjik i ujërave të zeza para derdhjes së tyre në lumin Gjanica, e më pas në Seman, mundëson rehabilitim të cilësisë së ujërave sipërfaqësore në Bashki, me ndikim të mëtejshëm në biodiversitet dhe në llojet që jetojnë në këto ujëra, në shmangien e mbartjes së ndotjes në zonën e plazhit, nëpërmjet grykëderdhjes së Semanit etj.

Figura 208. Foto ilustruese e një impianti të trajtimit të ujërave

Burimi: Tedagua, Madrid, Spanjë

10. Unaza 3

Unaza e jashtme e qytetit është një ndër investimet më të rëndësishme të Fierit në nivel urban, i cili ka dy funksione kryesore: të mbledhë fluksin e qarkullimit të radialeve urbane, dhe lidhëseve kryesore në një sistem unazor të jashtëm, si dhe të përcaktojë kufijtë e rritjes dhe densifikimit të qytetit.

Unaza kalon pothuajse plotësisht në një gjurmë të re, e kufizuar në veri nga Vija e Ngjalës dhe në jug nga zona e Azotikut, si dhe duke ndjekur në çdo rast kufirin maksimal të shtrirjes urbane në tokë bujqësore në lagjet Afrim i Ri, Afrim, Sheq i Vogël e Sheq i Madh. Në dy skajet veriore dhe jugore të unazës formohen ura automobilistike në kalimet përmbi Gjanicë.

Unaza 3 do ketë një gjerësi që shkon maksimalisht 20 metra, me 2 korsi kalimi në secilin drejtim, trafikndarës, korsi biçikletash, trotuar në anën e urbanizuar dhe, në anën tjetër, sipas rastit; si dhe parkim në zonat ku është zhvillimi më i dendur (lagjet Afrim i Ri dhe Afrim). Unaza shtrihet përgjatë 20 kilometrash, kryesisht në tokë të rrafshët bujqësore, pa prekur shumë struktura ekzistuese. Zona jugore, në kalimet në kryqëzimin me rrugën e Portëzës, fshatrat Zhupan dhe Romet, kanë terren më kodrinor dhe gjurma e rrugës mbivendoset me 40 ndërtesa të funksionit banim.

Figura 209. Prerje tip e Unazës 3.

Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

11. Rrjeti i fshatrave ekoturistike

Bashkia Fier ka në territorin e saj shumë potenciale natyrore, zona me vlerë historike, si dhe zonat e bregdetit, me potencial të lartë turistik. Gjithsesi, në aspekt të karakterit turistik, vendbanimet aktuale nuk kanë tendenca profilizimi, ofrimi të shërbimeve në ndihmë të turizmit, apo qoftë edhe sinjalistikën e duhur për të patur akses në zonat me interes natyror. Kështu, bazuar në parimin e zhvillimit mbi specializimin e venbanimeve, janë identifikuar disa fshatra me profil ekoturistik, të nxitur nga potencialet bregdetare, natyrore apo historiko-kulturore që ndodhen në afërsi të tyre, si dhe aksesit të mirë nëpërmjet infrastrukturës turistike dhe akseve rurale parësore e dytësore.

Këto fshatra janë: Pishë, Bashkim, Boçovë, Darzezë, të cilët do të specializohen në shërbimet akomoduese të turizmit bregdetar: Pojan, Cakran, Vanaj, Libofshë me fokus në turizmin kulturor, dhe Adriatik, Ndërnënas, Hasturkas, të cilët i shërbejnë aksesit në zona natyrore me vlerë peizazhistike.

Ndërhyrjet në këto zona përfshijnë dendësimin e qendrave dhe ristrukturimin e infrastrukturës kryesore rrugore dhe hapësirave të lira, caktimin e zonave të reja për zhvillim të përdorimit shërbime, aktivitete sociale e rekreative, dhe banim, si dhe konsolidimin e tipologjive ekzistuese në zonat që i nënshtrohen mbushjes urbane. Trajtimi peizazhistik në lidhjen me elementet e fortë respektivë është një aspekt tjetër i ndërhyrjeve ristrukturuese në këto njësi, respektivisht në formë shtegu, brezi të gjelbër, sinjalistikë turistike etj, në këto lidhje:

- Pojani me Parkun e Apollonisë;
- Darzeza me bregun e detit dhe resortin e Pishë-Poros;
- Fshatrat Bashkim e Bocovë me fshatin Pishë;

- Fshati Pishë me deltën e Vjosës, resortin në Pishë-Poro, bregun e Pishë-Poros, zonën e dunave dhe pyllit bregdetar etj;
- Fshati Vanaj dhe Libofshë me Ardenicën, mozaikun dhe 4 kishat e shpallura monument kulture, si dhe zonën natyrore ripariane të Semanit;
- Fshati Adriatik me Kurorën e Adriatikut, dhe fshatrat Ndërnenas dhe Hasturkas;
- Fshatrat Ndërnenas e Hasturkas me Parkun e Karavastasë;
- Cakrani me Parkun e Cakranit, zonën historike të Gurzezës etj.
- Qyteti i Fierit, me të gjithë këto vendbanime, nëpërmjet rrjetit rrugor (Yllësisë së Fierit) dhe lëvizshmërisë me biçikleta, parkut natyror të Semanit e Gjanicës etj.

12. Rrjeti i parqeve urbane e natyrore

Rrjeti i propozuar i parqeve urbane e natyrore përfshin tërësinë e zonave të konsoliduara natyrore, të pyllëzuara, të aksesueshme, të vazhduara dhe të përdorimit publik, në nivel bashkie, të kombinuara me zonat e gjelbëruara dhe publike urbane, të cilat kanë funksion kryesor rekreativ dhe shplodhës. Disa nga ndërhyrjet kryesore në këtë aspekt janë:

- Krijimi i parkut të vazhduar natyror të Semanit, duke rehabilituar dhe pyllëzuar zonën ripariane deri në kufi me argjinaturat e lumit (Projekti 13);
- Krijimi i parkut urban të Gjanicës (Projekti 3);
- Pyllëzimi dhe rehabilitimi i zonës ripariane në rrjedhën natyrore të Gjanicës e Vjosës;
- Zgjerimi i Pyllit të Levanit dhe kthimi në park natyror të aksesueshëm;
- Kthimi në Park i Pyllit të Cakranit, duke siguruar akses dhe sinjalistikë të përshtatshme turistike;
- Ndërtimi i një parku urban përfaqësues për qytetin e Fierit;
- Rehabilitimi i zonës pyjore dhe të dunave në bregdet, duke përmirësuar aksesin dhe duke e furnizuar me shërbime të përkohshme ndihmëse të turizmit;
- Shtimi i gjelbërimit rrugor përgjatë akseve kryesore turistike;
- Mbjellja e rreshtave bimorë përgjatë kanaleve kulluese e vaditëse kryesore, me funksion mbrojtjen e ujërave nga pesticidet dhe trajtimin peizazhistik të zonës bujqësore;
- Etj.

Këto ndërhyrje shpjegohen më në detaj në Seksionin 2.1.3.

13. Fasha Seman

Rehabilitimi i fashës së Semanit është një ndër projektet më të mëdha në nivel bashkie, për shkak të impaktit që ka në ndryshimet e përdorimeve të tokës, dhe konvertimit të tokës bujqësore në përdorim natyror. Nevoja për këtë projekt vjen për shkak të tendencave të lëvizjes së lumit Seman, i cili pothuajse gjatë gjithë segmentit

që përshkon në Bashkinë Fier pëson meandrime të shpeshta dhe mjaft të thella. Rehabilitimi i zonës ripariane i shërben sistemit lumor për disa arsye:

- brezi bimor nuk lejon ujërat e shirave të vërshojnë drejt lumit me shpejtësi, duke dëmtuar tokën dhe krijuar flukse të pamanaxhueshme;
- pesticidet dhe plehrat kimike që përdoren për bujqësinë nuk arrijnë të depërtojnë plotësisht në ujin e lumit, e më tej të transportohen në bregdet apo në akuiferë, pasi nitratet e nitritet përthithen nga bimësia e mbjellë përreth;
- bregu lumor stabilizohet nga rrënjët bimore dhe shmanget fluktuacioni i mëtejshëm i lumit, në zonat e thelluara;
- krijohet një zonë e vazhduar me vlera peizazhistike të larta dhe ndihmëse e biodiversitetit ujor.

Zona ripariane e Semanit propozohet të rehabilitohet deri në argjinaturat aktuale, duke ndryshuar në gjerësi nga 20 në 1200 metra në të dy anët e Semanit, në varësi të meandrimeve. Duke marrë parasysh përdorimet bujqësore përgjatë fashës, është e nevojshme të bëhet konvertimi i tokës bujqësore në natyrore, për respektivisht 950 Ha tokë bujqësore. Një pjesë e saj (rreth 30%) është tokë e pakultivuar, ose djerrë. Vlera e shtuar e kësaj ndërhyrje është krijimi i një zone natyrore në shërbim të lumit Seman, e cila, duke vazhduar drejt deltës së Semanit, në bashkim me lagunën e Karavastasë, krijon një korridor natyror të qëndrueshëm dhe me potencial të lartë biodiversiteti.

Figura 210. Skemë e strukturës dhe funksionit të zonës ripariane.



Burimi: Alberta Environment and Sustainable Resource Development[443]
Përpunoi: Co-PLAN, 2016

14. Zona e Bregdetit

Bregdeti i Fierit, me një gjatësi lineare 35 km nga Laguna e Karavastasë në Deltën e Vjosës, është zona më me potencial zhvillimi në bashki, e gjithashtu ndër më problematiket sa i takon kompleksitetit të habitateve dhe dukurive të karakterit gjeomorfologjik, të cilave u nënshtrohet vit pas viti. Zhvillimi i zonave rekreative,

plazheve të tipologjive të ndryshme, shërbimeve ndihmëse të turizmit etj, është bërë në përputhje me parimet e mbrojtjes dhe rehabilitimit të habitatit natyror e ujor, kushtëzimet nga legjislacionet dhe planet sektoriale (Ligji mbi manaxhimin e integruar të burimeve ujore, Rregullorja e Planifikimit të Territorit, Plani Ndërsektorial i Bregdetit), dhe janë propozuar disa ndërhyrje, si më poshtë:

- Në zonën e Karavastasë, deri në deltën e lumit Seman, zona është në mbrojtje (Park Kombëtar, kategoria 2) dhe propozohet të lejohet plazh në formë të paorganizuar dhe aktivitete shplodhëse, në përputhje me legjislacionin përkatës[444].
- Bregdeti nga delta e Semanit deri në daljen e TAP-it është zonë me vlera të larta peizazhistike, me laguna të shumta, por nuk është në status mbrojtjeje. Brezi pyjor nga delta e Semanit, deri ne Pishë-Poro, kufizuar nga kanali kullues paralel i bregdetit, propozohet të shpallet si zonë e mbrojtur, e kategorisë Park Natyror Rajonal, për të rehabilituar habitatin lagunor ekzistues, për të shmangur shpyllëzimet e zonës së pishës së butë në segmentin Seman-Darzezë, si dhe si masë mbrojtëse për dunat e shtrira në veriperëndim të Povelçës. Kështu, në këtë segment do të shmangen ndërhyrjet e mëdha transformuese të përdorimit të tokës, me përjashtim të propozimeve të projektit TAP, që parashikon ndërtimin e një pike të saldimit të fundit hiperbarik, si dhe një digë izoluese 300 metra.[445] Në shërbim të TAP-it do të krijohet një zonë ekonomike me sipërfaqe 10-20 ha, e cila do vendoset në afërsi të stacionit të kompresimit, në distancë sigurie nga linja TAP siç parashikohet në rregulloret e veçanta[446] (jo më afër se 100 metra nga linja e gazsjellësit) dhe sipas procedurave të paracaktuara të konsultimit për zonat me distancë 100-650 metra nga gazsjellësi.
- Në segmentin Seman-Darzezë, bregdeti shfaq dukuri problematike në lidhje me erozionin detar, përbërjen e shkrifët lymore të tokës, si dhe zhytjen tektonike të segmentit Seman-Darzezë (Shih seksionin 2.3.3 për më tepër detaje). Në këtë zonë, pavarësisht përdorimit aktual si plazh, nuk propozohet masivizimi i përdorimeve rekreative, për shkak të mungesës së fizibilitetit afatgjatë të tyre, duke qenë se në periudhën afatgjatë zona mund t'i nënshtrohet zhytjes më të dukshme. Ndërkaq, propozohen masa për zbutjen e dukurisë së erozionit detar, duke krijuar një ishull me bimësi rizofore përkundrejt këtij segmenti, në mënyrë që të ruhet linja aktuale e bregut. Ndërkaq, duke filluar nga Semani, e në jug deri në afërsi të deltës së Vjosës (ku shfaqet dukuria akumuluese), propozohet ngritja e një serie platformash detare prej guri, të cilat nuk lejojnë gërryerjen e mëtejshme të bregdetit, duke formuar gjithashtu njëkohësisht hapësira rekreative turistike.
- Segmenti Darzezë – Pishë-Poro do të jetë zona ku përqëndrohet pjesa më e madhe e zhvillimit turistik masiv në bregdet, për shkak të kushteve më të mira të territorit në këtë segment, dhe mospranisë së dukurive zhytëse. Darzeza, si qendra kryesore strehuese e shërbimeve turistike, do të zhvillohet drejt bregdetit, në formë të një marine jahtesh, që zhvillohet në vazhdim të kanalit të Hoxharës. Kjo marinë do jetë lidhja e vetme e llojit në bregdetin shqiptar, duke komunikuar me portet më të afërta të Selanikut dhe Dubrovnikut, në një rrjet turizmi të mirëformuar. Në afërsi të Darzezës, plazhet do jenë të tipologjisë gjysëm të organizuar, me shërbime ndihmëse, bare e restorante, një zonë natyrore të tipit park përgjatë dunave, dhe më pas Pyllin e Pishë-Poros, si zonë kufizuese natyrore.

- Zona e Pishë-Poros, në hapësirën bujqësore djerrë që nuk përfshihet në kufirin e zonës së mbrojtur të llojit Park Natyror, do të zhvillohet si zonë resortesh turistike dhe shërbimesh rekreative, sipas disa kushtëzimeve në lidhje me pozicionimin, lartësinë maksimale dhe mënyrën e zhvillimit. Rruga e vendosur përgjatë bregdetit, me gjerësi 12 metra, do të devijojë në këtë zonë, duke ruajtur një distancë 300 metra nga kufiri i pyllit të Pishë-Poros. Kjo lejon që midis pyllit dhe rrugës (duke ruajtur një zonë mbrojtëse 50 metra nga pylli, në përputhje me legjislacionin sektorial) të ndërtohet një rresht resortesh, me lartësi maksimale që nuk kalon lartësinë 12 metra të pishave të buta, në mënyrë që të mos dallohen nga pikat peizazhistike të territorit, siç është Apollonia dhe kodrat përreth. Për të mos cënuar pyllin e Pishë-Poros, propozohet që zona e resorteve të zhvillohet përkundrejt kushtit për ripyllëzim të skajit juglindor të tokës bujqësore, duke formuar në vazhdim korridore të gjelbërta komunikuese mes dy anëve të pyllit. Duke qenë se zona e resorteve do i përgjigjet turizmit masiv, propozohet që pjesa e plazhit midis plazhit aktual të Darzezës dhe Deltës së Vjosës të jetë i organizuar, me objekte shërbimi, platforma druri për ecje apo pushim, shërbime ndihmëse rekreative etj, pa cënuar kufirin aktual të pyllit. Zona e dunave, e shtrirë midis këtij segmenti dhe deri në plazhin e Semanit, propozohet të ripyllëzohet, të përforcohet dhe të bëhet e aksesueshme me gjurmë të lehta për kalim këmbësorësh.
- Segmenti Pishë-Poro deri në deltën e Vjosës është zonë mjaft e pasur natyrore, si pjesë e deltës së Vjosës, dhe vazhdim i peizazhit të mbrojtur të Nartës. Si e tillë, ajo do të lejohet të përdoret për aktivitet të kufizuar dhe individual turistik, pa lejuar ndërtime të përhershme. Zona, duke qenë vazhdimisht akumuluese, përbën një ndër plazhet më të mira natyrore në bregdetin e Fierit, me biodiversitet të pasur, mundësi të mira për peshkim dhe peizazh mjaft të larmishëm bregdetar.

Figura 211. Skemë e mënyrës së zhvillimit inkremental të zonës së resorteve, Pishë-Poro.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 212. Imazh i plazhit të lirë të Semanit.

Burimi: PLGP/Felixx Landscape Architecture, 2016

Figura 213. Imazh ilustrues i zonës së resorteve në Pishë-Poro

Burimi: PLGP/Felixx Landscape Architecture, 2016

Figura 214. Koncept zhvillimi i zonës së bregdetit të Fierit.



Burimi: Felixx dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 215. Imazh ilustrues i zonës së shërbimit të marinës, Darzezë.

Burimi: Felixx Landscape Architecture, 2016

c. Platforma e ndërhyrjeve në territor

Ndërsa transformimet strategjike të territorit kanë rëndësi dhe efekt katalitik, janë zonat e tjera të territorit ato në të cilat banorët kryejnë aktivitetin e tyre të përditshëm dhe jetojnë. Në përgjithësi këto janë zonat e banimit, të cilat sigurisht akomodojnë edhe një sërë shërbimesh dhe aktivitetesh institucionale e tregtare, përveç banesave. Veç zonave të banimit, janë edhe territoret bujqësore e natyrore, parimi i zhvillimit të të cilave, siç theksohet në fillim të Seksionit 2.1.1, është mbrojtja e rehabilitimi. Plani i Zhvillimit të Territorit ofron një platformë të mënyrës se si duhet të ndërhyhet në këto zona në të ardhmen, për të siguruar jetëgjatësinë e qëndrueshmërinë e tyre, përkrah cilësisë.

Nga pikëpamja metodologjike, mënyrat e ndërhyrjeve bazohen në: tipologjinë hapësinore e ndërtimore që kanë aktualisht territoret dhe vendbanimet e ndryshme në bashki; në analizën e strehimit, cilësisë së ndërtesave dhe në projeksionet e popullsisë; në kapacitetin mbajtës që kanë zonat e ndryshme sipas propozimeve për infrastrukturën; në treguesit ekzistues të zhvillimit (intensitet, koefiçientët e shfrytëzimit të tokës për ndërtim, hapësirë publike e rrugë, dendësitë); në hartën e fragmentimit të tokës bujqësore; në analizën e peizazhit natyror dhe fragmentimin e tij; si edhe në interesat e bashkisë e të komunitetit për të intensifikuar zhvillimin e zonave të banimit në të ardhmen.

Si rrjedhojë e sa më sipër, strategjikisht, platforma e bashkisë për mënyrat e ndërhyrjeve në territor bazohet në këto masa:

1) Rritjen e rivlerësimin e hapësirës publike, jo vetëm në qendrat e qytetit e të vendbanimeve, por edhe në zonat e banimit apo të aktiviteteve të tjera. Kjo hapësirë në disa raste përcaktohet në hartë/territor se ku do të ndodhet, siç mund të jenë për shembull transformimet strategjike dhe infrastruktura madhore, e në raste të tjera jepet përmes treguesit Kshp (Shih seksionin 2.1.3). Gjithashtu, propozimet për ndërtime të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore, qendrave kulturore e sociale, janë në funksion të rritjes së hapësirës publike.

2) Plotësimin me rrjet rrugor të niveleve të ndryshme të të gjitha zonave të banuara dhe me aktivitet njerëzor në bashki dhe ristrukturimin e infrastrukturës publike kudo që është e nevojshme për të rritur aksesin, depërtueshmërinë, cilësinë e hapësirës dhe shërbimit dhe lidhshmërinë.

3) Ripërtëritjen e zonave që kanë humbur funksionin apo cilësinë, sikundër edhe rikonceptimin e zonave që kanë premisa për të qenë funksionalisht të arrira, por nuk kanë cilësi të strukturave dhe të hapësirës

4) Konsolidimin dhe/ose mbushjen e dendësimin e zonave që kanë një karakter e tipologji të caktuar, të cilat vlen të ruhen ose është efikase që të ruhen, por ku nevojitet të përmirësohet infrastruktura dhe hapësira publike.

5) Zhvillimin dhe rizhvillimin me intensitete të larta të zonave ku ka presion zhvillimi, përqendrim të popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike, dhe ku propozohet të krijohet hapësirë publike ndërkohë që zona është e ndërtuar dhe shpronësimi nuk është një zgjidhje efiçente apo e drejtë (p.sh. zonat përgjatë hekurudhës, lumit Gjanica etj).

6) Rehabilimin mjedisor dhe sipas rastit historik, të zonave, kryesisht natyrore (por jo vetëm) me qëllim nxjerrjen në pah të vlerave, vënien e tyre në funksion të komunitetit, rritjen e cilësisë së hapësirës dhe mbi të gjitha ruajten e funksioneve të ekosistemit.

7) Konservimin e konsolidimin e tokës bujqësore dhe ekosistemeve natyrore, duke marrë edhe masa për përmirësimin e rigjallërimin e tyre sipas nevojës.

8) Krijimin e një sistemi urbano-bujqësor-natyror, i cili funksion mbi bazën e parimeve të integrimit, plotësueshmërisë, funksionalitetit, vetëripërtëritjes dhe qëndrueshmërisë. Këtë e garanton këtë përmes krijimit të shumë-qendërsive (rrjeti policentrik) dhe ofrimit të mundësisë për të shpërndarë në mënyrë të drejtë fuqinë ekonomike dhe aktivitetin ekonomik në të gjithë territorin.

Në funksion të këtyre masave, platforma e ndërhyrjeve të territorit në bashki përmban sa më poshtë: (Sigurisht, detajet e ndërhyrjeve jepen në seksionin 2.1.4, për njësitë strukturore)

- Konsolidim dhe ripërtëritje e zonave qëndrore aktuale, sidomos brenda unazës 1 dhe në disa pjesë të unazës 2, ku ruhet tipologjia ekzistuese e ndërtesave gjatësore, nxitet trajtimi dhe unifikimi i fasadave, si dhe ristrukturohen hapësirat e gjelbëra dhe infrastruktura e brendshme rrugore, për të krijuar zona banimi më të jetueshme, dhe të identifikueshme me vetë qytetin.

- Rizhvillimi dhe rikonceptimi i zonave që kanë pozicion strategjik, në afërsi të nyjeve apo akseve kryesore të transportit, si dhe përgjatë gjurmëve të forta të territorit, ku ka aktualisht presion të lartë zhvillimi. Të tilla janë tërësia e njësive përgjatë Gjanicës, të cilat jo vetëm duhet të integrojnë parkun e Gjanicës përmes tyre, por edhe të ofrojnë një ndryshim në organizim hapësinor, në tipologji ndërtimore, në rrjetin e brendshëm rrugor etj. Krahas tyre, njësitë përgjatë hekurudhës i nënshtrohen rizhvillimit, duke ndryshuar përdorim (nga shërbime ekonomike, në banim intensiv miks me shërbime, dhe duke realizuar intensitete dhe vlera Kshp-je më të larta, respektivisht i = 3-4 dhe Kshp = 10-20%). Në këtë brez rizhvillimi, njësia e Stacionit Multimodal, e shtrirë në dy anët e hekurudhës, merr rëndësi më të madhe, siç përshkruhet më sipër, në Transformimet Strategjike. Gjithashtu, i nënshtrohen rizhvillimit edhe fashat kryesore përgjatë unazës 2, ku ka presion të lartë zhvillimi, dhe nevojë për ndryshim të tipologjive ekzistuese të vilave apo ndërtesave të llojit magazinues. Në këto zona, intensitetet e synuara arrijnë vlera 3-3.5.

- Rizhvillimi i zonave ekonomike, të cilat shtrihen kryesisht përgjatë radialeve urbane dhe kalojnë përtej tyre. Në këto raste, strategjia e ndërhyrjes është gjithashtu rikonceptim dhe ristrukturim tërësor i zonës, por nuk i dedikohet një rritjeje të madhe në intensitet, për shkak të dominancës së funksioneve ekonomike, ose industriale, të shërbimeve etj, në varësi të rastit. Zona të tilla janë aksi i Portëzës dhe aksi i Aulonës, siç përshkruhen në Transformimet Strategjike më sipër.

- Zhvillimi i zonave të reja ekonomike, në përputhje me projeksionet e zgjerimit të qytetit dhe nevojave ekonomike të parashikuara. Këto janë zonat ekonomike të reja që zhvillohen, si aksi Daullas-Grecalli, i cili momentalisht ka përdorim bujqësor.

- Rizhvillimi dhe rehabilitimi mjedisor i zonave ekonomike ekzistuese, si Azotiku, ish-TEC-i etj, të cilat janë pothuajse jashtë funksionit për momentin, por kanë nevojë për trajtim rehabilitues të thellë, në mënyrë që të mund të rivendosen në funksione të ngjashme ekonomike.

- Intensifikimi dhe ristrukturimi në zonat urbane midis unazës 2 e 3, të cilat aktualisht janë të tipologjisë së vilave 1-2 katëshe, pa hapësira publike, dhe rrugë të gjerësisë 4 metra. Propozimet për këto zona çojnë intensitetin në vlerën 1, Kshp rreth 10% dhe zgjerojnë rrugët deri në 6 metra, duke shtuar hapësirën e nevojshme për trotuare.

- Mbushje urbane dhe ristrukturim në zonat me densitet të ulët, por që ndodhen në brendësi të unazës 3. Këto janë rastet si në zonën e ETC-së, në lagjen Afrim etj.

Figura 216. Platformat e ndërhyrjeve në qytetin e Fierit.



Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Ristrukturim, mbushje e rikonceptim nëpër qendrat e banuara të fshatrave sipas kufijve të vjetër, përfshirë edhe zgjerimet që ata kanë marrë në kufi. Përmendim këtu gjithë fshatrat e karakterit bujqësor apo kodrinor (qendra bujqësore e kodrinore në figurën e mëposhtme), që nuk kanë presion të madh zhvillimi apo identitet specifik, por që kanë nevojë të konsolidohen dhe të plotësohen me hapësirë publike cilësore e shërbime, në mënyrë që të tërheqin banorët për të ndërtuar banesat e tyre në këto zona të vogla urbane, në vend që të synojnë ta fragmentojnë më tej tokën bujqësore. Në të gjitha rastet, nevojiten ndërhyrje infrastrukturore përmirësuese dhe plotësuese.

Figura 217. Ndarja e fshatrave sipas llojit të ndërhyrjeve dhe karakterit kryesor të tyre.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- Ripërtëritje të qendrave të disa fshatrave kryesorë që janë edhe qendra të njësive administrative, apo qendra të konsideruara dytësore ose tretësore, me qëllim ofrimin e shërbimeve të reja dhe rritjen cilësore të hapësirës publike. Përmendim këtu fshatin Mbrostar, Topojë, Levan, Cakran, Libofshë, Frakull, Portëz, Dërmenas, Grecalli, Daullas, Çlirim etj, ku ndërhyrjet do jenë si intensifikuese, ashtu edhe nxitëse të miksimit të kategorisë së përdorimit të tokës, duke shtuar shërbimet dhe aktivitetet sociale-rekreative. Në këto qendra intensitetet e propozuara luhaten 0.8-1.5, të krahasueshme me zonën urbane të Fierit.

- Ristrukturim dhe mbushje në zonat e ndërtuara e të krijuara rishtazi, që shtrihen përgjatë rrugëve kryesore dhe kanë fragmentuar tokën bujqësore në mbi 30%. Në këto zona është humbur toka bujqësore në rreth 1/3 ose më tepër të parcelës bujqësore (e kufizuar nga infrastruktura tretësore e kullimit dhe vaditjes) dhe qëllimi është që të mos lejohet depërtimi i mëtejshëm i ndërtimit në tokën bujqësore në kufi të pjesës së ndërtuar edhe pse mund të jenë pjesë e të njëjtës parcelë bujqësore. Do të promovohet mbushja e tyre dhe mundësisht ndarja e tokës për qëllime zhvillimi, që banorët e zonave më të thella të synojnë të ndërtojnë në këto hapësira, sikurse dhe në qendra fshatrash, dhe jo në fermën e tyre.

- Zhvillim i disa njësive specifike për akomodimin e shërbimeve të reja të hotelerisë e argëtimit në fshatrat e caktuara si qendra turistike, respektivisht në Darzezë, Pishë, Pojan dhe Adriatik. Këtu caktohen zona të dedikuara me përdorim ekzistues bujqësor ose natyror, ku do zhvillohen, përkundrejt PDV-së, zonat e reja të shërbimit turistik, në vazhdim të qendrës së fshatit.

- Konservim të tokës bujqësore e natyrore e ngrirje të ndërtimeve në këto zona si edhe ato të rrezikuara gjeologjikisht, plus zhvendosje në raste ekstreme. Pavarësisht se një VKM e Ministrisë së Bujqësisë lejon ndërtime për qëllime të aktivitetit bujqësor në tokë bujqësore, plani synon të konservojë në maksimum tokën bujqësore. Këto toka përbëjnë pjesën më të madhe të tokës bujqësore dhe duhet të ruhen të paprekura nga zhvillime të tjera. Në të njëjtën logjikë veprohet për tokat natyrore, pyjet, kullotat, ku jo vetëm nuk lejohen ndërtime, por ka programe të shtimit të sipërfaqes pyjore dhe zbutjen e fragmentimit peizazhistik të habitatit.

- Ndërtim të rrugëve të reja, pavarësisht nivelit/hierarkisë, me qëllim jo thjesht lehtësimin e trafikut, por edhe lidhjen e të gjitha qendrave e vendbanimeve me njëri-tjetrin dhe krijimin e aksesit për banorët dhe bizneset.

d. Objektivat, Programet dhe Projektet e propozuara

O1: Rritja e konkurueshmërisë ekonomike të Bashkisë Fier, përmes mbështetjes së diversifikimit të profilit të saj ekonomik.

O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy poleve ekonomike rajonale, pranë fshatit Daullas (në jug të vijës së Ngjalës) dhe në Levan.

Pr1: Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse për funksionimin e polit ekonomik në fshatin Daullas dhe Levan

O1P2: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë së rëndë dhe asaj të ndërtimit në Portëz në kryqëzimin e rrugëve Fier-Kuçovë dhe Fier-Ballsh.

Pr2: Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse për funksionimin e polit ekonomik në kryqëzimet Fier-Kuçovë dhe Fier-Ballsh.

Programi Strategjik O1P3: Përmirësim i infrastrukturës dhe mbështetje e Shkollës së Mesme Profesionale "Rakip Kryeziu" si pol për zhvillimin e praktikave të mira në sektorin e bujqësisë.

Pr3: Rikonstruksioni, plotësimi me laboratorë dhe bazën materiale të nevojshme për shkollën "Rakip Kryeziu"; si dhe zgjerimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore në administrim prej saj në funksion të kërkimeve dhe testimeve, dhe si fidanishte për përdorim publik.

O1P4: Mbështetje, marketim, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.

Pr4: Ndërtimi i tregjeve ushqimore në funksion të zhvillimit të sektorit të bujqësisë (në Levan dhe Mbrostar);
Pr5: Ndërtimi i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Fier dhe zonave pranë.

O1P5: Rehabilitimi i ish-zonës industriale të Azotikut dhe kthimi i saj në një zonë polifunksionale me fokus zhvillimin e sektorit të industrisë dhe atë të shërbimeve.

O1P5: Hartimi i projektit për rehabilitimin mjedisor të ish-zonës industriale të Azotikut, dhe për kthimin e saj në pol ekonomik të bashkisë.

O2: Mbështetje e sektorit të bujqësisë dhe turizmit, si sektorë kyçë për zhvillimin e ekonomisë lokale

O2P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Fier

Pr1: Rehabilitimi i stacionit të elektropompave Mujalli dhe Bitaj, ana ndërtimore, makineri, pajisje dhe rrjeti ujitës;
Pr2: Rehabilitimi i rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti i kanaleve te dyta në zonën Kallm-Verri-Mbrostar;
Pr3: Rehabilitimi i sistemit të kullimit në zonën Kallm Verri Mbrostar - Kolektori i Bitajt dhe rrjeti i kanaleve kulluese të para dhe të dyta;
Pr4: Rehabilitimi i Ujitjes dhe Kullimit të Fushës së Sheqit Fier;
Pr5: Rehabilitimi i Stacionit të elektropompave Havaleas bashkë me rehabilitimin e rrjetit ujitës Kanalit Ujitës, Dega e Fierit dhe kanaleve të dyta;
Pr6: Rehabilitimi i sistemit ujitjes me stacionin e elektropompave Kafaraj, rehabilitimi i stacionit, ana ndërtimore, makineri pajisje dhe rrjeti i i kanaleve;
Pr7: Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Vjosë ne fshatin Hambar njësia administrative Cakran, si dhe mbrojtja në fshatin Kashisht, njësia administrative Frakull;
Pr8: Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Seman në zonën e fshatit Seman Ferm, njësia administrative Seman;
Pr9: Mbrojtja nga përmbytjet në zonën e Poros dhe Pishës (Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse Bregdetari i Majtë);
Pr10: Rehabilitimi i ujitjes së Fushës së Cakranit.

O2P2: Hartimi i instrumenteve të manaxhimit të tokës, të cilat do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me kategori bazë të përdorimit të tokës të propozuar B. Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore.

Pr11: Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të manaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja.

O2P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa bujqësore) përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP).

Pr12: Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore.

O2P4: Identifikimi, inventarizimi, hartëzimi (hartografimi) dhe përmirësimi/zhvillimi i aseteve historike.

Pr13: Vendosja e sinjalistikës orientuese për zhvillimin e turizmit.

O2P5: Zhvillimi i itinerareve turistike dhe promovimi i tyre si paketa turistike në bashkëpunim me aktorët aktivë të këtij sektori në Bashkinë e Fierit.

Pr14: Hartimi i itinerareve turistike në Bashkinë Fier dhe Bashkitë fqinje.

O2P6: Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në fshatrat Pojan, Boçovë dhe Bashkim.

Pr15.1: Rikonstruksion i Rrugës Pishë-Poro;
Pr15.2: Rikonstruksion i Rrugës Kthesa e Qarrit-Kryqëzimi i Darzezës.

O3: Mbrojtja dhe rigjenerimi i aseteve natyrore si elemente bazë të ripërtëritjes ekonomike dhe sociale.

O3P1: Mbrojtja e bregdetit nga erozioni bregdetar.

Pr1: Plotësimi i brezit pyjor mbrojtës në bregdet Pishë-Poro-Zona Kërnicë;
Pr2: Pyllëzimi i bregdetit nga grykëderdhja e Lumit Seman deri në Darzezë;
Pr3: Ndërtimi i një ishulli të mbjellë me bimësi rizofore për mbrojtje të bregdetit nga dukuritë erozive detare;
Pr4: Ndërtimi i një brezi platformash/infrastrukturash mbrojtëse ndaj erozionit në bregdetin Darzezë-Pishë-Poro;
Pr5: Ndërtimi i një parku botanik me funksion rekreativ dhe ruajtës të llojeve bimore me interes rritje në zona të kripëzuara.

O3P2: Rehabilitimi i shtretërve lumorë të Semanit, Vjosës dhe Gjanicës.

Pr6.1: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman;
Pr6.2: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Vjosë;
Pr6.3: Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe zonës ripariane të tij.

O3P3: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale; Mbrojtja dhe zgjerimi i pyllit të Levanit.

Pr7: Zgjerimi i Pyllit të Levanit dhe kthimi i tij në Park.

Programi Strategjik O3P4: Përmirësimi i shërbimit të manaxhimit të mbetjeve urbane.

Pr8: Hartimi i një plani për manaxhimin e integruar të mbetjeve urbane për Bashkinë Fier;
Pr9: Ndërtimi i impiantit të djegies së mbetjeve urbane;
Pr10: Mbyllja dhe rehabilitimi i pikës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve në Fier.

O3P5: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial.

Pr11: Hartimi dhe zbatimi i projekteve për mbrotjen e Kanalit të Roskovecit nga aktiviteti industrial i Bashkisë Fier por edhe i bashkive fqinje.

O4: Orientimi dhe kontrolli i zhvillimit urban përmes manaxhimit inteligjent të tokës dhe ofrimit të infrastrukturave të planifikuara në të gjithë territorin e Bashkisë Fier.

O4P1: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me infrastrukturat kombëtare.

Pr1: Konsolidimi i Rrugës Aulona deri tek Pylli i Levanit;
Pr2: Ndërtimi i Rrugës së Bregdetit Pishë-Karavasta e Re;
Pr3:Ndërtimi i 2 urave automobilistike mbi Seman: Adriatik dhe përgjatë rrugës së bregut;
Pr4: Ndërtimi i një ure këmbësore në Seman, përgjatë rrugës kryesore rurale Topojë- Ndërnënas;
Pr5: Zgjerimi i urës ekzistuese në rrugën Rreth Libofshë-Mujalli;
Pr6: Plotësimi i unazës së Fierit nëpërmjet rikonstruksionit të rrugës "Unaza perëndimore" (nga hekurudha Fier-Ballsh deri në rrugën nacionale Fier-Vlorë);
Pr7: Lidhja me rrugën "Celigrad" si portë hyrëse veriore, deri në Bypass;
Pr8: Lidhja me rrugën "Teodor II Muzaka" (Sheq i Madh, Bypass);
Pr9: Zgjerimi i Rrugës së Semanit deri në bregdet;.
Pr10: Ndërtimi i rrugës lidhëse me parkun arkeologjik të Apolonisë-porta hyrëse perëndimore;
Pr11: Zgjerimi i terminalit të autobusave ekzistues pranë varrezave të qytetit të Fierit, në drejtim të rrugës së Patosit dhe vënia e tij në funksion të transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë kufijve.
Pr12: Zgjerimi i rrugës së Cakranit, me korsi biçiklete dhe trotuarë

O4P2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues përgjatë rrugës së Semanit dhe në aksin Fier-Mujalli-Grecalli.

O4P3: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative në qytetin e Fierit dhe lidhjes së këtyre qendrave me njëra tjetrën.

Pr13: Ndërtimi i stacionit multimodal të Fierit në vendndodhjen ekzistuese;
Pr14: Rikonstruksion i rrugëve që lidhin fshatrat e qendrat administrative me njëra-tjetrën: Levan – Shtyllas, Rruga Ferras, Rruga kthesa e Bishanit – Boçovë – Varrezat e fshatit Bashkim, rrugës nacionale Fier - Ballsh (qendër e fshatit), Grecalli, Rugës Gorishovë – Selishtë, Rruga Frakull e Vogël – Varibob, Rruga Hekurudha Fier - Ballsh - hyrje fshati Zhupan, rruga Pojan –

Kthesa e Qarrit, rruga e brendshme “Sulo Gega”, “Kujtim Kosova”, “Baltëz Muçaj”, rruga kryesore Dërmenas, rruga “Agim Havaleas” (Dërmenas), Agim – Havaleas, Fier – Daullas, Mujalli, Grecalli, Autostradë- Kallm i Vogël, Rruga e Kallmit, Seman – Topojë, Cakran – Gorishovë – Selishtë);
Pr15: Rikonstruksion i bulevardit "Jakov Xoxa";
Pr16: Rehabilitim i rrugës “Muharrem Agolli”;
Pr17: Rikonstruksion i rrugës Plyk-Lalar-Kraps;
Pr18: Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku”;
Pr19: Rikonstruksion i rrugës Agim-Ndërmenas-Hasturkas;
Pr20: Rikonstruksion i rrugës “Mirkuptimi”.

O4P4: Intensifikimi i zhvillimit në fshatrat Levan dhe Frakull e Madhe si satelite urbane të qytetit të Fierit.

O4P5: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ-it.

Pr21: Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura;
Pr22.1: Rikonstruksion i ujësjellësit Topojë;
Pr22.2: Rikonstruksion i ujësjellësit Sek. Seman;
Pr22.3: Rikonstruksion i ujësjellësit Gorishovë;
Pr22.4: Rikonstruksion i ujësjellësit Poro-Bregdet;
Pr23.1: Ndërtim i depos së ujit në fshatin Mbrostar;
Pr23.1: Ndërtim i depos së ujit në fshatin Çlirim;
Pr24.1: Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në Darzezë;
Pr24.2: Ndërtim i ujësjellësit fshati Sheq Musalal;
Pr24.3: Ndërtim i ujësjellësit Drizë-Myrteza;
Pr24.4: Ndërtim i ujësjellësit Kraps-Patos fshat;
Pr24.5: Ndërtim i ujësjellësit Buzmadh;
Pr25: Ndërtim i KUZ-it Libofshë.

O4P6: Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve akupunkturë.

Pr26: Ndërtimi i një qendre për promovimin e produkteve artizanale në fshatin Pojan, pranë parkut arkeologjik të Apollonisë.

O4P7: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Fierit dhe disa nga qendrat urbane, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve.

Pr27: Projekte dizajni për hapësirat publike të qytetit të Fierit dhe qendrat e fshatrave Levan, Mbrostar, Libofshë, Cakran, Darzezë, Pojan, Adriatik, Daullas, Pishë, Boçovë, Bashkim.

Program Strategjik O4P8: Sigurimi i gazifikimit të territorit të bashkisë Fier nëpërmjet projektit të TAP-it.

Pr28: Hartimi i një projekti për lidhjen e bashkisë Fier me linjën e gazsjellësit TAP.

O5: Zbutja e pabarazive sociale përmes përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor.

O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.

Pr1: Ndërtimi i Spitalit Rajonal.

O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Fier

Pr2: Rikonstruksion dhe përmirësim i të gjitha qendrave shëndetësore të Njësive Administrative të Bashkisë Fier.

O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Fier, kryesisht me fokus mjekësinë.

O5P4: Mbështetje e arsimit profesional, përmes investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese në Bashkinë e Fierit.

Pr3: Rikonstruksion, plotësimi me laboratorë dhe bazën materiale të nevojshme për shkollën profesionale industriale;
Pr4: Rikonstruksion, plotësimi me laboratorë dhe bazën materiale të nevojshme për shkollën profesionale artistike.

Programi Strategjik O5P5: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Fier.

Pr5: Rikonstruksion i objekteve arsimore në Njësitë Administrateve në Bashkinë Fier (Dërmenas, Libofshë, Buzëmadh, Cakran, Varibob, Grecalli, Frakull, Mbrostar - Ura, Levan)
Pr6: Ndërtim kopshti në fshatrat Peshtan Bregas, Cakran, Varibob, Kreshpan, Kraps, Frakull e Madhe, Drizë, Afrim, Sulaj, Mbrostar, Venaj;
Pr7:Ndërtim shkolle 9-vjeçare në fshatrat Grykë, Metaj, Kallm i Vogël, Kraps;
Pr8:Ndërtim shkolle e mesme në fshatrat Plyk, Portëz, Peshtan, Kraps, Pishë, Mbrostar, Petovë, Ndërnënas;
Pr9:Rikonstruksioni i kopshtit në fshatin Darzezë;
Pr10:Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare të fshatit Fushë, në Topojë.

O5P6: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për strehim social në bashkinë e Fierit.

Pr11: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për strehim social në bashkinë e Fierit.

O5P7: Krijimi i infrastrukturës së gjelbër dhe asaj sportive/rekreative.

Pr12: Ndërtim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rrugës "Xoxi Andoni" dhe hapësirat rreth saj;
Pr13: Rivitalizim i parkut pranë Bar-Rinisë dhe rehabilitim i rrugës "Dervish Hekali";
Pr14: Gjelbërim i unazës së qytetit të Fierit dhe anët e lumit Gjanica;
Pr15: Ndërtimi i parkut të ri urban të Fierit (30ha) në zonën e Mbrostarit;
Pr16: Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në qytetin e Fierit;
Pr17: Ndërtimi i një marine jahtesh në kanalin e Darzezës.

O5P8: Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve social-kulturore

Pr18: Rikonstruksion i Teatrit "Bylis";
Pr19: Rikonstruksioni i Pallatit të Sportit.

Tabela 110. Reflektimi i propozimeve të planeve kombëtare në PPV-në e Bashkisë Fier.

Propozimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), ose PINS Bregdeti	**Reflektim në PPV**	**Sqarime për mënyrën e reflektimit në PPV**
Fieri si qendër parësore në hierarkinë e qendrave urbane, duke kryer së paku këto funksione: *- Funksione ekonomike dhe të qendrave të banimit;* *- Funksione të nyjave të rëndësishme të qarkullimi;.* *- Funksione të tregtisë me shumicë dhe pakicë;* *- Funksione kulturore dhe të rekreacionit;* *- Funksione administrative;,* *- Funksione arsimore, shkencore; shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale.*	I plotë	Pozicioni favorizues i Fierit në rajon është marrë në konsideratë në përcaktimin e infrastrukturave kryesore mbështetëse, në propozimin e projekteve të rëndësishme strategjike, si landfill-i rajonal, spitali rajonal, në propozimet për zonat ekonomike të reja dhe rivendosjen në funksionim të ekzistueseve etj.
-*Rritja* e sipërfaqes së *Zonave të Mbrojtura*, duke i shtuar *Rrjetin Emerald (*ku zgjerohet sipërfaqja e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit dhe Parku Kombëtar Llogara) dhe Zonat e Mbrojtura Detare e Bregdetare (IBA Coast, Grykëderdhja e Semanit).	I plotë	PPV parashikon rritjen me 3,000 Ha të zonave të mbrojtura, duke përfshirë zgjerimin e Pyllit të Levanit dhe caktimin e bregdetit nga zona e Deltës së Semanit në Pishë Poro, si dhe Pyllit të Cakranit, si Parqe natyrore rajonale.
Përcaktimi i korridorit lumor të Semanit	I plotë	Është evidentuar si fashë natyrore, në të cilën rigjenerohet tërësisht zona ripariane e lumit, deri në argjinaturën respektive.
Marrja e masave zbutëse në lidhje me ndryshimet klimatike	I plotë	Parashikuar në Plan por edhe në VSM. Masat janë të ndryshme si: shtimi i sipërfaqes pyjore në zonën kodrinore dhe në zonën ripariane të lumit Seman, krijimi i korridoreve vegjetative në zona bujqësore, krijimi i zonës ripariane të Semanit dhe burimeve të tjera ujore, marrja e masave për zhvendosje të popullsisë ose pritje të popullsisë nga zona në rrezik emergjent, mirëmbajtja e sistemit të kullimit dhe vaditjes etj.
PINS Bregdeti parashikon një marinë në	I pjesshëm	PPV parashikon një marinë jahtesh në

vazhdim të Vijës së Ngjalës, e cila lidhet me Durrësin në Plazhin e Gjeneralit dhe në një marinë të propozuar në ishullin e Sazanit.		vazhdim të kanalit të Hoxharës. Vendodhja është e ndryshme nga pozicioni i propozuar në Vijën e Ngjalës, për shkak të dukurive gërryese të detit që vërehen në bregdetin e Semanit, si dhe për shkak të afërsisë së marinës së propozuar me fshatin Darzezë dhe zonën e resorteve të propozuar në Pishë-Poro.
Komente nga "Akti i Përputhshmërisë për Dokumentin e Strategjisë Territoriale"	**Reflektim në PPV**	**Sqarime për mënyrën e reflektimit në PPV**
Fazimi i strategjisë dhe objektivave duke patur parasysh një territor në ndryshim të vazhdueshëm, i cili në harkun e 15 viteve në vijim do ketë zhvillime e nevoja të tjera. Një parashikim i skenareve të mundshme për këtë hark kohor do ndihmonte në identifikimin e problemeve/presioneve të ardhshme dhe kundërpërgjigjeve për zgjidhjen e drejtimin e tyre.	I plotë	Fazimi është kryer sipas pikës 2.4.1, në intervalet kohore 0-3 vite, 3-5 vite dhe 5-15 vite, duke identifikuar kështu projektet më prioritare, që mund të buxhetohen që në PBA.
Përputhja e rekomandimeve të evidentuara nga analiza SWOT (territori dhe mjedisi) me projektet prioritare për të siguruar efikasitet më të lartë të veprimit në territor.	I plotë	Projektet prioritare janë evidentuar duke marrë parasysh potencialet dhe kërcënimet e shfaqura ne analizën SWOT, si vazhdim i Strategjisë Territoriale të Zhvillimit, dhe duke marrë parasysh emergjencën e ndërhyrjeve dhe impaktin e tyre në arritjen e 5 objektivave të synuara për periudhën 2016-2031.
Detajimi i projekteve prioritare (fishave) me kosto të përafërta, në mënyrë që të bëhen sa më të prekshme për financues të mundshëm dhe të arrihet në një plan veprimi prioritar paraprak që i shërben bashkisë.	I plotë	Kostot për projektet prioritare dhe për gjithë projektet e tjera janë detajuar në Seksionin 2.4.2, Plani i Investimeve Kapitale
Monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe objektivave kërkon një sërë treguesish të matshëm, të cilët mund të evidentohen në fazat më të avancuara të PPV.	I plotë	PPV përmban një plan të zbatimit në faza dhe po ashtu treguesit dhe mënyrat e monitorimit të zbatimit.
Fokus në shfrytëzimin e linjës energjitike TAP si burim energjie për zhvillimin e industrisë së zonës.	I plotë	PPV parashikon një zonë ekonomike në shërbim të TAP, në afërsi të stacionit të kompresimit të gazit në fshatin Seman. Kjo zonë do të jetë e përmasave 10-20 Ha dhe do shtrihet në respektim të fashës së mbrojtjes nga gazsjellësi (minimalisht 100 metra nga linja, e për distancë deri 650 metra nga ajo gjurmë do të jetë subjekt konsultimi me operatorët e TAP-it), në zonë të kripëzuar, pa prekur zonën e propozuar të mbrojtur të lagunës së deltës së Semanit.
Ndërmarrja e nismave përkatëse me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të energjisë alternative, si ajo diellore (parqet fotovoltaike) apo energjia e erës etj.	I plotë	Janë marrë masa në VSM dhe PPV, për përdorimin e energjisë diellore, në nivel individual
Studimi i mundësive të zhvillimit të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës dhe gazit natyror, duke patur parasysh efektet e tyre anësore në mjedis	I plotë	Sipas studimit mjedisor dhe VSM-së, kjo industri ka efekte shumë negative në disa aspekte burimesh natyrore (toka, uji dhe bujqësia) dhe të shëndetit. Përdorimi i ujit nëntokësor dhe ri-injektimi i ujit të përdorur në shtresat tokësore ndikojnë

		negativisht akuiferin e Fierit. Për më tepër, zgjerimi në tokë bujqësore dëmton potencialin e Fierit si ekonomi e zhvilluar me bazë bujqësinë. Për këtë qëllim, Plani nuk propozon zgjerime të mëtejshme të zonës për nxjerrjen e naftës. PPV propozon marrjen e masave mjedisore për zbutjen e impaktit sipërfaqësor e të dukshëm, por sugjeron se ndërprerja e zgjerimit të aktivitetit në territor është mënyra e vetme për të mbrojtur burimet nëntokësore ujore. Lejet për zgjerim në territor, kompanitë i marrin ose i kanë marrë nga autoritetet qendrore dhe përtej sferës së PPV-së. PPV-ja është thelluar në studimin e teknologjisë së nxjerrjes dhe po ashtu ka komunikuar me kompanitë kryesore të angazhuara në shfrytëzimin e burimeve të naftës për të kuptuar veprimtarinë e tyre dhe mbi këtë bazë ka bërë sugjerimet e mësipërme.
Ndërtimi i stacionit multimodal, i cili në rastin e bashkisë hyn në kategorinë 'kombëtar' dhe lidhja e tij me rrjetin e transportit	I plotë	Stacioni multimodal i propozuar do të jetë pjesë e një kompleksi 10 ha, me shërbime ndihmëse infrastrukturore, tregtare etj. Pozicioni i propozuar është në stacionin aktual të trenit, me mundësi për përshtatjen e një vendndodhjeje të dytë më në jug, në truall të zënë me vila me densitet të ulët dhe përdorim bujqësor, në rast se zona e parë e propozuar do hasë vështirësi në përshtatje për PDV.
Rrjeti i biçikletave që përshkon rajonin, referuar rrjetit kombëtar të biçikletave të propozuar nga PPK-ja. Në këtë rast kalojnë Itinerari Bregdetar Turistik dhe Itineraret Horizontale Kombëtare.	I plotë	PPV-ja parashikon një rrjet të lëvizjes me biçikleta për të gjithë territorin e bashkisë, përfshirë itineraret bregdetare, bujqësore e ato lumore. Referencë për këtë është harta me kodin xxx.
Aktivizimi i zonave të mbrojtura si potenciale turistike nëpërmjet projekteve 'soft' që lidhin bregdetin me fshatrat përgjatë tij.	I plotë	Për këtë qëllim ka propozime në lidhje me zonën turistike afër Pishë-Poros, evidentimin e Kurorës në Fier dhe masat për mbrojtjen dhe promovimin e saj, Pyllit të Levanit dhe masat për mbrojtjen e zgjerimin e tij, dhe Apollonisë dhe propozimeve në favor të mbrojtjes së vlerave të saj.
Evidentimi i masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke patur parasysh përmbytjet, thatësirat dhe avancimin e detit në brendësi të tokës	I plotë	PPV-ja dhe VSM-ja paraqesin analizë të ndryshimeve klimatike dhe masa për mbrojtjen nga efektet ose për zbutjen e tyre. Masat variojnë nga mënyra e përdorimit të tokës bujqësore, zonat ripariane për lumenjtë, instrumentet inxhinierike dhe natyrore për zbutjen e erozionit bregdetar, mbrojtjen e mbarështimin e dunave detare, korridoret dhe ishujt vegjetativë në tokë bujqësore dhe deri tek mundësia për zhvendosje të banorëve në rast katastrofe. Bregdeti është studiuar në veçanti dhe PPV përmban një koncept zhvillimi, konservimi dhe rehabilitimi mjedisor për të.
Nevojat aktuale dhe ato në rritje të	I plotë	PPV përmban propozime konkrete për

populllsisë për furnizimin me ujë, duke marrë parasysh rrezikun që parashtron fenomeni i kripëzimit të akuiferëve në deltën e lumit Vjosa / puset e shpimit në Pishë-Poro.		sistemin e furnizimit me ujë
Identifikimi i nevojës reale për pajisjen me infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike, duke u ndaluar në projektin e Spitalit Rajonal të Fierit – karakterin e tij dhe raportin me spitalin ekzistues; trajtimin e varrezave të qytetit.	I plotë	Përveç zgjerimit dhe ristrukturimit të rrjetit rrugor, PPV-ja përmban propozime për zgjerimin dhe përmirësimin e aksesit në transportin publik, shtimin disa herë të hapësirës së gjelbër publike, përmirësimin e infrastrukturës së shkollave dhe qendrave shëndetësore, ndërtimin e një spitali rajonal në periferi të qytetit, dhe zgjerim të varrezave.
Rehabilitim të zonave industriale ekzistuese dhe marrëdhënia e tyre me ndërhyrjet e reja, duke përmendur këtu TEC-in e parashikuar edhe nga PPK-ja.	I plotë	Për zonat industriale si Azotiku dhe TEC-i Fierit janë parashikuar ndërhyrje të rehabilitimit mjedisor për përshtatjen e tyre në zona të industrisë së lehtë. Po ashtu, zonat e banimit përreth nuk pësojnë rritje në tregues zhvillimi dhe në to do të ndërhyet për ristrukturim të infrastrukturës dhe do të krijohet brezi i gjelbërimit të lartë prej 50 m përreth zonës industriale.

2.1.2 Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës

Koncepti i përdorimit të propozuar të tokës: Koncepti i përdorimit të tokës është një fazë e ndërmjetme midis vizionit të Bashkisë i paraqitur në Dokumentin e Strategjisë dhe përdorimit të propozuar të tokës. Ky koncept zbërthen më tepër idetë e vizionit duke i paraqitur ato në formë fashash, njollash, zonash dhe qendërsish në territor. Në paragrafët e mëposhtëm do të shpjegohen elementët e propozuar të përdorimit të tokës.

Zonat e banimit: Në këtë fazë janë evidentuar zonat e banimit, por ende nuk është vendosur se cilat zona do të densifikohen veçanërisht për zonat e fshatrave. Në një fazë të mëvonshme do të përcaktohen se cilat fshatra/ lagje do të densifikohen.

Zona ekonomike: Në Bashkinë e Fierit propozohen pesë zona ekonomike kryesore të cilat ndodhen në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme ekzistuese ose të propozuara, në zona me një profil ekonomik tashmë dhe në zona të degraduara, ish-industriale. Këto zona janë: Zona ekonomike e Azotokut, e Levanit, Grecallisë, Portëzës dhe Dërmenasit. Në seksionin e zonave të zhvillimit ekonomik shpjegohen karakteristikat për secilën nga zonat.

Zonat e industrisë: Në zonat industriale të propozuara në Bashkinë e Fierit janë zonat naftënxjerrëse në fshatrat Kallm i Madh dhe Kallm i Vogël në Mbrostar. Është përcaktuar një gjurmë e cila nënkupton zonën naftënxjerëse në territorin e bashkisë. Në këtë zonë shmanget urbanizimi i mëtejshëm, si dhe kultivimi i produkteve bujqësore. Ndërkaq, dy zona të reja industrial vendosen në shërbim të TAP, sipas parashikimeve të projektit, dhe në zonën

Fasha natyrore: Kjo fashë është shtrirë kryesisht në kodrat e Levanit dhe Cakranit dhe përbëhet nga zona natyrore të cilat kanë karaktere të ndryshme nga njëra – tjetra për shembull nga zona natyrore si Pylli i Levanit, Kurora e Adriatikut, kodra ullishtesh etj.

Nëpërmjet ketij propozimi priret që këto zona të mbrohen dhe të ruajnë karakterin natyror.

Fasha Lumore: Në territorin e Bashkisë Fier ka tre lloje fashash lumore të cilat janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Fasha e Lumit Seman përbëhet nga disa elementë përbërës. Përgjatë fashës gjendet kurora natyrore e Adriatikut, zona urbane e Libofshës, zona ku bashkohet me Lumin Gjanica, zona ekonomike e Mbrostarit si dhe zona insutriale e Kallimit të Vogël dhe Kallmit të Madh. Fasha lumore e Vjosës është më pak e ndërlikuar në elementë përbërës. Ajo përbëhet nga zona bregdetare, zona urbane fshatrave Ferras dhe Pishë-Poro, zona ku bashkohet me Bypass-in e Fierit si dhe zona bujqësore. Fasha e Lumit Gjanica për shkak të shtrijes së tij në pjesën më të madhe në zonë të urbanizuar, është tepër komplekse në përbërjen e tij. Fasha lumore e Gjanicës përbëhet nga:

Zonat e bujqësisë: Zonat e bujqësisë zenë një sipërfaqe të konsiderueshme të territorit të Bashkisë dhe shtrihen midis zonave të banimit, zonave natyrore dhe bregdetare si dhe midis fashave të tjera. Në thelb të konceptit qëndron ideja e ruajtes së zonave bujqësore dhe lidhje efiçente e tyre me zonat dhe fashat e tjera.

Fasha e hekurudhës: Kjo fashë fizikisht është lineare dhe shtrihet përgjatë gjithë territorit të bashkisë por duke mbartur me vete karakteristika të ndryshme në territore të ndryshme. Për shembull: fasha e hekurudhës në brendësi të zonës së urbanizuar të ka një karakteristikë tjetër e cila bëhet më urbane dhe duhet të trajtohet ndryshe ndërkohë në pjesë të tjera ka një karakter tërësisht natyror dhe bujqësor.

Zonat e turizmit bregdetar dhe natyror: Zonat e turizmit bregdetar dhe natyror shtrihen në pjesën perëndimore të Bashkisë dhe janë këto zona të cilat do t'i japin karakterin turistik Bashkisë së Fierit. Këto zona i janë dedikuar turizmit natyror dhe bregdetar plotësisht.

Zonat e tokave të kripura: Zona e tokave të kripura shtrihet pranë zonës së turizmit bregdetar dhe natyror dhe përbën një zonë me potencial për zhvillimin ekonomik të bashkisë. Fakti është se përmes këtij koncepti zonat e kripura tentohen në zona potenciale nëpërmjet programeve të ndërhyrjes.

Zonat në funskion të zhvillimit të bregdetit: Zonat në funksion të zhvillimit të bregdetit shtrihen shumë pranë tij dhe deri në këtë moment ekzistojnë dy versione të këtyre zonave. Njëra prej tyre është zona pranë pyllit të Pishë-Porosë dhe tjetra gjendet pranë fshatit të Darzezës. Të dyja këto zona do t'i shërbejnë zhvillimit të sektorit të turizmit duke siguruar zona akomodimi në formë resortesh dhe qendra të tjera shërbimi, hapësira publike, rrugë aksesi etj.

Për të siguruar përmbushur vizionin e zhvillimit dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në "Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Fier", të cilat në aspektin e përdorimit të tokës synojnë ruajtjen e tokës bujqësore si potenciali kryesor i zhvillimit ekonomik të kësaj bashkie, krijimin e kushteve të përshtatshme të banimit, duke harmonizuar nevojat e banorëve aktual dhe të pritshëm të kësaj bashkie dhe zbutjen e pabarazive sociale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave dhe shërbimeve publike, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fier përcakton Kategoritë dhe Nënkategoritë bazë të përdorimit të propozuar të tokës për çdo njësi

strukturore. Në mënyrë të përgjithshme, propozimet në lidhje me përdorimin e tokës përshkruhen si më poshtë:

Kategoria bazë Banim (A): duke u bazuar në projeksionet dhe skenarët e rritjes së ardhshme të popullsisë në Bashkinë Fier, dhe duke u mbështetur në analizën e nevojës për strehim, është përllogaritur sipërfaqja e nevojshme për të mbuluar kërkesat e parashikuara për strehim në 15 vitet e ardhshme. Duke iu referuar këtyre gjetjeve, analiza parashikon rritjen e popullsisë në Bashkinë Fier me rreth 22,000[447] banorë. Megjithatë, për shkak të potencialit të madh të tokës bujqësore, nivelit të lartë të fragmentimit të saj, dhe kushtëzimeve ligjore për konvertimin e saj në tokë truall, Plani parashikon zgjerimin e sipërfaqes së kësaj kategorie pak ose aspak në Njësitë Administrative fushore (Dërmenas, Topojë etj), duke u fokusuar më tepër në konsolidimin e zhvillimeve ekzistuese, dhe pjesërisht mbushje të njësive strukturore. Në qytetin e Fierit, megjithatë, për shkak dhe të përqëndrimit më të madh të popullsisë së ardhshme dhe rritjes deri në vitin 2030 me rreth 4,500 banorë, Plani parashikon zgjerimin e sipërfaqes së banimit në pjesët periferike, deri në gjurmën e Unazës 3. Kjo përjashton disa zona me përmasa mbi 30 ha, të cilat janë aktualisht bujqësore dhe caktohen në ngrirje, për të strehuar funksione të mundshme që mund të duhen në të ardhmen. Mbi këto rekomandime, plani përcakton njësitë strukturore të cilat do të akomodojnë nevojën për strehim, fillimisht në njësitë ku parashikohet dendësimi nëpërmjet intensifikimit, mbushjes urbane dhe më pas hapjes së zonave të reja të banimit nëpërmjet konvertimit të tokës (në fazën e tretë). Niveli i intensifikimit, zhvillimit, dhe zgjerimit të tokës së banuar është përcaktuar mbi bazë të projeksionit të popullsisë, zhvillimit të dëshiruar, si dhe pioritarizimit të fshatrave në nivel njësie administrative, në bazë të potencialit të tyre.

Tabela 111. Nevoja për sipërfaqe shërbimesh bazë, sipas Rregullores së Planifikimit.

Indikatore	Popullsia 2015	Popullsia 2031	*Kopësht/çerdhe (4.5m²/banor)*	*Struktura për përdorim publik (2m²/banor)*	*Terren sportiv (1.6m²/banor)*	*Parkim publik (6m²/banor)*	*Shërbim tregtar i kufizuar (5m²/banor)*
Cakran	25130	28683	129073.5	57366	45892.8	172098	143415
Dermenas	23279	25454	114543	50908	40726.4	152724	127270
Frakull	20488	23090	103905	46180	36944	138540	115450
Fier	38037	41658	187461	83316	66652.8	249948	208290
Levan	10384	11647	52411.5	23294	18635.2	69882	58235
Libofshë	10668	12099	54445.5	24198	19358.4	72594	60495
Mbrostar	17702	20463	92083.5	40926	32740.8	122778	102315
Portëz	10626	11824	53208	23648	18918.4	70944	59120
Qendër	11507	13708	61686	27416	21932.8	82248	68540
Topojë	26346	27419	123385.5	54838	43870.4	164514	137095
TOTAL	194167	216045	972202.5	432090	345672	1296270	1080225

Burimi: Rregullorja e Planifikimit të Territorit; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Sa i përket ngrirjes së njësive strukturore, ato përbëhen kryesisht nga parcela që aktualisht përdoren për qëllime banimi. Pjesa më e madhe e tyre janë të vendosura në zonën bujqësore ku parashikohet konservimi strikt i këtyre tokave, përgjatë përroit të

Fierit. Në zonën ripariane të lumit Seman në veri të Bashkisë, si dhe në afërsi të palejuar të infrastrukturës, rrugore, hekurudhore, kanaleve kulluese dhe vaditëse etj. duke mos respektuar rregullat e distancave minimale ndaj tyre. Në këto raste zhvillimi nuk propozohet të prishet (përveç rasteve të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për komuniteti që banon në këto zona) por ndalohet të ndërmerret çdo lloj aktiviteti me karakter ndërtimor. Në perspektivën afatgjatë, me amortizimin e strukturave ekzistuese, këta banorë do të mund të zhvendosen në zonat ku lejohet zhvillimi me qëllim banimi.

Tabela 112. Llogaritja e nevojës për shtim sipërfaqe banimi, për njësitë administrative.

Indikatorë	**Cakran**	**Dermenas**	**Frakull**	**Fier**	**Levan**	**Libofshë**	**Mbrostar**	**Portëz**	**Qendër**	**Topojë**	**TOTAL**
Popullsia 2015	25130	23279	20488	38037	10384	10668	17702	10626	11507	26346	194167
Popullsia 2031	28683	25454	23090	41658	11647	12099	20463	11824	13708	27419	216045
Peshë ne %	13.28%	11.78%	10.69%	19.28%	5.39%	5.60%	9.47%	5.47%	6.34%	12.69%	100.00%
Popullsi e shtuar	2906.74	2579.51	2339.94	4221.62	1180.31	1226.11	2073.72	1198.24	1389.17	2778.64	21894
Sn e nevojshme për strehimin e popullsisë shtesë	72668.3	64487.70	58498.5	105540.54	29507.6	30652.81	51843	29956.1	34729.2	69466.035	547350
I ekzistues bruto per perdorimin banim	0.126342	0.347876	0.175412	0.606525	0.350771	0.159629	0.29959	0.162061	0.374647	0.449682	0.3052538
Ksht ekzistues bruto për përdorim banim	10.01%	15.22%	13.13%	23.31%	14.82%	9.80%	15.89%	11.46%	16.88%	20.81%	15.13%
KSHP ekzistues	2.74%	1.27%	2.61%	2.28%	1.64%	0.98%	2.29%	1.58%	2.35%	1.74%	1.85%
KSHR ekzistues	1.06%	1.85%	1.60%	5.58%	1.33%	1.80%	2.50%	1.43%	2.06%	1.57%	2.08%
S rrugë e nevojshme për shërbim ndaj Sn shtesë (10%)	918.106	2243.372595	1026.13	6401.29	1035.043	489.3078	1553.18	485.471	1301.12	3123.76	18576.7
Sp që do shtohet për Sn, Sparcela publike dhe S rrugë të reja	10099.17524	24677.0985	11287.476	279451.4344	11385.48	5382.3862	17085	5340.1877	14312.32	34361.38838	413381.926
% e Sp të shtuar	2.44%	5.97%	2.73%	67.60%	2.75%	1.30%	4.13%	1.29%	3.46%	8.31%	100.00%

Burimi: Co-PLAN, 2016

Tabela e mësipërme tregon nevojën që ka për shtim sipërfaqe të ndërtueshme në secilën Njësi Administrative, duke marrë parasysh projeksionin e rritjes së popullsisë, nevojën për parcela publike: tregti, arsim, gjelbërim, parkim publik, infrastrukturë të

re etj, sipas Rregullores së Planifikimit, si dhe raportin ekzistues Sipërfaqe ndërtimi-Sipërfaqe parcele, duke bazuar në vlerat ekzistuese të intensitetit e Ksht-së. Rezulton se 70% e zhvillimit në nivel bashkie i takon Fierit, ku ka më shumë tendenca rritjeje popullsie, por edhe më shumë nevojë për hapësira shtesë për plotësim të standardeve të planifikimit për popullsinë ekzistuese dhe të propozuar. Gjithë njësitë e tjera duhet të akomodojnë minimalisht 1-4 Ha të tjera për përdorim banimi. Gjithsesi, parashikimet e intensiteteve ruajnë në parim këto tendenca, por parashikojnë fleksibilitetin për rritje të vogël të numrit të kateve, sipërfaqeve të vogla të shërbimit etj, për gjithë vendbanimet ekzistuese.

Kështu, vendbanimet që do i nënshtrohen densifikimit dhe rritjes urbane, në radhë respektive, janë:

Topojë: 1) Topojë, 2) Sheq Marinas, 3) Seman;

Dërmenas: 1) Darzezë, 2) Pojan, 3) Dërmenas, 3) Hoxharë;

Qendër: 1) Daullas, 2) Çlirim, 3) Grecalli;

Mbrostar: 1) Mbrostar;

Portëz: 1) Portëz;

Cakran: 1) Cakran;

Frakull: 1) Frakull e Madhe;

Libofshë: 1) Libofshë, 2) Adriatik, 3) Hasturkas, 3) Ndërnënas, 4) Rreth Libofshë;

Levan: 1) Levan, 2) Pishë, 3) Bishan, 3) Bocovë, 3) Bashkim.

Kategoria Bazë Industri dhe Ekonomi (IE): Kjo kategori përdorimi parashikohet të vendoset dhe konsolidohet në tre pika kyçe në qytetin e Fierit; në zonën ekonomike të Azotikut, si dhe përgjatë aksit të Portëzës dhe atij të Grecallisë. Zonat industriale dhe ekonomike i përkasin kryesisht nënkategorisë së industrive të lehta përpunuese, ndërtimtarisë etj. Rasti i Grecallisë është më miks, me shërbime tregtare dhe rekreative, duke shërbyer gjithashtu si hyrje e re e qytetit. Rivitalizimi i Azotikut parashikon gjithashtu industri të lehtë. Përgjatë zonave të tjera në qytet, ky përdorim shfaqet i përzier me kategorinë "Shërbime" për të pasuruar këto zona me funksione në shërbim të njëri-tjetrit. Për shkak të afërsisë së zonave me njësi të kategorisë banim, marrja e masave mjedisore, dhe rikrijimi i brezave mbrojtës (zonave buferike rreth tyre) është kusht i padiskutueshëm për zhvillimin e tyre.

Njësi të tjera të kësaj kategorie shfaqen në mënyrë pikësore, në Levan e Mbrostar, dhe akset lidhëse të qytetit të Fierit me këto dy zona (rruga "Aulona" dhe hyrja aktuale e Fierit. Në perspektivën afatgjatë ky aks do të marrë trajtën e Autostradës së mirëfilltë dhe krijimit të barrierave mbrojtëse, duke kufizuar hyrje daljet e rastësishme pranë bizneseve/industrive që ushtrojnë aktivitetin aktualisht. Në këtë kuadër, njësitë strukturore të kësaj natyre nuk parashikohet të prishen, por nuk do të lejohet të zhvillohen (shtrihen në sipërfaqe) duke kompromentuar konservimin e tokave

bujqësore që shtrihen përgjatë këtij aksi. Në raste specifike, ato do të mbështeten nga akse ndihmëse shërbimi, dhe në perspektivën afatgjatë zhvillimi i tyre do të orientohet në zonat e specifikuara industriale të përmendura më sipër, të cilat janë planifikuar të mbulojnë kapacitetin e ardhshëm industrial të Bashkisë Fier.

Kategoria Bazë Bujqësi (B): Ruajtja dhe konservimi në masën më të gjërë të kësaj kategorie është prioritet i Bashkisë Fier gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për këtë arsye në disa raste është propozuar ngrirja e zhvillimeve të shpërhapura në tokë bujqësore të cilat nuk janë në funksion të bujqësisë. Në njësitë e parashikuara me përdorim toke të kategorisë bazë Bujqësi janë parashikuar koefiçentë të ulët zhvillimi (Ksht max = 0.2%; Imax = 0.02) të cilët do të jepen vetëm për ndërtimin e strukturave në funksion të bujqësisë, konform ligjit për bujqësinë dhe planifikimit. Konvertime të mundshme të tokës bujqësore do të bëhen vetëm në njësitë të cilat kanë presion zhvillimi dhe parashikojnë akomodimin e popullsisë së ardhshme (tokat bujqësore deri tek Bypass-i), dhe konvertime në kategoritë bazë Infrastrukturë (IN) në rastet kur parashikohen zgjerime të infrastrukturave ekzistuese, apo propozimeve të akseve të reja infrastrukturore.

Kategoria Bazë Shërbime (S): Ky përdorim parashikohet të sistemohet në aksin qendror të qytetit të Fierit, kryesisht i përzier me Kategorinë Bazë Banim (A) dhe në raste specifike me Kategorinë Bazë Institucione (IS). Në të dyja këto raste funksionet e lejuara përjashtojnë funksione të cilat shkaktojnë ndotje akustike apo përdorime të tjera të papërputhshme me banimin, duke u kufizuar kryesisht në funksione tregtare; zyra dhe profesione të lira dhe argëtim. Ndërhyrja kryesore në këtë kategori është zona e parashikuar me resorte, në afërsi të pyllit të Pishë-Poros, e cila do të akomodojë nevojat e ardhshme për turizëm masiv elitar në bregdetin e Fierit.

Pjesa tjetër e Njësive të Kategorisë Bazë Shërbime (S) do të akomodohet brenda ose pranë njësive të Kategorisë Bazë Industri dhe Ekonomi, duke u kthyer në komplementare (plotësuese) të tyre siç është shprehur edhe më sipër.

Kategoria Bazë Përdorime të Veçanta (V): Në këta kategori do të bëjnë pjesë të gjitha ato njësi të cilat në përdorimin e ekzistues të tokës i përkasin nënkategorisë Varreza. Për secilën nga këto njësi, Plani parashikon rehabilitimin e hapësirave për varreza, dhe krijimin e brezave mbrojtës të tyre.

Kategoria Bazë Ujra (U): Kjo kategori përfshin të gjitha sipërfaqet ujore të bashkisë Fier duke nisur nga lumi i Semanit, lumi i Vjosës, lumi i Gjanicës, Vija e Ngjalës, Kanali i Hoxharës, rezervuarët e vegjël në zonat kodrinore të Cakranit e Libofshës, lagunat e ndodhura në afërsi të deltës së Semanit etj. Në rastet kur kjo kategori është e dëmtuar do të parashikohet pastrimi i tyre, dhe rindertimi i plotë i zonave ripariane (përgjatë Semanit) në zonat ku ajo është zhdukur apo dëmtuar krejtësisht si pasojë e përmbytjes. Për njësitë e tjera strukturore, kategoria bazë e së cilave është Ujëra, parashikohet Trajtimi Peizazhistik i tyre (lumi Gjanica) dhe kthimi i tyre në zona rekreative dhe çlodhëse për banorët e kësaj bashkie

Kategoria Bazë Natyrore (N): Njësitë strukturore të kësaj kategorie, shtrihen përgjithësisht në zonën kodrinore të Bashkisë ku janë të përqëndruara thuajse edhe të gjitha sipërfaqet pyjore të Bashkisë Fier. Për shkak të aktivitetit të lartë bujqësor edhe në zonat Kodrinore, shpesh sipërfaqet pyjore janë fragmentuar nga ato bujqësoret

duke shkëputur korridoret natyrore të tyre. Plani parashikon rehabilitimin e të gjithë njësive të cilat i përkasin kategorisë Bazë Natyrore dhe shtrimin e sipërfaqeve të tyre në rastet kur kemi ndërprerje të habitateve.

Kategoria Bazë Trashëgimi dhe Monumente Kulture (M): Fieri është i pasur me monumente kulture krahasuar me qarkun e Fierit në të cilin bën dhe pjesë, në këtë Bashki dallojmë Kompleksin e Apollonisë dhe një seri monumentesh kulture. Konservimi strikt i tyre dhe restaurimi në rast nevoje për të mbajtur gjallë këtë trashëgimi është i detyrueshëm. Monumentet e tjera natyrore/kulturore të cilat janë pikësore, janë integruar brenda Kategorisë Bazë Banim (A) dhe parashikohet ruajtja dhe konservimi i tyre në masën më maksimale.

Kategoria Bazë Institucione (IS): Plani i Përgjithshëm Vendor nuk parashikon ndryshime në këtë kategori bazë, për sa kohë nuk propozohen vendosje të institucioneve të reja administrative në këtë Bashki.

Kategoria Bazë Aktivitete Sociale dhe Rekreative (AR): Sipërfaqja e kësaj kategorie pritet të rritet ndjeshëm në Bashkinë Fier, kjo jo vetëm si pasojë e propozimeve të planit për hapjen e hapësirave të reja të gjelbëra por dhe si nevojë për hapësira të lira e popullsisë së ardhshme të Bashkisë. Shpërndarja e tyre parashikohet në të gjithë territorin e Fierit. Në Njësitë Administrative të cilat shtrihen përgjatë tokës bujqësore këto hapësira do të bëhen të mundura kryesisht në qendrat e njësive të cilat parashikohet t'i nënshtrohen rigjenerimit. Në qytetin e Fierit këto sipërfaqe janë parashikuar përgjatë Gjanicës, në lulishtet e reja të qytetit, në parkun e ri të ndërtuar në dalje të qytetit, si dhe brenda lagjeve të banuara etj. Në varësi të vendodhjes dhe madhësisë këto hapësira janë konceptuar si parqe/sheshe urbane; fusha sporti; lulishte dhe kënde lojrash.

Kategoria Bazë Arsim (AS): Duke iu referuar analizës së periferialitetit, dhe hartës së mbulimit me rreze të shërbimit arsimor në Bashkinë Fier, pothuaj të gjitha Njësitë Administrative shfaqen të avantazhuara, duke reflektuar një mbulim të mirë deri shumë të mirë me këtë shërbim. Megjithatë, siç sugjerohet dhe në seksionin e rekomandimeve të planit, parashikohet përmirësimi i cilësisë fizike të shkollave dhe kopshteve (kryesisht në Njësitë Administrative) dhe zgjerimi i oborreve të shkollave dhe kopshteve të cilat nuk përmbushin standardet e Rregullores së Planifikimit. Nevojiten shtimi i disa shkollave të mesme, 9-vjecare e kopshteve në fshatrat periferikë të njësive Libofshë, Cakran e Frakull, si dhe kryesisht në lagjet Afrim i Ri, Afrim e Sheq i Madh në Fier.

Kategoria Bazë Shëndetësi (SH): Plani nuk parashikon shtim njësish shëndetësore, duke qenë se numri i tyre është në përputhje me standardet për secilën Njësi Administrative, si dhe për qendrën e Fierit.

Ndërkaq, ndërhyrja më e madhe në sektorin e Shëndetësisë, është ndërtimi i spitalit rajonal të Fierit, i cili do t'i shërbejë gjithë rajonit të Jugut.

Kategoria Bazë Infrastrukturë (IN): Edhe në këtë rast, sikurse në rastin e kategorisë bazë banim, sipërfaqet e propozuara të përdorimit të tokës pritet të rriten. Kjo kategori përfshin të gjitha zgjerimet e mundshme në rrjetin rrugor të mundshëm përfshi këtu dhe hapjen e akseve të reja për të akomoduar parkimin publik, apo rritje e

mundshme si pasojë e parashikimit të ndërtimit të akseve të reja infrastrukturore të cilat shoqërohen me konvertime (shpesh të pjesshme) të sipërfaqes bujqësore.

Plani i përgjithshëm vendor parashikon dhe gjithashtu shtim të kësaj kategorie me qëllim akomodimin e Impiantit të trajtimit të Ujërave të zeza, në veri të qytetit të Fierit, ndërtimin e landfill-it të ri dhe inceneratorit në afërsi të Mbrostarit (për t'u vendosur), zonën e stacioneve të kompresimit të linjës së gazsjellësit në afërsi të fshatit Seman, zonën e stacionit multimodal në zgjerim të stacionit ekzistues në Fier etj.

Po ashtu këto struktura do të rriten për të sistemuar struktura të tjera të nevojshme të rrjeteve të shpërndarjes elektrike dhe telekomunikacionit, sipas planeve që do të hartohen nga palët përgjegjëse, në koordinim të plotë me parashikimet e këtij plani.

Figura 218. Përdorimi i propozuar i tokës, sipas kategorive bazë



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Tabela 113. Sistemet e territorit dhe treguesit përkatës

Sistemet	**Treguesit**	**Vlera**
Sistemi urban	1. Sipërfaqja e përgjithshme (ha ose km2)	7653 Ha
	2. Gjatësia e sistemit rrugor m/banor	17.59 metra/banor
	3. Popullsia ekzistuese dhe e parashikuar	Popullsia ekzistuese: 122475 (Instat) / 194167 (GJC) Popullsia e pritshme: 103277 (Instat) / 216061 (GJC)

	4. Njësi banimi të parashikuara	55 000, nga të cilat 48 704 janë ekzistuese
	5. Njësi banimi të mundshme për strehim social	670 njësi
	6. Njësi shëndetësore	68 njësi (spitale, qendra shëndetësore, poliklinika, ambulanca)
	7. Njësi të arsimit 9-vjeçar	89 njësi (publike/private; cikël fillor/9-vjeçar, nga të cilat 8 janë të propozuara)
	8. Njësi të arsimit të mesëm	26 njësi (publike/private; të përgjithshme/profesionale, nga të cilat 4 janë të propozuara)
	9. Nr. i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	transport rrethqytetas: 7 linja ekzistuese dhe 7 të propozuara transport urban: 4 linja
	10. Nr. i njësive strukturore	956
	11. Sipërfaqe e gjelbër m2/banor	39m2/banor (në zonën urbane)
	12. Sipërfaqe e hapur publike m2/banor (përfshirë sportive)	4550m2/banor (përfshirë gjithë territorin e bashkisë)
	13. Sipërfaqe trashëgimi kulturore (ha)	385 Ha
	14. Tregues ekonomikë	Zonë industriale: 1200 Ha Zonë shërbimesh: 350 Ha
	15. Sipërfaqe pronash publike (ha) dhe % ndaj sipërfaqes së përgjithshme	342 Ha prona publike që i përkasin sistemit urban (0.8% e sip. së bashkisë) 420 Ha prona publike të sistemit urban gjithsej, në përputhje me propozimin
	16. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m2 ose ha)	0 Ha
	17. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m2 ose ha)	0 Ha
	18. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m2 ose ha)	42 Ha për rrugë të reja dhe 32 Ha për zgjerim rrugësh ekzistuese
	19. Shërbime Administrative (bashki, gjykata, agjenci të ndryshme)	26 Institucione publike (të qeverisjes qëndrore dhe vendore (Sn=16900 m2)
	20. Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare	12 Institucione fetare (14400 m2)
	21. Intensitet për Ha	0.106 Ha/Ha
Sistemi bujqësor	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha)	39651.70 Ha
	2. Sipërfaqe kryesore (Boniteti I-IV) në ha	30921 Ha
	3. Sipërfaqe dytësore (Boniteti V-X) në ha	8730 Ha
	4. Sipërfaqe ose gjatësi e sistemit të ujitjes dhe vaditjes sipas 3 kategorive	Kanale parësore: 322.2 km Kanale dytësore: 449 km Kanale tretësore: 67.4 km
	5. Sipërfaqe tokë pa fryt (ha)	543 Ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m2 ose ha)	980 Ha
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m2 ose ha)	67 Ha konvertim tokë bujqësore në park urban 182 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë shërbimesh e banimi 95 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë ekonomike 72 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë Resortesh turistike Konvertimet e tjera bëhen rast pas rasti e nuk janë të llogaritshme në këtë fazë
	8. Sipërfaqe që konvertohet në	124 Ha për rrugë të reja dhe 54 Ha për

	infrastrukturore (m2 ose ha)	zgjerim rrugësh ekzistuese
Sistemi ujor	1. Sipërfaqe ujore (km2)	1255.90187
	2. Gjatësia e lumenjve kryesorë (km)	Seman: 49,15 km Vjosë: 53.22 km Gjanicë: 14,99 km
	3. Sipërfaqe akuiferesh sipas llojeve	Akuifer me porozitet ndërkokrrizor e ujëpërcjellshmëri shumë të lartë-të lartë: 12669 Ha Akuifer me porozitet ndërkokrrizor e ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët: 6885 Ha Akuifer me porozitet porocarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët: 11562 Ha Akuifer me porozitet porocarje dhe ujëpërcjellshmëri të ulët-shumë të ulët: 2550 Ha Jo akuifer: 32334 Ha
	4. Gjatësia e vijës bregdetare (km)	36 km
	5. Sipërfaqe që konvertohen, nëse është rasti	0 Ha
Sistemi infrastrukturor	1. Sipërfaqe ose gjatësi rrugësh sipas kategorive të kodit rrugor	140.8 km /172 Ha të shtuara të reja 425.8 km / 365 Ha të ristrukturuara dhe zgjeruara 3660 km / 452 Ha ekzistuese (perfshire rruget e brendshme te lagjeve dhe ato bujqesore) Rrjeti kryesor rrugor kategorizuar sipas kodit rrugor: A.Autostrada : 36.7 km linear B.Rrugë interurbane kryesore : 34.8 km linear C.Rrugë interurbane dytësore : 234.7 km linear D.Rrugë urbane kryesore : 38 km linear E.Rrugë urbane dytësore : 45.9 km linear F.Rrugë lokale: 236.5 km linear
	2. Gjatësia e hekurudhës (km)	46.89 km
	3. Nr. portesh	1
	4. Nr. aeroportesh	0
	5. Njësi energjitike (nr. ose sipërfaqe ose gjatësi)	5.48 Ha njësi energjitike dhe 25 km linjë gazsjellësi
	6. Landfill/ Incinerator/ Zonë për kompostim (nr. ose ha)	Landfill/Incenerator: 15.4 Ha
	7. Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura (nr. ose ha)	Impiant trajtimi: 20 Ha
	8. Sipërfaqe ose gjatësi që konvertohet në një sistem tjetër (specifiko, nëse rasti)	0 Ha
Sistemi natyror	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha ose km2)	16275.56
	2. Sipërfaqe pyjore (ha)	1944 Ha
	3. Sipërfaqe kullota (ha)	1341 Ha
	4. Sipërfaqe të matricës natyrore sipas llojeve (ha)	Korridor lidhës: 11051 Ha Matricë: 5111 Ha Mozaik: 3672 Ha Ngastër: 2601 Ha Parcela të ndara: 6807 Ha Parcela të lidhura: 2613 Ha

		Pyll mbrojtës: 447 Ha Pyll produktiv: 1682 Ha
	5. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm (nr dhe ha)	5 monumente natyrore 2 Rezervate të menaxhuara /Park natyror : 1431 Ha (së bashku me propozimet e këtij Plani) 1 Park Kombëtar: 1645 Ha 1 Park natyror rajonal : 400 Ha
	6. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	0 Ha (Nuk ka propozime për konvertim nga fondi pyjor publik në përdorim bujqësor. Konvertimet e mundshme nga fondi pyjor privat bëhen rast pas rasti, vetëm për pemëtari/ullishte)
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	37 Ha Konvertimet e tjera bëhen rast pas rasti e nuk janë të llogaritshme në këtë fazë
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	8 Ha për rrugë të reja dhe 4.5 Ha për zgjerim të rrugëve ekzistuese

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Figura 219 Sistemet e propozuara territoriale



Burimi: PLGP/USAID, Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

2.1.3 Nyjet kryesore të infrastrukturave dhe hapësirave publike

Ky seksion trajton ndërhyrjet kryesore sa i takon infrastrukturave publike, hapësirës publike dhe gjelbërimit. Studimi i pranisë së hapësirave rekreative të tipit gjelbërim publik sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit[448], është kryer në nivel qyteti. Kjo për shkak të tipologjisë predominuese të vilave, me oborr të jashtëm, ose të llojit kopësht, në vendbanimet e njësive administrative rurale. Nevoja për hapësira publike në zonat rurale është përmbushur nëpërmjet caktimit të vlerave të Kshp, në varësi të

pozicionit dhe qendërsisë së zonës, përcaktimit të zonave park natyror, zonave ripariane, gjelbërimit rrugor përgjatë rrugëve të reja të propozuara, etj.

Tabela 114. Bilanci i gjelbërimit publik, qyteti i Fierit

Zona e gjelbër	Standardi	Vlera ekzistuese			Vlera e propozuar		
	m^2/banor	**ha**	**m^2/banor (INSTAT)**	**m^2/banor (GJC)**	**ha**	**m^2/banor (INSTAT)**	**m^2/banor (GJC)**
a) Gjelbërim në nivel njësie strukturore	**2.5** m^2/banor	10.4	1.83	2.73	39	8.16	9.36
b) Gjelbërim masiv parqe e lulishte	**4** m^2/banor	3.4	0.60	0.89	110	23.01	26.41
c) Gjelbërim rrugor , sheshe, brigje ujore në zonë urbane	**2.5** m^2/banor	9.84	1.74	2.59	14.3	2.99	3.43
		32.7	5.77	8.60	0	0.00	0.00
ç) a&b&c	**9** m^2/banor	56.34	9.94	14.81	163.3	34.16	39.20
d) Park periferik	**17** m^2/banor	109	19.23	28.66	180	37.66	43.21
dh) ç&d: Gjelbërim i përgjithshëm publik	**26** m^2/banor	**165.34**	**29.17**	**43.47**	**343.3**	**71.82**	**82.41**
e) Fidanishte	PA	0	0.00	0.00	10	2.09	2.40
ë) Zonë ripariane	PA	1018	179.58	267.63	1460	305.43	350.47
f) Kopësht zoologjik	PA	0	0.00	0.00	0	0.00	0.00
g) Kopësht botanik	PA	0	0.00	0.00	10	2.09	2.40
gj) Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	PA	13853	2443.77	3641.98	23943	5008.89	5747.52
h) Pyje (pyllëzim)	PA	1898	334.82	498.99	70	14.64	16.80
i) Zona të mbrojtura natyrore	PA	25440	4487.80	6688.22	28483	5958.75	6837.44
e-i) Gjelbërim i veçantë	PA	**42209**	**7445.98**	**11097**	**43976**	**9200**	**10556**

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Situata e gjelbërimit në qytetin e Fierit paraqitet relativisht e mirë, duke qëndruar brenda standardeve për pjesën më të madhe të komponentëve të gjelbërimit (gjelbërim në nivel njësie, gjelbërim rrugor e në sheshe, gjelbërim i tipit park urban, gjelbërim periferik) etj. Gjithsesi, në pjesën më të madhe sipërfaqet e gjelbëra paraqiten të patrajtuara, nuk janë të përdorshme, dhe nuk i shërbejnë funksionit peizazhistik apo rekreativ. Në vazhdim bëhet një përshkrim i shkurtër i secilit komponent, metodologjisë së përdorur për matjen e tyre, si dhe standardi i realizuar, duke marrë në konsideratë popullsinë ekzistuese të qytetit të Fierit, për situatën ekzistuese, dhe parashikimin demografik për vitin 2031 për sistemin e propozuar të gjelbërimit. Shifrat e popullsisë ekzistuese dhe të projektuar reflektojnë vlerat e INSTAT-it dhe Gjendjes Civile, si dhe metodologjitë përkatëse të llogaritjes, të shpjeguara në seksionin 2.1.5.

- **Gjelbërimi në nivel njësie strukturore**

Ky komponent i gjelbërimit përfshin gjithë zonat e gjelbërta, hapësira publike, lulishte, kënde lojërash etj. që ndodhen brenda njësive strukturore, e që u shërbejnë vetëm përdoruesve të këtyre njësive. Vlera e tij është llogaritur duke konsideruar sipërfaqen aktuale të përdorimit publik në qytet, duke i hequr asaj sipërfaqet e përdorimeve Institucion, Shëndetësi, Arsim etj, me supozimin se 20% e këtyre hapësirave publike i

përkasin gjelbërimit publik. Vlerat ekzistuese të Kshp-së për zonën urbane të Fierit rezultojnë të ulëta, mesatarisht 7.3%, por duke ndryshuar nga 0% në 97% (në zonat e varrezave, apo njësitë strukturore me përdorime të tjera tërësisht publike) dhe me vlera më të përhapura në Kshp-të ekzistuese lëvizin mes 5 dhe 10%. Në tërësi, sipërfaqja e gjelbër në nivel zone, e llogaritur mbi bazë të këtyre vlerave të Kshp-së, është rreth 10,41 ha, në kufi të standardit 2.5m^2/banor.

Figura 220. Sistemi i gjelbërimit, nivel qyteti.



Burimi: Co-PLAN dhe Bashkia Fier, 2016

- **Gjelbërim masiv në parqe e lulishte**

Qyteti i Fierit ka aktualisht 4 lulishte, respektivisht lulishten e Bashkisë, 2 lulishte në afërsi të xhamisë dhe 1 pranë bar "Rinisë". Këto hapësira përbëjnë një sipërfaqe prej 3.24 ha. Ky komponent është më i rëndësishmi sa i takon gjelbërimit në qytet, pasi përfshin zonat publike të përdorshme masivisht për funksion rekreativ dhe çlodhës, si dhe i shërben biodiversitetit lokal. Nga standardi i caktuar prej 4 m^2 për banorë[449], aktualisht realizohen vetëm 0.6-0.8m^2, gjë që tregon për nevoja urgjente në ndërtimin e parqeve urbane dhe lulishteve për qytetin e Fierit.

- **Gjelbërimi rrugor, në sheshe, përgjatë lumenjve**

Gjelbërimi rrugor shtrihet përgjatë 33 akseve ose segmenteve të veçanta rrugore, në një gjatësi lineare prej 32.8 km. Kjo konvertohet në një kontribut prej rreth 9.84 ha (nëse konsiderohet mesatarisht kurora e bimësisë 3 m e gjerë). Sa i takon gjelbërimit nëpër brigje ujore, jo park, ai gjendet në një sipërfaqe prej rreth 32.69 ha përgjatë Gjanicës. Duke marrë në konsideratë vetëm gjelbërimin rrugor, duket se ai pothuajse realizon standardin e përcakuar në Rregulloren e Planifikimit (2.5m^2/banor). Gjithsesi pjesa më e madhe e bimësisë është ende e re, e pazhvilluar dhe nuk ka arritur ende fazën optimale të hijëzimit rrugor. Ndërkaq, kontribuesi kryesor në këtë lloj gjelbërimi është zona përgjatë lumit Gjanica, e cila është lënë në trajtë natyrore, të patrajtuar dhe pa akses publik përgjatë saj.

- **Gjelbërimi i llojit park periferik**

Në funksion të qytetit të Fierit, si dhe zonave përreth, veçanërisht njësive administrative Levan, Topojë, Frakull, Dërmenas, Qendër, si park periferik funksionon Parku i Levanit, cili është shpallur zonë e mbrojtur e Kategorisë IV (Rezervat Natyror)[450]. Sipërfaqja aktuale e parkut është rreth 109 ha (bazuar në dixhitalizimin e hartës bazë), ndërkaq sipërfaqja e deklaruar si zonë e mbrojtur arrin 200 ha. Ky park ka vlera të larta peizazhistike dhe ndihmon në funksionet kryesore të ekosistemeve të zones, si dhe në mbrojtjen e biodiversitetit lokal. Fakti që ka akses të mirë nga rruga "Aulona" e bën atë park të aksesueshëm, me vlera rekreative dhe çlodhëse për gjithë bashkinë. Sipërfaqja aktuale e parkut i përmbush nevojat e banorëve të Fierit dhe zonave përreth për gjelbërim të parkut periferik, duke realizuar tregues 19-28 m^2/banor, të pranueshëm në raport me standardin 17 m^2/banor.

Komponentët e mësipërm përbëjnë gjelbërimin e përgjithshëm publik, si në nivel qyteti, ashtu edhe periferik, për zonat urbane. Rezulton se qyteti i Fierit, pavarësisht dendësisë së lartë të ndërtimit, ka akses të mirë në katër llojet e gjelbërimit dhe plotëson standardet për to, veçanërisht për parkun periferik dhe gjelbërimin krahë lumenjve. Propozimet mbi gjelbërimin në qytet marrin parasysh këto nevoja:

-Shtimin e sipërfaqeve të përdorimit publik në nivel njësie strukturore;

-Shtimin e një zone të dedikuar të tipit park urban, me funksion rekreativ dhe akses të lehtë nga qyteti;

-Shtimin e gjelbërimit rrugor përgjatë gjithë akseve të reja të propozuara.

- **Lloje të tjera gjelbërimi**

Krahas gjelbërimit të përgjithshëm publik, i cili është i standardizuar, në territorin e bashkisë ka edhe zona të tjera të gjelbëra, publike, të cilat kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit, por nuk kanë si funksion parësor atë rekreativ.

- Zonat ripariane përgjatë lumenjve Seman e Vjosë, si dhe segmentit të Gjanicës që nuk përfshihet në gjelbërimin e përgjithshëm publik, përbëjnë një sipërfaqe prej 1018 ha. Kjo sipërfaqe i shërben popullsisë së bashkisë, me tregues 52-83 m^2/banor.

- Zonat e mbrojtura zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 23,578 ha, duke përfshirë Pyllin e Levanit, Pishë-Poron, Kurorën e Adriatikut. Nëse konsiderohet edhe kufiri i zonës së mbrojtur të Parkut të Divjakës (1,862 ha), kjo sipërfaqe arrin 25,440 Ha, pra rreth 4,500-6,500 m2/banor në nivel qyteti (ose, në nivel bashkie, 1,300-2,000 m^2/banor)

- Në zonat buferike është përfshirë brezi mbrojtës ndaj autostradës (60 m), brezi i dytë mbrojtës i TAP (40 m), brezat sanitarë përreth zonave industriale (50 m), zonat sanitare të varrezave (50 m), zonat buferike përreth zonave të mbrojtura (50 m), si dhe brezi mbrojtës i hekurudhës (25 m)[451]. Pavarësisht gjendjes aktuale të këtyre zonave mbrojtëse, ku mund të mungojë pyllëzimi, mund të jenë të pavazhdueshme, të zëna me ndërtime etj, këto zona janë marrë të mirëqena dhe përbëjnë një sipërfaqe potenciale pyllëzimi prej 97-150 m^2/banor.

- Pyjet në bashkinë Fier përbëjnë një fond[452] prej 4,140 ha, nga të cilat 1,898 ha janë fond pyjor publik, pra i aksesueshëm nga gjithë bashkia. Zona pyjore është e përhapur veçanërisht në njësitë Libofshë, Levan, Frakull e Cakran. Në nivel treguesish, ky fond shpërndahet në 97-154 m2/banor.

Tabela 115. Treguesit e gjelbërimit të veçantë, në nivel bashkie.

	Gjendja ekzistuese			Propozim		
	ha	**m^2/banor (INSTAT)**	**m^2/banor (GJC)**	**ha**	**m^2/banor (INSTAT)**	**m^2/banor (GJC)**
e) Fidanishte	0	0.00	0.00	10	0.97	0.46
ë) Zonë ripariane	1018	83.12	52.43	1460	141.37	67.58
f) Kopësht zoologjik	0	0.00	0.00	0	0.00	0.00
g) Kopësht botanik	0	0.00	0.00	10	0.97	0.46
gj) Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	13853	1131.09	713.46	23943	2318.33	1108.24
h) Pyje (pyllëzim)	1898	154.97	97.75	70	6.78	3.24
i) Zona të mbrojtura natyrore	25440	2077.16	1310.21	28483.4	2757.96	1318.40
e-i) Gjelbërim i veçantë	**42209**	**3446.336**	**2173.85**	**43976.4**	**4258.102**	**2035.52038**

Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Propozime mbi gjelbërimin në nivel njësie strukturore**

Në nivel njësie strukturore, gjelbërimi i brendshëm është integruar me propozimet për Kshp-në, të cilat në qytetin e Fierit variojnë 5%-60%, me vlerë më të përhapur 10-15% (dhe vlerë mesatare 13%) ndërsa në vendbanimet e tjera 0-20%. Për qytetin, kjo përbën një sipërfaqe prej rreth 195 ha, nga të cilët mund të supozojmë se minimalisht 20% janë gjelbërim i brendshëm lagjeje, kënde lojërash, lulishte gjysëm-publike etj, me një sipërfaqe mesatare prej 39 ha.

Propozime mbi gjelbërimin masiv të parqeve dhe lulishteve: Sa i takon parqeve dhe gjelbërimit masiv, tre janë ndërhyrjet kryesore që propozohen në nivel qyteti, dhe me impakt më të gjerë:

- Krijimi i parkut të ri urban në zonën e Mbrostarit, në sipërfaqet e tokës bujqësore që përmbytet vazhdimisht nga prurjet e Semanit. Sipërfaqja e

caktuar në dispozicion të zones është 67 ha, por mund të variojë në kohë dhe sipërfaqe reale parku, në varësi të dinamikave të procesit të shpronësimit.

- Ndërtimi i lulishtes në afërsi të xhamisë, në rrugën "Jakov Mile", në një sipërfaqe prej rreth 8,500 m2.

- Krijimi i parkut urban të Gjanicës, në segmentin nga ura në Unazën 3 në jug, në grykderdhjen në Seman në veri. Ky park do ketë një sipërfaqe të përgjithshme prej 41 ha, duke përfshirë një zonë mbrojtëse 20 metra në dy anët e lumit, si dhe zona të tjera të lira natyrore. Parku do jetë i aksesueshëm dhe përgjatë tij do ketë kalime këmbësore dhe automobilistike dhe 17 ura respektive, si dhe bimësi mikse të llojit të rrapit, plepit, pishës së butë, shelgut etj.

Duke realizuar këto investime, qytetit të Fierit, por edhe zonave përreth (sidomos NjA-në Mbrostar) do i shtohet një fond gjelbërimi publik prej 110 ha, duke realizuar një tregues gjelbërimi prej 23-26 m^2/banor, shumë më të lartë se standardi 4 m^2/banor.

Propozime mbi gjelbërimin rrugor: Në gjithë rrugët e reja të propozuara në qytet, si në Yjësinë e Fierit, në radialet urbane, në 3 Unazat, akset panoramike, lidhëset kryesore e dytësore urbane etj, propozohet shoqërimi me gjelbërim rrugor, në përputhje me vlerat e përcaktuara të gjerësisë së trotuarit dhe rrugës. Për qytetin e Fierit, këto segmente rrugore përbëjnë gjithsej një gjatësi prej 47,950 metrash, të barasvlefshme me rreth 14.3 ha gjelbërim rrugor, pra rreth 3 m^2/banor. Gjelbërimi përgjatë Gjanicës në këtë rast është llogaritur si pjesë e Parkut urban të Gjanicës.

Propozime mbi Parqet periferike: Si park periferik për qytetin e Fierit, në aspekt aksesueshmërie dhe distance të ulët, shërben më së miri Pylli i Levanit. Propozohet të bëhet një zgjerim i tij, me rreth 70 ha në zonën jugore. Kjo e rrit standardin e gjelbërimit në rreth 40 m^2/banor.

Sa i takon njësive të tjera administrative, nevojat për parqe përmbushen duke konsideruar zonat e mbrojtura të propozuara, të kategorizuara më poshtë, si lloje të veçanta gjelbërimi.

Propozime mbi llojet e veçanta të gjelbërimit: Bashkia Fier ka një rrjet natyror të pasur, si nga pikëpamja e biodiversitetit, ashtu edhe e vlerës, duke marrë parasysh sipërfaqet e mbrojtura ekzistuese. Në funksion të lidhjes më të mirë të këtyre elementeve, si dhe zhvillimit turistiko-rekreativ të integruar me mbrojtjen e potencialeve natyrore, janë propozuar këto ndërhyrje në sistemin e gjelbërimit në bashki:

- Krijimi i një zone fidanishtesh, në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit lokal dhe në shërbim të kërkimit shkencor në fushë. Kjo zonë do ketë përmasa 10 ha dhe do shtrihet në tokën në afërsi të shkollës së mesme bujqësore "Rakip Kryeziu".

- Krijimi i një kopshti botanik për të mbrojtur fondin gjenetik të bimëve halofite dhe hidrofite, me interes kultivimi në zonën bregdetare apo breglumore në bashki. Vendndodhja e këtij kopshti mund t'i bashkangjitet fidanishtes së propozuar në afërsi

të shkollës “Rakip Kryeziu”, ose të jetë pjesë e Parkut Urban të Mbrostarit, në një sipërfaqe prej rreth 10 ha.

- Rehabilitimi i zonave ripariane të Semanit, Vjosës dhe shtratit natyror të Gjanicës, në një sipërfaqe totale prej 1,460 Ha. Kjo zonë i shtohet fondit natyror të pyllëzuar, dhe varion nga 20 metra gjerësi, si brez minimal i mbrojtjes së trupave ujorë, në 1,300 metra, në zonat ku shtrati pëson meandrime të shpeshta.

Figura 221. Sistemi i propozuar i gjelbërimit publik në nivel bashkie.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Brezat sanitarë kërkohet të ripyllëzohen dhe rehabilitohen, si dhe të shtohen brezat përkatës për ndërhyrjet e tjera madhore në territor, si zonat ekonomike të TAP-it, zona e landfillit dhe inceneratorit, impianti i trajtimit të ujërave të zeza, zonat buferike të zonave të reja të propozuara në mbrojtje etj. Në total këto zona arrijnë një sipërfaqe prej 23,943 m^2, ose 1,100-2,000 m^2/banor.

Zonave të mbrojtura natyrore u shtohen propozimet për Park Natyror në Pyllin e Cakranit, zgjerimi i Pyllit të Levanit me 70 ha në pjesën jugore, si dhe Zona e bregdetit nga Pishë-Poro në grykëderdhjen e Semanit, me kufizim kanalin kullues paralel të bregdetit. Këto zona përbëjnë një sipërfaqe totale prej 3,043 Ha, duke shtuar me 12% sipërfaqen aktuale, deri në 1,500-2,500 m^2/banor.

Së fundi, pyllëzimet e reja përfshijnë rehabilitimin e zonave të mbrojtura ekzistuese dhe të propozuara, zonat ripariane, si dhe zgjerimin e zones së Pyllit të Levanit, të trajtuara në pikat më sipër. Përveç tyre parashikohet edhe krijimi i një brezi të gjelbër përgjatë kanaleve kryesore kulluese e vaditëse (Vijës së Ngjalës dhe Kanalit të Hoxharës), me funksion korridori peizazhistik, për mbërthimin e nitrateve e fosfateve nga toka bujqësore, e shmangien e ndotjes së akuiferëve.

Në total, në bashkinë Fier propozohet një tregues i gjelbërimit të veçantë prej 2,500-5,000 m^2/banor, dhe në nivel qyteti projektohet një tregues i gjelbërimit të përgjithshëm publik prej 71-82 m^2/banor, 2-3 herë më i lartë se standardi 26 m^2/banor.

2.1.4 Njësitë strukturore të territorit

Ndarja në zona në Bashkinë Fier, është bërë duke ruajtur kufijtë e Njësive Administrative, ku secila nga këto njësi administrative është cilësuar një zonë më vete

Zona 1 – Fier
Zona 2 – Cakran
Zona 3 – Dërmenas
Zona 4 – Frakull
Zona 5 – Levan
Zona 6 – Libofshë
Zona 7 – Mbrostar
Zona 8 – Portëz
Zona 9 – Qendër
Zona 10 – Topojë

Secila nga zonat e mësipërme është ndarë në njësi më të vogla të territorit, njësi strukturore, ndarja e të cilave ka për qëllim lehtësimin e procedurave të zbatimit të instrumenteve të planifikimit, si dhe të kontrollit të zhvillimit. Metodologjia për ndarjen e njësive strukturore bazohet në përcaktimet ligjore të VKM-së nr. 671, duke siguruar plotësimin e njërit apo disa prej kushteve të mëposhtme:

a. Kufizimin nga rrjeti rrugor ekzistues, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve dhe sipas rastit kufizimin nga linja hekurudhore, kanalet kulluese dhe vaditëse, përrenjtë dhe vija të tjera ujore;
b. Njësia strukturore garanton kompaktësimin dhe njëtrajtshmërinë e tipologjisë hapësinore ekzistuese dhe duke patur parasysh dhe atë të propozuar;
c. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
d. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, duke u bazuar në kategoritë e njëjta të përdorimit të tokës, përfshi këtu dhe funksionet apo aktivitetet homogjene;
e. Ekzistencën e vlerave të rëndësishme të trashëgimisë kulturore si në rastin e njësisë strukturore të Apollonisë
f. Kufij të tjerë natyrorë (kryesisht në njësitë strukturore natyrore) si shpatet e kodrave, ndryshimet e vegjetacionit etj;
g. Përcaktimin e zonave me prioritet zhvillimi për realizimin e një projekti me rëndësi.

Bazuar në sa më sipër, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fier, e ndan territorin në 1,467 Njësi strukturore, për të cilat janë përcaktuar kushtet dhe rregullat e zhvillimit në Rregulloren e Planifikimit, si pjesë e Instrumenteve të Përgjithshme Vendore. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe përcaktimi i zonave të cilat do të zhvillohen përmes Planeve të Detajuara Vendore (PDV). Për zhvillim me anë të PDV-ve janë përcaktuar ato njësi të cilat përmbushin të paktën njëri prej kritereve më poshtë:

a. Prekin njësi me zhvillim intensiv, në presion zhvillimi, zona të reja të pazhvilluara
b. Prekin njësi të degraduara në sistemin urban për të cilat parashikohet zbatimi i programit të rigjenerimit
c. Prekin zona ku parashikohet ndryshimi i përdorimit të lejuar të tokës
d. Prekin zona të cilat shfaqin nevojën emergjente të rikonceptimit të hapësirave në të, përfshi këtu nevojën për zgjerim të infrastrukturave të cilat shoqërohen me kthimin e sipërfaqeve të tokës nga private në publike dhe riparcelizimin përmes instrumenteve financiarë inovativ.

Llojet e ndërhyrjeve për njësi strukturore, zona të llojeve të ndryshme, infrastruktura, zona historike/ kulturore/ arkeologjike, dhe zona bujqësore e me vlera natyrore/mjedisore.

1. **Zhvillim** (*Development*): Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturat përkatëse. Në raste të veçanta, zhvillimi mund të përfshijë vetëm programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu zhvilluesit për ndërtime private. Zhvillimi ka efekt në ndryshimin e çmimit të tokës dhe përgjithësisht e ngre atë.

2. **Rizhvillim** (*Redevelopment*): Është zhvillim që kryhet përsëri në një zonë e cila është zhvilluar më parë. Është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese, si të formës e strukturës, ashtu edhe funksioneve dhe/ose treguesve të zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).

3. **Rikonceptim**: Është një formë e rizhvillimit, por e fokusuar kryesisht në elemente të dizajnit urban e arkitektonik të objekteve dhe rimendim të funksioneve të objekteve ekzistuese, duke i përshtatur ato. Mund të përfshijë edhe prishje objektesh në raste të caktuara, me qëllim çlirimin e hapësirës publike, por nuk nënkupton ndërtime të reja. Veçanërisht treguesit e rrugëve dhe të hapësirës publike mund të përmirësohen. Intensiteti mund të rritet lehtësisht në ndonjë rast, si rezultat i shtesave të mundshme në lartësi, ose të mbetet i pandryshuar..

4. **Ristrukturim** (*Restructuring, Reconstruction*): Ndodh për infrastrukturat, kur janë të degraduara, dëmtuara ose shumë të vjetëruara dhe riparimi nuk është i mjaftueshëm. Veç ndërhyrjeve strukturore, mund të ndryshohen edhe parametrat e infrastrukturës në fjalë. P.sh. rruga mund të zgjerohet dhe të pajiset me elemente sigurie shtesë, etj. Elementet e rrjetit të furnizimit me ujë apo të largimit të ujërave të ndotura mund të zëvendësohen dhe të ripërmasohen, si dhe i gjithë sistemi mund të zgjerohet/intensifikohet në pjesë të caktuara të tij. Kjo mënyrë ndërhyrjeje mund të përdoret për rrugët në

veçanti, por edhe për zona që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën e tyre.

5. **Rigjenerim, Rinovim, Rijetësim, Ripërtëritje, Rivitalizim, Rikualifikim** (*Regeneration, Renewal, Revitalization, Requalification*): Është një formë rizhvillimi që ka për qëllim të risjellë në jetë apo funksion zona të caktuara të cilat e kanë humbur atë, janë degraduar fizikisht, nuk janë më tërheqëse dhe të frekuentuara, paraqesin mungesë sigurie, kanë rënie të vlerës së pronës dhe kanë nevojë për rikonceptim nga pikëpamja e dizajnit urban, arkitekturor dhe të peizazhit urban. Zona të tilla mund të jenë aktualisht në funksion, por jo cilësore dhe të vjetëruara, ose mund të jenë jashtë funksionit (si *greyfields* në qytete – p.sh. parkime apo qendra tregtare të braktisura dhe me infrastrukturë ekzistuese etj.). *Brownfields*, si zona industriale të braktisura apo jashtë funksionit dhe me ndotje, trajtohen përmes rehabilitimit mjedisor (si më poshtë), por paralelisht edhe me rigjenerim urban, duke pasur për qëllim rifutjen e tyre në treg dhe veprimtari të rritjes ekonomike.

6. **Rehabilitim** (*Rehabilitation*): Rehabilitimi mjedisor është rindërtimi i elementeve, apo funksioneve ekologjike, pa realizuar restaurimin e plotë, kryesisht për qëllime njerëzore dhe jo natyrore. Mund të përfshijë një ose disa nga format e mëposhtme si: restaurim mjedisor, rikrijime të pjesshme, reklamim dhe pastrim, zbutje efektesh ndotëse/negative etj. Është i barazvlefshëm me konceptin rigjenerim në rrafshin urban.

7. **Konsolidim, Kompaktësim** (*Consolidation*): Është një proces zhvillimi dhe rizhvillimi në të cilin konsolidohet karakteri dhe tipologjia ekzistuese e zonës (urbane ose bujqësore) dhe për këtë kryhen punime ndërtimi, rindërtimi, ristrukturimi, rigjenerimi pjesor, mbushjeje urbane, konservimi, pastrimi. Këto punime kombinohen në pesha të ndryshme.

8. **Ngrirje** (*Development Freeze*): Është procesi i ngrirjes ose ndalimit dhe bllokimit të ndërhyrjeve zhvillimore të çdo forme në një territor të caktuar, deri në marrjen e një mase të dytë më të përshtatshme për situatën përkatëse. Kryhet në pamundësi të marrjes së masës së duhur, si rezultat i mungesës së informacionit, boshllëkut ligjor e institucional, ekzistencës së konflikteve të pazgjidhshme brenda periudhës së vendimmarrjes, proceseve të pambyllura gjyqësore, rreziqeve që mund të kanosen, të qenurit në pritje të një vendimmarrjeje tjetër, apo arsye të tjera penguese. Në varësi të rastit, autoritetet mund të marrin masa mbrojtëse, pyllëzuese, zbutëse të rrezikut, të garantimit të mbijetesës etj. nëse popullsia apo pronat në zonë janë të rrezikuara nga ndonjë faktor specifik.

9. **Dendësim** (*Densification*): Kjo ndërhyrje propozon rritjen e dendësisë së zhvillimit të zonave urbane me dendësi të ulët, duke promovuar përdorimin më efiçent të tokës, si dhe të rrjeteve të shërbimeve dhe infrastrukturave. Dendësimi ka dy nënraste si më poshtë. Nëse të dyja nënrastet janë prezente në një zonë, atëherë përdoret thjesht termi "dendësim".

    a. **Mbushje Urbane** (*Urban Infill*): Kjo është një formë e dendësimit, ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave bosh/të pandërtuara

me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me të parcelave që kanë ndërtime në momentin e mbushjes. Përgjithësisht ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

b. **Intensifikim** (*Intensive development*): Kjo është një formë e dendësimit, ku procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit, si në nivel zone, ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave. Intenstifikimi përfshin edhe proces të mbushjes, por nuk synon të ruajë karakterin dhe tipologjinë ekzistuese në zonë. Ndryshon nga rizhvillimi, pasi nuk synon të ndryshojë funksionin e zonës dhe përgjithësisht përdoret në zona (kryesisht) banimi.

10. **Konservim, Ruajtje** (*Conservation, Preservation*): Është procesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike, nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Procesi i konservimit/ruajtjes nuk nënkupton ngrirje, por shmangie nga aktivitete dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet subjekt i konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligjente e duke shmangur çdo lloj aktiviteti apo ndërhyrjeje dëmtuese/ndotëse. Masat që merren mund të përfshijnë si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim, dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen natyore të tyre, duke u mbrojtur nga ndërhyrje me karakter dëmtues/ndotës. Në rastin e zonave historike mund të përfshihen edhe procese rigjenerimi, pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. **Trajtim peizazhistik** (*Landscaping*): Mund të realizohet në zona urbane, natyrore dhe bujqësore. I shërben funskionit kryesor të zonës, por ka vlerë ekologjike përpos asaj estetike. Në çdo rast, ky trajtim modifikon karakteristikat e dukshme të zonës, si paraqitjen e bimësisë dhe elementeve ujore, formave të tokës dhe trupave ujorë, efektet e motit apo mikroklimës etj. Metodat që përdoren janë: krijim i korridoreve biologjike, ripyllëzime, mbjellje bimësh në një formacion të caktuar, rehabilitim dhe restaurim mjedisor, zbutje ose eleminim i fragmentimit të matricës natyrore ose komponentëve të ekosistemit, rikrijim ose restaurim i zonave ripariane dhe brigjeve ujore në tërësi, kombinime të elementeve bimore me ato ujore dhe historike për të krijuar një mesazh apo atmosferë të caktuar etj.

Tabela 116. Treguesit për zonat makrofunksionale.

Zona (Emër dhe Nr.)	**1_Fier**	**2_Cakran**	**3_Dërmenas**	**4_Frakull**	**5_Levan**	**6_Libofshë**	**7_Mbrostar**	**8_Portëz**	**9_Qendër**	**10_Topojë**
Sipërfaqe (ha)	1314.0	9604.74	6449.36	4276.12	11092.5	12615.8	4157.59	4690.72	2891.06	8963.76
Sipërfaqe banimi (ha)	783.3	693.577	412.49	270.2	332.45	421.4	543.4	364	566	694
Zona ekonomike (ha)	44.05	1.2	0.85	0.4	6.4	3.2	10.2	11.5	4.2	25
Kapaciteti mbajtës (popullsi)	156598	68729	45092	56482	110324	52983	92534	47588	67804	37647
Dendësi sipas kapacitetit mbajtës (banorë/ha)	119.18	7.16	6.9	13.2	9.9	6.82	22.25	10.1	23.32	4.2
Gjelbërim i zonës urbane (m^2/banor)	29.7	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA
Parkimi maksimal i mundur (m^2)	939588	412374	270552	338892	661944	317898	555204	285528	406824	225822
Nr. i njësive strukturore	306	255	114	98	156	127	105	166	72	66
Nr. njësive me PDV	26	0	1	0	1	0	0	0	0	0
Njësi për TDZH	12+12	0	1	0	1	0	0	0	0	0
Njësi për INK	po (42)	jo	po (1)	jo	po (1)	jo	jo	jo	jo	jo
Sistem urban (ha)	926	757	235	422	675	376	526	408	786	564
Njësi banimi	6263	2750	1803	2259	4412	2119	3701	1903	2712	1505
Dendësia njësi banimi/ha	6.76	3.63	7/67	5.35	6.54	5.64	7.04	4.66	3.45	2.67
Hapësira publike (m2)	211943	26818	22956	28766	33227	52415	44065	14984	32792	25003
Sistem bujqësor (ha)	308	4764	5327	6002	8975	7057	6285	6578	3281	9674
Nënkategoritë	Bujqësore e kultivuar (308 Ha)	Bujqësore e kultivuar (4759 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (5 Ha)	Bujqësore e kultivuar (3197 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (2130 ha)	Bujqësore e kultivuar (5701 Ha) Sera (300 Ha)	Bujqësore e kultivuar (4936 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (3141 Ha)	Bujqësore e kultivuar (5292 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (1764 Ha)	Bujqësore e kultivuar (6252 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (30 Ha) Sera (3 Ha)	Bujqësore e kultivuar (5918 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (640 Ha) Sera (20 Ha)	Bujqësore e kultivuar (3117 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (164)	Bujqësore e kultivuar (5320 Ha) Bujqësore jo e kultivuar (4354 Ha)
Nr. i njësive strukturore	20	49	31	11	26	40	22	33	16	15
Sistem ujor lumë (ha)	30.8121	247	0	115	280	440	322	224	121	360
Sistem ujor liqene (ha)	0	0.2435	0	0	1.8	4	0	0	0	0
Sistem infrastrukturor (ha)	111.84	57.75	35	23	75	67	21.6	42	65	43
Sistem natyror (ha)	3.15	3697.385	1013	1562	1459	3782	15.6	25.6	10.2	4032
Nënkategoritë		Pyll i Dendur (3100 Ha) Tokë ranore (500 Ha)	Pyll i Dendur (1013 Ha)	Pyll i Dendur (650 Ha) Pyll i rrallë (437 Ha) Shkurre të përziera (500 Ha)	Pyll i Dendur (1100 Ha) Tokë ranore (350 Ha)	Pyll i Dendur (3782 Ha)	Pyll i rrallë (15.6 Ha)	Pyll i rrallë (25.6 Ha)	Pyll i Dendur (10.2 Ha)	Pyll i Dendur (2340 Ha) Pyll i rrallë (1763 Ha)
Nr. i njësive	1	67	5	10	18	12	1	12	2	5

strukturore										

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Figura 222. Ndarja e njësive strukturore në nivel qyteti



Burimi: Bashkia Fier, PLGP e Co-PLAN, 2016

2.1.5 Parashikimi demografik dhe strehimi

Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshirë ketu edhe studimin e tregut.

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmonë sipas totalit te popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit te rritjes së mesme, duke ndjekur metodologjinë e INSTAT-it. Sipas këtyre te dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Fier, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie te konsiderueshme e cila si mesatare vjetore(përiudha 2015-2031) llogaritet te jetë rreth 1%,

ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet te jetë akoma më e madhe në rreth 15%.

Tabela 117. Popullsia e bashkisë Fier, 2011-2031

	2011	2015	2016	2021	2026	2031
BASHKIA FIER	**126,305**	**122,475**	**119,776**	**114,004**	**108,501**	**103,277**
Fier	58,460	56,687	55,438	52,766	50,219	47,801
Qendër Fier	4,404	4,270	4,176	3,975	3,783	3,601
Libofshë	6,437	6,242	6,104	5,810	5,530	5,263
Topojë	4,445	4,310	4,215	4,012	3,818	3,634
Dërmenas	8,153	7,905	7,731	7,359	7,003	6,666
Mbrostar	7,809	7,573	7,406	7,049	6,709	6,386
Levan	8,541	8,282	8,100	7,709	7,337	6,984
Frakull	7,139	6,923	6,770	6,444	6,133	5,838
Portëz	8,646	8,384	8,199	7,804	7,427	7,069
Cakran	12,271	11,899	11,637	11,076	10,541	10,034
QARKU FIER	**324,864**	**315,012**	**308,070**	**293,223**	**279,070**	**265,633**

Burimi: Instat 2015 dhe llogaritje të autorëve

Parashikimi në rënie i numrit te popullsisë rezidente përgjatë përiudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësite vendore te qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do te vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

Popullsia sipas Gjendjes Civile: Për të patur një pasqyrë më të saktë të situatës ekzistuese të popullsisë, në llogaritjen e projeksioneve për vitin 2031 janë marrë në konsideratë edhe vlerat e paraqitura në Regjistrin e Gjendjes Civile, në periudhën 2010-2015. Këto vlera, për Bashkinë Fier paraqiten si më poshtë:

Tabela 118. Popullsia e bashkisë Fier në periudhën 2010-2015.

Viti	F	M	TOTAL
2010*	86568	74870	161438
2011	93865	99175	193040
2012	94018	99222	193240
2013	94788	100014	194802
2014	95757	101194	196951
2015	94953	99214	194167

Shënim: Viti 2010 nuk ka të dhëna për popullsinë mbi 80 vjeç, prandaj nuk është marrë në konsideratë për projeksionin. Burimi: Gjendja Civile, 2015

Sipas këtyre të dhënave, në bashki kemi 194,167 banorë të regjistruar për vitin 2015, ndërkohë që metodologjia e INSTAT-it propozon një shifër prej 122,475 banorësh. Edhe për vitin 2011, viti bazë i Census, diferenca është e njëjtë, rreth 70,000 banorë. Kjo

diferencë reflekton problemet në regjistrimin e popullsisë, tendencat e emigrimit, si dhe probleme të mundshme të procesit të Censusit.

Figura 223. Piramida e popullsisë për vitin 2015



Burimi: Gjendja Civile, 2015

Të dhënat e Gjendjes Civile reflektojnë një dominancë të dukshme të meshkujve ndaj femrave, dhe një popullsi shumë të re, ku përqindja më e madhe i takon grup-moshave 20-24, 25-29, si dhe 30-34. Këto të dhëna konfirmojnë potencialin për të shfrytëzuar dividentin e lartë demografik, siç shpjegohet në seksionin 1.5.1.

Projeksionet e popullsisë sipas Gjendjes Civile janë llogaritur mbi bazë të normës së rritjes, e cila caktohet për secilën njësi administrative, në vitet 2011-2015, në bazë të formulës më poshtë:

$R = [(P_n / P_o)^{1/n} - 1] \times 100$ ku, R – Rritja e popullsisë

P_n – Popullsia e vitit për të cilin bëhet projeksioni

P_o – Popullsia aktuale

n – Numri i viteve të ndërmjetme

Duket se norma më e lartë e rritjes në nivel bashkie i takon njësisë Qendër, ndërsa Fieri ka një ndër normat më të ulëta. Si rrjedhojë, duke u nisur nga viti bazë 2015, është bërë llogaritja e popullsisë së parashikuar për 5-vjeçarët e ardhshëm, deri në 2031, sipas formulës:

$Pn = Po * (1 + R/100)\ n$ ku: R – rritja e popullsisë

Pn – popullsia e vitit për të cilin bëhet projeksioni
Po – popullsia aktuale
n – numri i viteve të ndërmjetme

Tabela 119. Projeksioni demografik për Njësitë Administrative, sipas Gjendjes Civile.

Viti	Cakran	Dermenas	Frakull	Fier	Levan	Libofshe	Mbrostar	Portez	Qender	Topoje
2010*	15172	11562	9503	78133	15935	9477	9672	10310	11177	6991
2011	16317	12369	10347	85565	17240	10176	10262	11166	12026	7572
2012	16514	12443	10464	84740	17386	10318	10397	11239	12159	7580
2013	16656	12532	10508	85373	17587	10363	10498	11332	12337	7616
2014	16731	12577	10581	87034	17613	10420	10544	11394	12428	7629
2015	25130	23279	20488	38037	10384	10668	17702	10626	11507	26346
2031	**28683**	**25454**	**23090**	**41658**	**11647**	**12099**	**20463**	**11824**	**13708**	**27419**
r	**0.83**	**0.56**	**0.75**	**0.57**	**0.72**	**0.79**	**0.91**	**0.67**	**1.10**	**0.25**

Burimi: Gjendja Civile, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016
Shënim: Viti 2010 nuk ka të dhëna për popullsinë mbi 80 vjeç, prandaj nuk është marrë në konsideratë për projeksionin.

Tabela 120. Projeksioni demografik për Bashkinë, në periudha 5-vjeçare.

Viti	Popullsia
2010*	177932
2011	193040
2012	193240
2013	194802
2014	196951
2015	194167
2016	**195468**
2021	**202105**
2026	**208966**
2031	**216061**

Burimi: Gjendja Civile, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016
Shënim: Viti 2010 nuk ka të dhëna për popullsinë mbi 80 vjeç, prandaj nuk është marrë në konsideratë për projeksionin.

Popullsia e Bashkisë Fier për vitin 2031 do jetë 216,061 banorë, me një rritje të ulët prej 0.8% në vit. Kjo shifër do përdoret më tej në llogaritjen e nevojës për banim, shërbime publike, infrastrukturë etj, duke marrë parasysh një skenar realist zhvillimi, në përputhje me tendencat e rritjes së 5 viteve të fundit.

Vlen të theksohet se metodologjia e INSTAT-it, sipas së cilës Bashkia Fier në 2031 do ketë ulje deri në 103,277 banorë, është e bazuar në kritere më gjithëpërfshirëse, në nivel makro, por për arsye të disponueshmërisë së të dhënave në nivel qarku, dhe përshtatjes metodike

më pas në nivel njësie administrative, është zgjedhur të përdoren të dhënat e Gjendjes Civile, që paraqesin një situatë më pozitive të rritjes.

Figura 224. Shpërndarja e popullsisë sipas Njësive Administrative, 2031.



Burimi: Gjendja Civile, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Figura 225. Rritja e popullsisë së Bashkisë Fier, 2010-2031.



Burimi: Gjendja Civile, 2015; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Shënim: Viti 2010 nuk ka të dhëna për popullsinë mbi 80 vjeç, prandaj nuk është marrë në konsideratë për projeksionin.

Si pasojë e mënyrave të ndërhyrjes në territor, në bashki rritet kapaciteti mbajtës përtej parashikimeve të popullsisë sipas Instat e Gjendjes Civile, deri në 740 000 banorë (rreth 3 herë më tepër). Kjo rritje e kapaciteti mbajtës vjen sepse ndërtimet për banim mund të rriten pasi kemi 118 njësi strukturore për mbushje urbane, 101 njësi strukturore për dendësim, 66

njësi strukturore per rigjenerim dhe 26 njësi strukturore për rizhvillim për të akomoduar banim.

Për strehimin social nuk parashikohet një zonë specifike e akomodimit të familjeve aplikuese. Për vitin 2016, në periudhën periudhen janar-maj janë regjistruar 20 kërkesa të reja për banesa me kosto të ulët, si dhe banesa sociale me qera. Ndërkaq, nga vitet e mëparshme bartet një numër prej rreth 50 familjesh që janë në kërkim të futjes së programeve të strehimit.
Aktualisht, Enti Kombëtar i Banesave ka investuar në 75 banesa sociale, të cilat do u shpërndahen përfituesve në vitin në vazhdim.

2.1.6 Instrumentet e drejtimit të zhvillimit

Me qëllim balancimin e interesave të pronarëve dhe zhvilluesve, në përputhje me parimet kryesore të këtij plani: sigurimin e shërbimeve dhe infrastrukturës bazë në përputhje me kapacitetin mbajtës, konservimin e tokës bujqësore dhe rehabilitimin natyror, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, etj, propozohen disa instrumente të menaxhimit të tokës, të cilët do zbatohen siç detajohet në Rregulloren e këtij plani.

TDZH: Transferimi i të drejtës së zhvillimit, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, do zbatohet në rastet ku mbi tokë bujqësore, ose natyrore, kemi presion zhvillimi, e plani parashikon për to mënyrë ndërhyrjeje konservuese dhe ruajtje të intensitetit ekzistues të ndërtimit për përdorim banim. Në këtë rast, e drejta e pronarëve për të zhvilluar transferohet në zona qëndrore ku nxitet densifikimi. Në Bashkinë Fier janë parashikuar 8 zona, në kufi me Unazën 3 të qytetit, si dhe në pjesën jugore, në afërsi të zonës së Azotikut. Plani parashikon veprimtari ndërtuese vetëm në brendësi të Unazës 3, por për të shmangur diskriminimin, njësitë jashtë unazës, në vazhdim të lagjes Afrim i Ri, Afrim, e fshatit Clirim, i nënshtrohen programit të TDZH. Ndërkaq, njësitë në pjesën jugore e jug-lindore të bashkisë kanë presion të lartë zhvillimi, ndodhen brenda unazës 3, kanë përdorim bujqësor aktual, por prania e zonës industrial të Azotikut e bën jetesën pothuajse të pamundur aty. Edhe këto njësi i nënshtrohen programit të TDZH, si njësi dhënëse.

Njësitë marrëse janë 12 njësi të vendosura në qytetin e Fierit, përgjatë lumit Gjanica, të cilat do i nënshtrohen Rizhvillimit, me intensitet 3-3.5. Procedurat e zhvilllimit të programit të TDZH do kryhen sipas Rregullores së këtij plani.

Intensiteti me kusht do zbatohet në njësi qëndrore, ku ka presion të lartë zhvillimi e kërkesë për investime, por mungojnë infrastrukturat bazë për të akomoduar këto zhvillime. Për të balancuar interesin e zhvilluesve për rritje të intensitetit, me kërkesën për Kshp më të lartë, zonave u atribohet një intensitet shtesë (+1), që mund të realizohet në këmbim të sigurimit të infrastrukurës, shërbimeve publike, gjelbërimit dhe hapësirave publike në njësinë respektive. Plani propozon 31 zona të tilla, ku 2 gjenden në afërsi të terminalit të ri të autobusëve, me intensitet të propozuar 4 dhe +1 me kusht, si dhe 6 në zonën e Gjanicës, në njësitë për rizhvillim në afërsi të qendrës, ku intensiteti i propozuar është 3.5, dhe ai me intensitet me kusht 4-5. Investimet publike të siguruara nga rritja e intensitetit, në këto zona, do i dedikohen përmirësimit të hapësirave brenda bllokut të banimit, krijimit të zonave të parkimit, gjelbërimit, etj, ndërsa rehabilitimi i parkut të Gjanicës do marrë investim të veçantë, si një ndër prioritetet strategjike të Bashkisë.

2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike

2.2.1 Efektet e infrastrukturave kombëtare e rajonale

Bashkia e Fierit shtrihet në një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme duke parë që në këtë bashki kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit të cilët janë Korridori i VIII dhe Korridori i Kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane, e quajtur në Planin e Përgjithshëm Kombëtar si Korridori i Gjelbër) janë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit.

Korridori i Kaltër (Korridori i Blu sipas PPK-së) sipas SETTO-s (South-East Transport Observatory, institucion i rëndësishëm që orienton stratëgjitë e transportit në Ballkan, e cila unifikon prioritetet e infrastrukturës së vendeve që janë pjesë e saj në bazë të strategjive kombëtare) nuk ka qenë pjesë e hartës së vitit 2015, por është një nga prioritetet e vitit 2016 të qeverisë shqiptare. Si pjesë e autostradës Adriatiko-Joniane (korridori kaltër), e cila është në proces fizibiliteti, disa nga segmentet që po punohet janë: rruga Thumane-Kashar-Vorë, By-passi i Tepelenës si dhe By-passi i Lezhës. Në këtë intenerar pritet të kalojnë mesatarisht 6,302 automjete/ditë.[453]

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) 2015-2030, i miratuar në maj 2016, ka vendosur disa direktiva të rëndësishme të cilat do të impaktohen në planet e përgjithshme rregulluese që po hartohen. Ndër elementet e PPK-së është infrastruktura dhe transporti në nivel kombëtar dhe rajonal, të cilat do të kenë impakt në planin e përgjithshëm të Bashkisë Fier kryesisht në infrastrukturën hekurudhore, e cila sipas Projekteve Prioritare të Ministrisë së transportit synon rivitalizimin e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese dhe me tej, duke e lidhur vendin tonë më Maqedoninë si dhe lidhjen e porteve me infrastrukturë hekurudhore.

Pësa i përket infrastrukturës rrugore, në pjesën perëndimore të qytetit do të kalojë Korridori i Blu (realizimi i lidhjes midis Malit të Zi dhe Greqisë nga Hani i Hotit në Shkodër dhe Gjirokastër përmes pikës kufitare të Kakavijës, me një gjatësi prej 405 km ose siç quhet ndryshe Korridori i Kaltër). Ky korridor do të kalojë në pjesën perëndimore të qytetit të Fierit në By-passin që po ndërtohet ku më pas shkon drejt Gjirokastrës dhe më tej nëpërmjet Levanit. Një tjetër intenerar i rëndësishëm që pritet të ketë impakt në bregdetin e Fierit është Korridori Blu (rrugë bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipojë – Shëngjin, Shëngjin – Patok, Patok – Durrës, Durrës – Divjakë, Divjakë – Seman , Seman – Vlorë, Vlorë – Dhërmi, Dhërmi – Sarandë, Sarandë – Butrint). Përgjatë zone bregdetare janë propozuar shtigje turistike në përputhje me PPK-në dhe keto shtigje kanë lidhen me njëra-tjetrën.

Figura 226. Impakti i projekteve rajonale dhe kombëtare, Bashkia Fier.



Burimi: AKPT (PPK); Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Transporti publik ndërqytetas**

Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) të bashkive me njëra-tjetrën. Ky lloj transporti është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Në kuadër të reformës administrative të vitit 2014, lindi nevoja për një konceptim të ri të transportit publik ndëqytetas në nivel bashkie dhe jo vetëm në nivel qarku që ishte më parë.

Duke u bazuar në këtë reformë, rrjeti i ri i linjave është përcaktuar pasi ka kaluar procedurat e modelimit dhe të konsultimit me përfaqësuesit e Bashkive respektive dhe shoqëritë që shërbejnë sot në transportin ndërqytetës. Po ashtu, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në zbatim të ligjit të mësipërm, ka hartuar Udhëzimin "Për kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus brenda vendit". Me udhëzimin e ri, është përcaktuar që gjithsej në gjithë vendin do të operojnë 326 linja ndërqytetëse, nga 588 që ishin më parë.[454]

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në zbatim të ligjit nr. 10/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të

ndryshuar, publikon rrjetin e linjave ndërqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe oraret për secilën linjë, që do të fillojë të zbatohet në 1 Janar 2017. Kërkesë e rëndësishme është që bashkitë të përcaktojnë vendndodhjen e terminaleve të autobuzëve në zbatim të nenit 21/1 të ligjit nr.10, 2016. E domosdoshme është gjithashtu që shoqëritë që do të licensohen, të rinovojnë 20% të flotës së tyre të autobuzëve gjatë vitit të parë licensës, edhe gjatë 2017.

Në muajin maj të këtij viti, u prezantuan linjat e reja të transportit ndërqytetas në nivel qarku si dhe në nivel bashkie. Sipas propozimeve të bëra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Bashkia Fier pritet të ketë lidhje të rëndësishme kryesisht me bashkitë e Patosit, Roskovecit dhe Tiranës. Metodologjia e kësaj analize është bërë me anë të numrit të orareve që lëviz çdo linjë në ditë. Duke u bazuar në këtë kriter, nga muaji janar pritet që në linjën Fier-Patos të nisen 18 orare në ditë. Kjo tregon rëndësinë që kanë këto dy bashki me njëra-tjetrën përsa i përket lëvizshmërisë. Bashkia e Fierit pritet të ketë lidhje të shpeshta edhe me bashkitë e Tiranës dhe të Divjakës respektivisht 15 orare drejt Tiranes dhe 13 orare drejt Roskovecit.

Figura 227. Linjat e propozuara të transportit publik ndërqytetës.



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrutkurës, Përpunoi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

2.2.2 Lëvizja në territor

- **Koncepti i lidhjeve infrastrukturore**

Koncepti i infrastrukturës përkon me fazën e parë të krijimit të sistemit rrugor për Bashkinë Fier. Në këtë fazë është bërë "qepja" e sistemit rrugor duke lidhur gjithë elementët fizike, natyrorë, fshatrat kryesorë, qytetin e Fierit me qendrat e ish-komunave, lidhjen e qytetit me pjesën perëndimore bregdetare të bashkisë si dhe lidhjen me zonat natyrore të mbrojtura. Sipas këtij leximi janë evidentuar 8 lloje rrugësh të cilat shpjegohen si më poshtë vijon:

Bypass-i: Fillimisht është evidentuar gjurma e plotë e ByPass-it të Fierit, e cila do të jetë një nyje e fortë lidhëse për qytetin e Fierit me autostradën Vlorë-Durrës. Kjo është një gjurmë e fortë e cila në një farë mënyre e lidh Bashkinë me pjesën tjetër të rajonit, por brenda saj e ndan territorin në dy pjesë gjatësore të mëdha. Lidhur me këtë fakt lind edhe sfida për të lidhur dy pjesët e territorit nëpërmjet sistemit infrastrukturor.

Në një nga hartat e përgatitura evidentohen edhe katër hyrje-daljet e Bypass-it me rrugët e tjera në territorin e Bashkisë. Hyrja më e rëndësishme pritet të jetë ajo e Grecallisë, e cila do të bëhet dhe hyrja kryesore në qytet. Një tjetër hyrje-dalje e rëndësishme përgjatë këtij aksi është ai Levanit. Një rëndësi më të ulët kanë hyrje-daljet e Pojanit dhe Dërmenasit.

Unazat Urbane: Zhvillimi i territorit të qytetit të Fierit është orientuar nga unazat urbane, unaza të cilat jo vetëm kufizojnë/orientojnë zhvillimin por edhe bëjnë lidhjen në mënyrë unazore të zonës urbane. Përkatësisht në territorin e qytetit të Fierit dhe periferive të tij janë propozuar tre unaza urbane: unaza e vogël, unaza e ndërmjetme dhe unaza e madhe. Unaza e vogël shërben për të kufizuar/rrethuar pjesën qendrore të qytetit, pra bërthamen e tij. Unaza e ndërmjetme shtrihet deri në ish-periferinë e qytetit[455] dhe shërben për lidhjen e zonave të banimit pranë. Unaza e madhe është ajo e cila përmbledh dy unazat e tjera dhe kufizon shtrirjen e qytetit si dhe lidh zonat e reja të banimit të pas viteve 1990 dhe zonave të reja të banimit të cilat mund të propozohen gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Radiale Urbane: Në konceptin e sistemit rrugor të bashkisë Fier bëjnë pjesë edhe radialet urbane të cilat kanë një funksion lidhës dhe "çarës" për unazat. Këto rrugë depërtojnë nëpër unaza, bëjnë lidhjen ndërmjet tyre, si dhe shërbejnë si nyje kryesore zhvillimi dhe kalimi.

Yllësitë e Fierit: Janë rrugë të cilat në hirearki do të qëndronin pas radialeve por që shërbejnë kryesisht si tranzitore. Yllësitë kanë për qëllim të të çojnë diku, në një destinacion si për shembull: drejt bregdetit, drejt pjesës më skajore të Bashkisë, drejt qëndrave të ish-komunave dhe drejt bashkive të tjera fqinje.

Rurale bujqësore: Rrugët rurale bujqësore janë rrugë të cilat praktikisht lidhin jo vetëm zonat bujqësore, por edhe qendra fshatrash. Ato bëjnë një lidhje më të mirë me rrjetin në tërësi por lidh edhe qendra kryesore zhvillimit. Për shembull këto janë rrugë të cilat lidhin fshatra të rëndësishëm si për shembull në Darzeza, Pojan, Mbrostar, Libofshë etj. Një lidhje e rëndësishme në këtë kategori është një lidhje e propozuar e cila lidh zonën industriale me rrjetin unazor urban dhe yllësitë.

Orbitale natyrore: Orbitalet natyrore janë të tilla pasi, jo vetëm që nga ana fizike kanë formë orbitalesh, por edhe se këto rrugë lidhin zona natyrore kodrinore por edhe

qendra fshatrash që ndodhen rrëzë kodrave. Këto rrugë janë deri diku ekzistuese por edhe propozohen të reja për shkak të lidhjes të gjithë sistemit. Duhet theksuar se në këtë moment rrugët nuk janë ndarë sipas gjerësisë së seksionit të tyre apo sipas ndarjes rrugë makinash apo këmbësorësh. E rëndësishme në këtë fazë është sigurimi i "qepjes" së të gjithë strukturës.

Vernakolare: Rrugët lidhëse vernakolare janë rrugët të cilat deri diku janë më "fshatareske" dhe shtrihen më natyralisht në territor. Këto rrugë jo vetëm që lidhin disa fshatra dytësore me njëra-tjetrën por edhe shërbejnë si "pathe" më alternative për të arritur elemente natyrore si për shembull: "Kurora e Adriatikut", lumin e Semanit, kalimet mbi të etj.

Lidhëse: Rrugë lidhëse janë quajtur të gjtha ato rrugë të tjera të cilat në rëndësinë e tyre qëndrojnë më poshtë në hirearki por që shërbejnë për të lidhur lagje fshatrash kryesisht të shpërhapura, toka bujqësore dhe zona natyrore të tjera.

Figura 228. Rrugët e propozuara sipas funksionit



Burimi: Bashkia Fier e Co-PLAN, 2016

Tabela 121. Kategoritë e rrugëve të propozuara, sipas klasifikimit të kodit rrugor

Kodi rrugor	Gjatësia në km linear
A.Autostrada	36.7
B.Rrugë interurbane kryesore	34.8
C.Rrugë interurbane dytësore	234.7
D.Rrugë urbane kryesore	38

E.Rrugë urbane dytësore	45.9
F.Rrugë lokale	236.5

Burimi: Bashkia Fier e Co-PLAN, 2016

Lidhshmëria në nivel qyteti

Figura 229. Integrimi aksial në Bashkinë Fier, para dhe pas ndërhyrjeve madhore të propozuara në rrjetin rrugor

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2016

Propozimet e rrjetit të ri rrugor vijnë si nevojë për të lidhur vendbanimet rurale në mënyrë më direkte me akset kryesore; për të realizuar akses në zonat me potencial zhvillimi (si bregdeti, zonat arkeologjike të Apollonisë dhe Ardenicës, zonat pyjore të mbrojtura në pjesën kodrinore të Levanit e Cakranit, etj); si dhe për të mundësuar një rrjet eficent lëvizjeje në token bujqësore.

Në nivel qyteti, ndërtimi i 3 unazave koncentrike ka disa funksione kryesore:

-Frenimin e zhvillimit e shpërhapjes së qytetit në zonën bujqësore përreth

-Konsolidimin e strukturës urbane rrjet brenda qytetit

-Përmirësimin e aksesueshmërisë në zonat periferike, sidomos në lagjet Afrim i Ri, Afrim e Sheq i Madh, Sheq i Vogël.

Përveç kësaj, përmirësimi i lidhjeve dytësore e tretësore në brendësi të qytetit, të cilat synojnë të lidhin njësitë strukturore në mënyrë kuadratike, sjell një integrim më të mirë hapësirave, siç tregohet nga analiza aksiale e sintaksës hapësinore, në figurën e mësipërme. Rrjeti i propozuar rrugor përmirëson lidhshmërinë e radialeve urbane me unazat, rrjetin kuadratik dhe lidhëset e tjera tretësore, duke konsoliduar rolin e tyre si hyrëse, mbartëse të trafikut qytetas, e akseve të shërbimit në qytet. Ndërkaq, zona në afërsi të stacionit të trenit dhe terminalit të ri të multimodal pëson gjithashtu përmirësim të dukshëm të lidshmërisë, i cili do i shërbejë nevojave të ardhshme për tranzit në këtë zonë.

Sistemi tretësor i shtigjeve, pavarësisht se nuk propozohet shtrim tërësor i tyre në këtë document, i nënshtrohet ndërhyrjeve mirëmbajtëse dhe strukturuese, si dhe rritjes në bazë të KShr të propozuar për secilën njësi strukturore, në Rregulloren e bashkëngjitur.

- **Transporti publik i propozuar**

Transporti publik është një nga shërbimet më të rëndësishme që ofrojnë bashkitë për të patur akses më të mire midis vendbanimeve sidomos me shërbimet që ndodhen në qytet të cilat duhet të aksesohen nga të gjithë banorët e bashkisë, në një kohë të shkurtër. Ky lloj shërbimi është i rregulluar në ligjin Nr. 8308, datë 18.03.1998 , për transportet rrugore, i ndryshuar. Transporti publik rrethqytetas dhe urban është kompetencë e bashkive dhe linjat e transportit publik miratohen nga Këshilli Bashkiak me propozim të kryetarit të Bashkisë.

Referuar informacioneve të bashkisë Fier, transporti publik rrethqytetas në këtë bashki bazohet në akset kryesore kombëtare. Sipas ndryshimeve që kjo bashki ka bërë me shtimin e transportit publik ndërqytetas mbulon një gjatësi 72 km linear. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Fier, numri i mjeteve të transportit në rang rrethi për vitin 2010 ka qenë gjithsej 14,540 mjete. Vihet re një rritje rreth 20 % çdo vit.

Nga analiza e gjendjes ekzistuese, si dhe bazuar ne ligjin Nr. 8308, për transportet rrugore, i ndryshuar, propozohet hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse bazuar mbi disa kritere si: të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me qendrat e Njësive Administrative përbërëse dhe qendrat e Njësive Administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre. Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse[456].

Në propozimet e transportit publik është bërë dhe një analizë e numrit të banorëve që përdorin transportit publik sipas INSTAT-it dhe projeksioneve deri në vitin 2031. Përqindja që përdorin transportin publik është e ulët duke parë që 14.2 % përdorin këtë lloj shërbimi në nivel bashkie por që varion për çdo ish-njësi administrative dhe në vitet e ardhshme pritet që numri i banorëve që përdorin këtë shërbim të rritet, ku në qytetin e Fierit pritet që transporti publik të përdoret nga mbi 40% e banorëve të qytetit kurse në ish-Njësitë Administrative të variojë nga 6-25% e popullsisë. Duke u bazuar ne linjat e transportit të propozuar supozohet që personat që do të përdorin transportin publik të rritet me 50%.

Tabela 122. Numri i banorëvë që priten të kenë akses në transportin publik në harkun kohor 2011-2031

	Projeksioni i popullsisë			**përdomini në % sipas vitit 2011**	**% e propozuar për transportin publik**	**Nr. i banorëve që pritet të përdorin transport publik**		
	2011	**2021**	**2031**			**2011**	**2021**	**2031**
BASHKIA FIER	126,305	114,004	103,277			0	0	0

Fier	58,460	52,766	47,801	18%	45%	10458	23745	21510
Qënder Fier	4,404	3,975	3,601	12%	18%	528	716	648
Libofshe	6,437	5,810	5,263	7%	10%	451	581	526
Topoje	4,445	4,012	3,634	4%	6%	187	241	218
Dermenas	8,153	7,359	6,666	11%	16%	856	1177	1067
Mbrostar	7,809	7,049	6,386	13%	20%	1015	1410	1277
Levan	8,541	7,709	6,984	6%	9%	512	694	629
Frakull	7,139	6,444	5,838	4%	6%	286	387	350
Portez	8,646	7,804	7,069	17%	25%	1470	1951	1767
Cakran	12,271	11,076	10,034	4%	6%	491	665	602

Burimi: Instat 2011; Përgatiti: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Përvec bazës ligjore, një tjetër analizë e rëndësishme është hedhja e një vije me distancë 500m (distanca që mund të ecë një person për në stacionin më të afërt) për çdo linjë ekzistuese të transportit publik, në mënyrë që të shihet së cilat janë zonat/vendbanimet që nuk aksesohen nga ky lloj shërbimi.

Nga analizat e kryera shihet që pjesët verilindore dhe jugperëndimore nuk kanë akses të mirë të transportit publik. Duke parë këtë mangësi aksesi, propozohet krijimi i disa linjave të cilat do të bëjnë të mundur lëvizshmëri më të mirë të vendbanimeve si dhe lidhjen e tyre me qytetin e Fierit. Për të qenë sa më të manaxhueshme nga pikëpamja funksionale dhe operative, propozohet krijimi i unazave, të cilat do të bëjnë të mundur mbulimin e territorit me këtë lloj shërbimi. Në pjesën verilindore propozohet linja unazore Fier - Libofshë - Havaleas - Seman i ri e cila ka një gjatësi 39 km linearë.

Përsa i përket pjesës jugperëndimore, ajo është e aksesuar mirë në pjesën më të madhe të territorit, por për të rritur aksesin e vendbanimeve që kanë mungesë të këtij lloj shërbimi propozohet linja Fier-Levan-Bishan-Shtyllas-Fier. Unaza qe shkon drejt Shtyllasit dhe Radostimës do të ketë orare me të rralla në raport me linjën e Levanit e cila është një nyje logjistike e rëndësishme e bashkisë Fier. Kjo linjë do të mbulojë një gjatësi 35 km.

Një linjë tjetër e rëndësishme është Fier-Plazh (duke kaluar nga Topoja) e cila do të jetë më e rëndësishme gjatë sezonit të verës ku fluksi i turistëve pritet të rritet në këtë zonë bregdetare. Një tjetër unazë propozohet nga Hoxhallara-Polveçë-Darzezë-Topojë-Fier. Këto linja janë propozuar për të bërë të mundur akses të mirë të vendbanimeve me njëri-tjetrin si dhe me qendrën e Fierit.

Në bashkinë e Fierit nga 72 km që mbulohet është aktualisht transportit publik, propozohet që ky lloj shërbimi të mbulojë 165 km, në mënyrë që të ketë akses më të mirë me shërbimet që ndodhin në qytet.

Figura 230. Rrjeti i propozuar i transportit publik në nivel Bashkie.



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Transporti publik qytetas**

Pas analizës së planit rregullues 2005 për` transportin publik si dhe një nga kriteret që është marrë parasysh gjatë hartimit të linjave qytetase është distanca 500 m që duhet të përshkruaj në këmbë një banor i qytetit për në stacionin më të afërt duke u bazuar edhe tek lidhjet e transportit rrethqytetas e cila me ndarjen administrative territoriale të vitit 2014 është kopetence e bashkive. Një pjesë e linjave rrethqytetase e mbulojnë qytetin e Fierit duke parë që nisen nga disa pika të qytetit. Linjat e reja të transportit publik propozohen kryesisht në akset kryesore të propozuara në mënyrë që nga ky shërbim të kenë akses të gjithë banorët e qytetit.

Krahas transportit publik, parkimet e nevojshme për përmbushjen e standardeve janë zgjidhur në dy mënyra: parkim në një anë apo në dy anë të rrugëve, si dhe vende parkimi të hapura. Në qytet janë identifikuar 12 zona ku mund të ndërtohen parcela parkimi, të ndodhura pranë zonave të reja të shërbimit, siç propozohet në këtë dokument, si dhe të shpërndara njëtrajtësisht në qytet. Në zonat rurale parkimi konsiderohet i zgjidhur nëpërmjet parcelave individuale, për shkak të tipologjisë së vilave në këto zona. Parkimi rrugor, në 1 apo 2 anë, është përcaktuar për secilin segment rrugor të propozuar, sipas prerjeve respektive.

Figura 231. Prerje e Unazës 2, ku kalon transporti publik i propozuar



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Figura 232. Skema e propozuar e transportit publik dhe parkimeve në qytetin e Fierit



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- **Kategoritë e kushtet teknike të sistemit rrugor sipas funksionalitetit**

Seksionet e prerjeve janë bërë sipas kategorisë së funksionit të rrugës dhe jo sipas kodit rrugor. Çdo funksion i rrugë i është dhënë një kod specifik që të kuptohen nga njëri tjetri p.sh rrugët lidhëse dytësore urbane kanë kodin Ur2 për tu identifikuar me seksionin e prerjeve në cad. Në autocad profilet janë bërë sipas rendit alfabetik p.sh Ur2-A ku Ur2 është funksioni i rrugës dhe A është prerja e cila në cad gjendet me emërtimin A-A' për të treguar segmentin ku është bërë prerja. Duke parë që rendi albabetik ka një limit shkronjash është vazhduar me dublikimin e gërmave pra Ur2-AA ku është po e njëjta llogjike si më lart (Ur2 është funksioni dhe AA tregon prerjen në cad me emertimin AA-AA'). Pra seksionet e prerjeve Ur2-A, B Ur2-AA dhe Ur2-AAA janë të ndryshme me njëra tjetrën, gjë e cila pasqyrohet në cad. Po më të njejtën llogjike janë bërë e profilet e segmenteve të tjera.

Figura 233. Kategorizimi i rrugëve sipas kodit rrugor



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- ***Përfundime***

Transporti Ndërqytetas, i miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, do të zbatohet në janar 2017 ku Bashkia e Fierit do të krijojë lidhje të rëndësishme me Bashkitë e Patosit, Tiranës dhe Roskovecit duke parë numrin e orareve që priten të nisen drejt këtyre bashkive.

Transporti publik në bashkinë e Fieri funksionon në linja lineare (radiale), mbulon një distancë 72 km linearë dhe propozohet që ky lloj transporti të mbulojë një gjatësi 165 km linearë.

Propozohet se krijimi i unazave do të sjellë akses më të mirë ndërmjet vendbanimeve me njëri-tjetrin dhe me shërbimet në qytet si dhe mënyrë me efiçente për të rregulluar linjat e autobuzeve (furgonave) që do të kalojnë në këto unaza.

2.2.3 Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura

Në këtë seksion do të trajtohen rekomandime të përgjithshme në lidhje me nevojat për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës e cila siguron shërbimin e furnizimit me ujë për konsum publik dhe kanalizimet e ujrave të ndotura urbane.

- **Infrastruktura e Furnizimit me Ujë**

Problemet kryesore të sektorit lidhen me mirëmenaxhimin e sistemit të furnizimit, ku zgjidhja e propozuar konsiston në instalimin e matësve individualë për çdo lidhje konsumatore. Faktor tjetër në përmirësimin e sektorit është eleminimi i të gjitha lidhjeve të paligjshme dhe të parregjistruara, kombinuar kjo me masa konkrete dhe ndërgjegjësim të popullatës mbi detyrimet financiare karshi ofrimit të këtij shërbimi.

Ngritja e një sistemi monitorimi, ku matës gjeneralë instalohen nga tubacioni kryesor të furnizimit, në dalje të rezervuarëve dhe në nënzonat e shërbimit. Kjo do t'i ofroj Ndërmarjes së Ujësjellës Kanalizime Fier mundësinë për të kuptuar dhe gjurmuar zonat ku uji humbet apo shpërdorohet si edhe për të adresuar përgjegjësitë.

Theksojmë se kryesore në masat që duhet të ndërmarrë Bashkia Fier, duhet të jetë sigurimi i linjave magjistrale, të cilat dërgojnë ujin nga pusshpimet/burimet drejt rezervuarëve e më pas drejt konsumatorëve. Në mënyrë kategorike në këto segmente nuk duhet të ketë asnjë lidhje shërbimi për klientë e konsumatorë të vegjël (*përjashtojmë rastet kur do të projektohen degëzime të cilat do të shoqërohen me projektin teknik dhe llogaritjet e detajuara hidraulike për të mos ndikuar në presionin e përgjithshëm të nevojshëm për të dërguar ujin në qëndrat kryesore të banimit*). Një objketiv tepër i rëndësishëm për ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Fier do të jetë ulja e humbjeve në masën e përgjithshme prej 25%, kjo mund të arrihet duke implementuar masat e sipërpëmëndura dhe si masë ndikon drejtpërdrejt në plotësimin e nevojave për një numër më të madh konsumatorësh.

Në total Bashkia Fier ka 26 zona të përcaktuara për furnizimin me ujë për konsum publik. Këto zona ndonëse mund të mbulojnë të gjithë shtrirjen administrative të Bashkisë, kanë mangësi lidhur me mbulimin e plotë të popullatës me shërbimin e furnizimit me ujë. Nga vrojtimi në terren dhe analizat teknike të të dhënave, në tabelën e mëposhtme konstatohet se NjA Cakran, Mbrostar, Qendër, Dermenas, Topojë dhe Portëz kanë si burime edhe sistem të pamjaftueshëm për furnizimin me ujë për konsum publik. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës, e kombinuar edhe me disponueshmërinë ndaj burimeve ekzistuese.

Prandaj, në bazë të kërkesës për ujë, sfida në lidhje me furnizimin e zonave te planifikimit urban në Bashkinë e re dhe të zgjeruar të Fierit duket se ka nevojë si për burime të tjera uji, njëherësh edhe për ndërhyrje mbi shtimin e sitemeve dhe mirë-menaxhimin atyre ekzistues.

Tabela 123. Kapaciteti i burimeve të furnizmit me ujë krahasuar me kërkesën e parashikuar.

Zona e furnizimit me ujë	Pop. 2015	Pop. 2030	Kapaciteti mesatar vjetor aktual i burimit te furnizimit me ujë		Kërkesa aktuale dhe e projektuar për popullsinë qe banon ne secilën zonë (m^3/ditë)		Kërkesa për ujë duke pranuar humbjet 25% (m^3/ditë)	Kërkesa ose jo për burime të reja të furnizimit me ujë (m^3/ditë)	
			l/s	**m^3/ditë**	**2015**	**2030**		**Mjafton (+)**	**Mungese (-)**
Fier (ish qyteti)	65,728	73,630	700	60,480	9,859	11,044	14,689	45,791	
Cakran	25,130	28,683	49	4,234	3,770	4,302	5,722		-1,489
Mbrostar Ura	17,702	20,463	13	1,128	2,655	3,069	4,082		-2,954
Libofshe	10,668	12,099	29	2,506	1,600	1,815	2,414	92	
Qender	4,143	4,935	11	972	621	740	985		-13
Dermenas	23,279	25,454	25	2,160	3,492	3,818	5,078		-2,918
Topojë	26,346	27,419	16	1,392	3,952	4,113	5,470		-4,078
Levan	6,652	7,151	50	4,320	998	1,073	1,427	2,893	
Frakull	3,893	4,387	30	2,592	584	658	875	1,717	
Portez	10,626	11,824	14	1,166	1,594	1,774	2,359		-1,192
Totali	**194,167**	**216,045**	**937**	**80,950**	**29,125**	**32,407**	**43,101**	**50,493**	**-12,644**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Rezervuarët e ujit për konsum publik parashtrojnë një problem tjetër të përbashkët, problem i cili lidhet me mbrojtjen higjeno-sanitare të tyre. Konkretisht, të gjithë rezervuarët, krahas shpëlarjes së rregullt 2 herë në muaj duhet t'i nënshtrohen edhe mbrojtjes higjeno santitare të udhëhequr nga Inspektoriati i Shëndetit Publik sëbashku me Ndërmarrjen UK Fier, ku nëpërmjet analizave dhe dezinfektimit këto rezervuarë të trajtohen dhe të çertifikohen rregullisht mbi statusin e tyre higjeno-sanitar. Në mënyrë të ngjashme duhet vepruar edhe me zonat e mbrojtjes Higjeno-Sanitare për të gjithë sitemet të cilat shfrytëzojnë pusshpime për furnizimin me ujë të pijshëm. Përkatësisht në një rreze prej 25m nga pusshpimi çdo aktivitet është i ndaluar dhe kjo do të quhet zona e mbrojtjes së rreptë. Më pas deri në një rreze prej 200m do të ndalohet aktiviteti ndërtues dhe ai bujqësor për të eleminuar në këtë mënyrë infiltrime me potencial ndotjete të akuiferit nën shfrytëzim.

Në mënyrë të ngjashme me analizën e mësipërmeme për burimet e ujit të pijshëm, rezulton se volumet e stokimit të ujit për Fierin dhe NjA Qëndër janë mëse të mjaftueshme, ndërkohë që problematike shfaqet situata sërish në NjA-të Cakran, Mbrostar, Libofshë, Dermenas, Topojë, Levan, Frakull dhe Portëz ku kërkohet një rivlerësim për volumet e nevojshme të cilat duhet të shtohen në secilën zonë.

Tabela 124. Kërkesa për rezervuarë shtesë sipas zonave të furnizimit me ujë.

Zona e furnizimit me ujë	Vëllimi aktual në zonën e furnizimit me ujë (m^3)	2030, Kërkesa ditore e projektuar për popullsinë qe banon ne secilën zone (m^3)	2030, Kërkesa mesatare ditore duke pranuar humbjet e ujit 25% (m^3)	Rregullimi "8-orësh" i vëllimit te ujit ne rezervuar (m^3)	Nevoja për rezervuare te rinj (m^3)	
					Mjafton (+)	**Mungesë (-)**
Fier (ish qyteti)	14,000	11,044	14,689	4,896	9,104	
Cakran	1,810	4,302	5,722	1,907		-97

Mbrostar Ura	500	3,069	4,082	1,361		-861
Libofshe	650	1,815	2,414	805		-155
Qender	486	740	985	328	158	
Dermenas	600	3,818	5,078	1,693		-1,093
Topojë	350	4,113	5,470	1,823		-1,473
Levan	250	1,073	1,427	476		-226
Frakull	250	658	875	292		-42
Portez	395	1,774	2,359	786		-391
Totali	**19,291**	**32,407**	**43,101**	**14,367**	**9,262**	**-4,338**

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Sipas "Master-Planit Kombëtar te Furnizimit me Ujë, Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur", që u miratua nga Këshilli Kombëtar i Ujit në dhjetor te vitit 2015, u bë e mundur të identifikohen projekte të veçanta që do t'u duhet të përmbushin nevojat e për furnizim me ujë në zonën e planifikimit të Bashkisë Fier megjithatë NjA-të Mbrostar, Libofshë, Qëndër dhe Portëz nuk janë përfshirë në këtë studim ndaj kërkojnë prioritet në planifikimet që do të realizohen për këtë sektor. Mbetet detyrë e Bashkisë dhe NUK-Fier të studiojë situatën dhe të përpilojë kërkesat e duhura për përfshirjen e këtyre zonave në nismat e reja të hartimit të projekteve zhvillimore e infrastrukturore.

Figura 234. Harta e sistemit aktual të furnizimit me ujë dhe propozimeve të reja, Bashkia Fier.



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016

Tabela 125. Përmbledhje e investimeve të nevojshme për Bashkinë Fier (2021-2040)

Sistemi i furnizimit me ujë	Ndërhyrja	Lloji
Varibop(Cakran)	Rehabilitim	Kaptazh për burimin e ujit
		Rezervuar
		Stacion pompimi
		Linje e Transmetimit Kryesor
		Lidhje
PishePoro (Levan, Dërmenas, Topojë)	Rehabilitim	Rrjeti shpërndarës i Furnizimit me ujë
		Lidhje
Frakull e Vogel (Frakull)	Zgjerim i zonës së shërbimit	Rrjeti shpërndarës i Furnizimit me ujë
		Lidhje
Pishe Poro (Levan, Dërmenas, Topojë)	Zgjerim i zonës së shërbimit	Kaptazh për burimin e ujit
		Trajtimi i ujit te destinuar për konsum publik
		Rezervuar
		Matës të ujit me shumicë
		Rrjeti shpërndarës i Furnizimit me ujë
		Lidhje
(Cakran) Varibop	Zgjerim i zonës së shërbimit	Rezervuar
		Rrjeti shpërndarës i Furnizimit me ujë
		Lidhje
Kafaraj (Fier, Frakull, Levan)	Rehabilitim	Kaptazh për burimin e ujit
		Rezervuar
		Stacion pompimi
		Lidhje
Kafaraj (Fier, Frakull, Levan)	Rehabilitim	Rrjeti shpërndarës i Furnizimit me ujë
Kafaraj (Fier, Frakull, Levan)	Rehabilitim	Linje e Transmetimit Kryesor

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

- **Infrastruktura e Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura Urbane**

Sot, mbi 55% e popullsisë në qytetin Fier është e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujrave të ndotura urbane. Vërehet se një numër i konsiderueshëm i tubacioneve te kanalizimeve, sidomos ato që ndodhen në pjesën fundore e të sheshtë, në afërsi të Lumit Gjanicë, kanë pjerrësi të pamjaftueshme për grumbullimin dhe sidomos transportimin e duhur të ujërave të ndotur duke shkaktuar njëherësh sedimentim të ujërave të ndotur. Në rast të kushteve klimatike me shira me intensitet të konsiderueshëm, këto sedimente shkarkojnë direkt në lumë. Aktualisht sistemi i kanalizimeve funksionon mirë, pavarësisht dëmtimeve dhe pjerrësisë se pamjaftueshme të shumë tubacioneve.

Infiltrimi nëntokësor i ujërave të ndotur në zonën urbane ashtu edhe në zonën rurale përtej unazës jugore të qytetit paraqet rrezik serioz për ndotjen e ujërave nëntokësore. Në vijim të kësaj, kanalet e hapura përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e banoreve te këtyre zonave, godinat e banimit i kane ndërtuar pikërisht ne këto zona. Situata aktuale të kanalizimeve të Bashkisë Fier (në zonën e qytetit) mund të përmirësohet vetëm me anë të ndërhyrjeve themelore e shume serioze të sistemit.

Sipas planeve të zhvillimit urban për zgjerimin e sistemit te kanalizimeve per ato zona qe përdorin uje nga sistemi i furnizimit te qytetit ne zonat rurale fshatrat rurale si Çlirimi, Zuphani, Driza, Daullas-Grecalli, Mbostar Ura, Vadiz, Plyk, Driza- Myrteza dhe Mbyet do te duhet te lidhen sa me shpejt me rrjet grumbullimi të ujrave të ndotura.

Sistemi i kanalizimit te ujërave ndotur në Fier përbehet pjesërisht nga rrjete të kombinuara (*ujërat e kanalizimeve janë bashkë me ujërat e shiut*) dhe në disa pjesë të qytetit nga rrjete të ndara (*ujerat e kanalizimeve janë veç nga ujerat e shiut*) ku të gjitha kanalet shkarkojnë direkt në Lumin Gjanicë dhe disa në përrenjt e kanalet e hapura më të afërta. Sistemi është në gjendje jo të mirë, veçanërisht në ato zona ku ekzistojnë tubacione të papërfunduara si dhe aty ku për shkak të bllokimit, kanalizimet janë hapur me rrjedhje të lirë duke krijuar kështu shkarkimin e ujerave te ndotur ne sipërfaqe dhe ne disa raste duke krijuar edhe pellgje llumi shumë pranë vëndbanimeve.

Zonat e Bashkisë Fier të cilat nuk janë te lidhura me sistemin e kanalizimit zakonisht përdoronin gropat septike për depozitimin e ujërave te ndotura. Efekti trajtues i këtyre gropave është shume i kufizuar. Ne gropat septike një pjese e ujerave te ndotur infiltrohet duke depërtuar deri tek niveli i ujerave nëntokësore, niveli ky qe arrihet lehte përafërsisht ne thellësi 4 deri ne 5m nën nivelin e tokës sidomos në sezonin me lagështirë të konsiderueshme. Një pjese tjetër e ujerave te ndotura shkarkohen ne kanale te hapura.

Duhet parashikuar një inspektim CCTV[457] i cili do të passqyrojë gjendjen aktuale të rrjetit ekzistues të kanalizimeve. Vetëm duke krahasuar kushtet e sistemit ekzistues të kanalizimit të qytetit, mund të themi se ky sistem ka nevojë thjesht për riparim apo për rindërtimin e tij nga e para. Mendohet se afërsisht 35 % e këtij sistemit ekzistues duhet ti nënshtrohet rehabilitimit. Ne rekomandojmë që të merret në studim edhe mundësia për të rindërtuar sistemin nga e para duke qënë se kostot e ndërhyrjeve për rehabilitim mund të jenë shpesh edhe më të mëdha se realizimi i një sistemi të ri. Si rezultat i relievit karakterizuar nga shpatete të pjerrëta që ka kjo Bashki, problem mbetet bllokimi nga mbetjet e ngurta të cilat shpesh bllokojnë seksionet e kryqëzimit të tubacioneve dhe në zonat e grykëderdhjeve ekzistuese.

Një nga rezultatet e masave të propozuara për zgjerimin e shërbimit në të gjithë zonat e banuara të Bashkisë Fier do të jetë edhe ulja e ndjeshme e numrit të gropave septike. Për rrjedhojë, kjo masë do të sjellë përmirësimin e tokës, rritjen e cilësisë se ujërave nëntokësore dhe uljen e sëmundjeve të shkaktuara si rezultat i mungesës së higjienës. Për më tepër, sistemi i ri i kanalizimeve i ndarë nga sistemi i grumbullimit të ujrave të larta do të parandalojë përmbytjet në zonat urbane dhe ato rurale si edhe do të sjell përfitime ekonomike nëse sistemi do të parashikojë rezervuarë për grumbullimin e ujrave të larta dhe përdorimin e tyre për qëllime sekondare.

Bashkia Fier sigurisht do duhet të ndërtojë një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, i cili ti shërbej pjesës më të madhe të popullsisë në qendrën urbane të Bashkisë si edhe NjA-ve të saj. Propozimi ynë synon që Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane për Bashkinë Fier të synojë grumbullimin masiv të ujrave të ndotura drejt një impianti të përbashkët dhe të ndërtohet pikërisht aty ku është parashikuar (pranë vendepozitimit ekzistues të mbetjeve).

Sipërfaqja e kësaj zone të propozuar për ndërtimin e impiantit është relativisht e vogël gjithashtu edhe pozicionimi gjeografik bie ndesh me dy elementë thelbësor (*distanca*

nga zona e banuar dhe distanca nga trupi ujor natyror) nevojitet që mbi këtë propozim të hartohet një plan i detajuar i veprimit ku të merren në konsideratë masa specifike për mbrojtjen nga shkarkimet aksidentale mbi trupin ujor, trajtimin e llumit aktiv si edhe për zbutjen e ndotjes aromatike në ajër duke pozicionuar impjantin në varësi të trëndafilit të erës si edhe uljen e efektit të ndotjes vizuale nëpërmjet krijimit të zonës buferike mbrojtëse e të veshur me vegjetacion të dëndur e të lartë.

Sigurisht do duhet të parashikohen edhe stacione të ngritjes mekanike pasi relievi nuk favorizon rrjedhje me gravitet të të gjitha zonave të Bashkisë Fier.

Impiantet e trajtimit i klasifikojmë kryesisht sipas nivelit të trajtimit që ofron teknologjia e instaluar.

Impianti i Trajtimi Primar: Ndryshe i quajtur si trajtim mekanik, realizon diferencimin dhe largimin e mbetjeve të ngurta të cilat pluskojnë dhe ato të cilat kanë dekantuar në fund të pondit. Kjo teknologji largon edhe llumin e formuar nga dekantimi. Megjithëse është një teknologji e cila bazohet në trajtimin mekanik, shpesh për të përshpejtuar proçesin e sedimentimit përdoren edhe kimikate.

Impiantet Mekanike reduktojnë nivelin e NBO[458] në ujrat e e ndotura në masën 20-30% dhe diferencojnë 50-60% të mbetjeve të ngurta në këto ujra. Kjo teknike trajtimi në përgjithësi përdoret si fazë fillestare e trajtimit të ujrave ku më pas mund të investohet për rritjen e efikasitet të trajtimit të ujrave me anë të metodave më të specializuara.

Impianti i Trajtimi Dytësor: Këto tipe impiantesh ofrojnë trajtim bilogjik të ujrave të ndotura urbane. Konkretisht ato arrijnë që nëpërmjet mikroorganizmave të konsumojinë të të gjithë lëndën organike ndotëse të tretur në këto ujra. Ky proçes biologjik i shoqëruar edhe me pondet e dekantimit realizon largimin e më tepër se 85% të mbetjeve inorganike ndërkohë që reduktimi i NBO do të realizohen nëpërmjet proçeseve me llum aktiv, sistemet ligatinore, filtra me pikim apo teknikave më bashkëkohore të cilat realizojnë shpërbërjen e lëndës ndotëse organike.

Impianti i Trajtimit Terciar: Në këto impiante krahas përfshirjes së dy sistemeve të mësipërme kemi integrimin e proçeseve kimike të specializuara dhe të mbyllura në të cilën realizohet pastrimi i ujrave të ndotura urbane duke larguar më tepër se 99% të masës ndotëse. Teknologjia e përdorur në këto impiante është mjaft e shtrenjtë qoftë për fazën e instalimit si edhe të mirmbajtjes së tyre, sidomos impiantet të cilat trajtojnë fosforin dhe azotin e tretur.

Vlen të theksohet se për dy tipet e fundit të impianteve, kostot e ndërtimit si edhe ato operimit janë relativisht të larta. Ndikimi në zbutjen konkrete të kostove mund të adresohet tek kostot operacionale ku në rast se sasia e përgjithshme e ujrave të ndotura që do të hyj në trajtim do të reduktohet rrjedhimisht ndikimi do të shfaqet edhe në koston e përgjithshme të trajtimit. Ndaj propozojmë që sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura urbane medoemos të diferencohet nga grumbullimi i ujrave të larta në mënyrë që sasia totale që do të dërgohet në impiant të reduktohet për tu reflektuar kështu edhe në kostot finale. Gjithashtu ky propozim ofron edhe përfitime të tjera duke konsideruar se ujrat e larta (të shiut) mund të depozitohen dhe të përdoren për qëllime dytësore të Bashkisë Fier (larje, vaditje, zjarrfikse etj.)

Figura 235. Harta e sistemit të shërbimit me kanalizime dhe propozimeve të reja, Bashkia Fier.



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Propozimi konkret për Bashkinë Fier do të ishte që të synohet ndërtimi i një Impianti Trajtimi Dytësor, pra një teknologji trajtimi me llum aktiv. Të synohet që pjesa më e madhe e NjA të dërgojnë ujrat e ndotura në një impiant të përbashkët dhe në rast se nga studimet e detajuar kjo mundësi nuk është e favorshme për shkak të kostove ekonomike atherë referuar propozimeve në Masterplanin Kombëtrar i Furnizimit me Ujë dhe Trjatimit të Ujrave të ndotura si edhe nga propozimet konkrete referuar nga ValueADD të përdoren pozicionet e parashikaura në dokumentin e tyre. Këto investime konkretisht do të ishin:

Tabela 126. Investimet e parashikuara për ITUNU, Bashkinë Fier (2016-2040)

Nr.	Njësia vendore që i shërbehet	Popullsia e shërbyer	Niveli i trajtimit	Teknologjia e trajtimit
1	Fier, Levan, Portez, Qender	69,697	Llum aktiv	Afatmesme (2016-2020)
2	Dermenas, Topojë	4,268	Pond Anaerobik	Afatmesme (2016-2020)
3	Frakull, Levan,	2,079	Pond Anaerobik	Afatmesme (2016-2020)

	Qender			
4	Cakran	2,971	Pond Anaerobik + Pellg artificial	Afatmesme (2016-2020)
5	Portez (e pjesshme)	3,736	Pellg artificial	Afatgjate (2021-2040)
6	Levan (e pjesshme)	3,038	Pellg artificial	Afatgjate (2021-2040)

Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

2.2.4 Ndriçimi i mjediseve publike

Aktualisht në Bashkinë Fier ndriçimi publik mbulon 79 akse rrugore, në një shtrirje totale prej 35.22 km linearë. Kjo mbulon vetëm 35% të rrugëve të qytetit dhe një pjesë të papërfillshme të rrugëve në nivel bashkie.

Figura 236. Ndriçimi i propozuar



Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Propozimet e rrjetit të ri rrugor shoqërohen me infrastrukturën përkatëse të shërbimit, përfshirë edhe ndriçimin rrugor dhe atë këmbësor. Në Bashkinë Fier propozohet rehabilitimi, zgjerimi dhe shtimi i 692 km lineare rrugë, nga të cilat 113 km janë shtigje, të cilat do pajisen me ndriçim këmbësor, e pjesa tjetër do pajisen me ndriçues rrugorë, sipas standardeve respektive. Kjo nënkupton një përmirësim të shërbimit të ndriçimit rrugor, duke rritur mbulimin me 230% nga gjendja ekzistuese. Pa ndriçim

mbeten rrugët bujqësore që nuk do shërbejnë si lidhëse kryesore bujqësore dhe shtigjet kodrinore që nuk do jenë pjesë e rrjetit të shtigjeve turistike.

Ndërkaq, sa i takon ndriçimit publik, parashikohet ndriçimi i hapësirave të propozuara si park, apo me përdorim publik, si mëposhtë:

-Parku i Gjanicës

-Parku i Mbrostarit

-Parku i Levanit

-Zona e bregdetit të Pishë-Poros

-Institucionet publike

-Lulishtet e ndodhura në qendër të Fierit

-Qendrat e fshatrave

Etj.

2.2.5 Mbetjet e ngurta

Në mbështjetje të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" si edhe ligjit nr. ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 "Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ngarkon Bashkitë për të hartuar e më pas për të zbatuar "Planin Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve".

Referuar Strategjisë Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Manaxhimit të mbetjeve miratuar me VKM-në nr. 175 dt 19.01.2011: Bashkia Fier, Lushnjë, Divjakë, Patos e Balsh trajtohen si Zona 12 e Mbetjeve. Fieri në planin kombëtar është përcaktouar si zonë strategjike e mbetjeve[459], prej nga rrjedh edhe përgjegjësia e detyrimi i arritjes së objektivave madhorë të Planit Kombëtar si edhe i lind e drejta të hartojë planin rajonal të manaxhimit të mbetjeve[460].

Shërbimi i manaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Fier duhet të shtrijë infrastrukturën e tij në të gjithë territorin dhe të nisë me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve që në pikat e grumbullimit. Propozohet që të hartohet një përditësim i planit lokal të manaxhimit të integruar të mbetjeve për Bashkinë Fier, plan i cili do të konsistojë në:

- Vlerësim i sasisë totale dhe merceologjisë së mbetjeve;
- Zbatimi i skemave të reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve. Vlerësim i potencialit të riciklimit me synim riciklim të 70% të mbetjeve të riciklueshme ;
- Organizimi i shërbimeve dhe operacioneve të Manaxhimit të Mbetjeve për mbulimin e të gjithë Nj.A-ve të Bashkisë Fier për një periudhë 15-20 vjeçare;.
- Rehabilitimi dhe monitorim i vend-depozitimeve ekzistuese;
- Ndërtimi i një landfill-i rajonal si edhe mundësia e ndërtimit të një incerneratori për asgjësimin e plotë të mbetjeve. Të gjitha të shoqëruara me

projektin teknik dhe vlerësimin përkatës mjedisor. Të përfshihen gjithnjë 2 ose më tepër altrenativa ku të përzgjidhet me parimin "Opsioni më i Mirë i Zbatueshëm Mjedisor" OZM;

- Ofrimi i shërbimit të riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve;
- Sistemet e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve;
- Trajtimi i mbetjeve;
- Organizimi i landfill-it;
- Mbetjet inerte dhe të rrezikshme, trajtimi i tyre;
- Mirëmbajtja.

Parashikohet që afati maksimal për ndërtimin e landfill-eve rajonale dhe vend-depozitimeve për mbetjet inerte dhe ato të rrezikshme (jo-urbane) të jetë fundi i vitit 2020, i cili përkon edhe me afatin e vendosur për mbylljen dhe rehabilitimin e të gjithë vend-depozitimeve jashtë kushteve teknike e çdo kriteri higjieno-sanitar. Duke qenë se në Bashkinë Fier ndërtimi i landfill-it duhet ende të kalojë nëpër procese mjaft sensitive, objektivi i lartpërmendur mbetet për t'u vlerësuar.

Ndërhyrje e menjëhershme nevojitet të parashikohet mbi rehabilitimin e vend-depozitimit të mbetjeve në veri të qytetit. Një plan dhe projekt i detajuar inxhinierik duhet hartuar fillimisht për parandalimin e shkarkimeve të shllameve, emetimeve të gazta dhe të vetë mbetjeve të ngurta mbi trupin ujor gjatë rehabilitimit të vend-depozitimit. Sa i përket fazës aktuale ku po realizohet depozitimi i mbetjeve duhet të tregohet vëmendje ndaj çlirimit të gazrave të kompostit në atmosferë.

Masat konkrete:

I. Rehabilitim *in-situ* duke izoluar tabanin dhe të gjithë perimetrin e vend-depozitimit.

II. Zhvendosja e të gjitha mbetjeve të grumbulluara ndër vite për në vend-depozitimin e ri në landfill ose në një Pikë Transferimi[461] të përkohshme e më pas rehabilitimi i zonëns që përdoret sot si vend-depozitim.

Duke vlerësuar distancat e largëta që kanë zonat bregdetare të Nj.A-së Levan, Dermenas dhe Topojë me Fierin ku duhet të ndërtohet *landfilli*-i rajonal, propozojmë që të ndërtohen të paktën tre Stacione Transferimi të mbetjeve urbane për të shërbyer edhe Nj.A-në Cakran. Pra duhet të studiohet mundësia për të përcaktuar nga një zonë specifike për secilën Nj.A (ose pika transferimi kufitare që u shërbejnë dy NjA-ve njëherësh), e cila do të ketë funksionin e vend-depozitimit tranzitor të mbetjeve për këto Nj.A. Në përzgjedhje duhet pasur parasysh që zona të ketë impaktin më të vogël në mjedis për sa i përket karakteristikave gjeologjiko-hidrologjike dhe mjedisit biotik të asaj zone.

Zonat potenciale, të marra si alternativë për ndërtimin e Stacioneve të Transferimit janë:

I. Kufiri midis zonave 1655 & 3015 Bashkia Fier NjA Dërmenas (pranë fshatit Povelçë) me një sipërfaqe afërsisht 11.5ha dhe rreth 3 mmnd[462] .

Koordinata referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 127. Koordinata referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e Pikës së Transferimit.

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19º 26' 30.3083"	40º 43' 46.6123"
UTM Zone 34N	368412.46	4509910.11
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4368490.24	4511845.53
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	452840.20	4510696.54

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 237. Vendndodhja e Pikës së Transferimit propozuar për t'i shërbyer Nj.A-së Dermenas, Topojë dhe Levan.

Burimi: Bashkia Fier & Co-PLAN

Kjo zonë e përcaktuar nuk ndodhet mbi akuiferin e Vjosës, por duke vlerësuar paraprakisht topografinë e zonës, nevojitet që të projektohet një sistemi i drenimit të ujërave të larta i cili duhet të evitojë shkarkime të mundshme në këtë landfill, si edhe përmbytjen e tij në raste reshjesh apo prujresh maksimale, duke patur parasysh se jemi vetëm 3 mmnd.

II. Zona kadastrale 3792 Bashkia Fier Nj.A Cakran, me një sipërfaqe afërsisht 0.5 ha dhe rreth 80 mmnd.

Koordinatat referuese të kësaj zone paraqiten si më poshtë:

Tabela 128. Koordinatat referuese të pozicionit alternativ për ndërtimin e landfill-it rajonal.

Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19º 34' 29.3607"	40º 37' 18.2367"
UTM Zone 34N	379455.84	4497743.34

Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4379538.12	4499673.78
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	464023.82	4498653.49

Burimi: ASIG Geoportal

Figura 238. Vendndodhja e Pikës së Transferimit propozuar për t'i shërbyer NjA-së Cakran.

Burimi: Bashkia Fier & Co-PLAN

Pozicioni gjeografik i kësaj ST-je ndodhet i pozicionuar në rrëzë të kodrave në veri të fshatit Vjosë, ku do të nevojitet një sistem drenimi i cili të largojë ujërat e larta nga ST-ja propozuar.

Paralelisht me masat e lartpërmendura, Bashkia Fier në bashkëpunim me organet e qeverisë qendore të cilat veprojnë në Fier, duhet të përcaktojnë një zonë specifikisht të dedikuar për mbetjet e rrezikshme industriale dhe mbetjet inerte. Ndër kriteret themeltare të cilat duhen respektuar rreptësisht në momentin që merret një vendim për shfrytëzimin e një hapësire teritoriale në funksion të grumbullimit dhe manaxhimit të mbetjeve të rrezikshme janë: distanca me zonën më të afërt të banuar, prezenca e ujërave sipërfaqësore, prezenca e akuiferëve, trëndafili i erës etj.

Ndërsa mbi kriteret e përcaktimit të vend-grumbullimit të mbetjeve inerte duhen patur parasysh kombinimi i tipologjisë së relievit dhe faktorëve atmosferik si shpejtësia dhe intensiteti erërave, prezenca e rrjedhave ujore sipërfaqësore, distanca nga zonat e banuara dhe qendrat turistike etj.

Nevojitet që të gjitha pikat e jashtëligjshme të depozitimit të mbetjeve urbane (*dhe jo vetëm*) t'u nënshtrohen një fushate për mbylljen dhe rehabilitimin e zonave që ato kanë zënë. Me asimilimin e pikave të jashtëligjshme të depozitimit të mbetjeve një masë shoqëruese duhet të vijojë, e cila do të konsistojë në hartimin e një plani veprimi për pastrimin e të gjithë Bashkisë Fier, ku nevojitet gjithëpërfshirja e shoqërisë civile, biznesit dhe administratës publike qendrore e lokale në mënyrë që nëpërmjet një programi 2 deri në 3 mujor, i gjithë territori i Bashkisë Fier të jetë inspektuar dhe pastruar nga mbetjet urbane dhe inerte. Krijimi i pikave të jashtëligjshme të depozitimit të mbetjeve mund të shërbejë si indikator i nevojës për shtrirje më efiçente të pikave të grumbullimit të mbetjeve apo nevojës për Pikë Transferimi.

Duke qenë se mbetjet mund të kthehen në burim fitimi propozojmë që skemat me cikël të mbyllur të manaxhimit të mbetjeve të inkorporohen si më poshtë:

- Çdo zonë bujqësore (Nj.A në bashkëpunim me banorët dhe bashkinë) të përcaktojë hapësirën e grumbullimit dhe kompostimit të mbetjeve organike, si edhe të përpunimit të plehut organik si produkt i këtij procesi.

- Fillimisht në qytet e më pas në të gjithë bashkinë të vendosen konteinierë të dedikuar për mbetjet organike, plastike, qelq – metal. Kjo infrastrukturë i shërben ndarjes në burim dhe funksionimi varet nga informimi i publikut mbi mënyrën e realizimit të ndarjes dhe vlerës së saj. Pra, bashkia duhet të ndërmarrë një fushatë informimi dhe edukimi qytetar mbi ndarjen e mbeturinave, riciklimin dhe ripërdorimin.

- Landfill-i i ri rajonal është studiuar mbi vendndodhjen potenciale dhe përfundimet e deritanishme e pozicionojnë atë në pjesën juglindore të ish-Azotikut në Fier.

- Në landfill-in e ri të parashikohet njësia e dedikuar mbi kontrollin - ndarjen dhe para-riciklimin e mbetjeve në mënyrë që sasia e dedikuar për depozitimin final të jetë e identifikuar dhe sa më e reduktuar në volum.

- Propozohet që në projektimin e *landfill*-it të ri të imponohet përfshirja e skemës së kapjes dhe përpunimit të gazit metan me qëllim prodhimin e LPG-së për përfitim ekonomik.

- Në rast të vënies në funksionim të inçerneratorit duhen monitoruar vazhdimisht nivelet e emetimeve në atmosferë, si edhe të merren masa teknike për djegien e mbetjeve në temperatura mbi 780^{o}C.

2.2.6 Infrastrukturat sociale

Analiza e gjendjes ekzistuese të objekteve sociale, arsimore e shëndetësore dëshmon për një mbulim të mirë të territorit me pjesën më të madhe të tyre. Aspekti i aksesueshmërisë është gjithashtu jo-problematik, duke qenë se pjesa më e madhe e objekteve arsimore e shëndetësore janë pozicionuar në qendrat e vendbanimeve rurale, ose në zona me akses të mirë në qytet.

Qendrat shëndetësore janë subjekt i mirëmbajtjes e rikonstruktimit në gjithë Njësitë Administrative, duke qenë se paraqesin gjendje fizike të degraduar. Nga pikëpamja e kapacitetit numri i tyre është i mjaftueshëm, përveç Fierit, ku nevojiten 3 qendra shëndetësore të tjera. Gjithsesi ky shërbim mbulohet nga poliklinika dhe objektet e tjera të specializuara të karakterit shëndetësor në qytet.

Ndërkaq, spitali rajonal i ri i Fierit, që parashikohet të jetë qendra e kujdesit spitalor për gjithë Rajonin e Jugut, do jetë një pol me impakt shumë pozitiv në bashki. Pozicioni i këtij spitali duhet të jetë i aksesueshëm nga infrastruktura kryesore rrugore, të ndodhet në zonë të arritshme e të izoluar, si dhe të ketë bazën infrastrukturore për menaxhimin e mbetjeve spitalore.

Objektet social-kulturore aktualisht mungojnë ose janë shumë të pakta në bashki. Parashikohet ndërtimi i një qendre multikulturore në secilën qendër të njësive administrative: Çlirim, Dërmenas, Topojë, Libofshë, Mbrostar, Levan, Frakull, Cakran e Portëz. Gjithashtu, në nivel qyteti, rikonstruksioni i teatrit të Bylisit është prioritet për 3-vjeçarin e parë të zbatimit të planit.

Sa i takon objekteve arsimore, ka mungesa në numër kopshtesh, dhe më pak në shkolla 9-vjeçare, sa i takon mbulimit të territorit. Sipërfaqja dhe kapaciteti akademik paraqiten jo problematike në pjesën më të madhe të institucioneve. Propozohen ndërtimet e kopshteve, shkollave 9-vjeçare e shkollave të mesme, si më poshtë:

Tabela 129. Nevoja për objekte arsimore.

	KOPSHTE (parcela minimale 1,000 -1,500 m^2)	**SHKOLLA 9 VJECARE (1,500 - 7,000 m^2)**	**SHKOLLA TE MESME (2,000 -7,000 m^2)**
Fier	Lagjja "Mbrostar"	Lagjja "Afrim i Ri"	
	Lagjja "Afrim i Ri"	Lagjja "Sheq i Madh"	
	Lagjja "Afrim"		
	Lagjja "Sheq i Madh"		
	Lagjja "Sheq i Vogël"		
	Lagjja "Kryengritja e Fierit"		
Libofshë	Havaleas	Adriatik	Hasturkas ose Ndernenas
	Metaj	Metaj	
	Adriatik		
Topojë	Gjokalli		
Dermenas	Mucaj	Sulaj	
	Sulaj		
	Kryegjatë		
	Havaleas		
Levan	Bashkim	Peshtan i Vogël	Pishe/Bashkim/Bocovë/ Bishan
	Peshtan i Vogël		
	Peshtan i Madh		
Frakull	Kafaraj		
	Kashisht		
	Cerven		
Cakran	Cakran	Cakran	
	Korceraj		
	Gjonçë		
	Gjorgos		
Portëz	Portëz	Kraps	Portez
	Kraps		
	Lalar		
	Patos Fshat		

Qender	Daullas		
Mbrostar	Mbrostar Ura		Mbrostar Ura

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Gjithashtu, sa i takon arsimit profesional, parashikohet rikonstruksioni dhe plotësimi me laboratorë dhe bazën materiale të nevojshme për shkollën profesionale industriale dhe atë artistike, si dhe zgjerimi i shkollës profesionale bujqësore "Rakip Kryeziu", plotësimi me laboratorët respektivë, dhe shtimi i një zonë fidanishtesh përkrah saj, për kërkime të aplikuara të fushës.

Objektet që do jenë subjekt rikonstruksioni në periudhën afatmesme janë gjithë objektet në fshatrat Dërmenas, Libofshë, Buzëmadh, Cakran, Varibob, Grecalli, Frakull, Mbrostar e Levan, kopshti në fshatin Darzezë dhe shkolla 9-vjecare në fshatin Fushë, Topojë.

2.2.7 Infrastruktura të tjera publike

- **Furnizimi me energji elektrike**

Qyteti i Fierit furnizohet me energji elektrike nga dy nënstacione elektrike me tension 35/6 kV, të vendosur përkatesisht në anën lindore dhe perëndimore të qytetit, si dhe nje nënstacion 110/35/20 kV. Nënstacioni Fieri/1, i vendosur në anën lindore të tij, është ndërtuar në vitin 1960 dhe furnizohet nga nënstacioni 220/110/35 kVTEC-Fier nëpërmjet linjës 35 kV. Nënstacioni 35/6 kV Fieri/ 2 është ndërtuar në vitin 1992, është vendosur në anën perëndimore të qytetit dhe furnizohet nga Nënstacioni 220/110/ 35 kV Tec-Fier nëpërmjet linjës 35 kV. Nënstacioni 110/35/20 kV është ndërtuar në vitin 2010, në pjesën jugperëndimore të qytetit dhe furnizohet nga linja 110/35 kV Elbasan.

Figura 239. Rrjeti elekrik në qytetin e Fierit



Burimi: Bashkia Fier, PPNV 2013, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

Rrjeti shperndarës i tensionit të mesëm të qytetit të Fierit, është me tension 6 kV dhe pjesërisht 20 kV(tre Fidera 20 kV). Rrjeti i tensionit të mesem 6 kV midis n/ stacioneve është i shtrirë në hapësirë me një gjatësi rreth 56 km, i përberë nga 32 km linja ajrore dhe 24 km linje kabllore. Përbëhet nga 17 fidera të tensionit të mesëm 6 kV që furnizojnë rreth 227 kabina transformacioni me fuqi të instaluar të përgjithshme 57 420 kVA. Rrjeti i tensionit të mesëm 20 kV me një gjatesi 2.7 km tërësisht kabllor (Cu3x185), furnizon 22 kabina me fuqi të instaluar 9 000 kVA.

Jo i gjithe territori i Bashkisë Fier mbulohet me rrjet elektrik. Veçanërisht problematike janë zonat kodrinore dhe ato bregdetare të papopulluara e të pazhvilluara, si dhe disa territore në afërsi të qytetit, si në kodrat e Radostinës, Petovës, etj. Përgjatë bregdetit situata e furnizimit është shqetësuese në Darzezë dhe Seman, në drejtim të stacionit të TAP, si dhe në zonën e plazhit të Libofshës.

Figura 240. Linjat e tensionit të lartë dhe nënstacionet elektrike, Bashkia Fier



Burimi: OSHEE, 2016

Në përgjithësi territori i bashkisë furnizohet nga linja të tensionit të mesëm 6,10 dhe 20 kV, ajror dhe kablor. Po kështu edhe transformatorët e kabinave të transformimit janë në këto tensione dhe të fuqive të ndryshme.

Linjat e tensionit të ulet (0,4kV) janë ajrore, me tel ose me kabëll, si dhe kabllore tokësore.

Perspektiva e zhvillimit është që brenda vitit 2017, të paktën brenda unazës së madhe të Fierit të ndërtohet rrjeti i ri 20 kV si dhe linja të reja TU. Kurse brenda vitit 2018,

me mbështetjen e Bankës Botërore, do te zhvillohet rrjeti në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë edhe fshatrat përreth, me linja tensioni të mesëm 20 kV dhe të linjave të reja të tensionit të ulët. Prioritet merr furnizimi i zonës së bregdetit, për mbështetje të zhvillimeve turistike në të.

- **Komunikimi elektronik**

Në territorin e Fierit ushtrojnë aktivitetin disa operatorë të telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme. Telefoni fikse: Albtelekom sh.a , telefona me kartë (operator kombëtar me kapacitet të rrjetit të parë prej 9100 numrash). Operatorë privatë të zonave rurale: “ Eden”, “ Iva Elektronik”, “Rezart 1”, “Rezart 2”.

Telefonia e lëvizshme celulare, si në të gjithë territorin e Shqipërisë, drejtohet nga katër operatorë: VODAFONE, PLUS, EAGLE dhe T-Mobile.

Figura 241. Rrjeti i telefonisë, nivel qyteti



Burimi: Bashkia Fier, PPNV 2013, Përpunoi: Co-PLAN, 2015

- **Mbrojtja kombëtare, civile e kundër zjarrit**

Mbrojtja nga zjarri është një shërbim që kalon tërësisht në varësi të bashkisë, pra përfshirë mjetet e asetet dhe stacionet e MZSH-së, sipas ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Sipas këtij ligji, bashkitë duhet të plotësojnë infrastrukturën dhe ekipet përkatëse deri në vitin 2018. Për bashkinë e Fierit, nisur nga stadardet minimale që vendos ligji për këtë infrastrukturë, duhet që të ketë të paktën 1 zjarrfikës profesionist për 1,500-2,000 banorë dhe jo më pak se 14 profesionistë zjarrfikës për një stacion MZSH. Për pasojë, bazuar në rritjen e popullsisë sipas Gjendjes Civile (216 061 banorë), në bashki, duhet të jenë të paktën

108 zjarrfikës profesionistë dhe të paktën 7-8 stacione MZSH. Sigurisht, kjo vlerë përllogaritet me popullsinë sipas Gjendjes Civile për vitin 2031, ndërkohë që bashkia duhet të përgatitë një plan pune për të shtuar gradualisht numrin e zjarrfikësve dhe stacioneve MZSH, të cilin mund ta rishikojë çdo tre vjet, në varësi të ndryshimeve që ndodhin në popullsi. Për shkak se shërbimi është dinamik dhe numri i punonjësve ndryshon sipas popullsisë, vendndodhja e stacioneve nuk mund të përcaktohet në këtë moment kohor, por është subjekt i zbatimit të Planit në kohë. Në çdo rast, nevojitet që të paktën 2 stacione të ndodhen në qytetin e Fierit, dhe të tjerët të shpërndahen për të mbuluar zonat rurale".

Aktualisht, në Bashkinë Fier funksionon vetëm një stacion zjarrëfikëseje, i cili ndodhet pranë institucionit të Prefekturës, në qytetin e Fierit.

Sa i takon mbrojtjes kombëtare, numri i pronave publike të dedikuara mbrojtjes civile, sipas AITPP (2015), është 98, me një sipërfaqe totale prej 252,319m2, rreth 5 % të totalit të pronave publike në bashki. Aktualisht bashkia i ka evidentuar këto zona, por për shkak se ato përbëjnë informacion të klasifikuar shtetëror, bashkia nuk mund të ndërhyjë në këtë lloj infrastrukture me propozime në nivel vendor. Për momentin, në dijeni të bashkisë nuk ka zhvillime të reja për zona të tilla."

Për sa i përket emergjencave civile, merren një sërë masash që lidhen me përmbytjet, rrëshqitjet dhe erozionin, ujërat e larta etj. Në mënyrë të detajuar këto masa infrastrukturore paraqiten në seksionin 2.3 të këtij dokumenti.

- **Administrimi i burimeve natyrore e kulturore**

Në lidhje me administrimin e burimeve natyrore, ky dokument trajton një sërë masash që i adresohen mbrojtjes së biodiversitetit, trajtimit të peizazhit, mbrojtjes kundër efekteve negative të përmbytjeve, dukurive gjeologjike, ruajtjes e shmangies së ndotjes së shkaktuar nga faktorë njerëzorë, etj. Disa nga këto masa janë:

-Krijimi i zonës ripariane të Semanit e Vjosës, në një gjerësi mbi 200 metra nga bregu
-Ripërtëritje të nënpyllit në ekonomitë pyjore të Levanit, Topojës dhe Libofshës
-Ndërtimin e veprave inxhinierike me karakter shuarës energjie përgjatë shtratit të lumit Vjosë dhe Seman
-Krijim i ishujve vegjetativë në token bujqësore, për të përthithur një pjesë të lëndëve ushqyese që burojnë nga plehu kimik
-Mirëmbajtje e sistemeve të kullimit e vaditjes
-Shtim të sipërfaqes së zonave të mbrojtura, etj.

Sa i takon burimeve kulturore, masa janë marrë veçanërisht në lidhje me Parkun Arkeologjik të Apollonisë, në përputhje me rregulloren e Planit të Menaxhimit të tij.

Më tepër detaje në lidhje me administrimin e burimeve natyrore e kulturore, gjenden në seksionin 2.3 të planit mjedisor dhe në masat e VSM-së, ne kapitullin 6 të saj".

2.3 Plani për mbrojtjen e mjedisit

2.3.1 Mbrojtja e tokës

- **Fenomenet e rrezikut gjeologjik**

Rrëshitjet/rrëzimin e gurëve: Në Bashkinë Fier, problemet me rrëshitjet/rrëzimin e gurëve evidentohen më tepër në zonat kodrinore për pasojë të shpyllëzimit, mosmenaxhimit të tokave e pyjeve dhe ndërhyrjeve të ndryshme. Me qëllim përmirësimin e gjendjes së territorit në zona ku ndodhin këto fenomene (shih hartën në analizën e thelluar të territorit) rekomandohet të merren masa mbrojtëse për të parandaluar këtë fenomen. Ndër masat kryesore përmendim:

- Hartimin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve: Për fenomenin e rrëshqitjes si pasojë e shpyllëzimeve pa kriter në këtë Bashki rekomandohet të merren masa në mënyrë emergjente nëpërmjet hartimit të Planit të Mbarështrimit. Bashkia mund të marrë masa paraprake duke mbjellë pemë dhe bimë të ndryshme në këto zona. Struktura pranë Bashkisë ndjek dhe mbikqyr punën për përmirësimin e zonave tek të cilat ka ndodhur proçesi i rrëshqitjes, detyrim ligjor i cili i vjen nga ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor.

- Kufizimi i sipërfaqeve që kalojnë nga tokë pyjore në tokë bujqësore: Një faktor tjetër, që duhet përmendur përsa i përket rrëshqitjeve është dhe shndërrimi i tokave pyjore në bujqësore duke tjetërsuar kështu morfologjinë e tokës në të cilën ndodh. Rekomandohet që Bashkia të mos miratojë kërkesa për kalimin e tokës pyjore në tokë bujqësore në zonat ku shihet dukshëm krijimi i këtij fenomeni.

Erozionit në zonat pyjore: Sa i përket erozionit në zonat pyjore, gjëndja paraqitet problematike si pasojë e shpyllëzimit, shfrytëzimit pa kriter dhe dëmtimit të bimësisë së ulët, në veçanti në zonën e Lumasit. Rekomandohet që Bashkia të marrë masa specifike për për ruajtjen e këtyre zonave si:

- të hartojë Planet e Mbarshtrimit të Zonave Pyjore: Zonat më problemtike ndaj këtij fenomeni shfaqen: brigjet e lumenjëve Vjosë dhe Seman, brigjet e lumit Gjanicë(në Objektin Mali i Cakranit, Kurora e Semanit, Argjinatura e Lumit Seman, etj. ku ka patur shpyllëzime dhe kullotje pa kriter)

- Ripërtëritje e bimësisë së ulët (ripërtëritja e nënpyllit) në ekonomitë pyjore të Levanit, Topojës dhe Libofshës me qëllim mbulimin e tabanit të tokës e si rrjedhojë, parandalimin e erozionit

- Disiplinimi i rrjedhës së ujërave të bardha në pyll: Stabilizimi i zonave pyjore nën ndikimin e erozionit në të cilat ka patur gërryerje të sipërfaqes të cilat kanë çuar në krijimin e kanaleve ujore të parregullta dhe të pakontrolluara

- të marrë masa për sistemimin e shtretërve të lumenjëve, ndërtimit të veprave inxhinierike me karakter shuarës energjie përgjatë shtratit të lumit Vjosë dhe Seman dhe krijimin e zonave ripariane përgjatë lumenjëve që përshkojnë Bashkinë dhe krijojnë probleme me përmbytjet e tokave përreth.

Erozionit në zonat fushore: Zonat fushore atë të Myzeqesë të Bashkisë Fier përshkohen nga një rrjet i dendur sistemi ujor, që nga kanalet vaditëse dhe kulluese deri tek përrenjtë dhe lumenjtë e duke shkaktuar përmbytje të herëpashershme të tokave përreth në rast shirash. Si një problematikë e rëndësishme rekomandohet që:

- të merren masa për përmirësimin e sistemit ujitës dhe kullues duke i pastruar dhe duke i përmirësuar si dhe duke i rehabilituar ato.

- të merren masa për përmirësimi e zonave riparane në mënyrë, që të minimizohet rreziku i përmbytjes së këtyre tokave me qëllim parandalimin e përmbytjes së tokave përreth lumenjëve.

- Futja e praktikave të mira bujqësore si punimi i tokës duke e trazuar sa më pak atë që parandalojnë erozioin. Këto janë mënyra të cilat parashikojnë lënien e më shumë se 30% të mbetjeve bimore të kultivimeve të mëparshme në sipërfaqen e tokës me qëllim mbrojtjen nga erozioni dhe shtimin e plehut organik

- Shmangia e lënies së tokës të zhveshur ose pa bimësi ndërmjet të mbjellave ose gjatë stinës së kultivimit.

Përmbytjet: Rreziku i përmbytjes me rikthim 100-vjeçar në Bashkinë e Fier parashikohet të shkaktohet nga lumi i Devollit ndaj dhe rekomandohet që:

- të përditësojë Planin e Menaxhimit të Përmbytjeve me rikthim 50-vjeçar. Planet e sotme janë të vitit 2003 dhe nuk marrin parasysh ndryshimet e regjimit të reshjeve dhe fenomeneve të tjera klimatike në dhjetëvjeçarin e fundit.

- të hartohet një plan menaxhimi në rast përmbytjesh me rikthim 100-vjeçar. Fillimisht rekomandohet të bëhen studime për të përditësuar përmbytjet në Bashki.

- Rrezik për përmbytjet paraqet edhe mbushja e digave ujëmbajtëse me materiale që sjell lumi duke ulur kapacitetin e tyre mbajtës.

- të hartoje dhe zbatojë Plane Veprimi për pastrimin e digave nga materialet e depozituara në to me qëllim shmangien e përmbytjeve.

- **Mbrojtja e tokës bujqësore**

Erozioni në toka bujqësore: është një tjetër fenomen që prek territorin e Bashkisë Fierit për pasojë të një sërë shkaktarësh, si përdorimi i tokës dhe shpyllëzimet. Përgjithësisht, në territorin fushor të Bashkisë (pjesa perëndimore) vihet re keqmenaxhimi i tokës duke ndjekur praktika jo të mira për përdorimin e saj. Përdorimi i tokës nga bujqësia ka shkaktuar probleme me erozionin. Ndaj rekomandohet që Bashkia:

- të hartojë Plane Veprimi për Informimin e Bujqërve për Punimin e Tokës duke ndjekur politika më të mira, si punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit etj.

- Për problemet me **erozionin**, të drejtojë dhe të mbikqyrë punën për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7. Po sipas të njëjtit ligj, Bashkisë së Fierit i rekomandohet që të marrë nisma për shtimin e sipërfaqeve pyjore dhe ripyllëzimin e këtyre sipërfaqeve në zonat e braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera (Nenit 27).

- Të ruajë tokën bujqësore nga ndërtimet: Bazuar në ligjin Nr.9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" Neni 10 Bashkia e Fierit është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme në funksion të **ruajtjes** së tokës bujqësore.

Veprimtari të tilla si ndërtimi mbi tokë bujqësore ndalohet në bazë të Nenit 14 të këtij ligji.

- <u>të ndalojë çdo zënie ose përdorim të paligjshëm të tokës</u> në teritorin e saj në zbatim të Ligjit nr. 7501 "Për Tokën" i ndryshuar, Neni 21. Për këtë arsye, rekomandohet Bashkia e Fierit që të marrë masa për shembjen e të gjithave ndërtesave të paligjshme në tokë bujqësore.

- Duke ju referuar Ligjit nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e Kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte" Nenit 19, Bashkisë i del për detyrë që të bashkëpunojë me bashkitë e tjera për të përcaktuar vendin e venddepozitimit rajonal dhe për mënyrën e funksionimit të tij. Në këtë formë Bashkia e Fierit eleminon përmbytjen e tokave nga lumi Seman.

2.3.2 Mbrojtja e peizazhit, biodiversitetit dhe hapësira e gjelbër

- **Masa për mbrojtjen e peizazhit**

Masat parandaluese të propozuara më poshtë, vijnë si rrjedhojë e analizave të bazuara në dokumentacionin përkatës ligjor e zyrtar, vizitat në terren, leximi dhe interpretimi i ortofotos 2015 dhe *Google Imagery*, hartave të tipologjive të peizazhit, si dhe elementeve përbërëse të secilit peizazh të identifikuar në territorin e Bashkisë. Peizazhi i qytetit të Fierit përbëhet nga një sërë komponentësh peizazh-formues, të cilët kategorizohen në pesë fasha: ***urbane, industriale, rurale, natyrore*** dhe ***ujore***. Të pesta tipologjitë e peizazhit kanë karakteristikat e veta, por në shkallë territori ato formojnë "*Mozaikun*" peizazhistik të Bashkisë Fier.

<u>*Peizazhi Urban*</u>

Masat mbrojtëse të këtij peizazhi janë ruajtja e struktures së ***pemëve përgjatë rrugëve***, pra nëse aksi rrugor karakterizohet nga pemë kumbulle të kuqe, që ka rezistuar në kohë dhe i është përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe mundësisht të jenë të së njëjtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur "*formalitetin*" që e karakterizon këtë peizazh. Zgavrat e bordurat ku pema qëndron duhet të jenë të së njëjtës madhësi, ngjyre dhe materiali mbulese. Kjo e fundit duhet të ketë çarje të mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit në rrënjë, por të mos pengojë ecjen mbi to. Gjithashtu duhet të jetë e lëvizshme për qëllime mirëmbajtjeje. Mirë është që të përdoren mbulesat dhe zgavrat të mos lihen të çara e me bordurë sepse, veçanërisht në rrugët me trotuare të ngushta (1-2 m), pemët kthehen në pengesë serioze për ecjen e kalimtarëve.

Nëse vendoset të rimbillen apo nëse nuk kanë bimësi atëherë ajo të zhvendoset, atëherë bimët duhet të jenë ose të të njëjtit lloj, ose me një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur, që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, diversiteti në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qëndrojnë të pandryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.

Në zona park e hapësira të tjera publike ku do të mbillen pemë, karakteri formal i këtij peizazhi mund të thyhet nga pemë të mbjella rresht e të të njëjtit lloj, në pemë të së njëjtës familje (gjethore, halore, shkurre), por të mbjella në grupime – pra grupe me nga 3 apo 5 pemë në varësi të hapësirës. Gjithsesi, në zonat park, projektuesit e peizazhit kanë liri në përzgjedhjen e formacioneve, për sa kohë që: zgjedhin bimë vendase apo të përshtatura për një kohë shumë të gjatë në territorin e qytetit/bashkisë së Fierit; i vendosin në mënyrë të tillë që të garantojnë hije në verë dhe depërtim të dritës së diellit në dimër; bëjnë të mundur krijimin e zonave me bar dhe jo vetëm lule ose tokë nën hije ku nuk mund të rriten bimët; krijojnë mikroklima të ndryshme brenda parkut; sjellin shumëllojshmëri bimësh që ofron informacion shkencor bazik edhe për përdoruesit e parkut; garantojnë që bimësia e përzgjedhur përmirëson cilësinë e tokës dhe rrit aftësinë filtruese e infiltruese të saj.

Ndonëse parqet në Bashkinë Fier kanë tipologji të ndryshme, një që duhet t'i kushtohet vëmendje është edhe ajo "xhep". "*Xhepat Urbanë*", ose thënë ndryshe hapësirat boshe, të patrajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit fshehin një potencial të madh në trajtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standarde dhe se është vetë elementi i përdorur në të i cili nëpërmjet funksionit që ofron edhe në një hapësirë relativisht të vogël, sërish ofron një shumëllojshmëri aktivitetesh e mjedisesh. Po si hapësirat e tjera park, edhe këto xhepa ofrojnë tipologji të ndryshme sipas vendndodhjes. Pra këto xhepa mund të trajtohen sipas nevojës së komunitetit. P.sh. nëse ato gjenden në një lagje ku komuniteti e ka të nevojshme të ketë një kënd lojrash atëherë edhe tipologjia që xhepi mund të marrë do të jetë pikërisht kjo. Këto xhepa mund të trajtohen si zona relaksuese me aktivitet të ulët si kopështe fluturash ku bimët e mbjella janë të tilla në mënyrë që të tërheqin fluturat dhe zogjtë e këngës si gardelinat dhe njëkohësisht mund të ofrojnë edhe stola ku njerëzit mund të ulen e të vëzhgojnë fluturat e shpendët pa i shqetësuar, si dhe me aktivitet të lartë si hapësirë parkimi e trajtuar me bimësi të ulët e pemë autoktone me mirëmbajtje minimale.

Tipologjitë e pemëve dhe roli i tyre në peizazh

Sistemi degëzor, drusor mbi tokë dhe kurora e një peme përcakton edhe vetë formën e përgjithshme të saj. Disa forma pemësh janë më të përshtatshme se të tjerat për një peizazh specifik. Dhe, forma është ajo e cila ndikon në sasinë e vëllimit që pema do të zërë. Disa forma të zakonshme pemësh përfshijnë atë: ***ovale***, ***të rumbullakët***, ***kolonë***, ***piramidë***, dhe ***vazo***.

Pemët ***ovale*** si plepi (*Populus Alba*) përshtaten më së miri në rrugët e qytetit pasi ato rriten përsëgjati dhe nuk pengojnë trafikun e automjeteve ngjitur me to. Për shkak të rritjes së tyre përsëgjati, ato mund të mbillen në afërsi të ndërtesave ndryshe nga pemët me rritje gjerësore. Por, këto pemë mund të arrijnë lartësi të mëdha (+45m) dhe mbjellja e tyre mund të ndikojë tek infrastruktura nëntokësore.

Pemët e ***rrumbullakëta***, si pisha e butë (*Pinus Pinea*) kanë tendencën të përhapen në gjerësi, se sa të ndjekin "liderin" në lartësi ndaj krasitja e tyre në periudhën e rritjes është e rekomandueshme për të mos penguar trafikun. Mbjellja e këtyre pemëve në qendër të qytetit ku densiteti i ndërtimit është edhe më i lartë, duhet të marrë në konsideratë distancën mes pemës dhe ndërtesave pasi zhvillimi horizontal i kësaj

peme kërkon një distancë të madhe mes pemës dhe ndërtesave, në qoftë se ajo është për t'u rritur në formë të natyrshme duke minimizuar edhe krsitjen.

Pemët në formë ***kolone***, si selvia (*Cupressus sempervirens*) zakonisht kanë degë të shkurtra, të forta dhe të ngushta të cilat ngrihen në lartësi. Këto pemë vlerësohen për gjerësinë e tyre të ngushtë e cila i mundëson atyre të mbillen në hapësirat e ngushta, ku nuk ka vend të mjaftueshëm për një pemë me një strukturë të përhapur.

Pemët në formë ***piramidale***, si bredhi i bardhë *(Abies alba)* e nisin zhvillimin në formë kolone dhe me moshë degët më të ulëta marrnin zhvillim dhe ulen nën peshën e tyre. Shumë pemë në këtë kategori kanë një degë të vetme dominuese nga e cila rriten degët anësore. Ndonëse pemët halore si pisha e bredhi ilustrojnë më së miri formën piramidale, ka edhe shumë pemë gjethegjerë në këtë kategori.

Pemët në formë ***vazore***, si lofata *(Cercis siliquastrum)* dhe ginko *(Ginkgo Biloba)* mund të jenë më të përshtatshme për t'u mbjellë në rrugët e qytetit pasi rriten lart dhe hapen përsëgjeri. Këto forma pemësh kanë tendencën të harkohen mbi rrugë dhe trotuare duke i hijëzuar ato dhe njëkohësisht duke ruajtur pastërtinë vizuale dhe lartësinë e nevojshme pët të mos penguar rrugë-kalimin e automjeteve.

Propozimet në vijim për bimët më të përshtatshme për peizazhe të ndryshme brenda territorit të bashkisë Fier janë bazuar tek parimet teknike dhe estetike më sipër ku forma e pemës ndikon drejtëpërsëdrejti tek peizazhi specific, por edhe tek roli që bima ka në mjedisin ku mbillet.

Bimë të përshtatshme, por jo të vetmet, për qytetin e Fierit janë:

Lofata *(Cercis siliquastrum)* - Dru i vogel gjetherënës, mjaft i vlerësuar në periudhen e lulëzimit (prill-maj) për lulet mjaft dekorative të cilat çelin përpara gjethëzimit. Ideale për t'u mbjellë në grupime apo edhe në rresht në rrugët dytësore të qytetit pasi duron mirë ndotjen urbane.

Lagestromia *(Lagerstroemia indica)* - Nuk ka kërkesa specifike për tokën, duron vendet gjysmë të hijëzuara por preferon diellin. Ideale për t'u mbjellë në grupime treshe në lulishte, parqe, dhe zona bregdetare. Vlera dekorative e kësaj bime mbizotëron në zonën urbane ku mbillet.

Kumbulla e Kuqe (*Prunus cerasifera*) – Bimë dekorative me rritje të shpejtë por jetëgjatësi të shkurtër. Kumbulla përshtatet dhe kombinohet më së miri me gjethet e hirta të ullirit në kombinime me nga tre në parqe apo edhe rresht në rrugë e rrugica të territorit.

Ulliri i egër (*Olea europaea*) – Dru tipik i klimës mesdhetare, ideal për rrugë, rrugica e shëtitore.

Rrapi (Platanus occidentalis) – "Loja" mes hijes dhe dritës që luan kurora e lartë dhe shpërhapur e drurit në një zonë urbane mund ta kthejë shumë shpejt atë zonë në një pike referimi "landmark". Preferon zonat hidrofile të territorit.

Pisha e Butë (*Pinus Pinea*) – Bimë e përshtatur më së miri në masivet pyjore të territorit por e vyer për parqet e qendrat urbane pasi bima është shumë efektive për thithjen e gazrave dhe tymrave qytetas.

Dafina *(Laurus Nobilis)* – Me gjethet të qëndrueshme, aromatike, të lëmuara, e me shkëlqim, dafina mbetet lloj tipik i drurit të klimës mesdhetare. Shumë e qëndrueshme ndaj thatësirës, dritëdashëse por rritet edhe në zona të hijëzuara.

Ginko *(Ginkgo Biloba)* - Druri është rezistent ndaj ndotjes dhe dëmtuesve, apo dhe kushteve të këqija të tokës, e si pasojë mund të përdoret gjerësisht në zona urbane pasi përshtatet gati në çdo lloj temperature si dhe vlerësohet për anën dekorative. Bima nuk është autoktone e Fierit, por është përshtatur me kushtet e zonës urbane.

Bimë të përshtatshme për qendrat e banuara në zonat rurale, por jo të vetmet, janë:

Pisha e Butë (*Pinus Pinea*) – Bimë efektive për thithjen e gazrave dhe tymrave specifikë e cila është përshtatur më së miri në masivet pyjore te bashkisë, por gjendet edhe i veçuar në parqet e qendra urbane të territorit. Tolerant ndaj krasitjes, por nga dora e specialistëve.

Rrapi *(Platanus orientalis)* – Gjendet në zona hidrofile të territorit dhe buzë përrenjve dhe lumit Gjanica. Ripërtëritja natyrale e bimës lehtëson rimbjelljen në zona të ndryshme.

Plepi *(Populus alba)* – Dru autokton në territor i cili kombinohet mirë me pemë të tjera si shelgu, eukalipti dhe akacia. Gjethet e gjelbëra me të bardhë të bimës e bëjnë atë një pemë efektive dekorative për peizazhin industrial. Rrënjët mund të shkaktojnë probleme në disa situata ndaj duhet të mbillet në distancë nga objektet e zonës. Plepi është shumë tërheqës kur mbillet në sipërfaqe të hapura si livadhe të krijuara pë të thyer imazhin industrial. Për shkak të sistemit të gjerë rrënjor dhe tolerances ndaj kripës, mund të vendoset edhe për të forcuar dunat ranore bregdetare apo si barrierë ndaj erërave.

Shelgu *(Salix species)* – Përshtatet më së miri në terrene me lagështi si përgjatë brigjeve të lumenjve e trupave të tjerë ujorë sipërfaqësorë në afërsi të zonës industriale. Rrënjët e shelgut janë tepër të fuqishme dhe gjithnjë në kërkim të lagështisë ndaj kjo veti duhet marrë parasysh nëse zona ku ato do të mbillen ka edhe ndërtesa në afërsi. Në anën tjetër rrënjët e fuqishme të bimës kanë një rol stabilizues në brigjet e lumenjve nga erozioni.

Eukalipti *(Eucalyptus)* – Pemë me rritje të shpejtë dhe sistem rrënjor ideal për stabilizimin e brigjeve të trupave ujorë, reduktimin e ujërave nëntokësore, lëngjeve ndotës nga aktivitetet industrial, shkripëzimin e dherave dhe si barrierë ndaj erërave. Duhet mbajtur në kontroll nëpërmjet krasitjes së degëve të sipërme, pasi njihet për shkëputjen e tyre të papritur. Bima është tepër e etur për ujë ndaj do mbjellë me kujdes per të shmangur tharjen e tokave të cilat i përkasin kulturave bujqësore.

Krasitja e shkurreve apo bimëve të ulëta mund të ndahet në dy forma; ***natyrore*** dhe ***gjeometrike***. Krasitja *natyrore*, e cila karakterizohet nga shkallëzimi i bimëve dhe ajrimi, aplikohet në parqe apo në zona ndarëse të dy tipologjive peizazhi si rripat e gjelbër mes një trupi ujor e rrugës së kalimit, apo mes shinave të trenit dhe autostradës apo zonës bujqësore. Imazhi i krijuar nga kjo tipologji krasitjeje përcjell diversitet biologjik mes situatës urbane dhe natyrës. Ndërsa krasitja *gjeometrike* karakterizohet nga format e pastra gjeometrike, të cilat aplikohen tek bima. Kjo krasitje gjendet zakonisht në kopshtet publike dhe oborret e objekteve institucionale apo të shërbimeve. Imazhi i krijuar nga kjo tipologji krasitjeje përcjell formalitet dhe rregull, ku bima vlerësohet më shumë për dizajnin që i ofron situates urbane kundrejt rolit në ekosistem. Zgjedhja mbetet në varësi të imazhit që NjA-ja do të përcjellë apo nevojës që ka për të adresuar. Në përgjithësi pemë të peizazhit urban preferohen të jenë pemë autoktone me kurorë të gjerë për hijëzim dhe dritë dielli në dimër.

Në peizazhin natyror *trupat ujorë* luajnë një rol të rëndësishëm si korridore kalimi nga një fashë peizazhistike në tjetrën, ndërkohë brenda peizazhit urban ato kanë një rol jetik në rritjen e shëndetshme të bimësisë së egër dhe të mbjellë (dekorative), parandalimit të përmbytjeve dhe freskimit të ajrit në sezonin e nxehtë. Por në mënyrë që ky *shërbim ekosistemi* të funksionojë qasja e manaxhimit të tyre duhet të ndryshojë nga ajo inxhinierike në atë ekologjike. Që do të thotë se manaxhimi i trupit ujor duhet të tentojë të "mbajë" ujin sa më shumë të jetë e mundur në qytet e jo t'i përshpejtojë rrjedhën nëpërmjet "*kanalizimit*" (veshjes së shtratit dhe anëve të tij me beton). Ndaj edhe plani propozon ruajtjen e ujrave të shiut në tokë, duke i mbajtur ato larg kanaleve kulluese nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të depërtueshme (si pllakat poroze në zona parkimi) dhe krijimit të sipërfaqeve ujëmbajtëse.

Figura 242. Shpërndarja e ngadaltë e ujit në territor kundrejt largimit të shpejtë



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016.

Diagrama konceptuale më sipër e lumit Gjanica tregon se si shtrati i lumit është "***valëzuar***" dhe "***thelluar***" në seksione të ndryshme (për të ngadalësuar rrjedhën), "***shkallëzuar***" (për filtrim dhe infiltrim më të mire duke ofruar gjithashtu edhe zona rekreative si rrugica shëtitëse si dhe aktivitete të ndryshme sezonale si pika peshkimi, apo vrojtimi të jetës së egër), dhe shpërndarë e mbajtur në "***zona ujëmbajtëse***" si kopshtet e shiut (*rain gardens*) apo edhe sipërfaqe të tjera të cilat mund ta mbajnë këtë sasi uji duke lejuar filtrimin dhe infiltrimin e ujit në akuiferin nëntokë.

Figura 243. Struktura e Kopshtit të Shiut.



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016.

Kopshtet e shiut mund të ndikojnë në mikroklimën e qytetit, mund të zënë hapësira shumë të mëdha e deri tek ato më të vogla sa një vend parkimi për makinën. Këto kopshte ndihmojnë edhe në mbrojtjen e kafshëve e shpendëve të cilat e përdorin këtë mjedis duke përfituar nga ushqimi, mbrojtja dhe zonat e riprodhimit që ofrohen në këto kopshte. Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëra dhe manaxhimi në tërësi i tyre nga bashkia lehtësohet, pasi kostoja e vaditjes minimizohet për shkak të ujit të akumuluar nëpërmjet kësaj qasjeje ku si pasojë edhe ritmi i zhvillimit të bimëve shtohet. Disa bimë drusore si shelgu (*Salix*) jo vetëm që përshtatet më së miri me këto zona por krijon edhe hapësira shlodhëse të hijezuara për qytetin si dhe nëpërmjet shëndetit të pemës, specialistët e gjelbërimit në bashki mund të kuptojnë edhe shëndetin apo sasinë e ujërave nëntokësore pasi thatësinë e dheut shelgu e shfaq nëpërmjet ngjyrimit të gjetheve.

<u>*Peizazhi industrial*</u>: Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijezuar hapësira parkimi, apo publike. Nje element ndihmës në përmirësimin e këtij peizazhi janë ***perdet e gjelbra*** dhe grupet e ***pemëve bllokuese (zona tampon)*** të cilat bllokojnë elemente të padëshiruara të këtij peizazhi. Ato zbutin ndikimet negative në mjedis, edhe në zbatim të ligjit për brezat mbrojtës, por edhe zbutin imazhin e "**thatë e armiqësor**", që shpesh herë i karakterizon zonat industriale. Veçanërisht disa nga pemët, krijojnë edhe ***pika referimi*** "*landmarks*" si pemët shumëvjeçare të rrapit përgjatë rrugës për në Qafë të Koshovicës. Në zonë industriale duhet të përdoren edhe bimë që i përshtaten ndotësve që mund të ekzistojnë aty, llojit të tokës, herë shumë acid e herë shumë bazik, dhe që asimilojnë një pjesë të ndotjes, duke moslejuar depërtimin e saj në tokë e ujë. Pemët gjethegjera dhe me push janë të preferueshme sepse thithin ajrin e ndotur.

Bimë të përshtatshme për zonat industriale në Fier janë:

Shelgu *(Salix species)* – Përshtatet më së miri në terrene me lagështi si përgjatë brigjeve të lumenjve e trupave të tjerë ujorë sipërfaqësorë në afërsi të zonës industriale. Rrënjët e shelgut janë tepër të fuqishme dhe gjithnjë në kërkim të lagështisë, ndaj kjo veti duhet marrë parasysh nëse zona ku ato do të mbillen ka edhe ndërtesa në afërsi.

Eukalipti *(Eucalyptus)* – Pemë me rritje të shpejtë dhe sistem rrënjor ideal për stabilizimin e brigjeve të trupave ujorë, reduktimin e ujërave nëntokësore, lëngjeve ndotës nga aktivitetet industriale, shkripëzimin e dherave dhe si barrierë ndaj erërave. Duhet mbajtur në kontroll nëpërmjet krasitjes së degëve të sipërme nëse është për t'u mbjellë në afërsi të ndërtesave pasi njihet për shkëputjen e tyre të pa pritur. Bima është tepër e etur për ujë sa së bashku me ujin mund të thithë edhe lëngjet e ndotura të krijuara nga aktivitetet ndotëse të industrive apo zonave të vend-depozitimit të mbetjeve. Eukalipti është veçanërisht efektiv në sekuestrimin e karbonit (C).

Akacia *(Acacia)* – Pemë azot-ndreqëse shumë efektive në sekuestrimin e karbonit. Me rritje dhe përhapje të shpejtë si dhe rezistencë të lartë ndaj zjarreve.

Plepi (*Populus alba)* – Dru autokton në territor i cili kombinohet mirë me pemë të tjera si shelgu, eukalipti dhe akacia për të krijuar një filtër biologjik për sekuestrimin e karbonit. Gjethet e gjelbëra me të bardhë të bimës e bëjnë atë një pemë efektive dekorative për peizazhin industrial. Plepi është shumë tërheqës kur mbillet në sipërfaqe të hapura si livadhe të krijuara për të thyer imazhin industrial. Për shkak të sistemit të gjerë rrënjor ky dru përballon erën ndaj edhe mund të vendoset si barrierë ndaj saj.

Lofata *(Cercis siliquastrum)* - Dru i vogël gjetherënës, mjaft i vlerësuar në periudhen e lulëzimit (prill-maj) për lulet mjaft dekorative të cilat çelin përpara gjethëzimit. Ideale për t'u mbjellë në grupime apo edhe në rresht duke thyer "monotoninë industriale". Pemë mjaft tolerante ndaj ndotjes.

Peizazhi Rural

Mbrojtja e peizazhit rural konsiston në mirëmbajtjen e trupave ujorë, të cilët në këtë peizazh vijnë në formën e kanaleve vaditëse ose lumi që përshkon zonën. Shtimi i rripave të gjelbër me bimësi të ulët e barëra si ndarës pronash si dhe ndalues të erozionit të kanalit do të mbronte tokat bujqësore dhe përdorimi i shkurreve si Manaferra (Rubus idaeus) do të hijëzonte kanalet duke ngadalësuar avullimin e tyre gjatë stinës së nxehtë. Në figurën e mëposhtme zona ripariane përgjatë trupit ujor (lumi Seman) shfaqet e copëzuar si pasojë e transformimit në tokë bujqësore. Bimësia karakterizohet nga barëra dhe shkurre të ulëta pasi aktiviteti njerëzor ka prerë pemët e larta si pasojë edhe parcelat shfaqen të izoluara (Kuroroa, NjA-ja Libofshë). Po ashtu, në tokë bujqësore është mirë që të vendosen grupime bimësh apo korridore jo lidhëse, por që mundësojnë që bimët të thithin një pjesë të ndotësve që rezultojnë në tokë dhe ujëra nëntokësore nga kimikatet.

Bimë të përshtatshme për zonat ripariane të Semanit, Gjanicës dhe Vjosës janë:

Shelgu *(Salix species)* – Përshtatet më së miri përgjatë brigjeve të trupave ujorë. Me rrënjë tepër të fuqishme, pema stabilizon brigjet e lumenjve nga erozioni.

Plepi (*Populus alba)* – Dru autokton në territor. Për shkak të sistemit të gjerë rrënjor ky dru përballon erën, si dhe ndalon erozionin ujor.

Akacia *(Acacia)* – Grupimet e mbjella të drunjëve konsiderohen si "fabrikë" për kontrollin e erozionit, për shkak të rritjes dhe përhapjes së shpejtë dhe rezistencës së lartë ndaj zjarreve.

Eukalipti *(Eucalyptus)* – Pemë me rritje të shpejtë dhe sistem rrënjor ideal për stabilizimin e brigjeve të trupave ujorë, reduktimin e ujërave nëntokësore, shkripëzimin e dherave dhe si barrierë ndaj erërave. Pemë ideale për t'u mbjellë në trupa ujorë në zona natyrore, bujqësore dhe qytete (nëse mbillet pranë trupit ujor në qytet si rasti i lumit Gjanica duhet mbajtur në kontroll nëpërmjet krasitjes së degëve të sipërme pasi njihen për shkëputjen e tyre të papritur). Bima është tepër e etur për ujë dhe së bashku me ujin mund të thithë edhe lëngjet e ndotura të krijuara nga aktivitetet ndotëse në sipërfaqe të trupit ujor, duke ndaluar edhe hyrjen e tyre në sistemin ujor. Ndonëse eukualipti është një pemë lehtësisht e djegëshme nga zjarret si pasojë e përmbajtjes së lartë të yndyrës që mbart, ajo e ka po aq të lehtë të ripërtërihet nga djegia.

Të gjithë drunjtë më sipër janë autoktonë në territor ku kombinohen më së miri me njëri-tjetrin për të krijuar një filtër biologjik për të gjithë territorin, si dhe stabilizim të brigjeve të trupave ujorë.

Bimë të përshtatshme për të krijuar korridore natyrore në territorin bujqësor të Fierit janë:

Figura 244. Zona ripariane përgjatë Semanit.

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016.

Bimë autoktone si dushku, frasheri shkurre-mersina, shqopa, verriu, murrizi, shkoza, mare, thanqere dhe marina të cilat zhvillohen vetë në mënyrë natyrore janë baza e bimësisë së koridorit natyror pasi jo vetëm janë përshtatur me klimën por ofrojnë edhe ushqim e vendstrehim për jetën e egër. Ndërkohë drunj erëpritës dhe mbrojtës të

korridorit janë **plepi** (*Populus alba),* **akacia** *(Acacia),* dhe **shelgu** *(Salix species)* për të njëjtat arsyet të përmendura në bimët e zonës ripariane.

Figura 245. Struktura e Zonës ripariane



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016.

Peizazhi Natyror

Masa urgjente për mbrojtjen e kësaj fashe mbetet rimëkëmbja e elementeve të peizazhit natyror, ku prioritet marrin mbjellja e bimësisë së humbur në ***zonat ripariane*** si pasojë e transformimit në tokë bujqësore, përgjatë trupave ujorë, ***zonat tampon*** dhe ***rripat e gjelbër*** në mbrojtje të elementëve të peizazhit natyror dhe ***korridoret,*** të cilët përfshijnë edhe sipërfaqet e fondit pyjor. Interes të veçantë do të merrte krijimi i nje korridori ekologjik midis kodrave të NjA-ve; Cakran, Frakull, Portëz dhe Levan, si dhe rimëkëmbja e zonës ripariane përgjatë fashës së bregdetit përfshirë edhe lidhjen ekologjike mes Pishë-Poros dhe Divjakë-Karavastasë. Pjesë e pandashme e këtyre korridoreve do të ishin edhe sipërfaqet e fondit pyjor, elementet e peizazhit natyror të përmendur më sipër si dhe trupat ujorë në këtë territor.

Trupat ujorë mund të luajnë një rol të rëndësishëm si korridore kalimi nga një fashë peizazhistike në tjetren për jetën e egër, si dhe të jenë "lidhës" të ngastrave, apo parcelave te ndara. Por, që kjo të ndodhë duhet të bëhet realitet mbjellja/risjellja e bimësisë ripariane të copëzuar nga bujqësia, përgjatë shtratit lumor.

Rreziqet kryesore për biodiversitetin e peizazhit natyror janë:

- humbja dhe fragmentimi i habitatit;
- mbishfrytëzimi dhe përdorimi jo i qëndrueshem i rezervave natyrore;
- shqetësimi dhe keqtrajtimi i kafshëve, përfshirë dhe gjuetinë e jashtëligjshme;
- zjarret për të krijuar kullotat për bagëtinë; dhe

- gjuetinë dhe peshkim e tepruar.

Arsyet kryesore që sjellin këto rreziqe janë:

- ndërgjegjësim i ulët mjedisor i komuniteteve lokale dhe i publikut në përgjithësi;
- mungesa e mekanizmave të zbatimit të ligjit;
- varfëria;
- mungesa e manaxhimit dhe e njohurive mbi praktikat më të mira të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; dhe
- kapaciteti i ulët institucional në zbatimin e politikave të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

- **Masa për mbrojtjen e pyjeve**

Në analizën e mëposhtme identifikohen disa nga Ekonomitë Pyjore që i përkasin Fondit Pyjor të Bashkisë Fier, problematikat e tyre si dhe rekomandimet për përmirësimin e situates në bazë të vizitave në terren.

Objekti i Malit të Cakranit

Materiali drusor i rrëzuar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë bëhet burim infeksioni për drurët e tjerë si pasojë e shpërbërjes së materialit drusor në ndërverprim me kushtet atmosferike dhe pedologjike, prerjet e paligjshme, kullotjet pa leje të cilat aktualisht janë sporadike por të pranishme, mungesa e një strategjie afat gjatë për përdorimin e objektit si atraksion turistik dhe promovimi i tij janë disa nga problematikat aktuale me të cilat përballet objekti. Si rrjedhojë, heqja e materialit drusor të rrëzuar, ripyllëzimi me bimë të cilat i rezistojnë erërave të forta dhe kushteve atmosferike dhe pedologjike, promovimi i burimeve natyrore të objektit dhe shpallja e tij si atraksion turistik janë disa nga qasjet të cilat mund t'i jepnin zgjidhje problemeve që mbart dhe, si rrjedhojë, edhe mbrojtjes së tij.

Objekti Kurora

(Kurora është Monument Natyre dhe aktualisht transferuar ish Komunës Libofshë me V.K.M nr. 89, ndajdalja e V.K.M së re e cila do ti kalojë pronat pyll Bashkisë duhet të thjeshtësoj realizimin e qëllimeve për administimin dhe mirë menaxhimin e Kurorës.)

Mungesa e investimeve, mbrojtja e objektit nga prerjet e paligjshme, kullotja pa leje së bashku me mungesën e politikave promovuese të objektit si atraksion turistike, janë disa nga problematikat aktuale me të cilat përballet objekti. Si rrjedhoj, pastrimi i shesheve dhe koridoreve egzistuese, rrethimi i objektit nga ana ku kufizohet me tokë, mbrojtja nga kondravajtësit, promovimi i burimeve natyrore të objektit, krijimi i vendeve shlodhëse brenda objektit, pastimi i trungjeve të plepave nga bimë parazitare si *Kulpres* ose *hedra helix* si dhe mbrojtja e drurëve të veçantë si *Rrënja* dhe *Vidhi* janë disa nga qasjet të cilat mund t'i jepnin zgjidhje problemeve që mbart dhe, si rrjedhojë, edhe mbrojtjes së tij.

Objekti i Kërrnicës

Shfrytëzimi pa kriter i objektit për peshkim, mbrojtja dhe shtimi i florës dhe faunës aktuale mbetet problematika më e madhe me të cilën përballet objekti i Kërrnicës.

Objekti i Argjinaturës së Lumit Seman

Kullotja pa kriter, erozioni dhe gërryerrja e shtratit të Lumit Seman janë problematikat kryesore, të cilat, nëpërmjet pyllëzimit të zonës ripariane dhe mbrojtjes së objekteve të pyllëzuara mund të rimëkëmbin sistemin ekologjik të objektit.

- **Masa për zonat e mbrojtura natyrore**

Në territorin e Bashkisë ka zona tërheqëse, sipërfaqe pyjore e ujore dhe më vlera të larta të biodiversitetit (shih seksionin e Zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit), të cilat fare mirë mund të vlerësohen dhe t'u jepet një status mbrojtës, si maja e pyllit të Cakranit. Në këtë situatë, Bashkisë i propozohet (pranë institucioneve përkatëse AKZM, AdZM) që:

- bashkëpunojë me AdZM Fier për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.
- të hartiojë planet e menaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre dhe marrja e masave për zbatimin e planeve të menaxhimit në bashkëpunim me AdZM Fier.
- Për pyllin Pishë-Poro, rekomandohet menaxhim i ngjashëm me atë të Parkut të Divjakë-Karavastasë. Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit, rekomandohet mbrojtja e ligatinave
- Të shmangen ndërhyrjet në grykëderdhjet (deltat) e lumenjve Seman e Vjosë si dhe të kanaleve Darëzezë e Vijë e Ngjalë, për shkak se shërbejnë si zonë vendstrehimi dhe zona për ushqimin e shpendëve shtegtarë.
- Hartimi i planit të emergjencave në rast zjarri dhe rreziqesh gjeologjike
- Plani emergjent të përfshijë ngritjen e rrjetit të informatorëve lokalë (barinjt e zonës, banorët në brendësi ose afër zonave të mbrojtura, etj.). Ky rrjet mund të shërbejë edhe për *kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive të jashtligjshme* (gjuetisë, mbikullotjes, prerjes së pyjeve, shfrytëzimit ilegal të inerteve brenda territorit, etj) në bashkëpunim me personat përgjegjës të institucioneve përkatëse.
- Promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura nëpërmjet zyrave të turizmit në Bashki (në bashkëpunim me AdZM Fier) me qëllim zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera
- Përfshirjen e pasurive natyrore (parqeve dhe monumenteve) në itinerare turistike me qëllim zhvillimin ekonomik të zonës.
- Ndërgjegjësimi i banorëve në afërsi ose brendësi të territorit të zonave të mbrojtura për ruajtjen e këtyre zonave të ndjeshme mjedisore.
- Shpalljen e majës së Pyllit të Cakranit (30-40 ha në zonën e quajtur Guri i Zi) si Monument Natyre. Në këtë zonë ndodhen edhe rrenojat antike të vendit të quajtur Guri i Zi. Pylli i Cakranit gjendet në zonën kodrinore të Bashkisë Fier. Zona e propozuar si monument natyre ofron pamje të bukura natyrore nga ku mund të soditet lugina e Vjosës dhe Semanit dhe e gjithë vija bregdetare përfshirë gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit. Në zonën e pyllit janë të fshehura thesare të antikitetit Shqipëtar si dhe fosile të guaskave e vertebrorëve të ndryshëm detarë. Deri më sot nuk kanë filluar gërmime arkeologjike për zbulimin

e fosileve dhe historisë së lashtë të qytetit që fshihet nën mantelin e tokës së këtij pylli për shkak të mungesës së fondeve. Ky pyll është zonë me vlera historike tashmë të njohura edhe ligjërisht.

Mbrojtja e Rezervateve Natyrore të Manaxhuara

Zona e Pishë-Poros dhe Pylli i Levanit në Fier i përkasin kategorisë IV të zonave të mbrojtura, sipas ligjit përkatës, të njohura si Rezervat Natyror i Manaxhuar ose Park Natyror. Pishë-Poro ka një sipërfaqe të miratuar prej 1,500 ha dhe ndodhet në deltën e Vjosës. Në këtë të fundit e përgjatë bregut, gjendeshin dikur edhe dunat ranore më të larta në Shqipëri, deri në 4 apo 6m mbi nivelin e detit dhe me një gjatësi rreth 1 km. Këto duna janë zbutur thuajse deri në zhdukje dhe janë prezente në një zonë shumë të kufizuar.

Bimësia përfshin pyje të pishës mesdhetare, si edhe bimësi tipike të ligatinave detare (hygrofite, halofite dhe psamofite). Në ujërat e pastra të Vjosës takohet lloji i lundrës globalisht e rrezikuar, lutra lutra, ndërkohë që lumi është i rëndësishëm edhe për peshqit migratorë (si trofta). Zona është e rëndësishme për shpendët, veçanërisht ata rrëmbyes dhe nuk ka plan manaxhimi. Veç të qenurit park natyror, zona e Pishë-Poros përmban edhe pishën e zezë, monument natyre (kategoria III e zonave të mbrojtura sipas ligjit), e cila zakonisht rritet në lartësitë 1,000 deri 1,200 m.

Pylli i Levanit ka një sipërfaqe 200 ha dhe është një pyll tipik i dushkajave në ripërtëritje e sipër. Ka edhe ripyllëzime me lloje të pishave mesdhetare. Në përgjithësi nuk dallohet për larmi të biodiversitetit, por, sipas Ministrisë së Mjedisit, ka rëndësi për mbrojtjen e peizazhit dhe zhvillimin e turizmit.

Në nenin 9 (Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror) të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, përcaktohet se:

"1. Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjie, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (park natyror).

2. Në parkun natyror zbatohet **shkalla e tretë e mbrojtjes**, ku **ndalohen**:

a**) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore**, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

b) **depozitimi i kimikateve**;

c) **lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë** rrugëve publike dhe **vendeve te caktuara** për parkim;

ç) **mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve poleontologjike dhe e gurëve**;

d) ngritja dhe funksionimi i **objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje**.

dh) **vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave**, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

e) **ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara**.

3. **Veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 te këtij ligji** dhe **çdo veprimtari** tjetër, **që nuk ndalohet nga ky nen**, mund të **ushtrohen, pasi të pajisen me leje mjedisi**.

4. **Zonë buferike** e zonës së manaxhimit të habitateve dhe llojeve mund të shpallet territori rreth saj, me gjerësi **50 m nga kufiri i zonës**."

Në vijim, pika 5 dhe e fundit e nenit 9 thotë se për shfrytëzimet turistike të formacioneve natyrore, të cilat ndodhen në këtë rezervat, Ministrat përkatës të Mjedisit, Territorit, dhe Pushtetit Vendor miratojnë rregulla të qendrueshme e të kontrollueshme për kalime vizitorësh vetëm për afate kohore të shkurtra, duke respektuar masat mbrojtëse të shkallës së tretë. Ndërkohë, pika 2 e nenit 5 të ligjit, sikurse përmendet më sipër, përfshin një listë të gjatë ndërhyrjesh, mes të cilave edhe "ndërtime të çdo lloji".

Nisur nga ky arsyetim, në zonën e mbrojtur të Levanit mund të realizohen ndërtime, të cilat nuk prekin pyllin (drurët dhe burimet ujore) dhe pas një argumentimi të qartë të nevojës publike për to, si dhe me një leje mjedisore e cila lëshohet nga autoritetet përkatëse të mjedisit në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe përshtatshmërinë e ndërtimit ndaj përdorimit ekzistues të tokës në zonën e mbrojtur. Pra kategoria e përdorimit të ndërtimeve të mundshme duhet të jetë në përputhje dhe jo në konflikt me përdorimin natyror të zonës së mbrojtur. Nëp rastin e Pishë-Poros, ndërtimet kufizohen edhe më tepër nga ekzistenca e pishës së zezë, monument natyror. Këto pisha, jo vetëm nuk duhet të priten, por edhe habitati i tyre nuk duhet të dëmtohet duke rezultuar në dëmtim të pishave të zeza. Në rastin më të mirë, ndërtimet mund të realizohen jashtë zonave të mbrojtura dhe në kufi me zonat buferike të tyre (përkatëse). Si për Levanin dhe për Pishë-Poro kjo është e mundur, pasi kanë në kufi të tyre zona të sistemit bujqësor. Rastet janë si më poshtë.

Në rastin e Levanit, zona e sistemit bujqësor shtrihet në perëndim, përgjatë rrugës së vjetër Fier – Vlorë. Ndërtimet në këtë zonë nuk mund të kenë karakter ekonomik industrial, çka do të çonte në ndotje të mundshme të ekosistemit, duke qenë një përdorim i papërputhshëm me sistemin natyror në zonë. Gjithashtu, ndërtimet e mundshme përballen edhe me dy kufizime të tjera: 1) distancën ligjore, sipas kodit rrugor, nga aksi kombëtar Fier – Vlorë (sipas seksionit të propozuar nga plani për të); 2) nevojën për procedurë të ndryshimit të kategorisë së tokës bujqësore në tokë të sistemit urban sipas ligjit nr. Xxx, datë xxx, [emertimi] dhe VKM nr. Xxx, datë xxx, [emertimi].

Në ratin e Pishë-Poros, mundësia për ndërtim në tokën bujqësore duhet të marrë në konsideratë këta faktorë: 1) distancën nga zona buferike e Pishë-Poros; 2) përputhshmërinë mes kategorisë së përdorimit të ndërtimit të ri dhe kategorive të sistemit natyror e bujqësor përreth – p.sh. ndërtimet industriale në këtë pjesë janë të papërputhshme dhe konfliktuale; 3) nevojën për procedurë të konvertimit të tokës bujqësore në tokë urbane; 4) distancën nga brigjet ujore sipas ligjit për manaxhimin e integruar të burimeve ujore; 5) marrjen e masave për mbrojtje nga përmbytjet e lumit Vjosa (për shkak të afërsisë së madhe me deltën) dhe për të mos lejuar depërtimin e

detit drejt zonës së ndërtuar, qoftë edhe si efekt i ndryshimeve klimatike. Veçanërisht faktori i fundit (përmbytjet dhe ndryshimet klimatike) janë një argument i fuqishëm në favor të mbrojtjes së pyllit të Pishë-Poros dhe dunave përgjatë bregut, të cilat veç vlerave ekologjike, natyrore, peizazhistike, të biodiversitetit etj. shërbejnë edhe si mbrojtës natyrorë të bregut dhe zonave të ndërtuara në brendësi. Së fundi, duke qenë se zona bujqësore midis dy masive pyjore të Pishë-Poros, është e kripëzuar, përdorimi i saj për ndërtime të qëllimit turistik (resorte cilësore dhe të parametrave ndërkombëtarë) është një nga opsionet e mundshme, dhe gjithmonë duke respektuar faktorët kufizues të përmendur më lart. Këto ndërtime, për shkak të vlerës peizazhistike e estetike të zonës, si edhe sepse nuk duhet të duken nga kodra e Apollonisë, nuk duhet të jenë kurrsesi më të larta se sa pylli i Pishë-Poros, dhe në çdo rast jo më tepër se sa 15 m, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 502 për lartësinë e objekteve.

- **Masat për mbrojtjen e pyjeve**

Në rang Bashkie, sipërfaqet e fondit pyjor e kanë të nevojshme të ndërmerren disa hapa për përmirësimin e gjendjes së tyre. Të tilla mund të jenë:

- Kryerja e një studimi të hollësishëm me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë shkaktuar tharjen e llojeve të bimësisë pyjore: rrap, dushk dhe plep në seksione të ndryshme të lumit Gjanica dhe Seman.

- Studimi i hollësishëm për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale si pishat e buta përgjatë vijës bregdetare.

- Mbajtja nënkontroll e sëmundjeve (koncesionares) dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.

- Marrja e masave për parandalimin e zjareve si: krijimin e një rrjeti për njoftimin e rënies së zjarreve (barinjtë mund të luajnë një rol tejet të rëndësishëm në këtë rast), ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien përpara përgjegjësisë të gjithë kundravajtësve që shkaktojnë zjarret etj.

Në rang ekonomie specifike pyjore masat e nevojshme për t'u ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes së tyre, mund të jenë:

Objekti i Malit të Cakranit

- Heqja e materialit drusor të rrëzuar;
- Ripyllëzimi me bimë të cilat i rezistojnë erërave të forta dhe kushteve atmosferike dhe pedologjike;
- Promovimi i burimeve natyrore të objektit dhe shpallja e tij si atraksion turistik.

Objekti Kurora

- Pastrimi i shesheve dhe koridoreve ekzistuese;
- Rrethimi i objektit nga ana ku kufizohet me tokë;
- Mbrojtja nga kondravajtësit;
- Promovimi i burimeve natyrore të objektit;
- Krijimi i vendeve shlodhëse brenda objektit;
- Pastrimi i trungjeve të plepave nga bimë parazitare si: *kulpres* ose *hedra helix*
- Mbrojtja e drurëve të veçantë si *rrënja* dhe *vidhi.*

Objekti i Kërrnicës

- Ndalim/manaxhim të peshkimit pa kriter të objektit;
- Mbrojtja dhe shtimi i florës dhe faunës aktuale.

Objekti i Argjinaturës së lumit Seman

- Pyllëzim të zonës ripariane.

- **Masa për mbrojtjen e biodiversitetit**

Territori i Bashkisë Fier ka një biodiversitet relativisht të pasur dhe të larmishëm (shih seksionin e biodiversitetit), si nga pikëpamja faunistike ashtu edhe floristike. Megjithatë, qëndrueshmëria e biodiversitetit has në një sërë vërshtirësish, të cilat lidhen kryesisht më problemet e shkaktuara nga aktiviteti njërëzor në territor. Zhvillimi bujqësor, industrial, urban dhe ai infrastrukturor janë problemet të cilët kanë pasur ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Hapja e tokave bujqësore (vitet e shkuara) ka çuar në tkurrje dhe fragmentim të habitateve natyror, industria e naftës kryesisht ka patur ndikim negativ në prishjen e cilësisë së tokës dhe të ujrave duke dëmtuar biodiversitetin, zhvillimi urban dhe ai infrastrukturor ka copëtuar gjithashtu habitatet, kryesisht ai infrastrukturor (rrugë) i cili ka copëtuar konsiderueshëm habitatet, duke vështirësuar, apo penguar plotësisht vijueshmërinë e tyre. Si pasojë, shumë specie mbeten të izoluara në habitate të vogla të copëzuara.

o Masa të parashikuara në PPV

Në këtë situatë, hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e biodiversitetit në teritorin e Bashkisë. Në PPV, Bashkia ka marrë disa masa specifike për të përmirësuar situatën e për të krijuar mundësinë për një biodiversitet sa më të qëndrueshëm. Masat janë kthyer në projekte specifike.

o Masa të tjera shtesë

Në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mëtjeshëm të biodiversitetit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Fier rekomandohet që **Bashkia:**

- të hartojë Planin e Menaxhimin/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij në brëndësi të territorit të bashkisë, kryesisht për zonat të cilat

shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qëndrore (AKM, ARM, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të ligjit Nr.587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit".

- të lobojë ose të ndërmarrë vetë nismën për inventarizimin e specieve dhe përditësimin e tij për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM, AKZM, ADZM). Inventarizimi dhe njohja e llojeve në territorin e Bashkisë do të shërbente në qartësimin e përcaktimit të masava efektive për mbrojtjen e tyre, si dhe propozimin për të dhënë status mbrojtjeje zonave të cilat spikaten për larmishmëri dhe strehojnë specie të rrezikuara, ka shumë zona të cilat mund të klasifikohen si zona të cilave mund t'u jepet status mbrojtës i veçantë sipas ligjit në fuqi. Realizimi i këtyre masave do ti shërbejë Bashkisë që të ruajë dhe të mbrojë biodiversitetin nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga element natyrorë, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 "Për Caktimin e kritereve për ngriten e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit".

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të dihet kapaciteti i teritorit për kullotje dhe të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes aty ku vlersohet e nevojshme**.**

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Medicinale dhe Aromatike, në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qëndrore, Ministria e Mjedisit, Ministritë e linjës, ARM, AKM, etj.)**.**

Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (ne bashkëpunim me ministrine e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).

Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrodhin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë bashkisë i lind detyrim nga ligji për mbrojtjen e faunës dhe ligji për mbrojtjen e biodiversitetit) është masa kryesore që do të përmirësonte situatëgjendjenn e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Kontrolli i zbatimit të moratoriumeve, gjuetise dhe pyjeve, kërkon që:

- të bashkëpunohet me institucionet lokale dhe qëndrore për të kordinuar punën dhe për të kryer veprimtari të përbashkëta të cilat cilësohen më efikase në bashkëpunim ndërinstitucional (institucionet që duhet të lidhen ura bashkëpunimi janë Bashkitë fqinje, Ministria e Mjedisit, ARM, AKM, Policinë e shtetit, etj.)

- të ngrihet sistemi i informimit në terren, në mënyrë që të raportohen në kohë dëmet dhe të dalin para përgjegjësisë shkelësit (sistemi duhet të jetë formal, krahas punonjëve të lidhen mardhënie të mira me banorët e zonës dhe kryesisht me barinjtë).

- tw hartohen planet e kontrollit dhe inspektimeve në terren, në mënyrë që të gjitha kontrollet të jenë të kordinuara dhe të kenë efikasitet në veprimtarinë e tyre.

- të organizohen fushata ndërgjegjësimi të qytetarëve për rëndësinë që ka ndalimi i gjuetisë dhe prerjes së pyjeve për një afat të paracaktuar, përkatësisht 5 vjet për ndalimin e gjuetise dhe 10 vjet për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve.

Studimi i ndikimit të industrisë së naftës në ndotjen e ujrave dhe marrja e masave për zvogëlimin e ndikimeve negative dhe shpërndarjen e ndotjes: kjo do të sigurojë përmirësimin e cilësisë të ujrave dhe të tokës e, si rrjedhojë, garantimin e kushteve optimale për zhvillimin e biodiversitetit përrth zonës industriale dhe më gjerë. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon:

- Rehabilitimin e zonave të ndotura nga aktivitëti i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të naftës (shih seksionin e pikave të nxehta mjedisore).

- Mbjelljen e pemëve në zonat ku është e mundur, përreth zonës industriale dhe në brendësi të sajë.

- Kontrollin e shkarkimeve të ujrave të ndotur industrialë, gjetja e mundësisë për trajtimin e tyre dhe ndalimi i shkarkimit të tyre në trupat ujorë (në bashkëpunim me organet qëndrore e vendore, Ministritë e Linjës, ARM, AKM etj.).

- Studimin e zhvillimi të fushave të reja naftënxjerrëse (pus-shpimeve) dhe marrjen e masave paraprake, në mënyrë që ndikimi të jetë sa më i ulët, ose të ndalohet zhvillimi i këtyre pus-shpimeve kur vlerësohet e tillë (Në bashkëpunim me institucionet qëndrore, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë përgjegjëse për industrinë, etj.)

Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore (kryesisht rruget lidhëse të fshatrave 6-8m gjerësi). Në pikat ku vlerësohet që ndarja e habitateve krijon probleme në biodiversitetin e zonës, të ndërtohen ura/nënkalime ekologjikë për të lidhur habitate. Rrugët lidhese ekzistuese dhe të propozuara në të gjitha zonat natyrore të Bashkisë duhet të kenë parasysh ndërtimin e urave ekologjike pasi këto rrugë kanë ndikim të konsiderueshmëm në habitate (copëzojnë habitatet).

Rehabilitimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbetjeve aktuale, e cila është jashtë standarteve të kërkuara. Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane shkakton një sërë problemesh në mjedis, duke ulur cilësinë e elementeve përbërëse të tij, si toka, ajri, uji dhe si pasojë ndikime negative në biodiversitetin e zonës. Ky venddepozitim, duke qënë fare pranë shtratit të lumit vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit të tij e, si rrjedhojë, në florën e faunën ujore.

2.3.3 Mbrojtja e sistemit ujor

- **Masa për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore**

Lumenjtë Vjosë, Seman, Gjanicë, Vija e Ngjalës e degët e tyre kanë pësuar dëmtime të shumta brenda territorit të Bashkisë së Fierit, (shih seksionin e Ujërave

Sipërfaqësore) në 20 vitet e fundit. Nga analiza e cilësisë së ujit në territorin e Bashkisë Fier ka rezultuar se ujrat e lumit Gjanicë janë të ndotur. Burimet kryesore të ndotjes kanë rezultuar fusha e depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane në brigjet e lumenjve që ka shkarkuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore nëpërmjet rrjedhjes së shllamit në ujërat e lumenjëve të kësaj Bashkie dhe depërtimit të tij në shtresat e tokës deri në Akuiferët e Fierit. Krahas venddepozitimit të mbetjeve, ujrat e ndotura urbane dhe jourbane (kryesisht ujrat e industrisë së naftës) kanë krijuar ndotje të vazhdueshme të lumit Gjanicë dhe Seman në mungesë të impjanteve përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura. Aktualisht, ujërat urbane dhe ujërat e ndotura të industrisë së naftës derdhen drejtpërsëdrejti në lumenjë.

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ruajtur mjedisin dhe ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj, Ligji nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" si dhe ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij. Për këtë arsye lipset që Bashkia të marrë masa urgjente për përmirësimin e gjendjes. Njëkohësisht, duke patur parasysh se ndotja e lumenjve fillon që në origjinë, nevojitet që Bashkia të bashkëpunojë me bashki të tjera nëpër të cilat kalon lumi Seman dhe Vjosë, Këshillin dhe Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit për hartimin e planeve ndërvendore për mbrojtjen e burimeve ujore jashtë territorit të saj administrativ.

Masa të parashikuara në PPV

Me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore, në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi, Bashkia Fier ka parashikuar marrjen e disa masave të cilat përqendrohen në *përmirësimin e hidro-morfoligjisë së lumenve të Basenit të Semanit dhe Vjosës* dhe degët e tyre, *mbrojten e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën si dhe *uljen e ndotjes nga industria e naftës.*

Konkretisht, për përmirësimin e hidro-morfoligjisë së lumenjve të Basenit të Semnit dhe Vjosës, në PPV, Bashkia ka propozuar rehabilitimi mjedisor dhe kthimin në zona për argëtim të zonave ripariane të Lumit Seman, Vjosë dhe Gjanicë. *Për mbrojten e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën, në PPV, Bashkia ka propozuar hartimin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sipas ligjit Nr. 10463, datë 229.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" Neni 12. Në plan përfshihen propozime për ndërtimin e në venddepozitimi të mbetjeve urbane (Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23). Gjithashtu, Bashkia ka propozuar edhe krijimin e sistemit për administrimin e ujërave të ndotura urbane të zeza dhe të bardha duke e shtrirë këtë sistem në të gjithë territorin e Bashkisë. Për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore nga ndotja si pasojë e shkarkimit të drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura urbane dhe industriale në lumin Seman dhe Gjanicë, Bashkisë së Fierit i del për detyrë të hartojë Planin për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura si dhe të përcaktojë teknikat, teknologjitë dhe metodave më të mira për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mëyrë që treguesit fiziko-kimikë dhe bilogjikë të ujërave që shkarkohen në mjediset pritëse të jenë brenda normave. Detyrime këto të cilat dalin bazuar në Ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura". Njëkohësisht, në PPV propozohet edhe kryerja e një studimi të thellë rreth ndikimit të industrisë së naftës në ujëra dhe tokë ndër vite. Më poshtë janë paraqitur masat kryesore të propozuara në PPV që synojnë mbrojtjen e burimeve ujore në Bashkinë Fier:

Tabela 130. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ujit

Qëllimi	Masa	Projekti
Përmirësime në hidro-morfoligjinë e lumit	Krijimi i zonave ripariane	- Rehabilitimi mjedisor dhe kthimi në zonë rekreative i zonave ripariane të Lumit Seman, Vjosë dhe Gjanicë - Ndërtimi i dy urave në Seman përgjatë rrugës Topojë-Ndërnënas - Zgjerimi i urës ekzistuese në rrugën Rreth Libofshë-Mujalli - Ndërtimi i rrugëve e 6 urave këmbësore përgjatë Gjanicës - Realizimi i masave infrastrukturore dhe vegjetative për mbrojtjen e tokave bujqësore nga lumenjtë e basenit të Vjosës e Semanit. - Hartimi dhe zbatimi i projekteve për mbrotjen e Kanalit të Roskovecit nga aktiviteti Industrial i Bashkise Fier por edhe i bashkive fqinje
	Mbrojtja e brigjeve të lumenjve nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturave të ndryshme	
	Administrimi efiçent i ujit	
Mbrojten e burimeve ujore nga ndotja nga mbetjet e ngurta e të lëngta	Menaxhimi i integruar i mbetjeve	- Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve, duke ndarë ujërat e bardha nga të zeza në qytet, e duke siguruar mbulim me rrjet për gjithë Bashkinë, - Mbyllja dhe rehabilitimi i pikës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve në Fier - Ndërtimi i një impianti të trajtimit të ujërave të ndotura, - Ndërtimi i impiantit të djegies së mbetjeve urbane -
Ulja e ndotjes nga nafta	Studime rreth ndikimit të sektorit të naftës në mjedis	- Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore - Hartimi i një plani për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane për Bashkinë Fier

Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

- Masa të tjera shtesë

Hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe, si rrjedhojë, edhe mbrojtjen e shëndetit të banorëve nga ndotja e ujit. Krahas masave të propozuara në PPV, rekomandohet edhe marrja e masave shtesë të cilat përfshijnë:

Krijimin e brezit të gjelbërt / fashës së gjelbërt ose zonës ripariane (me 100-200m gjerësi, sipas rastit të studiuar) përgjatë gjithë gjatësisë së lumit Seman, Vjosë,Gjanicë dhe degëve të tyre në zbatim të ligjeve nr. 107/2014 "Për Planifikimin e Territorit" dhe Ligjit Nr. 111/2012[463] "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Fasha e gjelbërt shton stabilitetin e shtratit dhe brigjeve të lumit duke e mbrojtur atë nga erozioni, mbron cilësinë e ujrave duke u bërë pengesë për sedimente, kimikate, nutrientë dhe ndotës të tjerë që të arrijnë lumin, krijon një habitat larmishëm për florën dhe faunën, krijon një korridor të pandërprerë, të vazhdueshëm, për florën dhe faunën duke lidhur habitate të zonave të ndryshme nëpër të cilat kalon, kontrollon përmbytjet, krijon një barrierë mbrojtëse ndërmjet lumit dhe tokës në vazhdimësi duke shmangur dëmtimet që mund t'i shkaktohen lumit nga përdorimet e ndryshme të tokës përreth, shërben si zonë argëtuese.

- Në disa zona ku zona e gjelbër / zona ripariane gjatë rrjedhës së lumenjëve është shndërruar në pronë private dhe është ndërtuar, apo zhvillohen aktivitete të ndryshme, rekomandohet të kalojnë në status ngrirje, më pas të punohet për gjetjen e zgjidhjeve specifike rast pas rasti.

Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Seman e Vjosë: Lumenjtë e Basenit të Semanidhe Vjosa janë shfrytëzuar për inerteve në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit dhe të Vjosës:

- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore të Vjosës dhe Semanit ku është vënë rë shfrytëzim itensiv i inerteve lumore. (në bashkëpunim me ABU Seman e ABU Vjosë, ARM Fier, ARM Vlorë dhe Ministrinë e Mjedisit). Bazuar në VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", Bashkisë së Kuçovës i rekomandohet që *për shfrytëzimn e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve të japë leje vetëm në rastet kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*. Pra, Marrja e inerteve, në rastet kur është e pashmangshme për arsye ekonomike, *të shoqërohet me studime specifike të posaçme për çdo rast* me qëllim shmangien e dëmtimit të trupit lumor. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka kryer studime të hollësishme rreth shfrytëzimit të inerteve të lumenjve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Për këtë arsye, rekomandohet *bashkëpunimi me SHGJSH për shqyrtimin e çdo lejeje*,

- Të largojë menjëherë impiantet e prodhimit të inerteve nga siperfaqet e shtratit apo terracës së shtratit të Vjosës dhe Semanit,
- Të rehabilitojë shtratin e lumit në zonat e dëmtuara përgjat lumit Vjosë, Semand dhe Gjanicë (Ndërtimin e pritave anësore e tërthore me qëllim shmangien e erozionit të brigjeve, mbrojtjen e urave, pastrimin e brigjeve të lumit të mbushura me inerte, krijimin e pyjeve artificiale në terracën e shtratit apo në terracën e parë me qëllim shmangien ose uljen e veprimtarisë gërryese të rrjedhës).[464]

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme*:* Bashkia Fier nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme shtepiake që është kompetencë e bashkisë mbetet ende një sfidë. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia Fier:

- Për mbetjet e rrezikshme shtepiake: të hartojë një Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Shtëpiake, si dhe mënyra e trajtimit të tyre dhe përcaktimi i vendit të depozitimit përfundimtar të tyre.
- Mbetje të rrezikshme: të insistoj pranë institucioneve të linjës për gjidhjen e menaxhimit të rrymave të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, të cilat ndodhen apo prodhohen brenda territorit të bashkisë.
- Mbetje të rrezikshme spitalore: të harojë një plan për përcaktimin dhe miratimin e vend depozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme dhe të monitorojë administrimin e mbetjeve sipas kopetencave të sajë.
- Mbetje të rrezikshme industriale: të bashkëpunojë më institucionet qëndrore për zgjidhjen e problemit të trajtimit të mbetjeve industriale të depozituara dhe që prodhohen në teritorin e bashkisë.

- Të shtohet përqindja e mbetjeve të ricikluara: Planet dhe projektet që do të hartohen / zhvillohen në funksion të menaxhimit të mbetjeve industriale, të marrin në konsideratë dhe mundësinë e reduktimit të tyre që në burim dhe uljen e mundësisë së deportimit të ndotjes nga industria në tokë, ujë, ajër.

Zgjerimi i rrjetit të monitorimit dhe i parametrave të monitoruar *në varësi të aktiviteteve ekonomike (industriale, bujqësore, etj.) të pranishme në territor*

Semani, Vjosa dhe Gjanica përshkruajnë territore të gjera me aktivitetet të ndryshme bujqësore dhe industriale. Për fat të keq, këta lumenj monitorohen nga një numër i kufizuar stacionesh monitorimi[465]. Duke parë rëndësinë që kanë për bujqësinë dhe si burim ushqyes për Akuiferët e Fierit, rekomandohet:

- Monitorimin mujor ose mundësisht ditor i cilësisë së ujërave të luemnjve Seman, Vjosë dhe Gjanicë nga ARM Fier dhe Vlorë gjatë gjithë vitit. Monitorimi i lumenjve deri më tani kryhet nga AKM. Është e udhës që monitorime të kryhen edhe nga ARM Fier dhe Vlorë. Duke qenë e pranishme në territor, ARM Fier dhe Vlorë arrin të monitorojë ujërat e lumenjve Seman dhe Vjosë në kohën e duhur edhe në rastet kur ka derdhje të rastësishme abuzive të lëndëve të ndryshm në lumë. ARM Fier dhe ARM Vlorë duhet të paktën të ketë përgjegjësinë e monitorimit të lumit të herëpashershme sipas një Plani Monitorimi Vendor të lumit si dhe të pajiset me laborator teknik të akredituar për kryerjen e analizave të ujit.
- Shtimin e stacioneve të reja të monitorimit të lumenjve në zonat më problematike (në qendër të zonave më të banuara, në zonën naftënxjerrëse, etj.). Për këtë nevojitet bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale Fier dhe Vlorë
- Shtimin e numrit të parametrave të monitoruara dhe përshtatja e parametrave që duhen monitoruar për ndotjen e lumenjve në varësi të aktivitetit industrial të pranishëm në territor . Në bashkitë si Fieri ku industria e naftës është mjaft aktive, nevojitet monitorimi i ujërave nga kjo industri. Sot, përveç përcaktimit të ndotjes, është e rëndësishme që të përcaktohet edhe burimi i ndotjes.

Kontrolli i shkarkimeve industriale në ujë: Në këtë konteks rekomandohet që Bashkia:

- të hartojë plane për kontrollin e zbatueshmërisë së Lejeve të Mjedisit (në bashkëpunim me ARM Fier dhe ARM Vlorë, AKM) për subjekete që shkarkojnë mbetje të cilat dëmtojnë cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, kryesisht subjektet e industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve në territorin e saj. Zbatimi i këtyre masave rrjedh si detyrim ligjor për Bashkinë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligje të tjera për mbrojtjen e mjedisit dhe specifikisht për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujrave.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit: rekomandohet që Bashkia:

- të ndërtojë një program ndërgjegjësimi të popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore, mospërdorimin e lumenjve si vende të depozitimit të mbetjeve, etj.

Hartimi dhe zbatimi i programeve e planeve ndërbashkiake/vendore për menaxhimin e Basenit të lumit Seman dhe Vjosës

Semani dhe Vjosa janë lumenjë që përshkojnë territorin e bashkive të ndryshme. Si rrjedhojë, mbrojtja e tij kërkon bashkërendimin e përpjekjeve të të gjitha bashkive përkatëse dhe me Këshillin e Basenit Ujor (KBU) të Semanit dhe Vjosës. Bashkëpunimi mund të kryhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve e planeve ndërbashkiake/vendore ose për hartimin e Planit të Menaxhimit të Basenit të Semanit dhe Vjosës. Ky plan duhet të përcaktojë angazhimet përkatëse për çdo bashki në fushat e mëposhtme:

- përdorimin e qëndrueshëm të ujërave të lumit Seman dhe Vjosë nga të gjitha bashkitë (bashkëpunim në dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit për qëllime të ndryshme si për pije, bujqësi, industri, etj.) pa penalizuar bashkitë në rrjedhën e mesme e të poshtme të lumit,

- kordinim për ruajtjen e mirëmbajtjen e lumit (pastrimin e shtratit të lumenjve, krijimin e fashës së gjelbërt, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumë,

- parandalimin e ndotjes së lumenjve në këto bashki (ndalimin e hedhjes së mbetjeve në lumë/burime ujore sipërfaqësore) në mënyrë që bashkitë në rrjedhën e poshtme të mos marrin të gjitha ujërat e ndotura të bashkive në rrjedhën e sipërme dhe të mesme;
- përcaktimin e pasojave që ndërtimi i HEC-eve në degët e Semait dhe Vjosës mund të ketë në cilësinë e ujit të lumenjve, në prurje, biodiversitet , dhe deri në plazhe.
- pyllëzimin e pellgut ujëmbledhës të lumit Seman, Vjosë dhe Gjanicë dhe degëve të tyre me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe erozionit;
- monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (të lumenjëve dhe të akuiferëve të Fierit)

Shpalljen e Gjanicës/Semanit dhe Vijës së Ngjalës si trupa ujorë tepër të modifikuar

Nga analizat e bëra në terren dhe nga studimet e kryera për lumenjtë dhe basenet e vendit tonë është vënë re se lumi i Gjanicës është i një cilësie shumë të keqe ndaj rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Sekretariatin Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit të shpallë si trupa ujorë të modifikuar segmentet e mëposhtme:

- lumin e Gjanicës
- segmentin Ura e Mbrostarit ku bashkohet me Gjanicën e deri në grykëderdhje
- Kanalin e Roskovecit (Vija e Ngjalës)

Bashkia duhet të bashkëpunojë me Ministrin e Mjedisit dhe me Këshillin e Basenit Ujor për të përcaktuar masa të përshtatshme për parandalimin e përkeqësimit të statusit të Gjanicës, segmentit të semanit dhe Vijës së Ngjalës.

- **Masa për mbrojtjen e ujërave nëntokësore**

Qarku i Fierit ku bën pjesë Bashkia Fier është i pasur me burime ujore nëntokësore ndër të cilët dallojmë akuferët ndërkokrrizorë që përkojnë me luginën e Semanit dhe të Vjosës. Duke u mbështetur në studimet e kryera nga SHGJSH rreth problematikave

të ndryshme të akuiferëve në Qarkun e Fierit[466], lind nevoja të merren disa masa të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Disa nga këto masa renditen më poshtë

- Mbrojtja e shëndetit të popullsisë

Ndalimi i menjëhershëm i furnizimit me ujë të popullsisë nga Akuiferi i Semanit (i Fierit): ky akuifer është përdorur për një kohë të gjatë nga industria e naftës. Në këtë akuifer kalojnë edhe një numër pusesh të cilët kanë edhe teknologji të vjetër gjë që në një farë mënyre tregon se puset nuk janë izoluar mirë (Në SHBA kur pus-shpimet e naftës bëhen në trupin e akuiferit nuk lejohet përdorimi i tij për uje të pishëm). Si rrjedhojë, për aq kohë sa nuk ka studime të thella për ndikimin e industrisë së naftës në cilësinë e ujërave të këtij akuiferi, rekomandohet me forcë që ujërat e Akuiferit të Fierit të mos përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë së Bashkisë së Fier. Megjithatë, e ritheksojmë se rekomandohet ndërprerja e menjëhershme e furnizimit me ujë të popullsisë së zonave urbane dhe fshatrave të Bashkisë së Fierit që furnizohen nga ky akuifer për aq kohë sa nuk janë kryer studimeve të thelluara rreth cilësisë së ujërave të akuiferit dhe ndotjes nga nafta.

Monitorimi në mënyrë urgjente i Akuiferit të Semanit e Vjosës për ndotje nga nafta (naftë bruto, gasoline, dhe aditivë të gasolinës). Monitorim për ndotje nga nafta është tejet I nevojshëm në Akuiferin e Vjosës në zonën nga Gorishova e cila gjendet shumë afër zonës naftënxjerrëse të Cakranit. Monitorimi duhet të ketë si qëllim të përcaktojë llojin e përdorimit të ujërave të Akuiferit të Semanit (nëse ujërat e këtij Akuiferi mund të përdoren për furnizim me ujë të popullsive të Bashkive Fier) dhe të Vjosës. Nevoja e monitorimit është urgjente edhe për faktin se ujërat e Akuiferit të Semanit përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë së disa fshatrave ndërsa Auifei i Vjosës përdoret për furnizimin me ujë të një numri të madh popullsie në Bashkinë e Fierit.

Mbas monitorimit të Akuiferit të Vjosës, të përcaktohet lloji i përdorimit të ujërave të këtyre akuiferëve (industrial apo për pije) sidomos në zonat Kafaraj, Pishë-Poro e Novoselë. Është e nevojshme që të shmanget përdorimi i ujërave të akuiferëve për pije në rast se mbas monitorimit, rezultojnë të ndotur.

Masat e mëposhtme vlejnë ë mënyrë të veçantë për mbrojtjen e cilësisë së ujërave të akuiferëve që shërbejnë për furnizim me ujë të popullsisë

Zbatimi dhe mbrojtja e zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve (legale/ilegale): Në Bashkinë e Fierit, pus-shpimet janë shërndarë përgjatë përgjat Semanit, kryesisht në fshatrat Kallm i Vogël, Kallm i Madh, Mbrostar, Grecalli, Petovë dhe Mujalli. Nga studimet e kryera[467], mungesa e zbatimit të zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve është përcaktuar si një ndër shkaqet kryesore që çojnë në ndotjen e akuiferëve. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Fierit:

- Të krijojë një regjistër ku të regjistrohen pus-shpimet legale dhe ilegale në territor dhe vendodhja e tyre me qëllim përcaktimin e cilësisë së këtyre ujrave dhe gjetjen e mundësisë për shmangjen e konflikteve më veprimtaritë e tjera (nafta, bujqësia, urbanizimi) që shkaktojnë ndotje në to. Pus-shimet duhen klasifikuar sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore. Kjo ndihmon për inspektimin e tyre të tyre të herë pas hershëm.
- Të krijojë dhe mbrojë zonat higjeno-sanitare përreth të gjitha pus-shpimeve në zbatim të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 " Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm".

- të zonohet territori sipas ndjeshmërisë së akuiferëve ndaj ndotjes sipërfaqësore në rast shpimesh. Kjo ndihmon për të përcaktuar se në cilat zona lejohen shpimet sepse nuk përbëjnë rrezik ndotjeje për akuiferët dhe në cilat zona ndodh e kundërta. Në rast të kundërt, rekomandohet krijimi e një liste në të cilën pusshimet renditen sipas nivelit të rrezikshmërisë që ato paraqesin për ndotjen e ujërave nëntokësore me qëllim ushrimin e kontrollit të tyre të herë pas hershëm.
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura industriale në Seman, Vjose dhe Gjanicë.

Krijimi i zonave të mbrojtura me status të veçantë (Dritaret hidrogjeologjike) në lumenj: Në disa zona të bashkisë, ujërat sipërfaqësorë (ujërat e lumenjve Vjosë dhe Seman) kanë lidhje të mira hidrologjike me ujërat nëntokësore e si rrjedhojë ujërat e lumenjve ushqejnë akuiferët. Në Bashkinë e Fierit lind nevoja që në ato zona ku ujërat sipërfaqësorë të lumenjve Vjosë, Seman e Gjanicë ushqejnë akuiferët, të krijohen zona të mbrojtura me status të veçantë (Dritaret Hidrogjeologjike).[468] Të tilla zona janë të rëndësishme për mbrojtjen e akuiferëve nga ndotja dhe duhen konsideruar si Zona të Mbrojtura gjatë planifikimit të zhvillimit të territorit në Bashki. Si hapa të parë në Bashkinë e Fierit, rekomandohet:

- dhënia e statusit "Zonë e Mbrojtur me Status të Veçantë" për zonat që shërbejnë si Dritare Hidrogjeologjike (ato zona të territorit që ushqejnë akuiferët). Përgjatë luginës së Vjosës, një zonë e tillë është zona nga Fusha e Hekalit deri në Mifol[469]. Kjo është edhe zona ku ujërat e Vjosës ushqejnë akuiferin me të njëjtin emër. Në luginën e Semanit, për përcaktimin e dritareve hidrogjeologjike nevojitet bashkëpunimi me SHGJSH-në.
- Në zonat e quajtura dritare hidrogjeologjike, të ndalohet dhënia e lejeve për pus-shpime/aktivitete ndotëse[470] ose të ndërpritet leja e aktiviteteve aktuale që shkaktojnë ndotje në mjedis. Rekomandohet që të vendosen kushte të rrepta që garantojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore gjatë dhënies së lejeve për aktivitete të ndryshme në këto zona.
- Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis.

Ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit për inertet lumore në zona të ndjeshme ndaj ndotjes: rekomandohet ndalimi i dhënies së lejeve të shfrytëzimit të inerteve lumore në zonat e ndjeshme, me qëllim ruajtjen e ekulibrave hidrodinamikë të akuiferëve, në bashkëpunim me Këshilllin dhe Agjensinë e Baseneve Ujor të Semanit dhe Vjosës. Ky rekomandim vjen edhe në zbatim të VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve".

Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktivitetetve ekonomike në zonë: AKM në bashkëpunim me SHGJSH monitoron gjendjen e burimeve ujore nëntokësore rregullisht me bazë vjetore[471]. Megjithatë, vihet re se numri i pikave të monitorimit për përcaktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në çdo basen e akuifer është i ulët, ndërkohë që zonat

me ndjeshmëri të lartë ndotjeje janë të larta, veçanërisht në akuiferët e Basenit të Semanit. Pikat më problematike brenda territorit të Bashkisë Fier përkojnë me shtrirjen e lumit Gjanicë. Me qëllim monitorimin e hollësishëm të cilësisë së ujërave të akuiferëve të Qarkut Elbasan, rekomandohet shtimi i pikave të monitorimit të akuiferëve dhe shtimi i parametrave të monitoruar. Në Bashkitë si Fieri rekomandohet monitorimi i parametrave që tregojnë edhe ndotjen nga nafta.

Të merren masa për mbrojtjen e akuiferëve nga Industria e naftës: Në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, nevojitet një direktivë specifike që trajton mbrojtjen e akuiferëve që shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë nga ndotja industriale, sidmomos nga industria e naftës, nxjerrja e mineraleve dhe prodhimi i energjisë gjotermale. Siç ndodh në vendet më të shvilluara si SHBA[472], direktiva duhet:

- Të përcaktohet nëse lejohet shpimi i puseve të naftës në akuiferë që përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Të përcakton zona të ndjeshme ndaj ndotjes në të cilat duhen shmangur aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje (mundësisht aktivitete industriale që pajisen me leje mjedisore A dhe B). Është me rëndësi të përcaktohet edhe largësia nga akuiferi (një zonë mbrojtjeje) brenda së cilës nuk lejohet shpimi i puseve industriale.
- Të hartojë një program për mbrojtjen e akuiferëve nga veprimtaria industriale dhe e naftës. Ky program duhet:

  - Të përcaktojë akuiferët që duhen ruajtur (ku përjashtohet çfarëdolloj veprimtarie industriale) sepse me rëndësi jetike për furnizimin me ujë të popullsisë. Këto akuiferë nuk mund të preken nga pus-shpime të ndryshme industriale
  - Të përcaktojë akuiferët ujërat e të cilëve janë tashmë të ndotur dhe mund të përdoren vetëm për qëllime industriale
  - Të përcaktojë trupat ujorë nëntokësorë të cekët dhe të thellë ujërat e të cilave lejohet të shfrytëzohen nga industria në përgjithësi dhe industria e naftës në veçanti si dhe të caktohet kuota e lejuar për shfrytëzim me qëllim që të shmangen rënie të nivelit të sipërfaqes së tokës.
  - Të përcaktohet nëse lejohet ri-injektimi (venddepozitimi) i ujërave të përdorura e të ndotura të industrisë së naftës
  - Në qoftë se lejohet ri-injektimi, të përcaktohen zonat ku ri-injektimi lejohet me ligj dhe zonat në të cilat ërjashtohen. Gjithashtu, në këtë rast, nevojitet që të përcaktohen me ligj kushtet teknike nën të cilat mund të kryhet ri-injektimi.
  - Të përcaktohen standardet që kompanitë e naftës duhet të zbatojnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e puseve të ri-injektimit
  - Të përcaktohen me ligj institucionet përgjegjëse për rregullimin e veprimtarisë së ri-injektimit në vend.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem në burimet ujore përbëjnë dhe infiltrimet e kimikateve dhe pesticideve që përdoren në bujqësi.

Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore të akuiferëve

Pajisja me një pasqyrë të rezervave vjetore të ujërave nëntokësore në akuiferë. Pasqyra të kihet parasysh gjatë dhënies së lejeve për shfrytëzimin e ujërave të akuiferëve me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të akuiferëve.[473] Rritja e kërkesës për ujë për nevoja familjare dhe veprimtari të ndryshme ekonomike ka rritur trysninë mbi akuiferët, në veçanti mbi Akuiferët e Fierit, duke çuar në mbishfrytëzimin e tyre. Në periudhën me reshje të pakta në verë (qershor-shtator), kërkesa për ujë rritet edhe më tej nga sektori i turizmit e bujqësisë. Në këtë periudhë, akuiferët kanë nivelin më të ulët të ujit në krahasim me periudhat e tjera të vitit për shkak të mungesës së shirave. Rol kryesor në menaxhimin e akuiferëve kanë SHGJSH-ja, Agjencia e Menaxhimit të Basenit të Semanit dhe Vjosës (ABU Seman dhe ABU Vjosë) së bashku me Bashkinë e Fierit dhe bashkitë e tjera përkatëse që shfrytëzojnë akuiferët. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujorë rrjedh si pasojë e zbatimit të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

Të analizohen akuiferët në thellësi mbi 200m: deri më sot, SHGJSH ka kryer studime përreth akuiferëve të cekët (nën 200m thellësi). Duke qenë se industria e naftës dhe industria në përgjithësi shfrytëzon edhe ujërat e akuiferëve në thellësi mbi 200m, lipset që këto akuiferë të pasqyrohen në inventarin e burimeve ujore në mënyrë që të përcaktohet ndikimi i industrisë në këto akuiferë dhe pasojat që mbishfrytëzimi i tyre mund të ketë në supërfaqe (ulje të nivelit të tokës).

Monitorimi i sasisë së ujit që shfrytëzohet nga akuiferët në Qarkun Fierit e Bashkitë e tij: Sipas ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", Bashkisë së Kuçovës në bashkëpunim me AKM, ARM dhe Këshillin dhe Agjensinë e Basenit Ujor të Semanit dhe Vjosës i del për detyrë të mbikqyrin dhe të detyrojnë subjektet dhe individët të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontrroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private për të eleminuar lidhjet e paligjshme dhë shfrytëzimin e pakontrrolluar të akuferit ujëmbajtës. Kjo do të sillte një mirëmenaxhim të burimeve ujore dhe, përsa i përket Akuferët e Fierit, Bashkia do të kishte informacion më të saktë për përdorimin e tij.

- **Propozime, Rekomandime dhe masa për zonën bregdetare:**

- Për zonën e Lagunës së Karavastasë duhet menjeherë të vendoset sistemi i mbajtjes hapur të kanalit të komunikimit të Lagunës me detin (kanali i Vahut).

- Erozioni në afërsi të godullës së re të Karavastasë duhet të mbahet nën vëzhgim për të ndërhyrë në rast se ky fenomen kërcënon shkatërrimin e këtij ekosistemi natyror me vlera.

- Duhet të monitorohen puset që shfrytezojnë ujin në suitën Rrogozhina, për të mos lejuar ndotjen e kësaj pasurie të rëndësishme natyrore.

- Të mbillen Marina (Tamarix) në të gjitha tokat e kripura dhe në brezat e gjelbër mbrojtës përgjatë vijës bregdetare.

- Të mbillen zonat ripariane përgjatë Semanit, Vjosës dhe Kanaleve kulluese kryesore, me pemë si; robinja (*Robinia Pseudoacacia*), rrapi (*Latanus*), Shelgë (*Salix*), plepi i bardhë (*Populus Alba*) dhe shkurre si; mersina, gjineshtra (*Sportum Juniceun*), dëllinjë (*Juniperus*), shqopë (*Rika Arborea*) dhe marina (*Tamarix*).

- Drunjtë e sjellë nga lumi Vjosa dhe Seman, mund të përdoren për rimëkëmbjen e dunave dhe rripave të gjelbër mbrojtës nga veriperëndimi i Povelçës e deri në grykëderdhjen e lumit Seman.

- Të orientohet aktiviteti njerëzor/ekonomik në plazhin e Semanit dhe pronarët të krijojnë brezat e gjelbër për ndërtimet e tyre, për të ndihmuar krijimin e "pritave" të rërës, për të mbrojtur bimësinë nga pas.

- Të mirëmbahen dunat ekzistuese dhe të zgjerohen më tej, përmes mbjelljes së bimësisë barishtore për duna.

- Të mirëmbahet zona e mbrojtur e Pishë-Poros, jo thjesht për vlerat e saj ekologjike apo si atraksion turistik, por si elementi natyror më i mirë mbrojtës i zonës nga depërtimi i detit, erozioni, dhe erërat në tokën bujqësore.

- Të kryhen studimet e hollësishme gjeologo-inxhinierike para se të avancohet më çfarëdolloj ndërtimi në zonën bregdetare.

- Nuk rekomandohet ndërtimi i porteve tregtare në këtë bregdet.

- Korridori blu është propozuar të kalojë në rrugët ekzistuese, duke shfrytëzuar akset e rrugëve bujqësore dhe më pas futet në zonën e resorteve turistike duke realizuar jo vetëm shërbimin për to, por edhe elementin mbrojtës nga ndërtimi të pyllit të Pishë-Poros.

- Zonimi i preferuar për shfrytëzimin e zonës bregdetare për qëllime të ekonomisë së turizmit, gjithmonë pas vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe lejes mjedisore, do të ishte:

i) zona mbi grykëderdhjen e Semanit është kryesisht grumbulluese dhe mund të ishte e përshtatshme për plazhe. Mirëpo është në dinamikë të ndryshueshme dhe veç kësaj është pjesë e ekosistemit të lagunës, ndaj rekomandohet të ruhet si habitat natyror i pacënuar nga aktiviteti njerëzor, përveçse për shëtitje dhe studime;

ii) Në jug të grykëderdhjes dhe mbi brezin e TAP-it, zona mund të përdoret për plazhe publike dhe ndoshta krijimin e një marine. Nuk rekomandohen ndërtime, pasi edhe kjo zonë është në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të lëvizjes së Semanit dhe ndryshimit të grykëderdhjes së tij. Në këtë zonë, ndodhet edhe një sipërfaqe fond pyjor (privat) tejet e kripëzuar;

iii) Zona poshtë brezit të TAP-it dhe deri në Darëzezë, ka probleme të zvogëlimit të shpejtë të plazhit, për shkak të thyerjes tektonike. Ajo zhytet drejt detit. Zona ka qenë historikisht e preferuar për plazhet publike dhe rekomandohet ta ruajë këtë funksion. Paqëndrueshmëria e saj nuk e favorizon për asnjë lloj ndërtimi, veç atyre të

përkohshme verore dhe të lëvizshme gjatë dimrit. Plazhi duhet të sistemohet për një përdorim të racionalizuar, dhe me shërbime ditore. Po ashtu, duhet të merren masa anti-erozion (jo shumë të shtrenjta) edhe pse këto nuk do ta zgjidhnin problemin e zhytjes, por së paku do të ndihmonin në rritjen e jetëgjatësisë së plazhit. Një koncept i sistemit të zonës jepet në figurën x. Në skajin më jugor të kësaj zone, mund të parashikohet një marinë e dytë e vogël për peshkim, si edhe zona e peshkimit, bazuar në traditën vendase;

iv) Në jug të Darëzezës dhe deri në grykëderdhjen e Vjosës, ku bregu ka karakter gërryes dhe grumbullues dhe nuk rrezikon zhytjen si më sipër, mund të krijohen dy zona plazhi: zona publike në pjesën veriore, dhe zona e resorteve në pjesën jugore. Të dyja kanë nevojë për një koncept sistemimi për shfrytëzim racional, sistemim me struktura të lehta e mundësisht natyrore anti-erozive (penda të drunjta, duna dhe bimësi dunash). Në çdo rast zona pyjore ruhet e paprekur dhe mirëmbahet. Në pjesën më jugore të këtij plazhi mund të krijohet një marinë e vogël turistike, në funksion edhe të resorteve.

- Sa i përket ndërtimit të resorteve turistike në hapësirën tokë bujqësore në zonën e Pishë-Poros, argumenti është si më poshtë:

Në nenin 9 (Rezervat Natyror i Manaxhuar/Park Natyror) të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002, "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, përcaktohet se:

"1. Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjie, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervate natyrore të manaxhuar (park natyror).

2. Në parkun natyror zbatohet **shkalla e tretë e mbrojtjes**, ku **ndalohen**:

a**) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore**, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

b) **depozitimi i kimikateve**;

c) **lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë** rrugëve publike dhe **vendeve te caktuara** për parkim;

ç) **mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve poleontologjike dhe e gurëve**;

d) ngritja dhe funksionimi i **objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje**.

dh) **vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave**, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

e) **ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara**.

3. **Veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji** dhe **çdo veprimtari** tjetër, **që nuk ndalohet nga ky nen**, mund të **ushtrohen, pasi të pajisen me leje mjedisi**.

4. **Zonë buferike** e zonës së manaxhimit të habitateve dhe llojeve mund të shpallet territori rreth saj, me gjerësi **50 m nga kufiri i zonës**."

Në vijim, pika 5 dhe e fundit e nenit 9 thotë se për shfrytëzimet turistike të formacioneve natyrore, të cilat ndodhen në këtë rezervat, Ministrat përkatës të Mjedisit, Territorit, dhe Pushtetit Vendor miratojnë rregulla të qëndrueshme e të kontrollueshme për kalime vizitorësh vetëm për afate kohore të shkurtra, duke respektuar masat mbrojtëse të shkallës së tretë. Ndërkohë, pika 2 e nenit 5 të ligjit, sikurse përmendet më sipër, përfshin një listë të gjatë ndërhyrjesh, mes të cilave edhe "ndërtime të çdo lloji".

Nisur nga ky arsyetim, në zonën e mbrojtur të Pishë-Poros mund të realizohen ato ndërtime, të cilat nuk prekin sipërfaqen e pyllit (drurët dhe burimet ujore), si dhe vetëm me një leje mjedisore, e cila lëshohet nga autoritetet përkatëse të mjedisit në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe përshtatshmërinë e ndërtimit ndaj përdorimit ekzistues të tokës në zonën e mbrojtur. Ndërtimet kufizohen edhe më tepër nga ekzistenca e pishës së zezë, monument natyror. Këto pisha, jo vetëm nuk duhet të priten, por edhe habitati i tyre nuk duhet të dëmtohet sepse do të rezultonte në dëmtim të pishave të zeza. Në rastin më të mirë, ndërtimet mund të realizohen jashtë zonave të mbrojtura dhe në kufi me zonat buferike të tyre (përkatëse). Për Pishë-Poron kjo është e mundur pasi ka në kufi zona të sistemit bujqësor. Sigurisht ndërtimet përballen me disa kushtëzime si më poshtë:

1. Nevojën për procedurë të ndryshimit të kategorisë së tokës bujqësore në tokë të sistemit urban sipas ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, ligji nr. 8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", VKM-ja nr. 410, datë 27.06.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës" dhe VKM-ja nr. 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar.

2. Distancën nga zona buferike e Pishë-Poros;

3) Përputhshmërinë mes kategorisë së përdorimit të ndërtimit të ri dhe kategorive të sistemit natyror e bujqësor përreth – p.sh. ndërtimet industriale në këtë pjesë janë të papërputhshme dhe konfliktuale;

4) Distancën nga brigjet ujore sipas ligjit për manaxhimin e integruar të burimeve ujore;

5) Marrjen e masave për mbrojtje nga përmbytjet e lumit Vjosa (për shkak të afërsisë së madhe me deltën) dhe për të mos lejuar depërtimin e detit drejt zonës së ndërtuar, qoftë edhe si efekt i ndryshimeve klimatike. Veçanërisht faktori i fundit (përmbytjet dhe ndryshimet klimatike) janë një argument i fuqishëm në favor të mbrojtjes së pyllit të Pishë-Poros dhe dunave përgjatë bregut, të cilat veç vlerave ekologjike, natyrore, peizazhistike, të biodiversitetit etj. shërbejnë edhe si mbrojtës natyrorë të bregut dhe zonave të ndërtuara në brendësi.

Së fundi, duke qenë se zona bujqësore midis dy masiveve pyjore të Pishë-Poros, është e kripëzuar, përdorimi i saj për ndërtime të qëllimit turistik (resorte cilësore dhe të parametrave ndërkombëtarë) është një nga opsionet e mundshme, dhe gjithmonë duke

respektuar faktorët kufizues të përmendur më lart. Këto ndërtime, për shkak të vlerës peizazhistike e estetike të zonës, si edhe sepse nuk duhet të duken nga kodra e Apollonisë, nuk duhet të jenë kurrsesi më të larta se sa pylli i Pishë-Poros, dhe në çdo rast jo më tepër se sa 15 m, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408 (rregullorja e zhvillimit të territorit) për lartësinë e objekteve.

2.3.4 Cilësia e ajrit

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj. Ligji 162/2014 "Për mbrojtjen e silësisë së ajrit në mjedis" është ligji kryesor që ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë specifike të përmirësimit të cilësisë së ajrit së bashku me ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij.

Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor dhe ajrit, u vu re se cilësia e ajrit në Bashkinë Fier nuk është e mirë, kryesisht në zonat naftënxjerrëse. Burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit në Bashkinë Fier janë kryesisht mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, industria e rëndë dhe kryesisht industria e naftës së bashku me sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimet. Në analizë u vu re edhe mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit gjatë gjithë vitit (monitorimi në një numër shumë të kufizuar ditësh gjatë vitit dhe mungesa e një rrjeti monitorimi me pajisje fikse në pika të caktuara në Bashki për monitorimin e përhershëm ose ditor të cilësisë së ajrit).

- Masat e parashikuara në PPV

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Fier ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për uljen e ndotësve të shkarkuar në mjedis nga transporti përfshijnë :

- uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane,
- shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet,
- hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë.
- planifikimin efiçent të territorit

- Masa të tjera shtesë

Krahas masave të mësipërme të propozuara në PPV, rekomandohet edhe marrja e masave shtesë të cilat përfshijnë:

- Zbatimin e masave të popozuara për përmirësimin e cilësisë së ajrit në PPV,
- Hartimin e Planeve të Detajuara Vendore (PDV-VE) duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik dhe transport alternativ (këmbësor, bicikleta, etj.). Kjo kërkon hartimin e politikave që synojnë fuqizimin e transportit publik, favorizimin e këmbësorëve dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të transportit alternativ (biçikleta ose motorrë, të paktën në zonat

urbane). Kjo gjithashtu kërkon zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, kufizimin e numrit të makinave në qarkullim në qendra urbane, shtimin dhe zgjerimin e trotuarve në rrugët më të rrahura nga qytetarët, fuqizimin e mëtejshëm të transportit publik dhe shtimin e korsive të biçikletave përgjatë akseve të rrugëve në qendra dhe nëpërmjet rrugëve që lidhin NjA-të e afërta në largësi, etj. Kjo nënkupton edhe zhvillimin territorial të qendrave të NjA-ve ose urbane në parimin e përdorimit të tokës/trullait në mënyrë efiçente dhe të përqendruar dhe jo të shpërhapur (përdorime mikse të zonave që nënkuptojnë biznese, banime, dhe shërbime në të njëjtën zonë), me qëllim uljen e kilometrave që qytetarët nevojitet të përshkojnë me makinë për plotësimin e nevojave të tyre (blerjet, udhëtime për në institute, shkolla, qendra spitalore) në jetën e përditshme.

- Përfshirjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Planet Sektoriale të transportit publik, transportit rrugor, zhvillimit urban, industrial, të tokës, pyjeve, etj.

Për më tepër, duke patur parasysh që burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit në Bashkinë Fier shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, *industria e rëndë dhe kryesisht industria e naftës* së bashku me sektorë të tjerë të ekonomisë si ndërtimet, rekomandohet:

- Hartimin e Planit të Veprimit Afatshkurtër për PM_{10}, NO_2 dhe Benzenin, në zbatim të Ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit", neni 8 pika 4. Nga analiza e cilësinë së ajrit në territorin e Bashkisë Fier, përmbajtja e PM_{10}, NO_2 dhe Benzenit në ajër është më e lartë së vlerat kufi të përcaktuara me ligj. Hartimi i planeve të tilla është kërkesë ligjore për Bashkinë sa herë që përmbjantja e në ndotësi në ajër kalon kufinjtë e caktuar me ligj.
- Bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM) për monitorimin e përditshëm të treguesve problematikë të ajrit (P_{M10}, NO_2 dhe Benzenin) deri në përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas standarteve ligjore.
- Krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në Qytetin e Fierit dhe në zonën naftënxjerrëse ku ka një përqëndrim të lartë pusesh. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM, dhe Institutin e Shëndetit Publik).
- Krijimi i stacioneve fikse të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në zona me aktivitet të lartë industrial si ajo e naftës. Në këtë mënyrë arrihet të kuptohet se cili është ndikimi i industrisë në shëndetin e banorëve.

Duke patur parasysh që në territorin e Bashkisë Fier veprojnë subjekte të industrisë së rëndë) të cilët shkarkojnë sasi relativisht të larta në ajër, rekomandohet që Bashkia:

- të marri pjesë aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve,
- të ndërmarrë nisma të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të llojit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi.
- të bashkëpunojë me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë.

- Të marrë masa që gjatë ndërtimeve (pallateve në veçanti) në qytet, të merren masa mbrojtëse për ajrin (të përdoren rrjeta, spërkatje me ujë, etj.)
- Të menaxhohen mbetjet sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre në venddepozitimet e mbetjeve. Pra, nevojitet që venddepozitimet e mbetjeve të pajisen me sistemin e kapjes së gazrave që çlirohen nga degradimi i mbetjeve në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë

2.3.5 Rekomandime mbi zonat e nxehta mjedisore

Venddepozitimet e mbetjeve urbane: Në Bashkinë Fier është i vendosur venddepozitimi të mbetjeve, njëra e vendosur në Urën e Mbrostarit në brigjet e lumit Seman. Nuk duhet të lëmë pa përmëndur se ka dhe pika ilegale të grumullimit të mbetjeve në territor. Ndaj,

- në PPV Bashkia ka propozuar një projekt për rehabilitimin e vend-depozitimeve duke bërë rehabilitimin e tokës dhe duke i kthyer në zona të gjelbërta. Këto depozitime janë jashtë kushteve tekniko dhe higjeno-sanitare. Ato kanë shkaktuar ndotje në tokë, në ajër dhe në ujëra nëntokësorë dhe rrjedhimisht dhe sipërfaqësor ose anasjelltas.
- Në PPV është propozuar edhe ndërtimi i një impianti djegës së mbetjeve urbane duke eleminuar një herë e mirë të gjithë problemet e mbetjeve të shkaktuara ndër vite. Ky projekt është propozuar në PPV nga Bashkia si një detyrim i cili i lind nga ligji Nr.139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore".
- Krahas ndërhyrjes rehabilituese të landfillit ekzistues, në periudhën afatshkurtër propozohet varianti i izolimit të zonës së vend-depozitimit, në trajtë karantine, pa lejuar aktivitete njerëzore e ekonomike të ndodhin në këtë zonë.

Venddepozitimet e mbetjeve industriale : Një problem i rëndësishëm përsa i përket mbetjeve janë dhe ato industrial veçanërisht ato nga industria e naftës, të cilat nuk kanë një vend specifik të depozitimit të tyre.

Duke ditur që në këtë Bashki industria zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë duhet marrë masat e përshtatshme, që industrisë t'i krijohen kushtet e përshtatshme për zhvillimin e saj. Ndaj ne rekomandojmë që Bashkia duhet të

- përcaktojë një vend transferimi të përkohshëm për mbetjet e gjeneruara nga aktivitetet me leje të tipit C. Këto vend transferimi duhet të përcaktohen deri në një moment të dytë ku të hartohen nje Plan Menaxhimi Rajonal në lidhje me to.
- të hartojë një program që përcakton llojin e teknologjisë që duhet të përdoret për shpim
- të hartojë programe që rregullojnë veshjen e puseve ose izolimin efikas të tyre
- të hartojë një plan veprimi për indentifikimin dhe regjistrimin e puseve që janë jashtë funksionit dhe izolimin e tyre

- detyrojë dhe kontrrollojë përdorimin e sasisë së ujit që përdoret nga industria e naftës
- duhet të sigurohen që pus-shpimet e nxjerrjes së naftës të mos ndikojnë ujin në akuifer
- duhet të marrë masa që shkarkimet industrial të kenë kaluar filliisht në trajtim paraprak dhe të mos derdhen në lumenjtë e Bashkisë Fier
- duhet të instalojë sistemin e kanalizimeve vetëm për industrinë dhe të projektojë dhe ndërtojë një impiant vetëm për trajtimin e ujërave industriale

2.3.6 Rekomandime mbi zonat historike dhe monumentet e kulturës

Bashkia Fier bart një larmishmëri të madhe të monumenteve të kulturës në territorin e saj. Nga parku më i madh arkeologjik i vendit Apollonia, e deri në disa mozaikë antikë, kisha e manastire, kala të periudhës antike dhe banesa popullore.

Veçanërisht e ardhmja dhe trajtimi i Apollonisë varet shumë nga miratimi dhe vënia në zbatim e një plani menaxhimi të hartuar tashmë por të pa ligjëruar nga Ministria e Kulturës. Ky plan ndër të tjera ka sugjeruar një zonifikim të ri të Apollonisë, duke saktësuar kufijtë e zonës arkeologjike dhe të vetë parkut si dhe ka ofruar parashikime për përdorimin me kritere të tokës brenda kufijve të parkut (zona B). Draft plani i menaxhimit përbën një udhëzues të mirë aktualisht për të parashikuar ndërhyrje emergjente përsa i përket çështjes së konservimit të monumenteve në park por edhe orientime për aktivitete me interes ekonomik dhe turistik për zonën.

Problematikat e Apollonisë shtrihen nga prezenca e 3 fshatrave të banuar dhe aktivitetit të tyre që duhet të jetë në harmoni me kriteret për mbrojtjen e pjesazhit kulturor, e deri te rishikimi i rrugëve të lëvizjes brenda territorit të parkut për banorët, siç është rasti i fshatit Kryegjatë ku sugjerohet krijimi i një rruge që do të lidhë këtë fshat me rrugën e re Levan-Fier duke evituar kalimin mespërmes mureve antike të Apollonisë nga banorët.

Problematika e 2 banesave në zonën e ish-repartit ushtarak në veri të Apollonisë mund të evitohet duke krijuar aksesin e nevojshëm rrugor për to që të lidhen me fshatin Havaleas duke penguar rrjedhimisht kalimin e mjeteve në brendësi të parkut arkeologjik. Në këtë mënyrë mund të mbrohet edhe më mirë parku arkeologjik (në aspektin e sigurisë).

Të gjitha kishat në territorin e bashkisë Fier kanë nevojë urgjente për pajisjen me zonat e tyre të mbrojtura si dhe projekte të restaurimit të tyre. Çështjet që duhet të merren në konsideratë janë ndalimi i ndërtimeve të reja në afërsi të tyre, zgjidhja e problematikës së varrezave moderne pranë tyre (rasti i varrezave brenda parkut arkeologjik të Apollonisë gjithashtu duhet trajtuar në këtë kontekst).

Kalaja e Gurzezës, qyteza e Cakranit dhe vendbanimi prehistorik në Cakran janë një grup sitesh shumë të rëndësishme arkeologjike dhe monumentale dhe si të tilla duke u gjendur pranë zonës së banuar të Cakranit kanë nevojë për zonat e mbrojtura të tyre. Për shkak të pozicionit të tyre në terren (Gurzeza dhe Cakrani) në hapësirën kodrinore të Cakranit dhe vendbanimi prehistorik në fushën në perëndim të Cakranit, presioni ndërtimor e zhvillimor në tërësi është aktual. Gurzeza është më e distancuar nga qendra e banuar, si dhe mungesa e rrugës për të arritur këtë sit arkeologjik e mbron natyrshëm nga problematikat. Gjithsesi, mungesa e rrugës ka sjellë grabitjen e herëpashershme të saj në periudha të ndryshme duke sjellë dëmtime të pariparueshme në nëntokën dhe potencialin e pasur arkeologjik. Ndërtimi i rrugës, miratimi i zonës

së mbrojtur, krijimi i hapësirës së parkimit si dhe pajisja me roje (nga bashkia në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës), do të sillte në hartën e vizitueshmërisë këtë destinacion duke rritur interesin e vizitorëve të turizmit kulturor. Në këtë mënyrë dhe sitet e tjera të zonës mund të prezantohen më mirë dhe zhvillimi i tyre të vendoset në një kontekst më të mirë.

2.4 Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së

2.4.1 Fazat e zbatimit të planit

Fazimi i rrjetit infrastrukturor

Fazimi i infrastrukturës rrugore rajonale është bazuar në projektet strategjike që ka Plani i Përgjithshëm Kombëtar si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Një nga prioritetet që pritet të ndëtohet në përiudhën 1-3 vjet është bypass-i i Fierit. Në ketë aks po vazhdojnë punimet dhe priten të mbyllen brenda 2 viteve. Bypass-i i Fierit është pjesë e korridori VIII i cili është korridori i vetëm Pan-Europian që kalon në Shqipëri.Transporti publik propozohet që të aksesohet nga të gjithë banorët e bashkisë gjatë periudhës 1-3 viteve. Ky shërbim është i rëndësishëm për mobilitetin (lëvizshmërinë) normal të bashkisë. Unaza e brendshme e qytetit pritet të mbyllet në brenda 5 viteve duke parë që një pjesë e saj është ekzistuese. Inteneraret e tjera të cilat shtrihen kryesisht në zonat rurale do të kenë zhvillim afatgjatë deri në vitin 2030 i cili përfundimi i planit. Rrugët ekzistuese janë vendosur në përiudhen 1-3 sepse kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme.

Fazimi i projekteve strategjike

Tabela 131. Fazimi i projekteve prioritare

Objektivat	Projektet	Fazimi		
		1-3	3-5	5-15
O1P1: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy poleve ekonomike rajonale, pranë fshatit Daullas (në jug të vijës së Ngjalës) dhe në Levan	PR1: Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse për funksionimin e polit ekonomik në fshatin Daullas dhe Levan			
O1P2: Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për përqendrimin e bizneseve të industrisë së rëndë dhe asaj të ndërtimit në Portëz në kryqëzimin e rrugëve Fier-Kuçovë dhe Fier-Ballsh	PR2: Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse për funksionimin e polit ekonomik në kryqëzimet Fier-Kuçovë dhe Fier-Ballsh			

O1P3: Përmirësim i infrastrukturës dhe mbështetje e Shkollës së Mesme Profesionale "Rakip Kryeziu" si pol për zhvillimin e praktikave të mira në sektorin e bujqësisë	PR3: Rikonstruksion, laboratorë e bazë materiale për shkollën "Rakip Kryeziu", si dhe zgjerimi isipërfaqeve të tokës bujqësore në administrim prej saj për kërkime, testimeve, e fidanishte publike.			
O1P4: Mbështetje, marketim, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale	PR4: Ndërtimi i tregjeve ushqimore në funksion të zhvillimit të sektorit të bujqësisë (në Levan dhe Mbrostar)			
	PR5: Ndërtimi i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Fier dhe zonave pranë			
O1P5: Hartimi i projektit për rehabilitimin mjedisor të ish zonës industriale të Azotikut, dhe për kthimin në pol ekonomik të bashkisë	O1P5: Hartimi i projektit për rehabilitimin mjedisor të ish zonës industriale të Azotikut, dhe për kthimin në pol ekonomik të bashkisë			
O2P1: Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe ujitës për të gjithë territorin e Bashkisë Fier	PR1: Rehabilitimi i stacionit të elektropompave Mujalli dhe Bitaj, ana ndërtimore, makineri, pajisje dhe rrjeti ujitës			
	PR2: Rehabilitimi i rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve te dyta në zonën Kallm-Verri-Mbrostar			
	PR3: Rehabilitimi i sistemit të kullimit në zonën Kallm Verri Mbrostar - Kolektori i Bitajt dhe rrjeti i kanaleve kulluese të para dhe të dyta			
	PR4: Rehabilitimi i Ujitjes dhe Kullimit të Fushës së Sheqit Fier			
	PR5: Rehabilitimi i Stacionit të elektropompave Havaleas bashkë me rehabilitimin e rrjetit ujitës Kanalit Ujitës Dega e Fierit dhe kanaleve të dyta			
	PR6: Rehabilitimi i sistemit ujitjes me stacionin e elektropompave Kafaraj, rehabilitimi i stacionit, ana ndërtimore, makineri pajisje dhe rrjetii i kanaleve			
	PR7: Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Vjosë ne fshatin Hambar njësia administrative Cakran, si dhe mbrojtja në fshatin Kashisht, njësia administrative Frakull			
	PR8: Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Seman në zonën e fshatit Seman Ferm, njësia administrative Seman			
	PR9: Mbrojtja nga përmbytjet në zonën e Poros dhe Pishës (Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse Bregdetari i Majtë)			
	PR10: Rehabilitimi i ujitjes së Fushës së Cakranit			

O2P2: Hartimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokës bujqësore	PR11: Projekt pilot për aplikimin e instrumenteve të menaxhimit të tokës për mbrojtjen e tokave bujqësore, në një nga njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja			
O2P3: Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP)	PR12: Hartimi i projekteve pilot PPP për rehabilitimin e disa aseteve publike dhe kthimin e tyre në pika magazinimi bujqësore			
O2P4: Identifikimi, inventarizimi, hartëzimi (hartografimi) dhe përmirësimi/zhvillimi i aseteve historike	PR13: Vendosja e sinjalistikës orientuese për zhvillimin e turizmit			
O2P5: Zhvillimi i itinerareve turistike dhe promovimi i tyre si paketa turistike në bashkëpunim me aktorët aktivë të këtij sektori në Bashkinë e Fierit	PR14: Hartimi i itinerareve turistike në Bashkinë Fier dhe Bashkitë fqinje			
O2P6: Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në fshatrat Pojan, Boçovë dhe Bashkim	PR15: Rikonstruksion i Rrugës Pishë-Poro dhe i rrugës Kthesa e Qarrit-Kryqëzim i Darzezës			
O3P1: Mbrojtja e bregdetit nga erozioni bregdetar	PR1: Plotësimi i brezit pyjor mbrojtës në bregdet Pishë-Poro-Zona Kërnicë			
	PR2: Pyllëzimi i bregdetit nga grykëderdhja e Lumit Seman deri në Darzezë			
	PR3: Ndërtimi i një ishulli të mbjellë me bimësi rizofore për mbrojtje të bregdetit nga dukuritë erozive detare			
	PR4: Ndërtimi i një brezi platformash/infrastrukturash mbrojtëse ndaj erozionit në bregdetin Darzezë-Pishë-Poro			
	PR5: Ndërtimi i një parku botanik me funksion rekreativ dhe ruajtës të llojeve bimore me interes rritje në zona të kripëzuara			
O3P2: Rehabilitimi i shtretërve lumorë të Semanit, Vjosës dhe Gjanicës	PR6: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjinaturës së lumenjve Seman, Vjosë dhe Gjanicë			
	Hartimi i projektit për krijimin e brezit pyjor mbrojtës kundër erozionit të lumit Vjosa			
	Hartimi i projektit për krijimin e brezit pyjor mbrojtës të argjinatuës së lumit Seman			
O3P3: Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale; Mbrojtja dhe	PR7: Zgjerimi i Pyllit të Levanit dhe kthimi i tij në Park			

zgjerimi i pyllit të Levanit				
O3P4: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane	PR8: Hartimi i një plani për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane për Bashkinë Fier			
	PR9: Ndërtimi i impiantit të djegies së mbetjeve urbane			
	PR10: Mbyllja dhe rehabilitimi i pikës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve në Fier			
O3P5: Zbutja e efekteve mjedisore nga aktiviteti industrial	PR11: Hartimi dhe zbatimi i projekteve për mbrotjen e Kanalit të Roskovecit nga aktiviteti Industrial i Bashkise Fier por edhe i bashkive fqinje			
O4P1: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me infrastrukturat kombëtare	PR1: Zgjerimi i Rrugës Aulona deri në Levan			
	PR2: Ndërtimi i Rrugës së Bregdetit Pishë-Karavasta e Re			
	PR3: Ndërtimi i 2 urave automobilistike mbi Seman: Adriatik dhe përgjatë rrugës së bregut			
	PR4: Ndërtimi i një ure këmbësore në Seman, përgjatë rrugës kryesore rurale Topojë-Ndërnënas.			
	PR5: Zgjerimi i urës ekzistuese në rrugën Rreth Libofshë-Mujalli			
	PR6: Plotësimi i unazës së Fierit nëpërmjet rikonstruksionit të rrugës “Unaza perëndimore” (nga hekurudha Fier-Ballsh deri në rrugën nacionale Fier-Vlorë)			
	PR7: Lidhja me rrugën "Celigrad" si portë hyrëse veriore, deri në Bypass, dhe nga Bypass në Daullas			
	PR8: Lidhja me rrugën "Teodor II Muzaka“ (Sheq i Madh, Bypass)			
	PR9: Zgjerimi i Rrugës së Semanit deri në bregdet.			
	PR10: Ndërtimi i rrugës lidhëse me parkun arkeologjik të Apolonisë-porta hyrëse perëndimore			
	PR11: Zgjerimi i terminalit të autobuzave ekzistues pranë varrezave të qytetit të Fierit, në drejtim të rrugës së Patosit dhe vënia e tij në funksion të transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë kufijve			
	PR12: Zgjerimi i rrugës së Cakranit, me korsi biçiklete dhe trotuarë			

O4P2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues përgjatë rrugës së Semanit dhe në aksin Fier-Mujalli-Grecalli	O4P2: Intensifikimi i aktivitetit urbanizues përgjatë rrugës së Semanit dhe në aksin Fier-Mujalli-Grecalli			
O4P3: Përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative në qytetin e Fierit dhe lidhjes së këtyre qendrave me njëra tjetrën	PR13: Ndërtimi i stacionit multimodal të Fierit			
	PR15: Rikonstruksion i rrugëve që lidhin fshatrat e qendrat administrative me njëra-tjetrën			
	Rruga Levan-Shtyllas			
	Rruga Gorishovë-Selishtë			
	Rruga Cakran - Floq			
	Rruga Agim - Havaleas			
	Rruga Fier -Daullas			
	Rruga Mujalli - Grecalli			
	Rruga Autostradë-Kallm i vogël			
	Kthesa e Qarrit - Darzezë			
	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme Grecalli			
	PR16: Ndërtimi i rrugëve Sheq Marinas-Ndërnenas; Bypassit të fshatit Adriatik; Hamil-Clirim; Ballëz-Clirim; Kreshpan-Vjosë; Topojë-bregdet; Adë-Drizë Myrteza; Grecalli-Mucaj; Darzeza me bypass-in			
	PR17: Zgjerimi i disa rrugëve bujqësore e rrugëve të brendshme			
	Rikonstruksion rruga "Plyk-Lalar-Kraps"			
	Rikonstruksion rruga Agim-Ndërmenas-Hasturkas			
	Rikonstruksion i rrugës Mirkuptimi			
	PR18: Ndërtimi i rrugëve dhe 6 urave këmbësore përgjatë Gjanicës			
	Rikonstruksion bulevardi "Jakov Xoxa"			
	Rehabilitim rruga "Muharrem Agolli"			
	Rikonstruksion rruga "Mujo Ulqinaku"			
	Rikonstruksion rruge brenda qytetit			
	PR19: Zgjerimi i 2 urave automobilistike (hyrje Fieri, unaza 2) pergjate Gjanices			
O4P4: Intensifikimi i zhvillimit në fshatrat Levan dhe Frakull e Madhe si satelite urbane të qytetit të Fierit	PR20: Intensifikimi i zhvillimit në fshatrat Levan dhe Frakull e Madhe si satelite urbane të qytetit të Fierit			
O4P5: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të	PR21: Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura			

ujësjellësit dhe KUZ	PR22: Rikonstruksion ujësjellësi Topojë, Sek.Seman, Poro-Bregdet, Gorishovë			
	PR23: Ndërtim depo uji në fshatin Mbrostar dhe Clirim			
	PR24: Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në Darzezë; fshatin Sheq Musalaj, Drizë-Myrteza, Kraps-Patos fshat, Buzëmadh			
	PR25: Ndërtim KUZ Libofshë			
O4P6: Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve akupunkturë	PR26: Ndërtimi i një qendre për promovimin e produkteve artizanale në fshatin Pojan, pranë parkut arkeologjik të Apolonisë			
O4P7: Rigjenerimi dhe zhvillimi i hapësirave publike në qytetin e Fierit dhe disa nga qendrat urbane, përmes instrumenteve financiare, dizajnit urban dhe PPP-ve	PR27_1: Projekte dizajni për hapësirat publike të qytetit të Fierit dhe qendrat e fshatrave Levan, Mbrostar, Libofshë, Cakran, Darzezë, Pojan, Adriatik, Daullas, Pishë, Boçovë, Bashkim			
	PR27_2:Projekti për rehabilitimin e qendrës së qytetit të Fierit			
O4P8: Sigurimi i gazifikimit të territorit të bashkisë Fier nëpërmjet projektit të TAP-it	PR28: Hartimi i një projekti për lidhjen e bashkisë Fier me linjën e gazsjellësit TAP			
O5P1: Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale	PR1: Ndërtimi i Spitalit Rajonal të ri			
O5P2: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të qendrave mjekësore/ ambulancave në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Fier	PR2: Rikonstruksion dhe përmirësim i të gjitha qendrave shëndetësore të njësive administrative të Bashkisë Fier			
O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Fier, kryesisht me fokus mjekësinë	O5P3: Çelja e disa departamenteve të arsimit të lartë publik në Bashkinë Fier, kryesisht me fokus mjekësinë			
O5P4: Mbështetje e arsimit profesional, përmes investimeve në tre shkollat profesionale ekzistuese në Bashkinë e Fierit	PR4: Rikonstruksion, plotësimi me laboratorë dhe bazën material të nevojshme për shkollën profesionale industriale dhe asaj artistike			
O5P5: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për ndërhyrje rehabilituese të kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Fier	PR5: Rikonstruksion i objekteve arsimore në njësitë administrateve në Bashkinë Fier (Fier, Dërmenas, Libofshë, Buzëmadh, Cakran, Varibob, Grecalli, Frakull, Mbrostar, Levan)			
	Rikonstruksion gjimnazi "Janaq Kilica"			
	Rikonstruksion i shkollës "Andon Xoxa"			
	Rikonstruksion shkolla "Jani Bakalli"			
	PR6: Ndërtim kopshti në fshatrat Peshtan Bregas, Cakran, Varibop, Kreshpan, Kraps, Frakull e			

	Madhe, Drizë, Afrim, Sulaj, Mbrostar, Venaj			
	PR: Ndërtim shkolle 9-vjeçare në fshatrat Grykë, Metaj, Kallm i Vogël, Kraps,			
	PR8: Ndërtim shkolle e mesme në fshatrat Plyk, Portëz, Peshtan, Kraps, Pishë, Mbrostar, Petovë, Ndërnënas			
	PR9: Rikonstruksioni i kopshtit në fshatin Darzezë			
	Pr10: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare të fshatit Fushë, në Topojë			
O5P6 Identifikimi dhe adresimi i nevojave për strehim social në bashkinë e Fierit	Pr11: Identifikimi dhe adresimi i nevojave për strehim social në bashkinë e Fierit			
	Pajisje per shtëpinë e të moshuarve			
O5P7: Krijimi i infrastrukturës së gjelbër dhe asaj sportive/rekreative	PR12: Ndërtim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rrugës Xoxi Andoni dhe hapësirat rreth saj			
	PR13: Rivitalizim i parkut pranë Bar-Rinisë dhe rehabilitim i rrugës Dervish Hekali			
	PR14: Gjelbërim i unazës së qytetit të Fierit dhe anët e Lumit Gjanica			
	PR15: Ndërtimi i parkut të ri urban të Fierit (30ha) në zonën e Mbrostarit			
	PR16: Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në qytetin e Fierit			
	PR17: Ndërtimi i një marine jahtesh në kanalin e Darzezës			
O5P8: Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve social-kulturore	PR18: Rikonstruksion i Teatrit Bylis			
	PR19: Rikonstruksioni i pallatit të Sportit			
	PR 20: Ndërtimi i qendrave multikulturore në qendrat e njësive administrative			

2.4.2 Plani i investimeve kapitale

(Shih dokumentin bashkëngjitur)

2.4.3 Monitorimi i zbatimit të planit dhe çështje institucionale-ligjore

Në përgjithësi, propozimet e planit, përveç atyre që kanë të bëjnë specifikisht me masat mjedisore, nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin ligjor e administrativ, së paku jo për periudhën afatshkurtër. Propozimet institucionale e ligjore për zbatimin e masave mjedisore janë trajtuar në mënyrë të zgjeruar në tekstin e VSM-së. Tabela përmbledhëse e këtyre propozimeve jepet më poshtë.

Tabela 132. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit mjedisor

Çështje ligjore, institucionale, proceduriale për monitorimin e mjedisit	Masa	Instrumenti
Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit	Pajisja me laborator	Numër laboratori të çertifikuar në pronësi të institucioneve
Mungesa e laboratoreve që kanë kapacitet të monitorojnë parametra si përbërjet klorure dhe PCB si dhe pesticidet dhe PAHs	Pajisja me laboratorë të specializuar	Rritja e kapacitetit për matjen e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs
Monitorimi i mjedisit bazuar në numër të kufizuar treguesish mjedisorë (parametrat)	Krijimi i bazës ligjore për shtimin e parametrave që nevojitet të maten për monitorimin e duhur të treguesve fizikë të mjedisit (ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, biodiversitetit, pyjeve)	Parametra /ndotës që shkarkohen nga industria e rëndë
Numri i kufizuar i pikave të monitorimit	Shtimi i pikave	Numri i pikave
Shpeshtësia e monitorimit të ujërave e pamjaftueshme	Shtimi i frekuencës	Numër i lartë matjesh/vit
Vetë-monitorimi i aktiviteteve të pajisura me leje A dhe B joreal	Kalimi i monitorimit të shkarkimeve të indsutrisë së pajisur me leje mjedisore (A dhe B) nën kompetencat e ARM-Fier	Monitorim mujor i parametrave
Mungesa e kompetencave të ARM-së Fier për monitorimin e mjedisit	Shtimi i kompetencave	Monitorimi parametrave
Mungesa e bazës ligjore/procedurave e programeve për mbrojtjen e ujërave nëntokësore	Krijimi i programeve të posaçme për mbrojtjen e akuiferëve nga industria e rëndë	Numri i programeve në mbrojtje të akuiferëve

Burimi: Bashkia Fier dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Përtej çështjeve mjedisore, sugjerimi kryesor është që PPV-ja të zbatohet për të paktën dy vite, periudhë gjatë të cilës Bashkia do të monitorojë jo vetëm zbatimin, por edhe vështirësitë e hasura. Këto do të raportohen në Raportin e Territorit. Kjo periudhë zbatimi do të ndihmojë që Bashkia të përpilojë propozime në lidhje me ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore dhe/ose administrative për planifikimin, sektorë të tjerë, dhe sipas rastit edhe për strukturën administrative në nivel vendor. Sigurisht këto propozime mbeten sugjerime në rast të një procesi të mundshëm ndryshimi të bazës ligjore. Pra, në tërësi, për periudhën afatshkurtër nuk mendojmë se nevojiten ndryshime ligjore dhe/ose administrative në nivel kombëtar.

Megjithatë, eksperienca e hartimit të PPV-së, parashtron disa sugjerime paraprake si në vijim, një pjesë e të cilave janë të tilla që duhet të shqyrtohen nga institucionet e nivelit kombëtar (në rast rishikimi të bazës ligjore) dhe një pjesë që vetë Bashkia do të punojë për t`i realizuar gjatë zbatimit të PPV-së. Sa u përket propozimeve për nivelin vendor, ato janë brenda dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, por vijnë si procedura të mundshme që Bashkia ka të drejtë të hartojë e realizojë në kuadër të autonomisw vendore dhe pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi.

Sugjerime në nivel kombëtar, në rast ndryshimi të bazës ligjore:

- Gjatë zbatimit të PPV-së, mund të lindë nevoja për të ndryshuar intensitetin e ndërtimit dhe/ose koefiçientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim (Ksht). Këta

koefiçientë kanë natyrë shumë teknike dhe janë shumë të rëndësishëm për procesin e zhvillimit dhe veçanërisht pronarët dhe zhvilluesit. Bashkia, mund t`i shfrytëzojë këta koefiçientë në zbatimin e Intensitetit me kushte, pra për të përfituar infrastrukturë publike. Ky proces ndryshimi kërkon fleksibilitet për të qenë efiçient dhe fitimprurës.
Për sa kohë që ndryshimi i nevojshëm/kërkuar nuk bie ndesh me propozimet e planit, me legjislacionin e posaçëm (sektorial) dhe treguesit për Kshp dhe Kshr (koefiçientë të interesit publik dhe që nuk duhet në asnjë mënyrë të zvogëlohen), sugjerohet që legjislacioni i planifikimit (në një ndryshim të mundshëm) të parashikojë ndryshim të **I** dhe **Ksht** vetëm me ndryshim të rregullores dhe miratim në Këshill Bashkiak, pa qenë i nevojshëm kalimi në KKT. Procesi duhet të jetë transparent dhe nevojitet një procedurë për ta realizuar. Këtë propozim nuk e përmban aktualisht ligji, por vjen si sugjerim për një ndryshim të mundshëm ligjor në të ardhmen.

- Po ashtu, nevojitet që legjislacioni i planifikimit dhe zhvillimit të territorit të rishikojë **dokumentacionin që dorëzohet për leje për objektet e vogla** (shiko tabelën e monitorimit në vijim) **në zona rurale**. Nevoja për të ndërtuar këto objekte mbetet shpesh peng i projektit, liçencave profesionale dhe kolaudimit e çertifikimit. Bashkia do të realizojë një procedurë të brendshme për ta lehtësuar procesin e lejes së ndërtimit për këto objekte duke zbatuar legjislacionin në fuqi, por do të ishte e udhës që ky rregullim të bëhej në VKM-në përkatëse.
- Një ndryshim ligjor që identifikohet si mjaft i nevojshëm dhe sugjerohet ka të bëjë **me ndryshimin e resursit të tokës bujqësore në urbane** (konvertimi i tokës), sipas legjislacionit aktual për bujqësinë/tokën bujqësore. Aktualisht, ky legjislacion përcakton se ndërtimet për interes bujqësor që lejohen të ndodhin në tokë bujqësore (llojet e ndërtimeve listohen në VKM nr 283, datë 01.04.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar), dhe si pjesë e procedurës së lejes së ndërtimit është ndryshimi paraprak i resursit të tokës bujqësore në urbane. Një veprim i tillë do të rezultojë në ndërtime për interes bujqësor që do të fragmentojnë tokën bujqësore duke krijuar ishuj urbanë.
  Pavarësisht se legjislacioni nuk lejon ndryshimin e përdorimit të objektit të ndërtuar, është më me vlerë që konvertimi i tokës të mos kryhet. Subjekti ndërtues/pronari i tokës mund të kërkojë të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së ndërtuar pas për shembull 10 apo 15 viteve, dhe kjo mund të lejohet për sa kohë që ndryshimi i destinacionit ndodh brenda listës së objekteve për interes bujqësor. Për shembull, një pronar mund të kërkojë që parcelën e zhvilluar si serë ta kthejë në stallë, apo anasjelltas. Në këtë mënyrë sigurohet fleksibilitet për ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore dhe në të njëjtën kohë parandalohet fragmentimi i saj dhe konvertimi gradual e me leje në tokë urbane.
- Është e nevojshme që koncepti **zonë ripariane** të bëhet i detyrueshëm me ligj, dhe pa ndryshuar pronësinë. Mbjellja e zonës ripariane duhet të kryhet nga autoritetet publike, edhe nëse pronësia e tokës është private. Në këtë zonë, pronarët kufizohen në të drejtat e tyre për ndërtim dhe bujqësi dhe bashkia dhe autoritetet qendrore duhet të parashikojnë instrumente dhe masa për të kompensuar këto të drejta, e veçanërisht të drejtën për bujqësi. Kjo do të garantonte edhe zbatimin e legjislacionit të ujërave në lidhje me brigjet dhe të drejtat për përdorimin e tyre. Parashikimet e PPV-së për këto zona përballen me tre vështirësi: kosto e lartë e mbjelljes; pronësia – për ato raste kur këto toka janë private; konvertimi i këtyre sipërfaqeve nga bujqësore në natyrore.
  Për vështirësinë e parë, autoritetet vendore e qendrore duhet të parashikojnë fonde të përvitshme. Për vështirësinë e dytë, autoritetet duhet të garantojnë se pronësia është e paprekshme nëse kompensohet vetëm e drejta për bujqësi dhe/ose zhvillim dhe mund të tjetërsohet vetëm në rast të një kompensim të plotë të pronës. Për vështirësinë e tretë, theksojmë se në mjaft raste këto zona kanë qenë natyrore dhe janë kthyer në

bujqësore për të rritur sipërfaqen e tokës bujqësore. Për rrjedhojë, burimi ujor ka shkaktuar përmbytje duke dëmtuar edhe më tej tokat e brigjeve. Pra nevojitet që këto sipërfaqe të rikthehen në gjendje natyrore e me bimësi të përshtatshme për ruajtjen e brigjeve ujore.

- Kodi rrugor ka bërë përcaktime që influencojnë vijën e kuqe. Vija e kuqe përcaktohet nga distanca e ndërtimeve nga trupi i rrugës. Kodi rrugor përmban shumë pak përcaktime në lidhje me këto distanca, duke mos konsideruar rastet e shumta të tipologjive urbane. Thelbi i neneve për distancat në Kodin Rrugor është distanca si një parametër teknik, por jo cilësia tërësore e hapësirës. Kjo e fundit realizohet në mënyra të ndryshme për tipologji të ndryshme dhe jo vetëm përmes distancës nga trupi i rrugës, por edhe përmes Kshp e Kshr (koefiçientët për hapësirë publike dhe rrugë). Në zona urbane ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve është e ulët dhe nuk prek sigurinë e qytetarëve, distancat nga trupi i rrugës mund të jenë më të vogla se sa ato të parashikuara nga Kodri Rrugor (deri në 0m), për sa kohë që trotuari ka një gjerësi të mjaftueshme. Madje në raste të tjera, situata urbane është e tillë ku ndërtimet e reja duhet të respektojnë vijën ekzistuese të ndërtimit (p.sh. zonë e konsoliduar, qendrore, historike, etj.). Këto raste përjashtimore lejohet nga VKM nr. 671/2015 (për planifikimin e territorit) dhe është PPV-ja që duhet t`i detajojë, por duhet të lejohen edhe nga Kodi Rrugor.
  Po ashtu, koncepti vijë e kuqe merr në konsideratë në mënyrë të njëjtë çdo object, ndërsa Kodi Rrugor përcakton distanca të ndryshme për ndërtimet, të ndryshme për pemet dhe të ndryshme për muret rrethuese. Nëse i referohemi Kodit, përfshirë këtu edhe rastet përjashtimore si në paragrafin më sipër, atëherë vija e kuqe për një rrugë mund të pozicionohet në mënyra të ndryshme, dhe kjo varet nga konteksti lokal. Për këtë qëllim, është mirë që vija e kuqe të përcaktohet vetëm përmes rregullores, prerjeve tip të rrugëve dhe jo përmes hartës plan.

Në nivel vendor:

- Në nivel vendor nëvojitet të: i) krijohen struktura të reja për monitorim mjedisor dhe të PPV-së, ose të përmirësohen ato ekzistuese duke u shtuar në organikën lokale, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore; ii) të rritet numri i inxhinierëve apo planifikuesve që mbulojnë njësitë administrative; iii) të shtohet stafi i drejtorisë së planifikimit për të zbatuar në kohë dhe më cilësi të gjitha projektet dhe proceset zhvillimore të parashikuara nga PPV-ja.
- Në vijim paraqiten të përmbledhura disa nga çështjet institucionale e ligjore që duhet të ndodhin në nivel vendor për zbatimin e planit të monitorimit të indikatorëve të PPV-së. Theksojmë se propozimet e tabelës së mëposhtme janë tërësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synojnë të detajojnë procedura të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore, përmes të cilave lehtësohet zbatimi i PPV-së dhe i ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Tabela 133. Indikatorët për monitorimin e PPV-së dhe çështjet institucionale e ligjore përkatëse në nivel vendor

Indikatori	Vlera	Periudha e monitorimit	Çështje institucionale e ligjore
Lejet e ndërtimit të dhëna në përputhje me PPV-në	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Procedurat për lejet janë të përcaktuara ligjërisht dhe në rregulloren përkatëse të bashkisë. Me një rregullore të brendshme nevojitet të rregullohet procedura për rastet e objekteve me volum të vogël, kryesisht për bujqësi, si

			strehim për kafshët në bujqësi, depo për vegla bujqësore, etj. Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Deklaratat paraprake për punime	E pacaktuar	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	
Ndërtime informale në territor	0	Çdo fund muaji dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkëpunim me ALUIZNI. Në rregulloren e brendshme nevojite të rregullohet procedura e monitorimit sipas strukturës përkatëse në bashki. Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Projektet prioritare të zbatuara në përputhje me PPV dhe veçanërisht Planin e Investimeve Kapitale	Të paktën 50% e projekteve sipas fazimit të realizuar në PPV dhe në PIK	Çdo gjashtë muaj dhe raportim final në dhjetor të çdo viti	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014.
Numri i rasteve/njësive strukturore në të cilat zbatohet INK	Të paktën një rast në vitin e parë pas miratimit të planit; 10% e rasteve të parashikuara, në 3 vitet e para pas miratimit të planit; mbi 20% e rasteve të parashikuara, në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës.
Numri i rasteve dhe pronave që marrin pjesë në program TDZH	Të paktën një rast në 3 vitet e para pas miratimit të planit; Të paktën kërkesa nga 40% e rasteve në vitet në vijim.	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Përgatitje e rregullores së programit specifik ose e procedurës për rastin përkatës. Indikatori rishikohet pas 3 viteve të para pas miratimit të planit, pas vlerësimit të suksesit dhe mundshmërisë së zbatimit të programit. Kjo mund të kërkojë edhe ndryshim të PPV për t`iu përshtatur kushteve të reja dhe realitetit.
Mundësia për	Jo më shumë se 5%	Çdo fund viti.	Bashkërendim me raportin e

ndryshim të PPV-së	e sipërfaqes brenda 2 viteve të para; Jo më shumë se 1% e njësive strukturore në lidhje me intensitetin dhe/ose Ksht, brenda 2 viteve të para; 0% zvogëlim të sipërfaqes së propozuar rrugore dhe të hapësirës publike në çdo kohë.		territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr. 107/2014. Dokumentim dhe publikim sipas ligjit i procedurave për ndryshim. Për dy vlerat e para (ndryshimi i sipërfaqes dhe i njësive strukturore në lidhje me Intensitetet dhe Ksht), pas dy viteve të para pas miratimit të planit duhet të propozohet një vlerë e re e indikatorit, por pa ndryshuar indikatorin. Vlera për hapësirën publike dhe sistemin rrugor nuk ndryshon gjatë jetëgjatësisë së planit, përveçse nëse rritet.

3. Shtojcat

3.1 Studime mbështetëse

(Bashkëngjitur këtij dokumenti)

3.2 Tabela përmbledhëse e PPV-së

1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Sipërfaqja e njësisë vendore	661.47 km^2	Sipërfaqe truall, tokë bujqësore etj.
Numri i popullsisë ekzistuese	122,475 banorë	Popullsia për çdo njësi të qeverisjes vendore
Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	1670 ha	Sipas legjislacionit të posaçëm dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
Problematika mjedisore		Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta dhe inerte, ndotja nga hidrokarburet në lumenjtë Seman e Gjanicë, Azotiku, zona naftëmbajtëse e Mbrostarit, erozioni lumor e bregdetar

2. Propozime të PPV-së		
Emërtimi	**Vlera dhe njësia**	**Specifikime**
Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme		Intensifikimi i qendrave të urbanizuara rurale: qendërsive të dyta e të treta, qendrave ekoturistike, etj. Konservim dhe konsolidim, si dhe mbushje urbane në qendrat rurale bujqësore dhe natyrore. Rizhvillim i akseve të shërbimeve në qytet. Konservim i tokës bujqësore e rehabilitim e konservim i tokës natyrore
Përdorimet kryesore të propozuara të tokës		Banim, Bujqesi, Natyrore, Industri e lehte përpunuese, Shërbime (hoteleri/tregtare), Park urban, Aktivitete Sociale dhe Rekreacion, Arsim dhe Shëndetësi, etj
Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	20 500 banorë	Vlerësimi sipas parashikimeve demografike, duke marrë parasysh Regjistrin e Gjendjes Civile. Sipas INSTAT, tkurrje me 20 300 banorë.
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	576 ha	Sipërfaqja që pritet të shtohet për banim në 15 vitet e ardhshme
Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	234 ha	Specifikimi i funksioneve biznes, tregti, industri etj.
Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje	8900 ha	Zonat e mbrojtura ekzistuese dhe të propozuara
Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social	0.7 ha	Strehim në zonat me INK
Sipërfaqe të gjelbra shtesë	178 ha	Të kategorisë gjelbërim i përgjithshëm (1767 të kategorisë Gjelbërim i Vecantë)
Numri i njësive strukturore	1457	

3. Të dhëna financiare		
Emërtimi	**Vlera dhe Njësia**	**Specifikime**
Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale	25,027,038,447.00 Lekë	Duhet të jetë në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
Fazat e zbatimit të zhvillimit	3 periudha përkatëse	0-3 vite – Afatshkurtër 3-5 vite Afatmesëm 5 deri në jetëgjatësinë e planit - Afatgjatë

4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim				
Nr.	**Kapitulli/Dokumenti**	**Hartohet/Miratohet**	**Referenca ligjore**	**Check list**
1.	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 2 VKM. 671	+
2.	Analiza dhe vlerësimi i territorit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 53 VKM. 671	+
3.	Parashikimet e planit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 54 VKM. 671	+
4.	Vlerësimi strategjik mjedisor	Hartohet dhe miratohet	Neni 51 pika 5 VKM. 671	+
5.	Materiali hartografik	Hartohen dhe miratohen	Neni 57 VKM. 671	+
6.	Rregullorja e PPV-së	Hartohet dhe miratohet	Neni 56 VKM. 671	+
7	Plani i Investimeve Kapitale	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Neni 51 pika 3/dh VKM. 671	+

5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit					
Nr.	**Tematika e hartës**	**Lloji i hartës**	**Shkalla**	**Kodi i hartës**	**Check list**
1.	Harta bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:150,000	B:1	+
2.	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:150,000 1:100,000 1:20,000	V:1	+
2.	Elementet ekzistuese të territorit	Topografik; gjeologo-inxhinierik; hidro-gjeologjik dhe hidrografik; e makrozonimit dhe, sipas rastit, mikrozonimit sizmik; boniteti i tokave; burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre; zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike.	1:150,000	V:2	+
3.	Pozicionimi strategjik i në	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik	1:500,000	Brenda në tekst	+

	raport me rajonin				
4.	Vlerësimi ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punësorë;	1:150,000	Brenda në tekst	+
5.	Vlerësimi social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:150,000 1:100,000 1:35,000 1:25,000	Brenda në tekst	+
	Vlerësim demografik	Përqendrimi i popullsisë në territor; lëvizjet e popullsisë në vite; shpërndarja e popullsisë në nivel banese dhe për tipologji banesash; sipërfaqen e banimit për person sipas tipologjive të banesave; numri i banesave në një strukturë banimi sipas tipologjive në territor.	1:150,000	Brenda në tekst	
6.	Analiza e planeve të mëparshme	Përdorimi i tokës; infrastrukturat; intensiteti i ndërtimit.	1:150,000 1:50,000 1:25,000	Brenda në tekst	+
7.	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integrimit	1:150,000	Brenda në tekst	+
8.	Rëndësia kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:150,000 1:25,000	Brenda në tekst	+
9.	Problemet mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor	1:150,000	M:06	+
10.	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë; nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet;	1:150,000 1:25,000 1:20,000	Brenda në tekst	+
11.	Infrastrukturat	Furnizimi me ujë; ujërat e zeza; mbetjet urbane; rrugët; ndricimi; transporti; lidhja me infrastrukturat kombëtare	1:150,000 1:25,000 1:20,000	P:03/1- P:03/8	+
12.	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rizhvillim.	1:150,000 1:20,000	N:01/11	+
13.	Tipologjitë hapësinore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike si dhe lartësisë së strukturave	1: 150,000	N:01/12	+
14.	Periferaliteti	Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të përafërt të të ardhurave të shtresave shoqërore; plotësimit me funksione sipas kategorive	1:150,000	Brenda në tekst	+

		bazë të përdorimeve të tokës; nivelit të kriminalitetit dhe sigurisë së jetës; problemeve të ndryshme sociale përfshirë përjashtimin social.			
15.	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim	1:150,000	V:2	+
16.	VSM	Hartat përshkruese, analizuese dhe vlerësuese	1:150,000	M:01-06	+
17.	Parashikimi i përdorimit të tokës	5 sistemet; kategoritë bazë dhe nënkategoritë; funksione dhe aktivitete; qendrat, polet, korridoret kryesore të zhvillimit ekonomik; tipologjitë e parashikuara hapësinore; zonat e rëndësisë kombëtare; njësitë strukturore; zonat me prioritet zhvillimi; zonat për PDV; shpërndarja e popullsisë; plani e strehimit; të tjera;	1:150,000 1:25,000 1:20,000	P:01/9 P:01/1 – P:01/8	+
18.	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjetet e infrastrukturave; Objektet e shërbimeve sociale dhe rrezet e mbulimit	1:150,000 1:25,000	P:03/1 P:03/3 P:03/5 P:03/7	+
19.	Instrumentet e drejtimit të zhvillimit	Zonat për transferim të së drejtës për zhvillim Zona për intensitet me kushte Zona për zhvillim të detyrueshëm të tokës Zonat e preferimit; Zonat e pezullimit të zhvillimit; Zonat për servitut publik;	1:150,000	Brenda në tekst	+
20	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave; Tjetër sipas rastit	1:150,000	Brenda në tekst	

3.3 Tabela e Sistemeve dhe Zonave

Sistemet	Treguesit	Vlera	Zona (Emër dhe Nr.)	1_Fier	2_Cakran	3_Dërmenas	4_Frakull	5_Levan	6_Libofshë	7_Mbrostar	8_Portëz	9_Qendër	10_Topojë
Sistemi Urban	1. Sipërfaqe përgjithshme (ha ose km^2)	7653 Ha	Sipërfaqe (ha)	1314.0	9604.74	6449.36	4276.12	11092.5	12615.8	4157.59	4690.72	2891.06	8963.76
	2. Gjatësia e sistemit rrugor m/banor	17.59 metra/banor	Sipërfaqe banimi (ha)	783.3	693.577	412.49	270.2	332.45	421.4	543.4	364	566	694
	3. Popullsia ekzistuese dhe kapaciteti mbajtës	Popullsia ekzistuese: 122475 (Instat) / 194167 (GJC) Popullsia e pritshme: 103277 (Instat) / 216061 (GJC) Kapaciteti mbajtës: 735781	Zona ekonomike (ha)	44.05	1.2	0.85	0.4	6.4	3.2	10.2	11.5	4.2	25
	4. Njësi banimi të parashikuara sipas kapacitetit mbajtës	55 000, nga të cilat 48 704 janë ekzistuese	Kapaciteti mbajtës (popullsi)	156598	68729	45092	56482	110324	52983	92534	47588	67804	37647
	5. Njësi banimi të mundshme për strehim social	670 njësi	Dendësi sipas kapacitetit mbajtës (banorë/ha)	119.18	7.16	6.9	13.2	9.9	6.82	22.25	10.1	23.32	4.2
	6. Njësi shëndetësore (ekzistuese dhe të prpozuara)	68 njësi (spitale, qendra shëndetësore, poliklinika, ambulanca)	Gjelbërimi zonës urbane (m^2/banor)	29.7	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA	PA
	7. Njësi të arsimit 9-vjeçar (ekzistuese dhe të prpozuara)	89 njësi (publike/private; cikël fillor/9-vjeçar, nga të cilat 8 janë të propozuara)	Parkimi maksimali mundur (m^2)	939588	412374	270552	338892	661944	317898	555204	285528	406824	225822
	8. Njësi të arsimit të mesëm (ekzistuese dhe të prpozuara)	26 njësi (publike/private; të përgjithshme/profesionale, nga të cilat 4 janë të propozuara)	Nr. i njësive strukturore	310	275	106	100	150	131	108	182	74	60
	9. Nr. i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	transport rrethqytetas: 7 linja ekzistuese dhe 7 të propozuara transport urban: 4 linja	Nr. njësive me PDV	26	0	1	0	1	0	0	0	0	0
	10. Nr. i njësive strukturore	1458	Njësi për TDZH	8+12	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	11. Sipërfaqe e gjelbër m^2/banor	39m2/banor (në zonën urbane) 4550m2/banor (përfshirë gjithë territorin e bashkisë)	Njësi për INK	po (13)	jo	jo	jo	po (2)	jo	jo	jo	jo	jo

	12. Sipërfaqe trashëgimi kulturore (ha)	385 Ha	Sistem urban (ha)	926	757	235	422	675	376	526	408	786	564
	13. Tregues ekonomikë	Zonë industriale: 1200 Ha Zonë shërbimesh: 350 Ha	Njësi banimi	6263	2750	1803	2259	4412	2119	3701	1903	2712	1505
	14. Sipërfaqe pronash publike (ha) dhe % ndaj sipërfaqes së përgjithshme	342 Ha prona publike që i përkasin sistemit urban (0.8% e sip. së bashkisë) 420 Ha prona publike të sistemit urban gjithsej, në përputhje me propozimin	Dendësia njësi banimi/ha	6.76	3.63	7/67	5.35	6.54	5.64	7.04	4.66	3.45	2.67
	15. Sipërfaqe që konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	0 Ha	Hapësira publike (m2)	211943	26818	22956	28766	33227	52415	44065	14984	32792	25003
	16. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m^2 ose ha)	0 Ha											
	17. Sipërfaqe që konvertohet në ujore (m^2 ose ha)	0 Ha											
	18. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	42 Ha për rrugë të reja dhe 32 Ha për zgjerim rrugësh ekzistuese											
	19. Shërbime administrative (nr. objektesh dhe Sn m^2)	26 Institucione publike (të qeverisjes qëndrore dhe vendore (Sn=16900 m2)											
	20. Detyrime fetare (nr. objektesh dhe Sn m^2)	12 Institucione fetare (14400 m2)											
	21. Intensiteti për ha (m^2/ha)	0.106 Ha/Ha											
Sistemi Bujqësor	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha)	39651.70 Ha	Sistem bujqësor (ha)	308	4764	5327	6002	8975	7057	6285	6578	3281	9674
	2. Sipërfaqe kryesore (Boniteti I-IV) në ha	30921 Ha	Nënkategoritë	Bujqësore e kultivuar (308 Ha)	Bujqësore e kultivuar (4759 Ha) Bujqësore	Bujqësore e kultivuar (3197 Ha) Bujqësore	Bujqësore e kultivuar (5701 Ha) Sera (300	Bujqësore e kultivuar (4936 Ha) Bujqësore	Bujqësore e kultivuar (5292 Ha) Bujqësore	Bujqësore e kultivuar (6252 Ha) Bujqësore	Bujqësore e kultivuar (5918 Ha) Bujqë	Bujqësore e kultivuar (3117 Ha) Bujqësore jo e	Bujqësore e kultivuar (5320 Ha) Bujqësore jo e

					jo e kultivuar (5 Ha)	jo e kultivuar (2130 ha)	Ha)	jo e kultivuar (3141 Ha)	jo e kultivuar (1764 Ha)	jo e kultivuar (30 Ha) Sera (3 Ha)	sore jo e kultivuar (640 Ha) Sera (20 Ha)	kultivuar (164)	kultivuar (4354 Ha)
	3. Sipërfaqe dytësore (Boniteti V-X) në ha	8730 Ha	Nr. i njësive strukturore	20	49	31	11	26	40	22	33	16	15
	4. Sipërfaqe ose gjatësi e sistemit të ujitjes dhe vaditjes sipas 3 kategorive	Kanale parësore: 322.2 km Kanale dytësore: 449 km Kanale tretësore: 67.4 km											
	5. Sipërfaqe tokë pa fryt (ha)	543 Ha											
	6. Sipërfaqe që konvertohet në natyrore (m^2 ose ha)	980 Ha											
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	67 Ha konvertim tokë bujqësore në park urban 182 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë shërbimesh 30 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë ekonomike 140 Ha konvertim tokë bujqësore në zonë banimi Konvertimet e tjera bëhen rast pas rasti e nuk janë të llogaritshme në këtë fazë											
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	124 Ha për rrugë të reja dhe 54 Ha për zgjerim rrugësh ekzistuese											
Sistemi Ujor	1. Sipërfaqe ujore (km^2)	1255.90187	Sistem ujor lumë (ha)	30.8121	247	0	115	280	440	322	224	121	360
	2. Gjatësia e lumenjve kryesorë (km)	Seman: 49,15 km Vjosë: 53.22 km Gjanicë: 14,99 km	Sistem ujor liqene (ha)	0	0.2435	0	0	1.8	4	0	0	0	0
	3. Sipërfaqe akuiferesh sipas llojeve	Akuifer me porozitet ndërkokrrizor e ujëpërcjellshmëri shumë të lartë-të lartë: 12669 Ha											

		Akuifer me porozitet ndërkokrrizor e ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët: 6885 Ha Akuifer me porozitet porocarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët: 11562 Ha Akuifer me porozitet porocarje dhe ujëpërcjellshmëri të ulët-shumë të ulët: 2550 Ha Jo akuifer: 32334 Ha											
	4. Sipërfaqe që konvertohen, nëse është rasti	36 km											
Sistemi Infrastrukturor	1. Sipërfaqe ose gjatësi rrugësh sipas kategorive të kodit rrugor	140.8 km /172 Ha të shtuara të reja 425.8 km / 365 Ha të ristrukturuara dhe zgjeruara 3660 km / 452 Ha ekzistuese (perfshire rruget e brendshme te lagjeve dhe ato bujqesore) Rrjeti kryesor rrugor kategorizuar sipas kodit rrugor: A.Autostrada : 36.7 km linear B.Rrugë interurbane kryesore : 34.8 km linear C.Rrugë interurbane dytësore : 234.7 km linear D.Rrugë urbane kryesore : 38 km linear E.Rrugë urbane dytësore : 45.9 km linear F.Rrugë lokale: 236.5 km linear	Sistem infrastrukturor (ha)	111.84	57.75	35	23	75	67	21.6	42	65	43
	2. Gjatësia e hekurudhës (km)	46.89 km											
	3. Nr. aeroportesh	0											
	4. Njësi energjitike (nr. ose sipërfaqe ose gjatësi)	5.48 Ha njësi energjitike dhe 25 km linjë gazsjellësi											
	5. Landfill/ Incinerator/	Landfill/Incenerator: 15.4 Ha											

	Zonë për kompostim (Nr. ose ha)												
	6. Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura (Nr. ose ha)	Impiant trajtimi: 20 Ha											
	7. Sipërfaqe ose gjatësi që konvertohet në një sistem tjetër (specifiko, nëse rasti)	0 Ha											
Sistemi Natyror	1. Sipërfaqe e përgjithshme (ha ose km^2)	16275.56	Sistem natyror (ha)	3.15	3697.385	1013	1562	1459	3782	15.6	25.6	10.2	4032
	2. Sipërfaqe pyjore (ha)	1944 Ha	Nënkategoritë		Pyll i Dendur (3100 Ha) Tokë ranore (500 Ha)	Pyll i Dendur (1013 Ha)	Pyll i Dendur (650 Ha) Pyll i rrallë (437 Ha) Shkurre të përziera (500 Ha)	Pyll i Dendur (1100 Ha) Tokë ranore (350 Ha)	Pyll i Dendur (3782 Ha)	Pyll i rrallë (15.6 Ha)	Pyll i rrallë (25.6 Ha)	Pyll i Dendur (10.2 Ha)	Pyll i Dendur (2340 Ha) Pyll i rrallë (1763 Ha)
	3. Sipërfaqe kullota (ha)	1341 Ha	Nr. i njësive strukturore	1	67	5	10	18	12	1	12	2	5
	4. Sipërfaqe të matricës natyrore sipas llojeve (ha)	Korridor lidhës: 11051 Ha Matricë: 5111 Ha Mozaik: 3672 Ha Ngastër: 2601 Ha Parcela të ndara: 6807 Ha Parcela të lidhura: 2613 Ha Pyll mbrojtës: 447 Ha Pyll produktiv: 1682 Ha											
	5. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm (nr dhe ha)	5 monumente natyrore 2 Rezervate të menaxhuara /Park natyror : 1431 Ha (së bashku me propozimet e këtij Plani) 1 Park Kombëtar: 1645 Ha 1 Park natyror rajonal : 400 Ha											
	6. Sipërfaqe që	0 Ha (Nuk ka propozime për konvertim nga											

	konvertohet në bujqësore (m^2 ose ha)	fondi pyjor publik në përdorim bujqësor. Konvertimet e mundshme nga fondi pyjor privat bëhen rast pas rasti, vetëm për pemëtari/ullishte)											
	7. Sipërfaqe që konvertohet në urbane (m^2 ose ha)	37 Ha Konvertimet e tjera bëhen rast pas rasti e nuk janë të llogaritshme në këtë fazë											
	8. Sipërfaqe që konvertohet në infrastrukturore (m^2 ose ha)	8 Ha për rrugë të reja dhe 4.5 Ha për zgjerim të rrugëve ekzistuese											

3.4 Korrespondenca institucionale

Takimet e kryera në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Fier			
Personat/ Institucioni/	**Data e takimit**	**Vendi i takimit**	**Qëllimi i takimit**
Luiza Dr. Mjedisi	6 Maj	Bashki	Krijimi i grupit të punës
Agim Hoxha, Drejtor i Pyjores	16 Maj 1 Qershor	Drejtoria e Pyjores	Kordinim për lëvizjet në terrren së bashku me specialistët e pyjores
Erald Filipi, Drejtor i Administrimit të Pronave	26 Prill 3 Maj	Bashki	Grumbullim informacioni mbi pronësinë e fondit pyjor
Genci Pina, Inxhinier Pyjesh	26 Prill 3 Maj 6 Maj 16 Maj 24 Maj 26 Maj 30 Maj	Drejtoria e Pyjores	Grumbullim informacioni mbi fondin pyjor, Grumbullim dhe interpretim informacioni në terren
Roventa Sera, Specialiste Pyjesh	1 Qershor 6 Maj 16 Maj 24 Maj 26 Maj 30 Maj 1 Qershor	Drejtoria e Pyjores	Grumbullim dhe interpretim informacioni në terren
Edvin Bixha, Drejtor i ARM Fier Valbona Grema, Specialiste Monitorimi	18 Korrik (vizita me përfaqësues të ARM-së Fier janë kryer gjatë gjithë vitit 2016)	DrejtoriaRajonale e ARM - Fier	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat Nxehta Mjedisore, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet e propozuara për Bashkinë Fier dhe Lushnje
Ardian Koçi, Drejtor i AdZM Fier Enea Zenuni, Shef Menaxhimi i AdZM Fier	18 Korrik 2016	Agjensia Rajonale e Zonave të Mbrojtura - Divjakë	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Fier dhe Lushnje. Diskutime mbi zona të cilat bartin potencial për t'u shpallur ZM.
Tim Kemp, Senior HSE Manager, Rubensa Sanka Environmental Assistant	27 korrik 2016	Zyta e Kompanisë Bankers Fier	
Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile		Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Emergjencat Civile Rajonale - Fier	26/02/2016	Bashkia Fier	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.

Autoriteti Rrugor Shqipëtar (ARrSh)	26/10/2015	Tiranë	
AlbPetrol	07/03/2016	Patos	Mbi vendburimin e gazrave dhe zonave të kontratës për Bashkinë Fier
Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Administrimit të Tokës Bujqësore		Tiranë	Marrje informacioni dhe harta për bonitetin e tokave, kanalet ujitëse dhe vaditëse
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)		Fushë-Krujë	Marrje e hartave dhe informacionit mbi bonitetin e tokave
INSTAT		Tiranë	Të dhënat mbi popullsine
SHGJSH		Tiranë	
ALUIZNI	11/04/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat info- rmale dhe zonat në process legalizimi
ARM Fier Edvin Bixha (Drejtor) Drejtoria Rajonale Mjedisit – Fier Valbona Grema /Specialiste	18/08/2016	Fier	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat Nxehta Mjedisore, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet e propozuara për Bashkinë Lushnje
AdZM Fier Ardian Koçi, Drejtor i AdZM Enea Zenuni, Shef Menaxhimi	18/08/2016 19/08/2016	Divjakë - Karavasta	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat e Mbrojtura, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet e propozuara për Bashkinë Fier
Bankers Petroleum Ltd. Tim Kemp, Senior HSE Manager, Rubensa Sanka Ing.Mjedisi	27/08/2016	Zyra e Kompanisë Bankers Fier	Diskutime rreth mundësisë së ndikimeve në mjedis nga industria e naftës dhe Kompania Bankers
Bordi I Kullimit	11/09/2015	Tiranë	Kërkesë për të dhëna mbi investimet e vitit 2016 të cilat pritet të financohen nga Banka Botërore
Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	11/09/2015	Tiranë	Të dhëna mbi vendodhjen e zonave me potencial arkeologjik
Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Paurive Kulturore	11/09/2015	Tiranë	Marrja e listës së plotë të monumenteve të kulturës
Drejtoria Rajonale e Mjedisit	11/09/2015	Fier	Marrja e informacionit mbi lejet mjedisore dhe subjektet operuese për Qarkun Fier
Drejtoria e Shërbimit Pyjor	11/09/2015	Fier	Marrja e informacionit mbi sipërfaqet pyjore në pronësi të Bashkisë Fier
Autoriteti Rrugor Shqiptar	11/09/205	Tiranë	Lista e objekteve ne

(ARrSh)			ndertim (2013, 2014, 2015) + Harta e sistemit rrugor dhe hekurudhor të Shqipërisë.
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	06/10/2015	Tiranë	Mbi lejet minerare në Bashkinë Fier
Qendra Kombëtare e Regjistrimit		Tiranë	Raporti Vjetor I Regjistrit Tregtar, 2015
Trans Adriatic Pipeline (TAP)	18/12/2016	Tiranë	Për gjurmën e projektit TAP dhe rrugëve të kalimit
MBZHRAU	06/04/2016	Tiranë	Të dhënat lidhur me aktivitetin e akuakulturës në lumenj, liqene, rezervuare

3.5 Procesverbalet/ materialet nga dëgjesa publike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e parë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Fier

Data: 16.10.2015

Në datën ***16.10.2015*** në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Fier organizoi dëgjesën e parë publike për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit. Në këtë proces bashkia mbështetet në projektitn PLGP/Usaid dhe asistencën teknike të Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit. Dëgjesa fokusohet në marrjen e nismës për hartimin e instrumentit të planifikimit vendor.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të bashkisë, njësive administrative, Komisionit Këshillimor Qytetar, Prefekturës Fier, si dhe disa qendra sociale e qytetarë të zonës.

Nisma u prezantua nga përfaqësuesja e Co-PLAN, znj. Besmira Dyca, pas fjalës hyrëse të Administratorit të Bashkisë Fier, z. Florian Muca. Materiali i përgatitur përmbante këto pika :

1. Qëllimi i hartimit të planit
2. Territori nën administrim
3. Dokumentat përfundimtare
4. Grupi i punës
5. Procesi dhe afatet kohore
6. Takime këshilluese, teknike dhe organizative
7. Dëgjesat publike
8. Forumi keshillimor vendor
9. Buxheti

Në përfundim të takimit pati një diskutim të shkurtër në lidhje me pritshmëritë mbi planin dhe procesin që do ndiqet. Grupi i punës konfirmoi se, sipas planit të aktiviteteve, miratimi i dokumentit të Planit do ndodhë në fund të vitit 2016, ndërkohë që dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Territorial do përfundojë në fund të vitit 2015.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e dytë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Fier

Data: 03.12.2015

Bashkia Fier më datë 03.12.2015 në orën 12:00, realizoi takimin e dytë publik/dëgjesën e parë mbi "Prezantimin e dokumentit të Strategjisë Territoriale", për të cilin Ju informojmë si më poshtë vijon:

- ***Pjesëmarrës:***

➢ *Stafi i AKPT prezentë në dëgjesë:*
- Bledi Dimo – Koordinator;
- Rezarta Laçi – Drejtoria Juridike;
- Albana Zotaj – Drejtoria e Regjistrit

➢ *Stafi i Bashkisë prezentë në dëgjesë:*
- Florian Muça – Administrator i bashkisë Fier
- Renilda Hyseni – Drejtore e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Përfaqësues të tjerë të Bashkisë

➢ *Përfaqësues i Co-Plan/PLGP-USAID*
- Besmira Dyca

Pjesëmarrës të tjerë në dëgjesë ishin administratorë të njësive administrative, fermerë, përfaqësues biznesesh, përfaqësues të teatrit të qytetit, përfaqësues të OJF-ve të ndryshme, ekspertë të fushave të ndryshme, etj.

- ***Rreth takimit:***

Takimi u hap nga znj. Hyseni e cila bëri falenderimet përkatëse si dhe prezantoi temën e takimit si dhe përse jemi mbledhur sot si dhe ecurinë dhe vështirësitë e deritanishme të procesit të hartimit të PPV-së.

Më pas u bë prezantimi i DRAFT strategjisë nga znj. Dyca, i cili ishte fokusuar në këto pika kryesore:

- Pozicioni gjeografik
- Elementët fizik të territorit
- Zhvillimi në kohë
- Përdorimi i tokës
- Zhvillimi ekonomik
- Analiza mjedisore
- Metabolizmi (ushqimi, uji, energjia, mbetjet)
- Demografia
- Punësimi
- Arsimi dhe shëndetësia
- Ujësjellës-kanalizime
- Infrastruktura rrugore dhe transporti
- Policentrizmi
- Analiza SËOT
- Planet e hartuara më parë
- Lidhja e PPV me PPK dhe PINS bregdeti
- Korridoret kryesore (PAN. Blu, boshti i jugut)
- Koncepte zhvillimi rajonale

Pasi mbaroi prezantimi u bë diskutim i hapur me publikun, ku këta të fundit të shpreheshin se cilat duhet të jenë ndërhyrjet prioritare strategjike për bashkinë e tyre si dhe për të marrë disa inpute për përcaktimin e vizionit të planit.

- ***Në diskutim u ngritën pyetje dhe problematika si më poshtë:***

- A do të ketë një hartë orjentuese për bizneset, ku të zhvillojnë biznesin e tyre?
- Hartë me pronat (pasuritë) publike të qytetit
- Turizmit duhet ti jepet më tepër përparësi në strategji
- Vendosja e ekuilibrave mjedisorë
- Grupimi (bashkimi) i fermerëve

Në përfundim u bë me dije se do të ketë një takim të tretë publik përpara miratimit të Strategjise territoriale. Ky takim mendohet të organizohet rreth fundit të muajit dhjetor 2015.

Gjithashtu përfaqësuesi i Co-Plan, informoj publikun se, miratimi i PPV-se mund të kryhet rreth fundit të vitit 2016.

Në përfundim znj. Laçi foli në emër të AKPT duke përmendur rolin e këtij institucioni në procesin e hatrimit të PPV, kuadrin ligjor në fuqi si dhe rëndësinë e dëgjesave dhe takimeve me publikun, të cilat e bëjnë këtë proces sa më transparent dhe gjithëpërfshirës. Gjithashtu ju bë me dije përfaqësueses së bashkisë se proces-

verbali i të gjitha diskutimeve të takimit, sugjerimet dhe pyetjet, fotot si dhe prezantimi duhet të botohen në RIT.

Duke shfrytëzuar vajtjen tonë në këtë bashki, u krye takim edhe me përfaqësues të drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit pranë kësaj bashkie për ti dhënë përgjigje disa pytjeve dhe problematikave të cilat këta të fundit hasin gjatë punës së tyre. Konkretisht mbi:

- Tipologjitë e lejeve të cilat kerkojnë leje ndërtimi dhe punimet që kërkojnë deklarim paraprak,
- Proçedurën e ngarkimit të dokumentacionit tekniko-ligjor në Regjistrin e Integruar të Territorit për Lejet e Ndërtimit dhe Deklarimet Paraprake.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e tretë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Fier

Bashkia Fier më datë 23.12.2015 në orën 15:00, realizoi takimin e tretë publik/dëgjesën e tretë mbi "Prezantimin e dokumentit të Strategjisë Territoriale" në sallën e Këshillit Bashkiak, për të cilin Ju informojmë si më poshtë vijon:

- ***Pjesëmarrës:***

➢ *Stafi i AKPT prezentë në dëgjesë:*
- Bledi Dimo – Koordinator;
- Rezarta Laçi – Drejtoria Juridike;
- Albana Zotaj – Drejtoria e Regjistrit

➢ *Stafi i Bashkisë prezentë në dëgjesë:*
- Kryetrari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi
- Florian Muça – Administrator i bashkisë Fier
- Renilda Hyseni – Drejtore e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Përfaqësues të tjerë të Bashkisë

➢ *Përfaqësues të Co-Plan/PLGP-USAID*
- Dritam Shutina- Drejtori ekzekutiv i CoPlan
- Besmira Dyca – Eksperte e planifikimit urban
- Fabjola Mecaj – Planifikuese urbane
- Merita Toska – Eksperte e financave vendore
- Teida Shehi - Eksperte e mjedisit
- Silvi Jano - Planifikues urban
- Imeldi Sokoli – Planifikues Urban

Në këtë takim të tretë publik kishte një pjesëmarrja të madhe në një numër prej 90 qytetarë. Pjesëmarrës të tjerë në dëgjesë ishin administratorë të njësive administrative, fermerë, përfaqësues biznesesh, përfaqësues të teatrit të qytetit, përfaqësues të OJF-ve të ndryshme, ekspertë të fushave të ndryshme, studentë etj.

- ***Rreth takimit:***

Takimi u hap nga kryetari i bashkisë Fier Z. Armando Subashi i cili njohu pjesëmarrësit me arsyen e takimit publik dhe ritheksoi edhe njëher rëndësinë e hartimit të PPV-së së Fierit. Z. Subashi bëri falenderimet përkatëse drejtuar pjesëmarrësve, përfaqsuesve të CoPlan/ PLGP – USAID si dhe ftoi qytetarët të bënhen pjesë e hartimit të PPV-së Fier nëpërmjet komenteve dhe pyetjeve të tyre.

Më pas u bë prezantimi i DRAFT strategjisë nga znj. Dyca dhe prezantimi i projekteve strategjike nga znj. Renilda Hyseni. Prezantimi u fokusua në këto pika kryesore:

- Drejtimi i zhvillimit të bashkisë Fier bazuar në zhvillimin e rajonit në të cilin ai ndodhet
- Zhvillimi i bashkisë Fier si pjesë e korridoreve VIII, Korridorit Blu dhe Korridorit Veri – Jug
- Koncepti i zhvillimit rajonal
- Analiza SWËOT
- Vizioni i territorit të Bashkisë Fier dhe objektivat strategjikë
- Detajimi i objektivave dhe programeve strategjike
- Projekte strategjike të tilla si (Zgjerimi i Pyllit të Levanit dhe kthimi i tij në Park Rajonal, Konsolidimi i rrugës Aulona, Ndërtimi i Spitalit Rajonal të Fierit, Krijimi dhe promovimi i itenerareve turistike, Konsolidimi i infrastrukturës në funksion të turizmit, Rehabilitimi i Lumit Gjanica, Ndërtimi i tregjeve ushqimore, Pyllëzimi i brezit të argjinaturës së Lumit etj)

Pasi mbaroi prezantimi u bë diskutim i hapur me publikun, ku këta të fundit të shpreheshin se cilat duhet të jenë ndërhyrjet prioritare strategjike për bashkinë e tyre si dhe për të marrë disa inpute për përcaktimin e vizionit të planit.

Në diskutim u ngritën pyetje dhe problematika si më poshtë:

- Cila do të jetë shtrirja kohore e miratimit të dokumenteve të planifikimit?
- Cilën pjesë të financimit të projekteve do të mbulojë bashkia Fier?
- Banorët kërkuan të vlerësohen mundësitë për zhvillimin e ekoturizmit në zonën e Ferras – Pishë Poro.
- Qytetarët sugjeruan që të ngrihen projekte pilot për tregun e prodhimeve bujqësore në rrugën e Vlorës dhe Semanit. Gjithashtu qytetarët sugjeruan të ngrihen projekte pilot lidhur me pikat e grumbullimit të produkteve bujqësore.

Në përfundim Z. Florian Muça bëri sqarime të mëtejshme lidhur me disa prej projekteve më të rëndësishme të përmendura gjatë prezantimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e katërt publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Fier (VSM)

Data: 3/05/2016

Përfaqësues nga Co-Plan: Kejt Dhrami *(Planifikuese Urbane)*
Arta Alla *(Eksperte Mjedisi)*
Silvi Jano *(Urbanist)*
Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Fier, Agjensia Rajonale Mjedisit, Agronom, Profesion i lirë, Shoqëri Civile, Media, Fondi Pyjor.

Nuk kishin ardhur përfaqësues nga: Organizata Mjedisore, Bizensi, Shërbimet Publike, Inspektoriati Mjedisor & AKPT.

Prezantimi nisi në orën **12:^{31}** am

Fjala hapjes & Hyrje në prezantim: *Arta Alla*

Përshëndetje e shkurtër të gjithë pjesmarrësve,vihet theksi në shkëmbimin e informacionit dhe thellimin e bashkëpunimit si edhe adresohet vonesa e fillimit të takimit për shkak të pjesmarrjes së ulët në orën zyrtare të nisjes së takimit.

Një sqarim mbi fazat që tanimë janë konsumuar, fazën aktuale si edhe fazat e ardhshme deri në mbyllje të proçesit.

*(**4**min)*

Prezantimi VSM: Arta Alla

U përshkrua objektivi i VSM si edhe proçeset që janë ndjekur në kuadër të hartimit të VSM-së për Bashkinë Fier. Në prezantim u trajtuan të përgjithsuara temat dhe faktet e analizuara, si:

- Kuadri Ligjor & Institucional.
- Territori & Tokat Bujqësore:
  Bashkia Fier është kryesisht zonë fushore dhe disi kodrinore në Jug-Lindjen e saj, përkatësisht zona e Nj.A Cakran. Bujqësia është aktiviteti primar sidomos në zonën e

Myzeqesë, evidentohet se zona kodrinore është punuar me tarraca vite më parë. Kompozimi i rrejtit infrastrukturor ka qënë mjaft efiçent (lumenjt, kanalet kulluese, tokat, zonat industriale dhe ato bujqësore etj.)
Ka fenomen të theksuar të erozionit detar sidomos në Seman dhe grykderdhjen e Hoxharës. Ndërtimet dhe ndërhyrjet pranë argjinaturave e shtretërve të infrastrukturës së ujrave sipërfaqësore ka ndikuar në rritjen e inetsitetit të përmbytjeve.

- Ndryshimet Klimaterike:
  Të synohet përshtatja me këto ndryshime dhe mënyra e përqasjes së problematikave që vijnë si pasojë e këtyre ndryshimeve.

- Ndotja:
  Nga monitorimi i ndotjes në ujrat sipërfaqsor u evidentua p.H acid i Lumit Seman në vlera mesatare 6.2, ku dyshohet se kontribues kryesor i kësaj ndotjeje është përdorimi i pesticideve në bujqësi.
- Ujrat Nëntokësore:
  Duke patur parasysh pozicinin territorial mbi të cilin janë zhvilluar hapsirat urbane krahasuar me pozicionin e akuifereve, rezulton se një pjesë fare e vogël në Fier ka ndërtuar mbi akuifer. Problematike shfaqet situatata lidhur me mbishfrytëzimin e këtyre akufiereve nëpërmjet pus-çpimeve, si ato private apo shtetëror, të cilat nuk kanë zbatuar parimin e mbrojtjes nëpërmjet zonave higjeno-sanitare.
- Mbetjet
  Problematike shfaqet situata lidhur me Vend-Depozitimin aktual, shllamet e të cilave dekantojnë në kolektorin kryesor vaditës si edhe në lum. Mungojnë të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme, janë shtuar pikat e pakontrolluara të grumbullimit të mbetjeve. Hapsira e shfrytëzueshme nga Vend-Depozitimi Fier është zgjeruar me 28% në 8 vite.
- Kripëzimi & lëngëzimi i tokave bujqësore.
- TAP në Bashkinë Fier kalon rreth 26km shtrirje tubacioni, pavarsisht shtrirjes së tubacionit duhet konsideruar mirë edhe zonat buferike të cilat do të ndikojnë në mënyrën e përdorimit të tokës.
- Ajri:
  Nuk ka të dhëna dhe monitorime të publikuara të realizuara mbi Bashkinë Fier.
- Fondi Pyjor & Kullusor:
  Aktualisht Fieri ka një sipërfaqe shumë të vogël pyjore e cila konsiston në rreth 4% të sipërfaqes totale të saj.
- Biodiversiteti:
  10% e specieve të rrezikuara në R.Shqipërisë gjenden edhe në Fier. Ska rregjistër të specieve rezidente dhe stacionare
- Lista Monumenteve Natyrore & Kulturore:
- Sfidat & Problematikat.

Mbyllje e prezantimit, falenderime dhe ftesa për diskutim!

(48min)

Prezantimi përfundoi në orën **13:23** am

Diskutime & Shënime:

ARM: A janë marrë në konsideratë mbetjet që gjenerohen nga bujqësia?

A.Alla: Momentalisht nuk kemi në dispozicion asnje studim apo informacion zyrtar mbi këtë element ndotës prezent në Bashkinë Fier, po ashtu edhe trajtimi i saj mungon në Raportin e Gjendjes në Mjesis 2014.

ARM: A është menduar ti sygjerohet Bashkisë Fier trajtimi biologjik i këtyre mbetjeve organike?

A.Alla: Masat, siç edhe sqaruam, do ti propozohen Bashkisë në fazën pasardhëse.

G.Pina (Pyjore – Fier): Jemi të paqartë lidhur me sipërfaqen e deklaruar prej 4% pasi mendojmë se nuk është reflektuar e plotë.

S.Jano: Jemi në pritje të komenteve dhe bashkëpunimit më intensiv për të përditësuar proçesin e dixhitalizimit të fondit pyjor.

Koment: Laguna e Karavastasë i ka kaluar Bashkisë Lushnje.

Koment: Punonjësist e fondit pyjor shprehen se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe shkëmbime njohurish.

Shoqëria Civile: Çfarë po ndodh me Azotikun e Fierit, është deklaruar më herët se një projekt Italian po punon për rehabilitimin e tij?

R.Hyseni (Dr.Urbanistikës): Universiteti Politeknik i Barit ka kryer një studim të thelluar mbi rehabilitimin e kësaj zone dhe kthimin e saj në një kampus Universitar.

- Ekziston edhe një iniciativë për demolimin e gjithë ndërtesave të rrënuara.

Shoq.Civile: A janë përfshirë materialet dhe planet e emergjencave civile?

A.Alla: Kemi marë të dhëna nga Emergjencat Civile të cilat edhe i evidentuam në prezantim, kryesisht mbi përmbytjet zonat nën presion, planet e reagimit nuk i disponojmë.

Koment: Duam të dimë burimin e ndotjes së lumenjve dhe përrenjve, ti identifikojmë dhe ti ndalojmë.

Shoq. Civile: Nuk ishte trajtuar Vija Ngjalës, kolektori i Roskovecit i cili është ndotësi më i madh i bregdetit të Semnait. Ai bart dhe shkarkon gjithë ndotjen e Patos Marinzës si edhe elemntë të tjer. Kërkojmë të trajtohet me vëmëndje dhe ti jepet zgjidhje përfundimtare.

A.Alla: Ky problem është trajtuar në Strategjin e Fierit por nuk është paraqitur në këtë prezanitm.

A.Alla: Ajri në Fier cilësohet si mjaft i ndotur, duam literaturë dhe studime konkrete të cilave tu referohemi.

Takimi & Diskutimi përfundoi në orën **14:00** am

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e pestë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të territorit të Bashkisë Fier

Data: 20.05.2016

Bashkia Fier më datë 20.05.2015 në orën 17:00, realizoi takimin e pestë publik mbi "Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit" në sallën e Këshillit Bashkiak. Takimi fokusohej në propozimet e para të planit, në lidhje me rrjetin infrastrukturor.

Përfaqësues nga Co-Plan: Kejt Dhrami *(Planifikuese Urbane)*
Dritan Shutina *(Drejtor Ekzekutiv Co-PLAN)*
Rudina Toto *(Planifikuese Urbane)*
Silvi Jano *(Ekspert Mjedisi)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Fier, njësitë administrative, Drejtoria e Pyjeve, si dhe qytetarë të interesuar

Takimi u hap nga kryetari i Bashkisë Fier, Armando Subashi, i cili theksoi rëndësinë e hartimit të Planit për zhvillimin territorial të bashkisë në 15 vitet e ardhshme. Gjithashtu Subashi prezantoi disa projekte prioritare të bashkisë për vitet e ardhshme, si ndërtimin e landfillit dhe inceneratorit të ri, ndërtimin e spitalit rajonal, etj. Në vazhdim, drejtori ekzekutiv i Co-PLAN, Dritan Shutina, bëri një prezantim të shkurtër të procesit të hartimit të planit dhe planin e aktiviteteve. Në vazhdim, ekspertja pranë Co-PLAN, Kejt Dhrami, prezantoi sipas strukturës së mëposhtme:

- Plani i Aktiviteteve të PPV-së dhe fazat e realizuara
- Zhvillimi rajonal dhe impaktet kryesore ekonomike e territoriale mbi Bashkinë Fier
- Hendeku social dhe periferialiteti, zonat më të ndjeshme të bashkisë
- Vizioni i zhvillimit dhe objektivat strategjike të bashkisë, të dakordësuara në Strategjinë Territoriale

- Identitetin e specializimin ekonomik të makrozonave në bashki
- Zhvillimin konceptual të fashave, qendërsive dhe poleve të zhvillimit
- Projeksionet kryesore demografike sipas 2 skenarëve të mundshëm
- Kushtëzimet kryesore sektoriale dhe rëndësinë kombëtare në territor
- Konceptimin e rrjetit të propozuar rrugor sipas funksionit
- Mënyrat e ndërhyrjeve në rrjetin rrugor, rrugët e reja dhe zgjerimet e rrugëve ekzistuese në nivel qyteti
- Disa seksione rrugore tip për akset kryesore të Fierit
- Rrjeti i propozuar i transportit rrethqytetas
- Terminalet e propozuara të transportit
- Propozimet kryesore për rrjetin e KUZ e ujësjellësit
- Propozimet kryesore për menaxhimin e mbetjeve urbane
- Projekte të tjera...

Në përfundim të prezantimit, u zhvillua diskutim mbi disa çështje të interesit publik, si psh:

- Menaxhimin e përmbytjeve në zonën e Gjanicës, gjatë periudhës së rreshjeve
- Problemet e pronësisë në fshatrat Kraps e Lalar
- Mundësinë për të përcaktuar pika të reja të grumbullimi bujqësor
- Menaxhimin e landfillit ekzistues
- Mundësinë për hapjen e tregjeve përgjatë Bypass-it të ri

Grupi i punës pranë Co-PLAN dhe drejtoresha e përgjithshme e planifikimit të territorit, Renilda Hyseni, u përgjigjën si më poshtë mbi çështjet e ngritura për diskutim:

- Përmbytjet e zonave urbane do menaxhohen nëpërmjet një Plani të dedikuar mbi Rehabilitimin e lumit Gjanica, në zonën nga Ura e Mbrostarit në Kompleksin "Apollon". Kjo do integrohet me një sistem më të mirë të shpërndarjes së ujrave sipërfaqësore në qytet, i cili kërkon një studim të detajuar të pjerrësive respektive.
- Janë parashikuar 2 pika të tjera të grumbullimit të produkteve bujqësore, në Cakran dhe Topojë, por mbetet për të diskutuar vendodhja e tyre
- Landfilli aktual do mbyllet, në bazë të parametrave respektivë izolues e mjedisorë.

Më tej, kryetari mori fjalën, duke adresuar çështjet e tjera në diskutim, si dhe për të prezantuar projektet prioritare.

U diskutua për zgjidhjen e problemit të pronësisë nëpërmjet shpërndarjes së certifikatave brenda viteve 2016-2017. Gjithashtu u prezantua projekti i Spitalit Rajonal të Fierit, si një investim strategjik kombëtar, i cili do pozicionohet në Pyllin e Levanit. Kryetari parashtroi problematikën e ndërtimit të një objekti spitalor në zonë të mbrojtur të kategorisë IV, por theksoi rëndësinë e këtij projekti.

Takimi zgjati deri në orën 19:00

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e gjashtë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Fier

Data: 13.07.2016

Bashkia Fier më datë 13.07.2015 në orën 19:00, realizoi takimin e gjashtë publik mbi "Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit" në sallën e Këshillit Bashkiak. Takimi fokusohej në propozimet përfundimtare të planit të përgjithshëm vendor, përdorimet e propozuara, projektet strategjike dhe treguesit e propozuar të zhvillimit për territorin.

Përfaqësues nga Co-Plan: Kejt Dhrami *(Planifikuese Urbane)*
Dritan Shutina *(Drejtor Ekzekutiv Co-PLAN)*
Kristi Bashmilli *(Ekspert Mjedisi)*
Ada Lushi *(Arkitekte)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Fier, AKPT, njësitë administrative, bizneset e zonës dhe shoqata të tjera tematike.

Dëgjesa u hap me fjalën e kryetarit Armando Subashi, i cili theksoi rëndësinë e dokumentit të Planit për të orientuar zhvillimin e bashkisë në 15 vitet e ardhshme. Më tej, u bë një paraqitje e shkurtër e procesit nga Dritan Shutina, drejtor ekzekutiv i Co-PLAN, i cili theksoi hapat kyçë të realizuar, si dhe pritshmëritë për përfundimin e dokumentit të PPVZHT, së bashku me dokumentet mbështetëse të Rregullores Vendore të Planifikimit dhe VSM deri në fund të shtatorit 2016. Në vazhdim ekspertja e planifikimit pranë Co-PLAN, Kejt Dhrami, bëri një prezantim të propozimeve sipas strukturës së mëposhtme:

- Vizioni e poletve kryesore të zhvillimit
- Identiteti i zonave në bashki
- Fashat e qendërsitë territoriale
- Disa nga kushtëzimet e parimet bazë të ndjekura gjatë hartimit të planit

- Propozimet kryesore në lidhje me infrastrukturën rrugore, si funksionet, mënyrat e ndërhyrjes, rrjeti i biçikletave, rrjeti i propozuar i transportit publik dhe parkimet e propozuara
- Ndryshimet kryesore në përdorimin e tokës në bashki dhe në qytet, si dhe ndryshimet bazë të sistemeve territoriale
- Ndarja e njësive strukturore dhe parimet e ndjekura për të
- Konceptet e zhvillimit në nivel qyteti sa i takon treguesve të zhvillimit, intensitetit, hapësirave publike, etj
- Konceptet e ndërhyrjeve nëpër fshatra, në varësi të karakterit të tyre
- Intensitetet e propozuara në qytet, dhe skema shpjeguese
- Projektet strategjike të bashkisë, me fokus stacionin multimodal, inceneratorin e ri, impiantin e pastrimit të ujërave të ndotura, rehabilitimin e Gjanicës, Semanit, zhvillimin e zonës bregdetare, parqet e reja urbane, etj
- Imazhe ilustruese të këtyre ndërhyrjeve

Në vazhdim filloi diskutimi mbi propozimet dhe shqetësimet e pjesëmarrësve, fokusuar në këto çështje:

- Si inkuadrohet Parku i Apollonisë në zhvillimet e propozuara
- Në zona rurale rekomandohet të rritet intensiteti, për shkak të problematikës së pronësisë ndaj tokës bujqësore të paregjistruar në emër të pronarëve. Komentet lidhen me faktin se parcelat truall nën pronësi variojnë deri 250 m2, e cila nuk lejon ndërtim të mjaftueshëm për intensitete nën 1.
- Si do bëhet menaxhimi i mbetjeve urbane në nivel njësish administrative
- Si do kryhet rehabilitimi i fushës së mbetjeve në veri të qytetit
- Cfarë propozohet për zonat e mbrojtura në Bashki

Në përgjigje të çështjeve të ngritura, grupi i punës dhe drejtoresha e përgjithshme e planifikimit të territorit, Renilda Hyseni, u përgjigjën si më poshtë:

- Për parkun e Apollonisë do përcaktohet në Rregulloren vendore parametrat e propozuar në planin e menaxhimit të Parkut të Apollonisë, pavarësisht se nuk është i miratuar. Kjo kërkon hapjen e rrugës që lidh fshatin Kryegjatë me rrugën kryesore, pa kaluar në zonën A të mbrojtjes së Parkut
- Cështja e ndërtimit në zonat rurale u mor parasysh në Rregulloren e Planit, si rast i veçantë
- Menaxhimi i mbetjeve urbane do kryhet në përputhje me një sistem të integruar, me dy stacione transferimi të propozuara të reja
- Propozohen 2 zona të reja të mbrojtura, Pylli i Cakranit dhe Bregdeti nga delta e Semanit në Pishë-Poro, për shkak të vlerave të tyre të larta peizazhistike. Parashikohet gjithashtu zgjerimi i Pyllit të Levanit në pjesën jugore të tij.

Në përfundim të diskutimit kryetari bëri një përmbyllje të temave, duke riadresuar projektet strategjike të bashkisë, dhe duke theksuar rëndësinë e dokumentit për integrimin e zhvillimeve në bashki.

Dëgjesa përfundoi në orën 21:00

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal

***Dëgjesa e shtatë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Fier* (Dëgjesa 3 për VSM)**

Data: 13.09.2016

Përfaqësues nga Co-PLAN: Arta Alla *(Eksperte Mjedisi)*
Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*
Kejt Dhrami *(Planifikues Urban)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Fier, Prefektura, ARM-Fier, AKPT, Drejtoria Administrimit & Menaxhimit të Tokave, SNL, Profesion i lirë, Shoqëri Civile, OJF, Shërbimet Publike, Auditi, Këshilltarë Bashkiak, Kryetarë të NjA-ve, Përfaqësues nga sektori i Agronomisë dhe Bujqësisë, Pyjeve, etj.

Prezantimi nisi në orën **11:^{00}** am

Prezantim Pjesa I: Arta Alla *(Eksperte Mjedis)*

Hyrje e shkurtër, ku përshëndeten pjesëmarrësit dhe specifikohet natyra e kësaj dëgjese të organizuar me qëllim paraqitjen e VSM-së për Planin e Përgjithshëm të Bashkisë Fier.

Prezantim nis me spejgimin e legjilslacionit ku bazohet hartimi i VSM, detyrimet dhe metodologjinë e ndjekur. Qartësohen proçeset e ndejkura duke vënë theksin në fazat që tanimë janë konsumuar, fazën aktualen si edhe fazat e ardhshme deri në mbyllje të proçesit. Pjesa e parë e dëgjesës u përqëndrua në paraqitjen e rezultateve gjeneruar nga analizat mjedisore kryer pët të gjithë trerritorin e Bashkisë Fier. Elementët e

trajtuar në këto analiza (Toka, Ndotja, Mbetjet, Akuiferi, Ujrat Sipërfaqësorë, Sistemi Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, Pyjet, Erozioni, Ajri, Zhurmat, Infrastruktura etj. *(15 min)*

Prezantim Pjesa II: Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*

Në këtë pjesë të dytë të dëgjesës u trajtua vlerësimi i ndikimit që do të ketë në mjedis nga zbatimi i të gjithë fondit me projekte parashkikuar në PPV. Ky seksion u prezantua fillimisht duke spjeguar metodën e Vlerësimit të Ndikimit dhe konceptin e Përputhshmërisë, për tu ndalur më pas tek vlerësimi i secilit prej projekteve dhe rezultatet e tyre përmbledhëse.

Fondi projekteve të PPV Bashkisë Fier është strukturuar në Objektiva të Planit, si rrjedhoj nga vlerësimi i ndikimit është realizuar specifikisht për secilin projekt duke marrë në konsideratë Objektivat Mjedisor, po ashtu është vlerësuar edhe përputhshmëria në nivel plani, u konkludua se:

Ndikimi në mjedis nga zbatimi i PPV-Bashkia Fier do të jetë relativisht i ulët nëse rrespektohen masat e parashikuara ky ndikim mund të minimizohet dhe mjedisi mund të ripërtërihet normalisht. Disa projekte dhe ndërhyrje të forta do të kenë nevoj për studime të mëtjeshme në kuadrin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Lidhur me përputhshmërinë, PPV – Bashkisë Fier, është vlerësuar të këtë përputhshmëri mesatare me Objektivat Kombëtare Mjedisor (Ajri, Uji, Toka, Pyjet, Biodiversitete, Kultura, Klima etj.) *(15 min)*

Prezantim Pjesa III: Arta Alla *(Eksperte Mjedis)*

Pjesa e tretë dhe e fundit e prezantimit konsitsoi në paraqitjen e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet që do të rrejdhin si rezultat i implementimit të projekteve të parashikuara nga PPV. Krahas masava konkrete mjedisore u paraqiten edhe projekte specifike të cilat kanë karakter rehabilitim të zonave të nxehta mjedisore si dhe ndërhyrje për seksione dhe terrene me probleme të theksuara në këtë Bashki (Rehabilitimi Zonave të Nxehta Mjedisore, Zona ripariane e lumit Seman, rehabilitimi Gjanicës, Projekte zhvillimore dhe mbrojtëse për vijën bregdetare etj) *(14 min)* Prezantimi përfundoi në orën **11:**[50] am

Diskutime & Shënime:

Në vijim janë përfshirë komentet dhe diskutimet e realizuara gjatë dëgjesës:

1. Znj. Ornela Durmishaj (Sektori Turizmit) shpreh shqetësimin lidhur me fenomenin e kripëzimit të tokave bujqësore në Bashkinë Fier.

Përgjigjie, Arta Alla: Këtë shqetësim e kemi trajtuar gjerësisht në analizë dhe kemi konstatuar se është një fenoment i hershëm i cili mund të minimizohet në nivele të vogla por do të jetë e vështirë të ndalohet si pasojë e rrymave të ujrave nëntokësor. Mbjellja me pemtari (Pishë) mund ta ngadalsojë këtë fenomen, por sygjerojë që këto hapsira të mëdha toke të përdoren nga Industria e Energjive të Rinovueshme për ngritjen e Centraleve Fotovoltaik ose Eolik.

2. Z. Dhimitër Gjini (Shoq. Pensionistëve): Konstatojmë se Bashkia nuk shfaqe interes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit ndaj edhe situtata nuk është e volitshme në Bashkinë Fier. Treguesit që ju propozoni të monitorohen mendojmë se janë të

mjaftueshëm dhe njëkohësisht të domosdoshëm për të vlerësuar hap pas hapi cilësinë e mjedisit dhe gjëndjen e tij. Ju përgëzoj për punën profesionale dhe uroj që masat që keni parashikuar dhe që i paraitiët sot, të merren në konsiderate dhe të mblidhen fondet e nevojshme për zbatimin sa më të shpejt të tyre.

3. Z. Piro Prifti (Arkitekt/Vlerësues): Si është parashikuar të trajtohet ndotja e lumit Gjanica dhe ndotja e tokave në Bashkinë Fier.

Përgjigjie, Rodion Gjoka: Aktualisht kemi identifikuar disa prej burimeve të ndotjes së lumit Gjanicë ku mund të veçojmë ndotjen që akumulohet dhe vjen prej rafinerisë së naftës në Ballsh. Gjithashtu edhe shkarkime të ndryshme industriale nga biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre përgjatë këtij lumi si edhe shkarkimet e ujrave të ndotura urbane e kanë kthyer këtë lum në një vatër të nxehtë mjedisore.

Në proejktet e PPV është parashikuar ndërhyrja fizike për rehabilitimin dhe disiplinimin e këtij lumi, me qëllim kthimin e tij në një fashë rekreative e cila do u shërbej gjërësisht banorëve të Fierit si edhe do të eleminoj problemet që shkaktohen gjatë shirave ku Gjanica paraqitet mjaft e ndjeshme dhe përmbytjet shkaktojnë vazhdimisht dëme. Sa i përket ndotjes, së pari kemi adresuar nevojën emergjenete për monitorimin e burimit të ndotjes, pra të identifikohen dhe penalizohen të gjithë që shkarkojnë mbetjet e tyre në Gjanicë. Sa i përket ndotjes së tokës, kemi paraqitur në seksionin e masave dhe propozimeve të VSM-së, teknika dhe ndërhyrje specifike të cilat i japin zhgjidhje konkrete problemit të tokave të ndotura.

Takimi & Diskutimi përfundoi në orën **12:^{40}** pm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal

Mbi: Takimi i dytë i FBPV për hartimin e PPV Bashkitë Fier dhe Lushnjë

Referuar VKM-së Nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Neni 2 përcakton se:

"Forumi për bashkërendimin e planifikimit" është një mekanizëm për të nxitur diskutimet strategjike të përfaqësuesve: të autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe ekspertëve; për të arritur koordinimin e çështjeve të planifikimit për një zonë, njësi vendore, rajon apo territorin në përgjithësi. **Forumi nuk është entitet vendimmarrës, miratues apo zgjidhës i konflikteve.**

FBPV-ja drejtohet nga drejtuesi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe përbëhet nga drejtuesi i organit përgjegjës për planifikimin në njësinë vendore që ka ndërmarrë nismën, përfaqësuesi planifikues i bashkive kufitare dhe përfaqësuesi planifikues i qarkut. Sipas rastit, FBPV-ja mund të ketë në përbërjen e tij edhe përfaqësues të grupeve të interesit.

Në ambientet e Hotel Mondial, më datë 19.10.2016, ora 10:30, u mbajt takimi i dytë i Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit Vendor për bashkitë Fier dhe Lushnjë.

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe diskutime mbi draft dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë Fier dhe Lushnjë.
Pjesëmarrës në takim ishtin përfaqësues të bashkive Fier, Lushnje, Patos, Kucovë, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Administrata e zonave te mbrojtura Fier, si dhe përfaqësues të Co-Plan.

Pas një prezantimi të përmbledhur të Draft PPV për secilën bashki, gjatë diskutimit të hapur u prekën çështjet dhe u diskutua si më poshtë si me poshtë:

- Përparësia që duhet ti jepet tokës bujqësore për të dy bashkitë duhet të jetë prioritare te të dy planet
- I duhet dhënë zgjidhje në plan tokave që janë dhënë me qera nga shteti si dhe tokave të kripura
- Zgjidhjet që dalin në lidhje me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe menaxhimin e ujërave të ndotura

- Si janë marr parasysh zonat e rrezikut të përmbytjeve sidomos në bashkinë Fier
- Si janë trajtuar monumentet e natyrës dhe kulturës në të dy planet
- Ndërlidhja e projekteve prioritare në mënyrë që ndikimi të jetë zinxhir dhe sa më efektiv
- Si do të realizohet shtimi i sipërfaqeve pyjore
- Cili është zhvillimi që do të marrë parku natyror Pishe Poro.

Pyetje: *Znj. Fiona Mali:* A është parashikuar stacion Multimodal në Bashkinë Fier? Nëse po ku mendohet të pozicionohet ai dhe cilat do të jenë llojet e transportit që do të akomodojë? Po për bashkinë Lushnje si është menduar Stacioni Multimodal?

Pergjigjet Z. Thimi Rudi: Stacioni multimodal për Bashkinë Fier është menduar të rizhvillohet në stacionin ekzistues të autobusëve. Ai mendohet të akomodojë autobusët ndërqytetas, furgon dhe taksitë.

Pergjigjet Znj. Fiona Imami: Sa i përket bashkisë Lushnje, janë dhënë dy propozime për Stacionin Multimodal. I pari, i cili mendohet të ndërtohet në periudhën më afatshkurtër propozohet në hyrje të qytetit të Lushnjes. Për periudhën më afatgjatë Bashkia Lushnje propozon krijimin e qendërsisë së re të Lushnjes e cila kulmon me zonën e stacionit Multimodal, në zonën e stacionit të vjetër të trenit. Kjo zonë parashikohet si një zonë multifunksionale, e cila integron stacionin e trenit, sipërfaqe për zyra, ambjente sociale dhe rekreative, zona shërbimesh etj. Në të dyja rastet zonat e stacionit multimodal përfshijnë ambjente për parkimin e autobusëve ndër dhe rreth qytetas, vendqëndrimin e taksive, si dhe sipërfaqe parkimi.

Koment: Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë: Bashkite Berat-Lushnje-Fier kane potencialin me te larte te tokave bujqesore te kategorise 1-4, keshtu duhet patur kujdes kur flitet per konvertim. Tokat e kripura kane qene ne perdorim dhe ka interes per zhvillim per produkte higrofile ose panele diellore, prandaj nuk mund te propozohen nderhyrje madhore si landfille, stacione transferimi ,etj pa konsultuar. Në të tilla raste duhet marre parasysh Strategjia e Zhvillimit Bujqesor
Pergjigjet Znj. Fiona Imami: Gjatë hartimit të PPV-së për Bashkitë Lushnje dhe Fier, sikurse dhe gjatë hartimit të dokumenteve të VSM për të dyja këto Bashki janë marrë parasysh jo vetëm Strategjia e Zhvillimit Bujqësor por të gjitha Strategjitë Kombëtare. Sa i përket Bashkisë Lushnje, PPV parashikon pikërisht ndërtimin e këtyre paneleve diellore në tokat e kripura të fshatit Plug. Megjithatë, pavarsisht dërgimit të shkresave zyrtare pranë Ministrisë suaj dhe institucioneve të tjera të varësisë, për marrje informacioni, nuk kemi mundur të marrim as informacionin lidhur me bonitetin e tokave, sikundër nuk kemi asnje informacion mbi tokat e kripura apo bujqësore që Ministria e Bujqësisë ka dhënë me qera përkatësisht në këto dy bashki

Pyetje: *Znj. Mirzeta Kashnica:* Do të sugjeroja që në hartën e rëndësisë kombëtare, aty ku ju keni paraqitur gjurmën e TAP të vendosni dhe gjurmën e IAP, gjurmë kjo e cila kalon si në bashkitë Fier ashtu edhe Lushnje. Sa i përket sistemit infrastrukturor, do të ishte më mirë të kishit emërtuar rrugët sipas Kodit Rrugor. Një pyetje tjetër lidhet me pozicionin e fshatit turistik. Keni pare mundesi per zhvillim ne fshatin Portiq? Pasi ne PINS Bregdeti parashikohet te zhvillohen fshatrat ekzistues, sikurse dhe të ndalohet ndërtim i zonës bregdetare në Fier.

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Sa i takon vendndodhjes së zonës së resorteve, u morën parasysh disa pozicione të mundshme: zona në afërsi të Topojës, e cila përkon me

deltën e Semanit; zgjerimi i Darzezës drejt tokës bujqësore, dhe zona e tokave të kripëzuara, kufizuar nga pylli i Pishë Poros. Pozicioni i parë nuk u konsiderua i realizueshëm, për shkak të vlerave peizazhistike të zonës ligatinore, dukurive të theksuara erozive të bregdetit, ku turizmi masiv nuk do ishte i qëndrueshëm, dhe kalimit të gjurmës së TAP, duke i dhënë zonës karakter më ekonomik. Në vendndodhjen e Darzezës janë propozuar ndërhyrje të mbushjes urbane dhe intensifikim, por nuk është parë e arsyeshme të zhvillohet zonë e gjerë e dedikuar për hoteleri. Sipërfaqja e përzgjedhur në Pishë Poro shtrihet 1.2 km nga vija bregdetare, është tokë e kripëzuar e papërdorur, dhe mund të zhvillohet në përputhje me zonat buferike përreth pyllit. Gjithashtu zona e plazhit ka karakter akumulues, të përshtatshëm për aktivitet turistik. Zhvillimi brenda zonës së resortit do bëhet në mënyrë inkrementale, nga pjesa veriore, linearisht përgjatë rrugës së brendshme, dhe për të realizuar një intensitet me kusht +1, zhvilluesit duhet të mbjellin breza pishash në anën tjetër.

Adresim në PPV: *Gjurma IAP do vendoset në hartat respektive të infrastrukturës, me t'u bërë të disponueshme. Paraqitja e rrugëve sipas klasifikimit të Kodit Rrugor dhe me gjerësitë respektive është paraqitur në dokumentet e PPV, në hartat me kodet P:02/2 dhe seksionet përkatëse në P:02/9.*

Pyetje: *Z. Sajmir Hoxha:* Cfarë parashikon PPV, si për bashkinë Fier ashtu edhe Lushnje për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe trajtimin e ujërave të ndotura? Sipas mendimit tim, gjatë parashikimit të vendodhjes së stacioneve të transferimit nuk duhet marrë parasysh vetëm kriteri i pronësisë apo cështje të kostos, por një sërë kriteresh të tjera mjedisore. Stacionet e transferimit, nuk janë gjë tjetër vetëm disa hotspote të krijuara, prandaj nuk duhen lejuar.

Pergjigjet Znj. Fiona Imami: Sa i përket Bashkisë Lushnje, PPV parashikon ndërtimin e një impianti të kompostimit të mbetjeve, pranë fshatit Murriz Peqin, është parashikuar ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, sikurse janë parashikuar dhe dy zona, në tokë të kripur, të cilat janë të përshtatshme për ndërtimin e Stacioneve të transferimit. Fatkeqësisht Bashkia Lushnje akoma nuk ka informacion se ku duhet ti depozitojë mbetjet, pra në cilin Landfill, kjo sepse vendimarrja është në një nivel më të lartë qeverisës.

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Në Fier propozohet mbyllja dhe rehabilitimi i landfillit aktual në veri të qytetit, dhe hapja e një landfilli të ri, në zonën e Plykut, rreth 500 metra në lindje të Azotikut. Kjo zonë do rezervojë mundësinë për ndërtimin e një Impianti të trajtimit të mbetjeve me djegie, sipas detajeve të mëtejshme të projektit.

Ndërkaq, parashikohen 2 stacione transferimi në Cakran dhe Topojë, duke pozicionuar në zona me tokë joproduktive/të kripëzuar.

Në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza, Bashkia ka parashikuar ndërtimin e një impianti pastrimi në veri të qytetit, në pjesën perëndimore të landfillit ekzistues, me një sipërfaqe të dedikuar rreth 20 Ha. Pozicioni është propozuar sipas projektit të KfË dhe pritet të ketë efekt shumë pozitiv në pastrimin e lumit Seman nga ndotjet e Gjanicës. Efektet negative të mundshme mund të shtrihen deri në 1 km nga impianti, nëse nuk përdoren teknikat e duhura të filtrimit për aromat në ajër.

Pergjigjet Z. Bledi Dimo: Stacionet e transferimit, janë ndërhyrje mjaft të domosdoshme, kjo sepse, nëse kostot për largimin e mbetjeve në cilëndo prej bashkive do të kalonin qoftë me një kilometër standardit, sistemi do të ishte totalisht

ineficent dhe nuk do të funksiononte. Vec të tjerash kur flasim për projektimin e stacioneve të transferimit kemi parasysh struktura të cilat do të projektohen dhe zbatohen sipas standardeve dhe jo thjesht gropa të hapura diku të cilat mbulohen me kalimin e kohës dhe mund të krijojnë atë që thoni ju, hotspote mjedisore.

Pyetje: *Znj. Mirzeta Kashnica:* Cfarë është menduar për përmbytjet në Gjanicë? Duhet patur parasysh që konvertimet e tokës për infrastrukturë dhe urbanizim të kufizohen, e duhet argumentuar mirë pse ndodh ky konvertim, sidomos për Unazën 3, e cila duket sikur vetëm merr tokë bujqësore, dhe në lidhje me aksin e Grecallisë. Ndërkaq, PINS Bregdeti dhe PPK propozojnë një rrugë që do zhvillohet përgjatë bregdetit, ku parashikohet ajo?

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Në PPV një ndër projektet strategjike që propozohet është rehabilitimi i shtratit të Gjanicës dhe kthimi i tij në park urban. Ky projekt do detajojë masa afatshkurtra dhe afatgjata kundër përmbytjeve. Për momentin nuk është parë e arsyeshme të propozohen xhepa të lirë krahas Gjanicës, duke patur parasysh nivelin e lartë të urbanizimit. Intensitetet e propozuara nga bashkia për zonat përreth Gjanicës marrin parasysh skenarin pozitiv të zhvillimit, ku Gjanica do jetë park urban i aksesueshëm, me rrjedhë të menaxhuar sipas një sistemimi të qëndrueshëm të shtratit.

Rruga përgjatë bregdetit është një ndër propozimet kryesore infrastrukturore në Fier. Ajo shtrihet përgjatë kanalit kullues paralel me bregdetin, në distancë që varion 1-5 km nga bregu, dhe në zonën e propozuar për resorte, në Pishë Poro, e përshkon zonën në mes, për të mos cënuar zonën buferike të rezervatit të menaxhuar. Ky aks ka funksion mbrojtës të brezit pyjor bregdetar dhe lidhës të funksioneve turistike të reja të propozuara.

Pergjigjet Z. Thimi Rudi: Per strukturimin e shtratit të Gjanicës do merren gjithashtu masa emergjente, duke thelluar shtratin periodikisht, për të shmangur përmbytjet. Gjithsesi kjo nuk na rezulton një ndërhyrje e qëndrueshme në terma afatgjatë, kështu kërkohet një studim i veçantë për të.

Adresim në PPV: *Unaza 3 vjen si përgjigje e rritjes së pritur urbane të Fierit në vitet në vazhdim, është në përputhje me 2 plane të mëparshme vendore të bashkisë, dhe synon kufizim të shtrirjes urbane. Nuk parashikohet zonë shërbimesh rreth saj, dhe intensiteti i banimit është mjaft i ulët. Zonat bujqësore ekzistuese pësojnë ngrirje, dhe vazhdohet përdorimi bujqësor deri në momentin që bashkia të ketë nevojë për plotësim të interesave publike në këto zona. Gjerësia e kësaj rruge është 15m dhe parashikohet të ndërtohet në periudhën afatgjatë.*

Aksi i Grecallisë është hyrja e re e qytetit nga Bypass, si rrjedhojë do pajiset me shërbime ekonomike, hotelerie, tregtie, etj.

Pyetje: *Z. Sulejman Xhepa:* A jane marre parasysh planet per infrastrukturat kombetare si për shembull korridori blu? Si janë trajtuar monumentet e natyrës në të dyja bashkitë? Më specifikisht për Dunat në Fier dhe burimet termominerare të Karbunarës?

Pergjigjet Znj. Fiona Imami: Po planet për infrastrukturat kombëtare janë marrë parasysh dhe siç e shihni janë hedhur gjurmët dhe në hartat e transportit të propozuar për të dyja bashkitë. Sa i përket monumenteve të natyrës, ato mbeten të paprekura dhe

plani shprehet për mbrojtjen e tyre. Sigurisht bashkia do të ketë rolin e saj në mirëmbajtjen e tyre së bashku me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Për Dunat e Fierit parashikohet ripyllëzimi i tyre me bimë higrofike, si dhe izolimi për të mos humbur sipërfaqe dhe lartësi. Monumentet e natyrës janë lënë të pacënuara nga ndërhyrjet artificiale, pavarësisht gjendjes së tyre pothuajse të degraduar në disa raste (si Rrapi i Cakranit).

Pyetje: Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë: Cilat parime keni ndjekur për konvertimet e mundshme, kryesisht ato në tokën bujqësore?

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Në Bashkinë Fier ndodhin kryesisht 3 lloje konvertimesh:

- tokë bujqësore në tokë natyrore
- tokë bujqësore në tokë urbane, me përdorim banim
- tokë bujqësore në tokë urbane, me përdorime specifike.

Toka që konvertohet në tokë natyrore i përket zonave ripariane të lumenjve, kryesisht lumit Seman, deri te argjinatura e tij. Ky konvertim është i rëndësishëm për rehabilitimin e shtratit të Semanit dhe mbrojtjen e ujit nga pesticidet. Synohet në periudhën afatgjatë.

Konvertimet e tokës bujqësore ne tokë banimi përgjithësisht përkojnë me vijat e verdha të fshatrave ose me zona me interes të lartë rritjeje, si fshatrat ekoturistikë.

Konvertimet e tjera kanë sipërfaqe më të madhe, e ndodhin kryesisht në toka bujqësore të papërdorurua: zona e resorteve dhe zona ekonomike në tokat e kripëzuara, respektivisht në Pishë Poro e Topojë, parku urban i Mbrostarit në tokat e përmbytura në afërsi të fshatit, etj.

Pergjigjet Znj. Fiona Imami: Sa i përket konvertimeve edhe në rregulloret e PPV shprehet se i kemi dy llojësh: konvertime të matshme dhe të llogaritshme. Konvertimet e matshme përfshijnë të gjitha ato konvertime të cilat ndodhin gjatë propozimeve tona, psh: konvertime të tokës bujqësore në natyrore për krijimin e zonave ripariane aty ku janë dëmtuar, shtimit të sipërfaqeve pyjore apo ndërtimin e parkut periferik të qytetit në rastin e Lushnjes. Konvertimet e llogaritshme janë ato vendimi për të cilat do të merret kohë pas kohë sipas procedurave ligjore të Ministrisë së Bujqësisë vecanërisht. Psh pavarsisht se në një zonë parashikohet le të themi mbushje urbane, dhe kategoria e propozuar është banim, zhvillimi mund të ndodhë në një përiudhë shumë më afatgjatë, ose ndoshta dhe fare. Për këtë arsye nuk mund ta propozojmë këtë fond bujqësor ose natyror ose cfarëdo për konvertim që me miratimin e planit, por konvertimet do të ndodhin rast pas rasti dhe sipas procedurave të parashikuara në ligj.

Pyetje: Shpendi Balilaj: Plani bregdetit në rregulloren e tij cakton një zone buferike 100 metra (50+50) të mbrojtjes, e cila është ulur në krahasim me rregulloren e mëparshme. Është marrë parasysh kjo distancë?

Pergjigjet Znj. Kejt Dhrami: Në propozimet e planit për bregdetin e Fierit është ruajtur si zonë minimale distanca 200 metra e përcaktuar nga Ligji i Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore dhe 300 metra për infrastrukturën kryesore. Për struktura të përkohshme të turizmit ruhet distanca 50 metra nga bregu, në zonën e Darzezës deri në Pishë Poro, ku është parashikuar zonë plazhi intensiv.

1 Bazuar ne kufirin e propozuar nga Bashkia Fier, për t'u miratuar në kuadër të Reformës Territoriale
2 Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Fierit, 2006
3 Numri i treguar i banorëve është gjeneruar nga analiza demografike bazuar në të dhënat e INSTAT 2015. Kjo shifër do të përdoret edhe gjatë analizave të tjera pavarësisht faktit se rezulton të jetë më i ulët se shifra e deklaruar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Fier.
4 Klasifikimi i klimës sipas Köppen është një klasifikim klime nga më të përdorurit në sistemet e klasifikimit të klimës. U publikua për herë të parë në 1884 nga klimatologu Ruso-Gjerman Wladimir Köppen. Më vonë, klimatologu gjerman Rudolf Geiger bashkëpunoi me Köppen në ndryshime të sistemit të klasifikimit dhe nga kjo sistemi njihet tashmë me emrin Köppen–Geiger. Ky klasifikim lidhet me tipat e vegjetacionit dhe si reagojnë ata ndaj klimës.
5 Klasifikimi Csa- Klima e grupit C- Klima mesatare që ndodhin zakonisht në anët perëndimore të kontinenteve ndërmjet gjërësive 30° dhe 50°. Csa- është klima me verë të thatë ose ndryshe klima Mesdhetare.
6 Geo Consulting, Shqipëria, Harta e Shpërndarjes së sasisë vjetore të orëve me diell.
7 World Trade Press, Albania Precipitation.
8 Geo Consulting, Shqipëria, Harta e Shpejtësisë mesatare të erës (m/s).
9 Bashkësia e strukturave gjeologjike brenda territorit të Shqipërisë.
10 SHGJSH, Harta e Pasurive Minerale, Qarku Fier, Shkalla 1:100,000, 2014.
11 "Akuifer ose ujëmbajtësi është një formacion nëntokësor shkëmbi të përshkueshëm apo materiali të copëzuar, i cili mund të prodhojë sasi të përdorshmë uji dhe të mërret qoftë nga burimet (natyrale) apo puset (artificiale)" cit: Vezir Muharremaj, "Shkenca e Tokës II", 2014.
12 SHGJSH, Harta Hidrogjeologjike, Qarku Fier,Shkalla 1:100,000, 2014.
13 SHGJSH, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Fier, 2014.
14 SHGJSH, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë", Qarku Fier, 2014.
15 Vezir Muharremaj, "Shkenca e Tokës II" fq. 161, 2014.
16 SHGJSH, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier" fq. 76, 2014.
17 SHGJSH, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier" fq. 91, 2014.
18 SHGJSH, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet ne qarqet e Shqiperise", Qarku Fier, 2014.
19 Andoni. B, 2012: "Fieri, me kujtesën e gëlltitur historike", bazuar në shkrime të historianit Ilirjan Gjika.
20 Cabanes, B.: "Historia e Arkeologjisë Shqiptare"
21 UNESCO 2015, Lista Tentative, http://whc. unesco. org/en/tentativelists/5885/, referuar më 19.11.2015.
22 Andoni. B, 2012: "Fieri, me kujtesën e gëlltitur historike", bazuar në shkrime të historianit Ilirjan Gjika.
23 Cabanes, B.: "Historia e Arkeologjisë Shqiptare"
24 Ministria e Kulturës.
25 VKM No. 396, 31.3.2005 "Mbi miratimin e kufijve dhe rregullat e administrimit të parqeve arkeologjike në Shkodër, Lezhë, Apolloni, Bylis, Amantia, Orikum, Antigonea, Finiq dhe Butrint" dhe Ligji nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar).
26 Vendim i Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 1, Datë 08.04.2014, Për Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)
27 Dokumenti i analizës së thelluar të Bashkisë Fier dhe i një pjese të Komunës Qendër, korrik 2012, f. 44.
28 Bashkia Fier dhe Co-PLAN 2015, Harta e Përdorimit ekzistues të Tokës Fier
29 Sipërfaqja e treguar është gjeneruar nga Plani i Përdorimit të Tokës për Bashkinë Fier në sistemin GIS, Co-PLAN dhe Bashkia Fier 2015.
30 Numri i treguar i banorëve është gjeneruar nga analiza demografike bazuar në të dhënat e INSTAT-it 2015. Kjo shifër do të përdoret edhe gjatë analizave të tjera pavarësisht faktit se rezulton të jetë më i ulët se shifra e deklaruar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Fier.

31 Studimet janë kryer referuar hartave topografike të para viteve 1990, 2007 dhe 2013 dhe janë përpunuar dhe përgatitur nga grupi i punës pranë Co-PLAN.
32 Përzgjedhja e kësaj zone si rajon është bërë vetë për arsye studimi. Në këtë territor gjenden burime të shumta ujore, janë përqendruar një pjesë e madhe e HEC-eve dhe paraqet një territor nga zona fushore e bregdetare deri tek ajo malore. Pra nga ana e analizës së metabolizmit përmban të gjithë elementët e nevojshëm për analizim.
33 Burimi i info Harta Shpejtësia Mesatare e erës, AKBN, përpunuar tek harta e energjisë në rajon (Co-PLAN).
34 Burimi i info Harta e rrezatimit mesatar vjetor, AKBN, përpunuar tek harta e energjisë në rajon (Co-PLAN).
35 Informacioni për përgatitjen e hartave të metabolizmit është marrë nga Bashkia Fier, SHGJSH-ja, Ministria e Mjedisit, www.riverwatch.eu, AKBN, INSTAT, Ministria e Bujqësisë dhe ASIG.
36 Informacioni për përgatitjen e hartave të metabolizmit është marrë nga Bashkia Fier, SHGJSH-ja, Ministria e Mjedisit, www.riverwatch.eu, AKBN, INSTAT, Ministria e Bujqësisë dhe ASIG.
37 Sipërfaqja e matur nga harta GIS (61 bashki).
38 Analiza Demografike 2015 (INSTAT, Co-PLAN).
39 Sipas hartës së Fluksit të Energjisë (HEC-et nga River Watch: http://riverwatch. eu/en/interactive-map).
40 Universitet Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Atlasi i Burimeve Gjeotermale në Shqipëri, Tiranë 2004.
41 Energji të rinovueshme, energjia diellore.
42 Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013.
43 INSTAT, Censusi 2011 (Grid).
44 Njësi Ekonomike Familjare.
45 INSTAT, Censusi (2011).
46 Imbotilim është uji i pijshëm i paketuar në shishe.
47 Harta Hidrologjike, SHGJSH.
48 Sipërfaqe e matur nga GIS nga harta e përdorimit të tokës.
49 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
50 Ndërmarrje ujësjellës që ofron shërimin e furnizimit me ujë në Njësitë Administrative Fier, Qendër, Dermënas, Topojë dhe Frakull.
51 Të dhënat për ujësjellës-kanalizime janë përpunuar nga Valu Add në kuadër të hartimit të planit të përgjithshëm vendor për Fierin.
52 Drejtoria Rajonale Bujqësore, Fier.
53 2014, Fier Region Waste Management Plan, DLDP.
54 INSTAT (2013), i disponueshëm në: http://www. instat. gov. al/al/themes/mjedisi. aspx?tab=tabs-5
55 Vendndodhja e përafërt (gjetur në hartë përafërsisht).
56 Të dhënat për kompanitë ricikluese nga Ministria e Mjedisit, aksesuar për herë të fundit tetor 2015.
57 E ekstrapoluar sipas Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve 2011.
58 Harta e Metabolizmit, Fluksi i Mbetjeve, Fier.
59 Vendim i KM-së nr. 175, datë 19.01.2011, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të manaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve".
60 Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Fier, USAID 2016.
61 Marrë nga SHGJSH, Harta Hidrologjike e Qarkut të Fierit.
62 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
63 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003.
64 PNUD, Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri, 2003
65 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier, 2014.
66 Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010
67 SHGJSH 2014.
68 SHGJSH, Harta Hidrologjike e Qarkut të Fierit.
69 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
70 Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010.
71 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit, 2013.

72 Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293.
73 SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjëndjes, Shkurt, 2016.
74 Kriteret mund të ndryshojnë nga vendi në vend.
75 Ligji Nr. 111/2012 Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore.
76 Instituti kompetent për studimin dhe monitorimin e gjendjes së shtretërve të lumenjve është SHGJSH-ja, siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2015 Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.
77 SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjëndjes, Shkurt, 2016.
78 SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori I Monitorimit të Rrjetit Lumor, Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjëndjes, Shkurt, 2016.
79 Instituti kompetent për studimin dhe monitorimin e gjendjes së shtretërve të lumenjve është SHGJSH-ja, siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2015 Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.
80 SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes, Shkurt, 2016.
81 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
82 USAID, 2014.
83 USAID 2014.
84 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
85 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
86 SHGJSH.
87 SHGJSH.
88 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
89Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Doëell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.
90 Sipas takimeve me pwrfaqwsues tw kompanisw Bankers
91 Ky monitorim i cilësisë së ujërave sipërfaqësore u krye për lumenjtë: Osum, Devoll, Seman, Shkumbin, Gjanicë dhe Vjosë. Monitorimi u krye në periudhën qershor-korrik, nga Co-PLAN, në kuadër të zbatimit të projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore. Në pellgun e Lumit Seman, marrja e mostrave të ujit për analizë u bë në 11 pika, 6 nga të cilat në Osum. Në të gjitha pikat u analizuan në laborator 13 parametra fiziko dhe bio-kimikë (pH, Light Transparency, Electric Conductivity, Total Suspended Solids (TSS), Total Dissolved Solids (TDS), Dissolved Oxygen (DO), Temperature, Biochemical Oxygen Demand (BOD), N-NH4, N-NO3, N-NO2, sulfidet dhe Total Coliform). Ndërkohë në 7 Nga mostrat e mbledhura, disa mostra u analizuan edhe për praninë e metaleve të rënda (Pb, Cd, Mn, Ni, Zn, Cu, Co, Cr, Hg, As, Ba, Br).
92 Parametrat e përbashkët të monitoruar nga Co-PLAN/PLGP-ja dhe AKM-ja janë pH, Oksigjeni i tretur, BOD5, N-NH4, N-NO2 dhe N-NH4.
93 Pikat e monitorimit për lumenjtë kryesorë të Basenit të Semanit (Gjanicë, Seman, Osum dhe Devoll) janë të njëjta me përjashtim të pikës së Mujallisë në Seman e cila është monitoruar vetëm nga AKM-ja. Pikat e monitorimit të AKM-së në Osum janë Uznovë dhe Urë Vajgurore. Monitorimi Co-PLAN/PLGP-së në Seman është kryer në 12 pika kundrejt 6 pikave të monitoruara nga AKM, ndërsa në Osum në 6 pika kundrejt 2 pikave të monitoruara nga AKM-ja.
94 Kjo pikë është monitoruar vetëm nga AKM-ja.
95 Parametrat e përbashkët të monitoruar nga Co-PLAN/PLGP-ja dhe AKM-ja janë pH, Oksigjeni i tretur, BOD5, N-NH4, N-NO2 dhe N-NH4.
96 Pikat e monitorimit për lumenjtë kryesorë të Basenit të Semanit (Gjanicë, Seman, Osum dhe Devoll) janë të njëjta me përjashtim të pikës së Mujallisë në Seman, e cila është monitoruar vetëm nga AKM-ja. Pikat e monitorimit të AKM-së janë Ura Mbrostarit,Ura Mbrostarit, Kuçovë-Kozare para bashkimit me Osumin, Uznovë. Monitorimi Co-PLAN/PLGP është kryer në 12 pika kundrejt 6 pikave të monitoruara nga AKM-ja.
97 Kjo pikë është monitoruar vetëm nga AKM-ja.
98 Nevoja Biologjike për Oksigjen.

99 Normat janë marrë nga Council Directive CEE/CEEA/CE 78/659 (Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659) për cilësinë e ujërave të ëmbël për rritjen e peshqve.
100 Vlerat e monitorimit të AKM-së paraqesin ujëra në gjendje të moderuar dhe vetëm në një pikë të varfër.
101Total Suspended Solids.
102Total Dissolved Solids.
103 Normat e N-NH4 dhe N-NO2 janë marrë nga Direktiva e BE "Directive 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC".
104 Vlera e lejuar e AKM-së për N-NH4 është 0.6mg N-NH4/l.
105 Normat e N-NO3janë marrë nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub (International Commission for the Protection of the Danube River).
106 AKM-ja përdor normat 0.12 mg.l ndërsa normat mjedisore të përdorura në analizën Co-PLAN/PLGP janë 0.03 mg/l sipas Council Directive CEE/CEEA/CE 78/659 (Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659) për cilësinë e ujërave të ëmbël për rritjen e peshqve.
107 Standardet për sulfatet janë marrë nga Directive 75/440/ECC.
108 Standardi mjedisor për bakterin koliform (Total Coliform) është marrë nga NIVA - Instituti për Studimet e Ujërave të Norvegjisë (Classification of the Quality of Status for general parameters of fresh waters, Bratli, 2000).
109 Metalet e rënda janë monitoruar në Seman 1 dhe 2, Gjanicë 1 dhe 2, Devoll 2, Osum 5 dhe 6, si she Vjosë 1 dhe 3.
110 Ligji 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".
111 SHGJSH.
112 Të gjitha të dhënat rreth burimeve ujore nëntokësore janë marrë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
113 Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e Qarkut të Fierit sipas ndarjes administrative të territorit përpara Reformës së Re Administrative. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve për çdo bashki.
114 Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e qarkut të Fierit sipas ndarjes së vjetër të territorit. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve për çdo bashki sipas ndarjes së re administrative të vitit 2014.
115 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
116 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
117 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
118 USAID.
119 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
120 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
121 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
122 SHGJSH: Deri më sot ende nuk janë kryer studime që përcaktojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar nga puse të tilla.
123 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
124 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
125 AKM 2015, Raporti i Gjendjes në Mjedis.
126 Sipas monitorimit të SHGJSH-së rezultatet e të cilit janë raportuar nga AKM në Raportin për Gjendjen e Mjedisit 2014.
127 AKM 2014.
128 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.

129 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
130 USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Fier pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014.
131 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
132 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
133 Monitorimi i Vjosës për metale të rënda është kryer nga PLGP/Co-PLAN në vitin 2015.
134 Monitorimi i akuiferit të Vjosës është kryer nga SHGJSH-ja dhe raportuar nga AKM-ja në Raportin e Gjendjes së Mjedisit 2014.
135 Agency for Toxic Substances and Disease Registry, Case Studies in Environmental Medicine (CSEM), Lead Toxicity, USA 2012.
136 Reasonably Anticipated to be a Human Carcinogen.
137 EPA, http://www.atsdr.cdc.gov/substances/toxsubstance.asp?toxid=15
138 EPA, http://www.atsdr.cdc.gov/substances/toxsubstance.asp?toxid=44
139 EPA, http://www.atsdr.cdc.gov/substances/toxsubstance.asp?toxid=17
140 Known to be a Human Carcinogen.
141 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
142 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
143 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
144 AKM 2014.
145 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë 2014.
146 Matthew Heberger and Kristina Donnelly , Oil, Food, and Water: Challenges and Opportunities for California Agriculture, Pacific Institute, December 2015.
147 SHGJSH, 2014.
148 SHGJSH, 2014.
149 Ligji Nr. 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".
150 US EPA, //www.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program
151 http://ëëë.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program
152 Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
153 Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
154 Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
155 Ri-injektimi kryhet kryesisht për ri-injektimin e CO2, mbetjeve, përmirësimin e prodhimit të naftës, minierat, si dhe për parandalimin e depërtimit të ujit të kripur.155 Një praktikë e tillë është parë si një mënyrë e sigurt dhe e pak shpenzime për depozitimin e mbetjeve të padëshiruara dhe kryesisht të mbetjeve të rrezikshme industrial dhe nënprodukteve të tyre. http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
156 "Ndikimet mbi mjedis të industrisë nxjerrëse të naftës, vlerësimi i mjedisit në vendburimin e visokës dhe rrugët që duhet të ndiqen për rehabilitimin e tij", Nevton Kodhelaj, Nevina Koja, Fatjona Levani.
157 Në SHBA, kongresi ka kaluar ligjin për Mbrojtjen e burime ujore (the Safe Drinking Water Act - SDWA) në vitin 1974 i cili parashikon mbrojtjen e burimeve ujore që furnizojnë ppullsinë me ujë të pijshëm. Në kuadër të këtij ligji, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka hartuar programin e Kontrollit të Lëndëve të ri-injektuara Nëntokë (Underground Injection Program Control) i cili përcakton kushtet kur ri-injektimi lejohet me ligj.
158 Biseda me përgjegjës të kompanisë Bankers Petroleum Ltd.
159 Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Strategjia e Manaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore në Shqipëri-Versioni Draft, mars 2016.
160 Frashëri, A. 2014, Gjeofizikia inxhinierike dhe mjedisore, Akademia e Shkencave, Tiranë.
161 J. Int. Environmental Application & Science, Vol. 9(3): 365-372 (2014).
Erosion of Beaches on the Albanian Coast, Causes, Consequences, and Measures for Their Improvement, Adriatik Balla, Shpejtim Bulliqi.
162 J. Int. Environmental Application & Science, Vol. 9(3): 365-372 (2014).
Erosion of Beaches on the Albanian Coast, Causes, Consequences, and Measures for Their Improvement, Adriatik Balla, Shpejtim Bulliqi.

163J. Int. Environmental Application & Science, Vol. 9(3): 365-372 (2014).
Erosion of Beaches on the Albanian Coast, Causes, Consequences, and Measures for Their Improvement, Adriatik Balla, Shpejtim Bulliqi.
164 J. Int. Environmental Application & Science, Vol. 9(3): 365-372 (2014).
Erosion of Beaches on the Albanian Coast, Causes, Consequences, and Measures for Their Improvement, Adriatik Balla, Shpejtim Bulliqi
165 J. Int. Environmental Application & Science, Vol. 9(3): 365-372 (2014)
Erosion of Beaches on the Albanian Coast, Causes, Consequences, and Measures for Their Improvement, Adriatik Balla, Shpejtim Bulliqi.
166 AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
167 AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
168 AKM, Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2014, Kapitulli 9. Monitorimi i dinamikës së vijës bregdetare shqiptare dhe vlerësimi i impaktit gjeomjedisor në mbështetje të manaxhimit të integruar të hapësirës bregdetare (përgatitur nga SHGJSH).
169 AKM 2014.
170 Pano, N. 2015, Pasuritë Ujore të Shqipërisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë dhe Balla, A. 2015, Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin-Vlorë, Temë Disertacioni në kërkim të gradës shkencore "Doktor", Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Filologjisë dhe i Historisë, Departamenti i Gjeografisë, Tiranë.
171 Pano, N. 2015, Pasuritë Ujore të Shqipërisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë dhe Balla, A. 2015, Evolucioni morfotektonik dhe morfologjik i zonës bregdetare Shëngjin -Vlorë, Temë Disertacioni në kërkim të gradës shkencore "Doktor", Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Filologjisë dhe i Historisë, Departamenti i Gjeografisë, Tiranë.
172 AKM 2014
173 AKM 2014
174 AKM 2015
175 Për Kurorën duhet theksuar se është Monument Natyre dhe aktualisht i është transferuar në pronësi ish-Komunës Libofshe me VKM nr. 89. Kjo do të krijojë problem për administrimin dhe manaxhimin e saj, ndaj duhet pritur dalja e vendimit që do t'i kalojë pronat pyll Bashkisë.
176 KM 2015.
177 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
178 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
179 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
180 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
181 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
182 Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
183Air Quality according to the Ministry 2002-2012dhe AKM 2014.
184MM, AKM 2002 – 2014.
185VKM Nr. 594, Dt.10.9.2014 Përmiratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit.
186Normat e BE, http://ec.europa.eu/environment/air/quality/standards
187[i] David J. Nowak, USDA Forest Service, Syracuse, NY, The Effects of Urban Trees on Air Quality, 2002.
187SZHT, Bashkia Fier.
188 US EPA, https://www.epa.gov/greenvehicles/greenhouse-gas-emissions-typical-passenger-vehicle-0
189 US EPA (United States Environmental Protection Agency), Average Annual Emissions and Fuel Consumption for Gasoline-Fueled Passenger Cars and Light Trucks, 2008.
190 INSTAT, 2010.
191 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
192 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.

193 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
194 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
195 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
196 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March.
197 Bëhet fjalë për naftën që përdoret për makina.
198 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
199 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
200 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
201 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
202 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
203 AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
204 Environmental Center for Administration and Technology, Tirana 2008.
205 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
206 Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016.
207 Sipas studimit të ECAT në vitin 2008. Nga fushata pilot mbi shkarkimet e gazrave nga marmitat e makinave zhvilluar në qytetin e Tiranës në vitin 2008, është studiuar sasia e shkarkimeve në ajër nga makinat me moshë të ndryshme. Studimi ka testuar 1,036 automjete me vite të ndryshme prodhimi. 880 makina përdornin si lëndë djegëse naftën dhe 156 benzinën.
208 ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008.
209 ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008.
210 VNM - Vlersimi i Ndikimit në Mjedis.
211US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
212 US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
213 US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
214 US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
215 US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
216 US National Library of Medicine, Korrik 2016,
https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
217 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
218 The World Bank, Looking Beyond the Horizon.
219 ECN 2008.
220 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
221 The World Bank, Looking Beyond the Horizon.
222 SZHT Bashkia Fier, 2016.
223 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
224 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
225 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
226 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
227 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
228 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.

229 SZHT Bashkia Fier, 2016.
230 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
231 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
232 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
233 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
234 Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016.
235 The World Bank, Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change.
236 The World Bank, Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change.
237 United Nations Economic Commission for Europe Albania Environmental Performance Reviews, Second Revieë, United Nations, New York and Geneva, 2012, Raporti South-Eastern European mining related risks: Identification and verification of environmental hot spots.
238 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
239 United Nations Economic Commission for Europe Albania Environmental Performance Reviews, Second Revieë, United Nations, New York and Geneva, 2012, Raporti South-Eastern European mining related risks: Identification and verification of environmental hot spots.
240 United Nations Economic Commission for Europe Albania Environmental Performance Reviews, Second Revieë, United Nations, New York and Geneva, 2012, Raporti South-Eastern European mining related risks: Identification and verification of environmental hot spots.
241 Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Qytetit të Fierit – Co-Plan 2010.
242 Strategjia e Zhvillimit të Qytetit – 2005.
243 Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.
244 http://www2.epa.gov/hydraulicfracturing
245 Futet sërish në pusin e shpuar.
246Dr. Shannon L. Ferrell, Dr. Tiffany Dowell Lashmet, Dr. Rusty Rumley, *Petroleum Production on Agricultural Lands in Oklahoma: Managing Risks and Opportunities*, USDA National Institute of Food and Agriculture.
247 Matthew Heberger and Kristina Donnelly , Oil, Food, and Water: Challenges and Opportunities for California Agriculture, Pacific Institute, December 2015.
248 Agjencia Amerikane e Mjedisit, Chapter 5 Oil/Water Separators, 2013.
249 Neni 2, Pika 5 (Përkufizime dhe fushat e veprimit) të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR"
250 Neni 9, Pika 4 (Rezervat Natyror i Manaxhuar/Park Natyror) të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura"
251 Neni 2, Pika 20 (Përkufizime dhe fushat e veprimit) të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR"
252 Neni 2, Pika 7 (Përkufizime dhe fushat e veprimit) të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR"
253 Cit. Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)
254 Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)
255 AKZM 2016
256 Ligji Nr 8906, datë 06.06.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
257 VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit
258 VKM Nr. 102, dt. 12.02.2015. Për Krijimin dhe Funksionimin e AKZM dhe AdZM.
259 Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), 2016
260 Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016
261 Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016
262 AKZM 2016.
263 AKZM 2016.

264 AKZM 2016.
265 AKZM 2016
266 Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
267 Ligj Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore
268 AKZM 2016
269 Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2015
270 AKZM 2016
271 AKZM 2016
272 Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2015
273 AKZM 2016
274 AKZM 2016
275 AKZM 2016
276 SHGJSH, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit, Tiranë, 2014
277 AKZM 2016
278 VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e biodiversitetit
279 Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet".
280 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
281 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
282 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
283 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
284 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
285 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
286 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
287 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
288 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
289 Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
290 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
291 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
292 Libri i Kuq i Florës e Faunës Shqipëtare, 2007.
293 Llogaritjet autori, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e Censusit të popullsisë, 2011.
294 Shënim metodik: Instat-i mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në "trendin" që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracioni, i ka ndërtuar skenaret e projeksioneve të popullsisë. Sipas këtyre përllogaritjeve janë ndërtuar tre skenare të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes së ulët, (lindje të ulëta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu vlen te theksohet se projeksionet e popullsisë për rastin e qarqeve janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5-vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel bashkie ose komune.
Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre respektive ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur "projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe komunash për periudhën 2016-2031.
295 Bashki të ngjashme janë konsideruar bashki që kanë popullsi të përafërt me Fierin, respektivisht Vlora, Elbasani, Shkodra dhe Durrësi. Për krahasim është marrë në studim edhe Tirana.

296 Këto të dhëna i referohen Strategjisë Rajonale të Zhvillimit të Qarkut Fier (2003), sipas Regjistrimit të vitit 2001, ndërsa vlera e vitit 2011 i takon Censusit 2011. Nga ana metodologjike e llogaritjes së popullsisë dhe treguesit këto vlera mund të kenë një shkallë të lehtë gabimi.
297 Referuar studimit të Center for Economic and Social Studies, (CESS Albania) 2011, "Mapping Roma children in Albania " dhe Censusit 2011.
298 Në qelizat e shënuara p/i nuk është gjetur informacion mbi praninë e çerdheve.
299 Të dhënat janë përshtatur sipas të dhënave të Njësisë Administrative Fier (2014-2015) dhe të dhënave të NjA-së Libofshë, 2015.
300 Të dhënat janë përshtatur sipas të dhënave të Njësisë Administrative Fier (2014-2015) dhe të dhënave të NjA-së Libofshë, 2015.
301 Llogaritja është kryer duke përdorur rrezen maksimale të mbulimit sipas standardit të përcaktuar në Rregulloren e Planifikimit të Territorit (VKM 480): për kopshtet 350 metra në zonë urbane e 600 metra në zonë rurale; për shkolla 9-vjeçare 600 metra në zonë urbane dhe 1500 metra në zonë rurale; e për shkollat e mesme 1,500 metra në zonë urbane e 4,500 metra në zonë rurale.
302 Siç specifikohet në Rregulloren e Planifikimit të Territorit, VKM 480.
303 Referuar Analizës së Përdorimit të Tokës, llogaritje të autorit.
304 Ky vlerësim është kryer nga Ministria e Arsimit, për gjithë objektet arsimore (parashkollor deri në shkollë të mesme) në territorin e Shqipërisë, në vitin 2012.
305 Të dhëna të marra nga Buletini i Institutit të Shëndetit Publik, (nr.4/2014), dhe i referohen vitit 2013.
306 Referuar "Strategjisë Rajonale të Zhvillimit", Qarku Fier, 2003.
307 Instat, 2011.
308 Të dhëna të marra nga Buletini i Institutit të Shëndetit Publik, (nr.1/2014).
309 Të dhëna të marra nga Buletini i Institutit të Shëndetit Publik, (nr.3/2014).
310 Referuar "Strategjisë Rajonale të Zhvillimit", Qarku Fier, 2003.
311 Ky vlerësim i referohet "Studimit Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri, 2008-2009" (INSTAT dhe ISSH), i cili kryen vëzhgime shkencore duke u bazuar në 4 rajone statistikore: Rajoni Bregdetar, Rajoni Qendror, Rajoni Malor dhe Tirana Urbane.
312 Raportim i Institutit të Shëndetit Publik në Buletinin nr 1/2015.
313 Burimi: http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2015/04/09/shendeti-publik-ne-fier-rrezon-bankers-u-clirua-gaz-metan/
314 Sipas të dhënave të INSTAT-it, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, 2014 .
315 Qarqe të ngjashme janë konsideruar Vlora, Durrësi, Shkodra e Elbasani, për shkak të popullsisë së përafërt. Tirana është marrë në konsideratë për arsye krahasimore.
316 Të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë, të përshtatura sipas DRSH-së Fier, 2015 dhe Dokumentit të Politikave të Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qendër, 2012.
317 I propozuar në Dokumentin e Politikave të Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qendër, 2012.
318 Kjo i referohet gjithnjë llogaritjes për vitin 2015 sipas Censusit 2011. Shifrat e Gjendjes Civile japin vlerë rreth 2 herë më të lartë të popullsisë.
319 Seksioni 1.4.1
320 Vjetari Statitikor Rajonal 2015, INSTITUTI I STATISTIKAVE.
321 Shiko seksioni i parë i analizës ekonomike.
322 Burimi: Ministri i Çështjeve Vendore, analizat e kryera në kuadër të Reformës Territoriale.
323 Vlera e shtuar Bruto sipas sektorëve 2012. Burimi: INSTAT.
324Organizatës për Bujqësi dhe Ushqim (FAO), 2014.
325 Të dhëna të marra nga Bashkia Fier, Prill 2016.
326 INSTAT, 2015
327 INSTAT, 2011.
328Strategjia Ndërsektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020.
329Strategjia Ndërsektoriale për Zhvilllimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020 dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Fier.
330Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014 "Analiza e skemave mbështetëse. Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi".
331Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014"Analiza e skemave mbështetëse. Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi".
332 Vjetari statistikor i Bujqësisë 1990.
333 Intervista u krye me Z. Muhamet Baboci punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësise Fier.
334CENSUS 2011.

335 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, Mars 2012, studimet pedologjike janë kryer nga lnstituti i Studimit të Tokave, në vitet 1981-1982.
336 Burimi: Bashkia Fier dhe Co-PLAN. Sipërfaqja është nxjerrë nga harta e përdorimit të tokës e punuar në GIS.
337 Harta Pedologjike e Fierit (Instituti i Studimit të Tokave, 2005).
338Plani Ndërvendor i Përgjithshëm, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Komunat Bubullimë, Mbrostar, Zharrëz, Kuman dhe Portëz.
339 AKM 2014.
340 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
341 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
342 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
343Plani i Përgjithshëm Vendor i Komunës Mbrostar, tetor 2013.
344Plani i Përgjithshëm Vendor i Komunës Mbrostar, tetor 2013.
345 Drejtoria Rajonale Bujqësore Fier, 2015.
346Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
347 Komuna Dërmenas
348 Komuna Dërmenas
349 Komuna Dërmenas, Plani i Zhvillimit të Komunës Dërmenas, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
350 Informacionet e përdorura në këta paragrafë janë gjeneruar nga shkresa zyrtare nr. 4031, datë 25.09.2015, që Drejtoria e Bujqësisë Fier i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Fier.
351 Për më tepër informacion të shikohet analiza e metabolizmit.
352Drejtoria e Bujqësisë Fier, 2015.
353 INSTAT, 2015.
354 INSTAT, 2015.
355 Plani Ndërvendor i Përgjithshëm, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Komunat Bubullimë, Mbrostar, Zharrëz, Kuman dhe Portëz.
356 Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293.
357 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
358 AKM, 2014.
359 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
360 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
35. Sherif Lushaj, Fragmentimi dhe konsolidimi i tokes, 2003 (libër Shtepia botuese Emal) [rregullo se nuk eshte OK]
361 LIGJI Nr.8743, dt. 22.02.2001 (Ndryshuar me ligjin nr. 9558[2]/2006): Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit.
362 Përdorimi i Tokës është hartuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN Instituti pë Zhvillimin e Habitatit.
363 Nga kjo listë e të dhënave nuk janë të përfshira disa zona publike për të cilat informacioni nuk ishte i plotë dhe si rrjedhojë nuk mund të bëhej llogaritja në programin GIS.
364 Llogaritja është bërë duke marrë parasysh vetëm të dhënat për pronat publike që vijnë nga Inventari i Pronave Publike. Pra të gjitha këto prona konsiderohen si 100%, por kjo është bërë për efekte llogaritje. Nga kjo listë e të dhënave nuk janë të përfshira zonat pyjore, rrugët si edhe një pjesë e madhe e pronave publike për të cilat informacioni nuk ishte i plotë dhe si rrjedhojë nuk mund të bëhej llogaritja në programin GIS.
365"Hapësirë publike" sipas përkufizimit të bërë në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit".
366 LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës.

367 http://www.arrsh.gov.al/projekte-me-finacim-te-huaj-donacione/sinjalistike-rrugore-2/bypas-i-fierit
368 https://sq. wikipedia. org/wiki/Lista_e_rrug%C3%ABve_komb%C3%ABtare_dhe_autostradave_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri
369 Nga analiza e kryer nga grupi i punës në sistemin G. I. S.
370 Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 i Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488, datë 5.12.2011, f. 7.
371 Përgatitur nga informacionet e marra nga ndriçimi urban, FSHZH-ja, vëzhgimet në terren, si dhe evidentimi nga ortofoton e vitit 2007 dhe 2015, ASIG.
372 http://www. albaniandf. org/Resources/Lista_e_Rrugeve_te_finacuara_nga_FSHZH_2005-2013.pdf, page 3.
373 2 është niveli më i lartë i rrezikshmërisë dhe 1 ka rrezikshmëri më të ulët.
374 Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 "Per transportet Rugore", i ndryshuar.
375 Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 "Per transportet Rugore", i ndryshuar.
376 Dokumenti i analizës së thelluar të Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qender, korrik 2012, f. 44.
377 Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar.
378 Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar.
379 Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar.
380 Dokumenti i analizës së thelluar të Bashkise Fier dhe një pjese të Komunës Qender, korrik 2012, f. 44.
381 ligji nr. 9317, datë 18.11.2004, KODI HEKURUDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE
382 Dokumenti i analizës së thelluar të Bashkisë Fier dhe një pjese të Komunës Qender, korrik 2012, faqe 44
383 ligji nr. 9317, datë 18.11.2004, KODI HEKURUDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.
384 Plani i Tranzicionit Për Shërbimet Ujësjellës-Kanalizime Sipas Reformës Në Sektorin e Ujit.
385 Burimi ValuAdd & KfW Design Report – Fier,
386 Projekti i përpiluar prej KfW.
387 PLGP/USAID/ValueAdd dhe KfW Design Report – Fier.
388 SCADA - Supervisory Control and Data Acquisition.
389 Bashkia Fier.
390 PLGP/USAID/VALU ADD, 2015.
391 Burimi: Bashkia Fier 2016.
392 Burimi: Bashkia Fier 2016.
393 Burimi: Bashkia Fier 2016.
394 Burmi : Të dhëna të përpunuara nga Co-PLAN 2016.
395 Raporti Gjendjes në Mjedis –2015 Seksioni Mbetjeve Fq.245.
396 Draft vlerësimi i situatës ekzistuese të ofrimit të shërbimit të mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Fier dhe skenarët paraprakë të përmirësimit/zgjerimit të shërbimit në një periudhë afatshkurtër.
397 Raporti Gjendjes në Mjedis –2015.
398 Indikator i përcaktuar nga AKM për Bashkinë Fier.
399 SHGJSH, 2014.
400Mbetjet në këtë pjesë të lumit janë vënë re gjatë vizitave në terren të ekspertëve të Co-PLAN gjatë 2015-2016.
401 Raporti Tregues i Gjendjes Mjedisore – Mbetjet Spitalore për 5 Bashki të vendit – SENIORA Project.
402 Bashkia Fier dhe ARM Fier, 2016.
403 Plani Lokal i Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Qytetit të Fierit – Co-Plan 2010.
404 Korrespondenca AKM – Bashki Fier.
405 Strategjia e Zhvillimit të Qytetit – 2005.
406 Të dhënat për kompanitë ricikluese nga Ministria e Mjedisit, aksesuar për herë të fundit tetor 2015.
407 E ekstrapoluar sipas Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve 2011.
408 Harta e Metabolizmit, Fluksi i Mbetjeve, Fier.
409 Vendim i KM-së nr. 175, datë 19.1.2011, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të manaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve".
410 Bashkia Fier 2012, Dokumenti i Politikave për Planin e Përgjithshëm të Planifikimit të Territorit, Bashkia Fier.

412 Burimi: Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.
[413] VKM 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
[414] Analiza policentrike, Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Fier, 2016
415 Për më shumë informacion shiko seksionin e analizës bujqësore.
416 UNESCO 2015, Lista Tentative, http://whc. unesco. org/en/tentativelists/5885/, referuar më 19.11.2015.
417 Instituti i Monumenteve të Kulturës 2015, Lista e Monumenteve Qarku Fier, http://www. imk. gov. al/wp-content/uploads/monumente/lista%20e%20monumenteve/FIER. pdf referuar më 19.11.2015.
[418] VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
419 AKPT 2015, Harta: Zonat me rëndësi kombëtare, http://planifikimi. gov. al/sites/default/files/Bregdeti_0.pdf referuar më 19.11.2015.
420 "Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020" miratuar me Vendim i KM, Nr. 691, data e aktit: 29.07.2015
421 Co-PLAN 2015, Harta e Përdorimit të Tokës Fier – Draft.
422 Ministria e Energjisë dhe Industrisë 2014, Promovim mundësie investimi në objekte industriale (anglisht),http://www.energjia.gov.al/files/userfiles/Industria/Promovim_mun desie_investimi_(anglisht)INFORMATION_ON_FORMER_INDUSTRIAL_BUILDINGS_PRONE_TO_OPPORTUNITIES_FROM_INVESTORS_IN_INDUSTRY_FIELD. pdf aksesuar 19.11.2015.
423 TAP AG 2015, Udhëzues për Blerjen dhe Qiranë e Tokës në Shqipëri, http://www. tap-ag. al/assets/03.land_access/albanian/GLAC_FINAL_PRINT. pdf referuar më 19.11.2015.
424 Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM Nr. 671.
425 Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM Nr. 671.
426 The World Bank, Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change.
427 INSTAT, 2015.
428 INSTAT, 2015.
429 Plani Ndërvendor i Përgjithshëm, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Komunat Bubullimë, Mbrostar, Zharrëz, Kuman dhe Portëz.
430 Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293.
431 Komuna Qendër, Relacion për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër, mars 2012.
432 AKM, 2014.
433 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
434 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2014.
435 Ligji 116/2013.
436 Kodi Hekurudhor (Ligji Nr. 9317, datë 18.11.2004).
437 Analiza e Përdorimit të Propozuar të tokës, Seksioni 2.1.2.
438 Ligji 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".
439 Plani i Përgjithshëm Kombëtar, 2015.
440 Plani i Përgjithshëm Kombëtar, 2015.
441 Ligji 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".
442 Informacioni mbi Azotikun ka si burim përfaqësuesin juridik të Ndërmarrjes së Azotikut, dhe daton në prill 2016.
443 Alberta Environment and Sustainable Resource Development, 2012: "Stepping Back from the Water: A Beneficial Management Practices Guide for New Development Near Water Bodies in Alberta's Settled Region".
444 Neni 6, Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura".
445 VKM nr 1, Datë 08.04.2014, " Për miratimin e lejes zhvillimore komplekse për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)".
446 Idem.
447 Referencë është marrë popullsia e parashikuar mbështetur në vlerat e marra nga Gjendja Civile, prill 2016.
448 Neni 86, VKM nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".
449 Neni 86, Pika 3,b, VKM nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

450 Ligji 8906 dt. 06.06.2002, “Për zonat e mbrojtura”.
451 Sipas ligjeve sektoriale respektive, të përcaktuara në Seksionin 1.10.
452 Shih Seksionin 1.4.2.
453 Multi-Anual Development Plan, Five year Multi-Annual Plan 2016,page 36.
454 http://www.transporti.gov.al/al/newsroom/njoftime/njoftim-per-linjat-e-reja-te-transportit-nderqytetas&page=1
455 Me ish-periferi të qytetit kuptojmë periferinë e qytetit deri pranë stadiumit.
456 Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
457 Closed Circuit Tele-Vision - Video inspektim i seksionti të tubacionit për dëmtime apo ndërhyrje të paligjshme.
458 Nevoja Biokimike për Oksigjen - NBO.
459 Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve - 2010 – 2025 f. 35.
460 Plani Kombëtar i Manaxhimit të Mbetjeve - 2010 – 2025 f. 41.
461 Pikë Transferimi Mbetjesh Urbane quhet një stacion tranzitor i përcaktuar për grumbullimin e përkohshëm e të gjithë mbetjeve urbane të një Bashkia/Qyteti apo komuniteti të vogël të cilat kanë si destinacion final Landfillin.
462 mmnd – metra mbi nivel deti.
463Ligji Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
464 SHGJSH, 2016
465 ARM 2014
466 SHGJSH
467 SHGJSH
468 SHGJSH
469 SHGJSH
470 SHGJSH
471 Rezultatet e monitorinit publikohen në Raportin e Monitorimit të Mjedisit të vitit përkatës.
472 http://www.epa.gov/uic/class-ii-oil-and-gas-related-injection-wells#dw_protect
473 SHGJSH